MËSIMDHËNIA E HISTORISË BASHKËKOHORE E EVROPËS JUGLINDORE

LIBRA MBËSHTETËS PËR MËSUESIT E HISTORISË

VËLLIM 1

LUFTA E FTOHTË (1944-1990)

Botuesi: Qendra për Demokraci dhe Pajtim në Evropën Juglindore (CDRSEE)
Redaktori në anglisht: Philip Carabott
Përktheu nga anglishtja: Ergys Bezhani
Korrektori: Nerina Kioseoglou
Faqosja: Ioanna Ghika
Dizajni grafik: LYNX, Karavasiloglou Ioulia, Eressou 65, 10683, Athinë, Greqi
Shtëpi Botuese: SAITI Publications S.A., Ermou 4, Metamorfosi 14452, Athinë, Greqi
Tirazhi: 1,500 kopje

"Ky botim u realizua me ndihmën e Bashkimit Evropian. Për përmbajtjen e këtij botimi mbajnë përgjegjësi vetëm autorët e tij, dhe pikëpamjet e shprehura në libër nuk pasqyrojnë domosdoshmërish edhe pikëpamjet e Bashkimit Evropian"

Raportuesi i CDRSEE-së në Bordin për Projektin e Përbashkët të Historisë: Costa Carras
Drejtori ekzekutiv i CDRSEE-së: Zvezdana Kovac
Ekipi i projektit të CDRSEE-së: Antonis Hadjiyannakis, Jenny Demetriou, Susan Nadeau, Ruth Sutton, Sasa Kulenovic, Michaela Zervidou dhe Elena Farini

REALIZIMI I KËTIJ LIBRI U MUNDËSUA NGA:

FONDATION PRO VICTIMIS GENÈVE

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG

SOE Dialog Südosteuropa

Deklaratë: Emërtimet që përdoren në këtë libër, si edhe të gjitha materialet që do të paraqiten në vijim, nuk nënkuptojnë medoemos pikëpamjet e botuesit (Qendra për Demokraci dhe Pajtim në Evropën Juglindore), apo të donatorëve të këtij të fundit (Fondacionet Shoqëria e Hapur). Ky libër pasqyron këndvështrimet e autorëve si individë, dhe ato nuk janë detyrimisht edhe pikëpamjet e Qendrës për Demokraci dhe Pajtim në Evropën Juglindore, apo të donatorëve të saj.

Përmbajtja e librit bazohet në kontributet e ndryshme të partnerëve tanë, që e ofrojnë përmbajtjen, e garantojnë dhe e përfaqësojnë atë, në dijeninë e tyre, nuk cenon të drejtat e ndonjë pale të tretë. Rrjedhimisht, botuesi nuk mban përgjegjësi, për ndonjë shkelje të të drejtave të asnjë pale të tretë, që mund të shkaktojë si rezultat i përmbajtjes së ofruar nga partnerët e ndryshëm.

Të drejtat e autorit: Qendra për Demokraci dhe Pajtim në Evropën Juglindore (CDRSEE):
Krispou 9, Ano Poli, 546 34 Selanik, Greqi
Tel: +30 2310 960820-1 Fax: +30 2310 960822
e-mail: info@cdrsee.org web: www.cdrsee.org

ISBN: 978-960-88963-8-3

MËSIMDHËNIA E HISTORISË BASHKËKOHORE E EVROPËS JUGLINDORE

LIBRA MBËSHTETËS PËR MËSUESIT E HISTORISË

VELLIMI 1

LUFTA E FTOHTE(1944-1990)

Redaktuar nga:

NEVEN BUDAK dhe ALEXEI KALIONSKI

Redaktore e serisë:

KRISTINA KOULOURI

Redaktor për botimin në gjuhën shqipe:

ARTAN PUTO

CDRSEE

Center for Democracy and Reconciliation in Southeast Europe

Selanik, 2016

TABELA E PËRMBAJTJES

PARATHËNIE 9

HYRJE E PËRGJITHSHME 13

KAPITULLI I. Shtete të vjetra, regjime të reja 18

Hyrje 19

I.1. Fundi i Luftës së Dytë Botërore 21

I.1.1. Çlirimi 21

I.1.2. Rikthimi në atdhe ose internimi 25

I.1.3. Rindërtimi 29

I.2. Regjime të reja 34

I.2.1. Tranzicioni 34

I.2.2. Opozita 42

I.2.3. Shtypja 45

I.3. Lufta Civile Greke 49

KAPITULLI II. Lufta e Ftohtë 58

Hyrje 59

II.1. Fillimi i Luftës së Ftohtë 61

II.2. Ndarja e Titos nga Stalini 64

II.3. Greqia dhe Turqia 69

II.4. Lëvizja antikolonialiste në Qipro 72

II.4.1. Kërkesa për bashkimin me Greqinë dhe reagimet 72

II.4.2. Pogromi kundër grekëve dhe jomyslimanëve të tjerë në Stamboll 73

II.4.3. Konflikte midis komuniteteve 76

II.4.4. Pavarësia 79

II.4.5. Shkatërrimi dhe përshkallëzimi i dhunës 81

II.5. NATO, Traktati i Varshavës dhe Lëvizja e Vendeve të Paangazhuara 84

II.5.1. NATO përballë Traktatit të Varshavës 84

II.5.2. Lëvizja e Vendeve të Paangazhuara 90

II.6. Aleancat ballkanike 92

II.6.1. Planet për Federatën jugosllavo-bullgare 92

II.6.2. Pakti ballkanik i vitit 1954: Turqia, Greqia dhe Jugosllavia 94

II.6.3. Rrugëtimi i Shqipërisë 95

KAPITULLI III. Diktaturat dhe tranzicionet demokratike 100

Hyrje 101

III.1. Regjimet komuniste 105

III.1.1. Socializmi real 105

III.1.2. Jugosllavia dhe vetadministrimi 106

III.2. Regjimet ushtarake 108
III.2.1. Diktatura ushtarake në Turqi 108
III.2.2. Diktatura e kolonelëve në Greqi 112
III.3. Përndjekja e qytetarëve: kampe dhe burgje 114
III.4. Lëvizjet rinore 120
III.5. Tranzicionet demokratike: arritjet dhe dështimet 122
III.5.1. Greqia 122
III.5.2. Turqia 124
III.5.3. Jugosllavia 125

KAPITULLI IV. Ideologjia 130
Hyrje 131
IV.1. Propaganda 135
IV.2. Kulti i individit 141
IV.3. Versionet e historisë 144
IV.4. Arsimi 147
IV.5. Politikat e gjuhës 152
IV.6. Arti 155

KAPITULLI V. Ekonomia 160
Hyrje 161
V.1. Reformat agrare 164
V.2. Industrializimi 168
V.3. Urbanizimi 176
V.4. Infrastruktura 186
V.5. Financat 189

KAPITULLI VI. Demografia 190
Hyrje 191
VI.1. Migracioni 193
VI.2. Pakicat 197
VI.3. Ndryshimet e popullsisë 204

KAPITULLI VII. Shoqëria dhe kultura 208
Hyrje 209
VII.1. Gjinia 211
VII.2. Feja 218
VII.3. Kultura rinore 222
VII.4. Letërsia dhe kinematografia 225
VII.5. Konsumizmi 230

VII.6. Turizmi 236
VII.7. Politikat shoqërore 240
VII.8. Sporti 242

KAPITULLI VIII. Kohë krizash 246
Hyrje 247
VIII.1. Qiproja në vitin 1974 249
VIII.2. Jugosllavia e viteve 1980 253
VIII.3. Kriza e komunizmit 262

BIBLIOGRAFIA 273

HARTA
Harta etnografike e Qipros në momentin e pavarësisë (1960) 81
Evropa gjatë Luftës së Ftohtë 66
Republikat jugosllave dhe krahinat autonome 261

Kanë kaluar 20 vjet që nga koha kur Projekti i Përbashkët për Historinë (JHP) iu propozua Qendrës për Demokraci dhe Pajtim në Evropën Juglindore (CDRSEE), si projekti i saj i parë dhe më i ngutshmi; 17 vjet që nga mbajtja e konferencës në ishullin Chalki, pranë Rodosit, që themeloi Komitetin e Arsimit të Historisë me në krye profesore Kristina Koulouri, dhe njëmbëdhjetë vjet që nga botimi i katër librave të parë, të titulluar: "Perandoria Osmane"; "Kombet dhe shtetet"; "Luftërat Ballkanike"; dhe "Lufta e Dytë Botërore". Këta katër libra janë përkthyer në të gjitha gjuhët e rajonit, përveç dy gjuhëve, dhe janë botuar edhe në dy gjuhë të tjera jashtë rajonit, jo çuditërisht njëra prej tyre është gjuha angleze (versioni origjinal) dhe tjetra, që ngjall edhe më shumë habi, është gjuha japoneze. Po cila është arsyeja? Kjo vjen si rezultat i vlerësimit të madh që ka Japonia për cilësinë e lartë të arritur nga JHP, por edhe për nevojën e një projekti të ngjashëm në Lindjen e Largët. Në vitin 2013, JHP u nderua me Çmimin e Përvitshëm të të Drejtave të Njeriut të Friedrich-Ebert-Stiftung në Berlin, një ngjarje që na dha të gjithëve një kënaqësi të madhe.

Në vitin 1995, Evropa Juglindore ishte një territor me probleme të veçanta dhe shumë serioze. Në vitin 2016, ndërsa po botohen dy librat e punës: "Lufta e ftohtë (1944-1990)" dhe "Luftërat, Ndasitë, Integrimi (1990-2008)", po bëhet gjithnjë e më e qartë se edhe vendet që e konsideronin veten të paprekur nga fenomene si racizmi, nacionalizmi apo nga paragjykimet e rrënjosura kundër popujve të tjerë evropianë, sot, kanë nevojë për një projekt të tillë, po aq sa edhe vendet e Evropës Juglindore. Sidoqoftë, Evropa Juglindore mund t'iu ofrojë të tjerëve përvojë dhe ekspertizë në përballimin e kësaj nevoje. Për rrjedhojë, rajoni ynë nuk është vetëm një pjesë e problemit apo thjesht problematik, por është edhe shembull i një përpjekjeje krijuese, për të gjetur zgjidhjen e një problemi të përhapur gjithandej dhe një problemi mbase të përgjithshëm. Për këtë arsye, në emër të Bordit të Qendrës për Demokraci dhe Pajtim në Evropën Juglindore, dëshiroj që këto dy libra të rinj të mirëpriten me vështrim kritik objektiv, që është gjithmonë i nevojshëm për studimin realist të historisë, por edhe me shpresën se përkushtimi i tyre ndaj punës që ata kanë materializuar, duhet të shërbejë si nxitje për t'u zbatuar me vendosmëri, kudo që të jetë e mundur. Pasi vetëm kështu Evropa, por edhe mësimi i historisë, me siguri do të jenë më të fortë dhe më të besueshëm. Nëse përpjekja, që Qendra filloi dy dhjetëvjeçarë më parë dhe që e ka zbatuar vazhdimisht që atëherë, mund të përforcohet në rajonin tonë dhe përtej tij, si rezultat i Vitit të Trashëgimisë Kulturore Evropiane në vitin 2018, atëherë festimi i atij viti jo vetëm që e vlerëson dhe e nderon të shkuarën tonë të përbashkët evropiane, si një e kaluar e pasur, e përbashkët dhe e larmishme njëkohësisht, por punimet e kësaj Qendre kontribuojnë dukshëm në kulturën evropiane dhe, ndoshta, edhe në të ardhmen tonë politike.

Tiparet dalluese të librave të përgatitura nga JHP janë të ditura. Tipari i parë është ai i nxitjes së një qasjeje kritike ndaj historisë, diçka e domosdoshme për çdo qytetar të ndërgjegjshëm, si edhe për çdo historian profesionist. Tipari i dytë është kundërshtimi për ta ndryshuar – dhe rrjedhimisht mospranimi për të ndjekur – modelin e pranuar të historive kombëtare, sipas të cilit çdo gjë e jona është e drejtë dhe çdo gjë e tjetrit hiqet: Projekti i Historisë së Përbashkët nuk e sheh si detyrë të sajën fshehjen e ngjarjeve të padenja të historisë, si ato që janë përgjegjësia jonë, ashtu edhe ato që janë përgjegjësi e të tjerëve. Së treti, këto libra paraqesin një vizion të gjerë dhe shumëplanësh; sepse ato përfshijnë si historinë kulturore dhe shoqërore, ashtu edhe atë politike dhe ekonomike; sepse të dhënat që janë paraqitur dhe trajtuar në to, janë mbledhur nga burime të ndryshme, mes përpjekjeve kolektive të historianëve, nga i gjithë rajoni dhe më gjerë. Së katërti, tezat, pyetësorët, dhe çelësat, janë përgatitur me qëllim që të depërtojnë lirshëm zemrat dhe mendjet e gjithsecilit, pa asnjë hamendësim paraprak se tjetri është më i mirë, ose më i keq se ne.

Vetë detyra që kemi ndërmarrë do të thotë se koha, hulumtimi dhe shqyrtimi i matur, do të çojnë dhe kërkojnë, në mënyrë të pashmangshme, në rishqyrtimin e punës së paraqitur këtu. I tillë paraqitet parashtrimi i trajtesave historike në katër librat e parë të punës, të botuar në vitin 2005 dhe të ribotuar në vitin 2009. Megjithatë, Bordi shpreson dhe beson se synimi i botimeve të historisë dhe i mësimdhënies së historisë së paraqitur, janë një përvetësim i përhershëm, një fener që do të vazhdojë të ndriçojë përmes një panorame gjithnjë e më të re evropiane.

Puna për hartimin e këtyre dy librave ka qenë shumë më e vështirë për t'u përfunduar, sesa puna që kërkuan katër librat e mëparshëm të punës. Ata trajtojnë probleme të historisë bashkëkohore. Rrjedhimisht nuk ka pasur kohë të zbuten pakënaqësirat dhe urrejtjet, por ka pasur kohë

të mjaftueshme për disa që ta harronin historinë në çdo kohë dhe në çdo vend. Procesi i përpilimit të tyre ka qenë i ndërlikuar, por me punën ngulmuese që është kryer ka qenë jashtëzakonisht krijues, dhe Bordi dëshiron të shprehë mirënjohje dhe admirim për të gjithë ata që kanë marrë pjesë në të.

Falënderimet duhet t'i nisim së pari nga Drejtoria e Përgjithshme për Negocimet e Fqinjësisë dhe Zgjerimit (DG-NEAR), që në vijim të përvojës së fituar për përgatitjen dhe botimin e katër librave të mëparshëm e posaçërisht për dejtorin e atëhershëm të CDRSEE, z. Nenad Sebek, që në vitin 2014 na ofroi ndihmën e nevojshme financiare për të përgatitur dy librat e rinj të punës, në një version të parë në gjuhën angleze. I falënderojmë ata për mbështetjen e tyre të pakufishme që na kanë dhënë deri më tani, dhe besojmë se përmes përkrahjes së nevojshme të përkthimeve të dy librave do t'iu kthehet investimi i tyre, që ata e meritojnë plotësisht.

Që këto dy libra të përfundonin, u nevojit mobilizimi tërësor i personave të angazhuar brenda dhe jashtë Evropës Juglindore. Në emër të Bordit dëshiroj të falënderoj secilin prej tyre, si për shembull kontribuesit e burimeve në secilin vend, anëtarët e Komitetit Burimor që mbikëqyrnin përzgjedhjen e burimeve dhe përkthyesit dhe redaktorët e gjuhës, që përballuan dhe kryen një punë voluminoze dhe cilësore, duke pasur parasysh se procesi përfshinte përkthimin dhe redaktimin në anglisht, nga jo më pak se njëmbëdhjetë gjuhë. Dizajni i mirë do të jetë shumë i rëndësishëm për suksesin edhe të këtyre dy librave, ashtu siç u provua edhe për katër librat e parë të punës; gjashtë librat e punës kanë gjithashtu të njëjtin botues, Petros Ballidis. I falënderojmë përzemërsisht të dy, si dizenjuesin ashtu edhe botuesin tonë.

Një rrjet i gjerë miqsh, akademikësh dhe specialistësh, me vullnetin e tyre u angazhuan për diskutimin, rihartimin dhe sigurimin e materialeve të mëtejshme burimore, sidomos në dy çështjet më kritike të të gjithë procedurës, së pari pas vërejtjeve dhe sugjerimeve të lexuesve dhe, së dyti, pas evidentimit të disa problemeve në fushën e të drejtës së autorit.

Ndihmesa e lexuesve tanë ishte vendimtare, siç kishte ndodhur edhe me katër librat e mëparshëm të punës. Kjo është veçanërisht e vërtetë për Maria Todorovën nga SHBA, me përvojën e saj, si lexuese edhe për katër librat e mëparshëm. Apo edhe ajo e lexuesve të tjerë si Andreas Demetriou nga Qiproja dhe Florian Bieber nga Austria, që ofruan vërejtje të vlefshme që e ndihmuan JHP-në në punën e saj për të nxjerrë më realisht në pah historinë e disa vendeve dhe disa çështjeve të rajonit, pa krijuar probleme për pasqyrimin më real të tyre në disa vende të tjera në rajon. Ne iu jemi shumë mirënjohës atyre për komentet dhe sugjerimet e tyre të vazhdueshme.

Stafi i CDRSEE-së në Selanik, nën drejtimin e palodhur të Zvezdana Kovaçit, ka përballuar me profesionalizëm dhe me këmbëngulje një sërë sfidash të mëdha gjatë përgatitjes së këtyre librave. Barra ka qenë veçanërisht e rëndë në muajt e fundit para botimit, kur stafi ynë ka kapërcyer me sukses vështirësi të paparashikuara dhe për të cilat Qendra është shumë mirënjohëse.

Barra kryesore e punës së kryer gjatë kësaj periudhe iu ka rënë kryesisht gjashtë studiuesve. Dy prej tyre përkatësisht: Dubravka Stojanoviç nga Serbia dhe Niyazi Kizilyurek nga Qiproja, vepruan si këshilltarë. Ata të dy punuan me të njëjtin përkushtim dhe këmbëngulje si edhe katër redaktorët. Redaktorët e variantit të parë (ose ndoshta duhet të themi "variantit të pestë") ishin Alexei Kalionski nga Bullgaria dhe Neven Budak nga Kroacia, ndërsa redaktorë të variantit të dytë (ose "variantit të gjashtë") ishin Kristina Koulouri nga Greqia dhe Bozo Repe nga Sllovenia. Për fat të mirë kam qenë dëshmitar i bashkëpunimit jashtëzakonisht të ngushtë dhe krijues midis të gjithë redaktorëve dhe këshilltarëve. Në pikëpamjen time personale hartimi i kapitullit mbi shpërbërjen e ish-Jugosllavisë paraqet një arritje të suksesshme, ku saktësia dhe baraspesha midis ngjarjeve të ndodhura dhe përshkrimit të tyre, kanë pasqyruar të vërtetën historike në shkallën më reale të mundshme. Gjithashtu, kam qenë dëshmitar i ndjenjës së përgjegjësisë që tregoi znj. Kristina Koulouri gjatë drejtimit dhe udhëheqjes së tërë procesit si Redaktore e Serisë, me mirësjellje dhe vendosmëri të lakmueshme, sidomos në përballimin e ngarkesave dhe punëve të shumta në fazat e mëvonshme të përgatitjes së vëllimeve. Pa përkushtimin, njohuritë dhe përvojën e saj, realizimi i detyrës do të ishte i pamundur.

Si përfundim dua të theksoj se hartimi dhe përgatitja e këtyre dy librave, kërkonte angazhimin e njëkohshëm të një numri të madh punonjësish, të cilët në emër të Bordit të CDRSEE-së dëshiroj t'i falënderoj dhe t'i përgëzoj të gjithë,

por edhe të shpreh besimin se puna e tyre e kryer për këto dy libra, që tani janë të përfunduar nga krijuesit e tyre, do të arrijnë pa dyshim një sukses të merituar, mbase nganjëherë përmes polemikash e debatesh të ashpra që mund të zhvillohen në një rajon ende të trazuar. Një kënaqësi e veçantë është mbështetja që CDRSEE ka marrë nga të gjitha ministritë e arsimit në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi.

Në udhëtimin e ardhshëm, librat e rinj të punës që do të përgatiten e do botohen prej JHP-së do të gjejnë rreth tyre një flotë anijesh të vogla, shkolla të shumta, private dhe publike në rajon, mësuesit dhe nxënësit e të cilave do të përdorin materialin që Bashkëpunuesit e CDRSEE-së kanë përpiluar në kuadër të JHP-së. Për ata, dhe veçanërisht për shumë mësues të cilët kanë marrë pjesë aktivisht në vlerësimin dhe përdorimin e librave të mëparshëm, si këto që po paraqitën tani, unë gjithashtu dëshiroj të shpreh vlerësimin e Bordit. Falë tyre kjo përpjekje u bë realitet: por mbështetja dhe entuziazmi i tyre janë shpërblimi ynë më i madh dhe shpresa më e sigurt e rajonit për të ardhmen.

COSTA CARRAS
raportuesi i Bordit të Drejtorëve të JHP-së


THE PEOPLE'S YOUTH
OF JUGOSLAVIA INVITES YOU TO PARTICIPATE IN THE CONSTRUCTION
OF THE HIGH-WAY OF FRATERNITY AND UNITY BEOGRAD-ZAGREB

Nga viti 2005 në vitin 2016: Vazhdimësitë dhe ndërprerjet

Botimi i dy vëllimeve me materiale studimore, mbi historinë e Evropës Juglindore nga viti 1944 deri në vitin 2008, përbën vazhdimësinë e katër librave të punës, që paraqesin periudhën nga pushtimi osman i Ballkanit, deri në Luftën e Dytë Botërore - përveç një numri të vogël tekstesh që bënin fjalë për historinë e viteve të pas Luftës së Dytë Botërore, duke dokumentuar krijimin e shteteve të reja kombëtare pas vitit 1990. Botimi i parë në gjuhën angleze i Librave, që u realizua njëmbëdhjetë vjet më parë, u përkthye në shumë gjuhë, dhe u vlerësua nga mësuesit e historisë në pothuajse të gjitha vendet e Evropës Juglindore. Njohuritë e vlefshme të fituara në seminaret e trajnimit të mësuesve, që ne organizuam, janë pasqyruar në çdo ribotim kombëtar, duke realizuar disa përmirësime dhe shtesa.

Këto dy vëllime të reja, janë arritjet e fundit të hulumtimeve të kryera nga një ekip i madh historianësh, që japin mësim në arsimin e mesëm dhe të lartë. Disa prej tyre kanë kontribuar edhe në punën përgatitore të vëllimeve të mëparshme, megjithatë, shumica e tyre janë të rinj; por duhet evidentuar fakti se kontributi i të dy palëve ka qenë një punë e vyer. Ashtu si edhe në vëllimet e mëparshme, burimet e gjetjes dhe regjistrimit të të dhënave, kanë qenë përgjegjësi e anëtarëve të Komitetit Burimor të ngritur në nivel kombëtar. Në tërësi, kanë qenë 33 historianë që kanë kontribuuar në këto dy vëllime plotësuese me materiale studimore për mësimdhënien e historisë për nxënësit e shkollave të mesme, të grupmoshës 15-18 vjeç.

Edhe pse ka kaluar një dhjetëvjeçar që nga botimi i fundit i atyre librave, shumë veçori të mësimdhënies së historisë në Evropën Juglindore, mbeten të njëjta. Kurrikulat dhe tekstet shkollore nuk janë përshtatur me ndryshimet gjithëpërfshirëse që karakterizojnë tekstet e lëndëve të tjera, ndërkohë që në disa raste vërehet një prapavajtje. Shumica e nxënësve, ende e konsiderojnë Historinë si një lëndë të vështirë, ose të mërzitshme, që kërkon njohuri të sakta rreth datave dhe emrave, si dhe aftësi për t'i fiksuar ato në kujtesë. Në të njëjtën kohë, nuk është e qartë nëse tekstet shkollore mund t'i kundërvihen Historisë Publike në lidhje me formimin e vetëdijes historike. Kurrikula vazhdon të jetë e bazuar në etnocentrizëm, ndërkohë që ende mbizotëron padituria në lidhje me historinë e vendeve fqinje.

Sigurisht, gjatë këtyre dhjetë viteve ka pasur ndryshime të rëndësishme, si në drejtim të gjeopolitikës, ashtu edhe në drejtim të mësimdhënies së Historisë. Disa shtete të reja shpallën pavarësinë e tyre, disa iu bashkuan Bashkimit Evropian, dhe në shumë vende të tjera u modernizuan metodat e mësimdhënies - në disa raste, kjo falë kontributit të organeve ndërkombëtare. Sidoqoftë, vazhdimi i këtij projekti të CDRSEE-së, me përgatitjen dhe botimin e dy vëllimeve të reja, ishte i domosdoshëm. Kjo ndërmarrje e re natyrisht kishte sfidat e veta, që në shumë aspekte dallonin nga ato të katër librave të mëparshëm. Sfida e parë buroi nga periudha historike që këta dy libra mbulojnë.

Sfidat e periudhave të pas Luftës së Dytë Botërore dhe pas Luftës së Ftohtë

Planifikimi dhe përgatitja e materialeve studimore rreth periudhave të pas Luftës së Dytë Botërore dhe pas Luftës së Ftohtë, përbën një sfidë të madhe për historianët, kryesisht për tre arsye:

1. Historia e kohëve të fundit nuk ka qenë objekt i hulumtimeve sistematike shkencore. Punimet që mund të merren si referencë, dhe në të cilat mund të mbështeten autorët për hartimin e një libri shkollor të historisë, janë të pakta dhe jo të shpeshta, veçanërisht ato që trajtojnë historinë e vendeve të Evropës Juglindore. Dihet që tekstet shkollore nuk janë rezultat i një pune të mirëfilltë kërkimore shkencore, por janë punime që përmbledhin dhe sistemojnë njohuritë ekzistuese akademike. Mungesa e botimeve akademike të librave të historisë reflektohet, në mënyrë të pashmangshme, në nivelin dhe mënyrën e hartimit të teksteve shkollore të historisë. Në këtë mënyrë, për ne redaktorët, ka qenë një sfidë e vërtetë përzgjedhja e kujdesshme e burimeve dhe përpilimi i një libri historie të Ballkanit, ku të përfshihej periudha që nga fundit i Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 2008, duke u përpjekur që, në fakt, të kryenim kërkime historike origjinale.
2. Si rregull, kjo periudhë nuk mësohet në shkollat e mesme të shteteve të rajonit, edhe pse mund të përfshihet në kapitujt përkatës të teksteve të historisë. Mësimdhënia nuk mbulon periudhën pas vitit 1990, për një sërë arsyesh, sidomos sepse orët e mësimit që i caktohen lëndës së Historisë janë të kufizuara. Koha e pakët në dispozicion dhe materiali

i shumtë mësimor, i shkurajojnë mësuesit dhe i bëjnë ata që të mos e trajtojnë fare historinë e kohëve të fundit.
3. Sfida më e madhe vjen nga kontekstet ideologjike dhe politike, që shoqëronin materialet studimore për Luftën e Ftohtë dhe sidomos për periudhën pas Luftës së Ftohtë, veçanërisht në republikat e ish-Jugosllavisë. Kujtimi tronditës i Luftërave Jugosllave është ende i gjallë; nuk do të ishte e tepërt të thuhej se ajo luftë përndjek mësimdhënien e Historisë. Dikush është përballur me një situatë tragjike disi të ngjashme në Qipro, ku ndarja de facto e ishullit në prag të pushtimit turk, në vitin 1974, ka shkaktuar trauma që vazhdojnë të ndikojnë në Historinë Publike dhe në mënyrat se si po mësohet kjo lëndë në shkolla. Historia e regjimeve të shteteve komuniste të këtij rajoni karakterizohet gjithashtu nga shtrembërimi ideologjik dhe mohimi i prerë i të vërtetës historike, që vështirëson të kuptuarit e realitetit të ndërlikuar historik dhe përvojave njerëzore. Si rrjedhojë, mësuesit e historisë duhet të përpiqen që të ekuilibrojnë shpjegimet kategorike të politizuara, që mbizotërojnë në tekstet shkollore, me subjektivitetin që mbizotëron mendimet e shoqërive dhe historitë e tyre personale dhe familjare.

Këto çështje u diskutuan në tre seminaret e trajnimit të mësuesve, që CDRSEE-ja organizoi në Vukovar (Kroaci, 5-7 dhjetor 2014); në Mostar (Bosnje dhe Hercegovinë, 6-8 mars 2015) dhe në Bujanovc (Serbi, 27-29 Mars 2015). Seminaret synonin të pasqyronin realitetin e mësimdhënies së lëndës së historisë në shkolla, që trajtonte historinë e viteve të periudhës 1944-2008, si dhe nevojat e mësuesve të lëndës së historisë. Ata theksuan ndryshimet në përmbajtjen e kurrikulës, midis trajtimeve dhe interpretimeve që ata kishin në dispozicion dhe burimeve historike të përdorura. Mësuesit ndanin pikëpamje të ndryshme, në lidhje me faktin nëse duhet të mësohet historia e periudhës së pas vitit 1990, nëse mund të mësohet, si dhe nëse duhet të mësohen apo jo, çështjet historike të diskutueshme dhe të ndjeshme. Për këtë arsye, në dy vëllimet e reja janë bërë përpjekje për t'iu dhënë përgjigje mëdyshjeve lidhur me metodën e duhur të mësimit të "historisë të së tashmes" dhe të momenteve të errëta të së kaluarës.

Në rastet e kujtesës tronditëse, detyra e historianëve është jashtëzakonisht e vështirë dhe e ndjeshme. Ashtu si në katër vëllimet e para, ne, pa dyshim, e kemi të qartë se anët e errëta të historisë së përbashkët të Evropës Jug-lindore nuk duhet të mbulohen në emër të pajtimit. Ato duhet të ekspozohen dhe të dokumentohen në mënyrë t; saktë, përmes paraqitjes tërësore të burimeve të shumta dhe të ndryshme. Përveç kësaj, vetëm duke zbatuar një metodë shumëplanëshe, mund ta zhvillojmë mendimin kritik të nxënësve dhe t'ua nxisim atyre dëshirën për të kryer kërkime historike.

Mësimdhënia e lëndës së historisë për periudhën e Luftës së Ftohtë ngre çështje të ndryshme për diskutim. Është e vështirë për nxënësit, që nuk e kanë përjetuar regjimin komunist, të kuptojnë jetën e përditshme të atyre kohërave. Ne u përpoqëm të përcillnim më shumë se një prezantim të thjeshtë të tipareve politike të këtyre regjimeve, duke u përpjekur që të përcillnim, nëpërmjet përzgjedhjes së kujdesshme të burimeve, "kulturën socialiste": artin, mallrat e konsumit, modën, jetën shkollore, argëtimin etj. Në përkthimin e burimeve, ne u përpoqëm të ruanim "gjuhën socialiste"; një gjuhë steriotipe dhe e ngurtë, e njohur për ata që kanë jetuar gjatë asaj periudhe, por e pakuptueshme për të rinjtë e sotëm. Mësuesit e historisë duhet t'iu shpjegojnë nxënësve se tekste të tilla (vendimet dhe direktivat e partisë, fjalimet zyrtare dhe të tjera si këto) përbëjnë gjithashtu dëshmi gjuhësore, që lejojnë një kuptueshmëri më të mirë të një regjimi që u shemb në vitin 1990, duke ofruar në të njëjtën kohë edhe mundësinë për të kuptuar më mirë natyrën e tij. Po ashtu, ne u përpoqëm të paraqesim peripecitë e demokracisë dhe të regjimeve ushtarake në Greqi dhe Turqi, si dhe veçoritë e çështjes së Qipros. Ballafaqimi i regjimeve të vendeve të "Bllokut Lindor" me ato të "Perëndimit", i nxit nxënësit që të gjurmojnë dhe krahasojnë në mënyrë të pavarur dhe vetjake, jo vetëm dallimet, por edhe ngjashmëritë midis tyre, siç mund të jenë ato në lidhje me kulturën rinore dhe krijimin artistik.

Përzgjedhja e përmbajtjes dhe metodave të mësimdhënies

Në përgatitjen e këtyre dy vëllimeve të reja, ne kemi ndjekur udhëzimet për planifikimin e përmbajtjes dhe qëllimeve arsimore të Librave të mëparshëm të punës, siç janë formuluar në Hyrjen e Përgjithshme të vëllimit të parë të atyre Librave të Punës. Shkurtimisht, kemi marrë parasysh çështjen e përputhshmërisë me kurrikulat e historisë së

shkollës së mesme, kontrollin që shteti ushtron mbi këto kurrikula dhe mbi tekstet shkollore, nevojat e mësuesve për Materiale arsimore shtesë të kësaj fushe, dhe qasjen shumëplanëshe në mësimdhënien e historisë. Edhe në këtë rast, ne kemi ndjekur një qasje rajonale, në mënyrë që të përfaqësohen të gjitha shtetet e sotme të Gadishullit Ballkanik. Çështja e përfaqësimit është, ndoshta, më e ndërlikuara për një projekt të këtij lloji. Në secilin shtet, nxënësit duhet të jenë në gjendje që të gjejnë historinë e tyre kombëtare brenda një konteksti rajonal, dhe në këtë mënyrë, të ndërgjegjësohen për nivelet e shumëllojta në të cilat ka kaluar zhvillimi historik. Në të njëjtën kohë, ata, gjithashtu do të duhet të gjurmojnë historinë e tyre kombëtare nëpërmjet burimeve historike të vendeve të tjera fqinje. Kështu, nëpërmjet përdorimit dhe zbatimit të metodës studimore krahasuese, nxënësit orientohen drejt një kuptueshmërie më të mirë të historisë së tyre kombëtare. Për shembull, për të kuptuar pozicionin e grave në shoqëri dhe ekonominë e shteteve socialiste, nuk ka nevojë që të paraqiten të gjitha burimet e secilit vend komunist; një ose dy, do të mjaftonin. Në fakt, ne e vendosëm theksin te përfaqësimi i temave për të trajtuar, kur ishte e mundur, të gjitha aspektet politike, shoqërore, kulturore dhe ekonomike të historisë.

Kjo, në një kohë kur tekstet ekzistuese të historisë paraqesin pothuajse vetëm pasqyrime për historinë politike, të bazuar në një numër të kufizuar burimesh. Siç është edhe rasti i katër Librave të mëparshëm të Punës, qëndrimi përkatës i çdo vendi në veçanti, ndryshon nga vëllimi në vëllim, në lidhje me ngjarjet historike. Burimet e materialeve historike nga republikat dhe krahinat e ish-Jugosllavisë, janë më të shumta në Vëllimin e dytë, që detyrimisht përqendrohet në luftërat pas viteve '90. Përkundrazi, në Vëllimin e parë, Jugosllavia trajtohet si një shtet i vetëm, siç edhe ishte, dhe si rrjedhim burimet jugosllave janë në përpjesëtim me ato nga Shqipëria, Bullgaria dhe Rumania. Është arritur një baraspeshim i përgjithshëm vetëm në nivelin e të dy vëllimeve si një tërësi e vetme. Që nga fillimi, këto dy vëllime u konceptuan si të tilla, dhe bashkëpunimi i redaktorëve ka qenë i vazhdueshëm, pavarësisht se kush ishte përgjegjës për secilin vëllim. Është e qartë se historia e viteve 1990 pasqyrohet në të dy vëllimet, duke bërë lidhjen midis: në kapitullin VIII të Vëllimit 1, theksi vihet te rënia e regjimeve komuniste, ndërsa në kapitullin I të Vëllimit 2, theksi vihet te shpërbërja e ish Federatës së Jugosllavisë.

Çështja e përfaqësimit u ngrit edhe në Vëllimin 1, në lidhje me raportin midis burimeve të secilit prej dy blloqeve të Luftës së Ftohtë në Evropën Juglindore. Në kushtet kur, Ballkani përbën një shembull të jashtëzakonshëm të ndarjeve në paktet e Luftës së Ftohtë (NATO, Traktati i Varshavës, Lëvizja e Shteteve të Pangazhuara), grupi i redaktorëve u përpoq të evidentonte të gjitha ngjyrimet e sistemeve politike të ndryshme. Duke pasur parasysh, se numri i vendeve jo-komuniste (Turqia, Greqia dhe Qiproja) ka qenë i vogël, ishte e vështirë të arrihej ruajtja e një baraspeshe të përgjithshme. Shqetësimi ynë kryesor, ishte që të paraqisnim të dyja anët e të njëjtit fenomen, përtej vijës ndarëse (e ashtuquajtur "Perdja e Hekurt"). Gjithashtu, ishte e rëndësishme që të theksoheshin veçoritë e trajektores historike të çdo vendi. Përdorimi i grupimit të përgjithshëm "regjimi komunist", nuk nënkupton që trajektorja historike e të gjitha vendeve komuniste në Ballkan, ishte e ngjashme. Është shumë e rëndësishme që të theksohen dhe të diskutohen këto ndryshime në orët e mësimit të lëndës së historisë në klasë. Po kështu, nxënësit duhet të jenë në gjendje që t'i kuptojnë të gjitha ngjyresat e grupimeve të periudhës pas vitit 1990: Shtetet anëtare të BE-së, ato jo anëtare të BE-së, apo shtetet anëtare të NATO-s, "Ballkani Perëndimor" etj. Sikurse edhe në vëllimet e mëparshme, edhe në vëllimet e tanishme historinë e Ballkanit e konceptojmë si pjesë të historisë evropiane dhe asaj botërore. Kështu që, këto tekste mësimore të lëndës së historisë mund të përdoren për qëllime arsimore në shkolla (si edhe në universitete), në të gjithë botën, ku gjuha e mësimdhënies është gjuha angleze. Duke pasur parasysh mungesën e burimeve historike parësore, të përkthyera në gjuhën angleze, nga vendet e Evropës Juglindore, vëllimet e tanishme padyshim do të jenë të përdorshme edhe për një publik më të gjerë lexuesish.

Dy vëllimet e reja përbëhen nga përmbledhje elementesh pamore dhe tekst, të shoqëruara nga hyrje dhe "çelësa", që përshkruajnë në mënyrë të përmbledhur kontekstin historik të secilit burim, dhe japin informacion në lidhje me të dhënat biografike, shënime të shkurtra për përcaktimin e termave etj. Meqenëse dëshironim t'i kushtonim më shumë vëmendje përmasës mësimore të projektit, pyetjet dhe detyrat u përpiluan nga dy ekspertët e Didaktikës së Historisë, Snjezhana Koren dhe Vassiliki

Sakka. Mësuesit mund t'i përdorin këto pyetje e detyra, ose mund të hartojnë edhe pyetje të tyre. Përdorimi i materialeve mësimore bazohet më së shumti në iniciativën dhe motivimin e mësuesve të historisë, që përballen me një sërë sfidash, të vjetra dhe të reja, të tilla si: politizimi i historisë në diskursin publik, në të cilin arsimi i mesëm është shpeshherë i përfshirë; mosinteresimi i nxënësve; materiali voluminoz mësimor.

Ritmi i zhvillimeve teknologjike paraqet sfida të reja. Si mund t'i angazhojmë nxënësit me metodën tradicionale të mësimdhënies së lëndës së historisë, në ditët e sotme të epokës së Wikipedias? Pavarësisht të dhënave jo të besueshme, nxënësit përdorin sot gjerësisht informacione të marrë nga Wikipedia, që në këtë mënyrë fiton epërsi ndaj shfrytëzimit të botimeve enciklopedike voluminoze. Dihet që shumica e informacioneve nuk përpilohen nga ekspertë dhe specialistë të fushës së historisë, dhe për pasojë të gjithë mund të kontribuojnë në përgatitjen dhe parashtrimin e materialeve me njohuri historike. Duke pasur parasysh këtë gjendje, si mundet që mësuesit në shkolla të nxisin nxënësit në hulumtimin e burimeve historike? Si mund t'u tregojnë ata kërkimin dhe gjetjen e materialeve historike, në arkiva apo biblioteka, madje edhe në formë të digjitalizuar?

Është e qartë se nuk duhet ta nënvleftësojmë internetin, as ta përjashtojmë si alternativë, duke qenë se është një fond i pasur materialesh kërkimore. Përdoruesit e vëllimeve të tanishme do të vërejnë se shumë nga burimet tona vijnë nga interneti. Në ditët e sotme interneti përbën një depozitë të madhe të digjitalizuar të burimeve parësore (p.sh. tekstet e traktateve ndërkombëtare, të dhënat statistikore dhe regjistrimet e popullsisë, organet e përditshme apo periodike të shtypit), që janë lehtësisht të qasshme, nëpërmjet faqeve të internetit të bibliotekave, universiteteve dhe institucioneve, apo organizatave, publike dhe private, me burime arkivore të shumta të dhënash. Në kushtet kur, interneti është një mjet i domosdoshëm për mësuesit, në vëllimet e tanishme ne kemi ofruar një sërë adresash në internet, pa dyshim jo aq sa do të kishim dëshiruar, me qasje të hapur në burimet parësore, si dhe adresat e internetit për filma dhe muzikë.

Siç u përmend më lart, mësimdhënia e lëndës së historisë e periudhës pas vitit 1990, mbulon çështje të diskutueshme dhe të ndjeshme, që nuk kanë qenë pjesë e studimeve shkollore. Për shumicën e këtyre çështjeve, autoritetet gjyqësore ndërkombëtare dhe kombëtare kanë marrë vendime, ndërsa organet e pavarura ndërkombëtare dhe kombëtare kanë kërkuar të gjejnë dëshmi mbi masakrat dhe shkatërrimet masive. Pavarësisht materialeve dëshmuese, asnjë historian nuk mund të mohojë kujtesën traumatike të viktimave të mbijetuara.

Mësuesit, shpesh, e gjejnë veten në klasa shumëkulturore ku bashkekzistojnë komunitete të ndryshme. Si munden ata të japin mësim për historinë kombëtare, në një klasë të tillë? Çfarë kuptojnë dhe mbajnë mend nxënësit nga tekste të tilla? Sa e suksesshme mund të jetë mësimdhënia e lëndës së historisë në arsimin e mesëm, si një fushë shkencore që distancohet nga objekti i studimit, që flet për diskurse "neutrale" dhe "ngrin" çështjet kontradiktore në vendet post traumatike? Mësuesit dhe tekstet e lëndës së historisë në shkolla, kanë rolin e ndërmjetësit midis historive të vogla të nxënësve dhe historisë së madhe. Një ndërmjetësim i tillë nuk mund të realizohet as përmes rrëfimeve të homogjenizimit të shumicës, që i shpërfillin pakicat, as nëpërmjet një pozicioni "neutral", që nuk merr parasysh ndjenjat e nxënësve. Për këto arsye, ne jemi përpjekur të evidentojmë grupet sociale dhe etnike, të pakicave që mungojnë në tekstet shkollore të lëndës së historisë, në mënyrë që mësuesit të mund t'i nxisin nxënësit e tyre, që ata të mprehin studimin dhe përvetësimin kritik të historisë. Përveç kësaj, puna në tërësi është një shumësi burimesh mbi "të tjerët", brenda dhe përtej kufijve kombëtare, dhe aty gjejmë armiqësi, injorancë ose indiferencë.

Ashtu si në rastin e Librave të mëparshëm të Punës, dy vëllimet e tanishme, duhet të përdoren si materiale shtesë të teksteve shkollore të historisë në përdorim, që përfshijnë përshkrimin e hollësishëm të ngjarjeve. Në këto tekste trajtohet historia kombëtare, evropiane apo botërore; dhe nuk trajtohet historia e Ballkanit. Librat e tanishëm të Punës kanë si synim që ta mbushin këtë zbrazëti, dhe nëpërmjet shumë burimeve të ndryshme ato lehtësojnë njohjen, mësimin dhe përvetësimin e një pjese të historisë dhe duke e krahasuar atë me botimet e tjera të kësaj lënde, ato mund të përmirësojnë gjykimet kritike të nxënësve.

Struktura e vëllimeve

Këto vëllime pasqyrojnë historinë e periudhës nga viti 1944, deri në vitin 2008. Edhe pse krijohet një mbivendosje me katër Librat e parë të Punës, ne zgjodhëm vitin 1944 si datë fillimi, sepse një njohje reale dhe e thelluar e ngjarjeve që ndodhën gjatë vitit të fundit të Luftës së Dytë Botërore, është vendimtare për të kuptuar epokën e Luftës së Ftohtë, me gjithë ngjyrimet e saj, veçanërisht në Evropën Juglindore. Mësuesit, në mënyrë të natyrshme, mund të kombinojnë burime të Vëllimit të katërt (kapitujt V dhe VI) me ato të Vëllimit të parë. Përzgjedhja e datës mbyllëse të Vëllimit të dytë ishte shumë më e vështirë për t'u caktuar, pasi shumë ngjarje kanë qenë (dhe ende janë) në zhvillim e sipër.

Ne zgjodhëm vitin 2008, sepse atë vit u shpall pavarësia e shtetit të Kosovës, një zhvillim që, me sa duket, i dha fund ciklit të shpërbërjes së Jugosllavisë. Është, gjithashtu viti kur filloi kriza financiare botërore, që goditi rëndë Greqinë dhe sidomos Qipron, megjithëse për arsye të dukshme, kjo çështje nuk është pasqyruar në mënyrë të plotë. Megjithatë, për t'i kuptuar më mirë disa prej burimeve, ka disa "çelësa përgjigjesh" që japin informacion edhe për periudhën pas vitit 2008.

Struktura e përmbajtjes është e njëjtë te të dy vëllimet, pavarësisht faktit se vëllimi i parë ka tetë kapituj dhe vëllimi i dytë ka gjashtë: Tranzicionet politike dhe kriza; Regjimet e reja; Prirjet disidente; Marrëdhëniet ndërkombëtare; Zhvillimet ekonomike; Të dhënat demografike; Migrimi dhe pakicat; Pabarazitë sociale; Mënyrat e argëtimit; Kultura masive; Arti dhe Letërsia. Ne vendosëm të nxirrnim në pah aspektet pozitive të historisë bashkëkohore të Ballkanit, siç është rasti i atyre që kanë marrë çmime ndërkombëtare nga vendet e Evropës Juglindore. Qëndrimi ynë ndaj historisë së pasluftës, nuk udhëhiqet as nga refuzimi i bazuar në ideologji, as nga idealizimi nostalgjik. Kapitulli i fundit i vëllimit të dytë "Mënyrat për të kujtuar", është përfshirë qëllimisht, për t'i ndihmuar nxënësit të kuptojnë se si kujtesa kolektive, sidomos siç shprehet nga burime zyrtare, luhatet mes këtyre dy qëndrimeve të skajshme, pa asnjë shans për një shkëputje të matur. Në të njëjtën kohë, ne kemi përfshirë materiale dëshmuese për raste pajtimi dhe shembuj sesi kujtimet traumatike mund të parandalojnë ndarjet.

Ashtu si në katër Librat e parë, ne jemi përpjekur t'iu japim zë aktorëve dhe subjekteve historike të panjohura, si gratë, por pa injoruar udhëheqësit dhe sundimtarët. Përveç kësaj, ka shumë burime për të pasqyruar më gjerë formimin kulturor të rinisë, pjesëmarrjen aktive të saj në këto veprimtari, gjatë Luftës së Ftohtë dhe periudhës pas Luftës së Ftohtë. Ne besojmë se tema si kinematografia, muzika dhe sporti, të cilat zakonisht nuk gjejnë trajtimin e duhur në tekstet shkollore të deritanishme, kanë më shumë gjasa të tërheqin interesin e nxënësve. Ne përzgjodhëm burimet nga një gamë e gjerë dhe e larmishme e materialeve dëshmuese, si: tekste ligjore, fjalime politike, dokumente diplomatike, traktate, tekste letrare, shënime biografike, intervista, tabela statistikore, diagrame dhe grafikë, karikatura, fotografi, gazeta dhe artikujt revistash, etj. Ne, gjithashtu do të kishim dashur të përfshinim një sërë burimesh nga materiale të shumta audio-vizive gjatë kësaj periudhe, por kjo do të ishte mjaft e kushtueshme dhe, në të vërtetë, një ndërmarrje dhe punë e vështirë për t'u realizuar.

Përfundimi i këtij botimi nënkupton përfundimin e fazës së parë të projektit. Ne besojmë se mësuesit do t'i përdorin në mënyrë krijuese këto dy vëllime të reja, dhe do t'i vlerësojnë dhe pasurojnë më tej ato me njohuritë që ata kanë. Ne, gjithashtu shpresojmë që Ministritë e Arsimit të vendeve të Evropës Juglindore dhe zyrtarët e tyre, do ta mbështesin projektin tonë dhe do t'i përdorin në shkolla vëllimet e përkthyera. E fundit, por jo më pak e rëndësishmja, ne besojmë se përfundimi i këtyre librave të rinj do ta thellojë më shumë dhe do rrisë bashkëpunimin ndërkombëtar institucional. Ky bashkëpunim sapo ka filluar.

KRISTINA KOULOURI

KAPITULLI I: SHTETE TË VJETRA, REGJIME TË REJA

Hyrje 19

I.1 Fundi i Luftës së Dytë Botërore 21

I.1.1. Çlirimi 21

I.1.2. Rikthimi në atdhe ose internimi 25

I.1.3 Rindërtimi 29

I.2. Regjime të reja 34

I.2.1. Tranzicioni 34

I.2.2. Opozita 42

I.2.3. Shtypja 45

I.3. Lufta Civile Greke 49

HYRJE

Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, përparësia kryesore e qeverive në të gjitha shtetet ballkanike ishte marrja nën kontroll e forcave të armatosura dhe përdorimit të armëve. Në vitet e para të pasluftës, grupe ushtarësh në pritje të çmobilizimit me male armësh dhe municionesh luftarake ishin një gjë e zakonshme. Megjithatë, fundi i luftës nuk nënkuptoi edhe fundin e ndryshimeve të sistemeve ideologjike dhe ambicieve politike. Qëndresa kundër Nazizmit dhe pushtimi nga Forcat e Boshtit nxitej nga shtysa ideologjike dhe bindje politike të ndryshme. Tek ajo u përfshinë grupe dhe forca të ndryshme, që në shumicën e rasteve nuk udhëhiqeshin nga një forcë e vetme politike. Ambiciet për të mbizotëruar dhe përçarjet midis tyre, që në disa raste kanë çuar në luftëra civile, ishin të pranishme edhe gjatë këtyre viteve të vështira. Nga ana tjetër, pushtimi i vendeve fqinj nga aleatet e Hitlerit (p.sh. Bulgaria) iu kishte lenë banorëve vendas kujtime të hidhura, siç kishin bërë edhe bashkëpunëtorët e nazistëve, që ishin përplasur me forcat e qëndresës, dhe tashmë po luftonin për mbijetesë paslufte.

Si rrjedhim, dikush mund të pretendojë se ndërtimi politik i shoqërive të pasluftës në Ballkan kishte nisur që gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore. Në këtë këndvështrim, qëndrimi që do të mbanin disa shtete ballkanike kundrejt pranisë së Ushtrisë të Bashkimit Sovjetik ishte ende i pavendosur. Lumturia e çlirimit nga Nazizmi, siç shihet në fytyrat e qeshura të njerëzve në fotografi të bëra në vitet 1944-1945, ishte e sinqertë, por u përdor edhe si një mjet propagande. Për vendet përgjatë itinerarit që përshkoi Ushtria Sovjetike: Rumani, Bullgari dhe Jugosllavi, dëbimi përfundimtar i trupave gjermanë shënoi vazhdimin e luftës. Thirrja e qeverisë së re komuniste të Frontit të Atdheut në Bullgari – "Çdo gjë për frontin, çdo gjë për fitoren" (këtë herë, së bashku me Rumaninë, kundër Gjermanisë naziste) – pasqyron me vërtetësi këtë situatë pasuese kritike.

Prania e Ushtrisë së Bashkimit Sovjetik, e miratuar nga Konferenca e Jaltës, në këto vende pati një ndikim politik me pasoja vendimtare për zhvillimet e mëtejshme. Kjo fuqizoi partitë komuniste të atyre vendeve dhe iu caktoi atyre një rol udhëheqës në vendosjen e rendit shoqëror të pasluftës, që nuk e kishin pasur asnjëherë para Luftës së Dytë Botërore. Krahas deklaratave politike sipas ideologjisë marksiste-leniniste-staliniste dhe të shprehura në thirrje utopike për drejtësi, vëllazëri kombëtare dhe barazi, partitë komuniste duhet gjithashtu të përmbushnin përgjegjësitë tradicionale për funksionimin e shtetit. Për shembull, Partia Komuniste e Jugosllavisë (PKJ) donte të mbështeste strukturën e re federale të shtetit, si edhe të mbronte pozicionin e saj të pasluftës, si një shtet komunist i fuqishëm me potenciale udhëheqëse në Ballkan. Kjo së bashku me marrëveshjet midis Fuqive të Mëdha mund ta shpjegojë pozicionin e qëndrueshëm që PKJ-ja kishte në përplasjen e saj me Stalinin dhe politikën e jashtme të Jugosllavisë së pavarur në dhjetëvjeçarët e ardhshëm. Para këtij konflikti, Bashkimi Sovjetik, që donte të siguronte kontrollin e partive komuniste dhe mbizotërimin e diktaturës komuniste staliniste në Ballkan, hartoi një plan në lidhje me një shtetformim të ri dhe të gjerë, pra një "Federatë Ballkanike" të Jugosllavisë dhe Bullgarisë, që më në fund do të përfshinte edhe Shqipërinë – me qëllim që të zgjidhte edhe "Çështjen e Maqedonisë" dhe mosmarrëveshjeve të tjera kombëtare të vjetra. Megjithatë, prishja e marrëdhënieve midis Titos dhe Stalinit në vitin 1948, dhe qëndrimi i aleatëve të tij të luftës, veçanërisht të Britanisë së Madhe, e pengoi realizimin e këtij plani.

Konsolidimi i rolit dominues të partive komuniste në jetën e pasluftës në këto vende, nxjerr në pah edhe një tipar tjetër të përbashkët të zhvillimeve të tyre: eliminimin gradual të pluralizmit politik, që vështirësoi ngritjen e strukturave socialiste liberale. Rezultati përfundimtar ishte themelimi i partive komuniste si forca e vetme udhëheqëse politike, për arritjen e qëllimit të domosdoshëm të zhvillimit të vendeve të tyre, si: ndërtimi i komunizmit dhe i shoqërisë së drejtësisë dhe të barazisë, dhe çlirimi i klasave punëtore nga shfrytëzimi. Fitorja përfundimtare ushtarake e PKJ-së në luftë çoi në triumfin politik të komunistëve në Republikat Socialiste të Federatës Jugosllave dhe asgjësimin tërësor të përkrahësve të rrymave të tjera politike. Në Bullgari, barazia në dukje e një sërë partish në koalicion në Frontin e Atdheut, retorika e bashkimit politik në emër të interesave të popullit, dhe deklaratat e "marrëdhënieve miqësore me BRSS-në, demokracitë Perëndimore dhe Republikën e madhe amerikane" u përdorën si maskim, për të mbuluar Partinë e Punëtorëve të Bullgarisë (pas vitit 1948 – Partia Komuniste e Bullgarisë, PKB) për të marrë plotësisht pushtetin dhe për t'u bërë forca e vetme politike në vend, pasi kishte eliminuar kundërshtarët e saj politikë dhe kishte konsoliduar formën më të pastër të stalinizmit në Gadishullin e Ballkanit, si aleati sovjetik më besnik. Në mënyrë të ngjashme, pas vitit 1946 dhe në vijim, komunistët në Shqipëri persekutuan të gjithë

"kundërrevolucionarët" deri sa Partia Komuniste e Shqipërisë (PKSH) e vendosi veten si forca politike udhëheqëse. Rrjedha e ngjarjeve në Rumani paracaktoi edhe mbizotërimin e partisë komuniste, pavarësisht pozicionit të saj të dobët në jetën politike dhe në shoqëri, në vitet e paraluftës.

Krahas shtypjes së opozitës politike të ligjshme në këto shtete, që kishin marrë rrugëtimin e sistemit komunist, një tjetër veçori e përbashkët ishte edhe përballja e qëndresës së armatosur kundër komunizmit. Përpjekje për të organizuar qëndresa të armatosura janë shënuar në Bullgari, Kroaci dhe Shqipëri. Ndikimi i tyre në shoqëri ishte më i dobët se ai i opozitës së ligjshme; duke qenë se ata ishin të izoluar në vendet e tyre, nuk mund të siguronin ndihmë nga jashtë dhe u shpartalluan keqas dhe u eliminuan me mënyra të ndryshme. E kundërta ndodhi në Greqi, për të cilën Fuqitë e Mëdha kishin rënë dakord se do të qëndronte jashtë sferës sovjetike të ndikimit; por Greqia doli nga lufta me një të majtë të fuqishme që gëzonte mbështetje popullore, madje më të madhe krahasuar edhe me Bullgarinë, e veçanërisht me Rumaninë, por që përjetoi tragjedinë e luftës civile në shkallë të gjerë. Lufta Civile Greke përfundoi me mposhtjen e komunistëve, kryesisht si rezultat i ndërhyrjes aktive të SHBA-së, që la një gjurmë të thellë në zhvillimin e vendit dhe në dinamikën e demokratizimit dhe praktikave autoritare midis elitës së djathë deri në mesin të viteve '70.

Eliminimi i pluralizmit politik në Ballkan, përveçse në Greqi, ndodhi përkrah shkatërrimit të të gjitha strukturave të jetës së lirë dhe ndërveprimit shoqëror, që ishte krijuar dhe funksionon te para Luftës së Dytë Botërore. Si rrjedhojë, u transformua struktura e sferës publike. U ndaluan të gjitha organizatat shoqërore (bamirësie, ndihmës reciproke, sigurisë shoqërore, përkujdesjes shoqërore, etj.); organizatat që merreshin me arsimin, kulturën dhe argëtimin; si edhe ato që merreshin me mbrojtjen e të drejtave (shoqatat e shumta të pavarura për mbrojtjen e të drejtave profesionale dhe garancitë ligjore të profesioneve, organizatat profesionale, organizatat e grave, organizatat e pakicave, etj.). Edhe jeta e përditshme ndryshoi rrënjësisht në aspektet e saj më thelbësore: tregu, tregtia, shijet dhe preferencat personale, rutina e përditshme.

Ndoshta shembulli më i mirë në këtë drejtim është fati i kishave në shoqëritë komuniste. Të gjitha morën një status të ri, që kushtëzohej nga bashkëpunimi i tyre i detyruar me regjimet komuniste, si edhe me mekanizmin e shërbimeve sekrete. Shumë shpejt vijuan: persekutimi dhe eliminimi fizik i klerikëve të devotshëm, konfiskimi i pronave të kishës dhe pasurive financiare, dhe shkatërrimi i rrjeteve të bamirësisë dhe edukimit të krishterë. Përpjekjet e komunistëve për t'i ndarë kishat nga strukturat ekumenike ekzistuese në disa prej këtyre vendeve, ishin pjesë e përpjekjeve për të vendosur tërësisht kontrollin e brendshëm. Fati i pakicave fetare të atjeshme, si: katolikët, myslimanët dhe sekte të shumta protestantësh, ishte edhe më i tmerrshëm.

Një fund i përbashkët për të gjitha shtetet ballkanike, pas Luftës së Dytë Botërore dhe Luftës së Ftohtë, që pasoi, ishte fundi i të gjitha dinastive mbretërore përkatëse dhe shfuqizimi i monarkisë si formë qeverisjeje: në Shqipëri, në vitin 1943, pas kapitullimit të Italisë, në Rumani, Jugosllavi dhe Bullgari. Megjithëse ky proces u tejzgjat dhe u zhvillua në kushte të vështira, ai ndodhi edhe në Greqi, ku monarkia u zëvendësua nga një formë qeverisjeje republikane tridhjetë vite pas përfundimit të luftës.

Një tipar tjetër i përbashkët për të gjitha shtetet ballkanike ishte se struktura politike e brendshme ishte e pajtueshme me drejtimin e tyre gjeopolitik strategjik, qoftë të zgjedhur ose të imponuar. Ndërsa Bashkimi Sovjetik u bë fuqia politike udhëheqëse për ndërtimin e shoqërive komuniste në to, demokracitë Perëndimore, dhe veçanërisht SHBA-ja patën një ndikim të madh në krijimin e marrëdhënieve shoqërore dhe rendit politik të Greqisë dhe Turqisë, që kishin mbetur jashtë sferës së ndikimit sovjetik. Kjo përcaktoi gjithashtu edhe mbizotërimin e disa forcave politike në shoqëritë greke dhe turke, dhe përgjithësisht, veçimin, përjashtimin dhe persekutimin e të majtëve.

Pavarësisht ndryshimeve për sa i përket ideologjisë dhe drejtimit gjeopolitik, kujtesa e të gjitha shoqërive ballkanike u përqendrua në përjetimet e luftës, si: uria, varfëria e skajshme, cenueshmëria e popullsisë civile, nevoja për ndihmë sociale dhe mbrojtje, dhe dyndjet masive të migrantëve pas lufte. Organizatat ndërkombëtare, si Kryqi i Kuq dhe Drejtoria për Ndihmë dhe Rindërtim e Kombeve të Bashkuara (UNRRA), si edhe ndihma financiare nga SHBA-ja, Mbretëria e Bashkuar dhe nga vende të tjera kontribuan në rimëkëmbjen e strukturave shtetërore të vjetra dhe krijimin e atyre të rejave, dhe mbi të gjitha siguroi furnizime të domosdoshme për të mbijetuarit: ushqim, strehim, veshje, medikamente dhe shërbime mjekësore. Në realitet, rikonfigurimet e ndërlikuara gjeopolitike dhe ideologjike në Ballkan krijuan një sërë pasojash edhe për individët, si edhe për komunitetin dhe për grupet minoritare, që në fund u bënë pjesë e kujtesës traumatike zyrtare dhe jozyrtare nga Lufta e Dytë Botërore dhe Lufta e Ftohtë që pasoi.

I.1. FUNDI I LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

I.1.1. Çlirimi

I-1. Ekstrakte nga procesverbalet e mbledhjes së Këshillit të Ministrave, më 28 shtator 1944, në lidhje me abuzimet e Ushtrisë së Bashkimit Sovjetik në territorin e Rumanisë

"Në të gjithë Moldavinë, u morën një numër i konsiderueshëm gjedhësh, njëthundrakësh dhe kafshësh të tjera (dele, derra, etj.). Besoj se në Moldavinë Veriore kanë mbetur vetëm 30 për qind e bagëtive që kishim. Praktika e mbledhjes së taksave vazhdon ende në ditët e sotme, pa asnjë normë në disa vende, në vijim të kërkesës kategorike dhe të ngutshme nga Shtabi vendor sovjetik, dhe në disa vende në mënyrë të padrejtë, nga njësi të shpërndara pas vijave të frontit [...]. Shtabi vendor kishte hartuar shumë plane për mbledhjen e taksave, të përllogaritura në bazë të të dhënave të gabuara statistikore [...]. Si rrjedhim, në qarkun e Dorohoit u kërkuan 3250 vagonë me grurë, ndërsa prodhimi i atjeshëm nuk i tejkalonte 3000 vagonë". [Gjenerali Dumitru Damaceanu e paraqet situatën nga një këndvështrim administrativ dhe flet për ushtarët rumunë, që ishin çarmatosur dhe ishin burgosur pas 23 gushtit të vitit 1944]: "Në bazë të informacioneve që kemi, trupat e çarmatosur ishin dërguar tashmë në Lindje të Lumit Prut. [Në vendndodhje të ndryshme] në lashi ishin rreth 45000 ushtarë, 1000 prej të cilëve ishin oficerë [...]. Sipas informacioneve që kemi, gjendja e tyre shpirtërore është e mjerueshme. Deri disa ditë më parë, atyre iu jepej si ushqim vetëm 100g miell misri i zier në ditë".

Koleksioni i Arkivit Kombëtar të Bukureshtit: Kryesia e Këshilli të Ministrave, dosja 2/1944, f. 201-258.

Më prill të vitit 1944 Ushtria e Kuqe hyri në territorin rumun. Gjysma Veriore e rajonit midis malit Karpat dhe lumit Prut, për pesë muaj ishte nën kontrollin e trupave sovjetikë, duke krijuar një pakënaqësi të madhe ndaj gjithë popullsisë. Më 31 gusht, kur trupat sovjetike hynë në Bukuresht, përfaqësuesit e Partisë Komuniste të Rumanisë, organizuan një pritje ceremoniale të kushtueshme, megjithëse shumica e njerëzve nuk ishin aspak entuziastë për pushtimin e ri.

I-2. Deklarata e organizatave sllovene, e 30 prillit të vitit 1945, teksa Ushtria jugosllave hynte në Trieste

Njësitë e Ushtrisë jugosllave po çlironin Triesten. Teksa po luftonin kundër nazifashistëve që kishin mbetur ende dhe spiunëve të tyre, që shtireshin si kundër-gjermanë, kombet e bashkuara jugosllave po zhvillonin betejën e fundit në Trieste dhe në pjesën e fundit ende të pushtuar të Rajonit slloven, Primorska.

Sllovenë nga Primorska, duhet të ndërgjegjësoheni për rëndësinë historike të këtij çasti! Sepse është momenti i përmbushjes së dëshirës shumëvjeçare për të qenë të lirë dhe të bashkuar me sllovenët dhe jugosllavët e tjerë. Për një të ardhme fatlume, për të gjithë ne dhe për brezat e ardhshëm.

Sllovenë nga Primorska, çasti i lirisë sapo ka mbërritur. Ngrini kryet dhe bashkojuni Ushtrisë jugosllave - çlirimtares sonë! Le të bëjmë më të mirën tonë, për të ndihmuar luftëtarët tanë në përpjekjet e tyre të fundit! Le të triumfojmë dhe ta ndalojmë armikun që të mos na shkatërrojë pasurinë tonë, pra dhe ta çlirojmë atdheun tonë! Arritja jonë, e realizuar nëpërmjet sakrificës, nuk mund të na mohohet. Rroftë Ushtria jugosllave, çlirimtarja jonë! Rroftë Marshalli Tito, udhëheqësi i luftës sonë çlirimtare! Rroftë Jugosllavia demokratike!

Komiteti Rajonal i Frontit Çlirimtar për Primorskën sllovene; Shoqata Antifashiste e Grave Sllovene; Shoqata e Bashkësisë së Punëtorëve të Rinj Sllovenë; Komiteti i Veprimit për Themelimin e [Shoqatës] së Punëtorëve të Bashkuar Jugosllavë; Sindikata e Punëtorëve për Primorskën sllovene.

Sedmak, 2002, fq. 108..

Njësitë e Ushtrisë jugosllave hynë në Trieste më 1 maj të vitit 1945. Historiografia sllovene dhe ajo jugosllave, i referohen kësaj ngjarje si çlirimi i Triestes, ndërsa historiografia italiane i referohet dhe e përcakton si pushtimi i Triestes. Ditën e nesërme, edhe trupat aleate, të udhëhequra nga një Divizion ushtarak i Zelandës së Re, mbërritën atje, megjithëse Ushtria Jugosllave kishte autoritet të plotë në qytet deri më datën 12 qershor. Më vonë, Trieste u vu nën administrimin britaniko-amerikan. Një natë para hyrjes së Ushtrisë jugosllave, njoftimi u afishua në të gjitha fshatrat, edhe në zonat më të thella. Trieste i kaloi Italisë në vitin 1954, por vetëm në vitin 1975 u konfirmua kufiri nga Marrëveshja italo-jugosllave e "Osimos".

Josip Broz Tito (1892-1980) ishte një revolucionar dhe burrë shteti. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, ai ishte udhëheqësi i lëvizjes së qëndresës partizane, që çliroi pjesën më të madhe të Jugosllavisë, pa ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të Aleatëve. Ai ishte përgjegjës për ekzekutimet masive të të burgosurve të luftës dhe të kundërshtarëve politikë, menjëherë pas përfundimit të luftës, si edhe për persekutimet e kundërshtarëve politikë pas prishjes me Stalinin, në vitin 1948. Në vitin 1951, ai përdori një sistem të vetadministrimit, duke e larguar Jugosllavinë nga vendet e tjera socialiste. Ai mbështeti tregun e socializmit, që solli zgjerimin ekonomik në vitet '50 dhe '60. Rëndësia e tij ndërkombëtare u fuqizua, kur u bë udhëheqësi kryesor i Lëvizjes së vendeve të paangazhuara. Ndikimi i tij i madh politik u dëshmua nga pjesëmarrja e delegacioneve nga 128 vende në ceremoninë e varrimit të tij.

Lexojini me kujdes të dhënat e mësipërme. Më pas, përpiquni të kuptoni se çfarë nënkuptojnë fjalët: "çlirim" dhe "pushtim", për njerëzit që banojnë në të njëjtën zonë. Sipas jush, përse historiografia sllovene dhe jugosllave i referohet hyrjes së Ushtrisë Jugosllave në Trieste si "çlirimtare", ndërsa historiografia italiane si "pushtuese"? Jepni argumente në bazë të materialit burimor. Rendisni disa arsye përse historiografitë e kombeve të ndryshme i interpretojnë ngjarjet e njëjta në mënyra të ndryshme. (Shihni edhe Kap. IV, dok. IV-19 A dhe B).

I-3. Ushtarë kroatë të zënë rob duke marshuar përmes Jugosllavisë

Mate dhe Crnogorac, 2013, f.15.

Më maj të vitit 1945, NDH-ja pro-naziste (Shteti i Pavarur i Kroacisë) po përballej me kapitullimin. Ushtria dhe një numër i konsiderueshëm civilësh, të cilëve iu bashkuan edhe çetnikët, po tërhiqeshin drejt kufirit me Austrinë, për të shmangur zënien rob nga partizanët dhe për t'iu dorëzuar Aleatëve Perëndimorë, siç veproi ushtria gjermane kur u tërhoq nga Greqia. Si rrjedhim, luftimet vazhduan edhe pas amnistisë midis Gjermanisë dhe Aleatëve, duke rritur numrin e viktimave, te të dy palët. Edhe pse udhëheqësi i kolonës marshuese, që shtrihej gjatë disa kilometrave, hyri në Austri, oficerët britanikë nuk i lejuan ata të vazhdonin më tej, por i kthyen mbrapa në Jugosllavi. Qindra të burgosur lufte u ekzekutuan menjëherë pas rikthimit në Jugosllavi, dhe shumë të tjerë vdiqën përgjatë marshimeve të gjata në Lindje të vendit. Anëtarët e forcave bashkëpunuese sllovene, "Home Guard" [Home Guard]* (Domobranci), pësuan një fat të ngjashëm.

*Mbrojtja e Atdheut

I-4. Qeveria e Shqipërisë dhe aleatët e saj: sovjetikët, britanikët dhe amerikanët, Tiranë më 28 nëntor të vitit 1944

Albumi i Arkivit të Shtetit shqiptar "Qëndresa shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore", Tiranë, 2014.

Forcat komuniste të armatosura, të quajtura ndryshe edhe Ushtria Nacionalçlirimtare, gjatë luftës patën ndihmesën dhe mbështetjen e disa misioneve të huaja, në veçanti të misioneve britanike, amerikane dhe sovjetike. Qeveria komuniste e Enver Hoxhës, pas ardhjes në pushtet, në nëntor të vitit 1944, ndërmori një politikë të forcimit gradual të marrëdhënieve miqësore me sovjetikët dhe ftohjes së marrëdhënieve me britanikët dhe amerikanët, që shiheshin si "përfaqësuesit e shteteve më të fuqishme të imperializmit botëror". Qeveria e Shqipërisë komuniste

→

e pasluftës do t'i ndërpriste marrëdhëniet diplomatike me misionet britanike dhe amerikane në vitin 1946, ndërkohë që do të hynte në një aleancë të ngushtë me Jugosllavinë e Titos gjatë viteve 1945-1948, dhe më vonë me Bashkimin Sovjetik deri në vitin 1960, kohë kur do të shkëputej nga blloku i vendeve komuniste të Evropës Lindore.

I-5. Mikpritja e Ushtrisë së Kuqe në Sofje, shtatori i vitit 1944

http://www.lostbulgaria.com/?p=1129, vizituar më 16.09.2016.

Termi Ushtria e Kuqe ishte një ndër termat që përcaktonte forcat e armatosura dhe ajrore të Bashkimit Sovjetik. Fillimisht u krijua më 23 shkurt të vitit 1918 me emërtesën "Ushtria e Kuqe e Punëtorëve dhe Fshatarëve", që lidhej drejtpërsëdrejti me idenë komuniste - ngjyra e kuqe dhe ylli i kuq me pesë-cepa (që vihej në uniformat e ushtarakëve sovjetikë). Përpos faktit, që simbolizonte fuqinë ushtarake të Bashkimit Sovjetik, Ushtria e Kuqe lidhej gjerësisht edhe me politikën e jashtme sovjetike, që shpeshherë bazohej në ndërhyrje ushtarake të drejtpërdrejtë. Pjesëmarrja e Ushtrisë së Kuqe në Luftën e Dytë Botërore pati një rol vendimtar në mposhtjen e ushtrisë naziste. Në kontekstin e Luftës së Ftohtë dhe si vazhdimësi e politikave të modernizimit stalinist, ajo ishte një ndër ushtritë më të armatosura, duke pasur në dispozicion struktura kërkimi e zhvillimi dhe një kompleks të saj ushtarako-industrial.

I-6. Ngjarjet e dhjetorit të vitit 1944 dhe Marrëveshja e Varkizës në shkurt të vitit 1945

Qeveria greke e Bashkimit Kombëtar, e themeluar në Liban, në maj të vitit 1944, arriti në Athinë më 18 tetor, menjëherë pas tërheqjes së forcave pushtuese gjermane dhe pas arritjes së njësive të para ushtarake britanike. Ajo udhëhiqej nga Jorgo Papandreu, që ishte një liberal progresist i spikatur në periudhën ndërmjet dy luftërave, dhe përfshinte në përbërjen e saj ministra nga të dy partitë parlamentare tradicionale, siç ishin: KKE (Partia Komuniste e Greqisë) dhe nga EAM (Fronti Nacionalçlirimtar), të udhëhequr nga komunistët. Me ndihmën e krahut të saj ushtarak ELAS, EAM-i doli si organizata më e fuqishme e qëndresës, që kontrollonte pjesën më të madhe të Greqisë. Ajo, në shtator, kishte rënë dakord të ndiqte udhëzimet e Qeverisë greke në Kazerta. Megjithatë, kur Papandreu vendosi, në vijim të këmbënguljes së britanikëve, t'i çmobilizonte të gjitha njësitë e armatosura të parregullta gjatë pushtimit nga fuqitë e Boshtit, EAM/ELAS nuk pranoi, dhe ministrat e saj dhanë dorëheqjen nga qeveria. Ajo urdhëroi forcat ushtarake të marshojnë drejt Athinës dhe bëri thirrje për organizimin e një manifestimi masiv të paarmatosur më 3 dhjetor, dhe të një grevë gjithëpërfshirëse një ditë më vonë. Manifestimi u shtyp nga policia, ku mbetën të vrarë 30 manifestues dhe shumë të tjerë u plagosën. Që prej 4 dhjetorit, EAM/ELAS ndërmori një mësymje në shkallë të gjerë kundër komisariateve dhe ndërtesave të qeverisë. Më pas mori hov një konflikt i armatosur, që zgjati 33 ditë dhe shkaktoi humbjen e qindra jetë njerëzish, kryesisht civilë, dhe përfundoi me fitoren e forcave qeveritare. Përfshirja aktive e ushtrisë britanike në "Ngjarjet e dhjetorit" kishte rëndësi vendimtare për rezultatin e luftimeve.

"Ngjarjet e dhjetorit" (në greqisht iu referohen si Dekemvriana) përbëjnë rastin e vetëm gjatë Luftës së Dytë Botërore, që forcat aleate përplaseshin me njëra-tjetrën për marrjen e pushtetit në vitet e pasluftës. EAM/ELAS, dhe pas tyre KKE, druheshin se çmobilizimi i njësive të armatosura të parregullta gjatë pushtimit nga Forcat e Boshtit, do të çonte në krijimin e Ushtrisë Kombëtare, përbërja e së cilës nuk pasqyronte fuqinë e përgjithshme të EAM-it në atë kohë, për arsye se njësitë e saj luftarake ishin të shpërndara dhe shumë prej luftëtarëve të batalioneve të saj, ishin mbështetës të qeverisë.

Nga ana tjetër, qeveria nuk do të pranonte të vinte në rrezik pozicionin e fortë të qeverisë të saj e as të cenonte sovranitetin e saj. Për më tepër, mosbesimi i rivalëve ndaj EAM/ELAS-it kishte të bënte me pozicionin e saj që zotëronte dikur në një pjesë të madhe të Greqisë. Mosbesimi u shtua pas sulmit të saj, në prill të vitit 1944, kundër një organizate të rezistencës në qarkun e Pernasos dhe vrasjes së komandantit të saj, Kolonel Dimitri Psarros, së bashku me shumë prej luftëtarëve të tij. Marrëveshja e Varkizës, e 12 shkurtit të vitit 1945, e nënshkruar midis qeverisë dhe EAM, parashikoi çmobilizimin e forcave të krijuara gjatë pushimit të Greqisë nga Fuqitë e Boshtit. ELAS-si e ndërmori shpërndarjen, dhe pjesërisht ia arriti, por vazhdoi të ruante depo të rëndësishme me armatime.

Jorgo Papandreu (1888-1968) ishte një politikan që shërbeu në tre mandate si kryeministër i Greqisë (1944-1945, 1963, 1964-1965). Ai ishte edhe themeluesi i "dinastisë" politike të Papandreve dhe u kthye në Athinë (në tetor të vitit 1944) si kryeministri i qeverisë greke të Unitetit Kombëtar. Ai dha dorëheqjen në vitin 1945, pas Ngjarjeve të dhjetorit, megjithatë vazhdoi të ishte në rangjet e larta të politikës. Partia e tij e qendrës i fitoi zgjedhjet në vitet 1963 dhe 1964, pasi drejtoi një fushatë të vendosur kundër përdorimit të "dhunës dhe mashtrimit", në zgjedhjet e vitit 1961. Politikat e tij progresiste u kundërshtuan fuqishëm nga Mbreti Kostandin II i të djathtës, që përfundimisht shpërndau qeverinë në korrik të vitit 1965, duke shkaktuar protesta masive. Jorgo Papandreu vdiq një vit pas grushtit ushtarak të shtetit, në prill të vitit 1967, ndërkohë që ishte ende në arrest shtëpie.

A. Raportim i dëshmitarëve okularë për demonstratën masive të të majtëve, të zhvilluar në Sheshin "Sintagma" (Athinë), më 3 dhjetor 1944

[…] Procesioni u afrua: burra, gra dhe fëmijë, duke marshuar krah për krah, vetëm 8-10 centimetra larg njëri-tjetrit, dhe çdo person i tretë ose i katërt mbante një flamur të Aleatëve, një flamur grek, ose një banderolë mbi të cilën shkruheshin slogane me shkronja të kuqe dhe të rregullta, të ngjashme me ato që brohorisnin demonstruesit, nëpërmjet megafonave prej teneqeje dhe prej kartoni. Ishte një demonstratë e zakonshme e KKE.-EAM.-it. Moshat e pjesëmarrësve ishin nga dhjetë -dymbëdhjetë vjeç, deri në gjashtëdhjetë e sipër. Disa nga fëmijët ishin këmbëzbathur, shumica e pjesëmarrësve ishin pa pallto, megjithatë kishte edhe nga ata që ishin veshur mirë. […] Nuk kishte asgjë të vrazhdë apo kërcënuese nga demonstruesit edhe pse disa burra bërtisnin si fanatikë kur ndodheshin përballë komisariateve të policisë dhe hotelit, por kishte edhe shumë të qeshura dhe ngacmime, dhe shumë prej shakave thuheshin midis demonstruesve dhe pasuesve që i ndiqnin nga trotuaret. […] Ajo që ndodhi më pas ishte tërësisht e pabesueshme, sikur të shihje një film. Skuadra e policisë nga sipër zbrazi pushkët në drejtim të demonstruesve. […] Në fillim, mendova se po gjuante me fishekë manovre, ose që po merrnin nishan shumë sipër turmës. Edhe shumë persona të tjerë menduan si unë. Por, në fakt, ajo që kishte ndodhur, ishte përtej imagjinatës. Burra, gra dhe fëmijë, që pak çaste më parë kishin qenë duke brohoritur, duke marshuar, dhe duke qeshur, plot gjallëri dhe mosbindje, duke valëvitur flamujt e tyre dhe flamujt tanë, ranë në tokë dhe gjaku filloi të rridhte nga trupat e tyre, në rrugë, ose sipër flamujve që mbanin me vete.

[…] Krismat e armëve vazhduan, duke bërë jehonë nëpër ndërtesa të larta, dhe në kohën midis të shtënave, ngado dëgjoheshin britma frike dhe klithma dhimbjeje, dhe njerëzit vraponin si të çmendur, duke u penguar në trupa të gjakosur. […]Nuk kishte shumë vend për të gjetur ndonjë strehë për demonstruesit, ndërsa disa u fshehën pas pemëve dhe mureve, shumica e tyre ranë në tokë, ndërsa qitjet vazhdonin sipër kokave të tyre. Për më shumë se gjysmë ore, vazhdoi gjuajtja, të gjithë plumbat vinin nga policët dhe mbështetësit e EAM-it ishin të shtrirë për tokë.

Byford-Jones, 1946, f. 138-139.

B. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Varkizës, midis qeverisë greke dhe EAM-it, 12 shkurt 1945

Muzeu Perandorak i Luftës, Londër.

Studioni burimet për historinë e Greqisë dhe frazën e mëposhtme nga çelësi: "Ngjarjet e dhjetorit përbëjnë rastin e vetëm gjatë Luftës së Dytë Botërore, që forcat aleate përplaseshin me njëra-tjetrën për pushtetin e periudhës së pasluftës. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

1. Përse mendoni se Ushtria britanike mori pjesë në anën e forcave qeveritare, në "betejën e Athinës"?

2. Përse u detyrua Ushtria Popullore Nacionalçlirimtare

(ELAS) të dorëzonte artilerinë e saj?

3. Lidhini këto ngjarje me Luftën Civile në Greqi

(Kap.I.3).

I-7. Ndryshimet e kufijve si pasojë e Luftës Së Dytë Botërore

Ndryshimet e kufijve ishin një ndër pasojat e Luftës së Dytë Botërore, megjithatë ato ishin të papërfillshme për pjesën më të madhe të shteteve të Evropës Juglindore, nëse krahasohen me përcaktimet e pasluftës së Parë Botërore Rumania, Bullgaria, dhe Hungaria, si ish aleate të Gjermanisë, i kthyen pa asnjë kusht të gjitha territoret e pushtuara, kur nënshkruan amnistinë me Aleatët. Në vijim të Traktatit të Parisit, të nënshkruar më 10 shkurt të vitit 1947, Bashkimi Sovjetik përvetësoi Moldavinë dhe Bukovinën Veriore (pas Luftës së Parë Botërore ku territori ishte nën kontrollin e Rumanisë, dhe në vitin 1940 u aneksua nga BRSS-ja). Bullgaria mbajti Dobruxhën Jugore (e aneksuar nga → Rumania pas Luftës së Dytë Ballkanike, në vitin 1913, iu kthye Bullgarisë në vitin 1940). Istria bashkë me Rijekën/Fiume dhe disa vende të Dalmatisë kaluan nga Italia te Jugosllavia (Kroacia dhe Sllovenia), por çështja e Triestes dhe çështja e kufijve midis dy vendeve (të Italisë dhe ish-Jugosllavisë), u zgjidhën përfundimisht në vitet 1954 dhe 1975. Ishujt dodekanezë, të pushtuar nga Italia që prej Luftës osmano-italiane (për Libinë) të vitit 1912, iu kthyen Greqisë. Marrëveshja e paqes me Italinë, që parashikonte aneksimin e ishujve, u nënshkrua gjithashtu, më 10 shkurt të vitit 1947. Në faqen e parë të gazetës greke përshkruhej ceremonia zyrtare e ngjarjes në Rodos, e zhvilluar në prani të çiftit mbretëror, më 7 mars të vitit 1948. Titulli i shkrimit ishte: "Pas gjashtë shekujsh skllavërie, [Ishujt dodekanezë] u bënë sërish grekë"

ΗΜΕΡΗΣΙΑ ΕΘΝΙΚΗ ΕΦΗΜΕΡΙΣ

ΕΙΑΝ ΕΞ ΚΑΙ ΠΑΕΟΝ ΑΙΩΝΩΝ ΠΑΛΙΝ ΕΛΛΗΝΙΚΑ

http://efimeris.nlg.gr/ns/pdfwin.asp?c=108&dc=9&db=3&da=1948, vizituar më 12.10.2016.

I.1.2. Rikthimi në atdhe ose internimi

I-8. Një pjesë nga autobiografia e Sara Romisherit, një gjermane etnike e dëbuar nga Biertani në Bashkimin Sovjetik, menjëherë pas fundit të luftës

Më kujtohet si tani viti 1945, sepse atëherë shumica prej nesh, saksonët e Transilvanisë, të moshës midis 18 dhe 35 vjeç, u morën me forcë për të punuar në Rusi. Data ishte 16 janar, moti ishte i shumë mirë, ishte ngrohtë, nuk kishte fare dëborë. Na larguan nga njerëzit tanë të dashur, nga fëmijët, prindërit, vëllezërit dhe motrat tona. Është vështirë ta kuptojnë ata që nuk e kanë përjetuar një gjë të tillë. [...] Më 24 janar të vitit 1945, të gjithëve bashkë, burra e gra, na futën në vagonë pis, që ishin përdorur për të transportuar bagëti, dhe që ishin plot me morra. Udhëtuam me atë tren për ditë të tëra, derisa më në fund ai ndaloi. Ishte nata e 2 shkurtit të vitit 1945.

Po shikoja nga të çarat e dritares së vagonit dhe pashë se po na zbrisnin dhe pasi po na përzienin, më pas po na hipnin sërish në një tren tjetër. Ishim rreth 30 veta në një vagon. Dhjetë hapa më tej ishte një ushtar që na ruante me [pushkë], kështu që asnjë nuk mund të arratisej. […] është shumë e vështirë të përshkruhet se si kaluan dy vitet e para: uri, të ftohtë, rrahje, morra në kokë, morra kudo; kishim morra edhe në rroba, edhe në trup. Shumë veta vdiqën nga uria, përfshirë edhe rusët, sepse edhe ata nuk kishin asgjë për të ngrenë, ashtu si ne. Kapëm disa qenë dhe mace. Edhe unë hëngra mish maceje. Gjithçka është e dhimbshme kur je i uritur. […] Veçanërisht burrat

sëmureshin më shpesh, sepse gratë dinin se si të kujdeseshin më shumë për vete por edhe duronin më shumë. Shihnim burra që për të mposhtur urinë, këpusnin dhe hanin bar. Kjo ishte gjendja. Edhe unë kam ngrenë lule mëllage dhe gjethe. Gjithmonë mendoja se duhet të kisha diçka në stomak, sepse e vetmja gjë që na jepnin për të ngrënë ishte një copë buke e thatë, në katër të mëngjesit të çdo dite dhe deri ditën e nesërme na jepnin vetëm një racion supë me lakër të kripur dhe pa vaj.

http://povestisasesti.com/2013/11/22/in-lagarul-memoriei-o-marturie-despre-deportare, accessed on 5.05.2015.

Në janar të vitit 1945, më shumë se 70,000 gjermanë etnikë nga Rumania (kryesisht saksonë nga Transilvania dhe shvabë nga Banati) u dëbuan dhe u dërguan në minierat në Donbas, me idenë se do ndihmonin në "rindërtimin e BRSS-së". Dëbimi do të zgjaste 5 vite; por më shumë se 20% e të dëbuarve ose vdiqën, ose u zhdukën dhe kurrë s'u mor vesh fundi i tyre.

I-9. Rrëfimi i Jelena Kurtnakerit nga Pozhega për internimin e saj në kampin e përqendrimit të Krndija, në korrik të vitit 1945

Mua dhe nënën time, në korrik të vitit 1945 na morën nga Pozhega dhe na dërguan në kampin e përqendrimit të Krndijas. E ndjenim që ishim kroatë. Më kujtohet se kisha në Krndija ishte shkatërruar, por altari i Shën Antonit ishte ruajtur. Ishim 100 veta në një ahur. Shtriheshim sipër kashtës së vjetër, ngjitur njëri me tjetrin. Më pyetën: a di të shkruash, pasi e vunë re që kisha një stilograf me vete. U bëra si sekretare. Mbaja listën e të burgosurve që ishin në ahur. Sa herë që vinin ata të administratës, duhet të bënin apelin. Një roje çdo natë vinte në mesnatë, dhe na nxirrte përjashta. Në kamp dëgjoja të flitej vetëm kroatisht. Në seksionin tim, një natë, një grua lindi në kamp. E ndihmoi një grua e moshuar. Fëmija ishte shumë i dobët. Një ose dy ditë para festës së Shën Mërisë (ra e diel), e pagëzuam fëmijën në kishë. I vumë emrin e krishterë Maria. Një ose dy ditë pas festës, Maria vdiq. Më kujtohet që dy vajzave të kampit iu dolën puçrra në lëkurë dhe të dyja vdiqën një natë. Nuk na jepnin ilaçe. Një nga të burgosurit ishte doktor. Në ato kushte nuk të bën përshtypje vdekja. Kishte vetëm një pus me ujë të pijshëm. Ushqimi ishte i tmerrshëm. Nëpërmjet gardhit me tela, një herë, vajza që shërbente në shtëpinë e kushërirës sime, na kaloi bukë dhe një shishe me konjak. Ajo kishte ardhur nga Pozhega në këmbë. Një vajzë, me emrin Ankica Bishof, nga Pozhega, u arratis nga kampi. E ndihmova unë. Nuk më kujtohen emra të tjerë. Ishte edhe një prift i ri në kamp. Ne e morëm vesh më vonë që ai ishte prift. Asnjë nuk ia dinte emrin. Ne e thërrisnim "i paemër". Pas kërkesës së nëntë të kushërirës sime në tetor të vitit 1945, nëna ime dhe unë arritëm të liroheshim. Ajo arriti t'i bindte se, në fakt, ne ishim hungarezë me origjinë dhe jo gjermanë. Kur u ktheva në shtëpi, në Pozhega, për shumë kohë nuk i tregova asnjërit për kampin. Ditët e mia në kampin e Krndija i përshkrova në tregimet e librit me titull: "Kujtime të hidhura: rrëfime nga kampi dhe i paemri". Nuk i referohesha kampit të Krndijës me emër, por kujtimet janë nga ai kamp.

Geiger, 2008, f. 371.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, një pjesë e madhe e pakicës etnike gjermane nga territori i Mbretërisë së Jugosllavisë e kishte përkrahur nacional-socializimin kombëtar dhe idetë që ishin përhapur nga "Rajhu i Tretë". Kjo ishte arsyeja se përse pas luftës pjesëtarët e pakicës gjermane u shpallën kolektivisht fajtorë nga autoritetet komuniste. Si pasojë, njerëzit u persekutuan dhe pasuria e tyre u plaçkit. Një pasojë të tillë pësuan gjithashtu edhe pjesëtarë të shumtë të pakicës gjermane, që nuk e mbështetën nacional-socializmin dhe Adolf Hitlerin gjatë luftës.

I-10. Reforma agrare dhe kolonizimi në Vojvodinë

Neni 16

Në lidhje me shpërndarjen e tokës, përparësi do t'iu jepet fermerëve pa tokë ose me parcela të vogla toke, që gjatë Luftës Nacionalçlirimtare kanë luftuar në çeta partizane, në Njësitë Partizane Çlirimtare dhe në Ushtrinë jugosllave; veteranëve me aftësi të kufizuara nga pasojat e dëmtimeve gjatë luftës çlirimtare, si edhe veteranëve të gjymtuar në luftëra të mëparshme (1912-1918 dhe prill të vitit 1941), dhe familjeve e jetimëve të ushtarëve të rënë dëshmorë në Luftën Çlirimtare dhe viktimave e familjeve të viktimave të terrorizmit fashist. Midis këtyre, do t'iu jepet përparësi veteranëve dhe vullnetarëve.

Përparësi për shpërndarjen e tokës do t'iu jepet luftëtarëve të përmendur në paragrafin paraardhës, që nuk janë fermerë, dhe që zotohen se do të vendosen në tokën e dhënë dhe do ta punojnë atë bashkë me familjen.

Neni 19
Sipërfaqja e tokës së dhënë sipas planit të lartpërmendur, duhet të jetë nga 8 deri 12 hektarë tokë e lërueshme kadastre, për çdo komunitet ferme (shtëpi ose familje). Në mënyrë të veçantë, sipërfaqe më të mëdha toke, por pa kaluar 30 për qind të maksimumit të vendosur, mund t'iu jepet heronjve kombëtarë ose familjeve të tyre dhe oficerëve të Ushtrisë jugosllave, që janë fermerë me profesion, si edhe familjeve të mëdha.

Nëse toka ndodhej në qytete më të mëdha, në formën e kopshteve ose tokave të punueshme, maksimumi i dhënë duhet të jetë nga 4 deri 6 hektarë.

Ligji për reformën agrare dhe kolonizimin, lista Službeni/Gazeta zyrtare e JFD (Jugosllavia Federale Demokratike), Nr.. 64/45.

Më 23 gusht 1945, Asambleja e Përkohshme Kombëtare e Jugosllavisë Federale Demokratike (JFD) miratoi një ligj për reformën agrare dhe kolonizimin, në bazë të së cilit rreth 40 për qind e tokës në Vojvodinë kaloi në pronësi të shtetit. Për pasojë, Vojvodina u kolonizua nga 258,405 persona (37,616 familje) nga Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Serbia dhe Mali i Zi. Kolonizimi u realizua në bazë të ligjit për reformën agrare dhe rregullores, që për shpërndarjen e tokës, iu dha përparësi banorëve që kishin marrë pjesë në Luftën Kombëtare Çlirimtare dhe veçanërisht veteranëve, që u mobilizuan në fillim të vitit 1941 dhe deri në vitin 1943. Pronat që iu dhanë të ashtuquajturve bezemljashi, "të patokët", pas luftës, ishin kryesisht ato që u përkisnin gjermanëve etnikë të dëbuar. Një numër i madh kolonësh u zhvendosën drejt fshatrave që ishin evakuuar nga gjermanët e larguar. Vendbanimeve iu vunë emërtime të reja që i korrespondonin përbërjes etnike të ardhësve.

Lexoni burimet e kapitujve I-9 dhe I-10. Përse mendoni se gjermanët etnikë që banonin në shtetet e Evropës Juglindore u trajtuan ashtu, pas luftës? A kishin të gjithë të njëjtat ide dhe a kishin mbajtur të njëjtin qëndrim kundrejt Rajhut të Tretë gjatë gjithë luftës? Diskutoni në klasë kuptimin e togfjalëshit "faj kolektiv", duke përdorur më shumë shembuj. Përpiquni të gjeni pamje filmike ose pjesë letrare për këtë temë, duke iu referuar jo domosdoshmërisht vendeve të mësipërme.

I-11. Kërkesë nga disa hebrenj të riatdhesuar nga Bukovina, ish të dëbuar në Transdinistri, drejtuar Ministrit të Punëve të Brendshme, për t'iu dhënë atyre dokumente identifikimi, pa dokumente mbështetëse, që ishin të pamundur të sigurohesin në atë kohë (korrik 1945)

Ministër [i Punëve të Brendshme],
Të nënshkruarit, të riatdhesuar nga Bukovina, në prill dhe maj të vitit 1945, si qytetarët rumunë, të sistemuar në Botoshan, Roman, Bacau, Foshan, Bukuresh, Brashov, Sibiu, Cluj, Oradea dhe Timishoara, [dhe] u pajisën kudo me dokumentet e duhura të identifikimit nga zyra e gjendjes civile, me përjashtim të bashkisë së Timishoarës.[...] Ata pretendojnë se certifikatat e riatdhesimit nuk janë të mjaftueshme dhe se ne kemi nevojë për dokumente shtesë, që, si ish të dëbuar në Transdnistri, nuk mund t'i kemi [...]. Jemi goditur disa herë nga fati me gjithë këto eksode, që na kanë çuar në varfërimin tonë të plotë. Nuk kemi më fuqinë, mjetet financiare, apo forcën shpirtërore për të duruar shqetësime të tjera. [...] Po afron data 1 gusht i vitit 1945, dita kur do të na përzënë nga Timishoara nëse [policia atje] nuk merr urdhra të qarta, për të na dhënë dokumentet tona të identifikimit. [Si rrjedhim] me respekt ju kërkojmë që të merrni parasysh që pa karta identifikimi civil, ne: 1) Nuk mund të marrim kartat për racionin e ushqimit; 2) nuk mund të gjejmë punë; 3) nuk mund të marrim shtëpi me qira; kështu që jetojmë në një shkollë, mbi bankat e nxënësve, aty ku na kanë toleruar deri më tani. Për këto arsye, ne me shumë respekt ju kërkojmë t'u dërgoni urdhrat e nevojshëm Komisariateve të Timishoarës, që të na pajisin me kartat e duhura të identifikimit, dhe t'i japim fund të gjitha këtyre shqetësimeve të padobishme dhe thellësisht të dhimbshme.

Koleksioni i Arkivit Kombëtar të Bukureshtit: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, D. 44/1945, fq. 35.

Transdnistria është rajoni midis Dniesterit dhe Bugit, që iu dha Rumanisë për pjesëmarrjen e saj gjatë sulmit të gjermanëve kundër Rusisë (Gusht 1941). Hebrenjtë, që u dëbuan nga Besarabia dhe Bukovina, u vendosen atje me dhunë, në kushte tmerrësisht çnjerëzore. Për të realizuar spastrimin etnik, gjatë lëvizjes së tyre në kampet e përqendrimit të Transdinistrisë, vdiqën rreth 105,000-120,000 hebrenj rumunë të dëbuar, së bashku me 115,000-118,000 hebrenj vendas (sipas http:// www.inshr-ew.ro/ro/holocaustul-din-romania/etape-ale-holocaustului.html, vizituar më 29.01.2015).

I-12. Kjo letër e një të mbijetuari nga kampet e shfarosjes, përcjell në mënyrë të dhimbshme vështirësitë që përballuan shumica e hebrenjve grekë kur u kthyen në atdheun e tyre, në vitin 1945

Në botimin tuaj të fundit, publikuat letrën e një të mbijetuari që me të drejtë ankohet për mbylljen e mensës së Qendrës. Të gjithë e mbajnë mend se çfarë ofronte Qendra. Secili nga ne kishte ngrënë aty një vakt me çmim të ulët, por më e rëndësishmja për ne është se në atë Qendër çdokush gjeti atë që i mungonte më shumë: "atmosferën familjare". Shumica prej nesh jemi të vetmuar, pa familje, pa një qendër që të zëvendësonte, qoftë edhe për një çast, familjet tona të humbura. Ju themi jo mensave për të varfrit. Ju themi jo radhëve të gjata që na kujtojnë kampet e përqendrimit. Le të kemi një mensë, ku izraelitët – të varfrit, punëtorët, punonjësit dhe sipërmarrësit e vegjël - do të gjejnë një pjatë gjellë të ngrohtë, falas për indigjenët dhe me çmime të ulëta për të tjerët. Mensat për të varfrit do të strehojnë vetëm një numër të vogël bashkëfetarësh. Shumica, edhe pse mund të jenë duke vdekur për bukë, nuk do të ulen pranë tyre, vetëm për të treguar dinjitet, që shyqyr zotit nuk e kemi humbur ende. Kemi përshtypjen se përpjekjet tona duhet të synojnë në përmirësimin e jetëve tona në përditshmëri, sesa të na kthejnë në ditët e zymta të vitit 1941.

Ισραηλιτικόν Βήμα [Tribuna Izraelite], Nr. 3, Selanik, 7 dhjetor1945, fq. 2.

Për gjenocidin e hebrenjve grekë, shihni: "Libri i punës 4", 2009, dok. III-26, III-27.

I-13. Një anije transferon studentë grekë drejt Francës, në vitin 1945

Menjëherë pas çlirimit të Greqisë nga pushtimi i forcave të Boshtit, në vjeshtën e vitit 1944, drejtori i Institutit francez në Athinë, Octave Merlier, i propozoi Ministrisë franceze të Punëve të Jashtme ofrimin e disa bursave për studentët grekë, si djem ashtu edhe vajza, për t'iu mundësuar atyre vazhdimin e studimeve në Francë. Shumica e atyre që u zgjodhën, diku te 200 veta, hipën në anijen "Mataroa" për trupat ushtarake, në dhjetor të vitit 1945 e lanë Pireun. Përgjithësisht, ishin të gjithë me bindje të majta, dhe shpërngulja e tyre drejt Francës i shpëtoi ata nga persekutimi i mundshëm në kuadrin e luftës civile të pashmangshme në Greqi. Në Francë, shumë prej tyre shkëlqyen në studimet dhe ndoqën një karrierë të suksesshme në Arte dhe në Shkenca. Për shkak të klimës politike që sundonte në Greqi, shumica e kishin të pamundur të ktheheshin, deri sa ra diktatura ushtarake në vitin 1974, ndërsa të tjerë zgjodhën të qëndronin në Francë përgjithmonë. Autorja Mimika Kranaki e përshkruan udhëtimin në një tekst të botuar fillimisht në frëngjisht, në vitin 1950.

→

Nuk mund ta imagjinonim në atë kohë që po i thoshim lamtumirë Greqisë! Ishte një udhëtim i zakonshëm për "studimet pasuniversitare", kështu të paktën i thoshim vetes, dhe më pas do të ktheheshim me patjetër në atdhe, çfarë mund të ndodhte tjetër? Më vonë do ta kuptonim se rrugë kthimi s'kishte më. […] Tashmë ishte errësuar tërësisht, nata e parë larg Greqisë sapo kishte rënë. Ne jemi "përfituesit e bursave" të shtetit francez, artistë, shkencëtarë, teknikë, etj.

Zbritëm nga anija "Mataroa " që transportonte trupa ushtarakë në Taranto, dhe pasi i hipëm një treni mallrash, vazhduam udhëtimin tonë. Është dhjetor. Vagonët e trenave nuk kishin dritare. Kur errësohej, nuk dallonim asgjë; natën e parë, të dytë, të tretë, o Zot sa e madhe ishte Italia, përpiqeshim të sajonim dyshekë me valixhet tona. Disa ishin nisur me valixhe të mirëfillta, që sidoqoftë do të dëmtoheshin para se të arrinim në Paris. Pavarësisht varfërisë, shumica kishin marrë me vete çanta shpine, shporta, bohçe të sajuara me plaçkat e tyre, dhe dashurinë e atyre që ia kishin bërë me dorë me shamitë e tyre në limanin e Pireut. […] Më në fund, pas një jave që ishin larguar nga Pireu, dëgjuam: Kujdes, kujdes, kemi arritur në Paris. Është mesnatë. Po përpiqeshim të shihnim ndonjë gjë në errësirë. Asgjë. Hiç. Vetëm, në distancë, shumë larg, dukeshin tek tuk disa drita, ishin si të mbyllura hermetikisht, dhe dukeshin edhe më të panjohura se sa vetë nata.

Kranaki, 2008, fq. 13, 15.

I-14. Dokument udhëzimesh nga viti 1946, për vendimin e marrë nga disa udhëheqës hebrenj nga Transilvania për të emigruar drejt Palestinës dhe Amerikës, një ide që mbështetej nga shumë banorë të komuniteteve të rajonit, veçanërisht nga zonat rurale

Do doja t'iu raportoja: Udhëheqësi i komunitetit hebre nga komuna e Ileandës, qarku i Someshit [Sălaj], Fridman Mauriţiu, mori pjesë në një takim me të gjithë udhëheqësit hebrenj të rajonit të Transilvanisë,

në Arad dhe Timishoara, që u mbajt më 4 dhe 6 maj dhe u përqendrua në emigracionin e hebrenjve drejt Palestinës. Në atë takim, u mor vendim për emigrimin e hebrenjve që dëshironin të largoheshin për në Palestinë. Rreth 20 familje hebreje po përgatiteshin të iknin së shpejti nga komuna e Ileandës. Nisja e tyre, me shumë mundësi, do të bëhet për 14 ditë. [...] Hebrenjtë e mbetur po bënin marrëveshje të ndryshme në Bukuresht, me idenë e emigrimit drejt Amerikës. Në lidhje me këtë, populli hungarez është i lumtur që po largohen hebrenjtë.

Komandanti i Legjionit të Xhandarmërisë të Somesh-Dej, Kapiteni Vasilescu Ionel

Koleksioni i Arkivit Kombëtar të Bukureshtit: Inspektorati i Përgjithshëm i Policisë, D. 68/1946, fq. 114.

Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore nuk iu dha fund vuajtjeve të shumë hebrenjve që i mbijetuan Holokaustit. Shumë komunitete hebreje në Evropë u shfarosën dhe ata që mbijetuan nuk kishin asnjë vend ku të shkonin. Cilat janë problemet dhe vështirësitë, që hasën të mbijetuarit dhe të riatdhesuarit hebre, pas fundit të luftës, përshkruhet edhe në këto burime (dok. I-11, I-12, I-14)? Shqyrtojeni më tej këtë çështje dhe gjeni arsyen përse shumë hebrenj evropianë vendosën të emigronin në Palestinë, ose në Shtetet e Bashkuara të Amerikës? Komentoni burimin e fundit, domethënë përpjekjet për të shfrytëzuar emigracionin e hebrenjve për qëllime politike (Lufta e Ftohtë).

I.1.3. Rindërtimi

I-15. Shpërndarja e pakove ushqimore dhe atyre të përkujdesjes, nga UNRRA (Administrata e Shteteve të Bashkuara për Ndihmë dhe Rehabilitim), në Sarajevë. Bosnja dhe Hercegovina ishin shtetet që vuajtën më shumë nga uria dhe familjet aty ishin tërësisht të varura nga ndihma e UNRRA

Arkivi i Shteteve të Bashkuara dhe Seksioni i Menaxhimit: S-0800-0011-1-1.

Misioni jugosllav i UNRRA-së e nisi veprimtarinë e tij në prill të vitit 1945. Fillimisht, merrej me problemet e zbutjes së urisë në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në disa pjesë të Kroacisë. Për këtë qëllim, dërgohen sasi të shumta ushqimesh dhe pajisjesh mjekësore, si edhe staf mjekësor. Më pas, u dërguan pajisje teknike për t'iu dhënë shtysë zhvillimi sektorëve bujqësorë dhe industrialë. Nevojat e Jugosllavisë ishin kaq të ngutshme, saqë ai vend u bë përfituesi më i madh i ndihmës së UNRRA-së gjatë historisë së zbatimit të programeve, me vlerë 415 milionë dollarë.

I-16. Shpërndarja e ndihmës amerikane në Greqi

Fotografi nga Dimitrios Harissiadis. Shpërndarja e pakove të ndihmës. Keramikos, janar i vitit 1952.
© Muzeu Benaki, Arkiva fotografike [USIS.212-2].

Pavarësisht, nëse bëhej drejtpërdrejt nëpërmjet Planit Marshall, apo nga organizatat ndërkombëtare të mbështetura në ligj nga Uashingtoni, ndihma amerikane për Greqinë, ku synoheshin rindërtimi i vendit dhe mbështetja e popullsisë vendase ishte tepër e nevojshme pas pushtimit nga Forcat e Boshtit dhe Luftës Civile, që pasoi në gjysmën e dytë të viteve '40. Midis korrikut të vitit 1948 dhe janarit të vitit 1952, përveç ndihmës ushtarake prej 560 milionë dollarësh, Shtetet e Bashkuara ofruan edhe një ndihmë tjetër ekonomike për Greqinë me vlerë 1,3 miliardë dollarë.

Plani Marshall (Programi i Rikuperimit Evropian) ishte një iniciativë amerikane, për të mbështetur rindërtimin e ekonomive evropiane Perëndimore pas luftë. Plani ishte vënë në zbatim që në prill të vitit 1948. Ideja ishte që Evropa të lulëzonte sërish, dhe si rrjedhim të parandalonte përhapjen e komunizmit. Midis të tjerave, Plani Marshall nxiti rritjen e prodhimtarisë, shtoi numrin e anëtarësisë së sindikatave të punës, si edhe përvetësimin e procedurave moderne të biznesit. Emërtimi iu vu në nder të Sekretarit të Shtetit, George Marshall (1880-1959), një komandant i shquar i ushtrisë, që për këtë nismë mori Çmimin Nobel për Paqe, në vitin 1953

I-17. Ndihma Amerikane Ekonomike drejt Turqisë në dollarë amerikanë (në milionë)

1948-52	1953	1954	1955	1956	1957	1958	1959	1960	1961	1962	1963	1964	1965
197.1	46.2	92.3	68.1	99.9	96.9	85.7	103.3	84.4	101.9	135.0	130.5	101.6	152.1

Oran 2002, vëll. 1, fq. 533.

I-18. Qeveria e Shqipërisë përfaqësuesen e UNRRA-së e shpalli persona non grata, që në vitin 1945

A. Një letër e Këshillit të Ministrave të Shqipërisë (2 tetor 1945)

PËR QYTETAREN ANGLEZE, ZONJUSHA PENNINGTON
Zonjusha Pennington më 10 gusht të vitit 1945 mbërriti në Shqipëri si përfaqësuese zyrtare e UNRRA-së.
Personi i lartpërmendur, në vend që të përmbushte detyrën për të cilën kishte ardhur në Shqipëri, merrej me çështje politike; në vend që të mbikëqyrte siç duhet dhënien e ndihmës, ajo e kritikonte atë, duke bërë të pamundurën për të shkaktuar mosbesim te populli për udhëheqësin e tyre, për qeverinë, dhe për të shkaktuar pakënaqësi. […] Faktet janë si më poshtë:

1) Më 4 shtator të vitit 1945, gjatë udhëtimit për në Shkodër, ajo pyeti disa kosovarë që ishin në Mamurras: Cila qeveri është më e mirë, ajo e tanishmja, apo ajo e periudhës së Zogut?

2) Në shtëpinë e QAZIM KASTRATIT në Shkodër, ajo donte të linte një letër, por nuk ia arriti.

3) Në lidhje me ndihmën që shpërndahej, ajo iu tha banorëve të zonës së Shirokës: Ne po ju sjellim shumë lehtësim, por ata që ju besoni, si Bedri Spahiu dhe Koçi Xoxe, dhe që ju përshëndesin me grushte, nuk iu kanë qejf. Ata duan të [ndërtojnë] socializmin.

4) Në zonën e Shtojit, ajo ka thënë: Përse iu shitet buka, kur ne ua japim falas?

5) Oficerit shoqërues i tha: Qeveria juaj po vret shqiptarë të mirë dhe mbron interesat e atyre që na kanë luftuar; Çurçilli në programin e tij ka deklaruar se të gjithë shqiptarët në Angli do të dërgohen këtu. Sa për çështjen greke, ajo i tha oficerit shoqërues se së shpejti do të ishim në luftë me Greqinë […]

6) Shprehu keqardhjen e saj për Zogun, ndërsa ofendoi ata që kryesonin tani Qeverinë, si Bedri Spahiun dhe Koçi Xoxen.

Personi i lartpërmendur është shpallur persona non grata, dhe si rrjedhim i kërkojmë asaj të bëjë përgatitjet zyrtare për t'u larguar nga shteti ynë.

AQSH [Arkivi Qendror i Shtetit], F. 490, v. 1945, d. 109. fl. 4.

B. Një letër e zonjushës R.V. Pennington dërguar drejtorit të misionit të UNRRA-së në Shqipëri, nëpërmjet së cilës ajo nuk pranon akuzat kundër saj në lidhje me veprimtarinë që ka zhvilluar në këtë shtet

Drejtuar: Z. Oakley-HILL
Kryetari i Misionit të UNRRA-së
Nga: R.V. Pennington

2 tetor 1945

Kam lexuar letrën e protokolluar me nr. 82, datë 2 tetor 1945, të Zyrës së Kryeministrisë dhe në përgjigje të saj më lejoni t'ju shpjegoj se nuk kam folur me asnjë grup personash dhe se kurrsesi nuk kam bërë kritika për Qeverinë, qëllimet dhe përparimin e së cilës e mbështes dhe e lavdëroj.

Për sa u përket deklaratave në këtë letër:

1) Më 4 shtator, ndaluam për të pirë diçka, në një restorant në Mamurras. E vetmja bisedë që kam bërë

kishte të bënte me vendasit dhe ngjarjet që lidhen me ta. Qëndruam atje vetëm për 20 minuta, gjatë rrugës tonë për në Shkodër.

2) Në Shirokë, i vetmi person që kam takuar ishte një furrxhi dhe synimi im i vetëm ishte të kontrolloja cilësinë e bukës. Vizituam edhe motrat katolike, për t'i pyetur për shëndetin e fëmijëve. Për më tepër, pamë një grua të moshuar, mbi 60 vjeç, e paralizuar, që na ftoi dhe të cilës unë i dhashë pesë franga. Vizituam edhe një familje të varfër, ku biseduam për peshkimin.

3) Në zonën e Shtojit vizituam tre shtëpi, ku na pëlqeu një makinë që e kishte sjellë një djalë i ri […]. Aty bisedova edhe me një grua dhe dy vajza të vogla.

4) E kisha shumë të vështirë të kuptoja të folurën si në dialektin si në dialektin tosk, ashtu edhe në atë geg të oficerit shoqërues. Pra, unë në asnjë mënyrë nuk pranoj asnjë nga vërejtjet që më kanë bërë, pasi ato unë jo vetëm që nuk i kam thënë, por as që i kam menduar.

5) E refuzoj në mënyrë kategorike këtë deklaratë, sepse nuk e kam bërë atë as atëherë dhe as në ndonjë kohë tjetër.

Më lejoni të shtoj këtu se i vetmi çast i sikletshëm gjatë udhëtimit për në Shkodër, ishte kur vizituam shtëpinë e Znj. Kastrati në Pllumb. Një kushëri i familjes aty më pyeti në prani të xhaxhallarëve [të tij] dhe të oficerit partizan, nëse kisha vënë re ndonjë ndryshim në Shqipëri në krahasim me situatën para-luftës. Iu përgjigja: Nuk mund të flas për çështje politike. Shikoj të njëjtët sy, të njëjtat këmbë, dhe dëgjoj të njëjtën gjuhë që kisha dëgjuar edhe më parë. Nuk e kuptoj se çfarë do të thuash me këtë pyetje, dhe për këtë arsye nuk do të flas në këtë pikë. Kur vazhdoi të më pyeste për mendimet e mia mbi përmirësimet e ardhme dhe atyre të tanishme, iu përgjigjja se nëse do të mbante në krahë një fëmijë të vogël, si do të mund dikush ta kuptonte nëse, kur ai të rritej, do të bëhej i pashëm apo do të kishte mjekër.. Në atë çast, partizani dhe të gjithë personat e tjerë të pranishëm, ia plasën së qeshurës, dhe më pas diskutuam edhe për disa gjëra të tjera.

A është e mundur që unë, e cila gjatë punës sime në Shqipëri në vitet 1924-1939, si edhe gjatë luftës, kam bërë të pamundurën, që kam dhënë edhe pará për Shqipërinë, që më quajtën edhe anti-Zog, që nuk pashë për një vit vajzën time- pikërisht unë të kem bërë vëzhgime të ashpra, ashtu siç pretendohet në letrën në fjalë? Asnjë shqiptar, që e njeh punën time, nuk mund të pohojë se kjo është e mundur.

R.V. Pennington

AQSH [Arkivi Qendror i Shtetit], F. 490, v. 1945, fl.5.

I-19. Hartë e fshatrave në Greqi, që u dogjën nga pushtuesit

I botuar nga Ministria e Rindërtimit, ky album në katër gjuhë, i ilustruar në mënyrë të përkryer, pasqyron në mënyrë të qartë dëmet
që vendi dhe populli ka pësuar gjatë pushtimit nga fuqitë e Boshtit. Diçitura e fotografisë shkruan si në vijim për "Fshatrat e djegura": "Sikur të mos mjaftonin të gjitha katastrofat, fuqitë pushtuese zbatuan një plan sistematik të shkatërrimit të helenizmit: duke djegur fshatrat. 1,770 fshatra grekë u bënë shkrumb e hi. Në disa pjesë të vendit, sidomos në afërsi të zonave kufitare, shkatërrimi nga zjarri arriti në 90 për qind të fshatrave të çdo rajoni.

Lexoni çelësin, fotografia (dok. I-16) dhe harta e fshatrave të djegur në Greqi (dok. I-19). Si mendoni se ishte situata në Greqi pas lufte, duke marrë parasysh se u pasua nga një luftë civile mizore?

DETYRA PËR KËTË PJESË TË KAPITULLIT I.1.3

1. Sa ishte ndihma financiare në tërësi që iu dha Evropës Juglindore në fund të luftës?

Cilat ishin problemet kryesore që duhet të përballeshin me ngut? Si ishte kjo ndihmë (qoftë nga zyrtarët dhe vullnetarët e

UNRRA-së, qoftë nga Plani Marshall) e drejtuar nga politikanët dhe qeveria? Gjeni informacion (raporte, materiale vizuale, dëshmi verbale) për shpërndarjen e drejtë ose përzgjedhëse dhe përdorimin ose keqpërdorimin e ndihmës.

2. Rendisni vështirësitë që hasën banorët e Evropës Juglindore në jetët e tyre të përditshme, dhe periudhën e pasluftës

K. Doxiadis (bot.), "Sakrificat e Greqisë në Luftën e Dytë Botërore", Athinë 1946, fotografia 53.


ALVANIA
JUGOSLAVIA
BULGARIA
TURQIA
KRITI

I.2. REGJIME TË REJA

I.2.1. Tranzicioni

I-20. Deklarata e qeverisë së Tito-Shubashiç, 9 mars 1945

Në këtë mënyrë, atdheu ynë ka një qeveri të bashkuar, që është një parakusht i domosdoshëm për përfundimin e shpejtë dhe të suksesshëm të luftës dhe për rindërtimin e shpejtë të planifikuar të vendin tonë. Qeveria, që e prezanton veten para popullit të Jugosllavisë me këtë deklaratë sot, është rezultati i nevojave politike të brendshme dhe të jashtme. Nga njëra anë, themelimi i saj do t'i japë edhe më tej shtysë për të mbledhur të gjitha forcat që ishin nëpërkëmbur pasi kishin bashkëpunuar me pushtuesin ose me bashkëpunëtorët e tij, dhe nga ana tjetër, në një klimë mirëbesimi, qeveria do të lehtësojë shumë përpjekjet për rindërtimin e vendit tonë dhe do të përforcojë më tej marrëdhëniet miqësore me aleatët e saj. Qeveria është e bindur se mbështetja e plotë e njerëzve dhe e përfaqësuesve të saj, do t'i japë fuqi për të përmbushur detyrat e rëndësishme që kërkon koha.

"Politika", Beogradi, viti XLII, nr. 11921, 10 mars 1945, 1, në: Neshoviç dhe Petranoviç, 1983, fq. 657-661.

U nënshkrua një marrëveshje midis KKÇJ (Komitetit Kombëtar për Çlirimin e Jugosllavisë) dhe Qeverisë Mbretërore dhe Kryeministrit të saj Ivan Shubashiç në ishullin e Vis, më 16 qershor të vitit 1944 (Marrëveshja Tito-Shubashiç), sipas së cilës palët nënshkruese e njihnin njëra-tjetrën dhe ranë dakord që të vepronin së bashku. Më 8 gusht, qeveria e Shubashiçit publikoi një deklaratë ku lavdëronte disa njësi të UÇKJ-së (Ushtria Çlirimtare Kombëtare e Jugosllavisë) për luftën e zhvilluar kundër pushtuesve dhe e njohu administratën e KAÇKJ-së (Këshilli Antifashist për Çlirimin Kombëtar të Jugosllavisë) dhe Komitetet Çlirimtare Kombëtare të Jugosllavisë deri në formimin e rregullt të asambleve popullore në vend. Mbreti Peter II, nëpërmjet fjalimit të tij në Radion e Londrës, më 12 shtator, e shkarkoi Gjeneralin Mihailoviç si shefi i shtabit të Ushtrisë jugosllave dhe iu bëri thirrje serbëve për ta njohur Mareshalin Tito në vend të tij. Marrëveshja midis KKÇJ-së dhe Qeverisë Mbretërore të Jugosllavisë e 1 nëntorit të vitit 1944 (Marrëveshja e Beogradit Tito-Shubashiç) vendosi që emërtimi i shtetit në të ardhmen do të ishte Jugosllavia Federale Demokratike (JFD), se "Mbreti Peter II nuk duhet të kthehet në vend deri sa të vendosë populli", se në mungesë të tij "autoriteti mbretëror do të zbatohej nga Regjenca", se do të formohej një qeveri e përkohshme, dhe se, deri sa të zhvilloheshin zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese, KAÇKJ-ja do të ngarkohej me funksionet legjislative dhe ekzekutive të qeverisë.

→

I-21. Kushtetuta e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë (RFPJ), 31 janar 1946

Neni 1. Republika Federale Popullore e Jugosllavisë është një shtet federal popullor, në formë republike, një komunitet popujsh me të drejta të barabarta, që në bazë të së drejtës të vetëvendosjes, përfshirë edhe të drejtën e ndarjes, kanë shprehur vullnetin e tyre të jetojnë së bashku në një shtet federal.

Neni 2. Republika Federale Popullore e Jugosllavisë përbëhet nga Republika Popullore e Serbisë, Republika Popullore e Kroacisë, Republika Popullore e Sllovenisë, Republika Popullore e Bosnjë-Hercegovinës, Republika Popullore e Maqedonisë dhe Republika Popullore e Malit të Zi. Republika Popullore e Serbisë përfshin krahinën autonome të Vojvodinës dhe krahinën autonome Kosovë-Metohi.

Neni 9. Sovraniteti i republikave popullore që përbëjnë RFPJ-në është i kufizuar vetëm në të drejtat që i jepen asaj nga kjo Kushtetutë.

Neni 12. Asambleja Popullore e RFPJ-së përcakton kufijtë midis republikave popullore. Kufijtë e republikës popullore nuk mund të ndryshohen pa miratimin e saj.

Neni 14. Mjetet e prodhimit në RFPJ janë ose në pronësi të të gjithë popullit, pra pronë në duart e shtetit, ose pronë e organizimeve kooperativiste të popullit, ose ndryshe pronë e personave privatë ose subjekteve ligjore. Tregtia me jashtë do të kontrollohet nga shteti.

Neni 15. Për të mbrojtur interesat thelbësore të popullit, për të rritur mirëqenien dhe të drejtën e përdorimit të potencialeve ekonomike dhe forcës,

shteti e drejton jetën ekonomike dhe zhvillimin e vendit në varësi të planit të përgjithshëm ekonomik, duke u mbështetur në sektorë ekonomikë shtetërorë dhe kooperativistë, për të arritur kontrollin e përgjithshëm ndaj sektorit privat ekonomik.

Neni 18. Garantohen pasuria private dhe nismat private në ekonomi.

Neni 19. Toka u përket atyre që e punojnë atë. Persona privatë nuk mund të kenë sipërfaqe më të mëdha në çfarëdolloj rasti.

Neni 24. Gratë kanë të njëjta të drejta me burrat në të gjitha fushat e shtetit, të jetës ekonomike dhe social-politike.

Neni 25. Qytetarëve iu garantohet liria e ndërgjegjes dhe liria e fesë. Kisha është e ndarë nga shteti.

Neni 26. Martesa është e vlefshme vetëm nëse bëhet para organeve përgjegjëse shtetërore. Pas martesës, qytetarët mund të bëjnë një ceremoni martesore fetare. Regjistrimi i lindjeve, martesave dhe vdekjeve bëhet nga shteti.

Gazeta e Qeverisë së RFPJ-së, Nr. 10/1946.

Në zbatim të vendimit të Asamblesë Kushtetuese, Kushtetuta e RFPJ-së u shpall më 31 janar të vitit 1946. Ajo u bazua në Kushtetutën e BRSS-së të vitit 1936. Ajo e shpalli sovranitetin e popullit dhe e përkufizoi Jugosllavinë si një "shtet kombëtar federal" i përbërë nga gjashtë republika. Shteti u organizua në bazë të parimit të autoritetit të vetëm dhe centralizmit demokratik. Republikat popullore e ushtronin në mënyrë të pavarur pushtetin dhe ishin të kufizuar vetëm nga të drejtat që ato me vullnet të lirë ia njohën. Megjithatë, roli i organeve federale të autoritetit dhe pushtetet e tyre i tejkaluan ato të organeve republikane, dhe si rrjedhim autoriteti ishte centralizuar nga kushtetuta. Pakicat kombëtare gëzonin "të drejtën për mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre kulturor dhe përdorimin e lirë të gjuhës së tyre". Pronësia ishte shtetërore, kooperativiste ose private. Pronësia private mund të kufizohej, ose të shpronësohej, nëse e kërkonte "interesi i përbashkët". Të gjithë qytetarëve mbi tetëmbëdhjetë vjeç iu dha e drejta e votës. Për herë të parë, gratë dhe ushtarët u lejuan të votonin. U garantuan liria e shtypit, fjalës, liria e tubimit dhe organizimit, si edhe e takimeve publike dhe manifestimeve. Shkollat u ndanë nga kisha dhe arsimi fillor u bë i detyrueshëm dhe falas.

I-22. Kushtetuta e vitit 1946: Mali i Zi, një Republikë në Federatën Jugosllave

Neni 2. Duke qenë se Mali i Zi është krijua si shtet kombëtar, përmes luftës çlirimtare dhe luftës së përbashkët të popujve jugosllavë, në bazë të së drejtës të çdo kombi për vetëvendosje, përfshirë të drejtën e ndarjes dhe bashkimit me popuj të tjerë, dhe duke qenë se populli i Malit të Zi ka shprehur vullnetin e tij, ai i bashkohet një bashkësie me popuj të tjerë jugosllavë dhe republikat e tyre populloree në bazë të parimit të barazisë […] në një shtet të përbashkët federal

– Republika Populloree Federale e Jugosllavisë.

Neni 10. Republika Populloree e Malit të Zi e administron vetë autoritetin e shtetit, duke i transferuar Republikës Populloree të Jugosllavisë vetëm ato të drejta nën kujdesin e shtetit federal të parashikuara nga kushtetuta e RFPJ-së.

Neni 13. Pakicat kombëtare në Republikën Populloree të Malit të Zi gëzojnë të drejtën dhe mbrojtjen e zhvillimit kulturor dhe lirinë për përdorimin e gjuhës së tyre.

Neni 16. Pronat publike janë shtylla e shtetit gjatë zhvillimit të ekonomisë kombëtare.

Neni 18. Pronat private mund të kufizohen, ose të shpronësohen, nëse është e domosdoshme për të mirën e të gjithëve, sidoqoftë kjo do të bëhet sipas ligjit. Disa fusha të industrisë apo ndërmarrjeve mund të shtetëzohen sipas të njëjtave kushte.

Neni 24. Gratë kanë të njëjtat të drejta me burrat në të gjitha fushat e shtetit, të jetës ekonomike dhe social-politike.

Neni 36. Shteti është përgjegjës për përmirësimin e shëndetit të përgjithshëm të popullit. Shteti është përgjegjës për përmirësimin e edukimit fizik të popullit.

Neni 38. Shkollat janë shtetërore. Arsimi fillor është i detyrueshëm dhe falas.

Peroviç dhe Iliç, 1986, fq. 315-339.

Krahasoni nenet 1, 2, 9 dhe 12, të Kushtetutës së Republikës Federale Populloree të Jugosllavisë (burimi I-21) me nenet 2, 10 dhe 13, të Kushtetutës së Malit të Zi (burim I-22). Si u formua Federata jugosllave, sipas të dyja këtyre kushtetutave?

I-23. Lufta e simboleve politike: Stalin kundër Mbretit Mihail; dy fragmente të shkurtra shënimesh nga dhe drejtuar Ministrit të Arsimit

A. Festimi i ditëlindjes së Stalinit, viti 1947

MINISTRIA E ARSIMIT. NËNSEKRETARI I SHTETIT PËR ARSIMIMIN E TË RINJVE. QARKORE NR. 2533/12, DHJETOR TË VITIT 1947

Më 21 dhjetor është ditëlindja e Gjeneralisimit Stalin. Me këtë rast, një mësues do t'iu flasë nxënësve të mbledhur për Gjeneralisimin Stalin. Në shkolla, që do ta kenë pushim atë ditë, festimi do të zhvillohet gjatë veprimtarisë arsimore të grupeve me klasa ose të klasave.

Koleksion i Arkivit Kombëtare të Vasluit:

"Cuza Vodă" Gjimnazi i Hushit, d. 172/1947, vëll. II, fq. 6.

B. Festivale të frymëzuar nga Bashkimi Sovjetik, viti 1948

KËSHILLI NDËRSHKOLLOR I HUSHIT, [RAPORT PËR] INSPEKTORIN E PËRGJITHSHËM, JANAR 1948.

Në shkolla përdoren sekretaritë dhe sallat e mbledhjes së nxënësve. Në shkollat e mesme të arsimit të përgjithshëm për vajzat dhe djemtë, këto mbledhje zhvilloheshin çdo javë dhe tematikat e tyre ishin rreth shkencës dhe letërsisë. Shumica e temave të diskutuara kishin një karakter progresiv dhe rezultati ishte besnikëria e theksuar ndaj frymës së kohës. Nëse dy vite më parë, nxënësit mbanin me krenari një karficë me portretin e ish Mbretit Mihail, tashmë fryma është disi më ndryshe; kështu që me rastin e festivalit të SHRMBS-së, nxënësit e shkollës së mesme në qytet organizuan një veprimtari artistike, që filloi dhe përfundoi me himnin e majtë (Internacionale), ndërsa i gjithë programi kishte këngë dhe poezi nga letërsia dhe muzika sovjetike. [...] Për sa i përket veprimtarisë kulturore dhe arsimore në vend, nuk kemi asnjë mundësi se si ta kontrollojmë këtë, për shkak të mungesës së mjeteve të transportit.

Koleksioni i Arkivit Kombëtare të Vasluit: "Cuza Vodă" Gjimnazi i Hushit, d. 173/1948, fq 14.

SHRMBS (ARLUS në gjuhën rumune) do të thotë "Shoqëria Rumune për Miqësi me Bashkimin Sovjetik". Kjo, në vjeshtën e vitit 1944, ishte një organizatë kulturore e përbërë nga një grup intelektualësh të majtë. Por shumë shpejt ajo u bë një mjet autentik propagande, i kontrolluar dhe i financuar nga shteti, që ka qenë aktive për pothuajse dy dhjetëvjeçarë në të gjitha institucionet publike.

Mbreti Mihai (Mikael) I, Princ i Hohenzollern-Sigmaringen (lindur në vitin 1921), ishte Mbreti i Rumanisë nga viti 1927 deri në vitin 1930 dhe sërish nga 6 shtatori i vitit 1940 deri në 30 dhjetor të vitit 1947, kur u detyrua të jepte dorëheqjen.

Klasat e mbledhjeve/këshillimit [diri-gentie në rumanisht] ishin klasa ku mësuesi kujdestar i çdo klase (çdo klasë kishte një mësues kujdestar) diskutonte me nxënësit probleme të ndryshme jashtë-shkollore ose probleme të klasës.

Shkollat nuk janë vetëm institucione arsimore, por edhe mjedise të rëndësishme të socializimit të të rinjve. Ato duhet të transmetojnë vlera dhe ide të caktuara që janë dominuese në shoqëri.

Shfrytëzoni dokumentet dhe njohuritë tuaja dhe përshkruani se si depërtoi dhe u përhap ideologjia e re në shkollat rumune. Gjeni në burim elementet kryesore të "së resë" që u promovuan dhe elementet e "së vjetrës" që u braktisën.

I-24. Partia Komuniste e Shqipërisë shqyrton festat e reja kombëtare

Sh.[shoku] Tuk Jakova deklaron se 1 Maji është lënë jashtë këtij projekti, si rrjedhim, ai si pjesëtar i Sindikatave tha: "Propozoj shpalljen e një majit si festë kombëtare". Sh. kryetar bëri thirrje të votonin dhe [propozimi] u pranua në mënyrë unanime. […] Sh. Gjergj Kokoshi pyeti për kriteret e përdorura për caktimin e festave: A u pyetën komunitetet fetare? Sh. Manol Konomi shpjegon se u konsultuan me komunitetet fetare dhe se ato vetë i propozuan. Nga këto festa fetare, një prej tyre u hoq nga feja myslimane dhe i kaloi bektashinjve. Një ditë u hoq nga festat ortodokse dhe katolike […] Sh. Ramadan Çitaku:

"Dita e Çlirimit të Shqipërisë u hoq, […] kjo është dita kur përfundoi Lufta e Madhe e shpallur nga populli shqiptar; kjo ditë duhet të kujtohet nga shqiptarët dhe të festohet nga të gjithë brezat [si] një ditë gjithëpërfshirëse. Festa e 28 nëntorit të vitit 1912 është e saktë, por edhe kjo ditë e Luftës së Dytë, e Luftës së Madhe, duhet të kujtohet. Problemi i vetëm është

data. Mesa di unë, në mesnatë të ditës 28 nëntor të vitit 1944 nuk kishte trupa armiqsh në Shqipëri, kështu që 29 nëntori e gjeti Shqipërinë të çliruar. Si rrjedhim, sugjeroj që ta shtojmë edhe datën 29 nëntor si një festë kombëtare. Ne e kemi pranuar ditën e fundit të luftës botërore, kështu që mendoj se nëse do të shtonim edhe Ditën e Çlirimit të Shqipërisë do të përbënte një gabim. Sh. Hasan Pulo: "Nuk jam kundër këtij propozimi. Por, do të doja të dija nëse shtete të tjera, që kanë luftuar parreshtur, madje kanë luftuar më fortë se ne, e festojnë këtë ditë". Sh. Ramadan Çitaku: "Në Jugosllavi, Dita e Çlirimit të Beogradit është festë kombëtare. Edhe nëse shtete të tjera nuk e njohin një ditë të tillë, ne mund ta bëjmë, sepse kemi luftuar më shumë se gjithë të tjerët". Sh. Hasan Pulo: "Të gjitha shtetet kanë caktuar një ditë si Ditë Pavarësie". Sh. Ramadan Çitaku: "Kemi vënë re se në Bullgari, megjithëse njerëzit atje nuk luftuan, e kanë njohur ditën e Çlirimit si festë zyrtare". […] Sh. Spiro Moisiu, që ndante të njëjtin mendim me propozimin e Sh. Ramadan Çitakut, shtoi se jo vetëm që 29 nëntori është dita e çlirimit të Shqipërisë, por është edhe dita që siguroi regjimin e ri për popullin shqiptar. Sh. Kryetar prezanton mendimet e shprehura dhe thekson se Shqipëria e ka humbur pavarësinë e saj, dhe si rrjedhim 29 nëntori është çlirimi i dytë i Shqipërisë, të cilën e arritën nëpërmjet një lufte të përgjakshme. Më pas ai i fton të votojnë dhe propozimi pranohet me shumicë votash.

Mbledhja e 14-të, Seanca e 5-të e Komitetit Drejtues, Tiranë, 9 nëntor 1945.

1. Përse shtetet vendosin festa kombëtare? Cilat janë festat kombëtare të Shqipërisë, që përmenden në këtë dokument? Përse janë përzgjedhur këto ditë si festa kombëtare?

Cilat janë festat e reja? Hartoni një listë me festat e vendit tuaj dhe arsyet përse i feston ato populli juaj.

2. Në librin e njohur: "Shpikja e traditës" 1983, i redaktuar nga historianët Eric Hobsbawm dhe Terence Ranger, u krijua edhe termi "traditë e shpikur". Dy historianët argumentojnë se shumë "tradita", që në dukje janë ose pretendojnë të jenë të vjetra, shpesh janë shumë të vona në kohë, dhe shpeshherë të shpikura, në mënyrë që të krijohet identiteti kombëtar, për të nxitur bashkimin kombëtar, apo për të ligjëruar krijimin e disa institucioneve ose praktikave. A mund të gjeni argumente ku mund të përdorni këtë nocion për aprovimin dhe shpalljen e disa festave të reja kombëtare në Shqipëri, pas Luftës së Dytë Botërore? Jepni argumente nisur nga faktet e përmendura në këtë burim.

I-25. Vendimi i Asamblesë Kushtetuese për t'u themeluar si Asambleja e Parë Popullore në Shqipëri, 16 mars 1946

I. Asambleja Kushtetuese, që është rezultatit i zgjedhjeve të 2 dhjetorit të vitit 1945, themelohet si Asambleja Popullore e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe do të qëndrojë e tillë deri në fund të mandatit katër-vjeçar, duke filluar që më 16 mars 1946.

II. Presidiumi i Asamblesë Kushtetuese, i zgjedhur në mbledhjen e 12 janarit të vitit 1946, bëhet Presidiumi i Asamblesë Popullore, që do të ketë për një afat katër-vjeçar të njëjtin numër pjesëmarrësish, siç parashikohet në Nenin 1 të Ligjit Nr.195/ 12.01.1946.

III. Asambleja Popullore do të funksionojë sipas së njëjtës rregullore të Asamblesë Kushtetuese.

AQSH, F. 489, v. 1946, d. 10, fl. 1.

I-26. Fjalimi propagandistik në referendumin për shfuqizimin e monarkisë në Bullgari, 1946

Qeveria e Frontit të Atdheut, gjatë dy viteve në pushtet, i ka dhënë popullit bullgar të drejta dhe liri të plota. Ajo kreu një spastrim në ushtri, dhe po bënte të njëjtën gjë me institucionet shtetërore, miratoi dhe ende po miraton ligje kundër spekulatorëve; në mbrojtje të demokracisë dhe të pushtetit të klasës punëtore; ligje për reformat agrare, konfiskimi i pasurive të paligjshme, për pensionet kooperative, për taksim shtesë nga përfitimet e kohës së luftës, në kooperativat me rendiment të lartë pune, si edhe shumë gjëra të tjera. Ajo arriti të mbyllte marrëveshje tregtare me BRSS-në, Çekosllovakinë dhe Poloninë. E shpëtoi popullsinë nga uria, si edhe gjënë e gjallë në këtë vit me prodhim të pakët. E shpëtoi monedhën e levës nga [zhvlerësimi]. Krijoi një buxhet real; krijoi klimë entuziaste midis fuqisë punëtore, që nuk ishte parë kurrë më parë, që në fakt po kthehej në heroizëm punëtor. Diferencimi i të dalluarve dhe konkurrenca u zhvilluan në shkallë të gjerë. [...] Në të gjithë fshatrat dhe qytetet, në të gjitha puset e minierave, punishtet, fabrikat dhe hekurudhat, po organizohen mijëra ditë vullnetare pune. Mijëra pjesëtarë të Frontit të Atdheut nga qytetet, duke sakrifikuar pushimin e ditëve të diela, shkonin me brigadat e punës vullnetare dhe forconin lidhjet midis punëtorëve dhe fshatarëve. E gjithë kjo ishte falë Frontit të Atdheut. [...] Populli, i çliruar nga fashizmi me sakrifica të mëdha, dëshiron që ta shkatërrojë fortesën e fashizmit, dhe folenë e tij në vendin tonë, monarkinë, dhe të themelojë një republikë demokratike popullore,

që do të krijojë kushtet e nevojshme materiale, garancitë politike dhe morale kundër kthimit në të kaluarën e errët dhe të turpshme.

Një republikë popullore që do të siguronte zhvillimin demokratik të vendit tonë. Një republikë popullore ku nuk do të ketë më vend për parazitë, sabotatorë, plaçkitës dhe shtypës të popullit. [...] Populli ynë punëtor dëshiron një republikë popullore, që do të zbatojë këtë parim: Cilido që është i aftë të punojë, por nuk ka dëshirë ta bëjë, pra nuk do të angazhohet shoqërisht me punë të dobishme, nuk duhet as të hajë bukë; nuk duhet të përfitojë nga pasuria materiale, kulturore apo shpirtërore e popullit.

ТДА [Arkivi Shtetëror Territorial] – Targovishte, f. 3Б, inv.1, a.u. 114.

1. Në fjalim, çfarë përcaktohet si arritje e Frontit të Atdheut? Cilat janë premtimet për të ardhmen? Çfarë titulli do t'i vendosnit këtij fjalimi?

2. Gjeni dhe komentoni kuptimin e fjalëve të përdorura, për të justifikuar referencën si "fjalim propagandist". Cilat janë shprehjet banale të përdorura nga ndjekësit e këtij regjimi?

I-27. Plebishiti për çështjen e regjimit në Bullgari, viti 1946

A. Karikatura propagandiste e plebishitit: "Fshesa e popullit - 8 shtator" 1946

ТДА [Arkivi Shtetëror Territorial] – Targovishte, f. 3Б, inventari 1, njësia arkivore 114.

B. Modeli sovjetik

Viktor Deni, Comrade Lenin Cleanses the Earth of Filth (1920). (Shoku Lenin pastron tokën e pisllëkut)

Më 8 shtator të vitit 1946, u mbajt plebishiti për çështjen e regjimit në Bullgari. Shumica dërmuese, 95.6 për qind, votoi për republikën.

Madje edhe kryetari i opozitës kundër-komunizmit, Nikola Petkov, deklaroi: "Plebishiti ishte tërësisht i lirë dhe të gjithë njerëzit u shprehën njëzëri pro shfuqizimit të monarkisë, që i solli Bullgarisë vetëm fatkeqësi dhe shkatërrim". Fjalët e Petkovit janë dëshmi e ndjesive të forta kundër-monarkisë në Bullgari në atë kohë, por Partia Komuniste e shfrytëzoi rastin për të zhvilluar një fushatë sistematike propagandiste, për të fuqizuar pushtetin e saj.

Krahasojini këto dy karikatura. Kini parasysh se karikaturat nuk transmetojnë fakte, por mesazhe dhe ide të caktuara. Cili është mesazhi i të dyjave? Si e pasqyrojnë ideologjinë komuniste? Cilat janë ngjashmëritë dhe ndryshimet midis tyre? A mendoni se karikatura sovjetike shërbeu si një model për atë bullgare? Jepni argumente bazuar në faktet për të dy burimet.

I-28. Zgjedhjet parlamentare dhe plebishiti për çështjen e regjimit në Greqi, viti 1946

A. Deklarata e një dege të EAM-it që bënte thirrje për bojkotin e zgjedhjeve parlamentare, të 31 marsit të vitit 1946

Zgjedhjet e përgjithshme, të 31 marsit të vitit 1946, ishin zgjedhjet e para që do të zhvilloheshin pas vendosjes së diktaturës të Metaksasit, më 4 gusht të vitit 1936 dhe Luftës së Dytë Botërore. Ato u zhvilluan në një klimë të tensionuar politike, midis ankesash të vazhdueshme nga e Majta dhe nga Qendra, për sa i përket terrorit që grupet e armatosura paraushtarake dhe shërbimet e sigurisë ushtronin në pjesën më të madhe të vendit. Si rrjedhim, KKE dhe formacione më të vogla politike majtistësh dhe të qendrës, vendosën të abstenonin. Parë nga këndvështrimi aktual, vendimi KKE-së konsiderohet më tepër si një gabim i rëndësishëm strategjik, sesa një gabim taktik. Kjo çoi në një fitore dërmuese për Kampin e djathtë të Bashkuar të Nacionalistëve (55.1 për qind të votuesve, 58.1 për qind të vendeve në Asamble), që si rrjedhim fitoi ligjshmërinë politike, si brenda, ashtu edhe jashtë Greqisë. Ajo ligjëroi edhe persekutimin nga ana e forcave të sigurisë së komunistëve të vërtetë dhe atyre që konsideroheshin si të tillë, si dhe të forcave të tjera të majta nga shërbimet e sigurisë.

ASNJË VOTUES I SINQERTË DHE GREK I VËRTETË, NUK DO TË VOTOJË PERSONAT E PREFEKTURËS SONË

Bevin urdhëroi Sofoulisin të zhvillonte zgjedhjet në Greqi më 31 mars [1946].

Asnjë parti e majtë nuk do të marrë pjesë në këto zgjedhje.

Partia e Progresiste e Kafantarisit, Partia e Mylonasit, si edhe parti të tjera demokratike, kanë deklaruar se nuk do të marrin pjesë në këtë parodi elektorale.

Kryeministri Soufoulis, të gjithë ministrat, të gjitha gazetat angleze dhe gazeta të tjera ndërkombëtare, pranonin se në Greqi monarko-fashistët ushtronin kontrollin e terrorit deri aty saqë vetë Kryeministri Sofoulis deklaroi se: "vetëm kandidatët mbretërorë mund të shkojnë në fshat". [...]

Qëndroni larg qendrave të votimit. Votimi përbën krim kombëtar. Do të ishte tradhti ndaj luftës sonë dhe bukës së fëmijëve tanë, nëse do të votonim për shfrytëzuesit tanë të përhershëm, që kujtohen për ne vetëm gjatë fushatës së zgjedhjeve, me qëllim marrjen e votave. Asnjë demokrat nuk do të marrë pjesë në këtë krim të ri, që monarko-fashistët po përgatisin në vendin tonë, nëpërmjet kësaj parodie elektorale.

Thirrja e degës në Veria (në Maqedoninë Qendrore të Greqisë) të Koalicionit Politik të Partive të EAM-it (Mars 1946), ASKI.

B. Plebishiti i 1 shtatorit të vitit 1946. Një afishe fushate pro monarkisë

I mbajtur pesë muaj pas zgjedhjeve parlamentare të 31 marsit, me pjesëmarrjen edhe të partive që i bojkotuan ato, përfshirë edhe KKE, plebishiti shënoi një shumicë prej 68.4 për qind që përkrahu kthimin e Mbretit Jorgos II. Sipas Misionit të Aleatëve, për të vëzhguar zgjedhjet greke, që përfshinte përfaqësues britanikë, francezë dhe amerikanë, por jo sovjetikë: "nuk ka asnjë dyshim që partia [e djathtë] që pasqyronte pikëpamjen e qeverisë ushtroi ndikim të paligjshëm në mbështetje të kthimit të Mbretit, por ne jemi të kënaqur që shumica e votave për kthimin e Mbretit mund të merrej edhe pa atë ndikim".

Mbreti Jorgos II ishte mbret i grekëve nga viti 1922 deri në vitin 1924 dhe nga viti 1935 deri në vitin 1947. Në vitin 1936, ai përkrahu diktaturën e Ioanis Metaksas (1936-1941), gjë që e bëri jopopullor si për të majtën, ashtu edhe për qendrën. Ai vdiq gjashtë muaj pas kthimit të tij në Greqi.

Arkivi Letrar dhe Historik Grek, Athinë.

Evzone (Ushtar presidencial) mban një pankartë, ku shkruhet: "Fletë votimi. Mbreti Jorgos II". Në pjesën e poshtme, duken dy burra të frikësuar "të pagdhendur", njëri ka veshur një këmishë të kuqe me inicialet KK (Partia Komuniste), ndërsa tjetri mban një thikë të gjakosur, të cilët po ia mbathin.

Në diçiturë shkruhej: "Kjo është pikërisht ajo që ata i druhen. Ky është ai për të cilin duhet të votojmë: Mbreti".

Evzone – emri i këmbësorisë së lehtë elitare historike dhe i disa njësive luftarake në male të Ushtrisë Greke. Në ditët e sotme këtë emërtim e kanë anëtarët e Gardës Presidenciale.

Krahasoni I-27A dhe I-28B në lidhje me sistemin e monarkisë në Bullgari dhe në Greqi. Ndiqni hapat e mëposhtëm për "leximin" e këtyre pamjeve vizuale: përshkruani imazhin, deshifroni simbolet, referojuni kontekstit dhe diskutoni kuptimin dhe fuqinë e secilës.

Krahasoni situatën në dy vendet fqinj. Përpiquni të gjeni materiale të ngjashme.

I-29. Ligji për shpronësimin e pronave të mëdha urbane në Bullgari, 15 prill 1948

Neni 1. Pronat e mëdha urbane (pronat e paluajtshme) u referohen pronave fizike brenda kufijve të planeve zhvillimore urbane, në pronësi të individëve apo të shtetit, që nuk janë planifikuar për të përmbushur nevojat për strehimin e pronarëve të tyre, për të siguruar të ardhurave shtesë të nevojshme, ose për të mbuluar nevojat e drejtpërdrejta ekonomike, por për të fituar para nga qiratë prej kapitalit të investuar në këto prona.

Neni 2. Çdo pronë e paluajtshme e ndërtuar (qoftë e banuar ose bosh), e vendosur brenda kufijve të zhvillimit të ndërtesave të strehimeve urbane, ku më shumë se një ose dy janë në pronësi të pjesëtarëve të çdo familje të vetme, duhet të shpronësohet dhe të kalojë në pronësi të shtetit, që nënkupton pasuri e popullit, siç specifikohet në nenet më poshtë. Pronat e paluajtshme të punëtorëve, të blera ose të ndërtuara për të përmbushur nevojat për strehim të familjeve, apo për të siguruar të ardhura shtesë, për mbajtjen e familjeve, nuk do të shpronësohen.

Fletorja Zyrtare, nr. 87, 15 prill 1948.

I-30. Kalimi nga sistemi politik njëpartiak në një sistem politik shumëpartiak

Pas fundit të Luftës së Dytë Botërore, Partia Popullore Republikane (Cumhuriyet Halk Partisi, CHP), që më parë kishte gëzuar monopolin e pushtetit, tashmë kishte filluar të hidhte hapat e para të kalimit gradual drejt një sistemi politik shumëpartiak, në mënyrë që të dukej se përkrahte parimet demokratike Perëndimore të vendit. Në këtë kontekst, ajo lejoi krijimin e partive opozitare, për t'u krijuar një sistem përfaqësues parlamentar. Zgjedhjet e vitit 1950, në të cilat humbi CHP-ja, përbëjnë një pikë kthimi në historinë politike të Turqisë.

A. Fjalimi i Ismet Inonu, 1947

Kontrolli i ushtruar nga Asambleja e Madhe, për taksat dhe shpenzimet e të ardhurave nga populli për çdo vit fiskal, është mjaft i saktë dhe i mprehtë dhe nuk ngelet pas kontrollit të kombeve më të përparuar demokratikë. I vetmi hendek i yni është mungesa e një partie kundër partisë qeverisëse.

Natyrisht, kishte edhe një vit e gjysmë kohë deri në zhvillimin e zgjedhjeve të reja. [...] Shumica e votave të popullit do të përcaktojnë pushtetin që do të mbizotërojë në zgjedhjet e vitit 1947, shpresojmë të përcaktohet pas vetëm një raundi. Deri atëherë, nuk mund të dimë nëse një parti opozitare mund të themelohet apo jo, dhe nëse krijohet, a do të prezantohet fillimisht brenda apo jashtë Asamblesë së Madhe. Ajo që ne dimë është se do të ishte më e dobishme për interesat dhe pjekurinë politike të kombit, nëse ata që nuk janë dakord për arsye parimore dhe zbatuese, do të marrin qartësisht pozicion sipas besimeve dhe programeve brenda një organi politik, sesa të veprojnë në fraksione politike

Inonu, 1946, vëll. 1, f. 388-389.

İsIsmet Inonu (1884-1973) ishte kryeministri i parë, pas themelimit të Republikës së Turqisë (1923) dhe presidenti i dytë, pas vdekjes së Mustafa Qemal Ataturkut, që gëzoi titullin "udhëheqësi i kombit". Si udhëheqës i PPR-së, ai i humbi zgjedhjet e para të lira në vitin 1950, por pas grushtit ushtarak të shtetit, të vitit 1960, ai u kthye si kryeministër në vitin 1961, dhe qëndroi në këtë detyrë deri në vitin 1965. Në vitin 1972, ai nuk u zgjodh më si udhëheqës i partisë ku pati si rival Bulent Ecevit.

B. Afishe e Partisë Demokratike për zgjedhjet në Turqi, 1950

Partia Demokratike (Demokrat Parti, DP) i fitoi zgjedhjet e 14 majit të vitit 1950, duke siguruar 55.2% të votave (PRP-ja mori 39.6%), dhe e përsëriti këtë sukses në zgjedhjet e vitit 1954 (57%) dhe në ato të vitit 1957 (47.87%). DP përkrahu parimet e ekonomisë së tregut dhe lirisë së besimit, kundër statizmit dhe versioneve të ashpra të shekullarizimit. Baza e saj e elektoratit përfshinte kryesisht fshatarësinë, por edhe klasat e mesme. Retorika fetare e partisë dhe dinamizmi i saj përshtatej mirë me zonën elektorale dhe çoi në shfaqjen dhe përfundimisht në konsolidimin e saj.
të Islamit konservator si një pol përballë themelimit qemalist dhe ushtarak. Në kontekstin e Luftës së Ftohtë, Islami dhe liberalizimi ekonomik, ishin një pengesë e rëndësishme e komunizmit në Lindjen e Mesme. Vitet '50 shihen nga intelektualët qemalistë si periudha e "kundër-revolucionit".

→

Mjaft! Populli do të vendosë!
PARTIA DEMORATIKE.
Krijuesi Selçuk Milar. Koleksion personal i Kerim Han Milarit.

I.2.2. Opozita

I-31. Udhëzimet dhe direktivat kryesore për organizimin e Qëndresës Kroate në Atdhe

Misioni i Rezistencës kroate në mërgim i konsideron Forcat e Armatosura Kroate në atdhe [luftëtarët guerrilas] si faktorin më të rëndësishëm dhe më të efektshëm në luftën për mbrojtjen e popullit dhe shtetit kroat, kundër komunizmit dhe Jugosllavisë. Forcat e Armatosura Kroate duhet të jenë pararojë, që do të thotë se janë të vetmit prijës dhe organizues të qëndresës së armatosur në atdhe, si edhe mbështetësit dhe rregullatorët kryesorë të veprimtarive kroate jashtë vendit. Vetëm pasi të organizohen dhe të bëhen të efektshme, do të mund të tërheqin vëmendjen e opinionit ndërkombëtar për kauzën kroate dhe do të japin një ndihmë të efektshme. Për këtë arsye, vëmendje dhe kujdes maksimal duhet t'iu kushtohet organizimit të Forcave të Armatosura Kroate.

1. DETYRA KRYESORE E FORCAVE TË ARMATOSURA KROATE Detyra kryesore e Forcave të Armatosura Kroate është përgatitja politike dhe ushtarake, si dhe organizimi i kryengritjes së përgjithshme kombëtare. Detyra e tërthortë është çorganizimi, goditja dhe shkatërrimi i sistemit të tanishëm administrativo-ushtarak të pushtuesit, shkaktimi i trazirave, panikut dhe frikës midis tyre, dhe përkrahja, forcimi dhe mbajtja gjallë e besimit dhe moralit të popullit kroat.

2. METODAT DHE MËNYRA E PUNËS Mënyra e punës duhet të jetë tërësisht e fshehtë, çdo gjë të kryhet pa u marrë vesh nga pushtuesit. Të tilla do të jenë lidhjet me personat përkatës, organizatat dhe veprimtaritë. Kjo është arsyeja përse FSHEHTËSIA është kushti kryesor dhe më i rëndësishëm në punën e tyre dhe nxjerrja e sekretit përbën tradhti. Rregulli ynë do të jetë: Mos flisni apo pyesni për gjëra për të cilat as nuk duhet të flisni apo të pyesni! Sipas kësaj, gjithkush duhet të bëjë shumë kujdes me informatorët armiq, dhe të parandalojë me vigjilencë infiltrimin e armikut në radhët e tyre.

Radeliç, 2011, fq. 59.

Në fund të Luftës së Dytë Botërore, anëtarët e formacioneve ushtarake të mundura u arratisën nga Jugosllavia. Megjithatë, disa prej tyre (kryesisht formacionet Ustash dhe Çetnik) qëndruan në vend dhe vazhduan të luftonin kundër autoriteteve të reja, ndërsa njësi të tjera herë pas here gjatë viteve të fundit, depërtonin në vend, me qëllim nxitjen e një kryengritjeje kundër autoriteteve komuniste.
Edhe formacionet e ustashëve u bënë të njohur si Krizhari (Kryqtarët). Me një serë veprimesh ushtarake dhe policore të mirëorganizuara, autoritet shtetërore jugosllave parandaluan organizimin e lëvizjes së kryqtarëve.

→

Megjithëse kryqtarët ishin më tepër aktivë në vitet 1945-1946, veprimet e fundit guerilase të tyre u kryen më vonë, rreth vitit 1952.

I-32. Raport i Zëvendës Ministrit të Punëve të Brendshme, Gjenerali Yonko Panov, për Kishën Ortodokse Bullgare, 25 qershor 1949

1. Pavarësisht disa ndryshimeve në përbërjen e saj dhe në regjistrimin e ish Ekzarkut Stefan, nga 9 shtatori i vitit 1944 deri më sot, Autoriteti Suprem i Kishës Ortodokse Bullgare, Sinodi i Shenjtë, është treguar reaksionar dhe kundërshtues ndaj të gjithë masave të qeverisë së Frontit të Atdheut. [...] Kjo është faktuar edhe nga provat e dorëzuara te shërbimi i sigurimit që tregojnë se metropolitët dhe priftërinjtë janë propagandistë aktivë të shumë përgojimeve keqdashëse, ata bëjnë agjitacion për luftë, nxitin frikën dhe pasigurinë midis popullsisë, përflasin qeverinë, si dhe bëjnë fushata kundër ndërmarrjeve bujqësore kooperativiste, kundër brigadave të punëtorëve vullnetarë, si edhe kundër politikave arsimore, planit ekonomik, etj., dhe përkrahin format ekstreme të qëndresës, banditizmit dhe spiunazhit.
2. Sinodi është kthyer në një vend grumbullimi dhe strehimi për elementet fashistë. Sinodi dhe mitropolitët kishin vendosur nën autoritetin e tyre shumë oficerë të shkarkuar, avokatë të pushuar dhe armiq të tjerë keqbërës të qeverisë. [...] Bazuar në faktet e sipërpërmendura, ne propozojmë marrjen e masave të mëposhtme kundër Kishës, në mënyrë që të neutralizohet qëndrimi i saj armiqësor kundrejt qeverisë: a) së pari, duhet të bëhen disa ndryshime në Sinodin e Shenjtë. Një spastrim i vogël në rangjet më të larta, do të frikësonte pjesën tjetër të mitropolitëve, të cilët mund t'i përkushtoheshin qeverisë së Frontit të Atdheut, dhe do të nxiste klerikët përparimtarë.

[...] b) Të largohen katër ose pesë persona, që e kanë treguar veten si klerikë reaksionarë, nga çdo fshat, duke zbatuar Ligjin për Fetë. [...] c) Të punohet që klerikët e besuar të Frontit të Atdheut dhe njerëzit e zakonshëm të vendosen në postet drejtuese në Kisha.

http://www.pravoslavieto.com/history/20/1949_doklad.htm, vizituar më 16.09.2016.

Gjatë regjimit komunist në Bullgari, kishte një prirje të vazhdueshme për t'i zëvendësuar klerikët e kishës dhe në veçanti ata që ishin sinqerisht të devotshëm, me klerikë të paaftë e të papërgatitur, por të lidhur drejtpërsëdrejti me shërbimet e sigurimit dhe me të besuarit e Partisë.
Kjo prirje ishte pasojë e drejtpërdrejtë e politikave të përgjithshme kulturore të PKB-së, për të nxitur shekullarizimin dhe ateizmin, në një linjë me luftën marksiste-leniniste kundër anakronizmave dhe mashtrimeve fetare. Çdokush që ishte fetar, ose vepronte në përkrahje dhe mbështetje të fesë, konsiderohej si i dyshuar, reaksionar, i prapambetur dhe cenues i pastërtisë ideologjike të regjimit. Kjo është arsyeja përse shumë klerikë të devotshëm u persekutuan, u dërguan në kampet e punës, u mbajtën nën vëzhgim nga shërbimet e sigurimit dhe u kufizuan në veprimtaritë e tyre predikuese dhe të riteve fetare.

I-33. Letër nga peshkopët katolikë, Zagreb, 20 shtator 1945

Ne, peshkopët katolikë, që jemi mbledhur në konferencat plenare, në Zagreb, besojmë se është detyra jonë si kujdestarë shpirtërorë që t'ju përcjellim juve, besimtarëve tanë të dashur, disa fjalë. [...] Gjatë luftës, një pjesë e madhe e priftërinjve u vranë, jo gjatë operacioneve luftarake, por ngaqë shumica e tyre u dënuan me vdekje nga autoritetet aktuale ushtarake dhe civile. Kur mbaroi lufta, dënimet me vdekje të priftërinjve nuk u ndalën. Sipas informacioneve që kemi, numri i tyre është si më poshtë: 243 kanë vdekur, 169 po vuajnë dënimet në burgje dhe kampe përqendrimi dhe 89 janë të humbur. Gjatë këtyre viteve, u vranë 19 klerikë, 3 murgj dhe 4 murgesha. [...] Reforma agrare dhe zbatimi i saj, që u ligjërua në Asamblenë e Përkohshme Popullore, përbën një padrejtësi të madhe ndaj Kishës Katolike. Toka në pronësi të Kishës është përfituar me mjete ligjore dhe të drejta. Kisha nuk e ka përdorur atë për qëllime përfitimesh të paligjshme apo për të përfituar prona të reja. Kisha, tokën e ka përdorur për të mbështetur shërbyesit e saj. [...] Kjo është arsyeja përse ne kërkojmë dhe nuk do të ndalemi së kërkuari, pavarësisht rrethanave: liri të plotë të shtypit katolik; liri të plotë për shkollat katolike; liri të plotë për arsimimin fetar në të gjitha vitet e para të shkollave të mesme; liri të plotë për shoqatat katolike; liri të plotë për punën bamirëse; liri të plotë për njerëzit dhe të drejtat e tyre të pacenueshme; respekt të plotë për institucionin e krishterë të martesës; rimarrjen e të gjitha institucioneve që kishës i janë konfiskuar.
Vetëm në këto kushte, situata aktuale në vendin tonë mund t'i kthehet normalitetit dhe do të mund të arrihet paqja e përhershme.

Raniloviç, 1997, fq. 17-31.

Për shkak të qëndrimeve të priftërinjve katolikë që kishin bashkëpunuar me autoritetet Ustasha të Shtetit të Pavarur të Kroacisë, (megjithëse shumë priftërinj kishin marrë pjesë edhe në lëvizjen e partizanëve), komunistët pasi morën pushtetin në dorë, filluan një përndjekje ideologjike dhe ekonomike ndaj Kishës Katolike. Pasuria dhe pronat e kishës ishin konfiskuar, dhe një numër i madh klerikësh patën një fund tragjik. Duke pasur parasysh situatat e përshkruara më sipër, Konferenca e Peshkopëve Katolikë të Jugosllavisë iu dërgoi besimtarëve, në shtator të vitit 1945, të ashtuquajturën Letra Pastorale, duke i paralajmëruar për situatat e reja me të cilat po përballej Kisha Katolike. Duhet pohuar se autoritetet komuniste i trajtuan edhe komunitetet e tjera fetare në të njëjtën mënyrë, sidomos ato pjesëtarët e të cilave bashkëpunuan me forcat pushtuese ose me regjimet kolaboracioniste, gjatë luftës.

I-34. Ndryshimet në legjislacionin për mbështetjen financiare të shtetit për Kishën në Rumani

A. Ekstrakt nga Ligji nr. 77/1948 për regjimin e përgjithshëm të kulteve fetare, Neni 33.

Kundërvënia me ligjet, për sa i përket rendit demokratik të Republikës Popullore të Rumanisë, mund të sjellin tërheqjen tërësore ose të pjesshme të subvencioneve shtetërore. Zyrtarët fetarë me qëndrime antidemokratike mund të mos përfitojnë përkohësisht ose përgjithmonë kompensim nga shteti [...]. Neni 35. Institucioni i patronazhit kishtar, që merrej me pasuritë që vinin nga individë apo institucione, vazhdon të jetë i shfuqizuar. Neni 36. Pasuria e kulteve të zhdukur ose që nuk njihen më de jure është në pronësi të shtetit [...].

Neni 59. Kishat dhe faltoret ushtarake, së bashkë me rezervat e tyre kthehen në pronësi të komunave të të njëjtit kult të cilit i përkasin. Katedralja peshkopale e klerikëve ushtarakë nga Alba Iulia, së bashku me trashëgiminë, kthehen në pronësi të Peshkopatës Ortodokse Rumune të Cluj, Vad dhe Feleac.

Fletorja Zyrtare, Pjesa I, nr. 178 (4 gusht 1948), fq. 6392-6396.

B. Vendim nr. 34345/1948 i Ministrit të Kulteve

Duke marrë parasysh kushtin e Nenit 33 të Ligjit nr. 77, për regjimin e përgjithshëm të kulteve fetare, ne vendosim përkatësisht: [...] Duke nisur nga 7 shtatori i vitit 1948, dhe për arsye të qëndrimeve të tyre jodemokratike, shpërblimi nga shteti do t'iu hiqet kategorikisht priftërinjve të mëposhtëm: Simoni Maksimilian, nga komuna katolike romake e Freidorf, qarku i Timish-Torontal [në ditët e sotme të Timishit]; Farkash Ioan, nga komuna katolike romake e Otelec, qarku i Timishit-Torontal [në ditët e sotme qarku i Timishit].
Ministër, Stanciu Stoian.

Fletorja Zyrtare, Pjesa I, nr. 211 (11 shtator 1948), fq. 7520.

Neni 36 u zbatua kryesisht për qëndrimin ndaj Kishës Katolike Lindore (nëpërmjet vendimit nr. 358/2 dhjetor 1948), që në atë kohë është llogaritur se ka pasur afro 1.5 milionë besimtarë dhe përfaqësonte objektivin kryesor të goditjes komuniste.

1. Cilat janë akuzat kundër zyrtarëve fetarë dhe klerikëve në rastet e Kroacisë (Jugosllavisë), Rumanisë dhe Bullgarisë?

Gjeni shprehjet përkatëse.

2. Përse mendoni se regjimet komuniste i kundërshtuan ndjesitë fetare të popullit? A ishin këto akuza një rezultat i përplasjeve midis ideologjisë komuniste dhe fesë, apo kishte edhe arsye të tjera që rridhnin nga ngjarje të veçanta gjatë luftës?

3. Cilat janë ngjashmëritë dhe ndryshimet ndaj fesë dhe klerit nga qeveritë e vendeve të lartpërmendura? Paraqisni idetë tuaja bazuar në materialin burimor dhe në njohuritë që kini për këtë problem.

I-35. Ministria e Punëve të Brendshme të Shqipërisë i raporton Këshillit të Ministrave për "veprimtarinë armiqësore" të Riza Danit, një anëtar udhëheqës i opozitës së parë kundër komunizmit, 26 shtator 1946

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË,
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME,
DREJTORIA E SIGURIMIT TË SHTETIT,
Tiranë, 26 shtator 1946

Nr. 05-3416. Prot. Res.

PËR ZYRËN E KRYEMINISTRIT

Më 9 shtator të vitit 1946, në orën 2 të mëngjesit, një grup elementesh opozitarë dhe disa fshatarë të mashtruar, sulmuan papritmas qytetin e Shkodrës me qëllim rrëzimin e autoritetit shtetëror, marrjen e kontrollit të qytetit dhe plaçkitjen e tij.

Kjo nismë dështoi. Forcat tona eliminuan brenda një kohe shumë të shkurtër të gjitha planet e opozitës.

Në këto rrethana, autoritet e Sigurimit të Shtetit nisën hetimet, nga të cilat rezultoi se autorët e veprave penale vijnë nga shtresat e mesme dhe të larta shoqërore, i kanë sulmuar tashmë reformat [ne i kishim zbatuar], dhe janë të lidhur me kriminelët e luftës dhe me armiqtë e popullit, si Jup Kazazi dhe me elementë që janë plotësisht të përkushtuar kundër Pushtetit Popullor.

Në mbështetje të [hetimit] të disa prej pjesëmarrësve kryesorë të arrestuar, rezulton se njëri prej përgjegjësve është Riza Dani, përfaqësues i qytetit të Shkodrës në Asamblenë Popullore. Ky person kishte marrë pjesë në takim si përfaqësues i myslimanëve, pasi se edhe disa të ashtuquajtur përfaqësues të zonave të tjera të Shkodrës kishim marrë pjesë. Në këtë takim, që u hap me vetë Riza Danin, u vendos rrëzimi me forcë i Pushtetit Popullor, themelimi i organizatës opozitare të quajtur "Bashkimi shqiptar" me agjentët e huaj kundër interesave të vendit tonë, organizimi i veprimtarive të tjera opozitare, duke mobilizuar secilin prej tyre në rrethin përkatës dhe duke vendosur çdo gjë në dispozicion të një nisme të tillë.

Duke marrë parasysh viktimat dhe pasojat e kësaj ndërmarrjeje kriminale, sigurinë dhe dëshmitë e individëve të arrestuar të shpallur përgjegjës, fajin dhe përgjegjësinë e Riza Danit dhe nevojën për procedura të shpejta ligjore, ne i dorëzojmë Presidiumit të Asamblesë Popullore kërkesën për heqjen e imunitetit parla-

mentar të personit të lartpërmendur.
MINISTËR
(Koçi Xoxe)

AQSH, f. 489, v. 1946, d. 170, fl. 4.

Riza Dani (1884-1949) ishte një politikan dhe aktivist aktiv në politikë që prej kryengritjeve shqiptare kundër osmanëve. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, ai u përfshi në qëndresën shqiptare (Lëvizja Nacionalçlirimtare). Në vitin 1945, ai u zgjodh anëtar i Asamblesë Kushtetuese. E kritikoi kushtetutën si jodemokratike. R. Dani ishte një prej figurave kryesore të Grupit të ashtuquajtur "Përfaqësuesit". Më 14 maj të vitit 1947, pas heqjes së imunitetit parlamentar, dhjetë anëtarë të Grupit, përshirë edhe Danin, u arrestuan. Gjykata e dënoi me vdekje. Ai u ekzekutua pas dy vitesh.

I.2.3. Shtypja

I-36. Gjykimi dhe ekzekutimi i Drazha Mihailoviçit

Beograd, 10 qershor 1946
PADIA
1. Dragoljub MIHAILOVIÇ - DRAZHA, […]
Në bazë të materialeve të hetimit, mund të shihet se: Së pari, i akuzuari Dragoljub Mihailoviçi dhe shokët e tij, fillimisht në mënyrë të fshehtë dhe më pas haptazi, bashkëpunuan gjatë luftës me pushtuesit fashistë gjermanë kundër lëvizjes çlirimtare të popullit të Jugosllavisë. Shokë të Mihailoviçit janë Slobodan Jovanovici dhe të tjerë (nga pjesa 1/G e dispozitës), që ishin jashtë shtetit gjatë luftës, duke gëzuar përkrahjen e vendeve aleate. Ata të dy i ndihmuan pushtuesit për të shtypur luftën çlirimtare të popullit të Jugosllavisë, megjithëse kjo mund të duket si paradoksale. Por, ata e ndihmuan pushtuesin dhe së bashku me të akuzuarin Mihaioviçin, ishin përgjegjës për organizatën tradhtare të çetnikëve, që nën udhëheqjen e tij, bashkëpunoi haptazi me pushtuesit gjatë luftës kundër lëvizjes çlirimtare të Jugosllavisë.
Të gjitha përpjekjet e këtyre shërbëtorëve dhe veglave të pushtuesve, gjatë luftës dhe pushtimit, kishin një qëllim të përbashkët që përkonte plotësisht me qëllimin e pushtuesve fashistë gjermanë, për të shtypur luftën e çlirimit të popullit të Jugosllavisë.
[…] Kjo është arsyeja përse janë vendosur sot para gjykatës së drejtë të popullit të Jugosllavisë dhe do duhet të mbajnë përgjegjësi për veprat e tyre tradhtare dhe kriminale. VDEKJE FASHIZMIT - LIRI POPULLIT Zëvendës Prokurori ushtarak i USHTRISË SË JUGOSLLAVISË
Koloneli Milos

Miniç Zeçeviç, 2001, fq. 110-232; http://www.znaci.net/00001/60. htm, vizituar më 16.09.2016.

Gjenerali Dragoljub (Drazha) Mihailoviç (27 prill 1893 – 17 korrik 1946) ishte udhëheqësi i çetnikëve në Luftën e Dytë Botërore dhe në vitet 1942-1944 ka qenë Ministër i Ushtrisë, i Forcave Detare dhe Forcave Ajrore të qeverisë jugosllave në mërgim. Fillimisht, ai luftoi kundër pushtuesve armiq, por më pas, në bashkëpunim me ta luftoi kundër partizanëve jugosllavë. Gjykimi i tij filloi më 10 qershor 1946. Nga 47 akuza, Mihailoviç u shpall fajtor për tetë akuza, kryesisht për "krimet kundër Lëvizjes Nacionalçlirimtare." Ai u dënua me vdekje dhe më 17 korrik të vitit 1946 u ekzekutua. Procesi i rehabilitimit të tij nisi në vitin 2006, përpara Gjykatës së Lartë në Beograd, dhe seanca e parë u zhvillua në vitin 2010. Përfundimisht, në vitin 2015, u rehabilitua.

I-37. Rasti kundër Stepinac

6/1946 NË EMËR TË POPULLIT!
I akuzuari Dr. Alojzije Stepinac, lindur më 8 maj 1898 në Krasiç, i biri i të ndjerit Josip dhe Barbara ne Peniç, kroat, qytetar i RFSJ-së, Kryepeshkop i Zagrebit dhe President i Konferencave të peshkopëve, aktualisht në burg, është shpallur FAJTOR: Për krimin sipas akuzës 1: Për realizimin e bashkëpunimit politik me armikun gjatë luftës dhe pushtimin e vendit prej tij sipas Nenit 3, pika 6, të Ligjit për Veprat Penale kundër Popullit dhe Shtetit. Për krimin sipas akuzës 2: Për bashkëpunim e konvertimit të detyruar të popullit të Jugosllavisë, sipas Nenit 3, pika 3, të të njëjtit ligj. Për krimet sipas akuzës 3: Për ndihmë të formacioneve të armatosura ushtarake, të përbëra nga qytetarë jugosllavë, që i shërbyen armikut dhe bashkëpunuan me të kundër vendit, sipas Nenit 3, pika 4, të të njëjtit ligj. Për krimin sipas

akuzës 4: Për angazhim në bashkëpunim me armikun gjatë luftës dhe pushtimi i vendit prej tij, sipas Nenit 3, pika 6, të të njëjtit ligj. Dhe për krimet sipas akuzës 5: Për ndihmën e dhënë në organizimin e bandave të armatosura dhe për ndërhyrjen e tyre në territor të shtetit, me synim për kërcënim të dhunshëm të rendit ekzistues shtetëror të RFSJ-së, sipas Nenit 3, pika 7, të të njëjtit ligj si edhe të krimit të shpifjes për autoritetet e popullit. Për këto arsye, i akuzuari Dr. Alojzije Stepinac, SHPALLET FAJTOR: Në bazë të Nenit 4, paragrafët 1 dhe 2, të ligjit për Veprat Penale kundër Popullit dhe Shtetit, dënohet me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vite burg me punë të rëndë dhe i mohohen të drejtat e njeriut dhe të drejtat e tij politike për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. Koha e paraburgimit, nga 18 shtatori i vitit 1946 deri në 11 tetor të vitit 1946, duhet të zbritët nga dënimi i tij.

http://www.zupa-stepinac.org/sudjenje/105-blazeni-alojzije-stepinac/sudjenje/170-5-u-ime-naroda, vizituar më 15.03.2016.

Kryepeshkopi i Zagrebit, Alojzije Stepinac, i akuzuar për mbështetje të veprimtarisë së ustashëve, për konvertim të detyruar të serbëve ortodoksë në katolikë, si edhe për ndihmë të grupeve të "Kryqtarëve" (shihni dok. I-31) pas përfundimit të luftës, në vitin 1946 u paraqit para gjykatës dhe u dënua me 16 vite burg. Pas pesë vitesh, atij iu dha arrest shtëpie, dhe në vitin 1960 u nda nga jeta. Ndërkohë, Papa Pius XII e emëroi atë kardinal, gjë që çoi në përkeqësimin e marrëdhënieve midis komunistëve jugosllavë dhe Kishës Katolike dhe në prishjen e marrëdhënieve diplomatike me Vatikanin. Pas shpërbërjes së Jugosllavisë, Selia e Shenjtë e lumturoi Stepinacin (1998). Stepinac mbetet një figurë historike e diskutueshme, duke qenë se historiografia zyrtare kroate e konsideron atë martir të regjimit komunist dhe viktimë të rrethanave historike, ndërkohë që historiografia serbe e konsideron përgjegjës për bashkëpunim me autoritetet e ustashëve. Për pikëpamjet e ndryshme rreth Stepinacit shihni Librin e punës 4. dok. I-47 dhe I-48.

I-38. Gjykimi dhe fati i Nikola Petkovit

Në fillim të vitit 1945, Nikola Petkovi shprehu mospajtimin e tij me veprimtarinë politike të Partisë së Punëtorëve të Bullgarisë [në vitin 1948, ajo u riemërtua Partia Komuniste e Bullgarisë] dhe u tërhoq nga koalicioni qeverisës i Frontit të Atdheut. Ai u caktua udhëheqësi i Partisë së re Agrare, Bashkimi Agrar Kombëtar i Bullgarisë. Disa muaj më vonë, Nikola Petkov (BAKB-Nikola Petkov) do të vihej në krye të opozitës antikomuniste në Bullgari. Lëvizja politike agrare ka rrënjë të thella në jetën shoqërore të Bullgarisë. Veprimtaria e saj para Luftës së Dytë Botërore lidhej me emrin e themeluesit dhe ideologut të BAKB-së, Aleksander Stamboliski. Programi politik i BAKB-së bazohej në teorinë e tij, sipas së cilës shoqëria bullgare përbëhej nga disa "shtresa", kryesorja e të cilave është e ashtuquajtura "shtresa punëtore" e fshatarëve dhe punëtorëve. Megjithëse përbënte më shumë se 80 për qind të popullsisë në fillim të shekullit XX, fshatarësia në Bullgari u shtyp dhe u shfrytëzua nga një pakicë e "grupeve të shtresave urbane", të arsimuarit, kapitalistët, administrata dhe ushtria. Shumicës së fshatarëve iu caktua një rol kryesor në vizionet utopike të Stamboliskit, për një sistem të ri shoqëror dhe jetën e re politike të Bullgarisë. Qeveria e Aleksander Stamboliskit, e shtyrë nga këto ide, në fillim të viteve '20 ndërmori disa reforma ekonomike dhe shoqërore të rëndësishme, që u penguan nga grushti i shtetit i 9 qershorit të vitit 1923 dhe vrasja e tij. Kushtet politike në Bullgari pas 9 shtatorit të vitit 1944 përcaktuan qëndrimin ideologjik të opozitës BAKB-Nikola Petkov, në një drejtim të ndryshëm: në përgjithësi, gjatë ballafaqimeve të saj me komunistët, Bashkimi u bë një formacion politik që mbrojti demokracinë dhe vlerat liberale. Më 5 gusht të vitit 1947, Nikola Petkov u gjykua në një seancë publike në bazë të akuzave të rreme. Duke u bazuar në akuzën kryesore të spiunazhit më 16 gusht u dënua me vdekje. Dënimi i tij me vdekje u ekzekutua më 23 shtator. Vendi i varrit të tij ende nuk dihet. Nikola Petkovi u rehabilitua pas vdekjes më 15 janar të vitit 1990.

A. Fjala e fundit mbrojtëse e Petkovit, më 14 gusht 1947

"Duke qenë i bindur se ju do të udhëhiqeni vetëm nga e vërteta dhe nga ndërgjegjja gjyqësore, shpresoj që të nxirrni një vendim shfajësimi. […] Nuk jam angazhuar, as nuk kam menduar të angazhohem në veprimtari të paligjshme kundër qeverisë së popullit pas 9 shtatorit të vitit 1944, për themelimin e së cilës ka kontribuar Bashkimi Kombëtar Agrar i Bullgarisë dhe unë personalisht. […] Nuk jam angazhuar asnjëherë në shërbimin reaksionar, qoftë të brendshëm ose të jashtëm. […] Për dy vite, që prej 25 korrikut të vitit 1945, kundër meje u shpall një fushatë e pandershme dhe e pamëshirshme.

→

[…] Nuk është kursyer as jeta ime publike, personale dhe private. Jam varrosur në mënyrë simbolike tre herë në Sofje dhe afro dymbëdhjetë herë në provinca.
Kam parë lajmërimin për vdekjen time në hyrje të varrezave të Sofjes dhe kam qenë i pranishëm në një varrim të tillë..."

Vergnet dhe Bernard-Derosne, në Cvetkov, 1991, fq. 123-132.

B. Dy gazetarë francezë e përshkruajnë atmosferën në të cilën u shpall dënimi me vdekje

Për sa i përket vendimit, ai pritej që të bëhej publik nga momenti në moment. Pa dyshim, ai ishte marrë tashmë. Heshtje ra mbi sallën e gjyqit. Ky është gjithmonë rasti, kur një ogur i zi i paraprin një vepre të ligë. Një atmosferë e tillë ishte e përshtatshme për krimin gjyqësor që do të kryhej. Gjyqtarët përfunduan shqyrtimin e çështjes. Të gjithë në sallë u ngritën në këmbë, përfshirë edhe të akuzuarit dhe avokatët e tyre mbrojtës. Pikërisht në këtë heshtje tragjike, relatori i gjyqit lexoi vendimin me një zë solemn: "Nikola Petkov, në emër të popullit bullgar, ju dënoheni me varje!" Në stol midis të akuzuarve të tjerë, të dënuarit iu desh vetëm një çast që të përmblidhte të gjithë kurajën e tij si një luftëtar. U bë kruspull, pastaj u tendos sikur donte të hidhej, fytyra e tij u bë flak e kuqe nga inati. "Në emër të popullit bullgar?" Këto fjalë nuk mund t'i gëlltiste. Mund të pranonte dënimin e tij me vdekje, por nuk mund të pranonte kurrë këto fjalë, që dënonin edhe vendin e tij dhe e ofendonin edhe atë vetë. Dhe me zë të lartë, bërtiti: "Jo! Jo në emër të popullit bullgar! Po më dënoni me vdekje, sipas urdhrave të padronëve të huaj, atyre nga Kremlimi apo nga vende të tjera. Populli bullgar, i mbytur nën tiraninë e përgjakur që ju e keni maskuar si drejtësi, nuk do ta besojë kurrë..." Relatori i çështjes bëri me shenjë. Milicia e qëlloi me grusht Petkovin dhe e tërhoqi zvarrë nga salla e gjyqit.

VVergnet dhe Bernard-Derosne, në Cvetkov, 1991, fq. 123-132.

I-39. Gjykimi dhe fati i Traiko Kostov

Archive anamnesis.info.

Prishja e marrëdhënieve mes Titos dhe Stalinit, në vitin 1948, pati një ndikim të drejtpërdrejtë në marrëdhëniet e Bashkimit Sovjetik me Bullgarinë. Në tetor të vitit 1948, Ligji për Sekretet Shtetërore hyri në fuqi në Bullgari. Sipas dispozitave të tij, Traiko Kostov, një nga figurat kryesore në qeverinë bullgare të pasluftës, anëtar i Byrosë politike të Partisë së Punëtorëve të Bullgarisë (komunistët) dhe Ministri i Elektrifikimit, nxori udhëzimet që dhënia e informacioneve ekonomike specialistëve të fushës së ekonomisë të Bashkimit Sovjetik nuk duhet të jetë më e drejtpërdrejtë, por duhet të kalohen nëpërmjet tij. Stalini, duke dyshuar se Bullgaria mund të ndiqte shembullin e Jugosllavisë, shprehu pakënaqësi të madhe për këtë situatë. Në dhjetor të vitit 1948, pozicioni i Kostovit u kritikua zyrtarisht gjatë një takimi të Byrosë politike të PPB-së (C). Gjykimi kundër Kostovit, ishte pjesë e fushatës ndërkombëtare të Bashkimit Sovjetik, që u ndërmor në fillim të pranverës së vitit 1949 kundër Titos dhe "titistëve" në të gjitha vendet socialiste. Më 27 mars 1949, një plenum i Komitetit Qendror të PKB-së e akuzoi Kostovin për veprimtari kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendosi largimin e tij nga Byroja politike dhe nga qeveria. Seanca gjyqësore u hap më 7 dhjetor të vitit 1949, me prova të stisura dhe akuza të nxitura nga "tradhtia dhe spiunazhi", në bashkëpunim me shërbimet britanike dhe jugosllave të inteligjencës. Kostovi u gjykua së bashku me dhjetë bashkë-të pandehur; për gjykimin e tij u thirren →

51 dëshmitarë dhe u caktuan gjashtë komisione ekspertësh. Më 4 dhjetor 1949, gjykata e dënoi me vdekje fajtorin kryesor, Traiko Kostov, me mohim të të drejtave civile dhe politike për jetë, me një gjobë prej 1,000,000 levash dhe konfiskimin e të gjithë pasurisë së tij. Të tjerët, u dënuan sipas rëndësisë së krimit: pesë u dënuan me arrest të përjetshëm shtëpie, tre u dënuan me arrest shtëpie për 15 vite, dhe dy të tjerë u dënuan me 12 vite. Të gjithë iu nënshtruan konfiskimit të të gjithë pasurisë së tyre, dhe gjobave, që varionin nga 1,000,000 në 200,000 leva, në varësi të rëndësisë të krimit. Atë ditë, Traiko Kostov, paraqiti kërkesën e tij të fundit përpara gjykatës, në përgjigje të akuzave:
"Gjatë kërkesës sime të fundit përpara të nderuarit trup gjykues, e shoh si detyrë të ndërgjegjes sime, për t'i deklaruar gjykatës, dhe nëpërmjet saj edhe publikut bullgar, se nuk kam qenë kurrë në shërbim të Inteligjencës Britanike, se nuk kam marrë kurrë pjesë në planet kriminale të fshehta të Titos dhe klikës së tij, se gjithmonë kam pasur respekt dhe nderim për Bashkimin Sovjetik."
Dënimi i tij me vdekje u ekzekutua më 16 dhjetor 1949. Në zbatim të ndryshimit në politikat e PKB-së, pas vdekjes së Stalinit, dhe veçanërisht pas Kongresit të 20-të të PKBS-së dhe Plenumit të prillit të PKB-së, në vitin 1956, Traicho Kostov u rehabilitua. Në vitin 1963, pas vdekjes, atij iu dha titulli i nderit i Heroit të Punës Socialiste dhe medalja e artë "Çekiçi dhe Drapri".

I-40. Trajtimi i katolikëve në Shqipëri

A. Zef Pllumi gjatë mbylljes së një kuvendit katolik

Përpara se të dilnim nga Kuvendi, një prej zyrtarëve mbajti një fjalim të shkurtër, që na drejtohej veçanërisht neve, studentëve të rinj. Ai deklaroi se për ne kjo ishte një ditë lirie nga muret e errëta dhe se tani e tutje do të bëheshim pjesë e rinisë së vërtetë, duke gëzuar përfitimet e socializmit. Prandaj, ai deklaroi se nuk duhet të shikoni pas dhe të ndikoheni nga opinionet reaksionare të klerit françeskan, sepse Partia ju ndjek me vigjilencë në çdo hap të jetës tuaj. Pasi regjistruam të gjitha adresat ku do të shkonim në tre ditë e para, ata na lanë në oborrin përpara kuvendit të Kishës françeskane. Ne as na dilte zëri e as nuk e kthenim kokën nga frika: Partia na ndiqte me sy. Nga dreka, çdo gjë kishte mbaruar. Të gjithë ne, të përulur dhe pa nxjerrë as edhe një fjalë nga goja, u shpërndamë drejt vendeve për të cilat kishim shkruar adresën.Shkova në Melgushe, ku kisha xhaxhain tim. M'u deshën tre orë për të mbërritur atje me këmbë. Dukej sikur të gjithë m'i ngulnin sytë. Dhe me shumë gjasa ishte e vërtetë. Por asnjë në qytet nuk gjeti guximin të vinte afër meje dhe të më fliste.

B. Zef Pllumi gjatë fillimit të persekutimit komunist kundër katolikëve

Më 14 nëntor të vitit 1946, Kuvendi Françeskan në Gjuhadol ishte rrethuar që herët në mëngjes. Zakonisht, ne fretërit zgjoheshin shumë herët para agimit, saqë në Shkodër thoshin: "Fretërit zgjohen para shejtanëve". Menjëherë sapo At Ferdinand Pali dhe Frati Ndou ishin gati të hapnin dyert, ata hasën në roje partizane, që nuk i linin as të dilnin e as të hapnin dyert. Para orës 8 të mëngjesit, oficeri Dul Rrjolli arriti me një togë ushtarësh. I urdhëruan të gjithë të shkonin te mensa. Ata e kontrolluan vetë kuvendin. Pasi mbaruan kontrollin e parë nga dreka, na urdhëruan që të mos dilnim nga mensa pa miratimin e tyre, madje as për të shkruar në tualet. […] At Aleks Baqli u soll si [udhëheqësi ynë]. Ai i foli Dulit për shërbimin fetar në Kishë dhe për jetën në komunitet. Duli vendosi që secili prej nesh të flinte në dhomën e tij. Si përfundim, pas zgjimit sipas programit të shërbimeve fetare që njerëzit i njihnin mirë, Kisha mbyllej, ne do të qëndronim gjithë ditën në mensë me një polic te dera dhe një tjetër në korridor, ndërsa në mbrëmje do të ktheheshim në dhomat tona dhe do binim në gjumë. […] Për të blerë ushqim, At Aleksi shkonte në treg i shoqëruar nga një polic. Kryeroje mbi ne ishte një farë Smail Sheme; Falna o Zot, por ai ishte gjysma kafshë e gjysma njeri. […] Ai kur donte të shante ndonjërin prej nesh i thoshte: "Krisht! O Krisht!". Një ditë e pyeta: "A e di ti se kush është Krishti? Ai u përgjigj: "Një fashist i qelbur si ju".

Pllumi, 1995, fq. 90,106.

At Zef Pllumi (1924-2007) ishte një frat françeskan, gazetar dhe shkrimtar. Ai shërbeu në rrethin e Shkodrës, në veri të Shqipërisë. Në vitin 1946, ai u arrestua dhe qëndroi në burg deri në vitin 1949. Në vitin 1967, pikërisht në atë vit, kur pushteti komunist i Enver Hoxhës i mbylli të gjitha institucionet fetare: kishat dhe xhamitë, dhe kur Shqipëria do të shpallej "i vetmi vend ateist në botë", At Zef Pllumi u arrestua sërish dhe qëndroi në burg deri në vitin 1989. Regjimi komunist ndoqi një politikë të rreptë kundër komuniteteve fetare në Shqipëri (myslimanëve, ortodoksëve dhe katolikëve), duke i ndaluar rreptësisht

→

veprimtaritë e tyre në vitin 1967 e më pas. At Zef Pllum përjetoi një persekutim edhe më të rreptë, pasi kleri katolik konsiderohej "agjenti sekret më i rrezikshëm i Perëndimit kapitalist", duke marrë parasysh edhe marrëdhëniet e drejtpërdrejta që ai kishte me Vatikanin.

I-41. Vendim që Fakulteti i Teologjisë në Universitetin e Ljubljanës të mos jetë më një institucion qeveritar.

Qeveria e Republikës Popullore të Sllovenisë
Këshilli i Arsimit dhe Kulturës, Ljubljana, 4 mars 1952

Numri I.1147/1

Zyrës së dekanatit të Fakultetit të Teologjisë, Ljubljana

Sipas dispozitave kushtetuese për ndarjen e Kishës nga Shteti, nëpërmjet kësaj shkrese ju informojmë se Fakulteti i Teologjisë nuk duhet të jetë më një institucion qeveritar, duke filluar nga 31 qershori i këtij viti, dhe nga kjo datë duhet të ndërpriten të gjitha detyrimet buxhetore dhe të tjera të Këshillit kundrejt Fakultetit.
Të gjitha problemet e mëtejshme në këtë drejtim, duhet të zgjidhen nëpërmjet Komitetit për Fenë dhe Presidencën e Qeverisë të Republikës Popullore të Sllovenisë.

Arkiva e Republikës Popullore të Sllovenisë. Koleksioni i Presidencës së Qeverisë së Republikës Popullore të Sllovenisë. Nr. i kutisë 19, Dosja 442-52.

Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, një prej fakulteteve themeluese të Universitetit të Ljubljanës, Fakulteti i Teologjisë ishte vazhdimisht nën trysni. Gjatë kësaj periudhe, gjysma e pedagogëve të fakultetit u përjashtuan nga ushtrimi i profesionit, ndërsa botimet e tyre u përfshinë në listën e librave të ndaluar. Propozimi i parë për mbylljen e fakultetit ishte parashikuar që prej vitit 1946. Tre vite më vonë ai u shpall i "pavarur" dhe nuk u lejua të merrte pjesë në procesin vendimmarrës të universitetit. Më 4 mars të vitit 1952, Këshilli për Arsimin dhe Kulturën i dërgoi një letër fakultetit, duke e vënë në dijeni se nuk do të ishte më një "institucion qeveritar". Në këtë mënyrë, fakulteti e humbi të drejtën e dhënies së diplomave, kështu që ato konsideroheshin të pavlefshme në Jugosllavi. Megjithatë, njiheshin jashtë shtetit. Pavarësisht faktit që fakulteti funksionon si një institucion privat deri në vitin 1991, qeveria kishte të drejtë të mos pranonte punonjësit dhe profesorët e fakultetit.

I.3. LUFTA CIVILE GREKE

Lufta Civile Greke (Mars 1946 deri Gusht 1949) ishte një prej konflikteve të armatosura më të përgjakshme dhe më tragjike të Greqisë në shekullin XX. Ushtria Kombëtare Greke (UKG) fitoi epërsi ndaj Ushtrisë Demokratikë të Greqisë (DSE), që ishte nën kontrollin e Partisë Komuniste të Greqisë (KKE). Lufta filloi në pranverën e vitit 1946-s, me një sërë përplasjesh vendore të shpërndara, kryesisht midis njësiteve guerile dhe forcave të xhandarmërisë dhe njësive paraushtarake. Më dhjetor të vitit 1946, njësitet guerile u shkrinë dhe u bënë një njësi e unifikuar, që ishte Ushtria Demokratike e Greqisë. Përshkallëzimi i konflikteve dhe pjesëmarrja e UKG, duke filluar nga pranvera e vitit 1947 dhe në vijim, u shndërrua dalëngadalë në një luftë civile të gjerë, një zhvillim i cili u lehtësua nga transformimi i DSE-së, nga një ushtri guerilase në një ushtri "të rregullt" dhe nga krijimi i Qeverisë së Përkohshme Demokratike (QDP) ku morën pjesë figura të shquara të KKE-së në fund të dhjetorit të 1947-ës.
Lufta civile greke u zhvillua në krahinat e Veriut të Greqisë dhe në Peloponez, larg qendrave urbane. DSE-ja përbëhej kryesisht nga luftëtarë prej fshatrave, por teksa zgjerohej fronti i luftës dhe luftëtarët pakësoheshin, rekrutimi i detyrueshëm i grave u kthye në një praktikë normale, që përbën një fenomen të veçantë të shoqërisë greke.
Lufta civile greke shënoi përplasjen e parë të armatosur ndërkombëtare të epokës së Luftës së Ftohtë me përmasa botërore. UKG-ja siguroi ndihma të rëndësishme materiale dhe organizative, fillimisht nga Britania dhe më pas nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nga ana tjetër, DSE-ja u mbështet nga vendet socialiste fqinje (Shqipëria, Bullgaria dhe Jugosllavia), që ofruan ndihmë materiale, si edhe një strehë e sigurt për riorganizimin e saj dhe një bazë nga ku u ndërmorën sulme të reja kundër UKG-së.
Një ngjarje që ndikoi shumë në zhvillimin e luftës

ishte edhe prishja e marrëdhënieve Tito-Stalin e vitit 1948, që e detyroi Titon t'i mbyllte kufijtë me Greqinë, më 10 korrik të 1949-s, dhe ta ndërpresë mbështetjen kundrejt komunistëve grekë.
Lufta civile greke përfundoi më gusht të vitit 1949, me humbjen e DSE-së, me pasoja të rënda dhe që shkaktoi afro 50,000 të vrarë, me mijëra refugjatë politikë, që fillimisht u strehuan në vendet socialiste fqinje (Shqipëria, Bullgaria, Jugosllavia), e më pas u vendosën në Çekosllovaki, Hungari, Poloni dhe në Bashkimin Sovjetik, dhe me qindra mijëra fshatarë që u shpërngulën nga UKG-ja për në periferitë e qyteteve, një përpjekje e bashkërenduar në mënyrë që DSE-ja të mos kishte mbështetje me fuqi njerëzore dhe burime jetese e luftarake në zonat malore ku vepronte.

I-42. Rezoluta tre: "Për masat e jashtëzakonshme lidhur me rendin publik dhe sigurinë", 1946

REZOLUTA tre: "Për masat e jashtëzakonshme lidhur me rendin publik dhe sigurinë"

Neni 1 §1. Cilido, që ka marrë pjesë në komplote; ose ka nxitur një kryengritje; ose ka arritur marrëveshje me të huajt; ose ka organizuar banda të armatosura; ose ka marrë pjesë në shoqata të tilla tradhtare, për të shkëputur një pjesë të territorit [të Greqisë]; ose ka marrë pjesë në grupime të tilla, është i dënuar me vdekje.

Neni 2 §1. Cilido që ngre, ose merr pjesë në një grup që përdor dhunë kundër Autoriteteve Publike ose Fetare, Shërbimeve të Sigurisë dhe punonjësve të qeverisë vendore, ose anëtarëve të ushtrive aleate, dënohet me vdekje.

Neni 9 §1. Ndërsa [Rezoluta] aktuale është në fuqi, Policia mund të: a) kryejë kontrolle ditë e natë [pa mandat kontrolli] për zbulimin e armëve, eksplozivëve, municioneve, ose për arrestimin e të dyshuarve; dhe b) të ndalojë daljet gjatë orëve të natës.

Fletorja Zyrtare, A-197 (18.6.1946).

Rezoluta tre: "Për masat e jashtëzakonshme lidhur me rendin publik dhe sigurinë", miratuar nga Asambleja Kombëtare me shumicë të djathtësh, i kufizoi rreptësisht liritë civile dhe parashikoi dënimin me vdekje për "krimet politike". Zyrtarët britanikë në Athinë, vlerësuan se midis korrikut të 1946-ës dhe fillimit të vitin 1950, afërsisht 3,000 të burgosur politikë u ekzekutuan, në vijimësi të dënimeve nga gjyqet ushtarake të posaçme.

I-43. Gjenerali Tsakalotos për organizimin e mbrojtjes qeveritare kundër guerilasve komunistë

Veprimet luftarake të banditëve, ose qëndresa kundër armiqve të brendshëm, u përhapën në Luftën e Fundit Botërore. Duhet ta pranojmë se ky rast do të përsëritet me siguri edhe në ndonjë luftë në të ardhmen, në kombinim me [përdorimin e] parashutistëve dhe dërgimin e banditëve nga [avionët e armikut].

Këto lloj veprimesh luftarake, të zhvilluara nga grupime të vogla të armatosura kishin përparësinë se shkaktonin shkatërrim, kaos dhe përhapnin varfërinë në shkallë të gjerë.

Në vende të prekura nga luftime të tilla, gjendja morale bie dhe ka një mundësi që fronti të shpërbëhet, si pasojë e mosfunksionimit të linjave të komunikimit nga brendësia deri në front. […]

Si rrjedhim, masa e parë e mbrojtjes [që duhet të merrej] ishte asgjësimi në kohë dhe pa mëshirë i udhëheqësve, në mënyrë që njësitë luftarake të banditëve të liheshin pa udhëheqje dhe të shpartalloheshin nga mësymja e papritur e forcave të shumta. Megjithatë, për arsye se komunistët nuk demoralizoheshin kollaj, edhe pas humbjeve që pësonin, vigjilenca ishte shumë e rëndësishme. Ata duhet të ishin nën mbikëqyrje të vazhdueshme nga njësitë e posaçme të xhandarmërisë dhe nga fshatarët e pajisur mirë dhe të caktuar për këtë detyrë, në mënyrë që edhe përpjekja më e vogël për t'u riorganizuar të zbulohej që në fillim. Të gjitha masat kryesisht ushtarake të përmendura më lart, për konfrontimin me banditët nuk do të ishin të efektshme, përderisa nuk studiohen dhe shqyrtohen faktorët socio-ekonomike të çështjes, duke marrë parasysh se udhëheqja komuniste rekruton mbështetësit e saj nga shtresat e varfëra shoqërore dhe midis qytetarëve të varfër dhe të pakënaqur.

Tsakalotos, 1960, vëll. II, fq. 327, 328.

Thrasivulos Tsakalatos (1897-1989) ishte Gjeneral Lejtnant i Ushtrisë së Greqisë, që ka marrë pjesë në fushatën luftarake të Azisë së Vogël të viteve 1919-1922, në Luftën greko-italiane të viteve 1940-1941 dhe në Ngjarjet e Dhjetorit të vitit 1944 në Athinë. Gjatë Luftës Civile, ai udhëhoqi një njësi që zhvillonte luftime sfiduese kundër fortesave të DSE-së. Si oficer ushtrie, ai mbajti një marrëdhënie të veçantë me trupat e tij, dhe gjithçka i ka nxitur ata. Në vitin 1983, me synimin e pajtimit kombëtar, ai u takua me udhëheqësin e DSE-së, Marko Vafiadis

I-44. Viktimat e Luftës Civile Greke

Numri i përgjithshëm i viktimave

	Forcat qeveritare		Komunistët
	Oficerët	Civilët	
Të vdekur	651	7,789	38, 421
Të plagosur	1, 708	27, 788	----
Të humbur	186	5, 620	----
Të burgosur	----	----	23, 960
Të dorëzuar	----	----	21, 544
NUMRI I PËRGJITHSHËM	2, 545	40, 837	83, 925

Nga të dhënat zyrtare të Stafit të Përgjithshëm të Ushtrisë: Zafeiropoulos, 1946, f. 670. Shënim: Tabela pasqyron vetëm viktimat midis luftëtarëve.

I-45. Guerilasit komunistë sulmojnë qytetin e Naousës, 13 janar 1949

DSE-ja sulmoi dhe e pushtoi Naousën (Greqia Veriore) më 11-13 janar. Pas tre ditë luftimesh, guerilasit u detyruan të tërhiqeshin nga trupat e qeverisë. Gjatë luftimeve që u zhvilluan në atë zonë, të gjitha fabrikat, shumë ndërtesa publike dhe dyqane, u shkatërruan. Forcat e UDK-së prishën në mënyrë selektive shtëpitë që u përkisnin personave të pasur dhe "armiqve". Ata vranë edhe 24 qytetarë, mes të cilëve edhe kryebashkiakun.

Associated Press (AP) Fotografi.

I-46. Persona të shpërngulur brenda vendit, Epiri 1947-1948

Vlerësohet se gjatë Luftës Civile më shumë se 700,000 persona (rreth 10% e popullsisë së përgjithshme), kryesisht fëmijë, gra dhe të moshuar, u larguan ose i larguan nga vendbanimet e tyre në zonat e luftimit. Qeveria e Athinës, personat e shpërngulur brenda vendit i strehoi në baraka prej alumini ose druri, në periferi të qyteteve ose në fshatra, që të ishin nën kontrollin e tyre.

Fotografi nga Voula Papaioannou. Njerëzit e shpërngulur në banesa të përkohshme gjatë Luftës Civile. Epiri, 1947-48.
© Muzeu "Benaki", Arkivi i fotografive [B.254.2].

I-47. Fëmijët e shpërngulur

Njësoj si në rastet e luftimeve vëllavrasëse të shekullit XX në Evropë, edhe gjatë Luftës Civile greke, fëmijët përjetuan ndarjen e "vullnetshme" dhe të detyruar nga familja, si edhe dërgimin e tyre nëpër institucione herë-herë larg vendit. Megjithatë, ende nuk ka ndonjë mendim të pranuar gjerësisht lidhur me numrin e saktë të fëmijëve të shpërngulur. Vlerësohet se rreth 14,000 u "evakuuan" nga DSE-ja drejt vendeve komuniste, ndërsa rreth 18,000 të tjerë u vendosën nga qeveria greke në afro 30 kampe për fëmijët, që ishin ndërtuar nën patronazhin e Mbretëreshës Frederica. Fati i këtyre fëmijëve përbën një prej trashëgimive më të debatuara dhe traumatike të luftës civile. Për vite me radhë, secila palë akuzonte tjetrën për rrëmbimin e fëmijëve nga gjiri i familjeve, si edhe dënonin kushtet e jetesës që fëmijët duhet të duronin dhe arsimin që morën. Për qeveritë e pas Luftës Civile, rrëmbim masiv i fëmijëve nga KKE (paidomazoma) synoi çhelenizimin e tyre dhe brumosjen e tyre me idetë komuniste. Qeveria greke, më shkurt të vitit 1948, ngriti akuza kundër KKE-së përpara Komitetit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara për Ballkanin. Për pasojë, në disa rezoluta të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara u bënë thirrje për riatdhesimin e fëmijëve të larguar nga shtëpitë e tyre prej KKE-së. Nga ana tjetër, KKE-ja i shihte Kampet e fëmijëve si "Vendqëndrimet hitleriane", pra si qendra larje truri dhe krah punë të lirë. Në kontekstin e Luftës së Ftohtë, këto akuza dhe kundërakuza paraqiteshin në një sërë materialesh propagandiste (pamflete, fotografi, artikuj shtypi, etj.).

A. Mbretëresha Frederica duke mbajtur një fëmijë

Pamflet i botuar nga Komiteti i Grave Greke (Comité des Femmes Grecques), Selanik, (nuk dihet data, me shumë gjasa në fillim të viteve '50).

B. Fëmijët grekë në Republikat Popullore

Nëse na doni vërtet, na sillni paqen në Greqi. Pamflet i botuar nga Komiteti Grek për Ndihmën e Fëmijëve, (EVOP), 1950.

C. Ribashkim botëror i fëmijëve ish-refugjatë në Shkup, 1988

Nga 25,000 refugjatë politikë, që u shpërngulën dhe u strehuan në Jugosllavi, shumica ishin nga pakica sllavo-maqedonase e qarkut grek të Maqedonisë. Në vitin 1988, me rastin e 40-vjetorit të këtyre ngjarjeve, kryeqyteti i Republikës Socialiste të Maqedonisë, Shkupi, organizoi ribashkimin e parë botëror të fëmijëve ish-refugjatë nga "Maqedonia e Egjeut". Gjatë një programi tre-ditor, u prezantua një monument kushtuar nënave që janë ndarë nga fëmijët e tyre në *"Parkun e Grave Luftëtare"*.

1. Për sa i përket emrit të pakicës etnike maqedonase, KKE ka përdorur emërtime të ndryshme, si: sllavo-maqedonas, maqedonas dhe sllav.

Dita e ndarjes. Dita e ribashkimit të parë botëror të fëmijëve refugjatë nga pjesa e Maqedonisë së Egjeut. Shkup 1948-1988, 1993, fq. 19.

I-48. Lufta Civile Greke dhe vendet fqinj

A. Marrëveshja midis Komitetit Qendror të PKJ-së (Partia Komuniste Jugosllave) dhe Komiteti Qendror i KKE-së, 14 tetor 1946

Në tetor të 1946-ës, Fronti Nacionalçlirimtar (Narodno Osloboditelen Front, NOF), që ishte formuar prej Republikës Populllore të Maqedonisë (një republikë pjesë përbërëse e Federatës jugosllave), një vit më vonë, i bashkoi forcat me KKE-në dhe mori pjesë në operacionet në Maqedoninë greke, një rajon që ishte emërtuar si "Maqedonia e Egjeut". Për sa i përket KKE-së, dhe në vazhdim të qëndrimit të saj në favor të Moskës gjatë ndarjes Stalin-Tito, në janar 1949 ajo shpalli një vendim në mbështetje të së drejtës së patjetërsueshme të "Populllit maqedonas (sllavo-maqedonas) për përmbushjen e aspiratave të tij kombëtare sipas dëshirës së vet" (Plenumi i 5-të). Kjo ishte një përpjekje për të afruar në radhët e DSE-së populllsinë sllavishtfolëse të Maqedonisë greke. Megjithatë, politika e re e KKE-së u përplas me vendimin e Titos për të ndërprerë mbështetjen ndaj komunistëve grekë, si edhe me akuza për "tradhti kombëtare" që vinin si nga brenda KKE-së, ashtu edhe nga brenda Greqisë.

1. Organizata e Partisë së Maqedonisë në Maqedoninë e Egjeut i bashkohet plotësisht KKE-së.

Shoku Paskal Mitrevski, që deri më tani ka mbajtur postin e Sekretarit të Komitetit të Egjeut (PKJ), të emërohet në Zyrën e Komitetit Vendor për Maqedoninë dhe Trakën, ndërsa shoku Dzodzo Urdov të emërohet në Plenumin e Komitetit Vendor. Në vijim të këtyre veprimeve për bashkim, Komiteti Vendor për Maqedoninë dhe Trakën duhet të rivendosë kuadrot e mbetura të Egjeut.

2. Duhet të themelohet një parti qendrore udhëheqëse e Frontit Nacionalçlirimtar për Maqedoninë e Egjeut (NOF). Udhëheqja qendrore, krahas personave të tjerë, duhet të përfshijë Mihailo Keramitçievin dhe Paskal Mitrevskin. Udhëheqja qendrore e Frontit i jep llogari për punën e tij Komitetit të Partisë (KP për Maqedoninë dhe Trakën). Udhëheqja qendrore duhet të përgatisë një gazetë që do të botohet në gjuhën maqedonase dhe në atë greke. Pavle Rakovski, që deri më tani ka qenë anëtar i udhëheqjes së Egjeut dhe që ka qenë përgjegjës për agjitpropin, caktohet në detyrën e redaktorit të gazetës.

3. Mincho Fotev, që deri më tani ka qenë anëtar i udhëheqjes së Egjeut dhe përgjegjës për çështjet e të rinjve, do t'i bashkohet komitetit rajonal të (Organizata e Bashkuar Panhelenike për të Rinjtë).

Kirjazovski, 1998, fq. 223.

B. Komiteti Qendror i KKE-së merr vendim në përkrahje të vetëvendosjes së "Popullit maqedonas (sllavo-maqedonas) ", janar 1949

Në Greqinë Veriore, populli maqedonas (sllavo-maqedonas) "dha shpirtin" për luftën dhe po lufton me heroizëm dhe me sakrifica të mëdha që meritojnë adhurim. Nuk ka asnjë dyshim që, si pasojë e fitores së Ushtrisë Demokratike të Greqisë dhe e kryengritjes së popullit, populli maqedonas do të arrijë përmbushjen e plotë të aspiratave të tija kombëtare ashtu siç i dëshiron, dhe për të cilën po jep sot gjakun e tij. Janë komunistët ata që kanë udhëhequr gjithmonë luftërat e popullit të tyre. Ndërkohë, komunistët maqedonas duhet të ruhen nga veprimtaritë përçarëse që përpiqen të realizojnë elementët shovinistë dhe reaksionarë, të nxitur nga jashtë vendit, për të shkatërruar bashkësinë [që ekziston] midis maqedonasve (sllavomaqedonas) dhe popullit grek, ndarje nga e cila do të përfitonte vetëm armiku i tyre i përbashkët - monarkofashizmi dhe imperializmi anglo-amerikan. Ndërkohë, Partia Komuniste e Greqisë duhet të shmangë tërësisht të gjitha pengesat dhe të mos pajtohet, po t'i luftojë të gjithë manifestimet dhe veprat shoviniste të "Greqisë së Madhe", që shkaktojnë pakënaqësi dhe probleme midis popullit maqedonas, të mos i mbështesin ata që cenojnë bashkësinë dhe përkrahin reaksionarët në veprimtaritë e tyre tradhtare. Vetëm i bashkuar mund të fitojë populli sllavo-maqedonas dhe ai grek. Të përçarë ata do të pësojnë vetëm humbje.

KKE, Tekste zyrtare, vëll. VI: 1945-1949, Athinë 1987, fq. 337.

C. Protokolli "A" nr. 13 i takimit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bullgarisë (PKB), 16 janar 1968

Lufta Civile në Greqi krijoi çështjen e pranimit, strehimit dhe integrimit të refugjatëve politikë në vendet e bllokut sovjetik. Autoritetet bullgare ndoqën qëndrimin e zakonshëm të solidaritetit ndaj qëndresës greke të të majtëve dhe mijëra refugjatë grekë kaluan përmes Bullgarisë gjatë rrugëtimit të tyre drejt Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera të Bllokut Lindor. Qindra prej tyre qëndruan në Bullgari. Ata filluan të ktheheshin gradualisht në vendin e tyre vetëm pas vitit 1974, pas rënies së juntës ushtarake greke.

III. Për çështjen e trajtimit të emigrantëve politikë grekë 1. [Byroja politike] ngarkon Departamentin e Politikës së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Komitetit Qendror të PKB-së, Komitetit të Sigurisë Shtetërore dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, për përcaktimin e numrit dhe vendndodhjes së saktë të emigrantëve politikë grekë. Fëmijët e emigrantëve politikë grekë, të lindur në Republikën Popullore të Bullgarisë dhe në vendet e tjera socialiste, si dhe të afërmit dhe familjarët e tyre, që kanë ardhur me pasaporta të rregullta dhe kanë marrë leje nga autoritetet përkatëse për të qëndruar përgjithmonë në vend, nuk do të regjistrohen si emigrantë politikë. Për refugjatët, kjo çështje do të trajtohet rast pas rasti. Autoritetet e Ministrisë së Punëve të Brendshme do të [sigurojnë] që ata që kanë ardhur nga Greqia për të vizituar familjen dhe miqtë në Bullgari, do të kthehen në shtetin e tyre, kur të përfundojë afati i vizave të tyre. 2. Azil politik do t'u jepet emigrantëve të rinj nga Greqia vetëm pas hetimit të duhur të prejardhjes së tyre, sipas rastit duke vepruar në bazë të kërkesës me shkrim të KQ-së të Partisë Komuniste të Greqisë dhe me një vendim të Sekretariatit të KQ-së të PKB-së. 3. Emigrantët politikë me prejardhje maqedonase, banues në vendet e tjera socialiste, do të kenë mundësinë të pranojnë shtetësinë bullgare dhe do të lejohen të rivendosen në Bullgari. Ministri i Punëve të Jashtme do të udhëzojë ambasadat përkatëse bullgare që të punojnë me kujdes me ata që duan të pranojnë shtetësinë bullgare dhe të rivendosen në vendin tonë. Emigrantët politikë maqedonas, që tashmë banojnë në Bullgari, mund të pranojnë shtetësinë bullgare sipas procedurës së përcaktuar. Emigrantët politikë që kanë pranuar shtetësinë bullgare, dhe që kanë marrë pjesë në lëvizjen e qëndresës në Greqi, dhe kanë cilësitë e duhura, do të njihen si luftëtarë aktivë kundër kapitalizmit dhe fashizmit. 4. Vendosja e të rinjve dhe rivendosja e emigrantëve politikë në qytetet e Sofjes dhe Varnës, nuk do të vazhdojë më. 5. Çështjet e administrimit, strehimit, punësimit dhe kujdesit shoqëror, në lidhje me emigrantët politikë, do të trajtohen nga këshillat, autoritetet shtetërore përgjegjëse dhe nga Kryqi i Kuq i Bullgarisë, nën mbikëqyrjen e komiteteve të Partisë.

ЦДА [Arkivi Qendror Shtetëror], f.1Б, inv.35, a.u. 12.

I-49. Gratë në Luftën Civile Greke

Një nga tiparet e reja të Luftës Civile Greke ishte pjesëmarrja masive e grave në DSE, duke punuar në njësitë ndihmëse dhe duke u angazhuar në një sërë veprimesh luftarake. Pas një periudhe të shkurtër trajnimi në shkollat e improvizuara ushtarake të DSE-së, ose vetëm për arsye se ato kishin dalluar në luftime të armatosura, shumë prej tyre u bënë oficere. Gratë kishin marrë pjesë gjithashtu në qëndresën e armatosur kundër Forcave të Boshtit (1941-1944), por në një numër të kufizuar dhe vetëm mbi baza vullnetare. Në DSE kishte edhe disa gra që kishin dalë vullnetare, por shumica ishin mobilizuar në zonat nën kontrollin DSE-së, dhe madje vetëm për disa ditë, veçanërisht pas fillimit të vitit 1948, kur mungesa e rezervistëve u bë veçanërisht e ndjeshme. I ashtuquajturi "asimilim" i tyre në njësitë luftarake, synonte krijimin e një identiteti të ri, atë të gruas luftëtare. Përveç problemeve ideologjike dhe praktike, që përfshinte një proces i tillë, kishte edhe një sërë konceptesh të trashëguara rreth rolit dhe pozitës së grave në shoqërinë greke, që duhet të tejkaloheshin.

A. Maria Beikou përshkruan jetën e grave në ushtri

Në moshë shumë të re, Maria Ferla Beikou (1925-2011) iu bashkua qëndresës së të majtëve dhe mori pjesë në luftën e armatosur Kundër Forcave pushtuese të Boshtit. Në vitin 1945, u martua me gazetarin Georgoulas Beikos, ndërsa gjatë luftës civile luftoi në radhët e DSE-së. Pas humbjes së komunistëve, në gusht të vitit 1949, u arratis drejt Shqipërisë dhe prej andej shkoi me bashkëshortin e saj në Bashkimin Sovjetik, ku studioi kinematografi dhe punoi në redaksinë e gjuhës greke të Radio Moskës. Pas rënies së juntës, në vitin 1974, ajo u kthye në Greqi.

Gjëja e parë që iu thashë atyre kur formuam togën ishte se ato duhet të vishnin pantallona, ashtu si në Ushtrinë Çlirimtare të Popullit të Greqisë (ELAS). Ato nuk donin. Ishin mësuar të vishnin funde. I thashë Diamantisit: "Kjo nuk është gjë e mirë. Ato duhet të veshin pantallona dhe të mbledhin flokët në gërsheta". Ai porositi qepjen e uniformave për gratë. Ishte gusht, u gjet një farë pëlhure, dhe rrobaqepësja jonë na mori masat dhe na i bëri uniformat … Iu thashë: "Është urdhër. Këtu është ushtri. Ne do t'i qepim dhe ju po deshët bëni provë që të mos i vishni" […]. Një mëngjes një bombë goditi tendën tonë, ne sapo kishim dalë. Po të kishim qenë brenda, do të ishim vrarë. Tenda u shkatërrua, por çantat tona shpëtuan. Pastaj filluan veprimet luftarake dhe ato u detyruan të vishnin pantallona. Ato nuk mund të kishin rrugë tjetër. Kështu, u zgjidh çështja e pantallonave.

Me kalimin e kohës, edhe pse kishte incidente gjatë jetës në luftë, burrat filluan të njihnin kontributin e vajzave. Ata na pranuan dhe çdo gjë u vendos në rregull. Kudo që shkonim, ishim bashkë. [Punët e përditshme] ndaheshin. Gratë pastronin dhe rregullonin vendin, ku do të qëndronin gjatë natës dhe qepnin - nëse do të ishte e nevojshme; burrat sillnin dru dhe ndiznin zjarrin [...]. Gjatë marshimeve, nëse një grup duhet të merrte një armë të rëndë, ajo mbahej në krah nga dhjetë [luftëtarë], burra dhe gra. Nuk kishte dallime.

Beikou, 2010, pp. 83, 86.

B. Intervistë me Uranija Jurukovën

- Pa dyshim, ju dhe burri juaj ishit miq të vjetër dhe të mirë kur vendosët të martoheshit, në korrik të vitit 1946. Nga pikëpamja e studimeve gjinore, do të doja të dija për rrjedhën e ngjarjeve që përshkuan historinë e jetës suaj. E di shumë mirë se sa e dyzuar ishit midis amësisë dhe patriotizmit.

Uranija Jurukova: Atje u detyrova të largohesha nga fëmija im katërvjeçar, sepse më urdhëruan të kthehesha menjëherë. "Kemi nevojë për ju këtu," thanë ata, "Ne kemi nevojë për çdo kuadro! Lëreni fëmijën me dikë dhe ejani këtu!" E lashë fëmijën me nënën e Evdokijës Fotevës që ishte në qytetin e Manastirit. [...] Dhe kështu rrugët tona u ndanë. Ia ndërpreva gjirin dhe u ktheva në detyrë aktive. Por sapo mbërrita, pata temperaturë të lartë, u sëmura dhe kështu që më duhej që të kthehesha në Manastir. Atje mësova se fëmija im ishte shumë i sëmurë dhe se ishte në spital në Shkup.

Për shkak të marrëdhënieve të acaruara midis Greqisë dhe Jugosllavisë, më duhej të prezantohesha si tezja e foshnjës sime, dhe jo si nëna e tij. E gjeta fëmijën gati të vdekur! Ai kishte vetëm një pelenë; e mbështeta në gji dhe mbyllja sytë me forcë, që të mos qaja, por nuk mund ta përmbaja veten. [...] I thirra mjekët menjëherë, bëra namin! Pastaj i filluan mjekimin dhe pas katër ose pesë ditësh fëmija më në fund u bë më mirë. […]

Pasi e rimori pak veten, shkuam në Manastir.

Stojanovic-Lafazanovska dhe Lafazanovski, 2002, fq.13-50.

C. Uranija Jurukova dhe Vera Foteva

Arkivi privat i mbesës së Uranija Jurukovës.

Evdokia Foteva (lindur më 1926 në Dendrochori, Greqi) dhe Uranija Jurukova (lindur më 1924 në Poria, Greqi, vdiq në Shkup në vitin 2012) ishin të dyja anëtarë të FNS-së rajonale të Kosturit (Frontit Nacionalçlirimtar sllavo-maqedonas) dhe të bordit rajonal të FN-së (Frontit Nacionalçlirimtar). Në prag të humbjes së DSE-së, në tetor të vitit 1949, Foteva dhe Jurukova, së bashku me të gjithë FN-në (të udhëhequr nga Paskal Mitrevski), u akuzuan nga KKE se ishin "agjente të Titos". Ato u arrestuan dhe u mbajtën në Shqipëri, nga ku u transferuan në burgjet dhe kampet sovjetike. Pas një gjyqi të gjatë në Moskë (në burgun Lubjanka), ato u dënuan me tetë vite punë të detyruar në kampet e Siberisë. Pas vdekjes së Stalinit, ato u liruan dhe më pas u internuan në Alma Ata, në Kazakistan. Në vitin 1956, ato u kthyen në Republikën Popullore të Maqedonisë.

Gratë si gjatë luftës, ashtu edhe në radhët e ushtrive revolucionare pritet të përballen me steriotipe, në lidhje me kapacitetin e tyre, pjekurinë, integritetin dhe efektivitetin në situate konfliktesh.

Lexoni me kujdes burimet e mësipërme dhe çelësat, dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

1. Çfarë qëndrimi steriotip vëmë re në mënyrën se si pretendohet që gratë të sillen (paraqitja, kodi i veshjes, punët dhe detyrat, etj.)? Si mund ta përshkruani rolin shoqëror të grave?

2. Me çfarë mëdyshje duhej të përballej Uranija Jurukova? A kishte ajo zgjedhje? Diskutoni temën e mobilizimit vullnetar dhe/ose të detyruar në ushtrinë komuniste gjatë luftës civile.

3. Shikoni me kujdes fotografinë me tri zonjat dhe diskutoni për uniformat e tyre. Gjeni më shumë fotografi të grave në DSE. Ku përqendrohen më shumë? Çfarë dëshiron të tregojë dhe të theksojë fotografi në lidhje me gjininë e tyre?

4. Gjeni, studioni dhe diskutoni dëshmitë verbale dhe pasqyrimin mediatik, për mënyrën se si këto gra u përballën me shoqërinë, gjatë dhe pas Luftës Civile.

5. Diskutoni kushtet dhe mënyrat e emancipimit të grave gjatë një periudhe lufte.

PYETJE PËR KAPITULLIN 1

Shpjegoni arsyen përse fundi i Luftë së Dytë Botërore nuk krijoi kushte për paqe të qëndrueshme në Evropën Juglindore. Shqyrtoni çështjet e mëposhtme: Lufta Civile Greke, hakmarrja masive, shtypja, diktatura njëpartiake. Gjeni shembuj në burimet e këtij kapitulli.

KAPITULLI II: LUFTA E FTOHTË

Hyrje 59

II.1. Fillimi i Luftës së Ftohtë 61

II.2. Ndarja e Titos nga Stalini 64

II.3. Greqia dhe Turqia 69

II.4. Lëvizja Antikolonialiste në Qipro 72

I.4.1. Kërkesa për bashkim me Greqinë dhe reagimet 72

II.4.2. Masakra kundër grekëve dhe jomyslimanëve të tjerë në Stamboll 73

II.4.3. Konflikte midis komuniteteve 76

II.4.4. Pavarësia 79

II.4.5. Shpërthimi dhe përshkallëzimi i dhunës 81

II.5. NATO, Traktati i Varshavës dhe Lëvizja e Vendeve të Paangazhuara 84

II.5.1. NATO kundrejt Traktatit të Varshavës 84

II.5.2. Lëvizja e Vendeve të Paangazhuara 90

II.6. Aleancat Ballkanike 92

II.6.1. Planet për Federatën jugosllavobullgare 92

II.6.2. Pakti Ballkanik, viti 1954: Turqia, Greqia dhe Jugosllavia 94

II.6.3. Rrugëtimi i Shqipërisë 95

HYRJE

"Një perde e hekurt ka rënë mbi kontinent." Këto fjalë historike të shprehura nga Uiston Çurçill në fjalimin e tij në Kolegjin Westminster në Fulton, Misuri, më 5 mars të vitit 1946, konsiderohen si fillimi i epokës së Luftës së Ftohtë në marrëdhëniet ndërkombëtare pas Luftës së Dytë Botërore.

Për një kohë të gjatë, Lufta e Ftohtë u perceptua si një konflikt i papajtueshëm midis i dy blloqeve të fuqishme politike dhe ushtarake; midis Perëndimit kapitalist demokratik dhe Lindjes komuniste autoritare, që u përfshinë në një garë strategjike për armët bërthamore në kërkim të mbizotërimit botëror. Pas rënies së Murit të Berlinit, që simbolizonte ndarjen e Gjermanisë, Evropës dhe pjesës tjetër të botës, që nga vitet 1960 e në vijim, Lufta e Ftohtë duket gjithnjë e më pak si preludi i rore dhe më shumë si rivalitet i ashpër midis elitave politike të të dyja palëve, që ishin të angazhuara për të, mbajtur ndezur dhe ushqyer ndjesinë e frikës dhe të pasigurisë te njëri-tjetri. Retorika e veçantë propagandistike e "palëve ndërluftuese" u pasqyrua fuqishëm nga disa të kundërta dypolare: antikomunizmi kundrejt antifashizmit; "vlerat e qytetërimit Perëndimor" kundrejt "luftës botërore për paqen"; "burokratizmi i partisë" kundrejt "dredhive të imperialistëve", dhe kështu me radhë. Megjithëse mund të duket e habitshme, në retrospektivë ruajtja me zell e ekuilibrit politik dhe propagandës shfaqet gjithnjë e më shumë si një sistem, që i siguroi një qëndrueshmëri më të madhe në një botë që ishte tepër e ndjeshme edhe ndaj tundimeve "më të vogla" për luftë.

Forcat antagoniste politike dhe ushtarake në të dyja krahët e "vijës së frontit" përfaqësoheshin nga Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) dhe Organizata e Traktatit të Varshavës (Pakti i Varshavës). Gjysma e dytë e shekullit të 20-të, ishte dëshmitare e krijimit, zhvillimit dhe konkurrimit midis pakteve të ndryshme ushtarako-politike rajonale dhe aleancave ekonomike ndërshtetërore, që pasqyronin linjat e ndarjes botërore - siç ishin Bashkësia Ekonomike Evropiane (BEE), Këshilli i Ndihmës Ekonomike Reciproke (COMECON) dhe Shoqata e Vendeve të Azisë Juglindore (ASEAN).

Një tipar kryesor i Luftës së Ftohtë në mbarë botën ishte nxitja e herëpashershme e konflikteve "të nxehta" vendore dhe rajonale, që prekën vendet joanëtare të dy blloqeve ushtarako-politike. Këto luftëra dhe konflikte, të nxitura nga fuqi të tjera, janë pjesë përbërëse e historisë botërore gjatë gjysmë së dytë të shekullit të 20-të, sidomos në kontekstin e dekolonizimit dhe përpjekjes për rritjen e ndikimit ideologjik, ekonomik dhe politik në vendet e të ashtuquajturës Botës së Tretë. Shumë prej këtyre dukurive filluan si përpjekje për ndryshimin e regjimeve dhe mundësinë e daljes nga sfera përkatëse e ndikimit, si edhe nga konfliktet civile në një sërë vendesh satelite (përkrahëse) ose asnjanëse, dhe në disa raste përfundoi në ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të trupave ushtarake sovjetike, amerikane, të NATO-s dhe Traktatit të Varshavës , si edhe të aleatëve të tyre. Kërcënimi më i fuqishëm për konflikt të drejtpërdrejtë ushtarak midis Bashkimit Sovjetik dhe SHBA-së, që ishte gati të përshkallëzohej në një Luftë të Tretë Botërore, u shënua nga kriza e raketave kubane të vitit 1962. Në çaste të një tensioni të tejskajshëm, Presidenti i atëhershëm i Shteteve të Bashkuara, Xhon Kenedi, e paralajmëroi qartazi Bashkimin Sovjetik se forca ushtarake amerikane ishte në mbrojtje të të gjithë "Hemisferës Perëndimore". Nga vitet '40 deri në vitet '80, të dyja superfuqitë ruajtën kontingjente të konsiderueshme ushtarake në Evropën e ndarë dhe në vende të tjera, brenda sferës së tyre përkatëse të ndikimit. Ndryshe nga pjesa tjetër e Evropës Lindore, trupat sovjetike nuk u vendosën në Bullgari dhe Rumani, pavarësisht disa "devijimeve" të Nikolai Çausheskut, nga politikat e koordinuara ndërkombëtare të bllokut sovjetik në vitet '60 dhe '70 (pozicioni i tij në krizën e vitit 1968, flirtimet me Perëndimin dhe me shtetet e paangazhuara. Gjakrat midis dy vendeve në secilën anë të "frontit të ftohtë", u ulën gjatë dy periudhave: në fillim të viteve '60 dhe në mes të viteve '70, kur po negociohej për pakësimin reciprok të armëve bërthamore, dhe gjallërim të marrëdhënieve kulturore dhe ekonomike, si programi i përbashkët i hapësirës "Soyuz-Apollo". Marrëdhëniet ndërballkanike u ndikuan edhe nga sjella e blloqeve ushtarako-politike botërore,

që karakterizoheshin nga një sërë lëvizjesh agresive, pavendosjesh dhe dredhish politike. Turqia dhe Greqia iu bashkuan NATO-s në vitin 1952, lëvizje e konsideruar nga vendet komuniste si një sfidë e drejtpërdrejtë ushtarake, që u përball me kundërpërgjigje si politike, ushtarake, ashtu dhe diplomatike. Ndarja e Jugosllavisë nga Bashkimi Sovjetik, çoi në një aleancë të posaçme ushtarako-politike përtej ndryshimeve ideologjike të nënshkruesve të saj. Më 28 shkurt, Turqia, Greqia dhe Jugosllavia, nënshkruan një traktat në Ankara që shënoi fillimin e të ashtuquajturit "Pakti Ballkanik" dhe të fazës pasuese të konflikteve ushtarake në gadishull. Në vitin 1968, edhe Shqipëria u shkëput zyrtarisht nga blloku sovjetik, duke u afruar me Kinën komuniste, që i kishte prishur marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik. Kjo shënoi fillimin e vetëizolimit të Shqipërisë.

Tensionet e Luftës së Ftohtë u projektuan edhe në kontekstin e politikës së brendshme. Faktorët kyç që mbanin gjallë atmosferën që sundonte në këto vende, deri në rënien e komunizmit ishin: dyshimi, mania e përgjimeve, kufijtë absurdë dhe kontrollet e vizave, regjimi i rreptë i "sekreteve shtetërore dhe ushtarake", si dhe persekutimi i vazhdueshëm dhe izolimi i disidentëve. Megjithatë, bashkimi ushtarak dhe politik i parashikuar i vendeve nga i njëjti bllok nuk e uli tensionin e vatrës së zjarrtë të përhershme të trazirave kombëtare. Ndoshta shembulli më i mirë është lëvizja antikolonialiste në Qipro (kolonia e vetme britanike në Evropën Juglindore), që u kthye në një konflikt të ashpër midis komuniteteve të qipriotëve grekë dhe turq. Nuk përbën çudi fakti që, edhe pasi Qipro fitoi Pavarësinë në vitin 1960, propozimet për zgjidhjen e konfliktit, ishin të ndikuara nga politikat e Greqisë dhe Turqisë. Rrjedhimisht, përçarja midis dy anëtarëve të NATO-s çoi në ndarjen e Qipros, që përbënte një burim mosmarrëveshjesh midis këtyre dy vendeve. Një faqe "shumëngjyrëshe" në historinë e Luftës së Ftohtë në Ballkan ishte Lëvizja e Vendeve të Paangazhuara, e themeluar në Beograd, në vitin 1961, që shënoi një ndër sukseset më të mëdha të diplomacisë jugosllave. Shtetet anëtare të saj, përshirë edhe Qipron, ishin në kërkim të një "rruge të mesme", duke shmangur konfliktin e përgjithshëm midis "Lindjes" dhe "Perëndimit".

Pavarësisht një sërë arritjeve të rëndësishme,për sa i përket versionit socialist të modernizimit dhe mirëqenies së shtetit, vendet e bllokut sovjetik dështuan gradualisht në fushën e ekonomisë. Dobësia ekonomike që i ngërtheu ato vende si në marrëdhëniet e brendshme, ashtu edhe ato të jashtme, nxori në shesh kufizimet e sistemit të tyre të centralizuar, jodemokratik dhe tmerrësisht burokratik. Idetë e Presidentit amerikan, Ronald Regan, në lidhje me imponimin e një ndryshimi në marrëdhëniet midis Lindjes dhe Perëndimit, dhe kriza e ekonomisë, politikës dhe ideologjisë, së vendeve komuniste, shënuan fazën e fundit të historisë së Luftës së Ftohtë. Ndonëse sistemi dypolar i marrëdhënieve ndërkombëtare dukej më i paprekshëm së kurrë, tashmë retorika e dy superfuqive ishte bërë më "e lakueshme". Kjo lehtësoi edhe fillimin e një dialogu që u bazua në koncepte, si: "toleranca", "mirëkuptimi", dhe "bashkëjetesa paqësore", për të cilin kontribuan ndjeshëm politikanët udhëheqës evropianë të asaj kohe (Fransua Miteran, Margaret Theçer dhe Helmut Kohl). Shumë prej këtyre koncepteve ishin futur në fillim të viteve '60, për shkak të të ashtuquajturit "ekuilibri i frikës". Megjithatë, në kontekstin e "Perestrojkës", që lidhej me idetë dhe vendosmërinë e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe liderit të saj Mihail Gorbaçovit, për të ndryshuar frymën e qeverisjes dhe për të drejtuar rilindjen e përgjithshme të shoqërive socialiste, këto të fundit patën pasoja të reja dhe ndonjëherë të pangjashme dhe rrënjësore. Ky dialog i ri dhe procesi i hapjes shkallë-shkallë ndaj sferës publike, i çoi shumë qytetarë të vendeve socialiste, të shprehin publikisht pakënaqësinë e tyre ndaj politikës së shtypjes dhe varfërisë së popullit, dhe ta mendojnë "modelin Perëndimor" gjithnjë e më shumë si një alternativë realiste kundrejt utopisë komuniste, dikur gjerësisht e përhapur.

Rënia e Murit të Berlinit në vitin 1989 shënoi fundin simbolik të Luftës së Ftohtë.

II.1. FILLIMI I LUFTËS SË FTOHTË

II-1. Perdja e hekurt

Uinston Çurçilli mbajti një fjalim në Kolegjin e Westminster, në Fulton të Misurit, pas marrjes së diplomës honorifike. Çurçilli, me aftësi tipike prej oratori, , përdori për herë të parë termin "perdja e hekurt", për të përshkruar ndarjen midis fuqive Perëndimore dhe zonës së kontrollit nga Bashkimi Sovjetik. Si i tillë, fjalimi i tij shënoi zanafillën e Luftës së Ftohtë. Stalini iu përgjigj Çurçillit dhjetë ditë me vonë,nëpërmjet një interviste të publikuar në gazetën "Pravda".

A. A. Fjalimi i Çurçillit, 5 mars 1946

Në këto çaste, Shtetet e Bashkuara qëndrojnë në majë të fuqisë botërore. Ky është një çast solemn për demokracinë amerikane. Për arsye se të qenit i pari në fuqi i bashkëngjitet edhe një ndjenjë përgjegjshmërie ndaj së ardhmes, që të ngjall admirim. […] Është e domosdoshme që qëndrueshmëria e mendjes, këmbëngulja e qëllimit dhe thjeshtësia e vendimit, të sundojnë dhe të udhëheqin sjelljen e popujve anglishtfolës në kohë paqeje, siç i kanë udhëhequr edhe në kohën e luftës.[…] E vlerësoj dhe kam shumë respekt për popullin trim rus dhe për shokun tim të luftës, Marshallin Stalin. […] Megjithatë, e kam për detyrë t'iu paraqes disa fakte për pozicionin e tanishëm në Evropë. Një perde e hekurt ka rënë mbi kontinent, duke filluar nga Stetini në Detin Baltik e deri në Trieste në detin Adriatik. Në prapavijë qëndrojnë të gjitha kryeqytetet e shteteve të vjetra të Evropës Qendrore dhe Lindore. Varshava, Berlini, Praga, Vjena, Budapesti, Bukureshti dhe Sofja, të gjitha këto qytete të njohura dhe popullsitë rreth tyre, qëndrojnë në atë që duhet ta përkufizoj si sferë sovjetike, dhe të gjitha, në një farë mënyrë, i nënshtrohen jo vetëm ndikimit të Bashkimit Sovjetik, por edhe masës së vigjilencës së lartë, madje në disa raste edhe të kontrollit gjithnjë e në rritje të Moskës. Zonja dhe zotërinj, siguria e botës kërkon bashkësi në Evropë, nga e cila asnjë komb nuk duhet të lihet mënjanë përgjithmonë. […] Në shumë vende, nga kufijtë e largët rusë dhe në të gjithë botën, janë themeluar kolona të pesta komuniste që funksionojnë në bashkësi të plotë dhe me bindje absolute ndaj direktivave që marrin nga qendra komuniste. Vetëm në komonuelthin e Britanisë dhe në Shtetet e Bashkuara, ku komunizmi është në fillesat e veta, partitë komuniste ose kolonat e pesta përbëjnë një sfidë në rritje dhe rrezik ndaj qytetërimit të krishterë. […] Nuk besoj se Rusia sovjetike e dëshiron luftën.

Ata dëshirojnë frytet e luftës dhe zgjerimin dhe fuqizimin e pakufishëm të doktrinave të tyre. Por, ajo që duhet të kemi parasysh në ditët e sotme, ndërsa kemi ende kohë, është shmangia e përhershme e luftës, dhe vendosja e kushteve të lirisë dhe demokracisë sa më shpejt të jetë e mundur, në të gjitha vendet. […] Kjo mund të arrihet vetëm nëse arrijmë të kuptojmë tani, në vitin 1946, të gjitha pikat e bashkëpunimit me Rusinë nën autoritetin e përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. […] Nëse i përmbahemi me bindje Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe ecim përpara me fuqi të përmbajtur dhe të matur, duke mos kërkuar pronën apo pasurinë e tjetrit, duke mos kërkuar vendosjen e kontrollit të paarsyeshëm mbi mendimet e njerëzve, dhe nëse forcat morale dhe materiale dhe bindjet e Britanisë iu bashkohen tuajave në një shoqatë vëllazërie, rrugët e vështira drejt së ardhmes do të jenë të qarta, jo vetëm për ne, por për të gjithë, jo vetëm për kohën tonë, por edhe për shekullin e ardhshëm.

http://legacy.fordham.edu/halsall/mod/churchill-iron.asp, vizituar më 3.09.2016.

B. B. Përgjigja e Stalinit për fjalimin e Çurçillit, 15 mars 1946

Nuk ka nevojë për përpjekje të veçanta për të treguar se Z. Çurçill po përgojon në mënyrë vulgare dhe pa dorashka fare si Moskën, ashtu edhe shtetet e lartpërmendura, që kufizohen me BRSS-në.

Së pari, është absurde të flitet për kontroll të jashtëzakonshëm nga BRSS-ja në Vjenë dhe Berlin, , ku ka Këshilla të Kontrollit të Aleancës së përbërë nga përfaqësues të katër shteteve dhe ku BRSS-ja ka një të tretën e votuesve. Ndodh që disa persona nuk mund të mos përfshihen në shpifje. Megjithatë, për çdo gjë ka një kufi.

Së dyti, rrethanat e mëposhtme nuk duhet të harrohet. Gjermanët e pushtuan BRSS-në, përmes Finlandës, Polonisë, Rumanisë, Bullgarisë dhe Hungarisë. Gjermanët arritën të na pushtonin përmes këtyre vendeve, sepse në atë kohë ato vende qeveriseshin nga armiq të Bashkimit Sovjetik.

Ndoshta është rasti ku një pakicë po mundohet të hedhë baltë mbi këto sakrifica të popullit sovjetik,që siguroi çlirimin e Evropës nga zgjedha e Hitlerit. Por, Bashkimi Sovjetik nuk mund t'i harrojë këto. Si rrjedhim, dikush mund të bëjë pyetjen: çfarë ka të habitshme lidhur me faktin që Bashkimi Sovjetik, me dëshirën për të përftuar sigurinë në të ardhmen, përpiqet që këto

vende të kenë qeveri, marrëdhëniet e të cilave të jenë besnike ndaj Bashkimit Sovjetik? Si mund t'i cilësojë një person i arsyeshëm këto aspirata paqësore të Bashkimit Sovjetik si "prirje zgjeruese" të qeverisë sonë?

https://www.marxists.org/reference/archive/stalin/ works/1946/03/x01.htm (tre paragrafët e parë), vizituar më 3.09.2016; Hanhimäki dhe Westad, 2003, fq. 49 (paragrafi i fundit).

Çfarë mendimi kishin Çurçilli dhe Stalini për palën tjetër dhe qëllimet e saj? Si i përshkruan Çurçilli synimet dhe qëllimet e BRSS-së dhe si i përshkruan Stalini? A dha një përgjigje bindëse Stalini ndaj akuzave të Çurçillit, në fjalimin e tij për "Perden e Hekurt"?

II-2. Guri i caktimit të kufirit italo-jugosllav me varrezat në sfond

Fotografi nga Božo Repe.

Kufiri midis Perëndimit dhe Lindjes, i referuar edhe si "Perdja e Hekurt", ishte pasojë e Luftës së Ftohtë. Ai ndikoi ndjeshëm në jetët e njerëzve të zakonshëm, që i shkëputën lidhjet dhe marrëdhëniet me njeri-tjetrin, si edhe ndryshuan zakonet e tyre. Kufiri ndau edhe varrezat e Mirenit (në kufirin italo-jugosllav) dhe si rrjedhim, ndau në mënyrë simbolike edhe të vdekurit. Varrezat u kthyen në simbolin e kufirit të pakuptimtë, që nuk ekzistonte para Luftës së Ftohtë. Midis viteve 1947 dhe 1975, u zgjerua vija kufitare midis varrezave nga komitetet e caktimit të kufijve. Kjo situatë e paarsyeshme u zgjidh në vitin 1975 me Traktatin e Osimos, ndërmjet Italisë dhe Jugosllavisë.

II-3. Pjesë nga raporti i CIA-së për "Krizën greke", 28 shkurt 1947

Fati i Greqisë mund të vendoset brenda disa muajve, në mos disa javëve. Nga pikëpamja ushtarake e demoralizuar dhe e papajisur siç duhet, kjo ushtri po humbet terren ndaj forcave guerrilase të mbështetura nga sovjetikët dhe satelitët e tyre. Nga pikëpamja politike, një qeveri e gjerë e partive të djathta, si pasojë e paaftësisë dhe mbështetjes së dobët politike, po e humbet edhe atë pak besim në popull që duket se kishte pasur dikur. Nga pikëpamja ekonomike, një vend i parindërtuar nga shkatërrimet e luftës, po e humbet luftën e tij kundër urisë, inflacionit dhe borxhit të brendshëm dhe të jashtëm.

Që prej çlirimit, dy faktorë e kanë shpëtuar Greqinë nga përpjekjet e palodhshme të BRSS-së për ta marrë atë nën kontroll, nëpërmjet përkrahësve dhe elementëve komunistë vendas: (1) Prania e trupave ushtarake; dhe (2) Ndihmat financiare, përfshirë ndihmën e UNRRA-së, nga SHBA-ja dhe MB-ja. Tashmë, në përballje të përpjekjes së përgjithshme të sovjetikëve për të shfrytëzuar krizën e tanishme, trupat britanike (përveç një force të vogël përfaqësuese) po tërhiqen, dhe SHBA-ja dhe MB-ja e kanë shumë të vështirë të mbledhin paratë për nxitjen e ekonomisë së Greqisë. Për shkak të vështirësive financiare të vetë MB-së, ndihma ekonomike nga ai burim mund të ndërpritet.

Greqia nuk mund ta shpëtojë veten pa u ndihmuar. Nga pikëpamja ushtarake, vendi ka nevojë për ndihmë në formën e pajisjeve dhe stërvitjes. Nga pikëpamja politike, politikanët kokëfortë të Greqisë duhet të binden ndaj domosdoshmërisë së korrigjimit të vetvetes, ndërsa partitë e dobësuara të Qendrës që tradicionalisht kanë pasur mbështetjen e shumicës së popullsisë, duhen ngritur në këmbë. Nga pikëpamja ekonomike, ka nevojë për donacione ose hua për mallra, ushqime, këmbim valutor dhe ar, për të mbajtur nën kontroll inflacionin. Nga këto çështje, nevojat ekonomike janë ato më jetësoret.

Nëse Greqia e përballon trysninë e Bashkimit Sovjetik gjatë muajve të ardhshëm, dhe u bën ballë guerilasve, partitë Qendrës, tani që nuk janë aktive,mund të fitojnë më tej force dhe të rrisin ndikimin për shkak të mizorive që po kryejnë majtistët dhe punës së dështuar të të djathtëve për t'u organizuar dhe për të marrë nën

→

kontroll qeverinë, duke përjashtuar si të djathtën, ashtu edhe të majtën. Një lëvizje e tillë mund të udhëhiqej nga Sofulis, që është i matur, ose nga Plastina, që është republikan.

Megjithatë, pa ndihmë të menjëhershme ekonomike për të do të dilte në pah rreziku i pashmangshëm, që e majta e nxitur nga sovjetikët do të merrte kontrollin e vendit, gjë që do të rezultonte në humbjen e Greqisë si një formë Perëndimore të demokracisë.

https://www.cia.gov/library/center-for-the-study-of-intelligence/csi-publications/books-and-monographs/assessing-the-soviet-threat-the-early-cold-war-years/5563bod1.pdf, vizituar më 3.09.2016.

Raporti i CIA-së për "Krizën greke" u hartua trembëdhjetë ditë para mbajtjes së fjalimit nga Presidenti Harri Truman, përpara seancës së përbashkët të Kongresit, më 12 mars 1947. Në atë raport, Presidenti argumentonte së Greqia "kërcënohej nga veprimtaritë terroriste të qindra luftëtarëve të armatosur të udhëhequr nga komunistët", dhe detyra e SHBA-së ishte mbështetja e vendit, në mënyrë që Greqia të krijohej si një "demokraci që mund të ecte me këmbët e veta me vetëbesim" (Shihni Kapitullin II.3).

1. Cila palë në luftën civile greke gjente mbështetje në këtë raport? Shpjegoni arsyen, duke marrë parasysh kontekstin e gjerë të Luftës së Ftohtë.

2. Çfarë shqetësimesh u paraqitën në raportin e CIA-s? Si i pasqyron ky raport marrëdhëniet e përkeqësuara midis SHBA-së dhe BRSS-së dhe zhvillimin e Luftës së Ftohtë? Shfrytëzoni njohuritë dhe informacionin nga ky burim dhe shpjegoni përse SHBA-ja vendosi t'i ofronte ndihmë Greqisë dhe Turqisë.

II-4. Bashkimi sovjetik vendosi të mos e rinovojë Traktatin e Miqësisë dhe Asnjëanësisë së vitit 1925 me Turqinë, nëse nuk binin dakord për kushtet e mëposhtme

1. Mbrojtja e Ngushticave u ndërmor nga Turqia dhe Bashkimi Sovjetik bashkërisht.
2. Përpos dispozitave të Konventës së Montreuxit për Regjimin e Ngushticave, shtetet që nuk kufizohen nga Deti i Zi, nuk do të kenë të drejtë kalimi nëpërmjet Ngushticave.
3. Bisedimet e Aleancës me Britaninë dhe Francën do të përfundojnë në biseda konsultimesh.
4. Në rast se Britania e Madhe dhe Franca i shpallin luftë Bashkimit Sovjetik, Aleanca e Trefishtë do të anulohet.

Ertem, 2010, fq. 3.

Që prej vitit 1939, Bashkimi Sovjetik e kishte kkundërshtuar Konventën e Montreuxit të vitit 1936, nëpërmjet së cilës Turqisë iu dha kontrolli i plotë mbi lundrimin detar në Bosfor, një rrugë jetësore detare për eksportet e sovjetikëve. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, mospërfshirja ushtarake e Turqisë në luftë bëri që kjo e fundit t'i lejojë anijet tregtare gjermane të kalojnë nëpërmjet Ngushticave. Disa nga këto anije rezultoi të ishin anije që ndihmuan flotën luftarake gjermane, që sulmuan anijet sovjetike dhe portet në Detin e Zi. Nga fundi i luftës, Stalini ishte i vendosur ta shfrytëzonte këtë fakt, si edhe çështje të tjera, si një justifikim për të detyruar Turqinë për lëshime, në formën e rishikimit të traktatit të Montreuxit. Kur Traktati i Miqësisë dhe Asnjanësisë sovjetiko-turke, i arritur në vitin 1925, mbaroi në vitin 1945, Moska zgjodhi të mos e rinovonte atë. Ministri i Jashtëm i qeverisë sovjetike, Viaçeslav Molotov, i komunikoi Ankarasë se pretendimet gjeorgjiane dhe armene ndaj territorit të kontrolluar nga Turqia duhet të zgjidheshin para mbylljes së traktatit të ri. Territori i diskutueshëm rreth Karsit dhe Ardahanës, rajon me probleme të ndërlikuara etnike në kufi me Kaukazin, ishte qeverisur nga Perandoria Ruse nga viti 1878 deri në vitin 1921, vit kur iu dorëzua Turqisë. Viaçeslav Molotovi argumentoi se, ndërsa Moska arriti marrëveshje me Poloninë për lëshimet territoriale (që ishin rezultat i dobësisë së qeverisë sovjetike në vitin 1921), lëshime të ngjashme ndaj Turqisë nuk ishin ligjëruar. Më 27 shkurt 1946, Turqia nënshkroi traktatin e bashkëpunimit dhe ndihmës me SHBA-në. Kjo shënoi fillimin e rivendosjes së marrëdhënieve miqësore.

Çfarë rreziku kishin marrëveshjet midis Bashkimit Sovjetik dhe Turqisë për kontrollin e Ngushticave? Si lidhej kjo me Luftën e Ftohtë?

II.2. PRISHJA E MARRËDHËNIEVE MIDIS TITOS DHE STALINIT

II-5. Pjesë nga Rezoluta e Byrosë Informative të Partisë Komuniste dhe Punëtore (Informbyroja) për qendrimin ndaj Partisë Komuniste të Jugosllavisë, 28 qershor të vitit 1948

1. Informbyroja njofton se kohët e fundit udhëheqja e PKJ-ja po ndjek vijën e gabuar, për sa iu përket çështjeve kryesore të atdheut dhe politikave të jashtme, vijë që tregon largimin e saj nga marksizëm-leninizmi. Në lidhje me këtë, Informbyroja miraton veprimin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik [PKBS], që ndërmori nismën e nxjerrjes në pah të politikës së gabuar të Komitetit Qendror të PKJ-së, në veçanti politikës së gabuar të shokëve Tito, Kardeli, Gjilas dhe Rankoviç.
2. Informbyroja deklaron se udhëheqja e PKJ-së po ndjek një politikë jomiqësore kundrejt Bashkimit Sovjetik dhe PKBS-së. Në Jugosllavi u ndërmor politika e padenjë e përgojimit të specialistëve ushtarakë sovjetikë dhe diskreditimit të Bashkimit Sovjetik.
3. Lidhur me politikat e brendshme, udhëheqësit e KPJ-së po largohen nga parimet ideologjike të klasës punëtore dhe po shkëputen nga teoria marksiste e klasave dhe luftës së klasave. [...] Udhëheqësit jugosllavë po ndjekin politikën e gabuar në fshatra, duke nënvlerësuar dallimin e klasave dhe duke i konsideruar bujqit individualë si një entitet të vetëm, në kundërshtim me doktrinën marksiste-leniniste të klasave dhe luftës së klasave, kundër tezës së njohur të Leninit që ekonomia private e bujqësisë në shkallë të vogël i jep jetë vazhdimisht, përditë, çdo orë, spontanisht kapitalizmit dhe borgjezisë.
5. Informbyroja mendon se regjimi burokrat i krijuar brenda Partisë, nga udhëheqësit e saj, është shkatërrues për jetën dhe zhvillimin e PKJ-së. Brenda Partisë nuk ka demokraci të brendshme partiake, as zgjedhje, e as kritika apo autokritikë parimore. [...] Informbyroja vlerëson se një regjim i tillë terrorist, i ngjashëm me atë turk, nuk mund të pranohet nga Partia Komuniste.
8. (…) Informbyroja, duke e parë situatën në tërësi, vlerëson se Komiteti Qendror i KPJ-së e ka larguar veten dhe Partinë Komuniste të Jugosllavisë nga familjet vëllazërore të Partive Komuniste, larg nga fronti i bashkuar komunist, dhe rrjedhimisht larg radhëve të Informbyrosë. […] Informbyroja nuk ka dyshime se brenda KPJ-së ka elementë revolucionarë të ndershëm, besnikë ndaj marksizëm-leninizmit, duke filluar nga parimet e marrëdhënieve ndërkombëtare të KPJ-së dhe deri te fronti i bashkuar socialist. Detyra e tyre është t'i detyrojnë udhëheqësit e tyre të tanishëm që t'i pranojnë haptazi dhe ndershmërisht gabimet e tyre dhe t'i ndreqin ato; të shkëputen nga nacionalizmi dhe t'iu rikthehen parimeve të internacionalizmit proletar; dhe të forcojnë frontin e bashkuar socialist kundër imperializmit. Në rast se udhëheqësit e tanishëm të KPJ-së dëshmojnë paaftësi për ta kryer këtë, puna e tyre është t'i zëvendësojnë ata dhe ta konsolidojnë udhëheqjen e re internacionaliste të Partisë.

https://espressostalinist.com/2014/01/02/resolution-of-the-information-bureau-concerning-the-communist-party-of-yugoslavia-june-28-1948, vizituar më 3.09.2016.

II-6. Busti i Stalinit si mbetje metalike në fabrikën sllovene

Dolenc et al, 1997, fq. 138.

Armiqësia midis Jugosllavisë së Titos dhe Byrosë Informative të Partive Komunistëve dhe Punëtore (Informbyroja) nisi më 18 mars 1948, kur Bashkimi Sovjetik, fillimisht, tërhoqi nga Jugosllavia këshilltarët e tij ushtarakë dhe të nesërmen edhe specialistët civilë. PKJ-ja iu kundërpërgjigj, duke u përpjekur të të shmangte skenarin më të keq dhe duke u përpjekur të dëshmonte "besnikërinë e saj të vërtetë komuniste" kundrejt vizionit sovjetik dhe

→

bashkimit të vendeve të bllokut socialist. Si rrjedhim, ata miratuan ligjin për shtetëzimin e pronave. Në të njëjtën kohë, filluan edhe gjyqe politike kundër ish të internuarve, kryesisht sllovenë, në kampet e Dakaut dhe dhe Bukenvaldit. Të internuarit u akuzuan për bashkëpunim me Gestapon në kampet, si edhe me aleatët Perëndimorë pas lufte, dhe u shpallën armiq të sistemit socialist.

Megjithatë, Stalini në letrën e tij të datës 4 maj 1948, i quajti udhëheqësit e Jugosllavisë: gënjeshtarë, budallenj dhe antisovjetikë. Për pasojë, Jugosllavia nuk pranoi të merrte pjesë në seancën e mbledhjes së Këshillit të Informbyrosë në Bukuresht, gjatë së cilës u përjashtua. Në Jugosllavi, nisi qëndresa e drejtuar nga shteti kundër Bashkimit Sovjetik. Imazhet dhe busti i Stalinit përfunduan në koshat e mbeturinave.

1. Përse e përjashtoi Informbyroja Jugosllavinë? Hartoni një listë me ankesat dhe akuzat e Informbyrosë kundër Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Bazohuni në njohuritë tuaja për t'i shpjeguar ato. Cilët udhëheqës jugosllavë u akuzuan me emër, për "politikën e gabuar"?

2. Si i shpjegoni rreshtat e mëposhtme:"Informbyroja nuk ka dyshime se brenda KPJ-së ka elementë revolucionarë, të ndershëm, besnikë ndaj marksizëm-leninizmit, duke filluar nga parimet e marrëdhënieve ndërkombëtare të KPJ-së e deri te fronti i bashkuar socialist." Detyra e tyre është t'i detyrojnë udhëheqësit e tanishëm që t'i pranojnë haptazi dhe ndershmërisht gabimet e tyre dhe t'i ndreqin ato. [...] Në rast se udhëheqësit e tanishëm të KPJ-së dëshmojnë paaftësi për ta kryer këtë, puna e tyre është t'i zëvendësojnë ata dhe ta konsolidojnë udhëheqjen e re internacionaliste të Partisë".

3. Ndryshe, nxënësit mund të plotësojnë tabelën e mëposhtme; atyre do t'iu jepet lista me ankesat dhe ata do të interpretojnë kuptimin e secilës prej tyre. Përveç Rezolutës, nxënësit mund të shfrytëzojnë edhe burimin II.8.

Rezoluta e Informbyrosë	Shpjegim dhe shembuj
1. Udhëheqja e PKJ-ja po ndjek vijën e gabuar për sa i përket çështjeve kryesore të atdheut dhe politikave të jashtme, vijë që tregon largimin e saj nga marksizëm-leninizmi.	
2. Udhëheqja e PKJ-së po ndjek një politikë jomiqësore kundrejt Bashkimit Sovjetik dhe PKBS-së.	
3. Lidhur me politikat e brendshme, udhëheqësit jugosllavë po ndjekin politikën e gabuar në fshatra.	
4. Një regjim burokratik është krijuar brenda Partisë nga udhëheqësit e saj; brenda Partisë nuk ka demokraci të brendshme partiake, as zgjedhje, e as kritika apo autokritikë.	
5. Komiteti Qendror i PKJ-së, veçanërisht Tito, Kardell, Gjilas dhe Rankoviç akuzohen për politika të gabuara.	

Evropa gjatë Luftës së Ftohtë

II-7. Pasojat e prishjes së marrëdhënieve midis Titos dhe Stalinit në vitin 1948 në Rumani: dëbimet nga Banati përgjatë kufirit me Jugosllavinë (1951)

Mara Pantin nga fshati Keça: "Ditën e dytë pas Rrëshajës, më 18 qershor të vitit 1951, dita e festimit të kishës [fshatit], u zgjuam nga disa trokitje në derë. Një oficer hyri brenda me furi dhe na urdhëroi të visheshim. Më pas, e preu bukën në gjysmë dhe një copë sallam dhe na tha se këto ishin të vetmet gjëra që mund të merrnim me vete [...]. Oficerit, që kishte mbërritur ndërkohë, i kërkuam leje për të marrë së paku një shishe uji për fëmijët, por ai tha jo, dhe shtoi: "Ne nuk japim leje për asgjë".

Ion Jurça, nga fshati Çiukiçi: "Në vitin 1951, më 18 qershor, në orën katër të mëngjesit, ditën e dytë pas Rrëshajës, ata erdhën dhe trokitën në derë [...] aq shumë sa mendonim se do ta rrëzonin shtëpinë. Oficeri i policisë dhe dy të sigurimit hynë brenda[...] nxori një letër dhe nisi ta lexonte: "Në zbatim të rregullores së datës 12 [qershor], të Ministrisë së Punëve të Brendshme [...], ju dhe familja juaj do të largoheni nga kjo shtëpi brenda tre orëve. Do të merrni me vete vetëm ato që mund të nxërë një karrocë [...]dhe asgjë më shumë". E besoni dot, vetëm këto nga një shtëpi e tërë kaq kaq e madhe sa kjo? Shtëpia mbeti plotësisht e mobiluar, ne të gjithë bërtisnim, nuk dinim çfarë të bënim, çfarë të kapnim, çfarë të merrnim, rroba, ushqime apo kafshët. Shtëpia kishte gjithçka që nevojitej [...] çdo gjë që një familjar i kujdesshëm mund të ketë. "

Mircea Rusnac, "Deportarea bănățenilor în Bărăgan (1951), din perspectivă istorică" [Deportation of Banat Inhabitants to Bărăgan (1951) from a Historical Viewpoint], http://www.banaterra.eu/romana/files/rusnac_mircea_ deportarea_banatenilor_in_baragan_1951_din_perspectiva_istorica.pdf, vizituar më 6.05.2015.

Natën e 18 qershorit të vitit 1951, mbi 44,000 persona nga zona kufitare ndërmjet Rumanisë dhe Jugosllavisë (provinca e Banatit) u dëbuan për pesë vjet në Baragan, një zonë pak e populluar, në Jug të vendit. Atmosfera e terrorit që mbretëronte dhe shkeljet e normave të sjelljes gjatë dëbimeve, e shtuan ndjenjën dramatike të atyre çasteve. Njerëzit kishin frikë se mund t'i dërgonin në Siberi (siç kishte ndodhur jo shumë kohë më parë me gjermanët) ose akoma më keq, se mund t'i vrisnin. Dëbimet nuk synonin vetëm dekurajimin e marrëdhënieve tradicionale midis njerëzve në të dy anët e kufirit, por edhe shpronësimin e tokës së fshatarëve të pasur (të ashtuquajturve kulakë). Kur u kthyen në atdhe, ata arritën të shpëtonin shumë pak nga pasuria që kishin braktisur. →

"Securitate" ishte policia politike e krijuar nga regjimi komunist në vitin 1948, për të zëvendësuar shërbimin, që deri në atë kohë kishte qenë përgjegjës për mbrojtjen e "sigurisë së shtetit" (Siguranța) [Sigurimi]. I krijuar si një shërbim i brendshëm dhe i jashtëm inteligjence , pati një kontribut të drejtpërdrejtë në vendosjen e regjimit terrorist, që vëzhgonte rreptësisht popullsinë, duke bërë arrestime dhe hetime të vrazhda, duke kërcënuar dhe sulmuar miliona persona të ashtuquajtur "armiq të popullit". Për shkak të qindra mijëra informatorëve të kamufluar, Sigurimi fuqizoi një regjim akuzash të përgjithshme dhe shpifjesh nga të cilat asnjë nuk mund të shpëtonte. Me kalimin e kohës, ai u bë shtet brenda shtetit, duke kontrolluar të gjitha institucionet, përfshirë edhe Partinë Komuniste. Fakti që "Sigurimi" kishte monopolin ndaj veprimtarive të caktuara, si vëzhgimi i tregtisë së jashtme dhe të marrëdhënieve me vende të tjera, iu dha hov mashtrimeve të mëdha shtetërore dhe i mundësoi oficerët e "Sigurimit", për të krijuar kapitale private, që i përfituan plotësisht nga rënia e regjimit komunist, në vitin 1989.

1 Arsyeja për vendimin e autoriteteve rumune për të dëbuar popullsinë që banonte në zonën kufitare me Jugosllavinë. Si u ndjenë të dëbuarit? Nga se ndruhej regjimi? Cilat ishin pasojat që patën të dëbuarit?

2. Komentoni këto ngjarje në kontekstin e të drejtave themelore të njeriut, të miratuara nga Kombet e Bashkuara me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (1948).

II-8. Pjesë nga fjalimi i Valko Çervenkov, udhëheqësi komunist i Bullgarisë pas Gjergji Dimitrovit dhe Vasil Kolrovit (1950-1956), për marrëdhëniet midis Bashkimit Sovjetik, Jugosllavisë dhe Bullgarisë, mbajtur në një takim të Partisë, në Kardzhali, më 11 qershor 1955.

Shokë, si filloi konflikti midis dy palëve? Dihet, që në

vitin 1948 udhëheqësit jugosllavë nuk ishin të gatshëm të shqyrtonin ndryshimet që kishin dalë në pah për një sërë çështjesh parimore së bashku me udhëheqësit sovjetikë dhe udhëheqësit e Republikave Popullore. Cilat çështje parimore? Për çështje të tilla si ligjet, që kanë të bëjnë me zhvillimin e revolucionit socialist, ose me fjalë të tjera, për mënyrën se si duhet të kryhet ndërtimi socialist. A duhet të ndjekim përvojën e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe ligjeve për zhvillimin e revolucionit sovjetik, që u shpallën nga Revolucioni Socialist i Tetorit? Udhëheqësit jugosllavë filluan të pohonin se zhvillimi i socializmit në Jugosllavi do të ndodhte në një mënyrë të veçantë dhe se ata nuk kishin asgjë për të mësuar nga Bashkimi Sovjetik, ndërkohë që mohuan përvojën e Bashkimit Sovjetik. Ata e mohuan rolin udhëheqës të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në lëvizjen ndërkombëtare të punëtorëve. Për çështjen se si do ta reformonin bujqësinë, ata deklaruan se kishin pikëpamje të veçantë, përfshirë, për shembull, edhe pikëpamjet për rolin revolucionar të kulakëve. Në vitin 1948, në takimin me Informbyronë, ne duhet të binim dakord për këto çështje me udhëheqësit jugosllavë. Ata ishin ftuar që të diskutonim nëse këto pikëpamje ishin të sakta dhe çfarë duhet bërë. Dihet se ata nuk erdhën në takim. Ata deklaruan paraprakisht që pikëpamjet e tyre nuk do të kuptoheshin, se vendimet do t'u diktoheshin atyre atje, ndaj ata nuk erdhën. Më pas, siç e dini, u miratua Rezoluta e Parë e Informbyrosë, që kritikoi pikëpamjet e udhëheqësve jugosllavë për një sërë çështjesh të rëndësishme parimore. Por, mospranimi i udhëheqësve jugosllavë për të qenë të pranishëm në këtë takim, nënkuptonte se ata po i shkëputnin marrëdhëniet me kampin tonë.

Kiriakov, Boyko et al. 2013, fq. 50-54.

II-9. Të burgosurit që kërcejnë "kolo" gjatë festës së 1 majit të vitit 1951, në kampin e ishullit Goli

Pas prishjes së marrëdhënieve ndërmjet Stalinit dhe Titos, dhe pas largimit të Jugosllavisë nga Informbyroja, në vitin 1948, kishte shumë gjasa që disa komunistë në Jugosllavi mund të mbështesnin linjën sovjetike dhe Stalinin. Për ta parandaluar një skenar të tillë, autoritetet ndërmorën një fushatë persekutimi të kundërshtarëve të mundshëm. Për këtë qëllim, në ishullin Goli u ndërtua një kamp i sigurisë së lartë, ku ndiqeshin praktika të rrepta dhe çnjerëzore. Përveç shumicës së të burgosurve që ishin mbështetës të Stalinit, të burgosurit e tjerë në ishull ishin persona që nuk kishin të bënin me stalinizmin, por ishin viktima të akuzave të rreme ose për shkak se kishin bërë deklarata të papranueshme. Thuhej se ishulli Goli përfaqësonte "Mënyrën staliniste për t'u marrë me stalinistët". Nga viti 1948 deri në vitin 1956, rreth 13.000 qytetarë jugosllavë u burgosën atje. Pas vitit 1956, kampi u kthye në burg të mirëfilltë.

Koleksion privat (Martin Previšić).

II-10. Torturat në kamp dhe poshtërimi i vazhdueshëm

A. Vukashin Popoviç, oficer i lartë i policisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme në Mal të Zi, flet për sistemin e riedukimit.

Kam duruar pesë vjet e gjysmë në burgjet e famshme të Cetinjës dhe Kotorrit, në kampet e përqendrimit në Stara Gradishka, Sveti Grgur, Ugljan pranë Zadarit, në Bileça dhe në ishullin Goli. […] Kam duruar tortura të tmerrshme në Cetinjë. Duhet pranuar se ata që nuk kanë kaluar nëpër bodrumin e ndërtesës së "Ambasadës Franceze" në Cetinjë nuk e kanë idenë se çfarë është

vuajtja e Tantalusit. Ndërtesa e bukur e shtetit miqësor të Francës në vitin 1949 u shndërrua në një vend torturash. […] Një metodë e parapëlqyer e kryerjes së hetimeve ishte "mbytja e thatë". Viktima shtrihej në shpinë, ndërsa disa udbashë (zyrtarë të Agjencisë Shtetërore të Sigurimit) e mbanin poshtë, duke u ulur mbi këmbë, stomak dhe gjoks të viktimës. Ata e detyronin atë të mos merrte frymë dhe i hidhnin ujë në hundë[…] Në vend të ajrit, viktima që donte të merrte frymë, thithte ujë dhe i binte të fikët pas pak minutash. Unë i jam nënshtruar kësaj torture disa herë në burgjet e Cetinjës dhe Kotorrit. Është çudi që jam ende gjallë pas gjithë atyre torturave që kam përjetuar.

B. Dëshmia e të burgosurit Dushan Lutovac

Ishulli Goli ishte epiqendra e çdo gjëje të keqe. Të gjitha tiparet e sjelljes njerëzore atje u zhdukën. […]Ai ishte i banuar nga fantazma njerëzore të uritura, të zymta, të papërmbajtura, të vdekur, ndonëse merrnin ende frymë, me eshtra të zhveshura dhe sy të zgurdulluar. Ishte i banuar nga gjeneralë të dënuar, ministra, heronj kombëtarë, të dënuar për vepra të ndryshme.[...]Dhe në një farë mënyrë arritëm të mbijetojmë për të parë fundin e vitit 1956 dhe lirimin e një grupi të madh,prej rreth 1000 të dënuarish prej nesh. Kur nisëm të largoheshim pas lirimit, dikush nga administrata e ishullit Goli, na këshilloi që të ktheheshim në vendlindjen tonë, ku na njihnin mirë dhe ku njerëzit do të na ndihmonin të gjenim një vend pune. Unë veprova siç më thanë, dhe çfarë ndodhi?

Greqi (Shihni burimin III-14A).

Hasa një bojkot të pestë - fizikisht të përballueshëm, por psikologjikisht pothuajse aq të rëndë sa në ishullin Goli. Askush nuk mund të më vizitonte. Fjala u përhap si zjarri që "tradhtari" kishte dalë nga ishulli Goli. Edhe miqtë dhe të afërmit e mi nuk erdhën të më takonin, ose hezitonin të vinin.

Stojanoviç, 1994, pp. 74, 79-80.

"Bojkot" ishte termi që përdorej në ishullin Goli për të përcaktuar trajtimin veçanërisht të ashpër të një të burgosuri nga të burgosurit e tjerë të qelisë: askush nuk u lejua të fliste me të; atij i jepej më pak ushqim, ndërkohë që duhet të punonte më shumë..

1. Kush ishin njerëzit që u internuan në Ishullin Goli? Gjeni referenca në këtë burim dhe në çelës. Pse u arrestuan? **2**. Si u trajtuan (për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, shfrytëzoni burimet pamore dhe të shkruara)? Sipas dëshmisë, cili ishte qëndrimi i bashkëqytetarëve të tyre kur ata u kthyen në vendlindje? Pse mendoni se njerëzit u sollën ashtu me ta? **3**. Shpjegoni frazat që gjenden në çelës: "Ishulli Goli përfaqësoi mënyrën staliniste për t'u marrë me stalinistët". **4**. Gjeni ngjashmëritë dhe dallimet me kampin e përqendrimit të ishullit të Makronisos në

II.3. GREQIA DHE TURQIA

II-11. Doktrina e Trumanit, viti 1947

Doktrina e Trumanit, që u shpall fillimisht gjatë një fjalimi të mbajtur nga Presidenti Truman, para seancës së përbashkët të Kongresit, më 12 mars 1947, parashtroi se Shtetet e Bashkuara do t'i ofronin Greqisë dhe Turqisë ndihma politike, ushtarake dhe ekonomike. Doktrina e Trumanit e riformuloi politikën e jashtme larg qëndrimit të tij të zakonshëm të tërheqjes nga konfliktet rajonale, duke mos u përfshirë drejtpërsëdrejti Shtetet e Bashkuara, për një ndërhyrje të mundshme në konfliktet e largëta. Pas deklaratës së qeverisë britanike se nuk do të ofronte ndihmë ushtarake dhe ekonomike për Greqinë, Truman i kërkoi Kongresit ta mbështeste qeverinë greke në luftën civile kundër komunistëve grekë. Ai i kërkoi Kongresit të ofronte ndihmë edhe për Turqinë, pasi edhe ai komb, më parë, varej nga ndihma britanike

FJALIMI I PRESIDENTIT HARI TRUMAN PARA SEANCËS SË PËRBASHKËT

[…] Vetë ekzistenca e shtetit grek sot kërcënohet nga veprimtaritë terroriste të disa mijëra njerëzve të armatosur, të udhëhequr nga komunistët, që e sfidojnë autoritetin e qeverisë në disa rajone, veçanërisht gjatë kufijve veriore.

[…] Greqisë duhet t'i ofrohet ndihmë, në mënyrë që të bëhet një republikë e pavarur dhe vetëqeverisëse. Shtetet e Bashkuara duhet ta ofrojnë këtë ndihmë. Ne kemi dërguar tashmë në Greqi ndihma të ndryshme përfshirë dhe ndihmën ekonomike, por këto janë të pamjaftueshme. Nuk ka asnjë vend tjetër tek i cili mund të drejtohet Greqia demokratike. Asnjë popull tjetër

nuk është i gatshëm apo i aftë të sigurojë mbështetjen e nevojshme për një qeveri demokratike greke. […]

Edhe fqinji i Greqisë, Turqia, e meriton vëmendjen tonë. E ardhmja e Turqisë si një shtet i pavarur dhe ekonomikisht i fortë nuk është më pak e rëndësishme për popujt liridashës të botës se e ardhmja e Greqisë.[...] Që nga koha e luftës, Turqia ka kërkuar ndihmë ekonomike nga Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara për të realizuar modernizimin e domosdoshëm për ruajtjen e integritetit të saj kombëtar. Ky integritet është thelbësor për ruajtjen e rendit në Lindjen e Mesme.[...] Besoj se duhet të jetë politika e Shteteve të Bashkuara që të mbështesë popujt e lirë, që po i bëjnë ballë përndjekjes për t'u nënshtruar nga pakicat e armatosura ose nga trysnitë e jashtme. Unë besoj se ne duhet t'i ndihmojmë popujt e lirë për të vendosur vetë për fatin e tyre.[...]Mjafton vetëm të vështrosh një hartë për të kuptuar se mbijetesa dhe integriteti i kombit grek janë të një rëndësie të madhe. Nëse Greqia bie nën kontrollin e një pakice të armatosur, pasojat mbi fqinjin e saj, Turqinë, do të jenë të menjëhershme dhe serioze. Hutimi dhe mungesa e rendit mund të përhapen në të gjithë Lindjen e Mesme.[...] Ne duhet të ndërmarrim veprime të menjëhershme dhe të vendosura. Prandaj i kërkoj Kongresit që të autorizojë ndihmën për Greqinë dhe Turqinë, në vlerë prej 400,000,000 dollarë, për periudhën që përfundon më 30 qershor 1948. [...] Përveç fondeve, i kërkoj Kongresit të autorizojë personelin civil dhe ushtarak amerikan për Greqinë dhe Turqinë, me kërkesë të këtyre vendeve, për t'i ndihmuar në detyrat e rindërtimit dhe mbikëqyrjes së shfrytëzimit të ndihmës ekonomike dhe materiale që mund t'iu ofrohen.[...] Popujt e lirë të botës na drejtohen për mbështetje për të siguruar lirinë e tyre. Nëse lëkundemi në udhëheqjen tonë, mund të rrezikojmë paqen e botës dhe pa dyshim do të rrezikojmë mirëqenien e kombit tonë. […]

http://avalon.law.yale.edu/20th_century/trudoc.asp, accessed on 21.09.2016.

II-12. Rivendosja e marrëdhënieve miqësore midis Turqisë dhe SHBA-së

OMë 23 shkurt 1945, Turqia nënshkroi traktatin e bashkëpunimit dhe ndihmës me SHBA-në. Ky veprim shënoi fillimin e rivendosjes së marrëdhënieve miqësore. Megjithatë, Partia Demokratike ishte ajo që në të vërtetë e bashkoi Turqinë me kampin proamerikan, në vitet '50. Turqia ishte e përfshirë në Planin Marshall, dhe kishte përfituar nga ndihma civile dhe ushtarake amerikane. Ajo u bë edhe anëtare e NATO-s (1952) dhe mori pjesë në luftën e Koresë (1950-1953).

A. Turqia i bashkohet NATO-s, në vitin 1952. Fjalimi i kryeministrit, Adnan Menderez

"Vendimi për pranimin e Turqisë në Aleancën Atlantike, si një anëtare me të drejta të barabarta, është mëse i mirëpritur. Kjo ngjarje pozitive duhet të konsiderohet si arritje e politikës joluftarake dhe të vendosur të qeverisë sonë, e mbështetur fuqimisht nga opinioni publik, si politika jonë kombëtare. Kjo ngjarje përbën një hap të ri dhe të rëndësishëm, për të arritur qëllimin e sigurisë së përbashkët në një mjedis demokratik, dhe si rrjedhim, bashkëpunimin dhe unitetin. Brenda kuadrit të Aleancës së Atlantikut me shtetet e tjera anëtare, bashkëpunimi do të bazohet në parimet e politikës sonë të jashtme, qëllimin e mirë, sinqeritetin dhe pacta sund servanda [marrëveshjet duhet të mbahen]".

Sarınay, 1988 (http://www.dunyabulteni.net/haberler/282594/turkiyenin-natoya-girisi-ve-yankilari, vizituar më 25.07.2016)

1. Shfrytëzoni njohuritë tuaja dhe shpjegoni arsyen përse Britania ishte e detyruar ta braktiste Greqinë në vitin 1947.

2. Cila ishte strategjia amerikane afatgjatë në Evropën Juglindore dhe në Mesdhe në vitet '40 dhe '50?

3. Shfrytëzoni njohuritë tuaja mbi aleancat e shekullit të 20-të dhe shpjegoni, duke iu referuar rastit të Turqisë, se si dy luftërat botërore dhe Lufta e Ftohtë ndikuan marrëdhëniet e pushtetit dhe ripozicionimi i disa vendeve.

B. Turqia dhe Greqia në Luftën e Koresë

Bakanlar Kurulunun dünkü tarihi kararı

Türkiye Koreye asker gönderiyor

Karar Birleşmiş Milletlere bildirildi

4500 mevcutlu Türk savaş birliği Koreye gönderilecek

AMERİKALI SENATÖRÜN MÜHİM BEYANATI

Türk askeri, kabiliyetlidir ve ustaca dövüşür. Türk askerine güveniyoruz

Hükûmetin tebliği

Marmarada

Titujt e gazetave:
Vendimi historik i djeshëm nga Kabineti
TURQIA DËRGON FORCA USHTARAKE NË KORE
Kombet e Bashkuara njoftuan se 4,500 ushtarë turq do të dërgohen në Kore.

http://www.dunyabulteni.net/haberler/282594/turkiyenin-natoya-girisi-ve-yankilari, vizituar më 25.07.2016.

Lufta në Kore shpërtheu më qershor të vitit 1950, kur forcat komuniste të armatosura të Koresë së Veriut, pushtuan Korenë Jugore, me pretekstin e ribashkimit të vendit. Në sajë të Luftës së Ftohtë, përmasa e konfliktit u zmadhua dhe përfundoi me ndërhyrjen e Shteteve të Bashkuara, të Bashkimit Sovjetik dhe Kinës. Në zbatim të Rezolutës së OKB-së, trupa edhe nga vendet Perëndimore u dërguan në mbështetje të Koresë Jugore. Turqia dhe Greqia, në përpjekje të fuqizimit të marrëdhënieve me kampin Perëndimor, morën pjesë në këtë ndërhyrje me 4.500 dhe 1.000 trupa secila. Kundërpërgjigja e armatosur e OKB/SHBA bëri që forcat e tyre të arrinin deri te kufiri kinezo-korean, përpara se kinezët të lëshonin kundërofensivën e tyre dhe ta vendosnin vijën e kufirit pak a shumë aty ku kishte qenë në vitin 1950. Lufta përfundoi në korrik të vitit 1953.

II-13. Greqia dhe Nato

Në tetor të vitit 1950, qeveria greke e qendrës, bëri kërkesë për anëtarësim në NATO, një pakt që sipas Ministrit të Jashtëm garantonte "sigurinë kolektive të popullit të lirë". Pas heqjes së kundërshtimeve britanike, një vit më vonë, një rezolutë e NATO-s parashikoi pranimin e Greqisë dhe Turqisë. Traktati i anëtarësimit u votua nga të gjitha partitë parlamentare, përveç së Majtës Demokratike të Bashkuar (EDA). Partia Komuniste e Greqisë (KKE) ishte shpallur e paligjshme në fund të vitit 1947.

A. Pjesë nga fjalimi i Kryeministrit Plastira, në Parlament për pranimin e Greqisë në NATO (18 shkurt, 1952)

Zotërinj, sot qeveria është e kënaqur, sepse me miratimin e njëzëshëm të projektligjit për pranimin e Greqisë në NATO, është konfirmuar një fakt i kënaqshëm dhe shumë i rëndësishëm. Me pranimin e vendit tonë, populli grek dhe sakrificat e tij janë nderuar, ashtu si edhe ushtria greke. Është një fakt shumë i rëndësishëm, sepse hapet një kapitull i ri [në historinë e Greqisë] dhe për arsye se vendi ynë është i mbrojtur nga çdo sulm, që mund të nisë ngado. Nuk mundemi veçse të pranojmë se pjesëmarrja e Greqisë në NATO, që përfshin vende të banuara nga popuj të lirë dhe demokratikë, e bën vendin të ndihet më i sigurt, pasi nuk është më i izoluar. Nuk mund të mos pranojmë se nga nesër Greqia siguron kufijtë e saj.

Është e pamundur që Greqia të ndjekë ndonjë politikë tjetër përveç asaj që kërkohet, sot më shumë se kurrë. Greqia duhet të jetë ndër vendet anëtare të NATO-s. Asnjanësia nuk përbën alternativë për ne

Dokos (bot.), 2013, fq. 38-40.

Komentoni frazën e mësipërme: "Asnjanësia nuk përbën alternative për ne." A jeni dakort me këtë deklaratë; përse?

B. Pjesë nga transmetimi i radiostacionit të KKE-së "Zëri i së vërtetës" në Bukuresht, 25 maj 1955

DUHET SHFUQIZUAR MARRËVESHJA E TRADHËTARËVE, E 12 TETORIT TË VITIT 1953

ATHINË. Shumica e njerëzve vazhdojnë t'i shtojnë përpjekjet e tyre për mbylljen e bazave ushtarake amerikane në Greqi, shfuqizimin e marrëveshjes së tradhtarëve të 12 tetorit [1953] dhe largimin e vendit tonë nga regjimi aktual i skllavërisë dhe varësisë së jashtme. Ngjarjet e fundit ndërkombëtare kanë përforcuar rezolutën e popullit në tërësi; madje edhe të politikanëve dhe personaliteteve të caktuara, , madje edhe të një pjese të klasës borgjeze , për të ndryshuar drejtimin e vendit drejt rrugës paqësore të pavarësisë dhe paqes, bashkëpunimit të barabartë me të gjithë vendet, pa baza të huaja ushtarake dhe detyrime ndaj aleancave agresive. Zemërimi i popullit kundër regjimit pushtues amerikan, po shkakton pasiguri të vërtetë në kampin [proamerikan], që i druhet edhe thjesht mendimit se mund të përfundojë pa mbështetjen e vetme që ka, që janë bajonetat dhe dollarët amerikanë.

ASKI (Arkivi i Historisë Shoqërore Bashkëkohore), Athinë.

Marrëveshja greko-amerikane për "Objektet ushtarake", e tetorit të 1953-it parashikoi krijimin e bazave ushtarake ajrore dhe detare amerikane në Greqi, "për zbatimin ose mbështetjen e planeve të miratuara të NATO-s". Dhjetë vjet më vonë, katër objekte të tilla amerikane ishin plotësisht funksionale; dy në ishullin e Kretës dhe dy të tjerë në rajonin e Atikës.

Përse anëtarët e KKE-së e cilësuan si marrëveshje tradhtare Marrëveshjen greko-amerikane për "Bazat ushtarake"?

II.4. LËVIZJA ANTIKOLONIALISTE NË QIPRO

II.4.1. Kërkesë për bashkim me Greqinë dhe reagimet

II-14. Pikëpamjet e Rauf Raif Denktashit mbi propozimet e Britanisë për autonominë, 5 qershor të vitit 1948

Për ne, qipriotët turq, ka të ngjarë që një fat shumë më i keq se ai që po na rrethon tani, mund të vijë nga vetëqeverisja, ose aneksimi. Jemi të sigurt se do të marrim përfitime të shumëfishta për një kohë të shkurtër brenda kuadrit të një sistemi administrativ që njeh të drejtat e pakicës turke. Të kemi sistemet tona!... A nuk është ajo që ne kemi dëshiruar gjithë këto vite? Të mos mbetemi nën pushtimin administrativ të shumicës Rum [qipriotë grekë]... A nuk është detyra jonë ta sigurojmë këtë, në rast se një lloj administrimi i tillë i imponohet ishullit? [...] Ne jemi pakicë. Duhet ta pranojmë vlerën e këtij fakti. Ne duam të drejtat që na takojnë.[...] Shqetësimi ynë nuk është të emigrojmë nga ky vend, por të forcojmë rrënjët tona në atdheun tonë, çdo ditë e më shumë, pavarësisht se jemi pakicë. Motoja jonë është të jetojmë si turq dhe të vdesim si turq në këtë tokë që na takon. Ne luftojmë për këtë qëllim dhe askush nuk do të mund të na shpërqendrojë nga ai.

Kızılyürek, 2016, fq. 94.

Në nëntor të vitit 1947, Guvernatori i Qipros, Lordi Winster Witherslack, iu kërkoi qipriotëve grekë dhe turq të merrnin pjesë në Asamblenë Kushtetuese. Kundërshtimi i vazhdueshëm i qeverisë britanike për të pranuar kërkesën e AKEL për vetëqeverim të plotë çoi në tërheqjen e këtij të fundit nga procedurat e asamblesë, që më pas, më 12 gusht 1948, u shpërbë. Nga ana tjetër, çështja kryesore për turqit qipriotë ishte mosnënshtrimi ndaj sundimit të shumicës qipriote greke. Kjo është arsyeja pse ata po e kundërshtonin idenë e Autonomisë aq sa edhe idenë e Bashkimit.

AKEL: Anorthotiko Komma Ergazomenou Laou (Partia Përparimtare e Punëtorëve), Partia Komuniste Qipriote Greke.

Rauf Raif Denktash (1924-2012), ishte avokat dhe politikan qipriot turk dhe një ndër themeluesit e TMT (Organizata e Qëndresës Turke). Pas pavarësisë së Republikës së Qipros (1960), Denktashi u zgjodh President i Dhomës Komunale Turke, ku mbajti një qëndrim nacionalist. Ai shërbeu si president i "Republikës Turke të Qipros Veriore" për më shumë se 20 vjet. Ishte kryenegociatori i qipriotëve turq në bisedimet e paqes, të nxitura nga OKB-ja, nga viti 1968 deri në vitin 2004. Në vitin 2002 dhe 2003, ai e hodhi poshtë projektin e dytë dhe të tretë të Planit të Ananit, propozimin për zgjidhje të hartuar nën autoritetin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Kofi Anan (shih vëll.2, Kap.III.1). Ai e kundërshtoi pa sukses në emër të qipriotëve turq projektin e pestë në prill 2004.

1. Si i karakterizon Denktashi qipriotët turq? Çfarë sistemi administrativ vlerëson ai si të përshtatshëm për ta?

2. Gjeni informacione për lëvizjen kundër kolonizimit në shekullin e njëzetë. Cilat koloni britanike u bënë shtete të pavarura dhe kur ndodhi kjo? Gjeni në hartën e botës territoret që i përkisnin Perandorisë Britanike, pas Luftës së Dytë Botërore.

II-15. "Plebishiti" për bashkimin me Greqinë, viti 1950

U bë e qartë se shumica dërrmuese e qipriotëve grekë po kërkonin bashkimin e ishullit me Greqinë. Më 15 janar të vitit 1950, kisha ortodokse e Qipros organizoi një "plebishit" për bashkimin me Greqinë (Enosis): 95.7 për qind e votuesve shprehën politikisht dëshirën e tyre për këtë bashkim. Qipriotët turq iu përgjigjën mbajtjes së "plebishitit" me organizimin e një sërë tubimesh, duke dërguar rezoluta në OKB dhe në organet qeveritare të Britanisë dhe Turqisë. Ata e dënuan Enosis, me arsyetimin se kjo do të çonte në shkatërrim ekonomik dhe luftë civile.

SOT është dita, dita e madhe, dita e ngjarjes së madhe kombëtare: Plebishiti. Ngushëllimi dhe shpresa, po shfaqen nga errësira e tiranisë. Të gjithë duhet të votojnë në këtë Plebishit. Çdo nënshkrim, çdo shenjë do të veprojë si një shpatë zemërimi dhe fitoreje. Toka që na lindi, toka greke, po shkelet nga shtypësit e huaj. Rrënjët e popullit tonë janë ende gjallë dhe kanë zgjuar brenda shpirtrave tanë, të kaluarën historike të helenizmit.

Gazeta *"Ethnos"*, 15 janar 1950.

1. Përse "plebishiti" u organizua nga Kisha e Qipros? Çfarë statusi kishte kisha dhe sa ndikim kishte ajo në politikë?

2. "Çdo firmë, çdo shenjë do të veprojë si një shpatë zemërimi dhe fitoreje."(dok. II-15). Çfarë nënkupton termi "zemërim"? Komentojeni gjuhën e përdorur në gazetë. Në atë kohë, cilët ishin "shtypësit"në Qipro?

II-16. Pulla greke në çështjen e Qipros (1954)

Një seri prej gjashtë pullash u shtypën në shtator të vitit 1954, me rastin e mbështetjes së qeverisë greke për të ngritur për diskutim përpara Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara çështjen "e parimit të të drejtave të barabarta dhe vetëvendosjes së popujve në rastin e popullit të Qipros". Pullat tregojnë një shenjë të zezë në procesverbalin e diskutimit parlamentar në Dhomën e Komuneve në lidhje me deklaratën e korrikut 1954 të qeverisë britanike për faktin se "territore të caktuara në Komonuelth", përfshirë Qipron, "kurrë nuk mund të pretendojnë të jenë plotësisht të pavarura".

http://greekstamp.blogspot.gr/2008/02/1954.html, vizituar më 3.09.2016.

Përse qeveria greke e bëri shtypjen e serisë së pullave? Çfarë simbolizojnë ato? Cili ishte përdorimi i tyre? A mund të gjeni pulla në vendin tuaj të lëshuara për qëllime propagandistike?

II.4.2. Pogromi kundër grekëve dhe jomyslimanëve të tjerë në Stamboll,1955

Pas bllokimit të Konferencës Tripalëshe mbi Mesdheun Lindor, mbajtur në Londër midis Britanisë, Greqisë dhe Turqisë, nga 29 gushti deri më 7 shtator të vitit 1955, Shërbimi Sekret Turk nxiti trazira kundër grekëve që shpërthyen në Stamboll dhe Izmir. Këto, së bashku me përshkallëzimin e konfliktit greko-turk mbi Qipron nën administrimin e Britanisë, krijuan një situatë marrëdhëniesh të tendosura mes këtyre dy vendeve anëtare të NATO-s. Më 6 dhe 7 shtator, të vitit 1955, në Stamboll u kontrolluan 5,300 ndërtesa, sipas të dhënave zyrtare (sipas të dhënave jozyrtare, numri i banesave të kontrolluara ishte 7.000). Viktimat ishin kryesisht grekë, por u prekën edhe pjesëtarët e komuniteteve armene dhe hebreje. Duket se trazirat ishin planifikuar nga shërbimet sekrete turke dhe u zbatuan në bashkëpunim me shoqatat e të rinjve dhe studentëve dhe me organizatën "Qiproja është turke".

Më 28 shkurt të vitit 1956, parlamenti turk votoi për kompensimin e qytetarëve, që iu bastisen bizneset dhe shtëpitë. Por në fakt, dëmshpërblimet e ofruara ishin të ulëta, por kryesorja, ata që ishin përgjegjës për trazirat nuk u dërguan para drejtësisë. Si pasojë e trazirave, mijëra jomyslimanë, kryesisht grekë, u detyruan të largoheshin nga Turqia. Pas grushtit të shtetit nga ana e ushtrisë në vitin 1960 në Turqi, Kryeministri Menderes dhe Presidenti Celal Bayar, u akuzuan për "ngjarjet e shtatorit", si një përpjekje për të treguar se vetëm anëtarët e Partisë Demokrate ishin përgjegjës për trazirat (shihni kapitullin III.2.1).

II-17. Kujtimet e dëshmitarëve okularë

A. "Ata erdhën me një kamion plot me gurë"

Shumë, shumë keq. Isha e martuar në atë kohë, Lula ishte dy vjeç. Ne ishim në shtëpinë tonë verore, në Jenimahalle [Sarıyer]. Nga Stambolli erdhën lajme se Bejoglu po digjej. Ishte rreth orës tetë, tetë e gjysmë. Erdhi një kamion i mbushur me gurë. 10-15 vetë zbritën nga kamioni, hynë fillimisht me forcë në tavernë, nuk lanë asgjë pa kthyer përmbys. Ne u mblodhëm në një vend, aty ishte edhe punonjës i kishës, me gruan dhe djalin e tij; atje ishte edhe prifti me bijat dhe gruan e tij. Ata filluan të thyejnë dritaret nga jashtë, për të hedhur gurët. Ndërkohë që ne shqetësoheshim dhe mendonim se çfarë të bënim, ra nata. Një familje turke jetonte në pjesën e pasme të shtëpisë, ata e dinin mirë se çfarë do të ndodhte. Ata menjëherë morën vajzat e priftit nga dritarja.

B. "Na është dhënë leje për të shkatërruar, jo për të vrarë"

E vura Lulën nën dyshek, nga frika se mos ata e vrisnin fëmijën. Binte breshëri gurësh. Ata erdhën në derën e përparme. E rrëzuan përdhe atë. Babai im menjëherë hapi derën e dhomës. Ai iu foli turqisht si një turk i vërtetë. "Do t'i shkatërrojmë", tha ai. "Për Qipron ia vlen, për atdheun", njerëzit po vërshonin brenda duke bërtitur. "Më vrit mua, gruan time, vajzat e mia", tha babai im. "Jo, nuk na është dhënë leje për të vrarë", u përgjigjën ata, "kemi leje vetëm për të shkatërruar". Ata e pyetën për emrin e tij; "Qemal", tha babai im. Ata thanë: "Kërkojmë falje, vëlla Qemal", dhe u larguan. Ata shkuan në dyqanin ushqimor, dhe shitësi iu tha: "Cili Qemal? Ai quhet Koço, është grek". Ata u kthyen. Hodhën radion dhe frigoriferin nga dritarja. Dyshekët, rrobat; e zbrazën dollapin e rrobave.[…] Ne po dridheshim. "Bëjeni copë e çikë vendin", tha babi im, çfarë mund të bënte ai? "Thyejeni, hiqeni, ia vlen, hidheni larg!". Ata shkatërruan [gjithçka] dhe u larguan. Pyetën për vajzat e priftit. Ne u përgjigjëm: "Ato nuk janë këtu". Ata e morën priftin, e lidhën në një motor, dhe e tërhoqën atë zvarrë gjatë gjithë rrugës.

Në të njëjtën kohë, burri i F. S. u largua nga Sirkeci, për t'u kthyer në shtëpi. "Atë natë, burri im ishte në punë. Ai erdhi në orën tre; erdhi në këmbë nga Sirkeci në Jenimahalle. Kur po kthehej në shtëpi, ai po thyente [gjithçka që mund t'i dilte përpara]; Çfarë mund të bënte ai? Ata që nuk bënin veprime të tilla quheshin kaur [jomyslimanë]". (Nga intervista me F.S., shtëpiake, 74 vjeçare, në kuadër të projektit "Një mijë dëshmitarë të mbijetuar për historinë").

http://www.radikal.com.tr/haber.php?haberno=163380, vizituar më 3.09.2016.

1. Përse burri i saj shkatërronte çdo gjë që i dilte përpara gjatë kthimit në shtëpi? Çfarë po ndodhte dhe për çfarë arsye?

2. Gjeni materiale pamore për pogromin kundër jomyslimanëve në Stamboll, në shtator të vitit 1955.

3. Gjeni krijime letrare ose kinematografike nga pogromi i shtatorit shtatorit (për shembull, filmi "Dhimbjet e Vjeshtës", nga Tomris Giritlioglu, trajlerin mund ta shikoni këtu: http://cine.gr/ trailer.asp?id=712282, vizituar më 3.09.2016).

4. Gjeni informacion mbi mënyrën se si këto fakte u paraqiten nga media turke, ajo greke dhe ajo ndërkombëtare, dhe krahasojini me burimin II-18.

5. Si lidhen "Ngjarjet e shtatorit" me çështjen e Qipros?

II-18. Dita e nesërme pas pogromit

Arkivi i fotografive të Sekretariatit të Përgjithshëm të Medias dhe Komunikimit,Athinë; https://www.youtube.com/watch?v=OsUa078S_k0, vizituar më 3.09.2016.

II-19. Reagimet e myslimanëve gjatë trazirave

A. Ndihma e fqinjëve, duke sulmuar të tjerët

Shtëpia jonë ishte në Rrugën Kaljoncu në rrethin Bejoglu [në pjesën evropiane të Stambollit]. Kur shpërthyen ngjarjet e dhunshme, portieri Mehmet i tha nënës: "Mos kini frikë, fshihuni në banesën tonë". Ai mori një flamur turk, mbylli portën e rrugës dhe qëndroi para bllokut të banesave. Kur erdhën sulmuesit e parë, ai u tha atyre se asnjë grek nuk jeton këtu dhe me të vërtetë që burrat u larguan pa e shkatërruar godinën. Mehmeti, që kishte mbrojtur znj. Katina armene të katit të dytë, Marian e katit të tretë dhe Antonisin e katit të katërt, më vonë doli nga shtëpia dhe si hodhi flamurin turk, rrëmbeu një copë dru dhe filloi të "sulmonte" dyqanet dhe shtëpi të bukura të jomyslimanëve në anën tjetër të rrugës. E pashë nga dritarja e shtëpisë tonë.

Intervistë me M. Vassileiadis, në Gyven, 2005, fq. 48.

Si do e karakterizonit sjelljen e Mehmetit? Si e shpjegoni faktin që shpëtoi fqinjët e tij jomyslimanë, ndërkohë që sulmonte qytetarë të tjerë jomyslimanë dhe pronat e tyre? Përse veproi kështu ai?

B. Një turk që shpëtoi kishën nga shkatërrimi

Grupi i demonstruesve mbërriti në portat e kishës [të Panagisë] dhe u përpoqën t'i hapnin ato me leva hekuri. Megjithatë, për fat të mirë, një tregtar turk me disa bashkëpunëtorë, u ndesh me ta duke iu bërtitur dhe lutur në mënyrë të vazhdueshme, dhe i ndali ata, dhe si përfundim kisha e bukur e komunitetit të krishterë të Beshiktashit u ruajt nga një mrekulli.

Vryonis, 2005, fq. 148-9

II.4.3. Konflikte midis komuniteteve

Në vitin 1955, krerët greko-qipriotë vendosën të merrnin armët kundër sundimit britanik në ishull dhe krijuan organizatën e fshehtë EOKA. Gjenerali Grivas u bë udhëheqësi i EOKA-s. Qipriotët-turq u përgjigjën, duke krijuar organizatën e fshehtë dhe të armatosur TMT, që pretendonte se "Qiproja i përkiste Turqisë" dhe kërkoi ndarjen e Qipros. Kyçyk dhe Denktash u bënë udhëheqës të komunitetit turko-qipriot. Gjatë vitit 1958 pati konflikte të përgjakura, si dhe trazira brenda çdo komuniteti.

II-20. Nxënësit qipriotë-grekë duke demonstruar në përkrahje të ENOSIS [Bashkimit], 1957

Zyra e shtypit dhe komunikimit, Koleksion privat i Takis Ioannidis, Republika e Qipros.

EOKA: Ethniki Enosis Kyprion Agoniston [Bashkimi Kombëtar i Luftëtarëve Qipriotë], është organizata e krahut të djathtë që udhëhoqi luftën antikolonialiste në Qipro nga viti 1955 deri më 1959. Për politikën e EOKA shihni Librin e Punës 2, 2009, fq.117.

Pse mendoni se nxënësit marrin pjesë në tubime për çështje kombëtare? A keni marrë pjesë ndonjëherë në një tubim të tillë? Nëse po, shkruani një raport për përvojën tuaj.

II-21. Fletushkë e komisionit të dy-komuniteteve, që bën thirrje për ruajtjen e paqes dhe pajtimit, viti 1956

THIRRJA E KOMITETIT PËR RUAJTJEN E PAQES MIDIS GREKËVE DHE TURQVE

Me anë të kësaj thirrje dhe me urdhër të të pranishmëve, nënshkruesit, që përbëjnë Komitetin për Ruajtjen e Paqes midis Grekëve dhe Turqve, i zgjedhur në mbledhjen e përgjithshme dhe përfaqësuese të dy komuniteteve të qytetit tonë, të mbajtur në Bashki më 29 maj të 1956-s, deklarojnë dhe bëjnë thirrje për të gjithë bashkëqytetarët tanë, si në vijim:

Ne jemi thellësisht të pikëlluar nga ngjarjet e dhimbshme që kanë ndodhur në qytetin tonë, që sollën cenimin e marrëdhënieve paqësore mes dy komuniteteve.

1. Ne dënojmë me vendosmëri çdo formë dhune, pavarësisht origjinës së saj.

2. Në parim, ne besojmë se çdo qipriot, qoftë grek apo turk, duhet të veprojë me qëllimin e vetëm të parandalimit dhe pengimit të veprimeve të ngjashme në të ardhmen.

3. Ne të gjithë duhet të kuptojmë se nuk ka vlerë dhe bekim më të madh në një vend se sa bashkëjetesa paqësore e banorëve të tij, edhe në rast se ka dallime politike.

4. Ne iu bëjmë thirrje qytetarëve tanë që të vlerësojmë seriozisht pasojat e shkatërrimit që do të ndodhë nëse lejojnë përsëritjen e një keqqeverisje të tillë dhe ne iu bëjmë thirrje të gjithëve që të përpiqen për të mirën e Qipros, dhe të jetojnë me moton: Larg urrejtjes racore. Dashuria, bashkëpunimi ekonomik dhe bashkëjetesa paqësore të zotërojë mes grekëve dhe turqve.

Me nismën e qipriotëve grekë dhe turq, që besonin në bashkëjetesën paqësore të të dy komuniteteve, në vitin 1956 në Limasol u formua komiteti i përbërë, me qëllim rivendosjen e paqes në prag të përplasjeve midis komuniteteve që kishin shpërthyer për shkak të ekzekutimit të një polici qipriot turk nga EOKA. Zhvillimet e mëvonshme do t'i mënjanonin përppjekje të tilla. Konfliktet morën një karakter më të përgjithshëm dhe ata që ishin në mbështetje të mirëkuptimit dhe bashkëjetesës paqësore midis dy komuniteteve mbetën të izoluar.

Duke marrë parasysh situatën e tensionuar mes dy komuniteteve, sa ndikim mund të këtë thirrja e mësipërme në shoqërinë qipriote?

II-22. Betimi i anëtarëve të rinj të TMT-së, 1957

Organizata Turke e Qëndresës (TMT) ishte organizata qipriote turke e themeluar në vitin 1957. Objektivi kryesor i saj ishte promovimi i ndarjes së ishullit me anë të forcave ushtarake.

Për jetën dhe lirinë e qipriotit turk, shpirtin e tij, pasurinë dhe të gjitha llojet e traditave dhe ritualeve. Unë ia kam përkushtuar veten kombit turk, që ai t'iu rezistojë shkeljeve kudo dhe nga kushdo që do të vijnë. Edhe nëse shkoj drejt vdekjes, do ta përmbush çdo detyrë që më është caktuar. Çdo gjë që unë njoh, shoh, dëgjoj dhe besoj, do ta vlerësoj më shumë se jetën ime dhe do t'i ruaj ato deri në fund. Unë nuk do t'i tregoj askujt atë që kam parë, dëgjuar, ndjerë dhe besuar. Unë e di se të tregosh diçka të tillë konsiderohet tradhti dhe dënimi është me vdekje. Unë premtoj dhe betohem për nderin, dinjitetin dhe për gjithçka që kam të shenjtë, që do t'iu qëndroj besnik parimeve të mësipërme.

Keser, 2007, fq. 443.

Krahasoni thirrjen e Komitetit për Ruajtjen e Paqes midis grekëve dhe turqve dhe betimin e dhënë nga anëtarët e TMT-së. Analizoni fjalorin e këtyre dy burimeve. Cilat fjalë përdoren më shpesh në secilën?

II-23. Përshkallëzimi i dhunës ndërkomuniteteve dhe i dhunës politike në vitin 1958

Në vitin 1958, dhuna midis komuniteteve në Qipro u bë jashtëzakonisht e egër, duke arritur kulmin me vrasjen e tetë qipriotëve grekë pranë fshatit qipriot Gynyeli, më 12 qershor. "Masakra" u nxit nga shpërthimi i një bombe jashtë Zyrës turke të shtypit, në Nikosia pesë ditë më parë, që iu ngarkua EOKA-s, por u zbulua më vonë se ishte punë e anëtarëve të TMT-së. Në ndërgjegjen e përgjithshme të qipriotëve grekë, ngjarjet e vitit 1958 u konsideruan si "Ngjarjet e Shtatorit të Qipros" në kundërpërgjigje të pogromit të grekëve në Stamboll, në vitin 1955.

A. Mehmet Ali Tremeseli, një nga nxitësit kryesorë të dhunës në atë kohë, përshkruan ngjarjet e vitit 1958

Ato ditë, siç ndodh në ndeshjet e futbollit, të gjithë dëgjonin me padurim në radio për reagimin e ekipit të tyre ndaj golit që sapo kishte pësuar. Nëse nuk do të shënohet një gol morali bie dhe fjalë të ashpra do të lëshohen kundrejt ekipit humbës.

Kızılyürek, 2015, fq. 13.

Pse mendoni se shkrimtari përdor fjalor me terma nga fusha e futbollit, për të përshkruar konfliktet midis komuniteteve në Qipro? Cili mund të ishte një nga qëllimet në këtë situatë? Komentoni fjalinë e mëposhtme: Nëse nuk do të shënohet një gol, morali bie dhe fjalë të ashpra iu drejtohen ekipit humbës.

B. Tregimi i Andreas Stavrou

Babai im Hristodoulos dhe xhaxhai im Petros u vranë në Gynyeli. Në kohën kur isha pothuajse një djalë dyvjeçar. Nëna ime ishte 28 vjeç dhe kishte pesë fëmijë. Pasojat e kësaj historie janë më të dhimbshme se thjesht ngjarja e masakrës.[…] Në Qipro çdo shtëpi ka të vrarët dhe të humburit e saj. Unë besoj se duhen bërë përpjekje që të mos ndodhin kurrë më ngjarje të tilla, familjet kurrë nuk duhet ta gjejnë veten në zi, kurrë më fëmijët nuk duhet të humbasin prindërit e tyre. Një situatë që të gjithë ne, për fat të keq, po e përjetojmë në shkallë të gjerë. Qipriotët turq dhe qipriotët grekë. […] Mënyra më e mirë për të kujtuar të vrarët është krijimi i kushteve të paqes, përparimit për vendin tonë; kjo është gjëja më e rëndësishme dhe më e vështirë [për t'u arritur]. Urrejtja është e menjëhershme; arritja e paqes është një përpjekje e mundimshme e shumë brezave, dhe jo vetëm e një të vetmi.

Kızılyürek, 2015, fq. 160-1.

"Mënyra më e mirë për të kujtuar të vrarët është krijimi i kushteve të paqes, përparimit për vendin tonë". Komentojeni këtë frazë.

Pse është kjo gjëja më e rëndësishme dhe më e vështirë për t'u arritur?

Diskutoni temën.

II-24. Aktiviteti antikomunist i kreut të EOKA-së, Georgios Grivas (pseudonimi si luftëtar "Digenis")

Në kontekstin e Luftës së Ftohtë, lufta antikolonialiste e EOKA-s kishte që nga fillimi karakter antikomunist, që u bë më i dukshëm në kohë. Kundërshtimi i AKEL-it ndaj luftës së armatosur, u përdor nga përfaqësuesi i krerëve të djathtë, Georgios Grivas, si pretekst për të akuzuar të Majtën si tradhtare. Në gjysmën e dytë të viteve '50, qipriotët grekë të majtë u rrahën dhe u masakruan nga anëtarët e EOKA-s. Përkatësisht, OTQ-ja, që ishte po aq antikomuniste, i përndoqi punëtorët qipriotë turq të krahut të majtë. 1958-a ishte viti që shënoi ngjarje të dhunshme etnike dhe politike. Në letrën e tij, Grivas i konsideron si kundërshtarë të tij: britanikët, qipriotët turq dhe komunistë.

Ne duhet ta përballojmë situatën me trimëri. Komunistët janë kundërshtarët tanë; e pëlqejmë apo jo, është e kështillueshme që t'i shkatërrojmë ata si një entitet politik, në mënyrë që të mos jenë më një faktor që ndikon në çështjen kombëtare! […] Sido që të jetë, unë po përgatitem që të përballem me këta kundërshtarë edhe duke përdorur forcën.

Grivas për Anthimon (25 janar 1958), cituar in Mihail, 2012, fq. 19.

Cilët i cilësonte EOKA si kundërshtarët e saj? Çfarë tregon kjo për sa i përket ndërlikimit të Çështjes së Qipros?

II-25. "Varri" i çështjes së Qipros, 1959

Pas një lufte katërvjeçare të dhunshme antikolonialiste të drejtuar nga qipriotët grekë, në shkurt të vitit 1959, marrëveshjet e Zyrihut dhe Londrës, midis Britanisë, Greqisë dhe Turqisë siguruan që Qiproja të bëhej një republikë e pavarur brenda Komonuelthit britanik. Në Greqi, marrëveshjet u dënuan nga partitë e opozitës si një "tradhti e helenizmit".

A ka lidhje midis veprimtarisë së EOKA-s dhe themelimit të organizatës së armatosur sekrete TMT? Pse TMT-ja pretendonte se "Qiproja i përket Turqisë", ndërsa EOKA luftonte britanikët? Shpjegoni dhe diskutoni se si dhuna pati pasoja të tmerrshme, duke krijuar kështu një rreth vicioz, ndërsa autoritetet kolonizatore i mbështetën dhe përfituan nga konflikte të tilla etnike.
Shihni burimin II-23 dhe çelësin përkatës.

Kryeministri Konstantinos Karamanlis duke vendosur një kurorë në varrin e të vrarëve të "Çështjes së Qipros". Duke i shtrënguar dorën, Kryetari i Parlamentit i thotë atij: "Urime kryeministri im. Ne kemi besimin e kombit!" Me dorën tjetër, mban një pankartë që shkruan: "Parlamenti grek: 170 vota pro, 118 kundër". Ministri i Jashtëm Evangelos Averof, me lopatë dhe shat në dorë, është varrmihësi. Karikaturisti është Fokion Demetriades. →



Hatzivassiliou (bot.), 2000, fq. 143.

II.4.4. Pavarësia

II-26. Struktura e Republikës së Qipros – 1960

Nënshkrimi i Marrëveshjeve të Zyrihut dhe Londrës (Rezidenca Lankaster, 19 shkurt 1959) parashikonte themelimin e Republikës së pavarur të Qipros si një shtet integral territorial, ndonëse me elementë të dukshëm federativë, për sa i përket administrimit të tij. Pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor u ushtruan nga përfaqësues dhe në emër të dy komuniteteve më të mëdha etnike të ishullit. Megjithatë, menaxhimi i një sërë çështjesh vendimtare nga Dhomat e komuniteteve qipriote greke dhe turke ishte plotësisht i ndarë. Këto dy organe, që gëzonin pavarësi të plotë, kishin pushtet të dyfishtë (legjislativ dhe ekzekutiv), duke funksionuar kështu si mekanizma shtetërore paralele dhe të pavarura.



Pavlou, 2015, fq. 202.

Studioni grafikun dhe përshkruani parimet për sa i përket lidhjes midis dy komuniteteve, sipas së cilës u strukturua Republika e Qipros.

Sipas jush, a është kjo strukturë, siç paraqitet në grafik, e efektshme? Çfarë mund të jetë jofunksionale apo problematike?

II-27. Pikëpamja e gazetës qipriote-turke për themelimin e Republikës së Qipros, 1960

Komuniteti qipriot turk miratoi qëndrimin pozitiv ndaj themelimit të Republikës së Qipros. Bashkimi i ishullit me Greqinë u pengua dhe barazia politike me qipriotët-grekë u sigurua. Artikulli nxjerr në pah rëndësinë historike të shtetit të ri, si dhe rëndësinë e tij për jetën e qipriotëve-turq.

Gazeta "Halkin Sesi" [Zëri i Popullit], 15 gusht 1960

Sot është dita e fundit e administratës kolonizatore në Qipro. [...] Nata e 15-16 gushtit ka një rëndësi historike për Qipron. Së pari, administratës kolonizatore të 82 viteve po i vjen fundi dhe se ishulli do të qeveriset menjëherë nga një qeveri e përbërë nga qipriotët. Në këtë administratë, qipriotëve turq iu janë dhënë të drejta partneriteti me kushte të barabarta. 30 për qind e zyrtarëve të shërbimit publik do të jenë qipriotë turq. […]

Pavarësisht të gjitha presioneve, komuniteti turk

mbijetoi; ai e ruajti karakterin e tij dhe ndërgjegjen kombëtare. Nëse vazhdon të ketë të njëjtin mobilizim dhe të bëjë të njëjtat përpjekje, ka shumë gjasa që ai ta ruajë ekzistencën e tij dhe të vazhdojë të mbijetojë në këto troje. Në të njëjtën kohë, nëse do të kemi ndihmë kulturore dhe ekonomike nga atdheu ynë, mund të themi se eardhmja jonë duket pa dyshim premtuese.

Cili ishte reagimi qipriot-turk për themelimin e Republikës së Qipros? A ishte pozitiv apo negativ? Cila ishte deri më tani gjendja e qipriotëve turq? Gjeni referencat në burimin dhe çelësin dhe paraqisni argumentet tuaja.

II.4.5. Shpërthimi dhe përshkallëzimi i dhunës

Periudha prej 21 dhjetorit të 1963-it deri më 10 gusht të 1964-ës ka qenë më e dhunshmja në konfliktin midis komuniteteve. Sipas opinionit zyrtar të palës qipriote greke, kjo periudhë dëshmoi rebelimin e ekstremistëve qipriotë turq që synonin ndarjen (Taksim). Nga ana e tyre, qipriotët-turq i i interpretuan ngjarjet si një sulm qipriot-grek, sipas planit të Akritas, duke synuar rishikimin e traktateve të vitit 1960 dhe për pasojë deklaratën e bashkimit me Greqinë. Në kundërshtim me ngjarjet e vitit 1958, në këtë konflikt viktima të shumta pësoi pala qipriote-turke.

II-28. Harta etnografike e Qipros në kohën e pavarësisë (1960)



Riprodhuar sipas hartës së përgatitur nga Departamenti i Tokave dhe Sondazheve me sanksionin e Qeverisë së Republikës së Qipros, të gjitha të drejtat e shtetit të rezervuara.

Pasoja më e pafavorshme e shkatërrimit të shtetit dy komunitetësh ishte vendosja e popullsisë qipriote turke në "zona të sigurta". Para konfliktit të 1963-64-ës, qipriotët turq u shpërndanë në të gjithë ishullin (shihni hartën). Pothuajse 25,000 qipriotë turq ishin të detyruar të shpërnguleshin në "zonat e sigurta", që ishin krijuar në rrethinat e fshatrave me popullsi krejtësisht turke, ose në zonat turke të katër qyteteve më të mëdha të ishullit (Nikosia, Famagusta, Larnaka dhe Pafos). Këto zakonisht ishin zona nën kontrollin ushtarak të Turqisë dhe quheshin "enklava". Jeta në këto enklava ishte shumë e vështirë, pasi një numër i madh i qipriotëve turq u strehuan në kasolle të përkohshme, të ndërtuara me mbështetjen e Gjysmëhënës së Kuqe dhe Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR). Me kalimin e kohës, shumë nga kufizimet u zbehën dhe shumica e tyre u shfuqizuan në mars të vitit 1968, kur rifilluan bisedimet midis dy komuniteteve.

←

II-29. Jeta në enklava (përshkrimi i procesit të synetit)

Një "Pasha" erdhi në fshat. Ai ishte "Komandanti i luftëtarëve", që erdhi nga Turqia dhe bashkëpunoi me TMT-në. Ky "Pasha" kishte autoritet absolut. Pavarësisht fushatës sistematike që Rauf Denktash kishte ndërmarrë që nga viti 1958 me moton"Patriotë, Flisni turqisht" (Vatandaş Türkçe Konus), banorët e Louroujina [Akıncılar] vazhdonin të flisnin pak turqisht. Natyrisht "Pashai" u shqetësua shumë për këtë: "Ju Apostatet [Ulen Murtatlar; Jo myslimanë të pastër!", bërtiti ai, dhe të gjithë u drodhën.[…]

Po i afrohesha moshës shkollore, kur "Pashai" vendosi që të organizohej një "Festë e madhe për Synetin" për të gjithë fëmijët refugjatë. Për shkak të problemeve midis dy komuniteteve të vitit 1964 dhe shpërnguljes të mëvonshme të banorëve, shumë djem nuk ishin bërë synet. Në fakt, shumë prej tyre e kishin kaluar moshën kur praktikohet normalisht syneti. Në traditën patriarkale islamike turke, ceremonia e synetit simbolizon fillimin e "mashkullorësisë" dhe në mjedisin ushtarak ku ne jetonim, ajo lidhej me imazhin e "burrit si ushtar".

Në një park në fshat, u ngritën flamuj turq dhe u varën tullumbace. Ngadalë, djemtë që do të bëheshin synet u mblodhën me familjet e tyre. Djemtë ishin veshur me uniforma të bardha dhe kishin vënë në kokë një kapele të bardhë. Ata u radhiten në një vijë, njëri pranë tjetrit. Shprehja e ngazëllyer e fytyrës së tyre nuk mund ta fshihte ankthin për atë që do të ndodhte. Megjithatë, askush nuk kishte guximin ta pranonte këtë, madje as t'ia kujtonte vetes që po dridhej nga frika.

Njerëzit vinin vërdallë, duke dëgjuar muzikën e orkestrës. Baballarët dhe nënat krenare, të veshur si për festë, nuk mund ta fshihnin entuziazmin e tyre. Pa dyshim, kjo ishte një atmosferë vërtet festive. Megjithatë, kur po afrohej "momenti i madh", ne, fëmijët, ishin të paduruar siç janë kafshët përpara tërmetit. Të shoqëruar nga melodité e tambureve dhe klarinetave, po prisnim secili radhën që të përballeshim me tehun kërcënues që mbante "mjeshtri i synetit". Teksa po na afrohej radha, po na kapërcente frika. Në çastin kur u ngrit tehu përpara nesh, i kishim harruar të gjitha "bekimet" dhe premtimet që "do të bëheshim burra dhe luftëtarë". Djemve, që e duruan "prerjen", para se t'ua lidhnin plagën iu dhanë një llokum [ëmbëlsirë turke]. "Pashai" na mbikëqyri të gjithëve një nga një (nuk më kujtohet nëse na la nga një dhuratë) dhe ne, djemtë e bërë synet, tashmë ishim bërë "luftëtarë".

"Τα Πέτρινα Χρόνια των Τουρκοκυπρίων, 1964 –1974" [Vitet e gurtë të qipriotëve turq, 1964=1974], dëshmi personale nga Niyazi Kızılyürek..

1. Si ndiheshin djemtë në këtë burim dhe pse? Pse ishte kjo "Festë e synetit" aq e rëndësishme për ta? Çfarë lidhje ka kjo ceremoni me periudhën e përshkruar?

2. Shpjegoni pse djemtë u konsideruan si luftëtarë pas bërjes synet. Si e komentoni barazimin e burrërisë me të qenit një luftëtar?

II-30. Karikaturë e "Daily Express" për palën e qipriotëve-grekë që kryesonte në luftën midis komuniteteve, të viteve 1963-64

Botuar në "Daily Express" në Londër, në vitin 1964, kjo karikaturë mund të konsiderohet profetike në aspektin e asaj që ndodhi gjatë viteve të ardhshme.

Karikaturë nga Michael Cummings, gazeta "Daily Express", 2 mars të vitit 1964.

Përshkruajeni karikaturën. Çfarë tregon ajo? Pse po zhyten qipriotët turq? Si përfaqësohen qipriotët grekë? Cilës palë i bashkohet karikaturisti (nëse është rasti) dhe pse? A mund të luante ndonjë rol nacionaliteti i tij?

II-31. "Ngjarja" e Kofinut, 1967

"Ngjarja" e Kofinut, më nëntor të vitit 1967, përbën një nga pikë-kthesat e historisë së Qipros. Anëtarët e Gardës Kombëtare, sipas udhëzimeve të Georgios Grivas, hynë në fshatin qipriot turk Kofinu dhe vranë 24 burra, gra dhe fëmijë qipriotë turq. Divizioni grek i dërguar në mënyrë të paligjshme në Qipro në vitin 1964, u tërhoq. Në janar të 1968-s, Presidenti Makarios deklaroi për herë të parë se bashkimi me Greqinë, megjithëse i dëshirueshëm, nuk mund të realizohej. Në bazë të kësaj politike, ai fitoi rizgjedhjen me shumicën dërmuese të votave (95%). Bisedimet midis dy komuniteteve, për zgjidhjen e çështjes së Qipros filluan në vitin 1968 dhe vazhdojnë deri në ditët e sotme.

Dëshmia e komandantit Marios Tempriotis, që mori pjesë në operacionet për "asgjësimin" e enklavës së Kofinut (15-16 nëntor 1967)

Unë po kryeja shërbimin e detyrueshëm ushtarak në Gardën Kombëtare [qipriote greke] gjatë krizës së Kofinut. Para ngjarjes, grupi ynë u vendos në zonën e Skarino, në pritje të urdhrave. Komandanti ynë na tha: "Shkoni në fshat dhe mos lini asnjë pulë të gjymtuar të gjallë, vritni gjithçka". Ndërkohë, qipriotët turq e kishin evakuar fshatin, përveç disa "luftëtarëve" të rinj dhe shumicës së grave, fëmijëve dhe të moshuarve. Ne, e sulmuam fshatin pa mëshirë dhe ndërmorëm një operacion pastrimi, duke bastisur çdo shtëpi. Mora një luftëtar të plagosur pesëmbëdhjetëvjeçar dhe ia dorëzova komandantit tim. "Na, merre dhe

zhduke këtë", tha ai. "Ai është një ushtar i plagosur, ne nuk mund ta vrasim atë", protestova unë. Nuk mund të pajtohem me vrasjen e këtij luftëtari; e admirova për guximin e tij. Rreshteri ynë e drejtoi armën e tij për nga i riu dhe donte ta vriste. Unë shkova para tij dhe i thashë: "Ti duhet të më vrasësh mua të parin." Si përfundim, mendoj se ai [luftëtari] u dërgua në spital. Gjëra të tmerrshme ndodhën gjatë sulmit. [...]Ushtarët [qipriotë grekë] plaçkitën të gjitha shtëpitë. Duhet ta pranoj, mora dy tavlla duhani të vogla dhe një flamur turk. Pashpirtësia që pashë në Kofinu ndryshoi jetën time. Pas ngjarjes, mendimet e mia ndryshuan në mënyrë dramatike. Në atë kohë, për ne emërtimi "turk" përfaqësonte barbarizmin dhe prapambetjen. Ata nuk kishin të drejta mbi këtë ishull .

Ata erdhën këtu gjatë periudhës së sundimit otoman dhe duhet të ktheheshin në Turqi. Ata ishin armiku ynë kombëtar. Ata nuk kishin të drejta në ishull. Pas ngjarjes së Kofinut, pikëpamjet e mia kishin pësuar transformim të plotë.

Marios Tempriotis intervistuar nga Niyazi Kızılyürek në fshatin Kofinu, më 18 prill 2014.

Pse sulmi i Kofinut pati një ndikim kaq të thellë te Mario Tempriotis? Çfarë mendoni ju e bëri atë të ndryshojë pikëpamjet e tij për qipriotët turq? Duke lexuar dëshminë e tij,a mund të themi se sulmi i Kofinut ndryshoi edhe pikëpamjet e Marios për njerëzit e tij, për qipriotët grekë?

II.5. NATO, TRAKTATI I VARSHAVËS DHE LËVIZJA E VENDEVE TË PAANGAZHUARA

NATO u themelua më 4 prill të vitit 1949 në Uashington, me nënshkrimin e Traktatit të Atlantikut të Veriut nga: Belgjika, Holanda, Luksemburgu, Franca, Britania e Madhe, SHBA-ja, Kanadaja, Portugalia, Italia, Norvegjia, Danimarka dhe Islanda. Shtabi i NATOS-s është në Bruksel. Një pikë kyçe në këtë traktat është neni 5, që parashikon mbrojtjen kolektive në rast të një sulmi të armatosur kundër një ose më shumë vendeve nënshkruese të traktatit. Megjithëse nuk u përcaktua qartë, në atë kohë "i dyshuari kryesor" ishte Bashkimi Sovjetik dhe shtetet komuniste të të ashtuquajturës "Perdes së Hekurt". Traktati i Varshavës ishte një Aleancë ushtarako-politike e këtyre shteteve, që u arrit më 14 maj 1955, me nënshkrimin e Traktatit të Miqësisë, Bashkëpunimit dhe Ndihmës së Ndërsjelltë – për këtë arsye edhe emërtimi i saj zyrtar është Organizata e Traktatit të Varshavës. Ajo u themelua për t'iu përgjigjur në mënyrë të drejtpërdrejtë kërcënimit të perceptuar ushtarak nga"Perëndimi kapitalist" dhe "rimilitarizimi" i saj dhe përfshirja e Gjermanisë Perëndimore në NATO. Traktati i Varshavës përbëhej nga: Bashkimi Sovjetik, Bullgaria, Gjermania Lindore, Polonia, Rumania, Çekosllovakia, Hungaria dhe (deri në 1968) Shqipëria. Organizata e Traktatit të Varshavës u shpërbë zyrtarisht në qershor të vitit 1991.

II.5.1. NATO kundër Traktatit të Varshavës

II-32. Pjesë nga raporti i ambasadorit hungarez në Bukuresht për pasojat e "ngjarjeve hungareze" në Rumani dhe veçanërisht të pakicës etnike hungareze, janar 1957

Ngjarjet në Hungari kanë pasur një efekt të rëndësishëm [...]. Dihet se [...]gjithë popullsia e Transilvanisë i ndjek lajmet nga Hungaria gjatë gjithë kohës dhe se shumica e tyre janë abonuar në gazetat hungareze. [...]Menjëherë pas fillimit të vitit shkollor akademik, studentët rumunë shfrytëzuan takimet, posaçërisht për zgjedhjen e Udhëheqësve të Bashkimit të Rinisë Punëtore [...]që të kërkonin përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës [...]si dhe të siguronin se inxhinierët e rinj pas shkollimit do të gjenin punë dhe pagat e tyre do të rriteshin [...].Protestat e studentëve i befasuan drejtuesit e universiteteve dhe organizatat e partisë. Ata premtuan se do të merrnin masat e duhura [por përfundimisht studentëve iu tha se] gjendja aktuale ekonomike e vendit kërkon sakrifica nga të rinjtë [...]. Artikujt e botuar në shtyp ngrinin haptazi ankesat e hungarezëve të Transilvanisë, si dhe trajtonin gabimet që janë bërë për sa i përket politikave të kombësive.

Shumë prindër pyesin nëse është e mundur t'i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollat dhe universitetet hungareze [...].U hapën më shumë shkolla hungareze [...] dhe u miratua botimi i një reviste kulturore dhe një tjetër reviste për fëmijë në gjuhën hungareze. Policia arrestoi disa studentë [...].Qeveria e ktheu përsëri në punë shumicën e punonjësve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që ishin shkarkuar disa javë më parë. Në objektet industriale, u punësuan si punëtorë qytetarët që kishin qenë punonjës të Ministrisë së Mbrojtjes. Në rrugë forcat policore u përforcuan dhe punonjësit e Ministrisë së Mbrojtjes, që kishin biçikleta, organizonin patrullime. Të huajve dhe diplomatëve, iu mohua hyrja në Transilvani dhe u dyfishua mbikëqyrja në të gjithë rajonin.

Në disa zona të Transilvanisë, udhëheqësit vendorë e bënë popullsinë hungareze të dyshojë, duke iu bërë thirrje atyre të tregoheshin vigjilentë, teksa kapitalistët dëshironin ta rivendosnin autoritetin e tyre, ndërsa midis popullsisë rumune qarkullonin thashetheme se vigjilenca ishte e detyrueshme për shkak se hungarezët po kërkonin ta rifitonin Transilvaninë. Përveç disa masave të menjëhershme dhe të ashpra, qeveria rumune bëri edhe disa lëshime. Më 29 tetor u miratua një vendim në lidhje me rritjen e pagave dhe pensioneve dhe dhënien e një subvencioni familjar [...].Këto patën ndikim të madh te popullsia. Kishte zëra që thoshin se të gjitha këto u arritën nga hungarezët për interes të punëtorëve rumunë[...].Duke marrë parasysh situatën reale, qeveria rumune u detyrua [...] të ishte e "qetë" me turmën e pakënaqur, duke zbatuar masa drastike për ata që e cenonin rendin publik [...].

Andreescu et al, 2003, fq. 246-249.

Çështja në Transilvani (një rajon tradicionalisht i kërkuar nga Rumania dhe Hungaria) kishte disa ndërlikime: Krerët e Partisë Rumune të Forcës Punëtore, kishin frikë se protestat e studentëve mund të çonin në humbjen e Transilvanisë për Hungarinë dhe në humbjen e besimit sovjetik tek Udhëheqësit e Rumanisë. Udhëheqësit rumunë vazhdimisht kanë ofruar shërbimet e tyre me qëllim shtypjen e rebelimit të antikomunistëve të Hungarisë të vitit 1956 (i quajtur në Perëndim "Revolucioni hungarez" dhe "ngjarjet hungareze" në Lindje). Trazirat e studentëve në zona të tjera të Transilvanisë (Bukuresht, Iashi) përfunduan me qindra arrestime dhe dënime. Veprimet shtypëse vazhduan edhe vitin e ardhshëm

II-33. Kundërpërgjigjet bullgare për sulmin ndaj Çekosllovakisë, 1968

Informacion tepër sekret!
Komandanti, Regjimenti i 12 i armatosur
Urdhri i Betejës Nr. 4
Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Popullore Bullgare,
Sofje, ora 20:00 , 19 gusht 1968

Sulmet e elementëve kundërrevolucionarë në Republikën Socialiste Çekosllovake kundër pushtetit të popullit, po bëhen gjithnjë e më të ashpra. Po rrezikohet fati i Partisë Komuniste dhe sistemi socialist në vend. Përpjekje të veçanta bëhen nga forcat reaksionare për ta tërhequr Çekosllovakinë nga Traktati i Varshavës dhe për ta pozicionuar atë kundër pjesës tjetër të vendeve socialiste. Për ta materializuar kundër-revolucionin, unë urdhëroj që regjimenti të vazhdojë të kryejë detyrat luftarake që i janë dhënë nga Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Përbashkëta të Armatosura të Traktatit të Varshavës (FPA) dhe të përmbysë elementët armiqësorë brenda afateve dhe rajoneve, sipas planit të veprimit. Të gjitha urdhrat dhe komandat e komandantit në krye të FPA-së, lidhur me këto detyra, do të kryhen me saktësi dhe pa hezitim.

Ministri i Ushtrisë Kombëtare të Mbrojtjes
Gjenerali i Ushtrisë, Dobri Dzhurov
Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Koloneli Semerdzhiev

http://1968bg.com/index.php?option=com_content&task=view&id=33&Itemid=20, vizituar më 4.09.2016.

II-34. Nikolai Çausheku dënon pushtimin sovjetik të Çekosllovakisë, 21 gusht 1968

Parimet e këtij fjalimi u përfshinë në një dokument zyrtar nga Asambleja e Madhe e Rumanisë, që iu dërgua të gjitha qeverive në botë dhe Kombeve të Bashkuara. Në Rumani, frika e një kërcënimi ushtarak çoi në rivendosjen e rojeve patriotike, që ishin shfuqizuar në vitin 1962, dhe në përfshirjen në Kushtetutë të një neni që përcaktonte se asnjë agjenci shtetërore nuk mund të njohë shkëputjen e një rajoni që është pjesë e shtetit kombëtar. Refuzimi i Çausheskut për t'u bashkuar me pushtimin e Çekosllovakisë prej Paktit të Varshavës u interpretua nga udhëheqja sovjetike si mosbesim dhe si shenjë e një politike gjithnjë e më nacionaliste. Në rrethana të tilla, shumë njerëz, hezitues deri atëherë, u bashkuan me Partinë Komuniste, ose të paktën iu përmbaheshin politikave të saj.

A. A. Çaushesku, duke mbajtur fjalim në ballkonin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Rumanisë

Foto #G512, Fototeca online a comunismului românesc [Fototekë online e Komunizmit në Rumani] (17.02.2016) (ANIC, ISISIP-fototeca), publikuar në http://fototeca.iiccr.ro/picdetails.php?picid=34548X125X170, vizituar më 17.02.2016.

B. Pjesë nga fjalimi i Çausheskut

Pushtimi i Çekosllovakisë nga trupat e pesë vendeve socialiste përbën një gabim të madh dhe një kanosje serioze të paqes në Evropë dhe fatit të socializmit në botë. Në botën e sotme, kjo është e pakonceptueshme. Kur populli ngre krye, për të luftuar për pavarësinë e tij kombëtare, për barazi të të drejtave[...] asnjë arsye nuk mund të pranohet, as për një sekondë, në mbështetje të një ndërhyrjeje ushtarake në çështjet e një shteti të pavarur socialist vëllazëror. Jam i bindur se populli çekosllovak, Partia Komuniste e Çekosllovakisë, klasa punëtore e Çekosllovakisë, të moshuarit, gratë, të rinjtë, të gjithë njëzëri e mbështesin partinë dhe udhëheqësit e shtetit, në përpjekjet e tyre për të përmirësuar gjendjen e rënduar të trashëguar nga e kaluara, në mënyrë që të garantohet triumfi i socializmit në këtë vend. Çështja e zgjedhjes se si realizohet socializmi, ka të bëjë me çdo parti, çdo shtet, çdo popull. Askush nuk mund të marrë rolin e këshilltarit dhe të këshillojë se si socializmi duhet të ndërtohet në një vend tjetër. Ne besojmë se për të zgjidhur marrëdhëniet midis vendeve socialiste, midis partive komuniste, sipas parimeve marksiste-leniniste, ne duhet njëherë e përgjithmonë t'i japin fund çdo ndërhyrjeje në çështjet e shteteve të tjera, të partive të tjera.

Gazeta „Scânteia", 22 gusht 1968, fq. 1.

II-35. Një karikaturë shqiptare në revistën satirike "Hosteni" që dënon pushtimin e Çekosllovakisë nga Traktati i Varshavës

Hosteni, 25 tetor 1968, fq. 5.

Studioni Urdhrin e betejës nr. 4 (II-33), pjesën e fjalimit të Çausheskut (II-34B) dhe karikaturën shqiptare (II-35). Shfrytëzoni njohuritë tuaja për të shqyrtuar pyetjet e mëposhtme:

a. Pse BRSS-ja pushtoi Çekosllovakinë në vitin 1968? Cilat vende iu bashkuan pushtimit? Shpjegoni pse Ministri bullgar i Mbrojtjes lëshoi Urdhrin e Betejës nr. 4.

Çfarë nënkupton ai me "elementë kundërrevolucionarë" dhe "forca reaksionare" në BRSS?

b. Krahasoni fjalimin e Çausheskut me të ashtuquajturën doktrinën e Brezhnevit ("Kur forcat e armatosura ndaj socializmit kërkojnë të kthejnë zhvillimin e një vendi socialist në kapitalizëm, ky nuk është vetëm një problem i vendit në fjalë, por një problem i përbashkët që ka të bëjë me të gjitha vendet socialiste", 1968). Shpjegoni pse Rumania nuk mori pjesë në pushtimin e Çekosllovakisë.

c. A ndihmon fakti që Shqipëria nuk mori pjesë në pushtimin e Çekosllovakisë, për të shpjeguar mesazhin e karikaturave? Si e paraqet karikaturisti mospajtimin e tij me pushtimin e Çekosllovakisë?

Cilët elementë të karikaturës e përcjellin këtë mesazh (merrni parasysh si mesazhet pamore, ashtu edhe ato tekstuale)?

II-36. Deklarata e Todor Zhivkovit mbi ratifikimin e Konventës për ndalimin e teknikave ushtarake ose të çdo teknike tjetër që dëmton mjedisin, nënshkruar në Gjenevë më 18 maj 1977

Shokë,

Ne vështirë se mund ta përfytyrojmë historinë shpirtërore të popullit bullgar pa lidhjen e tij të fortë me trojet amtare, mjedisin natyror, malet pyjet, fushat dhe detin. Këto lidhje pasqyrohen në këngët popullore. Kur bullgari thotë: "O, pyll, pyll i gjelbër", ai shpreh dashurinë dhe respektin e tij për bukurinë natyrore, mirënjohjen e tij për këtë tokë të përjetshme që na ka ushqyer.

Sot, në kushtet e reja të punës konstruktive për ndërtimin e një shoqërie të zhvilluar socialiste, respekti dhe adhurimi i mjedisit natyror po bëhet gjithnjë e më i madh, gjithnjë e më aktiv. Ne po kujdesemi dhe do të kujdesemi për ruajtjen e tij. Ne kemi miratuar ligje për mbrojtjen e tij dhe po mbajmë ndaj kujtdo që përpiqet të shkatërrojë luginat tona të bukura ose pyjet shekullore.

Kjo paprekshmëri është e lidhur në mënyrë të natyrshme dhe thellësisht me çështjen thelbësore të kohës sonë, me luftën për ruajtjen e paqes, ndalimin e armëve bërthamore dhe dhënien fund të gjitha provave të armëve bërthamore, për çarmatim tërësor dhe të përbotshëm. Mjedisi ynë natyror, Toka, duhet të mbrohet nga çdo formë helmimi apo shkatërrimi.

Shokë, kjo është arsyeja pse pikërisht Bashkimi Sovjetik, që në vitin 1974, ndërmori nismën që çoi në Konventën për Ndalimin e Përdorimit të Teknikave Ushtarake, ose Teknikave të tjera Armiqësore të Modifikimit Mjedisor. Siç dihet, më [16 maj] kjo Konventë u ratifikua nga Sovjeti Suprem i Bashkimit Sovjetik.

Sot po marrim vendimin për ratifikimin e të njëjtës Konventë […].

Konventa i mbyll derën përhapjes së garës së armëve në sferën e luftës së ashtuquajtur "meteorologjike" ose "gjeofizike", që ka një forcë shkatërruese, të paparë më parë, për asgjësimin e njerëzve dhe të mirave materiale. Dhe e mbyll atë derë, nëse do të shprehesha në mënyrë të figurshme, përpara se dikush "të na futet tinëzisht brenda".

Външната политика на НРБ, vëll. 4, fq. 422-424

Zhivkovi, kryetar i atëhershëm i Këshillit të Shtetit të Republikës Popullore të Bullgarisë, e bëri këtë deklaratë në mbledhjen e Këshillit të Shtetit të Republikës Popullore të Bullgarisë, më 25 maj të vitit 1978. Konventa u ratifikua nga Republika Popullore e Bullgarisë, më 31 maj të vitit 1978.

II-37. Operacioni ushtarako-strategjik i koduar me emrin "Mburoja-82", 1982

BNdërmjet 14 qershorit dhe 30 shtatorit të vitit 1982, në Bashkimin Sovjetik dhe në Republikën Popullore të Bullgarisë, u ndërmor operacioni ushtarako-strategjik i koduar me emrin "Mburoja-82", që ishte më e rëndësishmja në historinë e Traktatit të Varshavës. Ekspertët ushtarakë perëndimorë e quajtën atë "luftën bërthamore shtatorëshe", sepse simuloi operacionet ushtarake pas një greve bërthamore në të gjithë Evropën. Ky operacion në shkallë të gjerë e Forcave të Armatosura të Traktatit të Varshavës testoi tërë arsenalin strategjik të Ushtrisë Sovjetike dhe të ushtrive të vendeve të atëhershme socialiste në Evropë, duke përfshirë edhe atë të Ushtrisë Popullore Bullgare.

A. Tanket

http://socbg.com/2014/01/%D1%89%D0%B8%D1%82-82-%D0%BD%D0%B0%D0%B9-%D0%B3%D0%BE%D0%BB%D1%8F%D0%BC%D0%BE%D1%82%D0%BE-%D0%B1%D0%BE%D0%B9%D0%BD%D0%BE-%D1%83%D1%87%D0%B5%D0%BD%D0%B8%D0%B5-%D0%B2-%D0%B8.html, vizituar më 21.09.2016.

B. Distinktivi: "Mburoja 82 – Bullgari"

Krahasoni burimet II-36 dhe II-37. Ku është polemika këtu? Diskutoni mbi çështjen e çarmatimit të pakteve kundërshtare nën trysninë e rreziqeve të përdorimit të armëve bërthamore.

II.5.2. Lëvizja e Vendeve të Paangazhuara

Në kontekstin e dekolonizimit, pas Luftës së Dytë Botërore, shumë vende aziatike dhe afrikane fituan pavarësinë e tyre. Për të shmangur lidhjen me një nga blloqet, vendet e mësipërme u mblodhën dhe formuan Lëvizjen e Vendeve të Paangazhuara, që konferencën e saj të parë e mbajti në Beograd, në vitin 1961. Përveç Qipros, Jugosllavia ishte i vetmi vend i paangazhuar në Evropë dhe një ndër bashkëthemelueset e lëvizjes. Lëvizja u formua me qëllimin e nxitjes së bashkëpunimit politik dhe ekonomik midis anëtarëve të saj, si dhe të një politike bashkëjetese paqësore dhe aktive, duke marrë parasysh Luftën e Ftohtë.

II-38. Konferenca e Lëvizjes së Vendeve të Paangazhuara, në Beograd

A. Deklarata e Krerëve të Shtetit ose të Qeverive së Vendeve të Paangazhuara

Konferenca e Krerëve të Shtetit ose Qeverive të vendeve të mëposhtme të paangazhuara:

1. Afganistan, 2. Algjeri, 3. Burma, 4. Kamboxhia, 5. Silon, 6. Kongo, 7. Kuba, 8 Qipro, 9. Etiopi, 10. Gana, 11. Guine, 12. Indi, 13. Indonezi, 14. Irak 15. Liban, 16. Mali, 17. Maroku, 18. Nepal, 19. Arabi Saudite, 20. Somali, 21. Sudan, 22. Tunizi, 23. Republika e Bashkuar Arabe, 24. Jemen, 25. Jugosllavi dhe vendet e mëposhtme të përfaqësuara nga vëzhguesit: 1. Bolivi, 2. Brazil, 3. Ekuador, u mbajt në Beograd më 6 shtator të vitit 1961, me qëllim shkëmbimin e pikëpamjeve mbi problemet ndërkombëtare, dhe me synim paqen dhe sigurinë më të efektshme dhe bashkëpunimin paqësor midis popujve.

[…] Krerët e Shteteve ose Qeverive të Vendeve të Paangazhuara, duke gjykuar se krizat që çojnë drejt një konflikti botëror gjatë fazës së kalimit nga një rend i vjetër i bazuar në sundimin, në rendin e ri të bazuar në bashkëpunimin midis kombeve, [...] duke pasur parasysh se një paqe e qëndrueshme mund të arrihet vetëm nëse ky konfrontim çon në një botë ku sundimi i kolonializmit, imperializmit dhe neokolonializmit, në të gjitha aspektet e tyre, eliminohen rrënjësisht; […] për të zhdukur në thelb burimin e konfliktit nënkuptohet zhdukja e kolonializmit në të gjitha aspektet e tij dhe pranimi i zbatimit të politikës së bashkëjetesës paqësore në botë; […]

Duke u mbështetur në këtë dhe në vullnetin e popujve të tyre, qeveritë e vendeve pjesëmarrëse në Konferencë, e kundërshtojnë me vendosmëri pikëpamjen se lufta, përfshirë edhe "luftën e ftohtë", është e pashmangshme, […]

Megjithatë, blloqet ushtarake ekzistuese […] nxisinpërkeqësime herë pas here të marrëdhënieve ndërkombëtare.[…]

[…] 13. Pjesëmarrësit në Konferencë ripohojnë bindjen e tyre se:

(a) Të gjitha kombet kanë të drejtën e bashkimit, vetëvendosjes dhe pavarësisë […]

15. Pjesëmarrësit në Konferencë mendojnë se çarmatimi është një nevojë e ngutshme dhe detyra më urgjente e njerëzimit. Një zgjidhje radikale e këtij problemi, [...] mund të arrihet vetëm me anë të një çarmatimi të përgjithshëm, të plotë, të rreptë dhe të kontrolluar ndërkombëtarisht. […]

17. Vendet pjesëmarrëse iu bëjnë thirrje të gjithë Shteteve në përgjithësi, dhe Shteteve që aktualisht eksplorojnë hapësirën, në veçanti, ta përdorin hapësirën e jashtme ndërplanetare vetëm për qëllime paqësore. […]

21. Pjesëmarrësit në Konferencë mendojnë se duhen bërë përpjekje, për të shmangur çekuilibrin ekonomik të trashëguar nga kolonializmi dhe imperializmi. Ata e vlerësojnë si të domosdoshme kapërcimin, nëpërmjet zhvillimit të përshpejtuar ekonomik, industrial dhe bujqësor, të hendekut gjithnjë e në rritje në standardet e jetesës midis pak vendeve të përparuara ekonomikisht dhe shumë vendeve pak të zhvilluara ekonomikisht. […]

24. Vendet pjesëmarrëse e vlerësojnë të domosdoshme që Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, [...] të gjejë një zgjidhje për çështjen e zgjerimit të anëtarësisë në Këshillin e Sigurimit dhe të Këshillit Ekonomik dhe Social në mënyrë që përbërja të ketë [...] harmoni me nevojat e Organizatës dhe me anëtarësimin e zgjeruar të Kombeve të Bashkuara.

Butkoviç dhe Petkoviç (bot.), 1979, f. 679.

B. Mesazhi për Presidentin e SHBA-së, Xhon F. Kenedi, nga krerët e shtetit ose qeverive të Vendeve të Paangazhuara, 5 shtator 1961



CONFERENCE
OF HEADS OF STATE OR GOVERNMENT
OF NON-ALIGNED COUNTRIES

Belgrade, September 5, 1961.

Your Excellency,

We, the Heads of States and Governments of our respective countries attending the Conference of Non-Aligned Countries held at Belgrade from September 1 to September 5, 1961 venture to address Your Excellency on a subject of vital and immediate importance to all of us and to the world as a whole. We do so not only on our own behalf, but at the unanimous desire of the Conference and of our peoples.

We are distressed and deeply concerned at the deterioration in the international situation and the prospect of war which now threatens humanity. Your Excellency has often pointed to the terrible nature of modern war and the use of nuclear weapons, which may well destroy humanity, and has pleaded for the maintenance of world peace.

Yet we are at the brink of this very danger that menaces the world and humanity. We are fully aware that Your Excellency is anxious as any of us to avoid this dreadful development which will not

2/ ....

His Excellency Mr. John F. Kennedy
President of the United States of America
W a s h i n g t o n

7.

Sheikh Ibrahim Sowayel
Minister of Foreign Affairs
Personal Representative of King Saud
Of Saudi Arabia

Aden Abdulla Osman
President of the Somali Republic

Ibrahim Abboud
(Farik)
President of the Supreme Council for
the Armed Forces and Prime Minister
of the Republic of the Sudan

Habib Bourguiba
President of the Republic of Tunisia

Gamal Abdel Nasser
President of the United Arab Republic

Mesazhi për Presidentin e SHBA-së, Xhon F. Kenedi, nga krerët e shtetit ose qeverive të Vendeve të Paangazhuara, 5 shtator 1961 Fjalimet e Xhon F. Kenedi. Fjalime Presidenciale. Dosjet e Zyrë së Presidentit. Tematë. Samiti i Vendeve të Paangazhuara, Beograd, 1 shtator 1961. Njoftim për Xhon F. Kenedin nga Krerët e shteteve ose qeverive të Lëvizjes së Shteteve të Paangazhuara, 5 shtator 1961, fq. 1, 7.: http://www.jfklibrary.org/Asset-Viewer/Archives/JFKPOF-104-004.aspx, vizituar më 3.09.2016.

II-39. Pjesë nga artikulli i gazetës "New York Times" për Lëvizjen e Vendeve të Paangazhuara (1975)

KOMBET E BASHKUARA, N.J., 3 shtator – Kombet e Bashkuara duket se janë të destinuara të bëhen arena kryesore ku Shtetet e Bashkuara dhe fuqitë e tjera industriale përplasen për marrëdhënien e re me vendet që e cilësojnë veten si të paangazhuara. Shumica e këtyre vendeve janë të varfra, disa janë shumë të dëshpëruara dhe disa janë të sapopasuruara nga fati i papritur i fitimeve të mëdha nga prodhimi i naftës. Por gjendja e tyre është e ngjashme; një ndjesi e thellë e padrejtësisë që 70 për qind e njerëzimit duhet të ushqehet me 30 për qind të të ardhurave të botës.

Ndërsa Lëvizja e Vendeve të Paangazhuara po rritet, ajo tani ka plot 82 anëtarë, pothuajse tre të pestat e shteteve të regjistrit të Kombeve të Bashkuara-është gjithnjë e më shumë është e detyruar të gjejë kompromise mes prirjeve të kundërta në gjirin e saj.

Gazeta "The New York Times", 4 shtator 1975.

Lexoni burimet II-38A, II-38B dhe II-39:

a) Çfarë i shtyu këto vende që të formonin Lëvizjen e vendeve të paangazhuara?

b) Cilat ishin qëllimet e kësaj lëvizjeje?

II-40. Tre udhëheqësit e Lëvizjes së Vendeve të Paangazhuara: Gamal Abdel Naser (Egjipt), Josip Broz Tito (Jugosllavi), Makarios III (Qipro)

Zyra e shtypit dhe komunikimit, Republika e Qipros.

Në kundërshtim me pritshmëritë e Fuqive të Mëdha, Makarios kërkoi të vendoste marrëdhënie të ngushta dhe të bashkëpunonte me Lëvizjen e vendeve të paangazhuara, si mjet për të nxitur dhe paraqitur pavarësinë e Qipros (Konferenca e Beogradit, 1-6 shtator 1961). Zëvendës Presidenti, Kyçyk dhe udhëheqja qipriote turke, e kundërshtuan me vendosmëri iniciativën e Makarios. Për biografinë e Makarios, shihni Librin e punës 2, fq. 117.

Përse mendoni se Presidenti Makarios zgjodhi t'i bashkohej Lëvizjes së Vendeve të Painkuadruara, ndërkohë që Greqia, Turqia dhe Britania e Madhe ishin anëtarë të NATO-s?

II.6. ALEANCAT BALLKANIKE

II.6.1. Planet për Federatën jugosllavo-bullgare

Ideja e vjetër e themelimit të një federate sllavo-jugore, u ringjall në një takim midis Stalinit dhe udhëheqësve komunistë të vendeve të Ballkanit në Moskë, në vitin 1943. Nën presionin e Bashkimit Sovjetik, në fillim të vitit 1945, Tito dhe Gjergj Dimitrovi ranë dakord të fillonin përgatitjet për krijimin e një federate jugosllave-bullgare. Në qershor të vitit 1946, Stalini bëri thirrje për "autonominë kulturore-kombëtare të Pirinit të Maqedonisë", si hapi i parë drejt përfshirjes së rajonit në Republikën Popullore të Maqedonisë (RPM), si një njësi përbërëse e federatës së ardhshme jugosllavo-bullgare. Ky shtet i ri i madh federativ pritej të zgjidhte mosmarrëveshjet ekzistuese kombëtare sipas parimeve të modelit sovjetik. Ishte në këtë kontekst që pala bullgare ra dakord për zhvendosjen e eshtrave të heroit të përbashkët kombëtar, Goce Delçev, nga Sofja në Shkup. Pala jugosllave ndërmori një rol udhëheqës në procesin e bisedimeve dypalëshe, në të cilat një sërë çështjesh të hapura ose të paqarta dolën në pah, për sa i përket strukturës, funksionimit dhe madje edhe emrit të shtetit federativ të planifikuar. Udhëheqësit jugosllavë propozuan përfshirjen e Shqipërisë në federatën e ardhshme dhe shprehën aspiratat e tyre ndaj Maqedonisë greke, që u përballën me kundërshtimin e vendosur të Fuqive të Mëdha Perëndimore. Ky kundërshtim u shpreh qartë, veçanërisht nga Britania e Madhe, në lidhje me të gjithë projektin federativ. Britanikët i bënë thirrje Stalinit, duke kërkuar që të gjitha ndryshimet e kufijve shtetërorë në hartën territoriale në Ballkan duhet të shtyhen, përpara nënshkrimit të traktateve të paqes, që zyrtarisht i japin fund Luftës së Dytë Botërore. Bullgaria, si një ish aleat i Gjermanisë naziste, e nënshkroi Traktatin e Parisit për Paqe, më 10 shkurt 1947. Gjatë negociatave të paqes, Jugosllavia e mbështeti zyrtarisht Bullgarinë kundër pretendimeve territoriale të Greqisë në disa zona kufitare, duke përfshirë edhe një pjesë të rajonit të Pirinit. Pas marrëveshjeve jugosllavo-bullgare në Bled, Slloveni (30 korrik - 1 gusht 1947), ndjekur nga traktati i miqësisë së ndërsjelltë, bashkëpunimit dhe asistencës të nënshkruar nga Tito dhe Dimitrovi në Evksinograd, Bullgari (27 nëntor 1947), gjuha maqedonase e sapo standardizuar u fut në shkollat e rajonin të Pirinit. Kjo politikë shkaktoi reagime kundërshtuese midis popullsisë vendase, 63.6% e të cilave u regjistruan administrativisht si shtetas maqedonas. Si një lloj kompensimi, marrëveshjet

e Bledit parashikonin se në këmbim të përfshirjes së Pirinit të Maqedonisë në RPM, Bullgarisë do t'i jepeshin territoret kufitare brenda federatës, të cilat i kishte humbur me Traktatin e Paqes së Neilit të 1919-s, dhe ku shumica e popullsisë ishte bullgare. E gjithë kjo nuk u miratua zyrtarisht nga pala sovjetike dhe, përfundimisht, ndarja midis Stalinit dhe Titos në qershor 1948 i dha fund planeve për federatën jugosllavo-bullgare.

II-41. Dëshmi personale për koordinimin e planeve bullgare dhe jugosllave për federatën

Në mes të Beogradit të shkatërruar, të përgjumur dhe të sfilitur, çështja bullgare ishte pothuajse e vetmja që ishte ende e diskutueshme. Pa një shpirt të gjallë, pa shërbëtorë apo roje, me dyer të hapura, qëndrova pranë llambave të vogla të murit dhe studioja dokumentet famëkeqe për të njëqindtën herë. Sipas shënimeve me shkurtime, pikat kyçe të dy projekteve ishin si në vijim:
Projekti bullgar: Të dy qeveritë deklarojnë se po ecin drejt bashkimit të sllavëve të jugut, duke krijuar një shtet federativ, që përbëhet nga dy njësi federale - Bullgaria dhe Jugosllavia. Emri i shtetit: Federata e Sllavëve të Jugut - FSJ. Institucione të përbashkëta: Punët e jashtme dhe ushtria. Kushtetuta përfundimtare: Pas një referendumi dhe zgjedhjeve. Mënyrat e tranzicionit: Do të themelohet një trup i përkohshëm, Këshilli i Bashkimit të Sllavëve të Jugut, me seli në Beograd. Përbërja e këshillit: Në bazë të barazisë, do të kishte përfaqësues nga të dy vendet.

Projekti jugosllav: Shteti federativ do të bashkojë shtatë njësi federale: Bullgarinë, Serbinë, Kroacinë, Sllloveninë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Bosnjën dhe Hercegovinën. Emri: I papërcaktuar. Institucione të përbashkëta: Punët e jashtme, ushtria dhe zyra doganore. Kushtetuta përfundimtare: Pas një referendumi dhe zgjedhjeve. Mënyrat e tranzicionit: Komisioni bullgaro-sllav, me seli në Beograd dhe i quajtur "Komisioni i Bashkimit të Sllavëve", i autorizuar për të zgjedhur qeveri dhe për të hartuar kushtetutën. Përbërja e komisionit: Një numër i barabartë përfaqësuesish nga Bullgaria dhe nga gjashtë njësitë federale të Jugosllavisë.

Todorov, 1999, fq. 338.

Shpjegoni kontekstin historik të këtij fakti. Krahasoni ide të ndryshme për një federatë jugore sllave.

Shpjegoni rolin e Titos.

Analizoni ndarjet sipas pikëpamjeve bullgare dhe jugosllave për federatën. Shpjegoni pikëpamjet e Stalinit në kontekstin e Luftës së Ftohtë.

II-42. Delegacioni nga Republika Popullore e Maqedonisë në Sofje për marrjen e eshtrave të Goce Delçevit, viti 1946

A. "Mijëra njerëz nderojnë kujtimin e ndritur të Goce Delçevit në të gjithë Pirinin e Maqedonisë, pasi eshtrat e tij po dërgohen [në Shkup]"

Petriç, 8 tetor (nëpërmjet telefonit)
Korrespondenti ynë nga Petriçi raporton:
Sot, në rrugën e tij nga Sofja për në Shkup, delegacioni i Republikës Popullore të Maqedonisë që mbart eshtrat e Goce Delçevit kalon përmes Pirinit të Maqedonisë. Arkivoli i bërë posaçërisht për këtë rast, i mbuluar me flamuj jugosllavë dhe me flamurin e Republikës Popullore të Maqedonisë, qëndron në një top artilerie. Arkivoli u ruajt nga luftëtarët dhe oficerët e Ushtrisë Jugosllave. Procesioni i Delegacionit të Republikës Popullore të Maqedonisë, delegacioni i emigracionit maqedonas [organizatat e refugjatëve] në Sofje, të afërmit e Goce Delçevit dhe të tjerë ndjekin arkivolin. Mijëra njerëz e vlerësojnë kujtimin e ndritur të Goce Delçevit në qytete dhe fshatra, në të gjithë Pirinin e Maqedonisë, ndërsa po transportonin eshtrat e revolucionarit maqedonas.
Gazeta "Nova Makedonija", 8 tetor 1946.

Gazeta "*Nova Makedonija*", 8 tetor 1946..

B. A. "Kryeqyteti i Maqedonisë mirëpret në mënyrë solemne eshtrat e Goce Delçevit"

Shkupi, kryeqyteti i Maqedonisë, mirëpriti eshtrat e luftëtarit të madh dhe apostullit të lirisë, Goce Delçevi. Mijëra njerëz u përkulën para kujtimit të revolucionarit, duke falënderuar për veprat dhe bëmat e tij të pavdekshme [...]. Banorët e Shkupit i pritën eshtrat e Gocesë, siç i takonin. Një turmë e madhe njerëzish qëndronin nën një shi që nuk rreshtte, për më shumë se një orë në pritje të procesionit solemn dhe, kur

mbërritën eshtrat e Gocesë, i shoqëruan në banesën e tyre të fundit- në monumentin historik kombëtar, në Kishën e Shpëtimit të Shenjtë.
[…] Presidenti i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Blagoja Fotevi, foli për veprat dhe idealet e Goce Delçevit. Ndër të tjera, ai tha: "Dyzet e tre vjet na ndajnë nga vdekja tragjike, por heroike e këtij biri të madh të popullit tonë. Toka maqedonase ka pritur 43 vjet që të marrë në gjirin e saj eshtrat e Gocesë. Për rreth dyzet e tre vjet, imazhi i ndritshëm dhe i dashur i heroit tonë kombëtar ka jetuar dhe është ngritur më shumë në shpirtrat e popullit maqedonas".

Gazeta "Nova Makedonija", 11 tetor 1946, fq. 3.

C. B. Intervistë me ish-mësuesin, Kostadin Yakovliev, nga qyteti i Goce Delçevit, Pirini i Maqedonisë, më shkurt të 2009-s, për imponimin e identitetit kombëtar maqedonas, dhe më tej identitetin kombëtar bullgar mbi popullsinë vendase

Në vitin 1946, komunistët e kishin marrë tashmë pushtetin dhe midis popullit flitej se ne do të bashkoheshim me serbët, domethënë me Jugosllavinë. Dhe se Tito dhe Gjergj Dimitrovi kishin arritur një lloj marrëveshjeje në baza partiake, se rajoni i Pirinit do të bashkohej me Maqedoninë, me Maqedoninë serbe.
Nuk iu kushtova vëmendje të veçantë këtyre thashethemeve, por shumë njerëz u alarmuan

Dhe pastaj u mor vesh se këto nuk ishin thjesht thashetheme, por ato do të ndodhnin në të vërtetë. Ata filluan të na thërrisnin në Bashki dhe të na ndryshonin pasaportat tona bullgare, me të cilat identifikoheshim si bullgarë, me ato të reja ku na identifikuan si maqedonas. Shumë njerëz në atë kohë nuk mund t'iu besonin syve të tyre, por për arsye se ne jemi, ju e dini, frikacakë, kjo ndodhi disi pa u vënë re, megjithëse pati revolta paqësore në disa vende. Disa njerëz u futën në burg, por më lejoni të theksoj përsëri se - ndryshe nga ajo që ndodhi me pomakët [bullgarët myslimanë] në vitin 1972 - nuk pati shkelje normash. Dhe fundja fare, pse të zemërohesh? Në fund të fundit, unë e di që jam i krishterë ortodoks bullgar, prandaj nuk ka rëndësi se kush do të më identifikojë mua, apo jo? Kjo është ajo që shumica prej nesh i thamë vetes.

Por, në vitet 1947-48, të gjithë u identifikuan si "maqedonas" - bullgarë, turq dhe pomakë ... Dhe kështu ishte deri në vitin 1964, kur regjimi e kuptoi gabimin, filloi t'i rivendoste emrat bullgarë përsëri, duke i regjistruar ata në pasaporta edhe një herë si "bullgar".

Gruev et al., 2011, fq. 193-194.

II.6.2. Pakti ballkanik, viti 1954: Turqia, Greqia dhe Jugosllavia

Në vitin 1953, për të forcuar pozicionin e tyre gjeostrategjik dhe për të parandaluar që BRSS-ja të arrinte deri në Mesdhe, Jugosllavia, Greqia dhe Turqia, nënshkruan mes tyre aleancën politike dhe në vitin 1954 aleancën ushtarake. Pjesa interesante e këtij Pakti ishte fakti që Greqia dhe Turqia ishin në atë kohë anëtare të NATO-s, ndërsa Jugosllavia ishte një vend komunist. Kjo do të thoshte që Jugosllavia përfshihej në mënyrë jo të drejtpërdrejtë në sistemin mbrojtës Perëndimor. Kur marrëdhëniet midis Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik u normalizuan, dhe veçanërisht pas konfliktit greko-turk për Qipron, Pakti Ballkanik de facto pushoi së ekzistuari.

II-43. Pakti Ballkanik

A. Një gazetar jugosllav raporton nga Athina

SULME NDAJ ALEANCËS BALLKANIKE
Athinë, 29 maj (nëpërmjet telefonit) - Të përditshmet e shumta greke kanë pasqyruar gjerësisht vizitën e presidentit Tito në Greqi. […]

Grekët po punojnë për ngritjen e një harku triumfal në fund të rrugës Pire-Athinë, në ultësirën lindore të Akropolit. Ky vend konsiderohet si porta e qytetit dhe ky është vendi ku grekët mirëpresin vizitorë të rëndësishëm. […]

Shkrimet e sotme të shtypit athinas theksojnë veçanërisht dy lajme interesante për sa i përket politikës së jashtme, në lidhje me vizitën që do të bënte së shpejti Presidenti Tito.

E para ka të bëjë me veprimtarinë e spikatur të ambasadorit të ri italian në Athinë, z. Karuzo. Ky zotëri kishte bërë tashmë hetime, nëpërmjet Ministrisë së Jashtme greke, për mundësinë e paraqitjes së dokumenteve të tij të akreditimit përpara princit Pal, para ardhjes së Presidentit Tito. Këmbëngulja e tij për urgjencën është e pazakontë në këto çështje. Si

përfundim, kjo natyrisht lejoi nxjerrjen e përfundimeve të ndryshme, tipike të qëndrimit të Italisë ndaj Paktit Ballkanik, që përfshihej në axhendën e bisedimeve të Presidentit Tito me zyrtarët grekë. Dihet se pas takimit të Titos me Presidentin turk Bajar, Italia u përpoq të ndikonte te shtetarët e Greqisë, për ta penguar Paktin Ballkanik, që ende nuk kishte marrë formë. Roma u përpoq të përdorte NATO-n, për ta bërë Greqinë të tërhiqej, por këto përpjekje nuk patën sukses. [...] Shtypi grek përcolli një mesazh të hapur për imperializmin italian: Mbajini larg duart nga Ballkani!

Ngjarja e dytë që ka tërhequr vëmendjen e shtypit vendas, është kalimi i anijeve luftarake sovjetike nga Deti i Zi drejt Shqipërisë. [...] Moska ka dërguar luftanijet e saj pikërisht në të njëjtën kohë kur anija jugosllave "Galeb", që transportonte Presidentin Tito, do të jetë në të njëjtat ujëra. [...] Në Greqi, kjo është interpretuar si një shprehje e interesit të Moskës për Ballkanin, për Shqipërinë në këtë moment, dhe se çdo përpjekje për krijimin e çdo Pakti të ardhshëm Ballkanik duhet ta ketë mirë parasysh këtë fakt. Ajo shihet edhe si një lloj presioni ndaj të tre vendeve pasi ata po i afrohen një marrëveshjeje përfundimtare, për finalizimin e paktit. Duket qartë nga artikutj e shkruar në shtypin e përditshëm të Athinës se grekët i japin të njëjtin kuptim situatës në fjalë.

Trysnia që Roma dhe Moska po ushtrojnë ndaj këtyre tre vendeve, gjë që është e re në lidhje me marrëdhëniet mes tyre, janë vetëm një re e zezë kalimtare, si ajo që solli reshje shiu pasdite në Athinë, që e errësoi qiellin për pak kohë, por që më vonë Akropoli përsëri vezulloi me gjithë bukurinë e tij , nën shkëlqimin madhështor të diellit të Mesdheut.

Joshko Palavrshiç

Gazeta "*Vjesnik*", 30 maj 1954, fq. 1.

B. A. Pjesë nga fjalimi i ministrit të Jashtëm, Profesor Fuat Köprülü pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ankarasë, 28 shkurt 1953

Kjo marrëveshje është rezultat i qëndrimit realist të tre vendeve, që janë tërësisht të përkushtuara ndaj parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe idealit të paqes, në frymën e bashkëpunimit dhe miqësisë së sinqertë, si dhe të vendosur, për të mbrojtur pavarësinë e tyre në përballjen e një armiku të përbashkët. Si rrjedhojë, kjo marrëveshje, që në aspektin gjeopolitik, përputhet me idealet dhe interesat e përbashkëta të të gjitha qeverive paqësore, duket e përshtatshme si një dokument i qëndrueshëm dhe i besueshëm. Ndërsa ne theksojmë në mënyrë të vendosur miqësinë dhe bashkëpunimin, ne sigurojmë edhe themelin e ri për paqen dhe autonominë, në aspektin e realizmit dhe zhvillimeve të paqes në botën e lirë. Turqia është krenare të mirëpresë nënshkrimin e kësaj marrëveshje bashkëpunimi dhe sigurie që u parashikua në Beograd dhe u hartua në Athinë.

Gazeta "*Milliyet*", 1 mars 1953, fq. 1, 7.

C. A. Deklarata e bërë nga Hulusi Köymen, deputet për Partinë Demokrate gjatë diskutimit parlamentar për miratimin e marrëveshjes

Në rastin e një lufte në Evropë, rëndësia strategjike e gadishullit të Ballkanit dhe gjeografia turke do të bëhet e vetëkuptueshme. Për ta siguruar fitoren, forcat nga pala sulmuese do të jenë të detyruar të zgjerojnë operacionet e tyre në tokë dhe në det në tre kontinente, dhe të kontrollojnë burimet në këto zona. Rrugët kryesore të zgjerimit kalojnë përmes Ballkanit, Ngushticave dhe vendit tonë. Duke pasur parasysh këtë fakt strategjik, vendimi i përbashkët i tre vendeve, që luajnë një rol udhëheqës në përcaktimin e fatit të kësaj zone gjeografike, të marra për të mbrojtur paqen dhe koordinuar përpjekjet e tyre në mbrojtje të saj, padyshim do të pengojë çdo përpjekje luftënxitëse dhe do të prishë planet e tyre.

Gazeta "*Milliyet*", 19 maj 1953, fq. 7.

Pse u formua ky pakt? Cili ishte elementi i pazakontë i tij?Sipas burimit II-43A, si e shpjegoni interesin e Italisë dhe çfarë kuptimi kishte referimi i imperializmit italian në Ballkan? Pse Pakti nuk rezistoi gjatë?

II.6.3. Rrugëtimi i Shqipërisë

Në vitin 1949 Shqipëria gjendej në një situatë shumë të vështirë. Shkëputja e marrëdhënieve me Jugosllavinë, pezullimi i huave dhe largimi i specialistëve jugosllavë ishte një goditje e rëndë për ekonominë e dobët shqiptare. Në rrethana të tilla, Enver Hoxha kishte vetëm një mundësi:

Të kërkonte mbështetjen dhe mbrojtjen e plotë të sovjetikëve, dhe kështu të pranonte tutelën e tyre. Nga ana tjetër, pas prishjes së marrëdhënieve sovjetike-jugosllave, edhe Stalini kishte nevojë që Shqipëria të pozicionohej kundër Jugosllavisë së Titos, në mënyrë që të ngushtonte rrethin e izolimit për udhëheqësin heretik jugosllav, që guxoi ta kundërshtonte atë. Pas dënimit zyrtar të krimeve të stalinizmit në vitin 1956, marrëdhëniet Shqipëri-BRSS të tensionohen. Në vitin 1961, Shqipëria pushoi së qeni anëtare e Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke (KNER) dhe nuk mori më pjesë në Traktatin e Varshavës (ajo u shkëput zyrtarisht prej tij në vitin 1968, në shenjë proteste kundër pushtimit të Çekosllovakisë) dhe u bashkua me Kinën Maoiste deri në vitin 1978.

II-44. Shqipëria dhe BRSS-ja, 1961

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME Nr. 12
Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës Populllore të Shqipërisë [...] ka nderin të paraqesë në Ambasadën e BRSS-së në Tiranë dokumentin e mëposhtëm, duke e lutur me mirësjellje t'ia përcjellë atë qeverisë sovjetike:

I. Qeveria e Republikës Populllore të Shqipërisë u informua me habi dhe keqardhje për vendimin e Qeverisë së BRSS-së, me të cilin tërheq ambasadorin e saj aktual në Republikën Populllore të Shqipërisë me pretekstin e pabazuar dhe fiktiv, që Republika Populllore e Shqipërisë ka krijuar kushte të caktuara që e privojnë atë nga çdo mundësi, për të ushtruar funksionet e tij diplomatike.

Qeveria e Republikës Populllore të Shqipërisë e hedh poshtë në mënyrë të vendosur këtë akuzë të rreme, që është një nga shpifjet e shumta dhe veprimet e tjera jomiqësore, që ndërmerren vazhdimisht dhe në mënyrë sistematike nga udhëheqësit sovjetikë, kundër Republikës Populllore të Shqipërisë, që kanë një dhe vetëm një qëllim: Të përkeqësojnë dhe të shkëpusin marrëdhëniet vëllazërore midis dy popujve tanë miqësorë dhe dy vendeve tona socialiste.

Ambasadori i Republikës Populllore të Shqipërisë në Bashkimin Sovjetik, shoku Nesti Nase, gjithmonë ka kryer me përpikëri detyrat e tij si diplomat, si shqiptar dhe komunist, duke respektuar rreptësisht ligjet dhe rregullat në fuqi të Bashkimit Sovjetik. Ai ka punuar me të gjitha energjitë e tij, për të krijuar dhe forcuar gjithmonë miqësinë e përjetshme midis dy popujve tanë vëllezër dhe dy vendeve tona socialiste.

Duhet të theksohet se në kryerjen e misionit të tij fisnik si një diplomat socialist, ai jo vetëm që nuk është ndihmuar, por është penguar edhe nga autoritetet sovjetike në të gjitha mënyrat, madje edhe nga ato më të rëndësishmet, duke përfshirë mbikëqyrjen e hapur dhe të maskuar. Aktualisht, është i njohur fakti që për disa vite Ambasada e Republikës Populllore të Shqipërisë në Bashkimin Sovjetik ka qenë nën mbikëqyrje të vazhdueshme me pajisje të veçanta teknike të instaluara që nga ndërtimi i saj dhe që nga ajo kohë ka qenë në kontroll të drejtpërdrejtë policor.

Qeveria e Republikës Populllore të Shqipërisë proteston fuqishëm për vendimin e qeverisë sovjetike për të dëbuar Ambasadorin e Republikës Populllore të Shqipërisë nga Bashkimi Sovjetik, një vendim tërësisht i padrejtë, i pajustifikuar dhe në kundërshtim të hapur me parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare [dhe ato që udhëheqin] marrëdhëniet midis vendeve socialiste. Ajo fajëson qeverinë sovjetike për [pasojën që një vendim i tillë] do të ketë në marrëdhëniet midis Republikës Populllore të Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik.

Tiranë, 4 dhjetor 1961

MPJ [Ministria e Punëve të Jashtme], 1961, D. 37, fq. 22-25.

II-45. Artikull i "Washington Post", 1975: "Shqipëria e izoluar dhe e pajtuar me këtë situatë. Qëndron e vendosur kundër SHBA-së dhe Bashkimit Sovjetik"

TIRANË - Aeroporti ndërkombëtar i këtij qyteti ka një atmosferë të zymtë dhe terminali ka gjallëri vetëm pesë herë në javë, kur ndonjë aeroplan nga bota e jashtme ulet në kryeqytetin e atyre që duhet të renditen si një nga shtetet më të izoluara të botës.

Shqipëria, me një popullsi prej 2.4 milionë banorësh, është i vetmi vend në Evropë që nuk ka pranuar të lidhë marrëdhënie diplomatike me Shtetet e Bashkuara ose me Bashkimin Sovjetik.

Vizitorët e huaj janë të rrallë - më pak se 10,000 pranohen në vit - dhe Shqipëria i ka rezistuar tundimit për t'i shndërruar plazhet e Adriatikut në vendpushime që do të sillte të ardhura, duke tërhequr si turistë adhuruesit evropianë të diellit.

Shumica e vizitorëve janë pjesëtarë të grupeve dashamirëse politike, kryesisht komunistë nga Evropa Perëndimore, që ishin zhgënjyer me zhvillimin e ngjarjeve në Bashkimin Sovjetik dhe kanë ardhur për të parë Shqipërinë marksiste-leniniste si një parajsë.

Vizitorët e huaj të Shqipërisë vijnë sipas kushteve të Shqipërisë. Siç udhëheqësi i saj, Enver Hoxha, theksoi jo

shumë kohë më parë, se vendi nuk pranon të dëgjojë armiqtë e tij që "na kështillojnë ta kthejmë vendin tonë në një han me dyer të hapura për derrat dhe dosat, për njerëzit me pantallona ose pa pantallona fare, qafëleshëve dhe flokëgjatëve, për të zëvendësuar vallet e bukura të popullit tonë me orgjitë e tyre të egra".

Aeroporti i Tiranës ka një berber që qeth të gjithë kalimtarët meshkuj, që kanë pak flokë të varur poshtë veshëve të tyre. Dyqani i suvenireve shet jo vetëm xhingla të zakonshme turistike, por edhe pantallona për gra, fundet e të cilave janë ose shumë të gjata ose të shkurtra. Gjatë përpjekjes për të ruajtur pastërtinë e revolucionit të saj, Shqipëria është e vendosur t'i mbajë larg vlerat e individualizmit perëndimor, madje edhe manifestimet më sipërfaqësore të tij.

Gazeta "*Washington Post*", 8 shtator 1975, f. A11.

II-46. Afishe kineze për Aleancën kinezo-shqiptare, 1956

https://www.marxists.org/history/erol/albania/, vizituar më 24.08.2016.

Një afishe e rrallë kineze që përgëzonte miqësinë kinezo-shqiptare me rastin e takimit midis Maos dhe Enver Hoxhës në vitin 1956. Figura e madhe e Maos dhe rëndësia e saj historike për aleancën ndërmjet Kinës gjigante komuniste dhe Shqipërisë së vogël komuniste, mund të zbulohet nga pozita e trupit të Enver Hoxhës, pak e përkulur përpara Maos dhe duke shtrënguar dorën e Maos me të dyja duart.

II-47. Një karikaturë që ironizon udhëheqësin kinez Teng Tsiao Ping pas ndarjes kinezo-shqiptare në vitin 1978

https://www.marxists.org/history/erol/ncm-5/, vizituar më 24.08.2016.

Studioni informacionin në çelës dhe afishen (II-46) dhe përshkruani gjuhën e trupit të figurave të Maos dhe Hoxhës. Çfarë lloj aleance ishte ajo e krijuar midis Kinës dhe Shqipërisë? Përshkruajeni karikaturën (II-47). Cilat janë personat që pasqyrohen? Çfarë mesazhi politik synon të përçojë??

II-48. Udhëheqësit shqiptarë shpjegojnë ndarjen nga Kina, 1978

PËR KOMITETIN QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE TË KINËS
PËR KËSHILLIN E SHTETIT TË REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS

Më 7 korrik 1978, Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Kinës i dërgoi Ambasadës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në Pekin një komunikatë zyrtare, nëpërmjet së cilës theksonte se qeveria kineze kishte vendosur "të pezullojë ndihmën ekonomike dhe ushtarake për Shqipërinë, të pezullojë pagesat e ndihmës kundrejt Shqipërisë dhe të tërheqë specialistë ekonomikë dhe ushtarakë" që kanë punuar deri tani në Shqipëri.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës së Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare e dënojnë veprimin tuaj të vrazhdë para gjithë opinionit publik botëror, si një veprim që përsërit si në formë ashtu edhe në përmbajtje metodat mizore dhe shoviniste të Titos, Hrushovit dhe Brezhnevit, që Kina vetë i kishte dënuar më pare.

Është e pabesueshme dhe shkon përtej arsyes edhe të njeriut më të zakonshëm, që Shqipëria, një vend i vogël që lufton kundër rrethimit imperialist-revizionist dhe bllokadës së tij, që ka nisur një punë të gjerë dhe gjithëpërfshirëse për zhvillimin e shpejtë ekonomik dhe kulturor të vendit, dhe që punon pa u lodhur, për të forcuar mbrojtjen e atdheut socialist, do të përpiqej të shkatërronte bashkëpunimin ekonomik me Kinën dhe do të refuzonte huat dhe ndihmën e saj civile dhe ushtarake.

Kur Partia e Punës e Shqipërisë e mbrojti Partinë Komuniste të Kinës nga sulmi i revizionistëve të Hrushovit, në takimet e Partive Komuniste dhe Popullore në Bukuresht dhe Moskë në vitin 1960, e bëri këtë duke qenë plotësisht e vetëdijshme se po mbronte parimet e marksizëm-leninizmit dhe jo për të marrë nga Kina disa fabrika dhe traktorë. Kur Shqipëria socialiste mbrojti të drejtat e Kinës Popullore në Kombet e Bashkuara kundër komplotit amerikan për vite me radhë, ajo nuk veproi kështu për të pasur përfitime materiale, por për të mbrojtur një kauzë të drejtë dhe parimore.

Kur Partia e Punës e Shqipërisë dhe klasa jonë punëtore i mbështetën qëllimet strategjike të Revolucionit Kulturor të Kinës, ato nuk vepruan kështu, për të marrë asgjë në këmbim, por për të ndihmuar klasën punëtore kineze, popullin kinez dhe komunistët, që ta shpëtonin vendin nga elementë kapitalistë, që kishin uzurpuar pushtetin në Kinë.

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë dhe populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë së Punës së Shqipërisë, të kryesuar nga shoku Enver Hoxha, do të përmbushin deri në fund dhe me nder misionin e saj historik, për ndërtimin e socializmit të bazuar në forcat e veta, duke treguar përpara proletariatit botëror dhe njerëzve në mbarë botën vitalitetin e pashtershëm dhe të pamposhtur të ideologjisë marksiste-leniniste, që i bën të mundur edhe një vendi të vogël, të rrethuar nga imperializmi dhe revizionizmi, si Shqipëria, të ndërtojë me sukses socializmin, për ta mbrojtur atë dhe për ta çuar përpara gjithmonë atë.

Shqipëria kurrë nuk do t'i dorëzohet askujt. Ajo gjithmonë do të mbetet besnike ndaj marksizëm-leninizmit dhe internacionalizmit proletar. Ajo vazhdimisht do të marshojë në rrugën e socializmit dhe të komunizmit të udhëhequr nga mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS SË SHQIPËRISË
Tiranë, 20 korrik 1978

MPJ [Ministria e Punëve të Jashtme], 1978, D. 284, fq. 73-119.

KAPITULLI III: DIKTATURAT DHE TRANZICIONET DEMOKRATIKE

Hyrje 101

III.1. Regjimet komuniste 105

III.1.1. Socializmi real 105

III.1.2. Jugosllavia dhe vetadministrimi 106

III.2. Regjimet ushtarake 108

III.2.1. Diktatura ushtarake në Turqi 108

III.2.2. Diktatura e kolonelëve në Greqi 112

III.3. Përndjekja e qytetarëve: kampe dhe burgje 114

III.4. Lëvizja rinore 120

III.5. Tranzicionet demokratike: arritjet dhe dështimet 122

III.5.1. Greqia 122

III.5.2. Turqia 124

III.5.3. Jugosllavia 125

HYRJE

Në përfundim të periudhës revolucionare staliniste të luftës kundër "fashistëve, reaksionarëve dhe kulakëve" (fshatarë të pasur), regjimet komuniste në Evropën Juglindore u përballën me nevojën e gjetjes së metaforave të reja ideologjike, për të shpjeguar vonesën e realizimit të "shoqërisë komuniste", si dhe për të justifikuar kontrollin e shtetit mbi jetën shoqërore dhe ekonomike të vendit. Për këtë arsye, u shpik dhe u zhvillua koncepti i "Socializmit real", si një përgjigje ndaj nevojës për një normë të përgjithshme historike, për sa i përket propagandës dhe shkencave humane dhe sociale, dhe ai u bë pjesë e historisë, të periudhave të ndryshme të zhvillimit të regjimit, që mund ta forconte dhe mbronte mundësinë e "fitores përfundimtare të komunizmit". Si kusht për të përshkruar gjendjen e shoqërive socialiste, Socializmi real (termat "Socializmi i Pjekur" dhe "Shoqëria e Përparuar Socialiste" përdoreshin zyrtarisht si sinonime të termit kryesor) i referohej fundit të viteve 1950, dhe veçanërisht fillimit të viteve 1960, kur, sipas ideologjisë mbizotëruese komuniste, mbaroi periudha e parë, më gjithëpërfshirëse dhe e përgjakshme e revolucionit socialist; periudhë që dëshmoi rrëzimin e pushtetit politik, përmbysjen e "klasave shfrytëzuese" dhe shtetëzimin e pronësisë private mbi mjetet e prodhimit. Periudha e mëpastajme çoi në një "etapë të re", gjatë së cilës do të pasqyroheshin plotësisht dhe krejtësisht përparësitë e rendit të ri shoqëror; me pak fjalë ky ishte socializmi "real" ose "i pjekur".

Gjatë periudhës së socializmit real, ekonomia e planifikuar pritej të triumfonte mbi prodhimin kapitalist dhe produktivitetin e punës. Në tetor të vitit 1958, Todor Zhivkov, ndoshta i frymëzuar nga përvoja kineze, shpjegoi pikëpamjen e tij për "hapin e madh përpara" të Bullgarisë.

Rezolutat e Kongresit të 22-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, në tetor të vitit 1961, si dhe ato të kongreseve të mëvonshme të "partive motra", parashikuan një situatë më optimiste se të mirat e "socializmit aktual ekzistues". Ata premtuan arritjen e komunizmit dhe begati të plotë, duke filluar nga viti 1980, "profeci" jorealiste dhe e pabazë, që u harrua shumë shpejt dhe u zhduk në vitet në vijim. Në të vërtetë, vendet socialiste kryen eksperimentime të shumta për të modernizuar ekonomitë e tyre, në vitet 1960 dhe 1970, duke zbatuar në ndërmarrjet e mëdha "parimin e përparimit shkencor dhe teknologjik", "përqendrimin e prodhimit" dhe "përshpejtimin e procesit të prodhimit". Tashmë vendet socialiste i përqendruan përpjekjet e tyre te përshtatja me ndryshimet në ekonominë botërore dhe zhvillimin teknologjik, si dhe në përafrimin e strukturave të tyre ekonomike me ato të mbarë botës, që është në ndryshim të vazhdueshëm, duke i përshtatur ato ndaj qëndrimeve të reja konsumiste të popullsisë dhe pasojave të kulturës së masave që po përfshinte shoqëritë e tyre. Slogani propagandistik: "çdo gjë në emër të popullit, për të mirën e popullit" përmblodhi konceptin kryesor ideologjik të "socializmit aktual ekzistues".

Diktatura komuniste në vendet e Evropës Juglindore riprodhoi karakteristikat më thelbësore të diktaturave autoritare të shekullit të njëzetë; konkretisht, nëpërmjet mobilizimit masiv dhe politikave që synonin organizimin e gjithë jetës shoqërore. Pas zhdukjes së pluralizmit politik "borgjez" (sistemi shumëpartiak borgjez), ata, në vend të tij, zhvilluan të ashtuquajturën "lëvizjet e masës", të kontrolluara dhe të drejtuara nga partitë përkatëse komuniste. Të gjitha shtresat dhe komunitetet shoqërore u organizuan në nivelin më të ulët dhe më të gjerë të mundshëm, për të mos i lënë hapësirë veprimi organizimeve "jozyrtare" të njerëzve, nismave të pavarura dhe manifestimit të ndonjë kundërshtimi publik ndaj forcës kryesore politike. Regjimet komuniste i paraqitën "lëvizjet e masave" dhe organizatat e masave, si qendra të veprimtarisë qytetare, megjithëse, në fakt, ishin mjete për kontrollin e përgjithshëm të shoqërisë. Ata ndërtuan bazën e strukturës së re hierarkike shoqërore, pozicionet më të larta të së cilës ishin zënë nga elita e re socialiste-udhëheqja komuniste me në krye të saj "udhëheqësin dhe mësuesin" (deri në mes të viteve 1950) dhe më vonë, Partia Komuniste dhe udhëheqësi i shtetit.

Duke ndjekur këtë logjikë, pas "fitores" së tyre, të gjitha regjimet komuniste filluan të zgjeronin bazën e partive të tyre, duke arritur një anëtarësim disamilionësh në vitin 1989. Rritja e tyre u ndërpre nga "spastrimet" dhe shtypja e anëtarëve të partisë, si një sistem i mirëllogaritur për të mbajtur të nënshtruar elitën e vendit. Format kryesore të organizimit të "lëvizjeve të masave" ishin të ndryshme dhe, pavarësisht nga veçoritë vendase, në parim ato ishin të njëjta për të gjitha vendet komuniste në Ballkan.

Më e rëndësishmja, ato përfshinë zyrtarisht ruajtjen formale të një numri të madh të shoqatave kulturore dhe organizatave qytetare që ishin krijuar lirisht në periudhën para-komuniste (organizata të ndryshme artistike, sportive, të ecjes sportive, të minoriteteve, ato feministe, etj). Kushti i përgjithshëm për funksionimin e tyre të vazhdueshëm ishte zëvendësimi i udhëheqësve të tyre nga persona që kishin lidhje të afërta me regjimet komuniste. Kjo siguroi edhe zëvendësimin e parimeve që kishin udhëhequr veprimtarinë e tyre të lirë, para krijimit të regjimeve komuniste. Pas fitores së këtyre të fundit, të gjitha organizatat dhe shoqatat e tilla pranuan "rolin udhëheqës të Partisë". Një praktikë e zakonshme në krijimin e "lëvizjeve e masave" dhe "organizatave" të masave ishte bashkimi, në një formacion të vetëm dhe të madh, i ish partive politike që ishin përshtatur nga regjimi, organizatave qytetare ekzistuese, si dhe anëtarëve jopartiakë në bazë të vendbanimit. Secili anëtar, qoftë si një individ (në rastin e anëtarëve pa parti) ose si kolektiv (në rastin e partive dhe organizatave qytetare), mund të vepronte vetëm brenda një kuadri organizativ të përcaktuar. Një rast i tillë ishte edhe Organizata Socio-Politike e Popullit të Bashkuar "Fronti i Atdheut" në Bullgari. Organizata të tilla masive dhanë mbështetje të përgjithshme në zhvillimin e zgjedhjeve dhe shërbyen si një prapaskenë e madhe propagandistike e nismave ekonomike, shoqërore dhe ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, kontrolli i rreptë i partisë komuniste përcaktoi zyrtarizimin e plotë të tyre.

Një formë tjetër e organizimeve masive ishin edhe sindikatat (Bashkimet Profesionale), rëndësia e të cilave u parashtrua nga direktiva ideologjike e rolit udhëheqës të klasës punëtore në marrëdhëniet socialiste të shoqërisë së re. Megjithatë, duke marrë parasysh se mjetet e prodhimit ishin në pronësi të plotë të shtetit dhe punëtorët nuk mund të punësoheshin lirisht, roli i tyre i vërtetë, nga këndvështrimi i sindikatës, ishte qesharak. Ata, në fakt, ishin pjesë e mekanizmit që siguronte mobilizimin e vazhdueshëm të masave punëtore, në përputhje me direktivat e Partisë, gjatë arritjes së normës dhe planeve ditore të prodhimit. Si rrjedhim dhe në të vërtetë, sindikata kryente funksione kundër parimeve të sindikatave. Në të gjitha vendet komuniste në Ballkan, ato ishin ngritur sipas shembullit sovjetik: "një klasë, një parti, një sindikatë e unifikuar", dhe anëtarësia në to ishte e detyrueshme për të gjithë "punëtorët". Nuk është rastësi që fillimi i krizës, që çoi në fundin e socializmit në vitet '80, lidhej me krijimin e "Solidarnostit" në Poloni, në vitin 1980, që u vetëdeklarua si një "Sindikatë e Pavarur Vetëqeverisëse"; pra, solidariteti ishte diçka që sindikatat zyrtare në vendet komuniste as nuk e tregonin e as kishin ndër mend ta tregonin.

Një ndër organizatat më të rëndësishme ishte organizata e të rinjve komunistë (Organizatat e Rinisë), "Komsomol", në fjalorin sovjetik. Ajo bazohej në anëtarësimin e detyrueshëm të të gjithë të rinjve, midis moshës 14 dhe 18 vjeç, dhe kishte si qëllim që të funksiononte si një "shkollë e arsimimit komunist", si dhe të siguronte mobilizimin e vazhdueshëm politik të të rinjve. Një ndër funksionet më të veçanta, dhe padyshim më i rëndësishmi, ishte sigurimi i përkrahësve të rinj për Partinë udhëheqëse. Përgjithësisht, struktura e organizatës së të rinjve komunistë ishte sipas modelit të partisë komuniste. Ajo kishte buxhetin e saj, një mekanizëm që administrohej me kohë të plotë dhe një strukturë piramidale që fillonte nga organizatat bazë të rinisë "Komsomol" dhe shkonte deri në rang rrethi dhe në nivele të larta, me në krye komitetin qendror. Edhe organizatat komuniste të fëmijëve dhe adoleshentëve (Organizatat e Pionerit) deri në moshën 14-vjeçare, ishin nën kujdestarinë e "Komsomolit". Veprimtaritë e tyre synonin pasjen nën kontroll të të gjithë fushave të jetës së të rinjve, përfshirë edhe punën, praninë në jetën publike, apo mënyrën e të sjellurit dhe të të shprehurit.

Në tërësi, periodizimi i regjimeve diktatoriale komuniste në vendet e bllokut sovjetik, u përcaktua nga rrjedha e ngjarjeve kryesore të historisë së Partisë Komuniste të Bashkimi Sovjetik (PKBS), në të cilën morën formë: vdekja e Stalinit në vitin 1953; Kongresi i 20-të i PKBS-së në vitin 1956, dhe dënimi i "kultit të individit" dhe krimeve të stalinizmit; si dhe viti 1968 ndërhyrja e Bashkimi Sovjetik dhe Paktit të Varshavës në Çekosllovaki; dhe, së fundmi, zgjedhja e Mihail Gorbaçovit, si Sekretari i Përgjithshëm i PKBS-së dhe përpjekjet e tij për të "ristrukturuar" socializmin. Në Shqipëri, diktatura e Enver Hoxhës sipas modelit të Stalinit, vazhdoi edhe pas prishjes së marrëdhënieve diplomatike me Bashkimin Sovjetik dhe lidhjes së aleancës me Kinën (1960-1978), dhe më pas edhe gjatë periudhës së vetizolimit të Shqipërisë. Në Jugosllavi, pas viteve të hershme të stalinizmit ortodoks, u themelua diktatura "më e butë", megjithëse e padiskutueshme, e Titos. Të gjitha diktaturat komuniste në Ballkan karakterizoheshin edhe nga vendosja e rolit udhëheqës të partisë komuniste në të gjitha institucionet shtetërore dhe ekonomike, pra shkrirja e Partisë dhe shtetit, që ishte praktikë e zakonshme në të gjitha regjimet totalitare. Çdo nivel administrativ i qeverisjes shtetërore dhe çdo nivel i menaxhimit

ekonomik, kishin një organizatë partie të tyren dhe të gjitha vendimet ishin gjithmonë në sinkron me udhëheqjen përkatëse të partisë. Shkrirja e partisë dhe shtetit dëshmohet edhe nga fakti se krerët e të gjitha njësive administrative dhe ekonomike ishin gjithmonë edhe "kuadro të përgjegjshëm të Partisë", caktimi i të cilëve bazohej, mbi të gjitha, në vendin që zinin brenda partisë së tyre, dhe jo gjithmonë në bazë të njohurive që kishin. Pavarësisht disa ndryshimeve të veçanta, udhëheqja e partisë mbikëqyrte punën e qeverisë, ministrive, parlamentit, forcave të armatosura, policisë dhe shërbimit të sigurimit, medias, sistemit të arsimit dhe të gjitha institucioneve të tjera; një veçori e përbashkët e të gjitha diktaturave komuniste në Ballkan. Në këtë aspekt, as Jugosllavia, që kishte devijuar nga "rruga e drejtë" dhe ishte ndarë nga Bashkimi Sovjetik në vitin 1948, nuk bënte përjashtim. Shtypja sovjetike, nëpërmjet mënyrave të ndryshme, ishte e njohur nga të gjitha regjimet komuniste në Ballkan: shtypja e armikut nga komunistët gjatë luftës "me kartën e anëtarësimit në Parti"; dhuna ndaj pronarëve gjatë kolektivizimit të detyruar të bujqësisë dhe shpronësimit të pronave; shfaqja qesharake e seancave gjyqësore me vendim të paracaktuar për vdekje; burgimet dhe mbyllja në kampet e punës së detyruar; internimi; mobilizimi për punë të detyruar; pushimi nga puna, ishin vetëm disa prej mënyrave. Tipare të tjera kyçe të sundimit komunist në Ballkan ishin format e tij të ndryshme, si: heqja e të drejtave dhe përjashtimi (nga arsimi, punësimi, udhëtimi jashtë shtetit, zgjedhjet personale në jetë, dhe kështu me radhë), dhe një sërë fushatash armiqësore kundër "huliganizmit", "përmbysjes së pushtetit ideologjik", duke i shpallur intelektualët dhe persona të tjerë të shkencës, si disidentë.

Që nga vitet '60 dhe në vijim, një tipar i përbashkët i të gjitha regjimeve komuniste në Ballkan ishte zëvendësimi parimor i koncepteve kyçe marksiste-leniniste me teoritë ideologjike nacionaliste, lidhja paralele e ritualeve zyrtare dhe riorientimi për ngjarjet më të rëndësishme në jetën publike me ngjarjet dhe personalitet e rëndësishëm në panteonin kombëtar të çdo vendi (apo republike/kombi në rastin e Jugosllavisë). Festimet e përvjetorit të 2050-të të krijimit të shtetit të Dakisë dhe përvjetori i 1300-të i themelimit të shtetit të Bullgarisë, përkatësisht në vitet 1970 dhe '80, e treguan më së miri këtë prirje, në formën më të inskenuar të mundshme.

Deri në fillim të viteve '80, veprimet e rezistencës kundër diktaturave komuniste në Ballkan, ishin të rralla, të izoluara dhe të papërqendruara. Kjo vinte si rezultat i vetë natyrës së regjimeve, si edhe për shkak të faktit se, shumë shpesh, mendimet më kritike për "sistemin" jepeshin nga persona që kishin lidhje me partitë komuniste dhe ideologjitë e tyre. Më konkretisht, rasti i Milovan Gjilasit në Jugosllavi që, duke u bazuar në teorinë e Marksit, i kritikoi mangësitë e regjimit në krahasim me versionin e vërtetë të shoqërisë socialiste, (në veçanti, hendekun e krijuar midis elitave komuniste sunduese, nomenklaturës, dhe masave). Fati tragjik i disidentit bullgar, Gjergji Markov, e tregoi më së miri këtë trajektore. Në vitet '80, ideja e ndryshimit që erdhi nga këto qarqe ndoqi mesazhet e vagullta të Perestrojkës sovjetike, në lidhje me humanizimin e shoqërisë socialiste dhe ndërtimin "e socializmit me fytyrë njeriu", sipas thënies së famshme të liderit komunist reformator çek Aleksandër Dubçek në 1968. Vetëm një ose dy vite para rënies së komunizmit, në Bullgari u krijuan organizata "jozyrtare" të mirëfillta disidentësh, që ishin të interesuara për problemet e fundit të viteve '80 si: ndotja e mjedisit dhe të drejtat politike dhe civile të pakicave turke të vendit.

Pas fundit të diktaturës staliniste, në Jugosllavi u themelua një model partiak dhe shtetëror disi i ndryshëm. Në sajë të strukturës federale, ai ndërthurte kontrollin e shtetit ndaj ekonomisë dhe shoqërisë, monopolin politik të Partisë Komuniste, me doktrinën e vetadministrimit kolektiv në nivele të ndryshme dhe, veçanërisht në krahasim me Shqipërinë, Bullgarinë dhe Rumaninë, të qenit më të hapur ndaj Perëndimit. Rrjedhimisht, në vitet '60 dhe në fillim të viteve '70, kritikat ndaj problemeve të ndryshme në shoqëri po shtoheshin dhe po bëheshin gjithnjë e më shumë publike. Ato shpreheshin nga disa intelektualë të shquar, organizata dhe grupe, duke pasqyruar debatet dhe përpjekjet, për të çliruar, humanizuar dhe demokratizuar kushtet ekzistuese socialiste, të simbolizuara nga reformat e ndërmarra në Çekosllovaki. Së fundmi, edhe "Pranvera kroate" u shtyp, pas fundit të "Pranverës së Pragës", siç u shtypën edhe "liberalët" sllovakë dhe serbë. Megjithatë, kriza e thelluar vijoi të ndikonte mbi vendet komuniste dhe në vitet '80 autoritetet në Jugosllavi filluan të shqyrtonin sërish zgjidhje të suksesshme ndaj çështjeve të ngutshme, për një ekonomi dhe decentralizim politik të efektshëm.

Nga ana tjetër e Perdes së Hekurt në rajon, si faktorët e brendshëm ashtu edhe ata ndërkombëtarë, ende përcaktonin luftërat për arritjen e më shumë lirive dhe të drejtave të njeriut, për ringritjen e sistemit parlamentar demokratik dhe rendit kushtetues, shpesh i cenuar ose i trazuar nga regjimet autoritare ushtarake në Turqi, ose nga diktatura e djathtë e kolonelëve në Greqi (1967-1974). Sigurisht, këtu konteksti i rezistencës politike,

ose kundërshtimi i ligjshëm ishte shumë më i gjerë dhe i pangjashëm, përfshirë partitë e majta, të djathta ose centriste, lëvizjeve radikale dhe liberale dhe grupeve me vizione dhe ideologji të ndryshme. Pa dyshim, rezistenca kushtëzohej nga vlerësimet ideologjike, strategjike, ose vlerësime të tjera të SHBA-së dhe aleatëve të saj Perëndimorë. Në asnjë mënyrë, kjo nuk përjashtoi mënyrat e ndryshme të ndërhyrjes, ndonëse këto nuk ndodhën në formën e ndërhyrjeve të hapura të Bashkimit Sovjetik në Hungari dhe Çekosllovaki. Në fakt, në Greqi, trashëgimia e luftës civile e zhyti vendin në errësirë, gjë që shpjegon demokracinë e "dobët", ose "të kontrolluar" të regjimit deri në vitin 1967. Sidoqoftë, deri në vitin 1967, qeveritë e zgjedhura i kishin marrë parasysh zërin e politikanëve të zgjedhur dhe medias së lirë, të cilat ishin shumë të ndryshme nga pozitat politike të pallatit mbretëror, ushtrisë apo edhe shërbimeve të fshehta. Për shembull, në fillim të viteve '50, vihej re kërkesa për amnisti të përgjithshme; ndërsa në vitin 1958 u vu re rritja e madhe e votuesve të majtë; në vitin 1961, thirrja centriste kundër "forcës dhe mashtrimit" gjatë zgjedhjeve të atij viti; dhe në vitet 1963-64, fitoret e centristëve në sondazhe. Shtypja antikomuniste në vitet e pas përfundimit të Luftës Civile, siç dëshmohet edhe nga kampet e përqendrimit në Makroniso, u zëvendësua shkallë-shkallë me masat e "paqësimit" në vitet '50 dhe të demokratizimit në fillim të viteve '60, që diktatura ushtarake i shpërfilli më vonë. Junta u mbështet shumë te shërbimet ushtarake dhe të sigurimit, siç kishin bërë edhe qeveritë e zgjedhura nga Traktati i Varkizës, i vitit 1945 dhe në vijim, ndërsa i përmbahej vendimit të vitit 1947 të qeverisë centriste-të djathtë për të shfuqizuar Partinë Komuniste. Pas rënies së juntës në vitin 1974, u ligjërua Partia Komuniste, u shfuqizua monarkia dhe rrjedhimisht u demokratizua shoqëria.

Qiproja ndoqi rrugëtim të ndryshëm, pavarësisht veprimeve antikomuniste të organizatës së qipriotëve grekë EOKA, dhe organizatës së qipriotëve turq, TMT. Partia komuniste e qipriotëve grekë, AKEL, ishte e ligjshme që prej pavarësisë së ishullit në vitin 1960. Megjithatë, mosmarrëveshjet midis dy komuniteteve që çuan në akte të dhunshme dhe në shkatërrimin e shtetit dykomunitetësh (siç përshkruhet në Kapitullin II.4) përcaktuan zhvillimet e mëvonshme në Qipro dhe arritën kulmin me grushtin e juntës kundër Makarios dhe me pushtimin turk, në korrik/gusht të vitit 1974.

Turqia e pranoi pluralizmin politik, menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, ndonëse përjetoi paqëndrueshmëri politike, shoqërore dhe ekonomike, që çoi në grushtet ushtarake të shtetit dhe regjimet autoritare, qoftë nën sundimin e drejtpërdrejtë të regjimeve ushtarake (1960 dhe 1971) apo nën sundimin jo të drejtpërdrejtë të Këshillit të Sigurimit Kombëtar, ku sundonin ushtarakët. Në vitet '80, vendi përjetoi regjimin ushtarak më konservator dhe më të ashpër, të udhëhequr nga Shefi i shtabit, Gjenerali Kenan Evren. Si përfundim, pavarësisht administrimit të suksesshëm të Kryeministrit Turgut Ozal, pas vitit 1983, Turqia dështoi që ta rrënjoste demokracinë në vitet '80 dhe '90.

III.1. REGJIMET KOMUNISTE

III.1.1. Socializmi real

III-1. Ekstrakt nga raporti i Todor Zhivkovit në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bullgarisë, 11 dhjetor 1972

Një vend të rëndësishëm në procesin e natyrshëm të demokratizimit e zë çështja e qëndrimeve të zyrtarëve kundrejt punëtorëve [...].Në këtë aspekt, është e domosdoshme të theksohet se nevoja për fuqizimin e cilësive të vlefshme te udhëheqësve bashkëkohorë, pavarësisht radhës apo pozitës, si: a) cilësitë politike: të qenit besnik ndaj klasës dhe Partisë; të kuptuarit e thellë të Partisë dhe politikës të shtetit, dhe të luftuarit për zbatimin e saj; të ndjekurit e një qasjeje krijuese për politikën konkrete, që zhvillohej dhe zbatohej nga Partia në sektorin e punës; të edukuarit e masave sipas frymës komuniste; të qenit i aftë për të punuar me ta dhe për t'i organizuar; të pasurit e cilësive morale dhe udhëheqje shembullore; b) cilësitë e menaxhimit: të qenit i aftë për të drejtuar dhe punuar në mënyrë kolektive; zotërimin e kualifikimeve të duhura sipas arritjeve bashkëkohore të shkencës dhe matematikës; të pasurit e njohurive praktike dhe të qenit i aftë për të menaxhuar prodhimin; të qenit i familjarizuar me metodat dhe teknikat bashkëkohore të vendimmarrjes dhe zbatimit të tyre. Këto kërkesa paraqesin nevojën e ndryshimit rrënjësor në sistemin ekzistues të përgatitjes dhe veçanërisht të kuadrove udhëheqëse dhe rikualifikuese.

Zhivkov, 1978, vëll. III, fq. 319-322.

Me zhvillimin e shoqërisë socialiste dhe rritjen e kompleksitetit të jetës shoqërore, qeverisja dhe administrimi, nëpërmjet shtrëngimeve politike, u bënë veçanërisht problematike. Fjalimi i Zhivkovit, që bënte thirrje për profesionalizimin e qeverisjes dhe shërbimeve të administratës, tregon që vazhdimi i qeverisjes së vendit nëpërmjet shtrëngimeve të drejtpërdrejta politike është i pamundur. Ai pohon përpjekjen për të kapërcyer gjendjen e stanjacionit për shkak të një ideologjie të vjetër, që ka depërtuar te të gjitha sferat e jetës shoqërore, dhe për të siguruar se të gjitha shërbimet administrative do të kryheshin nga specialistë, që komunikonin qartë, me gjuhë transparente profesionale me qytetarët dhe jo nga burokratë të indoktrinuar nga ideologjia, që donin të siguroheshin se rregullat dhe rregulloret institucionale zbatoheshin sipas "frymës komuniste".

III-2. Ekstrakt nga intervista me një ish punëtor në fabrikën e Iashit, duke shpjeguar përse iu bashkua Partisë Komuniste të Rumanisë

Në fillim, nuk kam dashur të jem anëtar i Partisë [...] ky ishte një ndër problemet. Por më vonë, nuk dua të jem hipokrit, kuptova që, nëse nuk isha anëtar i Partisë, nuk do të kisha asnjë mundësi për të lëvizur diku, për të fituar disa para, sepse nuk kishte as edhe një mundësi të vetme që të bëheshe shef i punishtes pa qenë anëtar partie. Kur më bënë mua anëtar partie, bënë edhe pesë punëtorë të tjerë [...], duhet të mësoje [...] të gjitha idetë dhe parimet politike që duhet të shprehnim [...]. Nuk mund të them se hidhja vetëm parulla, por gjithmonë qëndroja i përmbajtur, nuk dilja në vijën e parë, e as nuk kisha, si ta them, lidhje me ata persona […]. Madje u habita shumë, kur me lejuan të udhëtoja në Perëndim, në kohën e Çausheskut. Pintilie, 2015, f. 118.

Përse iu bashkua Partisë Komuniste të Rumanisë i intervistuari? Çfarë elementi pasqyron anëtarësimi, për shoqërinë në të cilën jetonte ai?

III-3. Ekstrakt nga vendimet e Plenumit të Pestë të Partisë Komuniste të Shqipërisë, që dënonin veprimtarinë "oportuniste" të ish udhëheqësit komunist, Sejfulla Malëshova

Plenumi i Pestë i Komitetit Qendror të PPSH-së shënoi fundin e polemikave të brendshme të Partisë dhe fitoren e dogmës staliniste.

A. Raporti i mbajtur në plenumin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë (21 shkurt 1946)

Plenumi vuri në dukje se vija e Partisë ishte dëmtuar rëndë nga pikëpamjet e theksuara oportuniste që kishte mbrojtur Sejfulla Malëshova, i cili edhe në takimin e Plenumit vazhdoi të ngulte këmbë për bindjet e tij në

fushën ekonomike dhe politike.

Plenumi njëzëri vendosi ta përjashtonte Sejfulla Malëshovën nga Komiteti Qendror i Partisë.

B. Vendimet e 3 marsit të vitit 1946

Masat punonjëse u bënë forca kryesore e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Gjatë luftës në vendin ndodhi një zhvillim i rëndësishëm, ndërkohë që klasat sunduese u bashkuan me forcat e pushtuesve. Lufta jonë çlirimtare u drejtua edhe kundër atyre. Rrjedhimisht, kjo lëvizje kombëtare u shndërrua në një lëvizje kundër klasave sunduese dhe në përkrahje të pushtetit popullor. Revolucioni popullor u organizua dhe u udhëhoq nga Partia Komuniste, që përfundoi me çlirimin e Shqipërisë, krijimin e Ushtrisë Popullore dhe marrjen e pushtetit nga klasa punëtore.

Në vendin tonë kemi vendosur Diktaturë Revolucionare Demokratike të punëtorëve dhe fshatarëve, të kryesuar nga Partia Komuniste.

Tani ka ardhur çasti për të hedhur themelet e pushtetit, që është ekonomia, nën kontrollin e masave punëtore.

Partia duhet t'i udhëheqë masat punëtore gjatë luftës kundër klasave që kishin pasur monopolin e pushtetit, feudalëve dhe borgjezëve, që ende zotërojnë pozita të rëndësishme. Partia, e mbështetur në politikën e saj udhëheqëse, duhet të punonte veçanërisht për dy qëllimet e mëposhtme:

1. *Rindërtimi i vendit*. Rrethanat që kishte lënë pas lufta ishin: shkatërrimi, prodhimi i ulët dhe standardi i ulët i jetesës. Sfida jonë nuk është vetëm të rindërtojmë gjithçka që rrënoi lufta, por të ndërtojmë një jetë më të mirë.

Përpos rindërtimit ekonomik, duhet të zhvillojmë edhe çdo aspekt shoqëror dhe kulturor të shoqërisë sonë.

Populli ynë ka nevojë për më shumë ushqim, për më shumë kulturë. E gjithë puna jonë duhet të synojë masat punonjëse dhe të përmbysë përfundimisht klasat që kanë pasur pushtetin deri më tani. Ajo duhet të ketë vulën e pikëpamjeve tona për ndërtimin e socializmit.

Populli ynë duhet të mobilizohet mbi bazat e punës vullnetare, që është thelbësore për rindërtimin e vendit.

Duhet ta theksojmë qartazi se, për sa kohë që klasa punëtore do të jetë e ndërgjegjshme se puna e kryer është për të mirën e saj, ajo do të jetë e përkushtuar ndaj çdo sakrifice.

2. *Çështja e zyrtarëve*. Nëse nuk do të ketë zyrtarë të aftë, Partia jonë nuk do të arrijë t'i përmbushë detyrat e saj. Zyrtarët duhet të jenë të përkushtuar shpirtërisht ndaj socializmit. Ata duhet të jenë të ndërgjegjshëm se si të luftojnë frymën e vjetër dhe të punojnë për synimet tona. Arsimimi i zyrtarëve duhet të vendoset nën kujdesin më të lartë të Komitetit Qendror të PKSH. Zyrtarët duhet të përzgjidhen me kujdes, të arsimohen dhe të mbikëqyren gjatë punës. Duhet t'u përcjellim atyre më shumë kulturë dhe, veçanërisht, ideologjinë marksiste. Duhet të qartësojmë se ata që i kuptojnë mirë mësimet e Stalinit, punojnë më mirë dhe bëjnë më pak gabime. Duhet të saktësojmë se, në mënyrë që t'i shërbejmë më mirë Partisë sot, duhet të jemi të aftë t'i shërbejmë Pushtetit të ri, ekonomisë së re, Ushtrisë së re, kulturës sonë dhe vendit tonë.

Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Shqipërisë AQSH,, F.489, v.1946, d.10, fl.1

Shkrimtari dhe poeti, Sejfulla Malëshova ishte ndër komunistët shqiptarë që kishin kaluar një pjesë së jetës si refugjat politik në Bashkimin Sovjetik gjatë viteve '30. Pas çlirimit të Shqipërisë, ai u bë anëtar i Byrosë Politike, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, President i Bankës Kombëtare dhe kryetar i Këshillit Ekonomik. Në vitin 1946, ai u kritikua shumë nga Plenumi i Pestë i KQ të Partisë Komuniste, për sa i përket pikëpamjeve të tij që ekonomia shqiptare në atë kohë duhet të zhvillohej në sajë të ndërthurjes së sektorit shtetëror dhe privat. Malëshova ishte kundër thellimit të luftës së klasave, dhe këmbënguli që Shqipëria e pasluftës duhet të tregonte më shumë mençuri, duke integruar shtresat e ndryshme të shoqërisë në rindërtimin ekonomik dhe kulturor të vendit. Udhëheqja e Partisë Komuniste e konsideroi tezën e tij si oportuniste dhe liberale dhe rrjedhimisht ai u përjashtua nga Partia dhe u internua. Plenumi i Pestë i KQ të Partisë Komuniste shënoi fillimin e masave të ashpra kundër pronarëve privatë, duke njohur përparësinë e sektorit në pronësi të shtetit dhe duke ndërmarrë një fushatë persekutimi të ashpër ndaj tregtarëve dhe sipërmarrësve privatë.

III.1.2. Jugosllavia dhe vetadministrimi

Partia Komuniste e Jugosllavisë, gjatë konfliktit me Byronë Informative, vendosi t'i hedhë poshtë të gjitha modelet e zhvillimit ekonomik të BRSS-së, që cenonin kryesisht rolin e shtetit, duke krijuar një sistem tërësisht të ri. Ky sistem i ri u quajt vetadministrim, dhe krijuesit

e tij ishin Boris Kidriç dhe Milovan Gjilasi. Mendohej se vetadministrimi u besoi vetë punëtorëve menaxhimin e firmave dhe ndërmarrjeve, ndërkohë që ndërmarrjet kaluan në pronësi shoqërore (jo shtetërore). Organi kryesor i vetadministrimit ishte Këshilli i punëtorëve. Më 31 dhjetor të vitit 1949, u zgjodh i pari Këshill i tillë, në fabrikën e çimentos "Prvoborac" në Solin pranë Splitit. Gjatë vitit 1950, kur Asambleja Kombëtare votoi për Ligjin Themelor mbi Qeverisjen e Ndërmarrjeve të Punëtorëve, nëpërmjet së cilit u parashtrua zyrtarisht koncepti i vetadministrimit, u formuan deri në 250 këshilla, të përbërë nga 15 deri në 120 anëtarë. Si organe kolektive, këto këshilla duhet të merrnin vendimet më të rëndësishme në lidhje me funksionimin e çdo firme, impianti, ndërmarrjeje, shoqërie dhe të tjera. Ligjbërësit punonin sipas "frymës së tre D-ve: deburokratizimi, demokratizimi dhe decentralizimi". Ligji duhet të institucionalizonte idenë e Marksit për diktaturën e proletariatit. Megjithatë, pushteti i vërtetë mbi firmat mbeti në duart e Partisë dhe drejtuesve të lartë.

III-4. Kritika e Milovan Gjilasit për monopolin e Partisë, viti 1957

Ndryshe nga revolucionet e mëparshme, revolucioni komunist, që u zhvillua për të përmbysur të gjitha klasat shoqërore të borgjezisë, rezultoi në sundimin absolut të një klase, një klase të re. Pjesa tjetër është veçse një iluzion. [...] Në komunizëm, pushteti shpërndahet me shpejtësi midis disa udhëheqësve të partisë. Ajo që mbetet nga e ashtuquajtura diktatura e proletariatit është thjesht retorikë. [...] Shteti komunist, që është autoriteti, përpiqet të arrijë depersonalizimin e plotë të individëve dhe kombeve, përfshirë edhe përfaqësuesit e tij. Ai kërkonte t'i kthente njerëzit e një kombi të tërë në nëpunës, dhe të kontrollonte drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, pagat, kushtet e jetesës dhe të banimit dhe, në fund të fundit, edhe bindjet fetare. [...] Historia do t'i justifikojë komunistët për shumë gjëra, duke menduar se ata vepruan në atë mënyrë për shkak të rrethanave dhe për të siguruar mbijetesën e tyre. Por, duke shtypur të gjitha kundërshtimet ose, shprehur më mirë, duke pasur ata monopolin e shprehjes së mendimeve, në mënyrë që të mbronin interesat e tyre më egoiste, kjo do t'i vendosë ata në shtyllën e turpit të historisë, së bashku me Inkuizicionin dhe veprën e tij të djegies së njerëzve, madje do t'i vendosë ata në një pozicion në krye. [...]Komunizmi modern është një sistem totalitar me tre shtylla kryesore për kontrollin e popullit: pushteti, pronat dhe ideologjia, që janë monopoli i një partie të vetme politike; kjo nënkupton, siç u përmend edhe më parë dhe po përdorim të njëjtin formulim, një klasë të re, oligarkinë e Partisë. Asnjë sistem totalitar në histori, qoftë edhe në kohët e sotme, përveç komunizmit, nuk arriti të kontrollonte në të njëjtën kohë të tria shtyllat për sundimin e popullit. […]

Gjilas, 1990, fq. 40, 79, 94, 138, 156.

1. Kush ishte Milovan Gjilasi?

2. Çfarë nënkuptonte Gjilasi kur fliste për "klasën e re"? Nga kush përbëhej kjo klasë?

3. Çfarë fenomenesh kritikonte Gjilasi?

III-5. Këshilli i zgjedhur i punëtorëve në fabrikën e çimentos në Prvoborac të Solinit

Me propozimin e Këshillit Qendror të Aleancës së Sindikatave të Jugosllavisë, kolektivi i punonjësve të fabrikës së çimentos Prvoborac, në Solin ka zgjedhur Këshillin e tij të Punëtorëve me 13 anëtarë. Për herë të parë u formua ky këshill i punëtorëve në rrethin e Splitit. Ai do të kryejë detyrat e planifikuara dhe do të jetë shumë i dobishëm për ndërmarrjen. [...] Detyra e këshillit të punëtorëve është mbikëqyrja e vazhdueshëm e punës së ndërmarrjes dhe trajtimi i hollësishëm i të gjitha çështjeve. Këshilli do t'i kushtojë vëmendje të veçantë promovimit të shtabit të ri, kontrollit të përmbushjes së planeve mujore dhe vjetore dhe shfrytëzimit të materialit të tepërt, duke ulur kostot e përgjithshme të prodhimit, duke zbatuar garat socialiste dhe disiplinën e punës dhe duke shpërblyer punëtorët më të mirë. Ai gjithashtu do të kujdeset për novatorët dhe ata që punojnë për mbarëvajtjen e procesit të prodhimit. Formimi i Këshillit të Punëtorëve nuk e ka nënvlerësuar rolin e drejtuesit të shoqërisë, sepse, si kreu i saj ai është anëtar i këshillit dhe së bashku ata merren me punët e shoqërisë. Këshilli përfshin gjithashtu punëtorët që janë më të familjarizuar me procesin e prodhimit. Ata tashmë mund të përvetësojnë njohuri profesionale të veçanta, të ndihmojnë ndërmarrjen dhe të stërviten për t'u bërë drejtuesit e ardhshëm të ndërmarrjes. Kjo është arsyeja pse kolektivi i fabrikës së çimentos Prvoborac zyrtarisht e zgjodhi administrimin e parë të punëtorëve.

Gazeta "*Vjesnik*", 10.01.1950 .

1. Cilat janë veçoritë e modelit jugosllav të socializmit?

2. Si mund t'i përkufizonit konceptet si: vetadministrimi dhe Këshilli i punëtorëve?

III-6. Përfshirja e fëmijëve në arsimin ideologjik

Themelimi i Bashkimit të Pionierëve të Jugosllavisë gjatë luftës, në vitin 1942, tregon rëndësinë që autoritetet e ardhshme socialiste iu dhanë të rinjve. Bashkimi i pionierëve mblodhi fëmijët midis moshës 7 dhe 15 vjeçare; pas kësaj moshe ata bëheshin anëtarë të Lidhjes së Rinisë Socialiste të Jugosllavisë. Ceremonia e regjistrimit të nxënësve të klasave të para në shkollat fillore ishte një rast shumë formal që u zhvillua në të gjitha shkollat në Ditën e Republikës, më 29 nëntor. Gjatë ceremonisë, pionierët u zotuan në mënyrë solemne dhe morën një broshurë anëtarësimi, një shall të kuq dhe një kapele blu me një yll të kuq, të quajtur Titovka. Kjo ishte një mënyrë për t'i përfshirë fëmijët në sistemin ideologjik dhe politik, ku ata luajtën një rol të rëndësishëm propagandistik.

A. Simbolet

Kapelja dhe shalli i pionierëve

Simbol i pionierit

Koleksion privat.

B. Zotimi i Pionerëve

Sot, teksa po bëhem pionier,
Jap fjalën e nderit të Pionierit,
Që do të studioj dhe do të punoj me zell,
Do të respektoj prindërit e mi dhe të moshuarit,
Dhe do të jem një shok dhe mik besnik dhe i sinqertë.
Se do ta dua atdheun tonë, Republikën e vetadministruar Federale Socialiste të Jugosllavisë.
Se do të propagandoj parimet e Bashkim-vëllazërimit dhe parimet për të cilat ka luftuar shoku Tito.
Dhe do t'i vlerësoj të gjithë popujt e botës
që respektojnë lirinë dhe paqen!

Studioni me kujdes burimet e Kapitullit III. 1 (tekstin dhe materialin pamor). Më pas vini re:

1. Fjalorin e veçantë lidhur me llojin e regjimit politik të shteteve të përmendura.

2. Detyrimet e qytetarëve ndaj regjimit dhe mënyrës si ato shpreheshin

3. Elementet që tregojnë se regjimi i përngjan një diktature.

4. Procedura e ndjekur nga qytetarët, për të shprehur besnikërinë dhe përkushtimin ndaj regjimit.

5. Aspekti ceremonial i këtij procesi.

6. Mënyra se si trajtohen personat që shprehin mendime të ndryshme.

7. Përcaktoni dhe diskutoni mbi termin "Socializmi real".

III.2. REGJIMET USHTARAKE

III.2.1. Diktatura ushtarake në Turqi

Turqia zbatoi parimin e pluralizmit dhe u përfshi në Bllokun Perëndimor në mes të viteve '40. Në vitin 1950, Partia Republikane Popullore (PRP) e Ismet Inonut i humbi zgjedhjet pas 27 vitesh sundimi. Megjithatë, midis viteve 1950 dhe 1983, vendi ose kaloi përmes regjimesh autoritare të djathta, ose përjetoi paqëndrueshmëri politike, shoqërore dhe ekonomike, që çuan në grushte ushtarake të shtetit. Partia Demokratike (PD) nën udhëheqjen e Adnan Menderes dhe Xhelal Bajarit, që ndoqi një

kurs më represiv pas zgjedhjeve të vitit 1957 nuk mundi të përballonte krizën ekonomike dhe një sërë protestash studentore dhe u rrëzua në vitin 1960, gjatë të parit grusht ushtarak të shtetit kundër një qeverie të zgjedhur. Në vitin 1971, pas tre vitesh aktesh dhune midis militantëve radikalë të majtë dhe militantëve radikalë të djathtë, dhe pas një periudhë krize financiare dhe ekonomike, ushtria e detyroi Kryeministrin Sylejman Demirel, të jepte dorëheqjen. Pas zgjedhjeve të tetorit të vitit 1973, ushtria hoqi dorë nga pushteti. Shumë shpejt pas kësaj ngjarjeje, Turqia kaloi një periudhë trazirash të rëndësishme politike dhe paqëndrueshmërie ekonomike. Ndërmjet viteve 1975 dhe 1980, rreth 5.000 qytetarë humbën jetën gjatë akteve të dhunshme politike, ndërkohë që gjatë situatës së përkeqësuar nga pasojat e pushtimit të Qipros në vitin 1974, vendi u përball me një sërë zhvlerësimesh të monedhës vendase (e fundit ishte me 48 për qind) dhe norma shumë të larta inflacioni (106 për qind në vitin 1980). Këto kushte lehtësuan grushtin ushtarak të tretë, në shtator të vitit 1980, të kryesuar nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm Kenan Evren. Regjimi i Evrenit, që zyrtarisht zgjati deri në zgjedhjet e nëntorit të vitit 1983, ishte regjimi më i ashpër dhe më konservator nga gjithë të mëparshmit. Duke u hequr si "Ataturku i dytë" dhe me synimin që të zbatonte "qemalizmin e vërtetë", Evreni e shndërroi të ashtuquajturën "Sinteza turko-islamike" në doktrinën e re zyrtare të shtetit.

III-7. Grushti i shtetit më 27 maj të vitit 1960

Deklarata e Komitetit të Bashkimit Kombëtar
Më 27 maj të vitit 1960, komiteti ushtarak i kryesuar nga Gjenerali Cemal Gursel mori pushtetin, pas disa ditësh trazirash politike. Grushti i shtetit pati mbështetje nga studentë dhe intelektualë dhe e caktoi ushtrinë si agjentin institucional në politikë, që përfaqësonte Kombin dhe Shtetin. Menderes, Bayar dhe figura të tjera udhëheqëse të qeverisë së Partisë Demokratike u arrestuan.

A. Deklarata e dhënë nga Forcat e Armatosura të Turqisë

Të dashur qytetarë, sot, Forcat e Armatosura të Turqisë, për shkak të krizës me të cilën po përballet demokracia dhe për të mos shkaktuar luftime të mëtejshme midis vëllezërve në sajë të ngjarjeve të fundit të vajtueshme, do të marrin përsipër administrimin e vendit. Forcat e Armatosura e kanë marrë përsipër këtë operacion për të shpëtuar partitë nga një shtet i egër që kemi trashëguan nga e kaluara. Ato do të organizojnë zgjedhje të drejta dhe të lira sa më shpejt të jetë e mundur nën mbikëqyrjen dhe gjykimin e një administrate të paanshme jopartiake dhe më pas do t'ia kalojnë administrimin e pushtetit fituesit të zgjedhjeve, pavarësisht krahut fitues.

Kjo nismë nuk ndërmerret kundër ndonjë personi apo grupi të caktuar.

Administrimi ynë do të heqë dorë nga të gjitha veprimet kërcënuese kundër çdo individi dhe asnjëherë nuk do të lejojë kryerjen e veprime të tilla. Pavarësisht qëndrimeve personale dhe partiake, çdo qytetar do të trajtohet sipas parimeve të ligjit. Për zgjidhjen e problemeve tona dhe vendosjen e mirëqenies së kombit tonë, është thelbësore që të gjithë qytetarët të kujtojnë se janë pasardhës të të njëjtit komb, se ne jemi mbi çdo parti, dhe se duhet ta trajtojmë njëri-tjetrin me respekt, mirëkuptim dhe pa urrejtje.

Ju kërkojmë anëtarëve të kabinetit të strehohen te Forcat e Armatosura të Turqisë. Siguria e tyre personale është e garantuar me ligj.

Ne u bëjmë thirrje aleatëve tanë, fqinjëve dhe të gjithë botës. Qëllimi ynë është t'i përmbahemi Kushtetutës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe parimeve të të drejtave të njeriut. Standardi ynë është parimi i Ataturkut të Madh: "Paqe në atdhe, paqe në botë". Ju qëndrojmë besnikë aleatëve tanë dhe zotimeve tona.Ne i besojmë dhe i zotohemi NATO-s dhe CENTO-s. Bindja jonë është: "Paqe në atdhe, paqe në botë".

https://tr.wikisource.org/wiki/27_May%C4%B1s_Darbe_Bildirisi, vizituar më 25.08.2016.

B. Çastet e fundit të Menderes para ekzekutimit me varje

http://alchetron.com/Adnan-Menderes-1318013-W, vizituar më 8.09.2016.

Organizata Qendrore e Traktatit (CENTO), fillimisht e njohur si Pakti i Bagdadit, ose Organizata e Traktatit të Lindjes së Mesme (METO), u krijua në vitin 1955 nga Irani, Iraku, Pakistani, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar. Ajo u shpërbë në vitin 1979.

Adnan Menderes (1899-1961) ishte një figurë udhëheqëse e opozitës politike në Partinë Republikane Popullore pas Luftës së Dytë Botërore dhe ishte një ndër themeluesit e Partisë Demokratike (PD). Pas fitores së PD-së në zgjedhjet e vitit 1950, Presidenti Xhelal Bajari zgjodhi ta emëronte atë kryeministër. Në vitet '50, Menderes ishte një ndër udhëheqësit me më shumë ndikim politik në Turqi. Nën qeverisjen e tij, Turqia dëshmoi "kryengritjen e gjelbër" (mobilizimi shoqëror dhe politik i zonave rurale) dhe ringjalljen e parimeve islamike. Ushtria turke e rrëzoi atë nga pushteti me anë të një grusht shteti, pa shënuar viktima në vitin 1960. Ai u dënua me vdekje për shkelje të Kushtetutës dhe urdhërimin e pogromit të jomyslimanëve (kryesisht pakicës greke) në Stamboll në vitin 1955

(Shihni Kapitullin II. 4.2).

Xhelal Bajar (1883-1986) ishte anëtar i Komitetit për Bashkim dhe Përparim (Turqit e rinj), mori pjesë në luftën për pavarësinë turke dhe shërbeu si kryeministër (1937-1939) dhe President i Republikës (1950 -1960). Ai ishte bashkëthemelues dhe udhëheqës i Partisë Demokratike. I persekutuar nga krerët e grushtit të shtetit të vitit 1960, së bashku me Adnan Menderes dhe anëtarë të tjerë të qeverisë, ai u dënua me burgim të përjetshëm. Bayarit iu fal dënimi në vitin 1966.

1. Cila ishte shtysa e deklaratës së Forcave të Armatosura të Turqisë?

Ku e vendosnin ato më shumë theksin?

Vlerësojini arsyet që parashtruan për justifikimin e ndërhyrjes së tyre, qëllimet dhe përkushtimin ndaj parimeve demokratike. Përse përpiqen ta justifikojnë ndërhyrjen në çështjet politike? Çfarë synojnë të arrijnë dhe cilave ide duan t'iu paraprijnë? Diskutoni këtë polemikë.

III-8. Ultimatumi i marsit të vitit 1971

Ushtria i dha ultimatum Kryeministrin Sulejman Demirel, më 12 mars të vitit 1971, duke e detyruar atë të jepte dorëheqjen. Turqia nisi një periudhë "Terrori të Bardhë", gjatë së cilës udhëheqësit kryesorë të së Majtës radikale, ose u ekzekutuan ose u vranë.

1. Me sjelljen, mendimet dhe veprimet e saj, qeveria e ka çuar vendin tonë në anarki, në luftime midis vëllezërve dhe në trazira shoqërore dhe ekonomike. Ajo nuk ka qenë në gjendje të kryejë reformat që parashikon Kushtetuta, duke rrezikuar në këtë mënyrë të ardhmen e Republikës së Turqisë. Opinioni publik ka humbur shpresën për arritjen e nivelit të qytetërimit që Ataturku na kishte caktuar ne si një objektiv.

2. Është e domosdoshme të krijohet një qeveri e fortë, e besueshme dhe jopartiake, që do ta zhdukë anarkinë që mbretëron, do të kryejë reformat e parashikuara në kushtetutë, sipas këndvështrimit Qemalist, do të zbatojë ligjet e revolucionit dhe do të bashkëpunojë me parlamentin për gjetjen e zgjidhjeve të duhura, për t'i dhënë fund trishtimit dhe dëshpërimit që kombi turk dhe që forcat e armatosura po përjetojnë në këtë situatë të dëshpëruar.

3. Nëse nuk formohet një qeveri e tillë në mënyrë të ngutshme, Forcat e Armatosura të Turqisë janë të vendosura ta ndërmarrin detyrën e tyre të shenjtë për mbrojtjen e Turqisë, sipas ligjeve në fuqi, dhe të vihen menjëherë në kontroll të administratës. Për dijeninë tuaj.

http://dosyalar.hurriyet.com.tr/haber_resim_3/12_mart_raporu.pdf, vizituar më 25.08.2016.

III-9. Grushti i shtetit, më 12 maj të vitit 1980

Më 12 shtator të vitit 1980, Këshilli i Sigurisë Kombëtare, i udhëhequr nga Gjenerali Kenan Evren, e rrëzoi qeverinë e pakicës së Sulejman Demirel. Gjatë regjimit të ri ushtarak, që zyrtarisht zgjati deri në vitin 1983 (por në fakt vazhdoi deri në fund të dhjetëvjeçarit), u ekzekutuan rreth 50 militantë, qindra të tjerë u vranë dhe 650.000 njerëz u arrestuan, ndërsa u ndalua përdorimi i gjuhës kurde në publik.

A. Faqja e parë e gazetës *"Hürriyet"*

Hürriyet

YILDIRIM BASKI

BÜTÜN YURTTA SIKIYÖNETİM İLAN EDİLDİ

Ordu yönetime el koydu

Hükümet ve Parlamento feshedildi, Siyasal partilerin faaliyetleri durduruldu. Parlamenterlerin dokunulmazlıkları kaldırıldı. Saat 05.00'ten itibaren sokağa çıkma yasağı başladı

Përkthimi: VENDOSJA E LIGJIT USHTARAK NË TË GJITHË VENDIN
Ushtria e ka marrë pushtetin në dorë.

B. Komunikata e parë e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, 12 shtator 1980

I nderuar komb i madh turk!
Republika e Turqisë, si një tërësi e shtetit dhe kombit që iu është besuar juve nga Ataturku i Madh, kohët e fundit ka qenë viktimë e sulmeve shpirtërore dhe fizike tradhtare nga armiq të jashtëm dhe të brendshëm, të drejtuara ndaj vetë ekzistencës, rendit dhe pavarësisë së saj.

Shteti ka treguar dobësi në ndërmarrjen e veprimeve nëpërmjet institucioneve kryesore të tij; pasi organet kushtetuese, ose kanë mosmarrëveshje të brendshme ose kanë heshtur; partitë politike, me diskutimet dhe mosmarrëveshjet e tyre të paefektshme, nuk mundën ta siguronin bashkimin dhe unitetin e duhur, për ta shpëtuar shtetin dhe nuk mundën të ndërmerrnin masat e nevojshme. Rrjedhimisht, fuqitë shkatërruese dhe separatiste i shtuan veprimtaritë e tyre në maksimum dhe vunë në rrezik jetën e qytetarëve dhe pronat e tyre.

Në vend të Qemalizmit, u krijuan shumë ideologji reaksionare dhe ideologji të tjera të shtrembëruara, për të ushtruar trysni ndaj institucioneve arsimore, nga shkollat fillore e deri në universitet; në sistemin e administratës; në organet e gjyqësorit; në agjencinë e sigurisë së brendshme; në organizatat e punës; në partitë politike; madje edhe te qytetarët në zonat më të largëta dhe të thella të vendit, duke i çuar ata deri afër pragut të luftës civile dhe përçarjes. Thënë shkurt, Shteti mbeti i pafuqishëm dhe pa përkrahje.

Komb i lavdishëm turk,

Si pasojë e këtyre ngjarjeve, Forcat e Armatosura të Turqisë vendosen të kryenin detyrën e caktuar nga Ligji i Shërbimit të Brendshëm, të ruajnë dhe të mbrojnë Republikën e Turqisë, në emër të kombit turk, dhe në kuadër të drejtimit dhe të kontrollit të shtetit morën përsipër administratën e vendit.

Qëllimi i operacionit të mësipërm është mbrojtja e integritetit të vendit, garantimi i bashkimit kombëtar, parandalimi i një lufte të mundshme civile dhe luftimeve midis vëllezërve, rivendosja e autoritetit dhe pranisë së shtetit dhe kufizimin e shkaqeve që pengojnë funksionimin e rendit demokratik.

Parlamenti dhe qeveria janë shpërndarë. Është hequr imuniteti i Anëtarëve të Parlamentit. Ligji ushtarak është shpallur në të gjithë vendin.

Ndalohet udhëtimi jashtë shtetit. Për të mbrojtur jetën dhe pronën e qytetarëve, ora e ndalim qarkullimit dhe e mbylljes në shtëpi do të jetë ora 17.00, deri në një njoftim të ri. Informacion më i hollësishëm për këtë operacion për mbrojtjen e kombit do të jepet nga unë në buletinin e lajmeve të Radiotelevizionit të Turqisë, në orën 13.00. Pres nga qytetarët të dëgjojnë me vëmendje dhe me qetësi komunikatën e dhënë në radiotelevizion, si edhe t'i binden asaj dhe të kenë besim te Forcat e Armatosura të Turqisë, që janë pjesë e popullit.

Kenan Evren

www.tbmm.gov.tr/tutanaklar/TUTANAK/MGK_/d01/ c001/ mgk_01001001.pdf, vizituar më 25.08.2016.

1. Çfarë fjalori përdorën Forcat e Armatosura të Turqisë për t'iu referuar pezullimit të politikës së Parlamentit?

2. Si i drejtohen popullit turk?

Sipas tyre, cili është rreziku më i madh që po i kanoset Republikës? Si i kuptoni referencat që i bëhen Qemalizmit në burimet e mësipërme?

III.2.2. Diktatura e kolonelëve në Greqi

Grushti i shtetit i 12 prillit të vitit 1967, shënon fundin e periudhës që në histori njihet si "demokracia e kontrolluar". Kjo periudhë nisi në vitin 1946 dhe përshkohej nga ndërhyrja e fuqishme e ushtrisë dhe nga një ndërthurje e çuditshme e veprimtarisë demokratike dhe autoritare në jetën politike dhe administrative të vendit. Grushti i shtetit, i organizuar disa javë përpara mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare, që parashikoheshin gjerësisht të çonin në fitoren e Bashkimit të Qendrës, ndërpreu procesin e sforcuar të demokratizimit, që kishte filluar në fillim të viteve '60, duke e futur vendin në gjendje frike dhe heshtje për shtatë vite.

III-10. Ekstrakt nga fjala përshëndetëse e Kolonelit Jorgos Papadopulos, gjatë një konference për shtyp të mbajtur në Athinë, më 27 prill të vitit 1967

Me praninë e gazetarëve grekë dhe të huaj, konferenca për shtyp u mbajt jo më shumë se një javë para organizimit të grushtit të shtetit. Atje, koloneli Jorgos Papadopulos, udhëheqësi i padiskutueshëm i të vetëquajturit "Revolucion", e cilësoi kërcënimin komunist si arsyen kryesore për ndërhyrjen e ushtrisë.

Pavarësisht thirrjeve të përsëritura nga Sovrani sundues, vendi ishte në krizë dhe duke u përpjekur për të gjetur një rrugëdalje nga situata e bllokuar politike, që e kishte përfshirë [për shkak të] paaftësisë së elementëve politikë për të arritur një marrëveshje. Asnjë udhëheqës politik nuk mori përsipër ta ndihmonte Sovranin, që më kot kërkonte një zgjidhje brenda kuadrit kushtetues. Askush nuk ishte i gatshëm të sakrifikonte interesat e tij për interesat e kombit. Së bashku me një ide anarkike [të gjërave], që i ishte imponuar shumicës së shoqërisë, kjo situatë kishte evidentuar rrezikun përfundimtar të komunizmit duke penguar përparimin e vendit.

Të përballur me këtë situatë, Ushtria Kombëtare, Forcat e Armatosura të vendit, e vetmja forcë neutrale që ekzistonte, gjykoi se duhet të ndërhynte për të ndalur rrëshqitjen drejt greminës.

Asnjëherë etërit e filozofisë greke nuk i kanë cilësuar liritë demokratike si pandëshkueshmëri. Qëllimi i konceptit të demokracisë janë idetë e disiplinës, rendit, hierarkisë dhe bindjes ndaj ligjit. Sipas këtij këndvështrimi, ne kemi të drejtë ta cilësojmë veten si demokratë dhe t'iu kërkojmë që të na njihni si të tillë. Disa mund të përbëjnë përjashtim për disa kufizime që janë vendosur. Zotërinj, mos harroni. Përpara nesh kemi një të sëmurë që duhet ta fusim në sallën e operacionit. Nëse kirurgu nuk është i qetë gjatë operimit, ka gjasa që ai ta çojë drejt vdekjes pacientin, në vend që ta shërojë. Kjo është përgjigja që duhet të prisni [nga Ne] nëse, duke folur për demokraci dhe liri, ju do t'iu referoheshit kufizimeve të vendosura. Këto kufizime kërkojnë shtrimin e të sëmurit në shtratin e operacionit, në mënyrë që operimi të kryhet me sukses dhe pa lëndime.

Papadopulos, 1969, vëll. II, fq. 10 -11.

III-11. Hyrje në antologjinë e shkrimeve greke të botuara pas heqjes së censurës (1970)

Pas heqjes së censurës, që junta e solli si risi pas uzurpimit të pushtimit, në prill të vitit 1967, shkrimtarë grekë të shquar, që deri më tani nuk kishin botuar ndonjë vepër për shkak të rrethanave, bënë një antologji të shkurtër me shkrime të reja.
Me titullin e thjeshtë "Tetëmbëdhjetë tekste", antologjia përbëhej nga poema dhe tregime të shkurtra, tema e së cilës ishte shtypja dhe censura.

Me botimin e kësaj vepre origjinale të letërsisë në këtë vëllim për herë të parë pas tre vitesh [heshtjeje], ne besojmë se po kontribuojmë në përpjekjen për të rishqyrtuar problemin me të cilin përballen autorët grekë në këtë moment.

Heqja e censurës nuk mjafton për arritjen e emancipimit të jetës letrare të një vendi, ndërkohë që hapësira të rëndësishme janë ende në ngërç, gjë që e bën të pamundur përshkrimin dhe vlerësimin e tyre të gjithanshëm. Megjithatë, pasi të shqyrtojmë rëndësinë [e situatës], do të përpiqemi të rigjejmë besimin tonë në disa vlera themelore, ndër të cilat më e rëndësishmja është e drejta për liri intelektuale dhe artistike; asnjë nuk mund të mos e pohojë, pasi ajo lidhet në mënyrë të pandashme me [parimin] e respektimit të mendimit dhe integritetit të të gjithë autorëve, dhe jo vetëm atyre por të të gjithë njerëzve.

Ky besim dhe pretendim i zakonshëm, që na bashkon përtej dallimeve në pikëpamje dhe stil, theksohet nga ky [vëllim] me grup autorësh.

Δεκαοκτώ κείμενα [Tetëmbëdhjetë tekste], 1970, hyrje.

III-12. Junta

Amalia Fleming, gruaja dhe asistentja e Aleksander Fleming, fitues i çmimit Nobel, ishte mikrobiologe me profesion. Për shkak të kundërshtimit të saj të hapur ndaj juntës, ajo u arrestua dhe u torturua, përpara se të dëbohej dhe t'i hiqej shtetësia e saj greke.

[…]djem dhe vajza të moshës studentore filluan të shkruanin parulla në mure dhe të shpërndanin fletëpalosje me informacione nga radiostacionet e huaja […]. Disa nga të rinjtë më aktivë, shumica e të cilëve ishin studentë, u arrestuan dhe iu nënshtruan torturave të tmerrshme. Torturimi ndaloi vetëm kur ata ranë në koma, ose u thyen dhe folën, duke dhënë emrin e një shoku. Pastaj ky shoku do të arrestohej dhe do të trajtohej në të njëjtën mënyrë derisa të fliste edhe ai. Departamenti i shtabeve të policisë së sigurimit që merrej me torturën e studentëve quhet "Departamenti intelektual".

Tortura më e zakonshme është fallakaja, goditja e shputave të këmbëve me dru […]. Vdekja nga uria; privimi nga uji; qëndrimi në këmbë për ditë e net të tëra; goditje elektrike; torturimi i të dashurës së viktimës; djegiet e cigareve në trup; janë tortura të përdorura në masë. Detajet janë shkruar njëqind herë. Për çfarë arsye t'i përsërisim? Sepse ato ende vazhdojnë. Sepse kam takuar disa viktima dhe i dëgjova rrëfimet nga ata por, edhe i pashë plagët e tyre.

Fleming, 1972, fq. 34-35.

III-13. Rezistenca kundër Juntës: Aleksandros Panagulis

Më 13 gusht 1968, Aleksandros Panagulis, një ish aktivist në lëvizjen rinore të Bashkimit të Qendrës, u përpoq të vriste dorën e fortë të juntës greke, Kolonelin Jorgos Papadopoulos.
.Pas arrestimit të tij dhe pas disa javësh hetimi dhe torture, në nëntor të vitit 1968 u dënua me vdekje (masa e dënimit u ul në burgim të përjetshëm). Gjykimi i tij nxori në pah cenimin në mënyrë të tmerrshme nga ana e regjimit të të drejtave të njeriut, praktikat e të cilit përfshinin torturën dhe përndjekjen e disidentëve, që kryheshin nga policë famëkeq ushtarakë.



Rezistenca greke. Alekos Panagoulis. Një kontribut i brezit të ri kundër tiranëve të popullit tonë. Jeta e luftëtarit të paepur të demokracisë, është në kanosje të vazhdueshme. Heroi Panagoulis duhet të shpëtohet nga duart e tiranit. Koleksion privat.

1. Duke iu referuar luftës civile midis demokratëve dhe oligarkëve në ishullin e Korfuzit, në verën e vitit 427 p.e.s., Thukididi (Istoriai 3, 82-83-Patologjia e Luftës) vë në dukje:

"Ata ndryshuan kuptimin e zakonshëm të fjalëve dhe nuk iu dhanë atyre kuptimin e vërtetë, por atë që iu leverdiste atyre". A mund ta dalloni këtë në fjalimin e mësipërm të diktatorit Papadopulos (III-10)?

2. Cili është armiku dhe rreziku kryesor për kombin grek sipas Papadopoulosit? Si iu imponuan "frika dhe heshtja" qytetarëve grekë, nga junta?

3. Krahasoni situatën e përshkruar në burimet e mësipërme me atë të përshkruar në Raportin Vjetor të vitit 1981 të Amnistisë Ndërkombëtare në Turqi (burimi III-15). Më pas, shënoni fjalët e përdorura me një kuptim të shtrembëruar. Diskutoni.

→

	Turqia	Greqia
Referencat/ Fjalët e përdorura nga junta		

4. Krahasoni zhvillimet politike në vendet komuniste të Evropës Juglindore, me ato në Turqi dhe Greqi. Gjeni ngjashmëritë dhe ndryshimet.

III.3. PËRNDJEKJA E QYTETARËVE: KAMPE DHE BURGJE

III-14. Trashëgimia e Luftës Civile në Greqi

A. Kampi në Makroniso (1947-1950). Fotografi propagandistike

Ushtarët e "riedukuar" në ishullin e Makronisos, 14 qershor 1949; Gazeta "Associated Press".

Gjatë luftës civile, ishulli i pabanuar i Makronisos, përballë bregdetit të Atikës, shërbeu si një kamp për indoktrinimin e qindra disidentëve politikë të majtë, përshirë edhe anëtarë partie, intelektualë dhe rekrutë. Këta të fundit, pasi "riedukoheshin" në mënyrë të suksesshme, dhe riedukimi përfshinte dënimin e komunizmit dhe gjithçka që ai përfaqësonte, nëpërmjet nënshkrimit të një deklarate pendimi, dërgoheshin për të luftuar kundër ish-shokëve të tyre. Në shtator të vitit 1947, rreth 12.000 ushtarë dhe oficerë u burgosën në "Panteonin e ri", siç u përshkrua nga qeveria e Athinës. Kompozitori me famë botërore, Mikis Theodorakis, poeti Janis Ritsos, fitues i Çmimit Ndërkombëtar të Paqes "Lenin" dhe artistë e intelektualë, ishin mes atyre që u internuan në ishullin famëkeq. Kampi u mbyll në vitin 1950, një vit pas përfundimit të luftës civile.

Përshkruani fotografinë. Përse është një fotografi propagandistike? Lexoni informacionin te çelësi dhe shpjegoni përmbajtjen e "riedukimit" të të burgosurve komunistë.

B. Ekstrakt nga letra që e burgosura politike, Avgi Haralampidi, i dërgon djalit të saj në tetor të vitit 1959, mbi gjendjen shumë të vështirë të të burgosurve të liruar

Megjithëse numri i tyre ishte pakësuar ndjeshëm pas mbylljes së kampit të përqendrimit në Makroniso dhe me futjen e të ashtuquajturave "masa paqësimi", në vitet 1950 dhe 1952, në vitin 1962 ende ishin rreth 1.500 të burgosur politikë që vuanin në kampet e përqendrimit dhe në burgje, dhe jo të gjithë ishin përkrahës të Partisë Komuniste të Greqisë (KKE). Siç na sugjeron letra e Avgisë, në disa raste të burgosurit liroheshin nga vendet e internimit, në rastin tonë nga ishulli i Agios Efstatios dhe shkuan në qytetet e Greqisë kontinentale, shumë larg nga shtëpitë e tyre. Ata ishin nën vëzhgim nga policia, duhet të gjenin strehim dhe një mënyrë për të fituar para, pa mbështetjen e shtetit.

I dashur, po të njoftoj se jam në Spartë. Nga [ishulli i] Agios Efstatios u larguam më 23 tetor dhe mbërritëm në Pire më 26 tetor. U përballem me vdekjen gjashtë herë, por na shpëtuan. Të gjitha plaçkat e mia janë lagur. Fle në një krevat kampi; palltoja dhe një jastëk që kam vënë aty, e bëjnë edhe më të ngushtë. Siç thotë shprehja: "Bëj një jetë prej spartani në Spartë". Kam tre ditë këtu dhe ende nuk më kanë sistemuar. Po më mbajnë në qelinë e paraburgimit, në zyrat e komisariatit. I ankohem policit, i ankohem kryepolicit, i ankohem adjutantit. Dhe përgjigja e tyre është: "Shko dhe merr një shtëpi me qira, gjej një punë dhe jeto…je e lirë. Të kanë sjellë këtu dhe të kanë vënë nën vëzhgimin tonë".

Jam në mëshirë të tyre. Ku mund t'i gjej paratë për të marrë një shtëpi? Dhe si mund të gjej punë për të jetuar në një vend të huaj? Megjithatë, nuk dëshpërohem e as nuk po e humbas toruan, fare, as për një sekondë. Çdo peripeci me jep më shumë guxim dhe fuqi.

Arkivi i Historisë Shoqërore Bashkëkohore (ASKI), Arkivi i EDA-s, d. 124.

C. Ekstrakt nga fjalimi i mbajtur në fushatën zgjedhore nga Nikolaos Plastiras, duke premtuar amnisti dhe "paqësim", shtator 1951

Nikolaos Plastiras (1883-1953) ishte oficer ushtarak, që u ngrit deri në rangun e gjeneralit. Ai i tregoi aftësitë e tij në Luftërat Ballkanike (1912-13), gjatë fushatës në Ukrainë (1919) dhe Azinë e Vogël (1919-22). Duke qenë se ai ishte përkrahës i flaktë i Venizelosit, gjatë periudhës midis luftërave ai drejtoi një revoltë ushtarake pas Katastrofës së Azisë së Vogël (kur ushtritë greke u thyen nga ushtritë e Mustafa Kemal Ataturkut në 1922) dhe dy përpjekje për grushte shteti (në vitin 1933 dhe 1935). Ai u përfshi në politikë pas çlirimit të vendit nga fuqitë e Boshtit dhe qëndroi në postin e kryeministrit nga janari deri në prill të vitit 1945. Në vitin 1949, ai themeloi Partinë Qendrore Përparimtare Liberale, që në aleancë me Partinë Përparimtare Demokratike, e njohur si Bashkimi i Qendrës Përparimtare Kombëtare (EPEK), i kundërshtuan zgjedhjet e vitit 1950. Midis marsit dhe gushtit të vitit 1950, ai kryesoi një qeveri koalicioni me Partinë Liberale dhe me Partinë e Jorgos Papandreu. Megjithëse në zgjedhjet e vitit 1951 EPEK-u ishte forca e dytë fituese, Plastiras sërish kryesoi një qeveri koalicioni me Partinë Liberale nga tetori i vitit 1951 deri në tetor të vitit 1952.

I premtoj popullit grek, se nga çasti që do të formoj një qeveri homogjene, dhe nuk ka dyshime se do ta bëjë këtë, brenda dy ose tre muajve do të sjell paqen në vend, duke dhënë amnisti. Bashkimi nuk mund të arrihet nëse nuk e falim të shkuarën, nëse fëmijët e popullit nuk kthehen në shtëpitë e tyre. E kam thënë disa herë dhe do ta përsëris edhe një herë: Është e turpshme të ekzistojnë kampe internimi. Është e turpshme të ketë të burgosur që nuk janë gjykuar kurrë. Është e turpshme të themi se jemi demokratë …dhe ende nuk kemi pare asnjë gjurmë të demokracisë. Kur populli të më japë pushtetin, do të zhduk edhe ata elementë që kanë

mbetur nga Policia e Shtetit, siç e kam deklaruar edhe në manifestin e partisë. Do t'i trajtoj të gjithë grekët në mënyrë të barabartë.

Gazeta "*Proodeutikos Fileleutheros*" (Përparimtare Liberale), 6.09.1951.

1. Studiojini me kujdes burimet III-14A, B dhe C. Çfarë "zonash internimi" përshkruhen në këtë pjesë?Cili ishte qëllimi i tyre dhe kush dërgohej në to? Mendoni se procedura e dërgimit të njerëzve në zonat e internimit ishte e ligjshme? Përdorni argumente duke u bazuar në tekst.

2. Diskutoni rreth shprehjes "Bashkimi nuk mund të arrihet, nëse nuk e falim të shkuarën". Cilës së shkruar i referohet Nikolaos Plastiras?

3. Organizoni një diskutim në klasë për deklaratën e mësipërme të kryeministri grek. Nxënësit duhet të diskutojnë nëse mund të falen krimet e së shkuarës.

4. Vende, si Makronisos, që mbartin kujtime të dhimbshme historike, përdoren si muze të hapura. Vende të tilla tërheqin shumë vizitorë që, ndërkohë që përkujtojnë të kaluarën e dhimbshme, ndjekin edhe veprimtari kulturore. Gjeni shembuj të vendeve përkujtimore të këtij lloji dhe diskutoni rreth çështjes së përdorimit të tanishëm. Cilat janë pikëpamjet tuaja për "turizmin e kujtesës"? Krahasojeni me burimin III-16 dhe me Vëll. 2, Kap. VI (Burgu i Rumanisë, etj.)

VEPRIMTARI TË TJERA

Shikoni këtë film: "Comme des lions de pierre à l'entreée de la nuit"nga Olivier Zuchuat. https://www.youtube. com/watch?v=9MSOtL_2j34, accessed on 26.08.2016.

III-15. Ekstrakt nga raporti vjetor për Turqinë i Amnesty International, viti 1981

Shqetësimet kryesore të Amnesty International ishin torturat, ekzekutimet, dënimet me vdekje, dhe mbajtja e të burgosurve politikë. Vazhdoi dhuna që e çoi në qindra numrin e të vdekurve, që prej vitit 1975. Ligji ushtarak, i imponuar në dhjetor të vitit 1978, në 13 nga 67 krahina të Turqisë, u përditësua në intervale dy-mujore dhe u zgjerua për të mbuluar 20 krahina, por vrasjet, si nga grupet e të djathtëve ashtu edhe të majtëve, u shtuan dhe arritën në më shumë se 5.000 veta deri në 12 shtator të vitit 1980, kur udhëheqësit ushtarakë të Turqisë e shpërbënë parlamentin, pas grushtit të shtetit dhe e imponuan ligjin ushtarak në të gjithë vendin. Gjenerali Kenan Evren, Shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura njoftoi se pushteti legjislativ dhe ekzekutiv do të vihej në duart e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, të kryesuar nga ai vetë. Por, në dhjetor u formua edhe qeveria, e kryesuar nga admirali i dalë në pension Bulent Ulusu.

Mijëra persona u burgosën, përfshirë anëtarë të parlamentit, anëtarë të partive politike dhe kryetarë sindikatash. Kohëzgjatja e paraburgimit pa ndonjë akuzë, sipas ligjit ushtarak, u shtua nga 15 në 30 ditë dhe më pas në nëntor të vitit 1980 u shtua në 90 ditë. U ndalua veprimtaria e sindikatave profesionale dhe politike dhe u mbyllen tre gazeta, "Aydınlık" dhe "Demokrat" të spektrit të majtë dhe "Hergun" të spektrit të djathtë. Ndryshimet e mëvonshme në rregulloret e ligjit ushtarak shtuan pushtetin e komandantëve ushtarakë, duke iu dhënë atyre kontroll mbi korrespondencën, komunikimet, censurën e shtypit dhe të gjitha veprimtaritë e sindikatave profesionale. Sipas ligjit të ri, njerëzit mund të burgoseshin nga gjashtë muaj deri ne dy vite për shpërndarje "informacioni të rremë, të pabazë ose të deformuar, me qëllim alarmimin e publikut". Dënimi do të dyfishohej nëse shkelja kryhej nëpërmjet medias dhe, nëse në këtë vepër përfshihej edhe një i huaj, dënimi nuk do të ishte më pak se një vit. Një ndryshim tjetër përfshinte dënimet deri në tre vite, të miratuara nga gjykatat ushtarake, që nuk mund të apeloheshin.

Raporti Vjetor i Amnistisë Ndërkombëtare 1981, fq. 22-323 https://www.amnesty.org/en/documents/pol10/0001/1981/en/, vizituar më 26.08.2016.

III-16. Rasti i Rumanisë

A. Afishe për turistë e Cetatea Fagarashului në vitet '70

Fotografi nga Stefan Petraru, Konstantin Katrina, "përkujtimorja "Brashovul" Bukuresht, Editura Sport-Turism, 1976.

Kalaja e Fagarashit u mor nën administrim nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në vitin 1950 dhe funksionoi si burg për dhjetë vite. Të burgosurit e parë ishin anëtarë të departamenteve të Policisë së Shtetit dhe shërbimeve të fshehta të periudhës midis dy luftërave botërore, më pas ishin anëtarët e organizatave antikomuniste dhe kundërshtarët e kolektivizimit që ndërmorri pushteti komunist pas luftës. Kushtet e këqija të jetesës, si ato të higjienës, shëndetit dhe ushqyerjes, që të burgosurit duhet të përballonin, çuan në rritjen e vdekshmërisë. Në vitin 1960, kur u mbyll burgu, kalaja u bë muze për krahinën e Fagarashit. Në vitin 1976, regjimi komunist filloi ta promovonte kalanë si një monument kulture, duke anashkaluar faktin se kishte funksionuar si burg në vitet '50.

B. Ekstrakt nga Vendimi Nr. 221/1948 i Presidiumit të Asamblesë së Madhe Kombëtare për themelimin e Drejtorisë së Përgjithshme për Sigurimin e Popullit, në gusht të vitit 1948

Neni 1. Themelohet brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme Drejtoria e Përgjithshme e Sigurimit të Popullit.

Neni 2. Drejtorisë i caktohet si detyrë mbrojtja e arritjeve demokratike të Republikës Popullore të Rumanisë dhe garantimi i sigurimit të popullit kundrejt intrigave të armiqve të brendshëm dhe të jashtëm.

Neni 3. Organizimi, përgjegjësitë dhe funksionimi i të gjitha shërbimeve qendrore dhe të jashtme të Drejtorisë të rregullohen nga vendime dhe udhëzime të brendshme nga Ministria e Punëve të Brendshme. Këto vendime dhe udhëzime nuk duhet të bëhen publike. Pasi regjistrohen në një regjistër të veçantë dhe iu kmunikohen organeve kompetente, ato bëhen urdhra ekzekutivë.

Neni 4. Vetëm oficerët e sigurisë kanë të drejtë të ndërmarrin veprime kundër shkeljeve që i kanosen regjimit demokratik dhe sigurisë së popullit.

Neni 6. Normat e emërimit, administrimit dhe shkarkimit, si edhe ato të të drejtave dhe detyrimeve të personelit të Drejtorisë, janë të përcaktuara në Statutin e Oficerëve dhe Nënoficerëve të Drejtorisë, që nuk botohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 7. Pavarësisht parashikimit në ligjin për llogaridhënien publike, buxheti i Drejtorisë do të publikohet vetëm si një shumë e përgjithshme, pa ndarjet e veçanta, në buxhetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Fletorja Zyrtare, pjesa I, nr. 200 (30 gusht 1948), fq. 7245-7246.

1. Studiojeni me kujdes vendimin. Përqendrohuni në Nenin 2: Përse u themelua Drejtoria e Përgjithshme për Sigurinë e Popullit? Cili ishte qëllimi i saj i shpallur?

2. Komentoni dhe diskutoni frazat e mëposhtme: "Këto vendime dhe udhëzime nuk duhet të bëhen publike" (Neni 3), dhe "buxheti i Drejtorisë do të publikohet vetëm si një shumë e përgjithshme, pa ndarjet e veçanta" (Neni 7). Në këtë pikë, përshkruani dhe diskutoni funksionin e Drejtorisë.

III-17. Rasti i Bullgarisë

A. Vendimi II, Nr. 17 i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bullgarisë, 27 korrik 1977, mbi kufizimin dhe neutralizimin e veprimtarive armiqësore të emigracionit bullgar dhe mbi përmirësimin e përzgjedhjes dhe udhëzimit për qytetarët bullgarë që udhëtojnë jashtë shtetit

Në sajë të përmirësimit të marrëdhënieve ndërkombëtare, shërbimet e inteligjencës dhe qendrat e propagandës subversive të kundërshtarëve tanë, po i përqendrojnë përpjekjet e tyre në përdorimin më agresiv dhe në mënyra të ndryshme të kategorive të ndryshme të emigrantëve, duke i përfshirë në veprimtari armiqësore kundër Republikës Popullore të Bullgarisë [...].Byroja Politike vlerëson se është e kështillueshme të përmirësohet dhe të nxitet më shumë puna që synon në diskreditimin dhe izolimin politik, ideologjik dhe organizativ të emigracionit armiqësor bullgar dhe në privimin e mundësisë për të kryer veprimtari armiqësore kundër Republikës Popullore të Bullgarisë. Veprimtaria e Ministrisë së Punëve të Brendshme kundër emigracionit armiqësor do të përqendrohet kryesisht në diskreditimin dhe korruptimin e organizatave të saj; nxitjen e mosmarrëveshjeve ekzistuese dhe krijimin e mosmarrëveshjeve të reja; parandalimin e bashkimit të tyre; diskreditimin dhe kundërpërgjigjen ndaj veprimtarisë së udhëheqësve më aktivë të emigrantëve; dhe në nxitjen e mosbesimit te shërbimeve të inteligjencës së kundërshtarëve kundrejt [emigracionit bullgar] dhe ndjekësve të tyre; në parandalimin e krijimit të pakontrolluar të kontakteve kriminale me persona brenda territorit të vendit.

http://desebg.com/2011-01-13-09-23-35/1406-2013-08-26-07-52-55, vizituar më 26.08.2016.

B. Afishe propagandistike për festën e pesëvjetorit të Policisë së Popullit dhe Sigurimit të Shtetit, viti 1950

НБКМ [Biblioteka Kombëtare e Shën Cirilit dhe Shën Metodit], Гр VI.

C. Ekstrakt nga letra e Gjergji Markov drejtuar prindërve të tij

Babai thotë se gjykata në një seancë të mbyllur (përse jo të hapur?), më ka dënuar me gjashtë vite burg, ose ndoshta pak më shumë. Duke pasur parasysh reputacionin e keq të gjykatave bullgare, që kanë dënuar shumë njerëz të pafajshëm me vdekje dhe burgim, kjo nuk më befasoi. Kjo vetëm më kujton se sa e drejtë është rruga që unë kam zgjedhur. Në përgjigje të akuzave kundër meje, mund të them se të dyja akuzat janë të pabaza. Pikë së pari, nuk u largova, por autoritetet i stisën në mënyrë artificiale, dhe qëllimisht, rrethanat që më detyruan të bëhesha person i "dëbuar". Disa persona në Bullgari duhet të justifikojnë pagat e tyre, duke sajuar armiq. Ndalimi i vënies në skenë të dramave të mia, akuzat kundër meje, shkarkimi im [si skenarist i serialit televiziv] "Në çdo kilometër", që është krijimi im, kërcënimet dhe shantazhet kundër meje kishin filluar shumë kohë para se të bëja ndonjë gjë dhe pa ndonjë shkak nga ana ime.

Natyrisht, qëllimi ishte që kthimi im në Bullgari të bëhej i pamundur. Së dyti, unë kurrë nuk i kam shërbyer dhe nuk i shërbej ndonjë shteti apo organizate të huaj. BBC-ja, ku transmetoj një program kulturor, është një radiostacion i pavarur, në të cilin punojnë njerëz nga e gjithë bota dhe që në shumë raste kanë transmetuar kumtesa objektive dhe pozitive për Bullgarinë. Kolegët e mi hungarezë, polakë, rumunë dhe jugosllavë, që punojnë në seksionet përkatëse të BBC-së, e vizitojnë atdheun e tyre disa herë në vit, pa menduar se mund të akuzohen për faktin që punojnë për BBC-në. Madje edhe punonjësit e seksionit rus shkojnë në Rusi. A nuk mendojnë njerëzit e sigurimit bullgar se po e teprojnë pak si shumë? Së treti, deri më sot, askush këtu, nuk më ka thënë çfarë të shkruaj apo çfarë të them. Çdo gjë që kam shkruar dhe kam thënë ka qenë mendimi im personal. Sipas Kushtetutës sonë dhe Kartës së OKB-së për të Drejtat e Njeriut, askush nuk mund të më heqë të drejtën për të shprehur mendimin tim. Vetëm ata që heshtin nuk kanë mendime të tyre.

Hristov, 2006, fq. 193.

Gjergji Ivanov Markov (1929-1978) ishte një novelist dhe dramaturg bullgar disident. Ai botoi romanin e tij të parë në vitin 1957. Markovi ka shkruar edhe disa drama, por shumica e tyre nuk u vunë asnjëherë në skenë, ose u hoqën nga repertori i teatrit nga censorët. Në vitin 1969, ai u largua për në Itali. Ai kishte bërë plan të kthehej pasi marrëdhëniet e tij me autoritetet bullgare u përmirësuan, por në shtator të vitit 1971 qeveria bullgare nuk pranoi t'ia shtynte afatin e pasaportës së tij dhe kështu që vendosi të qëndronte në Perëndim. Ai shkoi më pas në Londër, ku mësoi anglisht dhe filloi të punonte për seksionin bullgar të Shërbimit Botëror të BBC-së. Ai ka punuar edhe për "Deutsche Welle" dhe Radion "Free Europe". Në vitin 1972, anëtarësimi i Markov në Bashkimin e Shkrimtarëve Bullgarë u pezullua dhe ai u dënua me gjashtë vite e gjashtë muaj burg për dezertim. Veprat e tij u hoqën nga bibliotekat dhe libraritë dhe, deri në vitin 1989, emri i tij nuk u përmend nga mediat zyrtare bullgare. Në Perëndim, ai vazhdoi karrierën e tij si një shkrimtar i suksesshëm. Ndërmjet viteve 1975 dhe 1978, vepra "Raportim në mungesë" e Markovit, që ishte një analizë për jetën në Bullgarinë komuniste, transmetohej çdo javë në Radion "Free Europe". Kritikat e tyre ndaj qeverisë komuniste dhe udhëheqësit të partisë, Todor Zhivkov, e detyruan regjimin të vendoste ta bënte të heshtte me çdo kusht. Markovi u vra në Londër nga një agjent i lidhur me KGB-në dhe policinë sekrete bullgare.

D. Ekstrakt nga një intervistë biografike rreth internimit të një familje të pasur dhe të mirëarsimuar (Markovët), nga qyteti Jabllanica, për në fshatin Batolsi

Mamaja nxori qilimin, një nga ato qilima peshonte 12 kg, dhe kur ajo e shtroi atë, naftalina shkëlqeu si dëborë. Dhe Rada Todorova tha, "Oh ky qenka i bukur! Këtu, shoqe" dhe tregoi me gisht një nga cepat e qilimit, "këtu do ta lidhim etiketën me emrin tënd, dhe do t'ia dërgojmë shokut Stalin, sepse ka ditëlindjen." Dhe mami im tha , "Oh, jo, nuk ua jap këtë. Më dërgoni tre gra dhe më jepni një javë kohë dhe unë do t'iu bëj një si ky. "E kam leshin, i kam gjithçka." "Po ju keni dy të tillë." "Epo, kam dy vajza." "Por emri juaj do të shkojë deri në Kremlin!" Nuk kam për ta harruar këtë skenë. Ajo filloi ta tërhiqte qilimin dhe mamaja ime filloi të tërhiqte cepin tjetër. Ishim me të vërtetë të trembura. Ishte një qilim i madh, ne e kemi akoma! Kështu që nuk ia dha. Dhe ata u larguan.

Dhe ditën e nesërme, nëpër muret e shtëpisë sonë, dikush kishte shkruar kulak [...].

Mëngjesin e ditës së nesërme , pamë të shkruar fjalën kulak, me shkronja të mëdha prej katrani, në portën tonë. Babai im erdhi në dhomë, na zgjoi, ishte ora 4 e mëngjesit, dhe tha: "Mimi, Tsatsi, çohuni vajzat e mia, duhet të strehohemi diku tjetër." "Çfarë është strehimi?" "Ata po na detyrojmë të ikim nga shtëpia, ne duhet të largohemi natën. Ngrihuni dhe filloni të bëni gati plaçkat." Kur u ngritëm dhe dolëm jashtë, pamë që dyert e bodrumit ishin të hapura dhe gjithçka ishte jashtë; gruri, gëzofët, djathi, mielli, çantat, ishin përhapur kudo dhe nuk do ta harroj kurrë se si Bibla e Vjetër ishte lënë përdhe, e hapur, dhe më duket se loshko vrapoi, dhe e rrëmbeu: "Por kjo është Bibla."

Daskalova et al., 2004, fq. 65-66.

1. Si përkufizohej emigacioni bullgar në Vendimin II, Nr. 17 të Byrosë Informative të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bullgarisë?

Çfarë masash parashikonin për eliminimin e pasojave të veprimtarisë së emigracionit antikomunist jashtë vendit?

2. Përse u dënua me burg Gjergji Markovi? Cila ishte veprimtaria e tij dhe si lidhej ajo me Vendimin II të përmendur më lart?

3. Gjeni burime në këtë libër, në lidhje me përvojat personale të personave të dëbuar, të internuarve, të burgosurve politikë, njerëzve që u detyruan të ndryshonin identitetin e tyre, etj. Si i shkelën të drejtat e njeriut regjimet e ndryshme në Evropën Juglindore, në gjysmën e dytë të shekullit të njëzetë? Cilat të drejta themelore të njeriut ishin vazhdimisht në rrezik?

III.4. LËVIZJET RINORE

III-18. Demonstratat studentore në Beograd, viti 1968

Demonstratat studentore të vitit 1968 në Beograd (jehona e të cilave arriti deri tek universitetet e Zagrebit, Lubjanës, Sarajevës dhe Novi Sadit), ishin pjesë e valës së demonstratave që goditën shumë vende në vitin 1968. Demonstrata e parë shpërtheu në kampusin universitar, më 2 qershor, pasi studentët nuk u lanë të ndiqnin një shfaqje teatrale në Universitetin e Punëtorëve, në Beogradin e Ri. Studentët u përleshën me policinë, dhe të nesërmen një grup policësh hynë në kampus dhe qëlluan me armë zjarri për t'i shpërndarë studentët e mbledhur. Pas një mbledhjeje të menjëhershme të dekanëve të të gjitha fakulteteve dhe akademive universitare, u vendos që të organizohet një grevë e përgjithshme dhe të pezullohen të gjitha orët mësimore dhe provimet. Studentët dhe profesorët, me mbështetjen e organeve vetëqeverisëse të fakulteteve, ngritën barrikada jashtë ndërtesave të universitetit, që u rrethuan nga policia. Gjatë grevës shtatëditore, policia i sulmoi këto ndërtesa disa herë, duke rrahur studentët. Në Fakultetin e Filozofisë u organizuan diskutime të gjera politike, duke kritikuar si regjimin, ashtu edhe monopolin e pushtetit të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. U bënë një sërë kërkesash për demokratizimin e të gjitha organizatave sociopolitike, veçanërisht ato të Lidhjes, për lirinë e zgjedhjes dhe mbledhjes, për zgjedhjet e lira dhe për heqjen e censurës. Me nismë të studentëve, universiteti u riemërua si "Universiteti i Kuq i Karl Marksit". Përpos këtyre, u krijua edhe një himn revolucionar, me refrenin "Majtas, majtas, majtas". Parulla më popullore ishte "Poshtë borgjezia e kuqe". Si përfundim, në një fjalim televiziv drejtuar studentëve, më 9 qershor, Tito premtoi zgjidhjen urgjente të të gjitha "çështjeve të mprehta" dhe zgjidhjen e kërkesave të studentëve. Kur protestat universitare përfunduan studentët dhe profesorët kënduan, përshëndetën Titon dhe kërcyen "kozarsko kolo" (një valle popullore tradicionale). Pas kësaj, udhëheqësit kryesorë të demonstratave dhe protestave, si Vladimir Mijanoviçi, u shkarkuan nga puna në universitet dhe pasaportat e tyre u konfiskua.

A. Deklarata e Këshillit Universitar të Aleancës Studentore të Universitetit të Beogradit, 3 qershor 1968

Punëtorë, qytetarë dhe studentë të Beogradit,
Shtypi, radioja dhe media të tjera, ju keqinformuan për demonstratat e mbrëmshme dhe të sotme studentore.

Përse po demonstronin studentët? Cilat ishin parullat e tyre dhe çfarë përfaqësonin? Si fillim, ata kërkojnë zbutjen e pabarazive shoqërore në shoqëri. Ata kërkojnë që problemi i papunësisë të zgjidhet menjëherë, në mënyrë që punëtorët tanë të mos emigrojnë jashtë shtetit për punë, [ata kërkojnë] të sigurojnë demokraci të vërtetë, në të gjitha aspektet e jetës në shoqëri dhe, njëkohësisht, të mundësojnë krijimin e shpejtë dhe rrënjësor të marrëdhënieve vetadministruese. Policia iu kishte bërë pritë studentëve, në afërsi të nënkalimit të Beogradit të Ri, dhe i shpërndau demonstratat, të dyja herët, nëpërmjet përdorimit të forcës dhe shkopit, për pasojë shumë kolegë u lënduan. Policia veproi në mënyrë të dhunshme, pa mëshirë, duke i goditur studentët dhe profesorët që na u bashkuan.

Për shkak të të gjitha atyre ngjarjeve, që kanë ndodhur, ne kërkojmë si më poshtë:

Lirimin e menjëhershëm të të gjithë kolegëve të burgosur dhe heqjen e dosjeve të tyre penale.

Largimin e çdokujt që është përgjegjës për mizorinë e policisë.

Mbledhjen e menjëhershme të seancës së Presidencës së Asamblesë Federale, ku duhet të diskutohet për qëndrimet e studentëve, me praninë e përfaqësuesve të studentëve dhe universitetit.

Shkarkimin e drejtorëve dhe redaktorëve të gazetave të përditshme të Beogradit, të radios së Beogradit dhe TANJUG-ut (Agjencisë Telegrafike Jugosllave), për transmetimin e ngjarjeve të shtrembëruara të 2 qershorit.

Juni '68. Studentski protest u Beogradu, Katalog, Izložba Biblioteke grada Beograda, [Qershor '68 Protestat studentore në Beograd, Katalogu, Biblioteka e Ekspozitës së Qytetit të Beogradit, 2008.

B. Shënime stenografie në mbledhjen e Komitetit Ekzekutiv të Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë (LKJ), 4 qershor 1968

Stevan Doronjski: "Dje u përballem me një situatë shumë të tensionuar. Isha atje dhe fola gjatë me studentët që u nisën për në demonstrata dhe vumë re se një grup ekstremistësh, që ishin studentë të Filozofisë, së bashku me Ljuba Tadiç, Miçunoviç dhe Sveta Stojanoviç, po fitonin epërsi në fakt […]. Natën zhvillonim biseda të zgjatura në Fakultetin e Filozofisë, duke përfshirë 350 studentë që mbanin fjalime nga ballkoni gjatë gjithë natës […].Dje ia dolëm në përpjekjen për izolimin e

menjëhershëm të studentëve nga populli, sepse qëllimi i tyre kryesor ishte të lidheshin me punëtorët dhe t'i tërhiqnin në rrugë për të demonstruar. […] Kjo është arsyeja përse e konsiderojmë si tmerrësisht urgjente dhe, gjatë natës, rreth orës tre ose katër të mëngjesit, vendosem t'i ndalonim të gjitha demonstratat dhe tubimet në sheshe […]. Nëse punëtorët dalin në rrugë, mendojmë se duhet të ndërhyjë ushtria. Deri këtu ka arritur puna".

AJ [Arkivi i Jugosllavisë, Beograd], Savez <2599>komunista Jugoslavije [Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë], 507-IV-41.

III-19. Përfundimet e miratuara nga asambleja e studentëve të Universitetit të Zagrebit, më 22 nëntor të vitit 1971

Ne, studentët e Universitetit të Zagrebit, i pranojmë ndryshimet në sistemin sociopolitik, që e njeh Republikën Socialiste të Kroacisë si një shtet-komb sovran për popullin kroat. Duke vepruar kështu, ne i përmbahemi përfundimeve të Asamblesë së Përgjithshme të qytetit të Zagrebit.

Ne i mbështesim plotësisht pikëpamjet e shprehura në raportin e paraqitur nga Dr. Savka Dabçeviç-Kuçar, në seancën e 22-të të Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Kroacisë. Ne besojmë se raporti përbën një platformë realiste veprimi për të gjitha forcat revolucionare dhe progresive në shoqërinë tonë.

I dënojmë të gjitha përpjekjet për të përshkruar disa "eksese të tepruara", si normën dhe tiparin kyç të situatës së tanishme socio-politike në Kroaci.

Theksojmë se ndryshimet revolucionare dhe rrënjësore në shoqërinë tonë, nuk mund të arrihen pa bërë ndryshime rrënjësore të elementeve në të gjitha strukturat ekzistuese socio-politike dhe strukturat e tjera, si në Kroaci ashtu edhe në të gjithë Jugosllavinë.

Përderisa nuk mund ta shprehim vetëm me fjalë mbështetjen tonë kundrejt Lidhjes së Komunistëve të Kroacisë, Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë dhe shokut Tito, kemi vendosur të ndërmarrim hapa konkretë dhe të pezullojmë të gjitha orët mësimore në Universitetin e Zagrebit.

Hrvatski tjednik, 26 nëntor 1971.

Gjatë vitit 1971, në Kroaci u bënë kërkesa të shumta, në lidhje me reformimin e federatës jugosllave. Ndryshimet u ndërmorën nga Lidhja e Komunistëve të Kroacisë, që u mbështet nga institucionet kulturore, individët dhe, së fundmi, nga studentët e Universitetit të Zagrebit. Për ta shprehur mbështetjen e tyre ndaj udhëheqjes politike kroate dhe reformave, që synonin përmirësimin e pozicionit → të Kroacisë në Jugosllavi, studentët organizuan një grevë të përgjithshme, në fund të vitit 1971. Greva do të përdorej si pretekst për të shkarkuar udhëheqjen e forumeve politike të Kroacisë.

III-20. Revolta e Universitetit Politeknik në Athinë, në nëntor të vitit 1973

Ekstrakt nga një transmetim në radio, nga studentët që kishin pushtuar Universitetin Politeknik të Athinës (14 deri në 17 nëntor të vitit 1973). Radioja e studentëve njoftoi për kërkesat e tyre dhe kundërshtimin e përgjithshëm ndaj juntës duke mobilizuar, rrjedhimisht, qindra qytetarë që u mblodhën jashtë Universitetit në përkrahje të tyre. Radioja heshti kur tanket e juntës pushtuan kampusin e Universitetit. Shumë prej transmetimeve të radios u bënë simbol i luftës kundër juntës në diasporën greke.

Vëmendje, vëmendje!
Kjo është radioja e Politeknikut, kjo është radioja e Politeknikut!

Studentët e lirë, luftëtarë të universitetit, grekë të lirë, luftëtarë nga brenda Politeknikut, që po luftojnë për liri, po ju drejtohen juve!

Po i drejtohemi popullit! Gjatë gjashtë viteve e gjysmë të diktaturës fashiste, ata u përpoqën ta dobësonin lëvizjen demokratike! Sot, studentët nisën një luftë për rivendosjen e Demokracisë në vendin tonë, për çlirimin e Greqisë nga interesat e Kapitalit Ndërkombëtar!

Të gjithë e kemi vënë re se çmimi i bukës është rritur, se arsimimi është i mundshëm vetëm për disa të përzgjedhur dhe se Greqia po qeveriset nga interesa të huaja.

I bëjmë thirrje të gjithë popullit, që t'i bëjë ballë juntës me armën e vetme të efektshme që kanë në dorë: grevën e përgjithshme! Poshtë zgjedhjet e juntës, Pushteti i përket popullit! Të gjithë të bashkuar kundër juntës!

Popull punëtor grek, ky është radiostacioni i studentëve të lirë luftëtarë, i grekëve të lirë luftëtarë! Studentët kanë nisur një luftë kundër juntës, bazuar te kërkesat e tyre të drejta. Megjithatë, të gjithë punëtorët përballen me probleme dhe, për këtë arsye, të gjithë duhet të luftojmë, që ta rrëzojmë juntën nga pushteti; ky është një parakusht i rëndësishëm për përmbushjen e çdo kërkese thelbësore! Greva e studentëve është një shembull. Punëtorë, junta duhet të rrëzohet, tani! Luftoni që greva e përgjithshme të mos shuhet, pasi është e vetmja armë me të cilën mund ta rrëzojmë juntën!

Arkivi i Historisë Shoqërore Bashkëkohore (ASKI), Athinë.

Krahasoni kërkesat e studentëve të Universitetit të Beogradit, të vitit 1968, me ato të studentëve të Universitetit të Zagrebit, në vitin 1971, dhe me ato të Politeknikut të Athinës, në vitin 1973.
A është rastësi që të gjitha lëvizjet studentore ndodhën në fund të viteve '60 dhe në fillim të viteve '70? Bëni pak kërkim për lëvizjet rinore dhe protestat në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vitet '60.
Krahasojini me "Ngjarjet e majit, të vitit 1968" në Francë. Më pas, shpjegoni praninë e lëvizjeve rinore në Evropën Juglindore, në kontekstin botëror.
Përse mendoni se studentët udhëhoqën lëvizje rinore? Krahasojini me raste të ngjashme në vendin tuaj.

III.5. TRANZICIONET DEMOKRATIKE: ARRITJET DHE DËSHMIMET

III.5.1. Greqia

III-21. Ndryshimi i vitit 1974

Rënia e diktaturës shtatëvjeçare, në korrik të vitit 1974, dhe ndryshimi i politikës që pasoi, u afirmuan me formimin e qeverisë së bashkimit kombëtar. Ajo udhëhiqej nga Konstantinos Karamanlis, që u vlerësua si politikani më i përshtatshëm për ta çuar vendin drejt qëndrueshmërisë demokratike. Ndër masat e para të qeverisë ishin: ligjërimi i Partisë Komuniste të Greqisë, që ishte nxjerrë si e paligjshme që prej vitit 1947, dhe shfuqizimi i certifikatave të "bindjeve të shëndosha shoqërore". Në zgjedhjet e 17 nëntorit të vitit 1974, që u kundërshtuan nga një koalicion i partive të majtave nën emërtimin "E majta e bashkuar", partia e djathtë e Karamanlisit, Demokracia e Re, shënoi një fitore të paprecedentë, duke marrë 54 për qind të votave. Më pak se një muaj nga zgjedhjet, u mbajt një plebishit për çështjen e kushtetutës. Pavarësisht lidhjeve tradicionale të ngushta të të djathtëve me Pallatin mbretëror, qeveria e Demokracisë së Re, e Karamanlisit, mbajti një qëndrim asnjanës për këtë çështje. 69.2 për qind e popullit votoi për republikën, pra kundër rivendosjes së monarkisë, duke i dhënë fund çështjes së vjetër të kushtetutës së monarkisë dhe duke filluar një epokë të qeverisjes republikane.

A. Konstantinos Karamanlis kthehet në Greqi nga vetinternimi në Francë, teksa po rrëzohej diktatura e gjeneralëve, 24 korrik të vitit 1974

Duke qëndruar katërmbëdhjetë vite si kryeministër (1955-1963, 1974-1980) dhe dhjetë vite të tjera si President i Republikës (1980-1985, 1990-1995), Konstantinos Karamanlis (1907-1998) u shqua si politikani udhëheqës konservator i shekullit të njëzetë në Greqi. Ai luajti një rol kryesor në kthimin e butë të Greqisë te jeta parlamentare, pas rënies së juntës dhe në kohën e ndërhyrjes ushtarake të Turqisë në Qipro, në korrik të vitit 1974; bindja e tij e fortë se Greqia "i përkiste Perëndimit" dhe evropianizimi i tij i patundur, u konkretizuan në maj të vitit 1979, me nënshkrimin e Traktatit për aderimin e Greqisë në Bashkësinë Ekonomike Evropiane (BEE).

Koleksioni fotografik i Konstantinos Karamanlis/ Fondacioni i Konstantinos G. Karamanlis.

→

B. Shfuqizimi i sistemit monarkik në Greqi, dhjetor 1974

Karikaturë nga Sp. Ornerakis.

1. Si e trajton karikaturisti çështjen e plebishitit? Përse mendoni se e portretizon institucionin e monarkisë në këtë mënyrë?

2. Gjeni informacion për rolin e familjes mbretërore dhe sovranit, në politikën greke, gjatë shekullit të njëzetë. Lexoni burimet në Kapitullin I (plebishiti për kthimin e mbretit, I-28).

3. Krahasojini me vendet e Ballkanit që kishin (ose vazhdojnë të kenë) mbret. Si është perceptuar institucioni i monarkisë në këtë rajon?

C. Andreas Papandreu dhe Lëvizja Socialiste Panhelenike (PASOK)

Kjo afishe zgjedhore e PASOK-ut për "lëvizjet" e fundit të garës për zgjedhjet e 15 tetorit të vitit 1981, e paraqet Andreas Papandreun me një pamje plot vetëbesim, si kryeministër i ardhshëm. Papandreu (1919-1996) ishte ndër politikanët më të shquar të periudhës pas juntës në Greqi. Duke qenë se atij (Papandreut) iu besua qeveria e parë socialiste (1981- 1985), mandati i tij i dytë u dëmtua nga akuzat për nepotizëm dhe nga një sërë skandalesh financiare, për të cilat doli para gjyqit. Pas shpalljes së pafajësisë së tij nga Gjykata Speciale dhe pas fitores së zgjedhjeve në shtator të vitit 1993, Papandreu u rikthye në detyrën e kryeministrit.



Përkthimi: POPULLI E DËSHIRON, PASOK-U MUNDET TË SJELLË NDRYSHIMIN. Me PASOK-un në pushtet, Pranvera do të vijë më në fund në Greqi, për një të ardhme paqësore demokratike; për një të ardhme të lirë socialiste. PASOK PËR NDRYSHIMIN. PASOK NË QEVERI; POPULLI NË PUSHTET.

Arkivi i Historisë Shoqërore Bashkëkohore (ASKI), Athinë.

Slogani kryesor i PASOK-ut gjatë fushatës zgjedhore të vitit 1981 në Greqi, ishte "ndryshim", dhe rezultoi shumë i suksesshëm. Cili është kuptimi i këtij slogani? Për çfarë ndryshimi kishte nevojë Greqia në atë kohë? Dini ndonjë slogan politik të këtij lloji të përdorur në vendin tuaj?

→

III.5.2. Turqia

III-22. Protesta e të majtëve dhe paqëndrueshmëria politike

Në fund të viteve '60 dhe në fillim të viteve '70, Turqia u zhvillua një lëvizje e fuqishme e klasës punëtore dhe vendi u kthye në shesh protestash të vazhdueshme të të majtëve, shtypja e të cilëve nga militantët e djathtë dhe forcat e sigurimit solli humbjen e shumë jetëve. Ngjarjet më të rëndësishme ishin: "Masakra e të Dielës së Përgjakur", më 16 shkurt të vitit 1969, dhe demonstratat masive të punëtorëve, më 15-16 qershor të vitit 1970. Që të dyja ndodhën në Stamboll.

A. "E diela e përgjakur: Ky nuk ishte një tubim, por një luftë midis vëllezërve - 2 të vdekur, 100 të plagosur", Gazeta "Hürriyet", 17 shkurt 1969

Hürriyet

KANLI PAZAR

Bu MITING değil kardeş kavgasıydı

2 ÖLÜ 100 YARALI

B. Duke festuar "Një majin", Stamboll 1977, momente para "masakrës"

Nga viti 1974 deri në vitin 1980, Turqia përjetoi një fenomen masiv të dhunshëm, që mori jetën e më shumë se 5.000 vetave. E djathta radikale dhe e Majta radikale, ishin protagonistët kryesorë të luftës thuajse civile, ndonëse konfliktit pati edhe një përmasë fetare. Në vitin 1977, 34 persona u vranë gjatë "masakrës së 1 majit" në Stamboll, një ndër ngjarjet më të përgjakura deri në grushtin e shtetit të vitit 1980.

http://www.barikat-lar.de/tarih/77.htm, vizituar më 1.10.2016.

III-23. Një dëshmi për fillimin e luftës guerilase të PKK-së

Partia e Punëtorëve të Kurdistanit (Partiya Karkerên Kurdistanê, PKK) u themelua nga Abdullah Ocalan, në vitin 1978. Pas grushtit të shtetit të vitit 1980, shtypja e identitetit kurd u përshkallëzua dhe madje u ndalua edhe përdorimi i gjuhës kurde në jetën private. Më 15 gusht të vitit 1984, PKK-ja filloi operacionet e para ushtarake në Turqi, duke filluar kështu një luftë të gjatë guerilase, që ende vazhdon. Rreth 45.000 vetë (mes tyre shumica dërrmuese ishin kurdë) janë vrarë dhe më shumë se 4.000 fshatra janë shkatërruar. Autoritetet turke kanë krijuar një forcë paraushtarake kurde të quajtur "Mbrojtësit e fshatrave", por ajo nuk ia arriti ta sfidonte PKK-në. Në fund të viteve 1980, u formua edhe një lëvizje politike kurde e ligjshme. Përpos shtrëngimit të përgjithshëm të shtetit, kjo lëvizje është ende e pranishme sot në Kurdistan dhe përbën forcën e katërt më të madhe politike në parlamentin turk. Ocalan u arrestua në Kenia në vitin 1999 dhe u dënua me vdekje, por më vonë dënimi iu ul në burgim të përjetshëm.

Agiti e uli poshtë pushkën, qëndroi para trupave dhe mbajti një fjalim të shkurtër. "Fjalimi im do të jetë e shkurtër. Së shpejti, ne do të fillojmë sulmin tonë ndaj objektivave, që simbolizojnë pushtimin dhe shfrytëzimin që i bën Turqia Eruhut [...]. Pavarësisht rezultatit [...], është e sigurt se do të përmendemi në histori. Ne e dimë se shumë operacione bastisjeje [janë zhvilluar edhe në të kaluarën]. Megjithatë, ne nuk duam që historia të përsëritet. Këtë herë nuk do të ketë një vlerësim të tillë si: "ngritën krye si heronj, por u goditën menjëherë dhe operacioni përfundoi pa sukses", siç shkruhet në të gjitha revoltat kurde. Në asnjë mënyrë, nuk do ta lejojmë këtë. Do t'i themi lamtumirë njëherë e përgjithmonë logjikës së humbjes, që është si një shenjë e zezë, si njollë në ballin e çdo kurdi. Ju e dini se veprimet e para sulmuese kanë një rol përcaktues për fatin e luftës guerilase. Historia do të shënojë Bashkimin e Propagandës së Armatosur të 14 korrikut si një fitore madhështore. Jemi betuar që do t'ia dalim. Ne do t'i sulmojmë objektivat e armikut, do t'i japim botës mesazhin se "ne kemi filluar luftën guerilase", dhe në të njëjtën kohë do t'i japim si dhuratë popullit kurd këtë fitore të rëndësishme. Ju përgëzoj paraprakisht për suksesin tuaj, për suksesin tonë".

http://www.kurdistan-post.eu/tr/kurdistan/15-agustos-atilimi-nizamettin-tas, vizituar më 20.09.

III.5.3. Jugosllavia

III-24. Kundërshtimi nga brenda radhëve të regjimit

A. Kush ka nevojë për "*Praxis*"?

Revista "Praxis" botohet nga Shoqata Filozofike kroate [...]. Duke pasur parasysh orientimin e saj, revista nuk do të trajtojë vetëm tema që janë të veçanta, vetëm për Kroacinë apo Jugosllavinë, por do të trajtojë edhe tema të përgjithshme, që kanë të bëjnë me njeriun dhe filozofinë. Temat do të trajtohen nga pikëpamja socialiste dhe marksiste, që është praktikisht një qasje ndërkombëtare[...]. Së bashku me botimin jugosllav të revistës (në gjuhën kroato-serbe), ne do të publikojmë edhe një botim ndërkombëtar (në anglisht dhe frëngjisht). Qëllimi i këtij botimi nuk është të "paraqesë" idetë jugosllave jashtë vendit, por të nxisë bashkëpunimin filozofik ndërkombëtar në diskutimin e çështjeve më të ngutshme të kohës sonë [...]. Ne besojmë se një qasje kritike, që arrin deri në rrënjën e problemit, pavarësisht pasojave, është një tipar shumë i rëndësishëm i filozofisë reale [...]. Përkrah theksit kritik të problemeve të përgjithshme të botës moderne, ne besojmë se detyra kryesore e marksistëve dhe socialistëve duhet të jetë të veprojnë në të njëjtën mënyrë për problemet në vendet e tyre. Për shembull, detyra kryesore e marksistëve jugosllavë duhet të jetë: të nisë një diskutim kritik mbi socializmin jugosllav. Duke vepruar kështu, ata do të kontribuojnë jo vetëm te socializmi i tyre, por edhe te socializmi ndërkombëtar.

Praxis, Nr. 1 (1964), fq. 3.

B. Ekstrakt nga një fjalim i Vladimir Bakariç "Praxis", 12 korrik 1968

"Praxis" ka qenë në agjendën tonë gjatë viteve të fundit. Unë mendoj se ajo përgjithësisht shpreh prirjen moderne amerikane, antikomuniste, që po përpiqet të gjejë një bazë në botën socialiste. Formulimet e dhëna janë, për shembull, pro-Gjilasit [...]. Platforma e tyre kryesore është platforma e diskutimit, dialogut dhe demokracisë së lirë. Kjo është, thënë me fjalë të tjera, një kthim te demokracia e vjetër burokratike, e cila nga ana e saj e bën burokracinë më të fortë, pavarësisht se cilat janë bindjet e atyre që luftojnë për të [...]. Së dyti, ne duhet t'u qasemi këtyre aspiratave duke marrë parasysh dy fronte: nga njëra anë, "Praxis", me pak fjalë antikomunizmin modern, dhe, nga ana tjetër, krahun e majtë [...].

Rreth pesë vite më parë, e shkëputem komunikimin

me anëtarët e "Praxis". Ne nuk jemi marrë me prirjet e tyre ideologjike, as nuk jemi përpjekur të parandalojmë krijimin e ideve të reja. Brenda radhëve tona ka njerëz, pikëpamjet e të cilëve iu ngjajnë atyre të anëtarëve të "Praxis", por jo në kuptimin politik.

Bakariç, 1983, fq. 528-536.

Veçoria e socializmit jugosllav u pasqyrua në mundësinë (e kufizuar), për të kritikuar ideologjinë e pushtetit. Kjo iu referohej kryesisht kritikave të ashtuquajtura të majta. Revista e filozofisë "Praxis" u botua fillimisht në Zagreb, në vitin 1964. Bashkëpunëtorët ishin filozofë, sociologë dhe shkencëtarë politikë marksistë, që në tekstet e tyre zbuluan mangësitë e rendit socialist jugosllav. Në ishullin e Korçulës "Praxistët" krijuan shkollën e famshme të Korçulës, ku morën pjesë intelektualë të shquar si nga Lindja, ashtu edhe nga Perëndimi. Pavarësisht sulmeve, nganjëherë shumë të forta, të udhëheqësve politikë jugosllavë (si Vladimir Bakariç), "Praxis" dhe shkolla e Korçulës mbijetuan për afro dhjetë vite.

1. Si e kuptoni këtë deklaratë: "Përkrah theksit kritik të problemeve të përgjithshme të botës moderne, ne besojmë se detyra kryesore e marksistëve dhe socialistëve duhet të jetë të veprojnë në të njëjtën mënyrë për problemet në vendet e tyre. Për shembull, detyra kryesore e marksistëve jugosllavë duhet të nisë një diskutim kritik mbi socializmin jugosllav. Duke vepruar kështu, ata do të kontribuojnë jo vetëm për socializmin e tyre, por edhe për socializmin ndërkombëtar".

2. Si e shpjegoni faktin se filozofët e mbledhur rreth "Praxis" i përshkruan pikëpamjet e tyre si socialiste dhe marksiste, ndërsa Vladimir Bakariçi i paraqiste ata si pjesë të "prirjes moderne amerikane dhe antikomuniste"?

3. A mendoni se Bakariç shpreh pikëpamje pozitive apo negative, kur thotë se platforma kryesore e njerëzve të "Praxis" është "platforma e diskutimit, dialogut dhe demokracisë së lirë"?

4. Sipas jush, si u mundësua botimi për dhjetë vite i një revistë si "Praxis", që kritikonte qeverinë jugosllave? (Lidheni përgjigjen tuaj me ndryshimet që ndodhën në Jugosllavi pas prishjes së marrëdhënieve midis Titos dhe Stalinit.).

III-25. Vendimet e Komitetit Qendror të LKJ-së për Sigurimin e Shtetit dhe Aleksandar Rankoviç, 1966

Komiteti Qendror i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë [...] miraton vlerësimin politik të komisionit [të ngritur për të shqyrtuar] shkaqet dhe pasojat e mundshme të shërbimeve të sigurimit shtetëror, duke u kthyer në një forcë që do të jetë mbi shoqërinë. Pas shqyrtimit të propozimeve të komisionit, Komiteti Qendror sugjeron që menjëherë të fillojë organizimi i organeve shtetërore të sigurimit, në mënyrë që ata të shërbejnë më mirë në përputhje me ndryshimet në shoqërinë tonë dhe sistemin e zhvilluar të vetadministrimit. Kontrolli faktik shoqëror i sigurimit të shtetit, bazuar në normat kushtetuese, ligjet dhe rregulloret, duhet të sigurohet nga organet përfaqësuese dhe organet e tyre ekzekutive. Për më tepër, organet përkatëse këshillohen që të zgjedhin zyrtarë politikë si drejtues të organeve të punëve të brendshme para se të përfundojë riorganizimi i sigurimit të shtetit, për ta lehtësuar procesin dhe që të përforcojë kapacitetet e stafit [...]. Miratohet dorëheqja e shokut Aleksandar Rankoviç nga Komiteti Qendror i LKJ-së dhe Komiteti Ekzekutiv i Komitetit Qendror. Sugjerohet që ai të japë dorëheqjen si nënkryetar i Republikës, pasi përgjegjësia e tij politike për punën e organeve shtetërore të sigurimit ishte e tillë që ai nuk mund ta mbante më këtë post.

Petranoviç dhe Zezheviç, 1988, fq. 1108-1109.

Në Seancën Plenare të Katërt të Plenumit të Komiteti Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, të mbajtur në Brijuni, më 1 korrik 1966, Aleksandar Rankoviçit, një komunist udhëheqës serb, iu hoqën të gjitha funksionet e Partisë dhe të shtetit. Arsyeja zyrtare për shkarkimin e tij ishte një skandal i pretenduar, që përfshinte përgjimin e Titos. Për këtë veprim Rankoviç u akuzua si një ndër figurat kyçe në policinë e fshehtë. Arsyeja e vërtetë ishin kërkesat e tij për centralizim të mëtejshëm të Jugosllavisë, si një mënyrë për t'u përballur me kërkesat e shumta për themelimin e krahinës autonome të Kosovës si Republikë. Plenumi u vlerësua si fitore e forcave që e nxitën centralizimin e federatës dhe fillimisht çuan në miratimin e ndryshimeve kushtetuese dhe në vitin 1974 në hartimin e kushtetutës së re. Rankoviç u paraqit nga përkrahësit e tij si luftëtar i interesave kombëtare serbe që, sipas tyre, u mposhtën nga përkrahësit e decentralizimit. Afro 100.000 veta qenë të pranishëm në ceremoninë e tij të varrimit, në vitin 1983. Në shumë grupe njerëzish në Serbi, deri më sot, rënia e Rankoviçit shihet si fillimi i fundit të Jugosllavisë

III-26. Demonstratat e vitit 1968 në Kosovë

Pas Plenumit në Brijuni, në vitin 1966, rastet e dhunës së policisë dhe ushtrisë kundër shqiptarëve të Kosovës u pakësuan disi, ndërsa u shtuan thirrjet për dhënien e autonomisë së zgjeruar rajonit. Gjatë tetorit dhe dhjetorit të vitit 1968, në Prishtinë dhe Tetovë u organizuan demonstrata masive për të bërë thirrje për vetëvendosje, bashkim, kushtetutë dhe universitet, dhe mbi të gjithë që Kosova të fitonte statusin e Republikës. Për pasojë, u bënë disa përmirësime në statusin e shqiptarëve të Kosovës: u krijua universiteti i Prishtinës, u miratua Kushtetuta e Kosovës, që parashikonte autonomi më të gjerë, u themelua Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, etj.

A. Demonstratat e Prishtinës, tetor të vitit 1968

Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës, Fondi Fotografitë në versionin bardhë e zi .

B. Protestuesit shqiptarë gjatë demonstratave të Prishtinës

Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës, Fondi Fotografitë në versionin bardhë e zi.

III-27. Pranvera kroate. Savka Dapçeviç duke folur para një tubimi në Zagreb, viti 1971

Instituti i Leksikologjisë, Zagreb; http://www.enciklopedija.hr/Natuknica.aspx?ID=26516, vizituar më 20.09.2016.

Nga fundi i viteve '60 dhe në fillim të viteve '70, udhëheqja politike kroate kërkoi me ngulm reformimin e Federatës Jugosllave, duke pretenduar se format ekzistuese nuk siguronin barazi të plotë të të gjitha kombeve dhe republikave jugosllave. Kërkesat u mbështetën nga shumë institucione kulturore, nga studentë dhe nga masat e gjera të banorëve të qytetit. Për shkak se udhëheqja kroate fitoi shumë përkrahje, termi "Lëvizje të masave" filloi të përdorej nga politikanët jugosllavë, kryesisht në kuptimin negativ. Më vonë, u zëvendësua me termin "Pranvera kroate". Kërkesat më të rëndësishme bënin thirrje për shpërndarjen e barabartë të të ardhurave (sidomos të parave të fituara nga turizmi, nga i cili Kroacia kishte pjesën më të madhe); për të drejtën e përdorimit të gjuhës kroate si gjuhë standarde, e ndryshme nga gjuha serbe; për një ndarje të drejtë të institucioneve të administratës shtetërore, në të cilat kroatët pretendonin se ishin të papërfaqësuar, etj. Nisur nga akuzat për përkrahjen e nacionalizmit dhe separatizmit, udhëheqja kroate u shkarkua në fund të vitit 1971 dhe shumë intelektualë dhe studentë u dënuan me burgim afatgjatë. Savka Dapçeviç Kuçar, që drejtoi Komitetin Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Kroacisë, që nga viti 1969, ishte udhëheqësja e seksionit reformist të komunistëve kroatë dhe një ndër personalitetet më të rëndësishme gjatë "Pranverës kroate". Shfaqjet e saj publike patën përkrahje të madhe nga masat, gjë që tregonte mbështetjen e tyre për kërkesat e udhëheqjes politike kroate. Banderola e madhe në fotografi (rreshti i parë, në të djathtë), shkruan: "Shteti [kroat] sovran është e drejta e popullit kroat, si edhe i popujve të tjerë të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë".

III-28. Rënia e liberalëve në Serbi, tetor 1972

Komiteti Qendror i Lidhjes së Komunistëve të Serbisë bëri dje këtë deklaratë në seancën e mbajtur më 26 tetor të vitit 1972:

Komiteti Qendror pranon dorëheqjet e presidentit dhe sekretares së deritanishme, shokëve Marko Nikeziç dhe Latinka Peroviç duke e konsideruar këtë si një lëvizje që do ta mundësonte Komitetin të vepronte me shpejtësi, sipas udhëzimeve të letrës dhe fjalimit të shokut Tito dhe si një vendim korrekt dhe të përgjegjshëm nga pikëpamja politike.

Është thelbësore që komunistët e Republikës Socialiste të Serbisë të përpiqen me vendosmëri për ta fuqizuar rolin dhe ndikimin e punëtorëve në shoqëri. Zbatimi i detyrave që përmbahen në këtë letër dhe në këtë fjalim të shokut Tito, përfaqëson pengesën më të madhe për t'u marrë me veprimtaritë e forcave kundër vetadministrimit, që kundërshtojnë Lidhjen e Komunistëve nga pozicione nacionaliste, rankoviçiste, anarkiko-liberale, burokratike dhe centriste.

"*Politika*" 28 tetor 1972, fq. 1.2.

Udhëheqja e Partisë Serbe (të ashtuquajturit "liberalët") u kritikuan për administrimin teknik të ekonomisë" (që do të thotë se administratorët profesionistë kishin më shumë pushtet se këshillat e punëtorëve); për liberalizmin e shkencës dhe veçanërisht të shtypit; për oportunizmin gjatë luftës me armikun e klasave; për braktisjen e centralizmit demokratik në Parti; për largimin nga Titoja; për fobinë sovjetike dhe qëndrimin pro-perëndimor. Në tetor të vitit 1972, Presidenti i Komitetit Qendror Marko Nikeziç dhe Sekretarja Latinka Peroviç, u detyruan të jepnin dorëheqjen, siç bënë edhe figura të tjera politike të shquara serbe. Peroviç ka pohuar se u shkarkuan nga 5.000 deri në 12.000 zyrtarë, ndërkohë që avokati Rajko Daniloviç vlerësoi se pas vitit 1972 "20.000" liberalë" "ndërruan krahun". Në disa raste, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 1973 u shkarkuan nga posti të gjithë kryetarët e bashkive dhe organizatave të punës.

Sipas burimeve, gjatë fundit të viteve '60 dhe fillim të viteve '70, Jugosllavia përjetoi shumë trazira dhe konflikte. Cilat ishin çështjet kryesore që demonstruesit dhe reformistët kishin ngritur? Çfarë kritike po i bëhej shtetit dhe regjimit?

SUVERENA DRŽAVA JE PRAVO
DVATSOS I OSTALIH NARODA SFRJ

KAPITULLI IV: IDEOLOGJIA

Hyrje	131
IV.1. Propaganda	135
IV.2. Kulti i individit	141
IV.3. Versionet e historisë	144
IV.4. Arsimi	147
IV.5. Politika gjuhësore	152
IV.6. Arti	155

HYRJE

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore në Evropë, të mbijetuarit dhe dëshmitarët e Holokaustit, të lindjes dhe perëndimit të diktaturave, të konflikteve të gjata dhe të ashpra ndërmjet komunizmit, nazizmit dhe fashizmit, mendonin se i priste një jetë e qetë. Shumë prej tyre, të dehur nga fitorja, besonin se nuk do të kishte më asnjë përpjekje për të monopolizuar të vërtetën dhe për të kontrolluar tërësisht jetën private dhe shoqërore. Shumë njerëz, që kishin marrë pjesë në lëvizjet e rezistencës, shpresonin që utopia komuniste për një shoqëri të drejtë do të bëhej realitet. Nga ana tjetër, kishte edhe nga ata që mbështesnin modelin Perëndimor demokratik të qeverisjes, duke iu kundërvënë kështu regjimit totalitar nazist. Megjithatë, Lufta e Ftohtë dhe polarizimi i botës në dy grupime ekonomike, politike dhe ideologjike pati ndikim të pashmangshëm në Evropën Juglindore. Rajoni u nda në dy kampe ideologjike, që pavarësisht lëkundjeve të brendshme, po propagandonin dy interpretime të së kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes që binin ndesh me njëra-tjetrën.

Në bllokun komunist, propaganda shtetërore mbështetej te pabarazitë e reja shoqërore, për të përligjur vizionet normative për një shoqëri të drejtë dhe përparimtare, ku të gjithë do të trajtoheshin barabar dhe do të shpërbleheshin sipas kontributit dhe aftësive të tyre. Në anën tjetër të Perdes së Hekurt, përdorej retorika e djathtë konservatore për "shpëtimin e atdheut", që përkrahte marrjen e masave të rrepta kundrejt çdo cenimi të traditave, besimit dhe gjuhës kombëtare. Qëllimi kryesor i propagandës shtetërore ishte që, nëpërmjet trysnisë së vazhdueshme dhe të planifikuar, të mbronte shpjegimet ideologjike rreth botës dhe t'i rrënjoste ato me forcë te çdo person, si normë e "mënyrës së duhur të të menduarit". Kjo gjë u bë e mundur kryesisht nëpërmjet sistemit arsimor, medias dhe artit, që shpesh e zbukuronin ose e shtrembëronin së tepërmi realitetin shoqëror, dhe u përpoqën të kontrollonin tërësisht jetën publike dhe private të njerëzve. Këto ligjërime pësuan ndryshime të qenësishme dhe u përshtatën në përputhje me nevojat e përhershme për rilegjitimimin e pushtetit absolut dhe të pakufizuar të Partisë në Lindjen komuniste, ose të pushtetit që kishin gjeneralët dhe politikanët populistë në Perëndim, si edhe për luftën opozitare ndaj regjimeve respektive që mori shtat gjatë kësaj periudhe.

Thelbi i propagandës zyrtare shtetërore përbëhej nga postulatet kryesore të Marksizëm-Leninizmit rreth pronës kapitaliste si burim i të gjitha të këqijave shoqërore, emancipimit të klasës punëtore nga shtypja e klasës borgjeze, pronës së përbashkët për sa i përket prodhimit dhe kultit të individit, pra të shndërrimit të udhëheqësit të partisë në hero dhe shenjtor, që buronte drejtpërsëdrejti nga postulatet për rolin udhëheqës të punëtorëve (p.sh në partinë komuniste) në ngritjen e sistemit socialist. Në rastin e Jugosllavisë, kremtimi i rolit dhe fitoreve të partizanëve të Titos në beteja të rëndësishme gjatë Luftës së Dytë Botërore, me mesazhin e tij që synonte të ndërtonte idenë e një ndryshimi revolucionar të pushtetit, ishte thelbësor për fuqizimin e regjimit, si dhe bashkimin e popullit jugosllav. Rasti jugosllav shquhej që në fillesë, pasi organet komuniste të pushtetit ishin formuar në territoret e çliruara nga vetë partizanët, që nga ana tjetër i dhanë udhëheqjes së shtetit pushtetin e nevojshëm për t'i zbatuar politikat pavarësisht nga shtetet e tjera të bllokut Lindor.

Si evoluan mesazhet kryesore ideologjike komuniste në Evropën Juglindore, nga viti 1945 deri në vitin 1989? Në vitet e para të revolucionit, fill pas ardhjes në pushtet të komunistëve, lufta kundër klasës borgjeze, kulakëve (pronarët e kamur të tokave) dhe disidentëve, ose intelektualëve të pavarur, që shiheshin si armiq, u vu në qendër të vëmendjes. Figura e tyre barazohej në mënyrë manipuluese me atë të nazistëve, fashistëve, dhe imperialistëve perëndimorë. Kjo luftë solli dënimin e mijëra njerëzve me vdekje, ngritjen e kampeve të punës së detyruar, ku kushtet e jetesës dhe të punës ishin çnjerëzore, si dhe dërgimin e mijëra familjeve në internim të përjetshëm, ndërsa shumë të tjera u dërguan me forcë në mërgim. Njëkohësisht, po zhvillohej edhe "lufta për paqe" dhe bashkëpunimi ndërkombëtar i vendeve komuniste nën mbikëqyrjen e Bashkimit Sovjetik dhe sipas modelit të këtij të fundit. Në rastin e Jugosllavisë, përçarja Tito-Stalin në vitin

1948 shënoi pikën e kthesës, pasi vendi vendosi të ndiqte "rrugën e vet socialiste". Ata që e kundërshtuan, si dhe ata që u akuzuan për kundërshtimin e kësaj lëvizjeje, përfunduan në burgun e ishullit të Goli Otokut apo gjetiu.

Gjatë "ndërtimit paqësor të socializmit", lufta kryesore ishte arritja e sukseseve që konsideroheshin si më fisniket, si realizimi i planit pesëvjeçar të zhvilimit të përshpejtuar ekonomik, hapja e ndërmarrjeve i bujqësisë etj. paraqisnin vështirësi të mëdha. Në epokën e ashtuquajtur "socializmi real", retorika e pasluftës iu hapi rrugë metaforave për mirëqenien dhe begatinë shoqërore, nevojës së rritjes së nivelit kulturor dhe ekonomik të punëtorëve, si dhe ballafaqimit të përparimit të kulturës popullore të inteligjencies artistike dhe krijuese, me kulturën "dekadente të masës" së Perëndimit, rëndësisë së revolucionit shkencor dhe teknologjik, thirrjeve për bashkëpunim me popujt vëllezër të Botës së Tretë etj. Jugosllavia zhvilloi modelin e saj të vetadministrimit socialist, që ndryshonte nga ai i shteteve të socializmit real, ndërsa në sferën e politikës së jashtme, ishte një prej themelueseve të Lëvizjes së Vendeve të Paangazhuara, që ishte kundër ndarjes së botës në blloqe. Duke filluar që nga vitet 1960, kufijtë e shtetit u hapën dhe qytetarët e saj mund të udhëtonin si në LIndje, ashtu edhe në Perëndim pa asnjë pengesë, ndërkohë që në vitet 1970 standardet e jetesës u rritën ndjeshëm.

Në disa vende, ligjerimët internacionaliste të regjimit u ndërthurën gradualisht me ato kombëtare, ku madje përfshiheshin edhe tema që nuk përputheshin me ateizmin shkencor dhe programet e modernizmit, siç ishin ato për kishën dhe zakonet e traditat. Kështu, në korrik të vitit 1977, ceremonia madhështore mortore e nënës së Nikolai Çauseskut, që vdiq në po atë vit, ishte tipike ortodokse juglindore. Drejt fundit të epokës komuniste, filloi të nxitej ideja e pluralizmit demokratik. Parrullat si glasnost dhe perestrojka , të cilat vetëm dy a tre dhjetëvjeçarë më parë (p.sh gjatë Kryengritjes Hungareze të vitit 1956, që u shtyp nga Ushtria e Kuqe, dhe Kryengritjes së Pragës së vitit 1968, që u shtyp nga ndërhyrja e armatosur e të gjitha vendeve aleate të Traktatit të Varshavës, përveç njërit) ishin cilësuar si shmangie nga idealet e Partisë, filluan të shtroheshin për diskutim.

Kulti i indivdit pësoi një zhvillim të ngjashëm. Në tërësi, ai pasqyronte optimizmin historik të klasës punëtore, duke sintetizuar postulate të ndryshme ideologjike rreth personalitetit të udhëheqësit komunist si shprehja më e lartë e dijes, sjelljes njerëzore dhe përkushtimit të palëkundur ndaj idealeve të drejtësisë dhe integritetit. Në vendet e bllokut Lindor, kulti i udhëheqësit ndoqi modelin sovjetik. Deri para vdekjes së Stalinit, udhëheqësi i partisë ishte veteran i luftës ose i qëndresës kundër fashizmit (si Gjergj Dimitrov, Tito, Hoxha), një hakmarrës i pamëshirshëm, por i drejtë ndaj tradhtarëve të idesë së proletariatit dhe figura e tij shihej si shenjt. Kur, pas Kongresit të Njëzetë të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në vitin 1956, kulti i individit, me nismën e udhëheqësit sovjetik Nikita Hrushovit u cilësua si shtrembërim i idealit komunist dhe shtypja masive e miliona njerëzve u dënua zyrtarisht, kulti i figurës së udhëheqësit u shndërrua jozyrtarisht në një shfaqje të gjithëgjendur, të detyrueshme dhe pothuaj të pakuptimtë të "dashurisë së klasës punëtore" për "të parin e partisë dhe shtetit". Në çdo paradë në nder të Ditës së Punës, apo në çdo festë tjetër zyrtare, që organizoheshin parada masive, fëmijët pionierë fytyrëqeshur i jepnin lule Todor Zhivkovit, Titos, apo Enver Hoxhës në një tribunë të posaçme (në Bullgari në platformën e Mauzoleut të Gjergj Dimitrovit), ndërsa fshatarët e drobitur tregonin se si njëri prej tyre ishte shëruar plotësisht nga kanceri gjatë një takimi me Çausheskun. Sigurisht që, kulti i individit nuk ishte tipar vetëm i regjimeve komuniste. Në Turqi, Qemal Ataturku, që vdiq në vitin 1938, mund të merret si shembull mbresëlënës i një udhëheqësi, kulti i të cilit u rrënjos në çdo aspekt të jetës publike dhe trashëgimia e të cilit përcaktoi rrjedhën e historisë turke të pasluftës.

Në regjimet autoritare dhe totalitare, arsimi i kontrolluar dhe i përqendruar në duart e shtetit, ka shërbyer gjithmonë si institucion për indoktrinimin politik. Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, ideologjia Marksiste-Leniniste-Staliniste u përhap në fushën e arsimit në vendet e bllokut Lindor. Si fillim, u spastrua i gjithë personeli mësimor i vjetër dhe borgjez, duke filluar nga mësueset në kopshtet parashkollore e deri te profesorët e universiteteve. Gjatë viteve në vijim, u hartuan rregullore që mbikëqyrnin përbërjen e studentëve, dhe veçanërisht të nxënësve që vijonin ose që kishin përfunduar shkollën e mesme, si dhe të kontrollonin pranimin në këto të fundit. Këto masa, lidheshin drejtpërdrejtë me politikën e krijimit të "inteligjencies së re të vërtetë të popullit". Nga fundi i

viteve 1940, të gjitha shtetet komuniste i kishin miratuar ligjet për arsimin kombëtar dhe kurrikulat në përputhje me doktrinën e Marksizëm-Leniznizmit, që kishin si synim madhor"formimin e qytetarëve të shtetit socialist". Për këtë qëllim, në materialet mësimore të lëndëve që studioheshin nëpër shkolla dhe universitete, qoftë të profilit të Shkencave Humane apo të Natyrës, u fut edhe materializimi dialektik. Ndër të gjitha fushat, përparësi e veçantë iu dha historisë, së cilës iu besua përligjja e rëndësisë dhe përjetësisë së regjimit komunist të asaj epoke. Kjo i ktheu të gjitha revoltat shoqërore të së shkuarës së largët në lajmëtare të revolucionit socialist, dhe lëvizjet politike të udhëheqësve të partisë, në heroizma.

Përdorimi i kulturës si mjet ideologjik, ishte një tjetër tipar kryesor i shoqërive komuniste. Funksioni i saj ushqehej nga koncepti klasik Marksist për kulturën si një "superstrukturë e marrëdhënieve bazë (ekonomike dhe shoqërore)", që pikërisht për këtë arsye duhet të pasqyronte ndryshimet rrënjësore që kishin ndodhur në shoqëritë që e kishin ndërmarrë tashmë rrugëtimin drejt komunizmit. Mjeti i saj kryesor dhe "metoda e saktë në të gjitha artet" njihej si "Realizmi socialist". Përkufizimi i kësaj metode ishte formuluar edhe në Statutet e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të BRSS-së, të miratuara në Kongresin e Parë të Lidhjes, në vitin 1934: "Realizmi socialist i kërkon artistit të bëjë një pasqyrim besnik dhe të saktë historik të realitetit, në zhvillimin e tij revolucionar". Realizmi socialist u imponua në mënyrë të suksesshme si normë konservatore dhe praktikë artistike e përditshme në vendet e bllokut sovjetik dhe në Jugosllavi. Ai i ndihmoi regjimet komuniste të përqendronin dhe kontrollonin plotësisht të gjitha institucionet kulturore dhe politikat e tyre përkatëse, si dhe të gjitha organizatat e pavarura të intelektualëve që ishin formuar para vendosjes së regjimit komunist dhe nismat e pavarura kulturore. Pas prishjes së marrëdhënieve me BRSS-në, arti dhe kultura në Jugosllavi pësuan ndryshime. Realizmi socialist u braktis, ndërsa artistët u lejuan të ndiqnin prirjet e artit modern Perëndimor. Gjatë viteve të fundit të komunizmit, fuqia e dogmave të Realizmit socialist filloi të dobësohej dalëngadalë edhe në ato vende që kishin qenë ndjekëse besnike të tij, për shkak të kontaktit që sa vinte e rritej me kulturën Perëndimore dhe zbutjes së censurimit të artit modern, alternativ, abstrakt apo formave të tjera të tij.

Klishetë ideologjike dhe "fotografitë e çastit" të realitetit socialist, e shkatërruan me plot kuptimin e fjalës funksionin e rëndësishëm shoqëror të medias dhe burimeve mediatike. Krahas krijimit të një sfere thuajse publike, ideologjia ndërhyri edhe në sferën private të pushimeve familjare. Në të gjitha shtetet socialiste pati përpjekje për të futur rite civile, që synonin të zëvendësonin ato fetare dhe të përmbushnin udhëzimet e ateizmit shkencor, si matrica e vetme shpjeguese e problemeve të qenësishme të ekzistencës. Por, përpjekje të tilla nuk ishin gjithmonë të suksesshme. Kështu, ritet e vendosjes së emrit të fëmijëve në Bullgari, nuk gëzuan kurrë popullaritet, ndryshe nga ritet e martesës, apo varrosjes së qytetarëve. Megjithatë, padyshim që në përshpejtimin e proceseve të shekullarizimit në Evropën Juglindore, ndihmuan edhe shumë rite të tjera zyrtare.

Në të njëjtën kohë pati përpjekje për të krijuar shtete të mirëqenies sociale dhe ekonomi të forta, jo sipas propagandës shtetërore dhe ideologjisë komuniste të revolucionit socialist, por në bazë të qasjeve ushtarake, paternaliste ose nacionaliste. Në ato raste, propaganda që zhvillohej ishte e kundërta, por edhe pasqyrimi i imazhit të modelit komunist. Ç'është e vërteta, në kohën e regjimit diktatorial dhe autoritar, propaganda ishte po aq e ashpër. Megjithatë, kishte një dallim të rëndësishëm: kudo ku parlamentet ishin formuar nëpërmjet votës, deputetët e zgjedhur gëzonin lirinë e fjalës. Në mënyrë të ngjashme, media do të mund të çonte më tej funksionin e saj të rëndësishëm shoqëror, përveç rasteve kur ndodhej nën regjimin diktatorial.

Në Greqi, si gjatë luftës civile (1946-1949) ashtu edhe pas saj, "armiqtë e shtetit" nuk ishin borgjezët, si në vendet komuniste, por "banditët komunistë". Gjatë juntës ushtarake shtatëvjeçare (1967-1974), një pjesë e shtypit u mbyll, ndërsa pjesa tjetër iu nënshtrua censurës; ndërsa mijëra kundërshtarë të juntës u torturuan, u internuan, u burgosën, dhe në rast se arratiseshin jashtë vendit, iu hiqej nënshtetësia. Tortura e disidentëve ishte në të vërtetë arsyeja kryesore e daljes për herë të parë të Greqisë nga Këshilli i Evropës në vitin 1969. Për më tepër, udhëheqësi i juntës, kolonel Jorgos Papadopulos, dha ndihmesë të veçantë në arsenalin ideologjik të autoritarizmit, duke e krahasuar shtetin me një pacient të futur në allçi, që ka nevojë të ngutshme për një mjek. Në vend të monarkisë, theksi u vu te Revolucioni i 21 Prillit, qytetërimi helen i krishterë dhe nevoja për përparim ekonomik në të gjitha fushat.

Aspiratat për të krijuar një ekonomi të fortë në Turqi, veçanërisht pas hartimit të Kushtetutës në vititn 1961, ku Republika e Turqisë cilësohej si "një shtet kombëtar, demokratik, shekullor dhe shoqëror i qeverisur nga sundimi i ligjit" u mbështetën edhe nga ushtria. Njohja e karakterit laik të shtetit, ishte thelbësore për doktrinën kombëtare. Ndryshe nga Greqia, mosmarrëveshjet ndërmjet të majtës dhe të djathtës patën shumë kthesa të papritura (këtu rol të rëndësishëm luajtën edhe ndarjet etnike), konflikte të ndërlikuara dhe të pafundme ideologjike dhe shoqërore, dhe arritje të ndryshme në ruajtjen e imazhit të Turqisë, të themeluar nga Qemal Ataturku, si shtet modern dhe laik. Vënia në pikëpyetje e kultit të tij të individit, do të bëhej dalëngadalë pjesë e debateve në Turqi. Gjatë viteve të para të Luftës së Ftohtë, parapëlqimet ideologjike të Turqisë, së bashku me drejtimin e saj politik dhe ekonomik, u përcaktuan nga faktori shtytës i kërcënimit sovjetik dhe faktori tërheqës i ndihmës financiare dhe garantimit të sigurisë nga Amerika. Kjo solli riformulimin e shpejtë të qemalizmit si doktrinë kundër komunizmit (madje, ajo mori edhe një emërtim tjetër dhe u quajt Ataturkizëm (Atatürkçülük) për ta çliruar elitën turke, në rrugëtimin e saj drejt "botës së lirë", nga angazhimet e dikurshme anti-imperialiste të qemalizmit). Ky formulim kundër komunizmit i ideologjisë themelore të shtetit, do të lartësonte më tej kultin e individit të Ataturkut, dhe do ta ngarkonte ushtrinë me detyrën për ta mbrojtur drejtimin ideologjik të republikës (kryesisht në përputhje me politikën e Aleancës së NATO-s).

Ky kapitull synon të përcjellë një panoramë të baraspeshuar të aspekteve të ndryshme të proceseve ideologjike në Ballkan, gjatë periudhës tejet të ideologjizuar të Luftës së Ftohtë. Ideologjia shërbente si armë kyçe për të dyja blloqet, duke qenë se synonin të tregonin dhe të përligjnin jo vetëm epërsinë e tyre ushtarake, por edhe atë morale. Kjo garë e përmasave ndërkombëtare u pasqyrua edhe në shoqëritë ballkanike, ku çdo regjim dhe udhëheqës synonte të fitonte, ose thjesht të trillonte besnikërinë e qytetarëve të tij. Megjithatë, nëse studiojmë mekanizmat e propagandës, pa shfrytëzuar të dhënat shoqërore dhe kulturore, mund edhe të arrijmë të besojmë se propaganda ishte me të vërtetë e efektshme, ose në të kundërt do të besonim se asnjë njeri nuk i qendronte besnik regjimit me vullnetin e tij të lirë. E vërteta është më e ndërlikuar se kaq. Pas fasadës së propagandës, ideologjia mbizotëruese mund të kundërshtohej në heshtje p.sh në vendin e punës ose në familje. Anasjellas, krahas atyre që e shprehën hapur kundërshtinë, kishte edhe mbështetës të heshtur të regjimit, që nuk ishin doemos anëtarë të elitës udhëheqëse. Sistemi gëzonte mbështetjen e shumë qytetarëve, që iu përkisnin kryesisht shtresave të ulëta shoqërore për shkak të arsimit pa pagesë, sigurimeve të plota shëndetësore, përfitimeve të shumta nga skemat e mirëqenies dhe më e rëndësishmja, zhvendosjes shoqërore nga poshtë lart (p.sh zhvendosja nga fshati në qytet). Në përgjithësi, që të bëhej kjo zhvendosje, ishte i domosdoshëm anëtarësimi në Parti, gjë që për shumë njerëz paraqitej si mundësi e veçantë. Si rrjedhojë, gjatë periudhës së pas Luftës së Ftohtë, nostalgjia për komunizmin nisi të manifestohej veçanërisht në ato vende që i kishte pllakosur tranzicioni, dhe që hasnin vështirësi në zgjidhjen e problemeve që shoqëronin proceset e transformimit.

IV.1. PROPAGANDA

IV-1. Afishe propagandistike e një gruaje duke pritur krahëhapur ardhjen e një traktori, Bullgari 1950-1960

НБКМ [Biblioteka Kombëtare e Shën Cirili dhe Metodi], Гр VI 4387.

Në diçiturë shkruhet: "Dhe tani, le të festojmë". Afishja tregonte një bullgare që ishte përfshirë në procesin e modernizimit të bujqësisë së vendit "me njohuri dhe përgjegjësi të plotë për normat e prodhimit". Gjithashtu afishja synonte të tregonte se vetëm punëtoret që i kishin arritur normat e prodhimit e meritonin të bënin pushime (rasti në fjalë, Dita e Punës).

IV-2. Afishe propagandistike në gjuhën turke, Bullgari 1954

Në diçiturë shkruhet: "Burra dhe gra punëtore turke që jetoni në Bullgari! Pushteti popullor kujdeset vazhdimisht për përmirësimin e jetës suaj ekonomike dhe kulturore. Jepjani votën tuaj Frontit të Atdheut".

НБКМ [Biblioteka Kombëtare e Shën Cirili dhe Metodi], Гр VI

1516.

1. Përshkruajini të dyja afishet. Si shfaqen gratë (veshjet, gjuha e trupit, shprehjet e fytyrës)? Çfarë mesazhi politik përcillet nëpërmjet kësaj figure? Pse mendoni ju se afishet përqendrohen te gruaja? A arrini të përcaktoni ndonjë stil në veçanti?

2. Tipari kryesor i realizmit socialist është optimizmi që përfaqëson të tashmen dhe të ardhmen e ndritur të një shoqërie ideale, të ndërtuar mbi themelet e shoqërisë socialiste. A e ndeshni këtë tipar në këtë afishe? Gjeni më shumë informacione dhe materiale pamore, që përfaqësojnë këtë stil në vendet socialiste të asaj kohe.

IV-3. Propozimet për organizimin e Paradës së Punëtoreve në Bukuresht, më 23 gusht 1971

Me rastin e 27 vjetorit të çlirimit të Rumanisë nga zgjedha e fashizmit, ne, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Rumanisë, propozojmë si më poshtë për punëtorët e bashkisë së Bukureshtit: 1. Në Sheshin e Aviatorëve do të organizohet një paradë ushtarake dhe një tubim i punëtorëve nga ora 8 deri në 11 të paradites me 150,000 pjesëmarrës. Veprimtaria do të hapet me himnin kombëtar të Republikës Socialiste të Rumanisë (RSR) dhe do të vijohet me paradën ushtarake, që do të përbëhet nga: një kuadrat i rojës patriotike prej 3,000 luftëtarësh; një kuadrat me 1,100 të rinj që po përgatiten për mbrojtjen e vendit dhe 900 brigadierë të reparteve të punës patriotike; një kuadrat prej 134,000 punëtorësh nga të cilët 3,000 qytetarë do të drejtojnë kolonën; një kuadrat prej 6,000 sportistësh, dhe një grup pionierësh që do t'u japin lule udhëheqësve të shtetit dhe të partisë. Aktiviteti do të mbyllet me paradën e 5,000 policëve.

2. Kuadrati i punëtorëve do të mbajë objektet e mëposhtme: portretet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe të anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Rumanisë (PKR-së), flamujt dhe stemat e PKR-së dhe RSR-së në numra të barabartë, pankarta me shprehje përshëndetëse për popujt e vendeve socialiste, parulla dhe vizatime për arritjen e normave, lule dhe objekte të tjera zbukuruese.

4. Në Sheshin e Aviatorëve, do të ngrihet një çadër qendrore dhe dy anësore me nga 500 vende secila, ndërsa në krahun e kundërt do të ngrihen dy çadra me nga 550 vende secila.

5. Në sheshet dhe parqet kryesore të kryeqytetit, në pasditet e 23 dhe 24 gushtit, do të organizohen festivale të ndryshme, me grupe artistike profesioniste ose amatore. […]

Gjatë 30 ditëve, në terren do të organizohen veprimtari si edhe festa për të rinjtë, gara të ndryshme sportive dhe udhëtime.

Arkiva Kombëtare e Bukureshtit, koleksioni: Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Rumanisë, seksioni: Kancelari dosja 85-1971, fq. 44-45.

IV-4. Parada e Ushtrisë në Beograd 1949



Muzej istorije Jugoslavije / Muzeu Historik i Jugosllavisë.

Ushtria Nacionalçlirimtare e Jugosllavisë, nga viti 1941 deri në vitin 1945 organizoi parada ushtarake, në formën e revistave ushtarake apo festimeve në përkujtim të ngjarjeve të rëndësishme. Paradat ushtarake të Ushtrisë Popullore Jugosllave u organizuan nga viti 1945 deri në vitin 1960. Paradat e para të mëdha u organizuan më 1 maj në Beograd, Nish, Novi Sad, Split dhe Sarajevë. Gjatë dy viteve pasuese, në të gjitha garnizonet e mëdha paradat ushtarake u organizuan: në Ditën e Fitores, më 9 maj; Ditën e Republikës më 29 nëntor, dhe në Ditën e Ushtrisë më 22 dhjetor. Nga viti 1948 deri në vitin 1957, paradat u organizuan vetëm në 1 Maj dhe vetëm në Beograd, apo edhe në kryeqytetet e tjera. Paradat e Ditës së 1 Majit përgatiteshin në kuadrin e festës së Ditës Ndërkombëtare të Punës ku, krahas njësive ushtarake, merrnin pjesë edhe organizata →

sportive, politike etj. Paradat në vitin 1965 u anuluan për arsye ekonomike, dhe u vendos që ato të organizoheshin çdo pesë vjet Ditën e Fitores. Parada e parë ushtarake, ku komandanti i shquar Marshall Titoja nuk mori pjesë pasi kishte vdekur në vitin 1980, dhe ajo e fundit e organizuar nga Republika Federale Socialiste e Jugosllavisë u zhvilluan më 9 maj të 1985-s në Beograd.

Dy burimet (IV-3 dhe IV-4) përshkruajnë ritet publike. Çfarë është parada? A organizohen parada në ditët e sotme në vendin tuaj? Nëse po, në cilat raste? Analizoni paradat kombëtare në vendin tuaj.

IV-5. Futja e riteve civile në Bullgari

A. Rregullat e ceremonisë së vendosjes së emrit, Stara Zagora 1975

Nëpunësi thotë: "Sot, jemi mbledhur në këtë ceremoni për t'i vënë emrin një tjetër qytetari të atdheut tonë socialist, të Republikës Popullore të Bullgarisë, vajzës së familjes Dimitrov. Çdo qytetar bëhet pjesë e shoqërisë me emrin e tij/saj. Sipas traditës bullgare, prindërit, Maria dhe Ognjani, kanë vendosur ta quajnë fëmijën e tyre Albena. (Nëse fëmija nuk është bullgar, fjalia e fundit zëvendësohet me "Prindërit kanë menduar ta quajnë fëmijën e tyre..."). Emrin ta gëzojë dhe ta nderojë!" Kori fillon të këndojë me ngadalë "Si një pishëz nën qiellin e kaltër" nga Asen Karastojanovi. Ndihmës nëpunësi thotë: "Pastë jetë të gjatë e të lumtur. Qoftë gjithmonë e gëzuar dhe e zellshme! U bëftë e zgjuar dhe nxënëse e mirë! Trashëgoftë bukurinë e luleve të atdheut tonë! Qoftë e vendosur dhe e matur! Ju sjelltë vetëm lumturi nënës dhe babait! Qoftë krenaria e kumbarëve dhe gjyshërve të saj! E dashtë atdheun po aq sa bijtë e tjerë! I qëndroftë besnike kauzës së socializmit dhe komunizmit!" Ceremonia përfundon. Kori e ndërpret këngën.

Сборник нормативни актове…, fq.100-101.

B. Fotografia e fëmijës që do t'i vendoset emri, 1974

http://socbg.com/2015/01/%D0%B8%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%83%D0%B2%D0%B0%D0%BD%D0%B5-%D0%B2-%D0%BE%D0%B1%D0%BD%D1%81-%D0%BF%D0%BE%D0%BC%D0%BE%D1%80%D0%B8%D0%B5-80-%D1%82%D0%B5.html, vizituar më 21.09.2016.

1. Cilat janë virtytet dhe cilësitë e renditura te pjesa e mësipërme që i urohen një fëmije? Cilat prej tyre janë personale dhe cilat ideologjike?

2. Kërkojuni prindërve të sjellin ndërmend kujtime që lidhen me ritet me natyrë publike ose private, si ato të përshkruara në pjesët IV-3, IV-4 dhe IV-5. Gjeni fotografi të vjetra familjare. Krahasojini ato me pjesët e mësipërme. Më pas krijoni një tregim tuajin, duke u bazuar në rrëfime gojore dhe burime të tjera.

IV-6. Shtëpia e Republikës, e quajtur ndryshe edhe si Shtëpia e Popullit (Casa Poporului) sot njihet si Pallati i Parlamentit të Bukureshtit

https://daniilgaucan.wordpress.com/2011/08/05/casa-poporului-vazuta-din-plan-astral, vizituar më 12.10.2016.

Ndërtesa që njihet sot si Pallati i Parlamentit është simboli arkitekturor më shprehës i butaforisë së madhështisë së Nikolai Çausheskut. Pas tërmetit të madh të vitit 1977, që e dëmtoi rëndë qendrën antike të Bukureshtit, Çaushesku urdhëroi ndërtimin në kryeqytet të një kompleksi qytetar që nga themelet. Por, në mënyrë që të ndërtoheshin: Bulevardi "Fitorja e Socializmit" dhe Shtëpia e Popullit, u shkatërrua lagjia e vjetër Uranus.

Me nisjen e punimeve, u prishën 7 km2 ndërtesa dhe u shpronësuan 40,000 banorë. Në vitin 1989, kohë kur për të paguar borxhin e jashtëm të vendit, regjimi kishte ndërmarrë masa shtrënguese shumë të ashpra, kostoja e përgjithshme përllogaritej 1.75 miliard $. Për ndërtimin e Shtëpisë së Popullit u punësuan plot 200 arkitektë dhe 2,000 punëtorë.

1. Studioni fotografinë në pjesën IV-6, dhe më pas diskutoni për ndërtimin e një godine të tillë, duke marrë parasysh kostot e përgjithshme dhe pasojat për banorët e zonës.

2. Si mendoni, pse Çaushesku urdhëroi ndërtimin e një godine të tillë? Komentoni emrin Shtëpia e Popullit. Për çfarë shërbente ajo gjatë sundimit të Çausheskut, dhe për çfarë shërben tani?

3. A dini raste të ngjashme në vendin tuaj?

IV-7. Afishe kundër komunizmit në Greqi

Koleksion vetjak.

Gjatë Luftës së Ftohtë, fryma kundër komunizmit, që u mbështet dhe u përkrah nga të ashtuquajturat klasat politike nacionaliste, monarkia dhe ushtria, u bë tipari kryesor dallues i Greqisë së pasluftës civile. Kjo afishe propagandistike u publikua në prag të zgjedhjeve të përgjithshme të shkurtit të vitit 1958, ku E Majta e Bashkuar Demokratike (EDA), aleanca e forcave të majta, që përfshinte edhe Partinë Komuniste të Greqisë (KKE), u rendit e dyta. Në të paraqitet një oktapod me një kapele me yllin tipik sovjetik, që mbulon Greqinë me të tetë tentakulat e tij, ku secila prej tyre mban emrin e një lëvizjeje apo grupimi grek, që pretendohej se zhvillonte veprimtari subversive komuniste. Në njërin sy të oktapodit shkruhet "EDA", ndërsa në tjetrin "KKE", duke i vënë kështu të dyja grupimet në baraspeshë. Në diçiturë shkruhet: " Votoni kundër EDA-s".

Pse e majta përshkruhet si një oktapod që i shtrin tentakulat e tij në të gjithë Greqinë? Gjeni afishe ose ilustrime politike të ngjashme me oktapodë. Çfarë simbolizon kjo figurë? Cili është mesazhi?

IV-8. Gruaja "ushtare" në Shqipërinë Socialiste 1972

Shqipëria e pasluftës ishte një vend rural dhe i prapambetur, me një ekonomi shumë të dobët dhe shoqëri kryesisht patriarkale. Censuset e popullsisë së paraluftës tregojnë se 80% e shqiptarëve jetonin në zona rurale dhe se rreth 75% ishin analfabetë. Analfabetizmi vazhdonte të ishte tepër i lartë te gratë, duke arritur në 67% në vitin 1950. Megjithatë, regjimi komunist e futi vendin në rrugën e industrializimit, dhe krijoi sektorin e ekonomisë së kontrolluar nga shteti. Në zonat rurale, prona private u zëvendësua nga kooperativat bujqësore shtetërore. Ky transformim ekonomik kishte nevojë për shumë krah pune, gjë që solli edhe ndryshimin e rolit të grave në shoqëri. Pjesëmarrja e grave në sferën e prodhimit, në atë publike, arsimore, dhe kulturore sa vinte e rritej, ndërsa roli patriarkal i familjes u zëvendësua me rolin paternalist të Partisë. Partia i mësonte shqiptaret se si të ishin nëna dhe qytetare të denja, por para së gjithash, se si të bëheshin punëtore dhe ushtare të devotshme në shërbim të atdheut. Sipas censusit të fundit të popullsisë në kohën e komunizmit, në vitin 1989, popullsia rurale arrinte në 65%, ndërsa analfabetizmi te gratë ishte vetëm në shkallën 11%.

Fotograf: Petrit Kumi.

Lexojeni çelësin me kujdes dhe analizoni fotografinë. Çfarë tregon gjuha e trupit të vajzës? Diskutoni fjalinë e mëposhtme në klasë: Pjesëmarrja e grave në sferën e prodhimit, në atë publike, arsimore, dhe kulturore sa vinte e rritej, ndërsa roli patriarkal i familjes u zëvendësua me rolin paternalist të Partisë. Partia i mësonte shqiptaret se si të ishin nëna dhe qytetare të denja, por para së gjithash, se si të bëheshin punëtore dhe ushtare të devotshme në shërbim të atdheut.

Si vihet në pikëpyetje "pozicioni i ngritur" i grave në shoqëri?

IV-9. Rroftë Komiteti Qendror i Partisë së Punës së Shqipërisë me në krye Enver Hoxhën. Parullë në një fabrikë

Fotograf: Petrit Kumi.

IV-10. Simbolet ideologjike të Shqipërisë komuniste: kazma, pushka dhe libri "Historia e Partisë së Punës së Shqipërisë"

Fotograf: Petrit Kumi.

Përshkruani fotografinë e mësipërme. Çfarë simbolesh vini re? Si lidhen ato me tiparet e vendit?

IV.2. KULTET E INDIVIDIT

IV-11. Anitkabir, Mauzoleu i Ataturkut në Ankara (1944-1953) Fotografi nga Luk Voteri

Fotografi nga Luk Voteri.

Mustafa Qemali (Ataturku) vdiq më 10 dhjetor të vitit 1938, pasi kishte transformuar rrënjësisht shoqërinë turke. Kulti i tij, që ishte krijuar gjatë jetës, vazhdoi edhe pas vdekjes.

Sipas Sibel Bozdoanit, Mauzoleu i Ataturkut, i projektuar nga Emin Onati dhe Orhan Ardai, është përmendorja më e rëndësishme shtetërore kombëtare e Turqisë. Ndërtimi i saj, i ndarë në katër faza, filloi më 9 nëntor të vitit 1944, me një ceremoni madhështore, dhe përfundoi pas nëntë vjetësh. Përmendorja i përket Periudhës së Dytë të Arkitekturës Kombëtare (1940-1950), kur u ndërtuan shumë ndërtesa monumentale, simetrike dhe me gurë kubikë. Njëkohësisht, mauzoleu përmban referenca ikonografike të qytetërimeve anadolliane paraislamike dhe pasqyron tezat zyrtare të historisë së Turqisë në atë kohë.

Sipas Sibel Bozdoanit, Mauzoleui Ataturkut është përmendorja më e rëndësishme shtetërore kombëtare e Turqisë. Si e kuptoni këtë? Çfarë është mauzoleu?

Krahasojeni me pjesën VI-4 (Shembja e Mauzoleut të Dimitrovit, viti 1999) në vëllimin 2 dhe diskutoni se çfarë simbolizojnë këto përmendore për sferën publike.

IV-11. Kulti i individit të Çausheskut. Udhëheqësi rumun si kumbar në "pagëzimin e gjahtarëve"

Nga koleksioni online i fotove të komunizmit rumun. http://fototeca. iiccr.ro/fototeca/, vizituar më 28.07.2016.

Diktatori rumun ishte shumë i dhënë pas gjuetisë. Gjatë vizitave të tij jashtë vendit, merrte shpesh armë gjuetie si dhuratë. Ndër shokët e tij të gjuetisë ishin edhe udhëheqës të shquar të shteteve të tjera si Josif Broz Tito apo Teodor Zhivkovi. Gjatë gjuetive, ku merrnin pjesë anëtarët e trupit diplomatik të Bukureshtit, udhëheqësi rumun shprehu dëshirën që të bëhej kumbar në "pagëzimin e gjahtarëve".

IV-12. Funerali simbolik i Stalinit në Knjazhevo, 9 mars 1953

http://www.lostbulgaria.com/?cat=344, vizituar më 28.07.2016.

Shihni filmin rumun: "Dasmë e heshtur" (Nunta Muta) realizuar nga Horatiu Malaele për vdekjen e Stalinit. Ngjarjet zhvillohen si më poshtë: Në një fshat të vogël dhe të izoluar, një dasmë në vitin 1953 ndërpritet nga lajmi i vdekjes së Stalinit. Meqenëse festimet publike ishin të ndaluara, ata vendosin ta kthejnë këtë ngjarje të hareshme në një dasmë të heshtur. Paraqitja e shkurtër e filmit mund të gjendet në: https://www.youtube.com/watch?v=LoRZBEpbqyA. Bëni disa kërkime për stalinizmin dhe diskutoni se si ndikoi ai në jetën e përditshme, edhe përtej kufijve të Bashkimit Sovjetik.

IV-13. Deklarata e Valko Çervenkovit në Plenumin e Partisë Komuniste të Bullgarisë, 21 prill 1956

Duke filluar pikërisht nga viti 1950 e në vijim, fill pas praktikës së kultit të individit të Stalinit, rreth emrit tim filloi të krijohej dalëngadalë një bujë e madhe, nisën nderimet, lavdërimet, m'u dhanë merita që nuk më takonin dhe çdo gjëje që unë bëja i mëshohej fort. Kjo situatë arriti deri në atë pikë sa Çervenkovi filloi të identifikohej me Komitetin Qendror (KQ) dhe me Partinë. [...] Unë vetë nuk arrita ta shihja të gjithë ndikimin e thellë që kulti i individit ushtronte tek unë, dhe nuk bëra të pamundurën për t'i eliminuar pasojat e tij te puna ime. Kjo shpjegohet me faktin se kulti i individit, që e sollëm në vendin tonë, është një helm kaq i ëmbël sa, pavarësisht vullnetit tënd, të helmatis pak nga pak, të verbon, të krijon një vetëbesim të tillë sa individi e vendos veten praktikisht dhe zyrtarisht mbi KQ-në, Partinë dhe shtetin, si dhe iluzioni se autoriteti i tij është i barabartë me atë të Partisë, zë vend tek ai gjithnjë e më shumë. [...] Pikërisht për shkak të ndikimit të kultit të individit, që u rrënjos thellë në vendin tonë, lindën tek unë huqe, dhe fillova të sillesha e të urdhëroja në Byronë Politike, KQ, dhe në Parti si të isha çifligar. Në thelb, nisa të zhvilloja mendësinë e udhëheqësit (më të lartë). Tërësia e huqeve, mënyrave dhe metodave të punës që burojnë nga ky vetëbesim prej despoti, të krijuara nga kulti i individit, mund të quhen despotizëm. Kjo nënkuptonte se unë duhet të isha medoemos individi që duhet të fliste me Partinë dhe popullin për çështje të rëndësishme, që nisma duhet të më përkiste gjithmonë dhe kurdoherë

mua, që fjala ime duhet të ishte e para dhe e fundit. Në të vërtetë, u shndërrova në një monopolist që donte të zotëronte gjithçka, kryesisht frontin ideologjik.

Kiriakovi et al. (botime), 2013, fq. 50-54.

Partisë Komuniste të Bullgarisë nga viti 1950 deri në vitin 1954, dhe kryeministri i saj gjatë periudhës 1950 -1956. Sundimi i tij u shënua nga fuqizimi i modelit stalinist, industrializimi me ritme të larta, kolektivizimi dhe përndjekja në masë e kundërshtarëve politikë.

1. Studioni me kujdes burimin e mësipërm. Si e përshkruan Çervenkovi këtë shndërrim të ngadaltë? Gjeni fjalët që e pasqyrojnë me saktësi këtë proces. Pse mendoni se ndodh kjo?

2. Kthejeni këtë përshkrim vetjak në një monolog teatral, të shoqëruar me një paraqitje pamore të riteve personale civile të udhëheqësve politikë në rang ndërkombëtar.

3. Ky fjalim u mbajt një muaj e gjysmë pas raportit të famshëm të Nikita Hrushovit "Për kultin e individit dhe pasojat e tij" në Kongresin e Njëzetë të Partisë Komuniste të BRSS-së më 25 shkurt 1956. Krahasojini të dy fjalimet me njëri-tjetrin.

https://www.marxists.org/archive/k hrushchev/1956/02/24.htm, vizituar më 28.07.2016.

IV-14. Futbollistët duke vajtuar pas njoftimit për vdekjen e Titos

Start, 14 maj 1980; Arena, 9 maj 1980..

Titoja vdiq më 4 maj të vitit 1980, pas një lëngimi të gjatë. Për shkak të rolit që kishte në shoqërinë jugosllave dhe në komunitetin ndërkombëtar, vdekja e tij, edhe pse e parashikuar për shkak të moshës së thyer (88 vjeçare), e tronditi popullin. Kjo fotografi u bë gjatë një ndeshjeje futbolli midis skuadrave të "Hajdukut" (Split) dhe" Crvena zvezdas" (Beograd), fill pas lajmërimit për vdekjen e Titos. Si lojtarët, ashtu edhe spektatorët u shkrehën në vaj.

IV-15. Vdekja e Enver Hoxhës

PARTIA DHE POPULLI SHQIPTAR TË PIKËLLUAR THELLË PËR VDEKJEN E UDHËHEQËSIT TONË TË DASHUR ENVER HOXHËS

Shokë, komunistë, punëtorë, kooperativistë, intelektualë, gra e të rinj të Shqipërisë, veteranë të luftës dhe bashkatdhetarë.

Me hidhërim e dhimbje të thellë ju njoftojmë se sot, më 11 prill 1985, ora 02.15, pushoi së rrahuri zemra e udhëheqësit tonë të dashur e të lavdishëm të Partisë dhe popullit tonë shokut Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, Kryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë, Komandant i Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të RPS të Shqipërisë.

U nda prej nesh themeluesi i Partisë sonë të lavdishme, organizatori dhe udhëheqësi i Luftës Nacionalçlirimtare e i revolucionit tonë popullor, arkitekti i ndërtimit të Shqipërisë së re socialiste. Mbylli sytë Komandanti heroik i Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare. Ai që krijoi Frontin Demokratik dhe hodhi themelet e Pushtetit Popullor.

Jeta dhe vepra e Enver Hoxhës, është historia e gjallë e Shqipërisë së sotme. Emri i tij është i lidhur me të gjitha betejat klasore dhe me të gjitha fitoret e Partisë dhe popullit shqiptar. Në të gjitha etapat që ka kaluar populli ynë, që nga dita kur u krijua Partia Komuniste e deri më sot, në çdo kohë kur vendoseshin fatet e popullit e të Atdheut, kurdoherë ka qenë i pranishëm mendimi dhe personaliteti i tij. Në të gjitha momentet kyçe, kur zgjidhej rruga që duhej ndjekur e lufta që duhej zhvilluar, udhëheqja dhe drejtimi i tij kanë qenë vendimtare.

Zëri i Popullit, 11 Prill 1985.

Enver Hoxha (1908-1985) ishte udhëheqësi komunist më jetëgjatë në pushtet. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, ai drejtoi Partinë Komuniste të Shqipërisë dhe Ushtrinë Nacionalçlirimtare ku mbizotëronin komunistët. Menjëherë pas ardhjes në pushtet të komunistëve, në nëntor të vitit 1944, Hoxha u kthye dalëngadalë në diktatorin e padiskutueshëm të vendit për afërsisht gjysmë shekulli. Fillimisht, ai ushtroi funksionin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, Kryeministrit dhe Ministrit të Jashtëm, përpara se të hiqte dorë nga të gjitha funksionet qeveritare dhe të merrte pushtetin absolut si Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë. Ai ishte arkitekti i politikave të ashpra ekonomike dhe i një sërë aleancash politike me Jugosllavinë e Titos (1945-1948), Bashkimin Sovjetik (1948-1960) dhe Kinën e Maos (1960-1978). Duke e konsideruar Shqipërinë komuniste si "vendin e vetëm socialist në botë", ai e çoi atë drejt izolimit ndërkombëtar nga fundi i viteve 1970 e deri në vdekjen e tij. Regjimi i Hoxhës kishte si tipar shtypjen e egër politike, pasi nga 3 milionë shqiptarë, 20,000 persona u burgosën dhe ekzekutuan.

Pse mendoni se pikëllimi për vdekjen e Stalinit, Hoxhës dhe Titos shprehej në këtë mënyrë? Çfarë tregon kjo për marrëdhënien ndërmjet udhëheqësve komunistë dhe popullit?

IV.3. VERSIONET E HISTORISË

IV-16. Ekstrakt nga një tekst shkollor i klasës së katërt (1954)

ZHVILLIMI I SHPEJTË I KAPITALIZMIT NË INDUSTRINË PRODHUESE TË BULLGARISË

Kapitalizmi në Bullgari, siç dëshmohet edhe nga numri i madh i fabrikave, filloi të zhvillohej me ritme të shpejta në fillim të shekullit XX. Në po të njëjtën kohë, u shtruan linja hekurudhore dhe rrugë automobilistike, si dhe u ndërtuan porte në Danub dhe në Detin e Zi. Duke qenë se fabrikat dhe trenat kishin nevojë për qymyr, u hapën miniera në Dimitrov (Pernik) dhe në vargmalet e Ballkanit. Pas çlirimit nga sundimi osman, në vitin 1878, Bullgaria kishte një numër shumë të vogël fabrikash, por në vitin 1911, numri i tyre kishte arritur në 350, me 16,000 punëtorë.

PËRPARIMI KULTUROR

Me përhapjen e kapitalizmit në Bullgari, lindi nevoja për arsimim. Meqenëse borgjezët bullgarë kishin nevojë të arsimoheshin si nëpunës civilë, administratorë fabrikash, llogaritarë tregtie etj., në vend u hapën shumë shkolla, një universitet dhe një akademi arti në Sofje, si dhe u themelua Akademia e Shkencave të Bullgarisë.

SITUATA E PUNËTORËVE DHE FSHATARËVE

Nga ky përparim kulturor përfituan vetëm borgjezët. Jeta e punëtorëve dhe fshatarëve nuk u përmirësua. Ata shfrytëzoheshin mizorisht në punë nga borgjezët, rrogat e tyre ishin shumë të ulëta dhe jetonin nëpër periferi. Edhe situata e fshatarëve ishte e mjerueshme. Ata rropateshin duke punuar nga mëngjesi në darkë nëpër ara, me vegla të vjetruara dhe ishin të zhytur në taksa. Një pjesë e mirë e prodhimit të tyre përdorej për të paguar taksat dhe borxhet.

Burmov et al., 1954, fq. 93.

IV-17. Dy versionet e ndryshme të çlirimit të Tiranës, kryeqytetit të Shqipërisë, nëntor 1994

A. Roli i ish-kryeministrit komunist Memet Shehu vlerësohet lart si një komandant partizan, 1967

Beteja e Tiranës. Teksa Mbledhja e Dytë e Këshillit Nacionalçlirimtar po mbahej në Berat, Ushtria Nacionalçlirimtare e Shqipërisë (UNÇSH) po përleshej për herë të fundit me pushtuesit gjermanë dhe me bandat e mbetura kundërrevolucionare, që po bënin të pamundurën të largoheshin nga Shqipëria për t'i shpëtuar vdekjes.

Asokohe, ngjarja më e rëndësishme ushtarake ishte beteja për çlirimin e Tiranës. […] Korparmata e Parë hartoi një plan operacioni të hollësishëm, sipas udhëzimeve të Komandantit të Përgjithshëm. […] Në rrethin e Tiranës, do të vepronin trupat e Divizionit të Parë me komandant Mehmet Shehun.

Gjatë sulmit vendimtar të 11 nëntorit, u aktivizuan edhe njësi të tjera të UNÇSH-së. […] Duke asgjësuar njëri pas tjetrit pozicionet ushtarake të armiqve, forcat partizane morën nën kontroll të gjithë qytetin, përveç tre ose katër pozicioneve të fortifikuara, që kontrolloheshin ende nga armiku.

Ndërkohë, më 11 nëntor, Brigada e Pesëmbëdhjetë Sulmuese partizane çliroi qytetin e Elbasanit pas një përleshjeje të ashpër me trupat gjermane, që po tërhiqeshin nga Greqia. Këta trupa (5,000) ishin ngarkuar të sulmonin prapa krahëve forcat partizane që po rrethonin Tiranën, të shkatërronin qytetin dhe të tërhiqeshin së bashku me garnizonin gjerman drejt Shkodrës. Forcat partizane dhe qytetarët e Tiranës u gjendën përballë një rreziku të madh, por kalimtar falë kundërpërgjigjes së vendosur dhe të rrufeshme të Korparmatës së Parë, që drejtonte betejën për çlirimin e kryeqytetit.

Mëngjesin e 17 nëntorit të vitit 1944, qëndresa e armikut u mposht. Pjesa më e madhe e ushtrisë së rrethuar u asgjësua. Tirana u çlirua.

Beteja për çlirimin e Tiranës zgjati 19 ditë. Luftëtarët e UNÇSH-së treguan heroizëm të pashoq dhe zunë njëri pas tjetrit pozicionet e armiqve të pajisur me tela me gjemba, mina, tanke dhe autoblinda. Në luftën kundër gjermanëve, nuk u mobilizuan vetëm partizanët, por edhe qytetarët e Tiranës.

Pollo, 1967, fq. 810-813.

B. Emri i Mehmet Shehut as nuk përmendej më, pasi u shpall "armik i popullit" fill pas vetëvrasjes në dhjetor të vitit 1981

Beteja e Tiranës. Teksa Mbledhja e Dytë e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar po mbahej në Berat, Ushtria Nacionalçlirimtare e Shqipërisë (UNÇSH) po përleshej për herë të fundit me pushtuesit gjermanë dhe me bandat e mbetura kundërrevolucionare, të cilat po bënin të pamundurën të largoheshin nga Shqipëria për t'i shpëtuar vdekjes.

Në rrethin e Tiranës, u caktuan trupat e Divizionit të Parë.

Gjatë sulmit vendimtar të 11 nëntorit, u aktivizuan edhe njësi të tjera të UNÇSH-së. Pasi asgjësuan njëri pas tjetrit pozicionet e armiqve, më 14 nëntor, forcat partizane morën nën kontroll të gjithë qytetin, përveç tre ose katër pozicioneve të fortifikuara.

Mëngjesin e 17 Nëntorit të vitit 1944, qëndresa e armikut u mposht. Tirana u çlirua

Pollo, 1984, fq. 625-628.

IV-18. Interpretime të ndryshme të përfundimit të Luftës së Dytë Botërore

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Lufta për Çlirimin Kombëtar (siç quhej ndryshe nga përkrahësit), ishte kthyer në një prej ngjarjeve kryesore, ku mbështetej legjitimiteti e Jugosllavisë socialiste. Versioni zyrtar i luftës nuk linte vend për rishikime. Krimet kundër armikut dhe robërve të luftës mbuloheshin ose anashkaloheshin. Nga ana tjetër, anëtarët e palës së mundur, që arritën të largoheshin nga Jugosllavia, e tjetërsonin sipas interesit rolin që kishin luajtur gjatë luftës, duke i mëshuar fort dhe zakonisht duke i zmadhuar krimet e sipërpërmendura.

A. Versioni zyrtar i autoriteteve komuniste jugosllave

Gjatë ditëve të fundit të të ashtuquajturit SHPK (Shtetit të Pavarur të Kroacisë), kur nuk kishte më pikë dyshimi se Gjermania e kishte humbur luftën, udhëheqësit e regjimit ustash u përpoqën t'ia mbushnin mendjen vetes, kriminelëve të tjerë, dhjetëra mijëra qytetarëve të indoktrinuar dhe fshatarëve me uniforma ushtarake, se do të ndërhynin dhe mësynin në Karinthia, ku do të takonin Aleatët. […] Në fund të prillit dhe në fillim të majit, Ushtria Jugosllave, e përbërë prej 800,000 luftëtarësh, mposhti ushtrinë pushtuese dhe çliruan të gjithë vendin, përfshirë edhe Triesten, dhe arritën deri në Soça, duke i mundur përfundimisht forcat tradhtare. Gjatë këtyre operacioneve, Çetnikët dhe Ustashët lidhën aleancë duke i bashkuar forcat e tyre në luftën e përbashkët kundër partizanëve, pavarësisht përleshjeve të përgjakshme të mëparshme mes tyre dhe pushtuesve […] Njësitë e Ushtrisë Jugosllave arritën t'iu zinin pritë forcave tradhtare në kufirin ndërmjet Austrisë dhe Jugosllavisë, duke penguar kështu dorëzimin e tyre te fuqitë Perëndimore, dhe duke zënë rreth 50,000 robër, kryesisht ushtarë Ustashë e Çetnikë. Pjesa tjetër e këtyre forcave kaloi në Austri, ku kishin ngritur edhe kampet e tyre.

Bilandziç, 1978, fq. 78-79.

B. Versioni i të arratisurve politikë kroatë që u larguan nga vendi në vitin 1945

Dubrovniku, Spliti, Sinji, Imotski, Mostari, Siroki Brijegu, Travniku, Sarajeva, Nashica, Mitrovica,

Gospiçi dhe qytetet e tjera kroate, ranë në duart e "të kuqve", që morën përforcime ushtarake nga Shtetet e Bashkuara dhe Britania e Madhe. Të gjitha këto zona ishin përgjakur nga masakra e barbari, që nuk ishin parë që prej kohës së pushtimeve mongole dhe turke. Pasuesit e Titos e arritën qëllimin e tyre për të spastruar të gjithë shtetasit kroatë me burra, gra, të rinj e të moshuar, të varfër e të pasur, intelektualë e punëtorë. Edhe 25 vite më parë, kam dhënë shifrën e 600,000 qytetarëve kroatë të vrarë pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. […] Kroatët tani përdorin vetëm shifrat e Nikoliçit prej më se 200,000 viktimash në Bleiburg, pa i përmendur shifrat e mia, paçka se unë kaloj nëpër duar rreth pesëfishin e dokumenteve burimore ku mbështetet libri në spanjisht dhe përkthimi i tij nga Nikoliçi dhe Nevestiçi.

Prcela, 2001, fq. XXXI.

IV-19. Interpretimet e ndryshme të Luftës së Dytë Botërore nga dy historianë grekë

Vlerësimi i rezistencës greke gjatë pushtimit të forcave të Boshtit, në periudhën 1941-1944, nuk lidhet vetëm me qasjet e ndryshme që janë përdorur që prej viteve 1950, por edhe me politikat bashkëkohore dhe kryesisht me metodat e kundërshtimit të kampeve politike të Greqisë së pasluftës, që ishin ngritur sipas identiteteve të tyre përkatëse. Njohja e kontributit të komunistëve në rezistencë, akuzat për bashkëpunim, dhe lufta civile gjatë periudhës së pushtimit janë vetëm disa prej shqetësimeve që trajtojnë historiografia dhe politika greke.

A. Pikëpamja e majtë

Më 27 shtator të vitit 1941, disa sindikata dhe figura politike, së bashku me Partinë Komuniste dhe partitë e tjera të majta si: Partia Socialiste dhe Bashkimi i Demokracisë Popullore që sapo ishin themeluar, krijuan njëherazi Frontin Nacionalçlirimtar (FNÇ) dhe Ushtrinë Nacionalçlirimtare Popullore (UNÇP), qendrën për rezistencën ushtarake, veprimtaria e së cilës zë fill në shkurt të vitit 1942. FNÇ-ja bashkoi shumicën dërrmuese të popullit grek, dhe rëndësia e veprimtarisë së saj i tejkalonte ato të lëvizjes së një qëndrese të thjeshtë. […] Rëndësia e FNÇ-së, prirja e saj për reforma të thella shoqërore dhe mbizotërimi i Partisë Komuniste në udhëheqje, i shqetësonte partitë politike të paraluftës dhe qeverinë mbretërore në Kajro, që mbështeste krijimin e lëvizjeve të tjera të rezistencës.

Svoronos, 1978, fq. 139,140.

B. Pikëpamja e djathtë

Njerëzit prireshin, me të drejtë, ta nderonin Betejën e Britanisë, njësoj siç prireshin t'iu shmangeshin me pështirosje "përseve" të francezëve, apo të të gjitha palëve që kishin kapitulluar në atë kohë; por njëherazi, i shpërfillnin, pa të drejtë, reagimet e grekëve për Luftën e Dytë Botërore. Këtë gjendje e kishin shkaktuar vetë grekët, jo vetëm përmes mosmarrëveshjeve të brendshme dhe të vazhdueshme, por edhe me paaftësinë e tyre gjatë paqes, për të shfrytëzuar titujt që kishin fituar dhe sakrificat që kishin bërë gjatë luftës. Mbreti dhe qeveria luftoi jashtë vendit me Aleatët në El Alameini dhe Rimini, duke ndihmuar me flotën e tyre tregtare dhe ushtarake, të paktën atë çka kishte mbetur prej saj. Në Greqi, ata luftonin me armikun. Bashkëpunëtorët dhe oportunistët ishin pakicë e papërfillshme në vend. Fatkeqësisht, zënkat e brendshme ndërmjet partive dhe mungesa e organizimit të përpjekjeve të përbashkëta iu dhanë mundësinë komunistëve ta zgjeronin bazën e FNÇ-së, pasi ç'është e vërteta, ishin në pakicë.

Markezinis, 1968, vëll. 4, fq. 326.

Lexojini të dyja interpretimet e lëvizjes së rezistencës në Greqi. Gjeni ndryshimet ndërmjet dy pikëpamjeve. A ka pika të përbashkëta? Nëse po, cilat janë ato? Diskutoni rreth paanshmërisë së historianëve.

IV.4. ARSIMI

IV-20. Faqe e shkëputur nga abetarja e fundit socialiste në Bullgari, 1986



http://socbg.com/2015/01/%D0%B8%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%83%D0%B2%D0%B0%D0%BD%D0%B5-%D0%B2-%D0%BE%D0%B1%D0%BD%D1%81-%D0%BF%D0%BE%D0%BC%D0%BE%D1%80%D0%B8%D0%B5-80-%D1%82%D0%B5.html, vizituar më 21.09.2016..

IV-21. Ekstrakte nga një qarkore dërguar shkollave rumune në shkurt, të vitit 1948

Shkollat duhet të fillojnë të funksionojnë me hap dinamik dhe revolucionar. Ne duhet të hapim një kapitull të ri për shkollat popullore. [...] Mësueset e shkollës do të ngrenë korin e shkollës ku, krahas pjesëve muzikore që përkojnë me frymën e kohës sonë, do t'iu kërkohet të përgatisin edhe himnin sovjetik dhe "Internacionalen". [...] Klasat do të zbukurohen si më poshtë:

Këndi ARLUS me portretet e Kryekomandantit Stalin, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Asamblesë së Madhe Kombëtare, Kryeministrit të Këshillit të Ministrave, dhe me pankarta e parulla, që shpalosin marrëdhëniet miqësore ndërmjet Bashkimit Sovjetik dhe Republikës Popullore të Rumanisë.

Në gazetën e murit (tabela e propagandës) duhen vendosur çdo muaj krijime të ndryshme të nxënësve për shkollën dhe jetën shoqërore të fshatit, vizatimet më të mira etj.

Formimi i nxënësve me frymën republikane, bëhet përmes mësimeve ditore dhe agjencisë "Klasa Republikane", çdo të shtunë, pas mësimit. [...] Mësueset, me ndihmën e nxënësve, do të korrigjojnë dhe mbledhin materialet e nevojshme nga gazetat, revistat dhe broshurat, duke krijuar kështu një dosje enkas për "Klasën Republikane". [...] Të gjitha shkollat duhen informuar menjëherë për të bërë ndryshimet e mëposhtme në tekstet shkollore:

Abetarja e klasës së parë: Të hiqen faqet e para me portretet e figurave mbretërore.

Leximi i klasës së dytë: Të hiqen faqet e para me portretet e figurave mbretërore. Të fshihen rreshtat në mësimin për mbretin në faqen 131. Të fshihen dy rreshtat e para në faqen 235 (Përmbajtja),

Leximi i klasës së tretë: Të fshihen rreshtat "Madhërisë së tij, Mbretit, iu dha dekorata e "Urdhrit të Fitores", titullit më të lartë të nderit në Bashkimin Sovjetik".

Matematika e klasës së tretë (faqet 73 dhe 74): Të mbulohet figura e ish-mbretit në monedhat 20 dhe 100 lei.

Gjeografia e klasës së katërt (faqe 64): Të fshihen fjalët "Ferdinandi kurorëzohet si Mbreti i Rumanisë" dhe të zëvendësohen me këto fjalë "Kremtohet bashkimi i rumunëve".

Qarkore Nr. 2256, nga shkurti i vitit 1948, e publikuar në Fletoren Zyrtare të Inspektoratit të Kontesë së Bakaut Nr.23-24/Janar-Shkurt 1948 (Arkiva Kombëtare e Iashit) koleksion: Inspektorati Rajonal i Shkollës së Kontesë së Iashit, dosje 97/1948, fq. 21, fq. 1-13).

ARLUS do të thotë Shoqëria Rumune për Miqësi me Bashkimin Sovjetik, që ishte një shoqatë kulturore e ngritur nga një grup intelektualësh të majtë në vjeshtë të vitit 1944, që u kthye shumë shpejt në një vegël propagande, e kontrolluar dhe e financuar nga shteti.

Cilat ishin qasjet novatore që u futën nëpër shkollat rumune në vitin 1948? Duke shfrytëzuar njohuritë tuaja, paraqitni arsyet e fshirjes së referencave të mbretit nga tekstet shkollore. Diskutoni rreth marrëdhënies ndërmjet të kujtuarit dhe të harruarit.

IV-22. Letra e Ministrit të Arsimit të Popullit, K. Dramalievit, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bullgarisë, më 30 gusht të vitit 1950

Në mbledhjen e zgjatur të 21 gushtit, në Ministrinë e Arsimit të Popullit shokët miratuan një plan për zhdukjen e analfabetizmit, sipas së cilit 100,000 analfabetë dhe 50,000 analfabetë funksionalë, duhet të regjistrohen në kurset e mësimit të shkrimit dhe leximit gjatë vitit shkollor 1950-1951.

Puna e deritanishme nuk ka pasur rezultate të kënaqshme. Në vitin shkollor 1948-1949, rreth 49,951 analfabetë mësuan të shkruanin e të lexonin. Një vit më vonë, rreth 49,192 persona të tjerë ndoqën këto kurse. Nga viti 1945 deri në 1950-n, në këto kurse morën pjesë rreth 140,000 analfabetë dhe analfabetë funksionalë gjithsej.

Arsyeja kryesore e kësaj pune pa fryte ishte se u ndërmor pa përfshirë Partinë. Ministria e Arsimit të Popullit mendonte se nuk mund të kishte arritje në rrugë administrative nëse organizatat e partisë nuk përfshiheshin si pjesëmarrëse të drejtpërdrejta në luftën për zhdukjen e analfabetizmit, dhe nëse populli nuk përfshihej në aksion. Përpjekjet tona për të tërhequr organizatat e masave nuk kanë dhënë shumë rezultate. Zhdukja e analfabetizmit mbeti punë e mësuesve.

Bashkimi i Grave të popullit bullgar, duhet të bëjë propagandë te gratë, sidomos me gratë turke dhe ato bullgare myslimane. Ato duhet të ngrenë qendra për fëmijët e nënave, që ndjekin kurset e analfabetizmit, për kohëzgjatjen e mësimit të tyre.

Sindikata e Përgjithshme e Punëtorëve dhe Ministria e Industrisë, duhet të gjurmojë dhe regjistrojë të gjithë punëtorët analfabetë dhe të ofrojë mjedise për kurset. Kontrolli për funksionimin e rregullt të

kurseve, duhet bërë nga komitetet e sindikatave dhe drejtuesit e ndërmarrjeve. Gjithashtu duhet siguruar sistem ngrohjeje, ndriçim, ndihmë për mësuesit dhe shpërblime.

ЦДА (Arkiva Qendrore e Shtetit) f.1Б, inv. 6, a.u. 1090.

Lexojeni burimin me kujdes. Diskutoni shprehjet e mëposhtme: "Arsyeja kryesore e kësaj pune pa fryte ishte se u ndërmor pa përfshirë Partinë", "Përpjekjet tona për të tërhequr organizatat e masave nuk kanë dhënë shumë rezultate" dhe "Zhdukja e analfabetizmit mbeti punë e mësuesve". Kujt i takon detyra e zhdukjes së analfabetizmit? Cili ishte roli i Partisë Komuniste në punët publike, veçanërisht në arsim? Si mund të ndihmojë Partia në zhdukjen e analfabetizmit sipas burimit?

IV-23. Neni 16 për arsimin i Kushtetutës së parë të periudhës së pas Luftës Civile në Greqi, 1952

Arsimi kaloi nën mbikëqyrjen e rreptë të shtetit dhe financohej prej tij dhe organeve vendore vetëqeverisëse. Në të gjitha shkollat e arsimit 8-vjeçar dhe të mesëm, mësimdhënia synonte edukimin moral të intelektualëve dhe të rinjve, si dhe zhvillimin e ndërgjegjes së tyre kombëtare, mbështetur në parimet ideologjike të qytetërimit helen të krishterë. Arsimi fillor ishte i detyrueshëm për të gjithë dhe financohej nga shteti. Ligji parashikon se arsimi i detyrueshëm nuk duhet të jetë më pak se gjashtë vjet. Institucionet e arsimit të lartë vetëqeverisen nën mbikëqyrjen e shtetit, profesorët e të cilëve janë funksionarë publikë. Autoritetet iu japin të drejtën për të ushtruar veprimtarinë e institucioneve të arsimit të lartë të gjithë individëve fizikë dhe juridikë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e shtetit.

Fletorja e Qeverisë, botimi I, nr. 1 (1 janar 1952).

IV-24. Kisha e Qipros dhe arsimi 1970

Në një artikull të botuar në numrin e fundit të së përjavshmes "Paratiritis" më 21 shkurt, 1970, Metropoliti Anthimosi i Kitionit përsëriti atë çka kishte deklaruar gjatë një predikimi në fshatin e Erimit, se "ata që po sundojnë Qipron tani, as nuk janë, e as nuk mendojnë si grekë" dhe se mësuesit kishin "ndjenja të dyshimta atdhetare dhe shoqërore". Megjithëse pikëpamjet e tij nuk përkonin me ato të shumicës së qytetarëve grekë qipriotë, ndikimi që ato patën në shoqëri nuk ishte i vogël, pasi ndikohej prej rolit tradicional të kishës në arsimin greko-qipriot. Kjo situatë ishte tipike për kohën, veçanërisht pas vitit 1967, për shkak të pasojave që patën në shoqërinë qipriote-greke ligjërimet politike nacionaliste të regjimit të kolonelëve në Greqi. Në të vërtetë, kritikat e tërthorta të Metropolitit ndaj presidentit Makarios, iu shkuan përshtat pushtetarëve që jetonin në Athinë. Junta e quajti prirjen e majtë të Makarios si të papranueshme.

→

Fakti se kisha dhe arsimi kanë qenë historikisht vëzhguesit, drejtuesit dhe shtylla e traditave greke të krishtera, që përgjatë shekujve të skllavërisë mizore ruajtën dhe konsoliduan ndjenjat atdhetare të popullit grek, është i padiskutueshëm. Përderisa nuk kam dijeni, nuk mund të pretendoj se arsimi në Qipro nuk e luan më rolin e tij të dikurshëm. Megjithatë, ajo çka unë di është se në arsimin 8-vjeçar dhe të mesëm, ka mësues me kombësi dhe ndjenja atdhetare të dyshimta, përpjekjet e të cilëve përqendrohen në krijimin e ndërgjegjes qipriote dhe largimin e të rinjve të Qipros nga traditat e mrekullueshme të krishtera kombëtare.

Në këtë pikë, duhet ta përgëzoj Ministrin e Arsimit, që pavarësisht se ishte i "rrethuar" nga të gjitha anët, u tregua i vendosur të luftojë për karakterin grek të arsimit qipriot. Gjithashtu, në këtë aspekt, duhet të nënvizoj arsimin e mrekullueshëm kombëtar që zyrtarët grekë iu ofrojnë të rinjve të rekrutuar të Qipros.

Gazeta "Filelefteros"
25 shkurt 1970.

Burimet e krerëve IV-23 dhe IV-24 i referohen qytetërimit helen të krishterë dhe traditave greke të krishtera. Si mendoni, çfarë lloj ideologjie u mundua të rrënjoste arsimi në Greqi dhe Qipro te fëmijët në atë kohë? Gjeni fjalët që shprehin ideologjinë, për të mbështetur arsyetimin tuaj.

IV-25. Fasada e Universitetit të Tiranës me një fotografi të stërmadhe të udhëheqësit komunist Enver Hoxhës (1908-1985)

Fotograf: Roland Tasho.

The photograph was taken in October 1988, on the occasion of the 80th anniversary of the birth of the Albanian communist leader.

IV-26. Edukata familjare dhe seksuale në Bullgari

Edukata seksuale dhe familjaro-martesore shihen si një element përbërës tejet i rëndësishëm i formimit të përgjithshëm të personalitetit socialist. Si të tilla, edukata seksuale dhe familjaro-martesore, që është një aspekt i mëvetësishëm nga procesi i arsimit, lidhet kryesisht dhe drejtpërdrejt me rrafshe të tjera të arsimit si: me rrafshin intelektual, moral, fizik, etik, ideologjiko-politik etj.

Edukata seksuale dhe martesore nuk duhet vështruar si një proces i thjeshtë dhe i një fushe të ngushtë, pasi ajo përfshin në vetvete një sërë temash, që mund të ndahen në disa grupe:

1. Trajtimi i zgjeruar i këtyre temave ofron informacionin dhe njohuritë e nevojshme rreth dukurive dhe proceseve biologjike, psikologjike, shoqërore, higjienike dhe shëndetësore të jetës seksuale dhe familjare.

2. Edukata seksuale, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, është veprimtaria pedagogjike nëpërmjet së cilës realizohet sistematikisht procesi i formimit të personalitetit, ndërgjegjes dhe sjelljes së të rinjve, për t'i ndihmuar ata të formojnë koncepte të shëndosha rreth seksit dhe jetës familjare, sipas normave të moralit komunist.

E gjithë kjo veprimtari e ndërlikuar dhe me shtrirje të gjerë të procesit edukativ realizohet me punë intensive që fillon që me rastet e fëmijërisë e deri në ato të formimit dhe pjekurisë së plotë të personalitetit, duke filluar që në mjediset e shkencës bashkëkohore, dhe duke iu kundërvënë kategorikisht të gjitha anakronizmave të së shkuarës.

Sot, tani që sistemi ynë arsimor po ndërtohet nga e para, edukata seksuale dhe familjaro-martesore duhet ta gjejë vendin që i takon në procesin edukativo-mësimor në tërësi. Për këtë qëllim, po hartohen edhe programet përkatëse. Sigurisht që, për sa iu përket shkollave, çështja kryesore është se, krahas programeve të arrira e me nivel shkencor, duhet të kemi edhe mësues dhe edukatorë të përgatitur e të mirëformuar, që të kenë aftësitë dhe autoritetin e duhur për të punuar.

Nga ana tjetër, realizimi i këtij procesi veç synimeve si mësimi sistematik, me objektiva të qarta, i përpiktë dhe me baza shkencore i edukatës seksuale dhe familjaro-martesore, nuk duhet të arrihet vetëm përmes procesit mësimoro-edukativ të shkollave, por nga puna frontale e gjithë shoqërisë, duke përfshirë familjen, autoritetet shëndetësore, organizatat shoqërore, mediat dhe institucionet shëndetësore.

Bostandzhiev, 1979, fq. 24-26.

Në vitet 1960 dhe 1970 pati një "revolucion" të pazakontë në sjelljen e të rinjve të bllokut socialist, që lidhej me zgjerimin e vazhdueshëm, edhe pse të kontrolluar rreptësisht nga shteti, të hapësirës së kontaktit dhe ndërveprimit me kulturën popullore Perëndimore dhe "revolucionin seksual", që nga ana tjetër kultivonte shije të caktuara muzikore (kryesisht parapëlqime për disa lloje të ndryshme të muzikës rrok), praktika të shthurura dhe ideologji të çlirimit të trupit (si nudizmi). Shembulli kryesor në këtë aspekt ishte ajo e lëvizjes së nudizmit në Gjermaninë Lindore, që u tolerua nga autoritetet, dhe romani më i shitur i Zigfrid Shnablit "Burri dhe gruaja në intimitet" (Mann und Frau intim) e çoroditën bllokun socialist, duke përfshirë edhe Bullgarinë. Elitat bullgare komuniste, në përpjekje të vazhdueshme për t'i kontrolluar këto qëndrime dhe ide të reja rreth gjinisë dhe seksit, hartuan politika shkencore dhe arsimore, që synonin rregullimin e interesave të shtetit dhe të rinjve në rrafshin e intimitetit. Në shtypin socialist, filluan të botoheshin gjithnjë e më shumë artikuj për edukatën morale dhe seksuale. Në vitin 1963, Profesor Todor Bostandzhievi hapi zyrën e parë këshillimore të seksologjisë në Bullgari, dhe paraqiti një sërë nismash për edukatën seksuale. Krahas botimit të artikujve në revistat për gra e të rinj, dhe artikujve shkencorë me

→

tema që lidheshin me seksin, ai ishte shumë aktiv edhe në futjen e lëndës së edukatës seksuale në kurrikulën e shkollës. Edhe mjekë e shkencëtarë të tjerë u munduan ta kthenin seksin në një temë për të cilën të mund të diskutohej lirisht. Nuk mund të jetë rastësi, që pikërisht në parathënien e botimit të parë në gjuhën bullgare të librit me titull: "Burri dhe gruaja në intimitet", Profesor Hristo Golmamovi, Drejtori i Institutit për Edukimin Shëndetësor, citoi fjalimin e mëposhtëm të Todor Zhivkovit: "Temat e kulturës së seksit dhe edukimit seksual të rinisë, vazhdojnë të jenë të ndaluara në publik. Padituria në këtë drejtim, zakonisht e vë shëndetin fizik dhe moral të të rinjve në një rrezik që mund të shmanget. Është më se e qartë se duhet krijuar një sistem i përgjithshëm për edukimin seksual dhe familjaro-martesor të të rinjve."

1. Komentoni rreth burimit të kreut IV-26 dhe çelësit. Pse mendoni se formimi i qëndrimeve të caktuara për jetën seksuale dhe intimitetin, ishin kaq të rëndësishme për shoqëritë socialiste? Gjithashtu, merrni parasysh edhe mungesën e edukimit fetar në atë kohë.

2. Krahasoni nismat e praktikave edukative të ditëve të sotme në lidhje me këtë temë në vendin tuaj.

IV-27. Kushtetuta e Republikës së Turqisë, 7 nëntor 1982

Megjithëse dekretoi Qemalizmin si ideologjinë e vetme zyrtare dhe shpalli shekullarizimin, Kushtetuta e vitit 1982, i ngarkoi fesë edhe një mision kombëtar. Sipas Nenit 24, përgjegjës për edukimin fetar të qytetarëve ishte vetëm shteti. Edukimi dhe mësimi fetar dhe etik ofrohet vetëm nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e shtetit. Udhëzimet për kulturën fetare dhe edukatën morale janë të detyrueshme në kurrikulën e arsimit 8-vjeçar dhe të mesëm. Edukimi dhe informimi i mëtejshëm fetar i nënshtrohet vullnetit të vetë individit, dhe në rastin e të miturve, jepet me kërkesë të përfaqësuesve të tyre ligjorë.

NENI 42

Formimi dhe edukimi kryhen në përputhje me parimet dhe reformat e Ataturkut, mbi bazën e shkencës bashkëkohore dhe metodave të mësimdhënies, nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e shtetit. Nuk do të lejohet ngritja e institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, që nuk i respektojnë këto dispozita. […] Qytetarëve turq nuk do t'iu mësohet asnjë gjuhë tjetër amtare në institucionet e arsimit dhe formimit profesional përveç gjuhës turke. Gjuhët e huaja, që do të mësohen në institucionet e arsimit dhe formimit, si dhe rregullat që do të ndiqen nga po këto shkolla në gjuhë të huaj, përcaktohen me ligj. Dispozitat e traktateve ndërkombëtare janë të rezervuara.

http://www.refworld.org/cgi-bin/texis/vtx/rwmain?docid=3ae6b5be0, vizituar më 26.11.2015..

Diskutoni shprehjen: "Qytetarëve turq nuk do t'iu mësohet asnjë gjuhë tjetër amtare në institucionet e arsimit dhe formimit profesional përveç gjuhës turke".

DETYRAT PËR KAPITULLIN IV.4

Termi i shoqërizimit nënkupton procesin e përjetshëm gjatë së cilit fitojmë aftësitë dhe shprehitë e nevojshme për të marrë pjesë në shoqëri. Ne mësojmë edhe rreth pritshmërive shoqërore si: normave, zakoneve, vlerave dhe ideologjive. Shoqërizimi në fëmijëri nxitet nga disa faktorë. Krahas familjes, një ndër faktorët më të rëndësishëm është edhe shkolla. Kjo është arsyeja se përse çështjet arsimore trajtohen jo vetëm si pedagogjike, por edhe si politike. Analizoni burimet në këtë pjesë dhe në atë që vijon (IV. 5 Politika gjuhësore) dhe gjeni disa praktika shoqërizimi përmes procesit të arsimimit. Kushtojuni vëmendje të veçantë shoqërizimit kulturor e politik, si dhe politikave të identitetit dhe krijimit të "njeriut të ri socialist". Zgjidhini burimet në përshtatje me to (vini re se nuk ju kërkohet të gjeni të gjitha burimet për shtjellimin e kësaj çështjeje).

→

Plotësoni tabelën e mëposhtme:

Vendi	Titulli i burimit	Viti	Shembuj të praktikave të shoqërizimit

IV.5. POLITIKA GJUHËSORE

IV-28. Kodifikimi i gjuhës maqedonase

A. A.Vendimi i ASNOM-it për alfabetin maqedonas

https://en.wikipedia.org/wiki/Macedonian_alphabet, vizituar më 26.09.2016..

B. Rezoluta e miratuar nga ASNOM-i, ku gjuha maqedonase shpallet si gjuhë zyrtare, viti 1944

Rezoluta e Asamblesë Antifashiste të Frontit Nacionalçlirimtar të Popullit Maqedonas, ku maqedonishtja shpallet gjuha zyrtare e shtetit të Maqedonisë.

Neni 1. Në këtë dokument, gjuha amtare maqedonase shpallet gjuha zyrtare e shtetit të Maqedonisë.

Neni 2. Kjo rezolutë hyn menjëherë në fuqi. Në Manastirin e Atit të Shenjtë Prohorit të Pçinjës, më dy gusht, Ditën e Shën Elisë1944.

Koleksioni i Dokumenteve të Asamblesë Antifashiste të Frontit Nacionalçlirimtar të Popullit Maqedonas (ASNOM), 1964, fq. 241.

Në seancën e parë të Asamblesë Antifashiste të Frontit Nacionalçlirimtar të Popullit Maqedonas (ASNOM), të mbajtur në Pçinjë më 2 gusht të vitit 1944, gjuha amtare maqedonase u shpall gjuha zyrtare e shtetit të Maqedonisë, dhe u hodhën themelet e gjuhës standarde maqedonase bashkëkohore. Procesi i kodifikimit të gjuhës si gjuhë zyrtare, vijoi me miratimin zyrtar të alfabetit maqedonas dhe rregullores legjislative të drejtshkrimit maqedonas. Komisionit të Gjuhës dhe Drejtshkrimit Maqedonas, të themeluar në nëntor të vitit 1944, nga Presidiumi i ASNOM-it iu ngarkua detyra për të punuar për alfabetin dhe drejtshkrimin. Në maj të vitit 1945, Qeveria Popullore e Republikës së Maqedonisë miratoi alfabetin e gjuhës maqedonase, që u botua më pas në numrin e parë të së përditshmes së parë maqedonase "Maqedonia e Re". Më 7 qershor të vitit 1945, Ministria e Arsimit të Popullit miratoi drejtshkrimin e paraqitur. Kodifikimi pasqyronte gjuhën amtare maqedonase. Libri "Gramatika e Gjuhës Maqedonase", e shkruar nga Krume Kepeski u miratua si tekst shkollor nga Ministria e Arsimit të Popullit, më 24 janar të vitit 1946.

IV-29. Marrëveshja e Novi Sadit (1954)

Gjuha ishte kthyer në një çështje të rëndësishme politike në Federatën shumëkombëshe të Jugosllavisë. Pas Marrëveshjes së Novi Sadit në vitin 1954, ku gjuhëtarët kroatë dhe serbë ranë dakord që serbët, malazezët dhe kroatët të flisnin të njëjtën gjuhë, që njihet si gjuha serbo-kroate, gjuhëtarët kroatë krijuan shoqatën kulturore "Matrix Croatia", dhe në vitin 1967 publikuan një deklaratë për emrin dhe pozitën e gjuhës standarde kroate. Nxjerrja në pah e natyrës së veçantë të gjuhës kroate, në raport me atë serbe, ishte një ndër kërkesat e shumta për ndryshimin e pozicionit të Republikës së Kroacisë në Federatën e Jugosllavisë.

PËRFUNDIME

1. Serbët, kroatët dhe malazezët flasin një gjuhë standarde që përdoret në dy qendra kryesore urbane, përkatësisht në Beograd dhe Zagreb, në dialektet yekavian dhe ekavian.

2. Në përdorimin zyrtar të emërtimit të gjuhës, duhen cilësuar të dyja gjuhët përbërëse.

3. Si shkrimet me alfabet latin, ashtu edhe shkrimet me alfabet cirilik kanë të njëjtën rëndësi. Prandaj, duhet të sigurohemi që në shkollë të mësohen të dyja gjuhët, ajo serbe dhe kroate.

4. Të dyja dialektet janë të barabarta në të gjitha drejtimet. [...]

7. Gjuha e përbashkët duhet të shqiptohet saktë. Tashmë, drejtshkrimi është kërkesa më e rëndësishme kulturore dhe shoqërore. Me pëlqimin e të gjitha palëve, do të hartohet një udhëzues drejtshkrimor nga një komision i përbërë nga specialistë serbë e kroatë.

9. Komisioni për drejtshkrimin dhe terminologjinë do të emërohet nga tre universitete: (Beogradit, Zagrebit dhe Sarajevës); dy akademi shkencash: (në Zagreb dhe Beograd); Shoqëria Kulturore Serbe në Novi Sad dhe Shoqëria Kulturore Kroate në Zagreb. Për legjitimimin dhe standardizimin e terminologjisë, duhet bashkëpunuar me administratat federale, si dhe me institucionet profesionale dhe shoqëritë përkatëse.

Në Novi Sad, 10 dhjetor 1954

Drejtshkrimi i gjuhës standarde serbo-kroate në fjalor drejtshkrimor, 1960, fq. 9-10.

IV-30. Deklarata për emërtimin dhe pozitën e gjuhës standarde kroate (1967)

Institucionet dhe organizatat e nënshkruara kulturore dhe shkencore kroate mendojnë se është e domosdoshme:

1. Vendosja në mënyrë të qartë dhe të padiskutueshme e të katër gjuhëve standarde, përkatësisht gjuhës: sllovene, kroate, serbe dhe maqedonase në raporte barazie nëpërmjet një rregulloreje kushtetuese. Për këtë arsye, Neni 131 i Kushtetutës së Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, duhet të jetë si më poshtë: "Ligjet federale, por edhe legjislacione të tjera të miratuara nga organet federale, publikohen në po të njëjtin tekst në gjuhën: serbe, kroate, sllovene dhe maqedonase, pra në të katër gjuhët standarde të popullit jugosllav". Pavarësisht se kishin të njëjtën rëndësi në lidhje me gjuhët e popujve të tjerë jugosllavë, paqartësia e dispozitës kushtetuese për gjuhën serbo-kroate ose kroato-serbe sillte vendosjen e të dyja gjuhëve në raporte sinonimie dhe jo barazie. Në praktikë, kjo paqartësi e ktheu gjuhën serbe në gjuhën që flitej si nga serbët,

ashtu dhe kroatët. Institucionet dhe organizatat e nënshkruara, mendojnë se këto rrethana shërbejnë si tregues që populli kroat as nuk përfaqësohet dhe as nuk ka pozitë të barabartë. Kjo praktikë nuk mund të përligjet nga fakti i padiskutueshëm shkencor se gjuhët standarde serbe dhe kroate kanë një bazë të përbashkët gjuhësore.

2. Përdorimi i vazhdueshëm i gjuhës kroate në shkolla, shtyp dhe në sferën publike (politikë, radio dhe televizion) në vijim të kërkesave dhe shpjegimeve.

Telegram, 17.3.1967.

Cilat ishin kërkesat kryesore të Deklaratës për emërtimin dhe pozitën e gjuhës standarde kroate (1967)? Ku ndryshojnë nga Marrëveshja e Novi Sadit? Si lidhet gjuha me identitetin kombëtar? A mund të flasin popuj të ndryshëm të njëjtën gjuhë? A dini ndonjë shembull të tillë? Diskutoni rreth elementeve të tjerë të rëndësishëm shtetformues.

IV-31. Rezoluta e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (Tiranë 1972)

[...] III. Duke e vlerësuar gjuhën letrare të njësuar si një nga arritjet më të mëdha të shoqërisë sonë socialiste në lëmin kulturor, si kurorëzimin e përpjekjeve të pareshtura të shumë brezave që, edhe në ditët më të errëta, e ëndërruan këtë ditë dhe punuan me vetëmohim për ta bërë sa më të afërt, Kongresi i bën thirrje të gjithë popullit shqiptar që ta përdorë gjuhën letrare të njësuar si një mjet të fuqishëm të përparimit shoqëror dhe ta shohë kujdesin për zhvillimin e lulëzimin e saj të pandalshëm si detyrë të vazhdueshme.

1. Në mënyrë të veçantë, Kongresi u bën thirrje:

a) Shkollës shqiptare, si vatra themelore e formimit gjuhësor të brezave të rinj, që i edukon ata me dashuri për gjuhën amtare dhe u zbulon thesarin e pashtershëm të saj, ta vlerësojë përvetësimin e normave të njësuara të gjuhës letrare e të drejtshkrimit të miratuar nga Kongresi si detyrë themelore dhe të zbatojnë plotësisht rregullat e reja të drejtshkrimit, duke filluar nga viti 1973-1974.

b) Institucioneve të teksteve shkollore, që të përgatisin dhe të botojnë tekste ndihmëse dhe mjete të tjera të nevojshme për përvetësimin dhe zotërimin praktik të normave të gjuhës letrare dhe drejtshkrimit të saj.

c) Shkrimtarëve shqiptarë, të cilët luajnë një rol të dorës së parë në kristalizimin dhe ngulitjen e normës letrare kombëtare, të punojnë me këmbëngulje për zbatimin e përhapjen e normës drejtshkrimore të njësuar.

ç) Institucioneve botuese, që t'i zbatojnë me përpikëri rregullat e drejtshkrimit dhe të ndihmojë gjallërisht për përhapjen e normave letrare dhe për ngritjen e kulturës gjuhësore të popullit.

d) Institucioneve shtetërore, organizatave shoqërore, institucioneve të shkencës e kulturës, që të marrin masa për të zbatuar në gjuhën e shkruar rregullat e drejtshkrimit.

dh) Radio-televizionit, teatrit, kinematografisë që të zbatojnë rregullat e drejtshkrimit dhe rregullat e drejtshqiptimit për të ndihmuar në përhapjen dhe ngulitjen e normave të trajtës së folur të gjuhës letrare.

e) Institucioneve shkencore-arsimore që merren me studimin e gjuhës shqipe, që t'u kushtojnë vëmendje të vazhdueshme problemeve të drejtshkrimit dhe të ndërmarrin studime të mëtejshme në këtë fushë.

2. Kongresi porosit që, duke marrë parasysh ndryshimet që pëson gjuha letrare gjatë zhvillimit të saj si edhe çështjet e reja që nxjerr praktika gjuhësore, "Rregullave të drejtshkrimit" t'u bëhen në të ardhmen, kur të jetë e nevojshme, përmirësimet dhe plotësimet e duhura.

Kongresi shpreh besimin e tij të plotë se kjo thirrje do të përkrahet me entuziazëm dhe do të frymëzojë arsimtarët, shkrimtarët, punonjësit e shkencës dhe të kulturës, gjithë inteligjencien dhe të gjitha masat punëtore, që me veprimtarinë e tyre krijuese, ta pasurojnë dhe ta ngrenë gjithmonë më lart gjuhën tonë letrare kombëtare.

www.shqiptarja.com, vizituar më 21.10.2015.

IV-32. Ministri i Arsimit Kombëtar Giorgios Ralis, për futjen e demotikisë (gjuhës bisedore) në arsimin 8-vjeçar dhe të mesëm (Parlamenti grek, 7 prill 1976)

Greqia, rreth fundit të shekullit të XIX, u trazua nga i ashtuquajturi "problemi i gjuhës". Pati një mosmarrëveshje ndërmjet përkrahësve të gjuhës bisedore (demotikisë) dhe përkrahësve të katharevousa-s, gjuhës së pastër artificiale që imitonte greqishten e vjetër. Zgjedhja e një gjuhe →

zyrtare dhe letrare ishte çështje politike, shoqërore dhe ideologjike, që lidhej drejtpërdrejtë me mënyrën e përkufizimit të identitetit kombëtar grek. Nga fillimi i shekullit të XX e në vijim , u ndërmorën një sërë reformash arsimore të pasuksesshme. Qeveria centriste e Giorgis Papandreut, në vitin 1964, ndërmori reformën më të rëndësishme të kohës së pasluftës. Megjithatë, ajo u anulua nga regjimi i kolonelëve, dhe demotikia greke arriti të shpallej si gjuhë zyrtare në arsimin 8-vjeçar, të mesëm dhe arsimin e lartë vetëm në vitin 1976.

Projektligji synonte të caktonte një gjuhë. Sot nuk ka asnjë të tillë. Si burime të vetme shërbejnë dokumentet e përpiluara nga funksionarët publikë nën moshën tridhjetë e pesë vjeç, ose nga të sapodiplomuarit e shkollës së mesme. Situata lë shumë për të dëshiruar nga ana e gabimeve drejtshkrimore dhe sintaksore, pasi mësimi në shkollën 8-vjeçare zhvillohej në gjuhën demotiki, ndërsa në shkollën e mesme në gjuhën katharevousa, dhe nxënësit nuk e përvetësonin mirë as njërën e as tjetrën. Edhe ata që e mbaruan shkollën gjatë kohës kur "mbretëronte" katharevousa, nuk mund ta flasin mirë atë. Kur nuk arrijmë ta flasim mirë as ne, përfytyroni pak se ç'po heqin fëmijët tanë dhe sa e rëndësishme është kjo për mënyrën e tyre të të menduarit. A mundet dikush të arsyetojë, kur nuk arrin të shprehet saktë? Kështu, me futjen e demotikisë ne po synojmë të caktojmë një gjuhë të përbashkët, pa zgjatime apo idioma.

Punimet parlamentare , 1976, vëll. 7, fq. 4118-4119..

Gjuha është tejet e rëndësishme për zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare. Luftërat për hir të gjuhës kanë shkaktuar trazira në shoqëri, edhe për një shekull të tërë (si në rastin e Greqisë), ose përplasje etnike. Pse mendoni se gjuha është kaq e rëndësishme për vetëpërkufizimin e një qytetari? Rishikoni teoritë për vetëvendosjen, apo ndërgjegjen kombëtare sipas kritereve të gjuhës, fesë dhe traditës (qasja gjermane/Romantizmi), apo vullnetit dhe zgjedhjes së lirë, qasjeve dhe ndjenjave të përbashkëta (qasja franceze/ Iluminizmi). Më pas diskutojeni çështjen e politikave të gjuhës duke pasur parasysh vendin tuaj.

IV.6. ARTI

IV-33. Dekreti i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bullgarisë "Për t'i dhënë hov arkitekturës dhe sintezës artistike të artit në ndërtimin e fasadës arkitekturore artistike të qyteteve dhe mjedisit" (28 qershor 1977)

Në këtë mënyrë, Byroja Politike VENDOSI:
1. Arkitektura socialiste bullgare të vazhdojë të marrë pjesë në krijimin e një mjedisi kompleks jetësor, që do të kënaqë nevojat materiale dhe shpirtërore të shoqërisë së formuar socialiste, dhe në formimin e një personaliteti harmonik socialist në tërësi. [...] Njëkohësisht, arkitektura duhet të mishërojë shpirtin e pasur të popullit tonë, dhe dashurinë shumëshekullore të bullgarëve për të bukurën. Kjo duhet t'i shërbejë sa më shumë të jetë e mundur edukimit estetik të popullit dhe të rinjve. Tiparet kryesore të arkitekturës duhet të jenë: karakteri tejet popullor që pasqyron dashurinë e Partisë për popullin, lumturinë dhe mirëqenien e tij, maturia e përdorimit të fondeve të popullit dhe burimeve të vendit, udhëheqja drejt metodave më të përparuara industriale për përshpejtimin e kryerjes së punëve ndërtimore sipas tipizimit dhe unifikimit, si dhe bukuria e përsosmëria e paraqitjes arkitekturore të ndërtesave dhe kompleksëve. Arkitektura jonë duhet të dallohet për përsosmërinë e saj estetike dhe konceptuale dhe pastërtinë stilistike të koncepteve arkitekturore. Arkitektura duhet të pasqyrojë siç duhet proceset dhe dukuritë shoqërore në strukturën funksionale të ndërtesave dhe kompleksëve. Në bazë të arritjeve të larta krijuese, kushteve dhe mundësive komplekse për të lulëzuar sërish, arkitekturës sonë i është caktuar detyra historike e krijimit të një arkitekture klasike socialiste.

Arkivat e shtetit f. 1B, inv. 55, a.u. 494.

IV-34. Kultura e përkujtimit të Luftës së Dytë Botërore në Jugosllavi

A. Përmendore e Luftës së Dytë Botërore, realizuar nga Zelimir Janesh në Novi Vinodolski, 1951 – vepër e realizmit socialist

Dëshmorëve të rënë në luftën për çlirimin e vendit gjatë viteve 1941-1945 (fotograf: Mihal Klajban). https://commons.wikimedia.org/wiki/File:Novi_vinodolski_(center),_Croatia_(1).JPG, vizituar më 29.08.2016.

Zelimir Janeshi (1916-1996), krijoi vepra të artit abstrakt nën ndikimin e Kostandin Brinkushit, por njëkohësisht krijoi edhe përmendore në stilin socialist realist, sipas porosive zyrtare.

B. Përmendore e partizanëve, vepër e realizuar nga Vojin Bakiçi për Petrova Gorën (Kroaci)-vepër e artit abstrakt

Arkivat e Këshillit Kombëtar Serb (pa numër).

Të dyja përmendoret, që përkujtojnë epopenë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, shërbejnë si dëshmi e ndryshimit që pësoi arti që aplikohej në kulturën e përkujtimit të kohës së komunizmit. E para (1951) është krijim tipik i kohës së pasluftës, pasi forma është simbolike dhe tejet realiste. Zakonisht, përmendore të tilla porositeshin nga nga → populllsitë lokale, për të përkujtuar heronjtë dhe të rënët vendas të luftës dhe pasqyronin shijen artistike të këtyre populllsive. E dyta u përket përmendoreve abstrakte me rëndësi të madhe të sponsorizuara nga shteti, që u kthyen në tipar artistik pas vitit 1960. Artistët e shquar (si Vojin Bakiçi, një ndër skulptorët më të mirë kroatë me origjinë serbe) krijonin vepra të ndryshme me porosi të zyrtarëve të shtetit. Megjithëse Titoja shprehu hapur mospëlqimin e tij për veprat e artit abstrakt, përmendore të tilla sponsorizoheshin nga shteti në të gjithë Jugosllavinë.

IV-35. Arti abstrakt

A. "Gjarpërimi" nga Zhylije Naiferi



Koleksioni vetjak i Marinko Sudaçit.

Zhylije Naiferi (Zagreb, 1924 - Paris, 2004) është një ndër artistët kroatë më të shquar të shekullit të XX dhe një ndër përfaqësuesite lëvizjes artistike "Prirjet e reja" të fillimit të viteve 1960. Arti i tij përjashton simbolikën dhe abstrakten, duke u përqendruar më tepër te krijimi sesa tek objekti. Ai u bë i njohur për gjarpërimin e tij të krijuar në teknika të ndryshme (piktura, vizatime, grafika murale, kolazhe). Edhe Muzeu i Artit Bashkëkohor të Zagrebit u ndërtua në formën e gjarpërimit. Gjarpërimet e tij janë bërë pjesë e ekspozitave në shumë muze dhe galeri të Evropës, kryesisht në Gjermani dhe Francë.

B. Ekstrakte nga manifestimi i grupit Exat-51 (Zagreb 1951)

Grupi Exat-51 mendon se i ashtuquajturi arti abstrakt nuk është shprehje e aspiratës dekadente. Përkundrazi, e sheh atë si një mundësi për të studiuar metodat dhe parimet për zhvillimin dhe pasurimin e komunikimit pamor. Në lidhje me mënyrën tonë të të kuptuarit të realitetit në kuadrin e luftës për përparim në të gjitha drejtimet e veprimtarisë njerëzore, grupi e sheh të nevojshme të luftojë kundër pikëpamjeve dhe krijimeve të vjetruara në rrafshin e artit pamor. Si detyrë kryesore sheh orientimin drejt sintezës së artit pamor, dhe, së dyti, duke i dhënë një karakter eksperimental veprave artistike- duke qenë se nuk mund të ketë përparim të qasjes krijuese pa eksperimentim- grupi e konsideron themelimin e tij dhe veprimtaritë që ai zhvillon si një rezultat konkret pozitiv në zhvillimin e debatit të mendimeve, pa të cilin nuk mund të ketë zhvillim të artit.

B. Bernardi, arkitekt; Z. Bregovaçi, arkitekt; I. Picelji, piktor; Z. Radiçi, arkitekt; B. Rashica, arkitekt; V. Rihteri, arkitekt; A. Srneci, piktor; V. Zaharoviç, arkitekt.

Denegri, 2000, fq. 69.

Pas braktisjes së modelit sovjetik "në ndërtimin" e shoqërisë (1948), Jugoslavia filloi të bënte ndryshime politike, ekonomike dhe shoqërore. Ndryshimi kryesor në kulturë ishte refuzimi i realizmit socialist si një lloj veprimtarie e urdhëruar. Artistëve në Jugosllavi iu dha më shumë liri për të krijuar dhe për t'u shprehur, se sa në vendet e tjera komuniste. Ky ndryshim solli arritjen e disa sukseseve në shkallë ndërkombëtare në arkitekturë, artet e bukura, skulpturë, filma vizatimorë, etj.

IV-36. Vala e Re në muzikë

"Vala e re" është një zhanër muzikor i kulturës popullore që lindi në Jugosllavi nën ndikimin e pankut (punk) dhe valës së re, që kishin fituar shumë popullaritet në Britaninë e Madhe dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në fundin e viteve 1970. "Vala e re" jugosllave nuk ishte thjesht një kopje e modelit Perëndimor, por një dukuri brezash që arriti të krijonte një shprehje të veçantë muzikore. Grupet më të shquara muzikore ishin Prljavo kazalište; Haustor; Azra; Film; Pankrt;, Lačni Franc; Lajbah; Pekinška patka; Šarlo akrobata; Električni orgazam; Idoli;, Luna; La Strada; Paraf; Laki pingvini dhe Boa. Para të hidheshin në treg albumet e tyre të para, grupet: Šarlo Akrobata; Električni orgazam dhe Idoli regjistruan një album të përbashkët muzikor, të quajtur "Paket aranžman". Në shkurt të vitit 1982, u krijua grupi muzikor kult Katarina II (që më vonë u quajt Ekaterina Velika). Mundësia që ofroi "Vala e re" mund të shihet në format e thjeshta muzikore, paraqitjen pamore (kopertinat e albumeve dhe afishet) dhe në tekste, që zakonisht kritikonin rendin e vendosur. Pavarësisht karakterit kritik, "Vala e re" jugosllave nuk pati probleme madhore me institucionet komuniste. Ajo u mbështet nga revistat: "Polet" nga Zagrebi dhe "Džuboks" nga Beogradi, si dhe nga programi televiziv muzikor "Rokenroler". Në mesin e viteve 1980, vrulli i "Valës së re" ra, por kjo kohë njihet si "koha e artë" e muzikës pop dhe rrok (rock) në shtetet që u krijuan pas shpërbërjes së Jugosllavisë. Rëndësia e "Valës së re" jugosllave u vlerësua edhe në median Perëndimore Melody Maker, NME Koekrand, që shquhej për cilësi dhe origjinalitet.

→

Polonia në zemrën time

Në Gdansk 1980 kur vjeshta tha jo Në Gdansk 1980 të gjithë ne kryqëzuam gishtat/minatorë Studentë, marinarë të gjithë Gdansk 1980 fabrika të trazuara/Mos i dërgoni dy herë tanket kundër punëtorëve Ata nuk guxonin/ ne fituam/ Të gjithë ne Polonia në zemrën time/ mazurka në zemrën time Polonia nuk ka pasur kurrë/nuk ka pasur kurrë tradhëtor/Çdo ditë Poloneza/ po troket në derën time/qelibarët polakë/byzylykë Orët e Volodias/sundojnë me gjysmë çmimi/Papa Gjon Pali Dhe unë/ Gdansk 1980/ Radha për gazeta/sindikata të pavarura/komitetet e mbrojtjes Gdansk 1980/Fabrika të trazuara/Mos i dërgoni dy herë tanket kundër punëtorëve/ Tanket kundër punëtorëve/Tanket kundër nesh

Azra, Album Sunčana strana ulice [Diellishta e rrugës], 1981.

Kënga, që u hodh në treg në vitin 1981, bën fjalë për grevën e organizuar nga sindikata e parë e pavarur polake "Solidariteti" në kantierin detar të Gdanskut, si dhe për ngjarjet e vitit 1970, kur u shtyp një grevë e ngjashme nga Ushtria e Popullit Polak dhe Milicia e Qytetarëve, ku u vranë të paktën 52 persona dhe u plagosën më se 1,000 të tjerë. Në kohën kur u kompozua kënga, shumë qytetarë polakë po udhëtonin në Jugosllavi duke shitur qelibar, pëlhura liri dhe mallra të tjera derë më derë (orët "Volodia" janë simbol i orëve të lira sovjetike). Papa Gjon Pali i II, që u zgjodh papë në vitin 1978, ishte simbol i rezistencës ndaj komunizmit.

IV-37. Sllovenia Tjetër, 1987 Afishe e Ditës së Rinisë

Autorë: Roman Uranjek, A.D. Knez, Darko Pokorn dhe Miran Mohar, Arti i ri Sllovenë.

Dita e Rinisë ishte një festë që iu kushtohej të rinjve të Jugosllavisë dhe përkonte me kremtimin e ditëlindjes së Josif Broz Titos më 25 maj. Në këtë ditë, organizoheshin veprimtari të ndryshme sportive nëpër shkolla, por veprimtaria më e spikatur mbetej Stafeta e të rinjve, ose Stafeta e Titos. Shkopi i stafetës mbahej përgjatë të gjitha republikave jugosllave nga të rinj e të reja, dhe në ndalesën e fundit në Beograd, mbajtësi i fundit ia dorëzonte atë Titos, duke e uruar për ditëlindjen e tij. Në mesin e viteve 1980, me lindjen e lëvizjeve socialiste dhe kërkesave për demokratizim, filloi të shfaqej ideja e anulimit të Stafetës së të rinjve, gjë që u përkrah edhe nga Shoqata e të Rinjve Socialistë të Sllovenisë. Në shenjë proteste, u organizua manifestimi i quajtur "Stafeta absurde", ku në qendër të Lubjanës, u vendos një trung, të cilit iu dha me sharrë elektrike me zinxhir, forma e një shkopi stafete. Afishja për Ditën e Rinisë së vitit 1987 u krijua nga studioja "Kolektivi i ri)", pjesë e ekipit "Arti i ri Sllovenë" →

"Kolektivi i ri" krijoi në mënyrë simbolike një afishe naziste, duke shtuar në të simbole të komunizmit. Afishja shkaktoi të ashtuquajturën "Meselenë e afishes". Më në fund, Shoqata e të Rinjve Socialistë, nën trysninë e udhëheqjes së Partisë Komuniste, e ndryshuan afishen.
Stafeta e fundit e të Rinjve u zhvillua në vitin 1987, ndërsa ceremonia e Ditës së Rinisë një vit më vonë.

IV-38. Festivali i xhazit në Bled, 1960

Kronika sllovene e shekullit të XX (1941-1995) "Revista e re", Lubjanë, 1997, fq. 263.

Ndryshe nga ndikimet e tjera Perëndimore (kapitaliste) që nuk ishin pranuar nga qeveria socialiste, xhazi nuk u ndalua kurrë në Jugosllavi. E gjitha kjo është meritë e kompozitorit dhe kreut të Orkestrës së Kërcimit të RTV Sllovenë, Bojan Adamiç, që kishte ngritur grupe kulturore artistike partizane gjatë luftës dhe kishte kompozuar shumë marshe partizanësh në stilin xhaz. Ideja e organizimit të një festivali xhaz jugosllav lindi në një festival muzikor në Opatija (Kroaci) në vitin 1959. Ai u organizua një vit më pas në qytetin turistik të Bledit në Sllovenë. Në vitin 1967, festivali u zhvendos në Lubjanë, duke u kthyer në një festival ndërkombëtar, mikpritës për përfaqësuesit më të shquar të muzikës xhaz.

KAPITULLI V: EKONOMIA

Hyrje	161
V.1. Reforma agrare	164
V.2. Industrializimi	168
V.3. Urbanizimi	176
V.4. Infrastruktura	186
V.5. Financa	189

HYRJE

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, vendet e Ballkanit u përballën me probleme të mëdha ekonomike, zgjidhja e ngutshme e të cilave lidhej ngushtësisht me ideologji të fuqishme politike dhe interesa gjeostrategjikë. Pasojat shkatërruese të luftës ishin të shumta dhe të ndryshme: industria e varfëruar e prodhimit;infrastruktura e dëmtuar rëndë; pakësimet në ushqim dhe lëndë të para; normat e larta të inflacionit; rënia e prodhimit bujqësor, dhe ndër të tjera edhe lulëzimi i praktikave të tregut të zi. Në të njëjtën kohë, fillimi i një lufte të re ideologjike, që ishte Lufta e Ftohtë, e ndau Evropën në blloqe politike dhe ekonomike. Në qershorin e vitit 1947, SHBA-ja propozoi planin Marshall (i quajtur kështu prej Sekretarit të Shtetit në detyrë, Xhorxh Marshall) për Evropën, i cili ofronte 13 miliardë dollarë për të ndihmuar në rimëkëmbjen e Evropës gjatë një periudhe katërvjeçare (duke nisur nga viti 1948). Bashkimi Sovjetik dhe satelitët e tij, u ftuan të bëheshin pjesë e këtij plani, por Stalini e pa atë si kërcënim ndaj ndikimit sovjetik dhe nuk pranoi. Shqipëria, Bullgaria, Rumania, dhe Jugosllavia (së bashku me Poloninë, Hungarinë, Çekosllovakinë, dhe Finlandën) vepruan njësoj. Për këtë arsye, këto vende e humbën mundësinë për të përfituar nga ndihma e SHBA-së, që e ndihmoi Evropën Perëndimore dhe Greqinë në rimëkëmbjen e shpejtë të ekonomisë, normalizimin e jetës ekonomike dhe përmirësimin e standardeve të jetesës brenda një dhjetëvjeçari. Antagonizmi politik i kapitalizmit kundrejt komunizmit/socializmit u përhap menjëherë në sferën ekonomike. Përveç Greqisë dhe Turqisë, Jugosllavia ishte i vetmi vend ballkanik me regjim komunist që përfitoi ndihmë në kuadrin e planit Marshall pas ndarjes së saj nga Bashkimi Sovjetik.

Pas periudhës shkatërrimtare të Pushtimit (1941-1944) dhe Luftës Civile (1946-1949) Greqia u rimëkëmb ndjeshëm. Në fundin e viteve 1940 dhe fillimin e viteve 1950, ndihma e SHBA-së kontribuoi në ruajtjen e qëndrueshmërisë së ekonomisë greke. Shkurtimi i ndihmës amerikane e detyroi Greqinë t'ia dilte mbanë vetë. Dhrahmia,monedha kombëtare, u stabilizua;normat e larta të inflacionit gjatë viteve 1940 u vunë nën kontroll;u zbatuan reforma të rëndësishme në fushën financiare dhe bankare;u rivendos kontrolli mbi financat e qeverisë, dhe vendi në vitin 1952 iu bashkua paktit të NATO-s. Me zhvlerësimin dhe liberalizimin e ekonomisë në vitin 1953, ajo u zhvillua dhe shkalla e rritjes mbeti e lartë për 20 vitet e ardhshme. Shkalla e lartë e rritjes u ndërthur me inflacionin e ulët, buxhetet pothuajse të ekuilibruara të qeverisë dhe deficitet e jashtme të menaxhueshme. Gjatë kësaj periudhe Greqia ndërmori projekte të rëndësishme në infrastrukturë, tërhoqi investime të huaja të mëdha,pati sukses në zhvillimin e sektorëve kyç industrialë, rriti në mënyrë të habitshme kapacitetin e furnizimit me energji elektrike dhe përmirësoi ndjeshëm infrastrukturën e transportit dhe komunikimit. Përfundimi ishte rritja reale e të ardhurave kombëtare për frymë. Së fundi, në vitin 1961 vendi u bë vend anëtar i Bashkësisë Ekonomike Evropiane (BEE), që është një nga organizatat kyçe të ekonomisë kapitaliste, bashkë me Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (pasuesja e Organizatës për Bashkëpunimin Ekonomik Evropian, fillimisht e themeluar për të administruar ndihmën e planit Marshall në Evropë) dhe Shoqatën Evropiane të Tregtisë së Lirë. Krahas këtyre arritjeve në ekonomi, gjatë periudhës së diktaturës së Kolonelëve, turizmi dhe bujqësia u zhvilluan shumë, falë mbështetjes së SHBA-së dhe ndërhyrjeve të shtetit.

Megjithëse Turqia e pranoi planin Marshall pak kohë pas Greqisë, ajo po ndiqte të njëjtin model të zhvillimit ekonomik kur u bë pjesë e NATO-s në vitin 1952. Shteti nxiti shtimin e kapitalit privat në industri dhe kërkoi të zgjidhte problemin që kishte pasur prej një kohe të gjatë me bujqësinë. Ai gjithashtu lehtësoi procesin e privatizimit, i cili zgjati tridhjetë vjet. Megjithatë, reformat e vërteta ekonomike dhe rritja e shpejtë erdhën vetëm pas vitit 1980. Edhe në Turqi u zbatuan përparësitë e shtetit dhe u përdor ndihma e jashtme financiare, si nga diktatura ushtarake e Gjeneralit Kenan Evren në vitet 1980-1983,ashtu edhe nga qeveritë pasuese pas rivendosjes së demokracisë parlamentare. Kishte një prirje drejt rritjes industriale, mbështetjes së tregtisë së vrullshme, organizimit të suksesshëm të turizmit, dhe zhvillimeve të tjera pozitive. Zgjedhjet parlamentare në vitet 1983 dhe 1987 i fitoi Partia e Mëmëdheut (ANAP) e Turgut Ozalit, i cili zbatoi politika për privatizim të shpejtë dhe qëndrueshmëri financiare. Në vitet 1980, Greqia dhe Turqia kishin modernizuar dukshëm ekonomitë e tyre në krahasim me vitet 1940 dhe 1950, dhe ia kishin dalë mbanë të përfitonin nga aspektet përparimtare të modelit perëndimor për mirëqenien e shtetit.

Ekonomia e tregut kishte kundërshtaren e saj që ishte ekonomia e planifikuar, ku shkëmbimi i mallrave mbështetej te prodhimi i planifikuar dhe i kontrolluar i ndërmarrjeve shtetërore. Në të njëjtën mënyrë, plani Marshall, NATO-ja, dhe organizatat ekonomike ndërkombëtare evropiane të lidhura me to, kishin një alternativë në Këshillin e Ndihmës Ekonomike Reciproke (COMECON) dhe Paktin e Varshavës. Në vitin 1949, Bashkimi Sovjetik krijoi COMECON-in si organ bashkërendues të ekonomisë dhe planeve ekonomike të shteteve në Bllokun Lindor. Në vitin 1950, ai përbëhej nga Bashkimi Sovjetik, Bullgaria, Rumania, Polonia, Çekosllovakia, Hungaria, Republika Demokratike e Gjermanisë (RDGJ), dhe Shqipëria. Më vonë Shqipëria u largua, Jugosllavia mori statusin e vëzhguesit, dhe disa vende në zhvillim si Mongolia, Kuba, dhe Vietnami iu bashkuan COMECON-it. Në fillim, parimi më i rëndësishëm i COMECON-it ishte ndarja thuajse falas e arritjeve shkencore dhe teknologjike me vendet anëtare. Në tërësi, integrimi ekonomik (që synonte sheshimin e "dallimeve në mallrat dhe shërbimet e pakta midis shteteve, nëpërmjet eliminimit të paramenduar të pengesave të tregtisë dhe mënyrave të tjera të ndërveprimit") u kthye ngadalë në parimin kryesor të veprimtarive të COMECON-it. Perestrojka (Ristrukturimi) dhe përmbyllja e marrëveshjes së bashkëpunimit me BEE-në, në vitin 1988, praktikisht solli fillimin e fundit të COMECON-it.

Teksa zhvillimi ekonomik i vendeve ballkanike me drejtim perëndimor, mbështetej në modelin e "ndihmës financiare nga SHBA-ja, mbështetjes shtetërore për industri të caktuara, dhe nxitjes së ndërmarrjeve private," modeli socialist mbështetej në shndërrimin rrënjësor të strukturave ekonomike nëpërmjet kolektivizimit, shtetëzimit, dhe industrializimit të detyruar. Në të vërtetë, modeli që u krijua në vendet e Bllokut Lindor, karakterizohej nga pronësia absolute e shtetit dhe kontrolli i industrisë së rëndë,si dhe degëve të tjera kyçe të ekonomisë, me anë të vetëmjaftueshmërisë së sistemit ekonomik në kuadrin e COMECON-it dhe rregullimit të planifikuar të të gjitha proceseve ekonomike (me nivele të ndryshme të kolektivizimit të bujqësisë dhe tolerancës ndaj ndërmarrjeve private në vende të ndryshme).

Heqja e pronës private, shtetëzimi i mjeteve të prodhimit dhe vendosja e një shpërndarjeje të re dhe "të drejtë" të mallrave, ishin veprimtari të domosdoshme që njëkohësisht do ta nxisnin dhe pengonin zhvillimin ekonomik të vendeve socialiste të Ballkanit. Kolektivizimi, sidomos në Bullgari dhe Rumani, shndërroi në mënyrë rrënjësore dhe të pakthyeshme botën e fshatit tradicional. Ai përfundoi, ose u shpall se përfundoi, midis fundit të viteve 1950 dhe mesit të viteve 1960. Kolektivizimi i tokës ndryshoi shpejt pjesën më të madhe të ekonomive bujqësore të këtyre vendeve, kundrejt shndërrimit shkallë-shkallë të Greqisë dhe Turqisë. Administrimi i tokës dhe organizimi i punës në kooperativa të mëdha bujqësore dhe futja e makinerive moderne rriti prodhimin bujqësor. Ky proces pati një efekt të menjëhershëm në shoqëri meqenëse krijoi vende të tepërta pune, dhe çoi drejt urbanizimit në shkallë të gjerë. Një pasojë psikologjike shoqërore ishte braktisja e mënyrës tradicionale të jetesës dhe përshtatja e tyre me mënyrën e jetesës urbane. Kolektivizimi dhe ndryshimet në ekonominë bujqësore shkatërruan mënyrën tradicionale dhe rurale të jetesës. Urbanizimi kishte edhe një efekt tjetër, i ashtuquajtur "rurbanizimi" i qyteteve në shoqëritë komuniste, ku zakonet rurale përcaktonin sjelljen dhe marrëdhëniet e përditshme të banorëve të rinj të qyteteve. Elektrifikimi, infrastruktura e re rrugore, dhe ndikimi i vazhdueshëm i medias ishin rrugët më të shkurtra drejt këtij versioni modernizimi. Ai gjithashtu përfshinte një përmirësim të përgjithshëm të mënyrës dhe cilësisë së jetesës duke futur kujdesin e përgjithshëm shëndetësor falas, dhe duke ofruar mundësi më të mira për emancipimin vetjak me anë të arsimit dhe formimit profesional në masë. Për një periudhë afatgjatë, ky proces çoi drejt shpopullimit të fshatit dhe në ditët e sotme drejt prirjes së zhdukjes së fshatrave si njësi shoqërore, ekonomike, dhe kulturore.

Shtetëzimi i ndërmarrjeve industriale dhe i bankave, ishte një aspekt tjetër i revolucionit socialist në fushën e ekonomisë. Domosdoshmëria ideologjike e industrializimit të përshpejtuar ishte një faktor nxitës i rëndësishëm në zhvillimin e ekonomive të vendeve komuniste. Ai kërkonte kthimin e industrisë së rëndë në degën kryesore të ekonomisë, si mënyrë për të siguruar pavarësinë ekonomike. Fuqizimi dhe rritja e nxjerrjes së mineraleve, metalurgjia, arritjet në industrinë energjetike dhe atë kimike, nuk ishin vetëm paraqitje simbolike e ecurisë komuniste, por edhe objektiva parësorë afatshkurtër për zhvillimin e ekonomisë. Parimeve klasike të marksizmit iu shtua ideja staliniste, që sistemi i centralizuar i ekonomisë duhet të mjaftonte për të përmbushur nevojat e tij dhe të shoqërisë. Kjo teori ishte e dyshimtë edhe për një vend të madh dhe të pasur me burime natyrore si Bashkimi Sovjetik. Për shkak të përparësisë kategorike të industrisë së rëndë (duke përfshirë teknologjitë ushtarake) dhe në mungesë të konkurrencës në treg, ekonomia duhej të kompensonte në mënyrë periodike mungesën dhe cilësinë e ulët të

mallrave të konsumit dhe ushqimeve.

Ekonomisti hungarez Janos Kornai e përkufizoi si ekonomi "mungesash", dhe në vitet 1980 mangësitë e këtij sistemi ishin të dukshme kundrejt mirëqenies dhe konsumit të Perëndimit. Pavarësisht retorikës për "mbrojtjen e pronave të socializmit", besimi i popullsisë dhe elitës udhëheqëse te përparësitë e këtij modeli ekonomik, u lëkund shumë asokohe.

Disa parime klasike marksiste kishin nisur të humbisnin fuqi gjatë fundit të viteve 1950, dhe kjo u vërtetua nga braktisja e kolektivizimit në Jugosllavi dhe Poloni, si dhe nga lejimi i krijimit të ndërmarrjeve private brenda normave të caktuara në Hungari. Në tërësi, që prej viteve 1960 u kryen disa përpjekje për reforma ekonomike ku përfshihej futja e një sistemi kontraktor midis ndërmarrjeve dhe kontabilitetit të kostos dhe vetëfinancimit në rang ndërmarrjeje, ndërkohë që pakësoheshin subvencionet shtetërore dhe promovohej vetadministrimi. Megjithatë, këto reforma nuk ndikuan në thelbin e sistemit. Gjithashtu, gjatë fundit të viteve 1980 dështuan edhe përpjekjet për të ngritur forma të ndërthurura të ekonomisë së tregut dhe ekonomisë së centralizuar. Pas vitit 1989 këto u panë si disa nga shkaqet e rënies së shteteve ku ishin instaluar regjimet socialiste.

I vetmi vend socialist që pati sukses në zhvillimin e një sistemi hibrid ekonomik në Ballkan, ishte Jugosllavia. Pas shkëputjes së Titos nga Stalini, kolektivizimi (i cili sapo kishte nisur) "u shty" dhe u krijua një sistem specifik pronësie i ndarë midis sektorëve "publikë" dhe "privatë" të fermave familjare. Në të njëjtën kohë, ekzistonin mundësi për nisma private në zejtari dhe tregti, dhe firmat private më në fund lejoheshin të kishin numër të kufizuar punonjësish. Në të njëjtën mënyrë, nga vitet 1950 dhe 1960, kërkohej dhe u mbajt një ekuilibër midis modeleve politike dhe ekonomike të Lindjes dhe Perëndimit. Në kuadrin e Lëvizjes së Shteteve të Paangazhuara, në vitet 1970 dhe 1980, u ndërmorën fushata për të ristrukturuar tregtinë dhe lidhje të tjera midis vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, nëpërmjet Kartës së të Drejtave Ekonomike dhe Detyrave të Shteteve, e miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1974. "Rruga e Tretë" e socializmit jugosllav karakterizohej nga vetadministrimi, siç pretendohej nga Titoja. Megjithatë, Jugosllavia dhe vende të tjera të Evropës Lindore hynë në një borxh të thellë, që thelloi "krizën e sistemit".

Njohja e pasojave që industrializimi në vendet e Perdes së Hekurt pati në mjedis, u bë publike saktësisht në vitet 1980, dhe kjo në njëfarë mënyre ishte shenjë e kësaj krize. Për shembull, qyteti bullgar i Ruses në Danub, u ekspozua për vite të tëra ndaj çlirimit të gazit të klorit nga një impiant kimik përtej lumit, në Xhorxho, Rumani. Banorët e këtij qyteti, dhe sidomos fëmijët, nisën të vuanin nga sëmundje të rënda të rrugëve të frymëmarrjes dhe kjo gjë shkaktoi një sërë protestash, që çuan në krijimin e një prej organizatave disidente në Bullgari. Sigurisht që alarmi më i madh në Evropë u shkaktua nga "aksidenti" në centralin e energjisë bërthamore të Çernobilit, në Bashkimin Sovjetik më 26 prill 1986, i cili u përkeqësua nga ndërprerja e plotë e informimit në vendet e Bllokut Lindor.

Si përfundim, pavarësisht suksesit të vërtetë të arritur në modernizimin e përgjithshëm ekonomik, zhvillimi specifik i ekonomive të vendeve socialiste të Ballkanit, dhe në rastin e Bullgarisë dhe Rumanisë, varësia e tyre nga hapësira ekonomike e Bllokut Sovjetik i bëri më të cenueshëm ndaj ndryshimeve rrënjësore të epokës pas vitit 1989.

V.1. REFORMAT BUJQËSORE

V-1. Grua mbi një traktor në rajonin e Krajovës, Rumani, 1952

La S.M.T. Grua mbi një traktor në Baileshti, në rajonin e Krajovës,(1952) Fotografi: #W079, Fotografi në internet e komunizmit rumun, vizituar më 13.02.2016. Numri i indeksit: 6/1952, Burimi: Muzeu Historik i Republikës Popullore të Rumanisë]

1. Si do ta përshkruanit këtë fotografi? Spontane, rastësore, e parapërgatitur, e vërtetë, apo e stisur? Arsyetoni përgjigjen tuaj.

2. Përdorni njohuritë tuaja për të shpjeguar arsyet pse është bërë një fotografi e tillë.

3. Krahasojeni me afishen e propagandës bullgare (dok. IV-1) në kapitullin IV dhe diskutoni lidhur me ngjashmëritë dhe/ose dallimet midis tyre.

V-2. Përmbledhje e raportit të Securitate për mendimin e përgjithshëm të banorëve të rajoneve të ndryshme të vendit, pas vendosjes së normave të reja për kontributin e detyrueshëm në prodhimin bujqësor, rreth vitit 1951

RAJONI I ARADIT
Dymbëdhjetë fshatarëve të mesëm nga komuna e Sinicolaul Micit nuk iu pëlqen fakti që pasi plotësuan normat e kërkuara, u kthyen në shtëpi nga zona e pastrimit pa asnjë kokërr gruri. Fshatarët e mesëm të komunave të Fantaneles, Vladimirescuit, Horias dhe Maskës janë të pakënaqur, sepse prodhimi i tyre nuk u pranua në zonën e pastrimit për arsyen se përmbante shumë papastërti.

RAJONI I ARGESHIT
Në komunën e Spinenit, për shkak të mungesës së depove të drithit, gruri ruhej në ambientet e shkollës së komunave të Vinetit dhe Spinenit. Meqenëse nuk kishte mjete të përshtatshme transporti, depot e sajuara u tejmbushën me drithë, dhe si pasojë ishte e nevojshme të shembej një nga muret e shkollës "Spineni".

RAJONI I BAIA MARES
Anëtarët e Kooperativave Bujqësore të komunave të Modoroshit, Rateshti, Ateas, Medieshul Aurit, Miculas, Halmeit, Ardudit dhe Daras nuk janë të kënaqur, sepse pasi plotësojnë normat, iu japin vetëm një kilogram grurë për ditë pune.

Berindei et al, 2009, vëllimi I, fq. 354-357.

V-3. Ekstrakt nga një Vendim i Këshillit të Ministrave për statusin e modelit të Kooperativave Bujqësore, Bukuresht, qershor 1953

Kooperativa Bujqësore është një fermë e madhe socialiste ku punëtorët fshatarë me dëshirën e tyre bashkojnë ngastrat e tokës dhe mjetet e tyre kryesore të prodhimit.

Arsyet e themelimit të kësaj (shoqate) dhe ideja e mjeteve të përbashkëta (pasuri e popullit) të prodhimit, e punës në kolektiv, dhe e prodhimit të përbashkët (që realizohet nga këto kooperativa).

Në Kooperativat Bujqësore, puna kryhet në bazë të një plani me anë të mjeteve mekanike dhe metodave të përparuara në fushën e bujqësisë në shkallë të gjerë.

Në Kooperativat Bujqësore, interesat vetjake të fshatarëve dhe interesat e përbashkëta të kolektivit janë ngushtësisht të lidhura mes tyre.

Fshatarët që punojnë mund të ndërtojnë një jetë të re, të begatë dhe të lumtur vetëm duke ndjekur metodën e kooperativave bujqësore, e cila është metoda e socializmit, metoda e vetme e drejtë për punëtorët fshatarë, e cila mbështetet në fshatarësinë kolkoziane të Bashkimit Sovjetik dhe fshatarësisë kolektiviste të vendit tonë [...].

Nëpërmjet punës së organizuar dhe mjeteve të përbashkëta të prodhimit ne mund të:

–krijojmë një Kooperativë Bujqësore;

–garantojmë fitoren përfundimtare kundër *chiaburive* (fshatarëve të pasur) dhe të gjithë shpërdoruesve dhe armiqve të sistemit;

–asgjësojmë veprimtarinë e fshehtë, si dhe fermat e vogla tradicionale individuale.

Sipërfaqja e bashkuar e tokave të kooperativave nuk mund të zvogëlohet kurrsesi, por vetëm të zmadhohet. […]

As *chiaburit*, as shpërdoruesit dhe as ata që i kanë humbur të drejtat e tyre qytetare, nuk mund të pranohen anëtarë në kooperativat bujqësore.

Çdo lloj keqpërdorimi i pasurive kolektive ose shtetërore, apo sabotimi i pronave kolektive dhe pajisjeve të SMT-ve (Stacionet e Makinave dhe Traktorëve) do të shihet si tradhti ndaj interesave të përbashkëta dhe si ndihmë ndaj armiqve të popullit. Fajtorët e dëmtimit të Kooperativave Bujqësore do të çohen në gjyq dhe do të dënohen sipas ligjit.

Roske et al, 2007, fq. 341-350.

Në thelb SMT-të ishin vende ku përqendroheshin makineritë bujqësore që ishin të organizuara si ndërmarrje shtetërore. Në të vërtetë, shumica e fshatarëve nuk iu bashkuan Kooperativave Bujqësore me dëshirë, meqenëse të ardhurat për çdo punonjës ishin të vogla. Pavarësisht propagandës, nuk kishte as mjete të mekanizuara dhe as specialistë apo dobi të dukshme nga pjesëmarrja në organizata të tilla, të cilat në fakt përdoreshin për të forcuar pushtetin e zyrtarëve të komunizmit në fshat.

1. Përdorni njohuritë dhe informacionin që keni nga burime të ndryshme dhe shpjegoni se çfarë ishin Kooperativat Bujqësore. Përshkruani Kooperativën Bujqësore ideale (burimi V-3). Përpiloni një listë arsyesh pro dhe kundër ngritjes së ekonomive të tilla dhe diskutojini ato me nxënësit. Cilat ishin arsyet ideologjike që fshiheshin pas krijimit të kooperativave të tilla?
2. Lexojini burimet me kujdes dhe përpiloni një listë me arsyet pse fshatarët ishin të pakënaqur. Çfarë problemesh hasnin fshatarët çdo ditë? Cilat mendoni se janë arsyet pse ata vëzhgoheshin nga Sigurimi? Krahasoni raportin e Sigurimit me fotografinë e një gruaje duke ngarë një traktor. A e plotësojnë apo bien ndesh me njëra-tjetrën?

V-4. Këngë e propagandës bullgare që lartëson mënyrën "e re" të jetesës socialiste

Mes pllajës së bukur,
që shtrihet në mes të logut.
Ngjajnë me cicërimat,
tingujt e kavallit të Dobrit.

Livadhi i gjerë,
si qilim i blertë,
tufën me 100 dele
sikur e thërret.

Shumë kujdesej Dobri,
për tufën e tij.
Emri iu bë i njohur,
në gjithë Bullgari.

Për punën e kujdesin,
që Dobri tregoi,
me urdhrin "Dimitrov",
Partia e nderoi.

Arkivi Qendror i Shtetit, f. 449, inv. 1, a. u. 102, л. 562.

Propaganda komuniste shpeshherë e përshkruante regjimin politik si të përkrahur në mënyrë të pakushtëzuar nga të gjitha shtresat shoqërore. Për ta arritur këtë synim,një pjesë e propagandës u përqendrua te krijimi i këngëve popullore, që lartësonin mënyrën "e re" të jetesës socialiste. Kënga e mësipërme, me titull "Kryebariu i brigadës", ishte një nga shembujt e shumtë të kësaj propagande.

Urdhri"Dimitrov" ishte urdhri më i lartë shtetëror në Bullgari që iu jepej individëve apo grupeve për arritje të mëdha në shkencë, art dhe kulturë gjatë viteve 1949 deri në vitin 1986. Ky çmim e mori emrin prej Gjergj Dimitrovit (1882-1949), figura më e shquar e komunistëve bullgarë dhe i njohur në arenën ndërkombëtare, udhëheqësi i Ndërkombëtares së Tretë dhe Partisë Komuniste të Bullgarisë, si dhe kryeministër i Republikës Popullore të Bullgarisë (1946-1949).

Përshkruajeni imazhin e idealizuar të jetës së barinjve në Bullgari.

V-5. Ekstrakt nga një intervistë me Zlatkon (lindur në vitin 1934), një mësues nga Shumeni, për Fermat shtetërore dhe Kombinatet agroindustriale

Kohët më të vështira erdhën pas përfundimit të kolektivizimit të bujqësisë. Disa u anëtarësuan në fermat shtetërore (TKZS). Ata që u anëtarësuan nuk kishin tokë, dhe fshatarët që kishin ngastra toke me përmasa deri në 0,5 - 0,6 hektarë u bashkuan në to në vitin 1946. Ata ndërtuan një furrë buke për fshatin. Kështu nisi jeta në kolektiv, por rroga ishte shumë e ulët. Disa vite më vonë, kur ishim më të rritur, nisëm të ndiqnim studimet nëpër qytete. Nuk kishim as para, dhe as gjë tjetër për të (për të paguar studimet). Sepse kur na morën tokën, na lanë vetëm disa krerë dele dhe dy ose tre pula.

Pyetje: Çfarë bënë prindërit e tu në fermat shtetërore?

Përgjigje: Shiko, në fillim nuk donin të bëheshin anëtarë të tyre dhe nuk u bënë. Por kur përfundoi kolektivizimi i të gjithë ekonomisë, nuk kishin zgjidhje tjetër. Vinin në mbrëmje te ne dhe na thoshin: "Kur do t'iu bashkoheni fermave shtetërore? Duhet të na bashkoheni." Dikur ne u lodhëm, pasi ata edhe na kërcënuan. [...] Por pastaj njerëzit nisën t'i pëlqenin këto ferma. Qumështi ishte i lirë, buka shitej te furra dhe mamaja nuk kishte më arsye të piqte bukën vetë, sepse mund të shkonim ta blinim. Njerëzit nisën ta pëlqenin këtë organizim. Deri në vitin 1960, fermat shtetërore nuk ishin aq keq. Ato po ecnin mirë në fillim

dhe kjo është arsyeja pse ne erdhëm këtu. Por më pas u themeluan kombinatet agroindustriale (KAI) dhe njerëzit nuk i quanin më tokën dhe pajisjet pronë të tyre. Punëtorët dhe gratë e këtyre ekonomive, shkuan në Sredna, Belokopitovo, Drumevo, dhe vende në mes të hiçit. Asgjë nuk e ndjenin si të tyren, shkonin në punë si mëditës dhe si të punësuar. Shkonin në orën dhjetë të mëngjesit dhe ktheheshin në katër të pasdites, dhe kalonin dy orë në mesditë duke ngrënë salsiçe, duke pirë verë, bozë, birrë, apo çfarë pije tjetër kishin. Kështu ishin gjërat.

Intervista u krye në vitin 2012 në kuadrin e projektit "Histori të rrëfyera për komunizmin në Bullgari (1944-1989)", nga Instituti i Studimeve të së Kaluarës së Afërt dhe Fondacioni Amerika për Bullgarinë.

Kolektivizimi i bujqësisë në Bullgari u krye nëpërmjet të ashtuquajturave "ferma shtetërore" (TKZS). Ky proces u zhvillua midis viteve 1944 dhe fundit të vitit 1950, dhe mund të ndahet në katër periudha. Periudha e parë zgjati nga viti 1944 deri në vitin 1948. Në prill të vitit 1945 u miratua një ligj për fermat shtetërore, dhe u ndërmor një fushatë e madhe propaganduese për ta promovuar si formën më përparimtare të kooperativave. Në mënyrë të tërthortë, fshatarët u detyruan që t'iu bashkoheshin kooperativave me anë të çmimeve të ulëta të prokurimit për produkte bujqësore, si dhe prodhimin e detyrueshëm dhe kuotat e planifikuara të shpërndarjes (të quajtura "planet e mbjelljes") për fermerët privatë. Në të njëjtën kohë filloi një fushatë diskriminuese me bazë klasore për veçimin dhe kufizimin e ndikimit të fermerëve sipërmarrës dhe të pasur , e frymëzuar nga e ashtuquajtura "lufta kundër kulakëve*" e ndërmarrë në Bashkimin Sovjetik. Me krijimin e Bashkimit Qendror të Fermave në vitin 1947, të gjitha fermat e pavarura deri në atë kohë u vunë nën kontrollin e shtetit. Fundi i periudhës së parë u shënua në shkurt të vitit 1948 nga miratimi i një ligji për blerjen e detyrueshme të mjeteve të prodhimit të fermave të mëdha nga pronarët privatë. Pronarët u kompensuan nga qeveria me letra me vlerë, të cilat me kalimin e kohës e humbën vlerën e tyre për shkak të inflacionit. Bashkimi i fermave ishte alternativa e vetme që kishte mbetur, pasi nuk kishte më toka dhe mjete prodhimi private, kishte shumë trysni politike, dhe kuota të larta të planifikuara të shpërndarjes për fermerët privatë. Periudha e dytë zgjati nga viti 1948 deri në vitin 1951. Kjo ishte periudha më e dhunshme e kolektivizimit të detyruar të fshatarëve bullgarë, e shoqëruar nga revolta masive të fshatarëve në provincat veriperëndimore të vendit. Duke marrë parasysh se prodhimi bujqësor ishte i ulët, regjimi u tërhoq nga këto synime me qëllimin për të zbutur tensionet sociale. Kjo shënoi fillimin e periudhës së tretë, e cila mund të përshkruhet si periudha e "ngadalësimit", dhe zgjati deri në mesin e viteve 1950. Periudha e fundit zgjati nga viti 1956 deri në Kongresin e Dytë të Partisë Komuniste të Bullgarisë në vitin 1958, që ishte kongresi i "socializmit fitimtar", ku u raportua se 95% e tokave në Bullgari ishin kolektivizuar. Gjatë kësaj periudhe, shumë fshatarë ishin larguar nga fermat, urbanizimi ishte në kulmin e tij, dhe ekzistonte pririja për të migruar në qyteza dhe qytete.

**kulak* – term sovjetik që përdorej në terminologjinë komuniste për të identifikuar një fshatar të pasur si armik të mundshëm të regjimit..

V-6. Të dhëna statistikore për arsimin, bibliotekat, grupet e valltarëve, qendrat kulturore, dhe kinematë në zonat rurale të Rumanisë

Arsimi: Gjatë vitit shkollor 1948-1949 në ciklin fillor (nga klasa e 1 deri në klasën e 4), u regjistruan 1,291,063 nxënës, në ciklin e mesëm të ulët (nga klasa e 5 deri në klasën e 7/8) u regjistruan 162,574 nxënës, dhe në ciklin e mesëm të lartë (nga klasa e 9 deri në klasën e 11/13) u regjistruan 353 nxënës. Gjatë vitit shkollor 1964-1965, në ciklin fillor u regjistruan1,116,280 nxënës. Po këtë vit në ciklin e mesëm të ulët u regjistruan1,005,760 nxënës, ndërkohë që 47,628 nxënës u regjistruan në ciklin e mesëm të lartë. Të dhënat statistikore të mësipërme pasqyrojnë numrin e nxënësve të regjistruar në shkolla dhe që i vijonin mësimet në sistemin e paradites si dhe të të nxënit në distancë.

Qendrat kulturore dhe "shtëpitë e leximit": Në vitin 1948 kishte 4,931 qendra të tilla, në vitin 1952 kishte 12,071, dhe në vitin 1964 kishte 11,945.

Bibliotekat: Në vitin 1955 kishte vetëm 612 biblioteka "komunale", ndërsa në vitin 1963 kishte 2,810 (me rreth15,363,810 artikuj). Të dhënat iu referohen qendrave rurale, që përbëheshin nga disa fshatra së bashku. Krahas kësaj, në fshat kishte 3,500 biblioteka me 4,500,000 artikuj.

Grupet e valltarëve: Në vitin 1964, në mbarë vendin kishte 9,500 grupe valltarësh, që në repertorin e tyre jo vetëm valle tradicionale që ishin pjesë e etnografisë së zonave nga ishin këto grupe, por edhe pjesë "të frymëzuara nga jeta e re e njerëzve", […] me tituj si:

→

"Punë, fruta, dhe gëzim", "Jemi shpërngulur në një shtëpi të re", "Dasmë në kooperativë", etj".

Kinematë: Në vitin 1963 kishte 4,509 "njësi kinemash" rurale, ndërsa në vitin 1964 kishte 5,209. Krahas kësaj, kishte 94 karvanë filmash që jepnin shfaqje në mbarë vendin.

Statistikat Vjetore të Rumanisë, 1965, fq. 456-457, 508; Moraru, 1964, fq. 330-331, 352, 363, 364.

Pasqyrojini këto të dhëna statistikore në një tabelë ose grafik. Krahasojini dhe përshkruani prirjet dhe proceset duke përdorur informacione nga burime të tjera, sidomos të dhëna statistikore lidhur me popullsinë urbane dhe rurale (K. V.3). A i mbështesin apo kundërshtojnë të dhënat e mëparshme?

Mësuesit do t'i ndajnë nxënësit në dy grupe. Të dyja grupet do ta përshkruajnë jetën e fshatarëve në Rumani dhe Bullgari. Njëri grup do të marrë të dy fotografitë në këtë pjesë, këngën popullore "Kryebariu i brigadës" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave të qershorit të vitit 1953. Grupi tjetër do të marrë raportin e Sigurimit, intervistën me mësuesin Zlatko dhe të dhëna të tjera statistikore për arsimin, bibliotekat, etj., në zonat rurale në Rumani. Pasi ta kenë përfunduar detyrën, nxënësit do të krahasojnë punën që kanë bërë. Ata do të diskutojnë nëse ka ndryshim ndërmjet përshkrimeve të tyre dhe do të arsyetojnë mbi to. Për shembull, ata mund të diskutojnë për problemet, të cilat hasen nga historianët, kur kanë vetëm materiale zyrtare dhe/ose propaganduese. Ata mund të përdorin intervistën me Zlatkon për të treguar përvojat e ndryshme dhe të ndërlikuara të njerëzve. Gjithashtu ata mund të reflektojnë mbi përvojat e ndryshme të rumunëve dhe bullgarëve në kooperativa. Ata mund të diskutojnë për mënyrën se si burimet e reja mund të shërbejnë për të ndryshuar interpretimet e mëparshme për të shkuarën. Duke përdorur prova nga burimet, ata gjithashtu mund të tregojnë arsyen pse historianët duhet të marrin parasysh pikëpamje dhe përvoja të ndryshme të njerëzve në të shkuarën. Nxënësit mund të diskutojnë arsyetimet pro dhe kundër kooperativave, etj.

V.2. INDUSTRIALIZIMI

V-7. Tubim i brigadës së punëtorëve të rinj të Frontit Popullor në Sarajevë, 1948

Koleksion fotografish, Muzeu Historik i Sarajevës.

Menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore në Jugosllavi, u formuan brigadat vullnetare të punëtorëve të rinj për t'i angazhuar të rinjtë në punën për rindërtimin e vendit, por gjithashtu edhe për t'iu rrënjosur ideologjinë e re. Shumë të rinj nga vende të tjera, sidomos nga vendet Perëndimore, erdhën në Jugosllavi për t'iu bashkuar brigadave vullnetare. Vepra më e mirënjohur ku kontribuan vullnetarët e brigadave ishte ndërtimi i hekurudhës Shamac - Sarajevë në Bosnjë dhe Hercegovinë, ku mijëra të rinj nga Jugosllavia dhe vende të tjera, kishin punuar me vegla shumë të thjeshta në një rrugë 239 km, plot me ura dhe tunele. Një parullë e njohur asokohe ishte: "Ne ndërtuam hekurudhën, ndërsa hekurudha na qytetëroi neve", e cila nënkuptonte se puna i ka bërë shumë të rinj proletarë të ndërgjegjshëm. Brigadat e rinisë u angazhuan gjithashtu me ndërtimin e Autostradës së Bashkim Vëllazërimit (shih burimin V-31). Me zhvillimin e teknologjisë së mjeteve të sektorit të ndërtimit, brigadat e rinisë u aktivizuan më pak, por në vitin 1970 u bë një përpjekje për t'i gjallëruar, sepse besohej se bashkimi i të rinjve do të ishte ndalesë për rritjen e ndjenjës kombëtare. Këto "veprimtari të punës së të rinjve" u bënë inkubator i kulturës së rinisë.

Fronti Popullor (FP) ishte një organizatë e madhe, ku përfshiheshin të gjithë ata që mbështesnin regjimin komunist (me dëshirë apo jo). FP-ja pasluftës u angazhua me organizimin e brigadave të punëtorëve të rinj gjatë periudhës së rindërtimit socialist të vendit.

V-8. Uzina metalurgjike Zenica

A. "Shokë, mbusheni kubaturën deri në metër kubin e fundit"

Koleksion fotografish, Muzeu Historik i Sarajevës.

B. Ekstrakt nga fjalimi i Titos në Zenicë, më 12 tetor 1958

Kur flasim për një ndërtesë të tillë, ose një uzinë të madhe në përgjithësi, nuk mund të përmendim vetëm tonë çeliku ose mallrat që prodhohen aty. Nuk duhet të harrojmë asnjëherë se si janë edukuar me normat e moralit komunist punëtorët dhe klasa jonë punëtore në uzina të tilla, dhe pastaj ta njohim rolin, rëndësinë dhe përgjegjësinë e tyre. Për sa i përket kësaj, ky kombinat i madh metalurgjik i Popullit të Bosnjës dhe Hercegovinës luan një rol të madh. Meqenëse punëtorët kanë ardhur këtu nga fshati, disa prej tyre deri kur nisi lufta,nuk e dinin se çfarë ishte uzina. Këta njerëz njëherë e një kohë dukeshin ndryshe nga ç'duken tani. Ata erdhën nga fshatrat për të punuar si punëtorë dhe për t'i përdorur aftësitë e tyre krijuese për të kontribuar në zhvillimin e vendit.

Ademović et al, 1967, fq. 46.

Uzina metalurgjike Zenica, e dëmtuar rëndë gjatë luftës, në vitin 1946 kishte arritur prodhimin maksimal të paraluftës. E ndodhur në një rajon me miniera qymyrguri dhe mineral hekuri, nga viti 1948 deri në vitin 1958, ajo ishte qendra më e madhe metalurgjike në Jugosllavi. Disa hidrocentrale dhe termocentrale boshnjake i mundësonin burimet e nevojshme të energjisë së vendit. Uzina metalurgjike Zenica, u bë simboli i suksesit dhe industrializimit socialist në Jugosllavi, dhe veçanërisht në Republikën Socialiste të Bosnjë-Hercegovinës (Shih stemën; burimi V-9).

1. Pse ishte Uzina Metalurgjike Zenica e rëndësishme për Jugosllavinë? Si e shpjegoi Titoja rëndësinë e saj? Si e shihte ai rolin e saj në edukimin e "punëtorit socialist"?
2. Industrializimi i Bashkimit Sovjetik përshkruhet në romanin e mirënjohur të Nikollaj Ostrovskit:"*Si u kalit çeliku*", ku paraqiten sprovat heroike të një djali të ri komunist, për të ndërtuar një shoqëri të re të njerëzishme dhe të drejtë (duke ndihmuar në shndërrimin e vendit të tij nga një vend bujqësor në një vend industrial), që shërben si model ideal për vendet e tjera socialiste. Gjejeni këtë model në burimet e mësipërme dhe nënvizoni fjalët dhe shprehjet që lidhen me të. Lexoni librin dhe diskutojeni në klasë.

V-9. Simbolet e industrializimit - Stema e Republikës Socialiste të Bosnjës dhe Hercegovinës

https://sh.wikipedia.org/wiki/Grbovi_jugoslovenskih_socijalisti%C4%8Dkih_republica, vizituar më 26.09.2016.

Stema e Bosnjës dhe Hercegovinës u miratua më 31 dhjetor 1946. Diskutoni lidhur me simbolet, imazhet dhe mesazhet e saj. Çfarë kuptimi kanë dy oxhakët e uzinës? Çfarë dobësish ka zhvillimi industrial?

V-10. Ekstrakte nga një raport për industrinë jugosllave të ndërtimit të anijeve

Në periudhën midis viteve 1968 dhe 1984, nga 11 milionë tonazh i rëndë, 93,5 për qind eksportohej. Nga kjo sasi, 82,2 për qind e tonazhit iu shit blerësve perëndimorë, dhe pjesa tjetër u dërgua në BRSS. Gjatë 30 viteve të kaluara, Jugosllavia ka eksportuar anije të prodhuara prej saj në 67 vende të botës, duke përfshirë të gjithë vendet kryesore për ndërtimin e anijeve përveç Japonisë, Koresë së Jugut dhe Spanjës. Anijet e ndërtuara për blerës norvegjezë dhe suedezë, kur kjo industri ishte në kulmin e saj, shihen si prova e prodhimeve të suksesshme jugosllave.

Për vite të tëra Jugosllavia ka pasur pak a shumë një prodhim të qëndrueshëm dhe renditej në 10 vendet

kryesore në botë për ndërtimin e anijeve. Në vitet e kaluara, kantieret detare kanë arritur ta konsolidojnë pozicionin e tyre dhe sot janë në vendin e gjashtë në listën për prodhimin e rreth 2.5 për qind e të gjithë mjeteve të lundrimit në botë.

Si pasojë e humbjes së shumë anijeve gjatë Luftës së Dytë Botërore, në sajë të ndihmës së Aleatëve, Jugosllavia e arriti tonazhin e paraluftës vetëm në vitin 1958 (rreth 411,000 GT). Që atëherë ka pasur një rritje të qëndrueshme. Nga periudha e pasluftës e deri në vitin 1975, kishte realizuar deri në 2,4 milionë GT, por ende nuk e kishte arritur përqindjen e paraluftës të të gjithë prodhimit në botë. Në vitin 1939 prodhimi i përgjithshëm ishte 0,62 për qind, ndërsa në vitin 1975 ishte 0,56.

Reporteri detar dhe lajmet për inxhinierinë, maj 1986, fq. 42.

Industria e ndërtimit të anijeve ishte një nga degët më fitimprurëse të prodhimit industrial jugosllav që synonte më së shumti eksportin. Pjesa më e madhe e kantiereve detare të ndërtimit të anijeve ndodheshin në Republikën Socialiste të Kroacisë, pra 86% e anijeve jugosllave ndërtoheshin në kantieret detare kroate. Duke parë cilësinë e lartë dhe numrin e madh të këtyre anijeve, Jugosllavia ishte "superfuqi". Në fundin e viteve 1980, Jugosllavia renditej vendi i tretë në botë për ndërtimin e anijeve.

V-11. Të dhëna statistikore për Flotën Tregtare Greke

Në vijim të një tradite të vjetër, në vitet pas Luftës së Dytë Botërore flota tregtare greke pati një rritje të madhe, dhe ishte një nga shtyllat e ekonomisë greke. Kjo rritje pasqyrohet në Tabelën A për dhjetë flotat më të mëdha tregtare në mbarë botën, dhe në Tabelën B: për zhvillimin e flotës tregtare greke (anijet me flamurin grek dhe anijet e regjistruara në emrin e pronarëve grekë) nga viti 1949 deri në vitin 1990.

A. Flotat më të mëdha tregtare në mbarë botën, 1973-1992

Emri i vendit	1973	Flotë tregtare botërore (%)	1983	Flotë tregtare botërore (%)	1992	Flotë tregtare botërore (%)
Liberi	49.9	17	67.6	16	55.2	12
Japoni	36.8	13	40.8	10	25.4	6
Britani e Madhe	30.2	10	19.1	4		
Norvegji	23.6	8	19.2	5	22.6	5
Greqi	19.3	7	37.5	9	24.5	6
(nën pronësinë e grekëve)	(42.6)	(15)	(56.1)	(13)	(56.9)	(12)
Rusi	17.4	6	24.5	6	26.4**	6
SHBA*	14.9	5	19.4	5	18.2	4
Panama	9.6	3	34.7	8	49.6	11
Itali	8.9	3	10	2	—	
Francë	8.3	3	10	2	—	—
Bahamas	—		—		20	5
Kinë	—		—	2	13.9	3
Qipro	—		—	1	20.4	5
A. Tërësia e dhjetë flotave më të mëdha	218.8	75	282.8	67	276.2	62
B. Flota botërore	289.9	100	422.6	100	444.3	100

B. Flota tregtare greke 1949-1990

Viti	Flotë tregtare me flamur grek	Flotë tregtare nën pronësi greke	Norma e rritjes (%)	Flotë tregtare greke	Norma e rritjes (%)
1949	1.301	2.377		82.300	
1950	1.265	2.930	23	84.600	3
1955	1.270	6.906	16	100.600	3
1960	5.575	12.201	-2	129.800	4
1965	7.198	18.575	13	160.400	5
1970	12.850	30.899	15	227.490	7
1975	25.108	48.298	6	342.162	10
1980	41.422	53.626	1	419.911	2
1985	28.646	46.909	-4	416.268	-1
1990	22.524	46.580	3	423.627	3

Harlaftis, 2001, fq. 434, 590-591.

Në të dy burimet e mësipërme gjenden të dhëna mbresëlënëse për praninë e Jugosllavisë dhe Greqisë në veprimtaritë lidhur me anijet nëpër botë. Studioni burimet dhe gjeni më shumë informacion për: a) Prodhimin dhe cilësinë e kantiereve detare të Jugosllavisë; dhe b) Për flotën tregtare greke si një traditë e vjetër. Më pas, krahasojini me situatën në ditët e sotme.

Gjeni shkrime, ose filma lidhur me këtë traditë (p.sh për sa i përket Greqisë, filmi i Pandelis Vulgarisit: "Anglia e vogël", që përshkruan jetën e prodhuesve të anijeve dhe marinarëve në ishullin e Androsit, bazuar në romanin e Joana Karistianit dhe poezinë e Nikos Kavadiasit që pasqyronin përvojat personale të marinarëve).
Shih gjithashtu http://www.maritime-museum.gr/index.php.

V-12. Statistika të vërteta apo të rreme?

Përqindja e shpërndarjes së investimeve sipas sektorëve është siç vijon:

Industri: 43.6% në vitin 1950, 48.9% në vitin 1965, 47.1% në vitin 1987; Inxhinieri civile: 5.9% në vitin 1950, 3.9% në vitin 1965, 4.7%në vitin 1987;

Bujqësi: 10.6% në vitin 1950, 16.3% në vitin 1965, 16.7% në vitin 1987;

Transport: 15.5% në vitin 1950, 9.4% në vitin 1965, 9.8% në vitin 1987; Mallra dhe shërbime: 2.3% në vitin 1950, 2.6% në vitin 1965,2.3% në vitin 1987

Administrata publike, strehim dhe shërbime të tjera: 12.2% në vitin 1950 (prej të cilëve 11.2% shërben për strehim), 14.1%në vitin 1965 (11.29%), 16% në vitin 1987 (9.3%).

Statistikat Vjetore të Rumanisë, 1988, fq. 59, 64.

Këto shifra të publikuara nuk duhen besuar verbërisht, sepse dihet që zyrtarët e Partisë Komuniste zakonisht i falsifikonin të dhënat për t'i shtuar arritjet e regjimit komunist. Këtë e dinin jo vetëm zyrtarët dhe administratorët e regjimit, që e pranuan haptazi këtë manovrim të tyre pas fundit të regjimit, por edhe njerëzit e zakonshëm që duhet të përballonin mospërputhjen ndërmjet statistikave të realitetit dhe atyre të propagandës. Duhet marrë parasysh fakti se gjatë asaj periudhe monedha kombëtare, leu, ishte zhvlerësuar disa herë, veçanërisht gjatë viteve 1980. Gjithashtu ia vlen të përmendet se ardhja në pushtet e Nikolai Çausheskut në vitin1965 u konsiderua ngjarje historike për zhvillimin ekonomik të Rumanisë së pasluftës.

Përfytyroni se jeni një historian që po kryeni një hulumtim për arritjet ekonomike të vendit tuaj në vitet 1960-1980. Cilët faktorë dhe të dhëna do të merrnit parasysh? Si do të siguroheshit për besueshmërinë dhe saktësinë e burimeve statistikore që do të gjenit?

V-13. "*Devrimi*", makina e parë turke

"*Devrimi*" (revolucion), makina e parë turke, simbolizonte dëshirën e regjimit ushtarak për t'u shndërruar në një vend industrial. Në të vërtetë, *Devrim* u emërtua grushti i shtetit që u krye nga ushtria. Makina "*Devrim*" nënvizoi pavarësinë e ekonomisë turke nëpërmjet punësimit të brendshëm. Për shkak të diskutimeve për mungesën e zhvillimit të vendit si dhe rezultateve të rritjes në sajë të bujqësisë gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar, kjo sipërmarrje kishte shumë ngjyrime simbolike. Pothuajse të gjitha pjesët e makinës ishin prodhuar brenda vendit. Mesatarisht brenda 120 ditësh, inxhinierët dhe punëtorët turq prodhuan katër prototipa të makinës "*Devrim*". Kjo nismë nuk vazhdoi, sepse prodhimi i automjeteve me anë të metodave manuale nuk ishte aq fitimprurës kur krahasohej me teknikat perëndimore të prodhimit në masë.

A. Artikull gazete

Një nga makinat e prodhuara në Iskishihir iu dhurua presidentit Gyrsel. Ishin përfunduar të gjitha përgatitjet për të kaluar në prodhimin në masë.

Gyrseli mori çelësat e makinës përballë Asamblesë së Madhe Kombëtare dhe tha: "I përgëzoj inxhinierët dhe punëtorët e nderuar të Hekurudhës Shtetërore që punuan për këtë makinë. Për shkak të kompleksit të inferioritetit, thuhej se në Turqi nuk mund të prodhoheshin automjete. […]

MËNYRA PERËNDIMORE DHE MËNYRA LINDORE

Makina e zezë në të cilën ndodhej Gyrseli, ndaloi pas disa metrash dhe turma u mblodh rreth saj. Shoferi i tha Gyrselit: "Pashai im, na mbaroi karburanti." Gyrseli pasi doli nga makina kritikoi hutimin e shoferit duke thënë: "E prodhuam makinën sipas mënyrës perëndimore, por harruam ta "ushqenim" sipas mënyrës lindore".

Milljet, 30 tetor 1961.B.

B. Kopje e "*Devrimit*"

http://pics.imcdb.org/0ge28/283260-vlcsnap-2011-01-19-17h10m03s125.jpg, vizituar më 17.08.2016.

V-14. Minierat e squfurit në malet Kalimani: Shembull i një investimi të pasuksesshëm në periudhën e komunizmit

Investimet në minierën e squfurit në malet Kalimani në veri të Rumanisë, ishin prova e dëshirës së Çausheskut për ta kthyer Rumaninë në një vend të pavarur ekonomikisht, pavarësisht pasojave. Miniera u hap në vitin 1969 dhe në periudhën e prodhimit më të madh kishte rreth 8,000 punëtorë. Në afërsi të saj, nisi të zhvillohej një "qytet", me blloqe, mensa, dyqane dhe floktore. Miniera u mbyll në vitin 1997, mes dyshimesh se gjatë periudhës komuniste ishin publikuar shifra të rreme për prodhimin.

http://carieradesulf.blogspot.ro/, vizituar më 06.05.2015.

Lexoni burimet dhe çelësat me kujdes. Nga një pikëpamje financiare,a ishin të arsyeshme vendimet për ndërtimin e fabrikave, shifrat e prodhimit, etj? Te burimet gjeni arsye të tjera që nuk lidhen me ekonominë, për ndërmarrjen e investimeve të tilla.

V-15. Një fotografi propaganduese e Kombinatit Metalurgjik "Lenin" në Kremikovtsi, Bullgari, 1985

http://www.lostbulgaria.com/?p=3075, vizituar më 17.08.2016.

V-16. Gratë veshur me *Vatenka**

Në Kremikovtsi,
ndodhet një fabrikë,
ku gratë e palodhura,
punojnë natë e ditë.

Punët e shtëpisë,
shpejt e shpejt mbarojnë,
veshur me vatenka*, në fabrikë shkojnë.

Me punë të rënda,
çdo ditë ato hasen,
zemrat e duart e tyre,
kurrë nuk dinë të plaken.

Me mund në familje,
Me lodhje në fabrikë,
Hapin shtigje të reja,
S'pushojnë natë e ditë.

**Vatenka*: Një xhaketë e ashpër me tegela që e vishnin punëtorët e fabrikave.
Arkivi Shtetëror i Sofjes, dosja 2337, inventari 1, njësia arkivore 61.

Cili është qëllimi dhe kuptimi i kësaj poezie? Si lidhet me fotografinë (burimi V-15)? Përshkruajeni fotografinë: rrobat dhe gjuha e trupit e grave, sfondi dhe këndi. A mendoni se këto dy burime janë produkte të propagandës? Jepni arsyetimet tuaja.

V-17. Centrali i Korporatës Energjetike të Kosovës

Arkivi i Institutit të Historisë, Prishtinë.

V-18. Miniera e Trepçës në Mitrovicë, Kosovë

Miniera e Trepçës ndodhet në Mitrovicë […]. Burimet minerare të Kosovës u shfrytëzuan nga paraardhësit ilirë, më vonë nga bizantinët, turqit, dhe në fund nga serbët dhe jugosllavët. […]

Hulumtimi fillestar gjeologjik u krye nga gjeologë britanikë në vitin 1924. Dy vjet më vonë, kompania britanike "Trepça Mines Limited" përfitoi të drejtat e shfrytëzimit për një periudhë prej pesëdhjetë vjetësh […]. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, gjermanët e përdorën minierën e Trepçës, megjithëse niveli i prodhimit ishte i ulët. Nga viti 1945 deri në vitin 1990 miniera kishte një prodhim vjetor prej 600,000 tonësh. […]

Gjatë 58 vjetëve të funksionimit, miniera e Trepçës ka "prodhuar" tre milionë tonë mineral me përbërje mesatare 9% (Pb dhe Zn) ose rreth tre milionë tonë metal (Pb dhe Zn).

http://www.trepca-akp.com/pages/posts/2/, vizituar më 12.08.2016..

Miniera e Trepçës (ende në përdorim, por në rënie) ishte një nga qendrat më të mëdha industriale jo vetëm në Kosovë,por në mbarë Jugosllavinë. Mijëra punëtorë (shqiptarë, serbë, malazezë, boshnjakë) kanë punuar aty.

V-19. Përqindja e grave që punonin në industrinë e tekstileve në Serbi dhe Jugosllavi

	1952-1959	1960-1969	1970-1979	1980-1989
Përqindja e grave që punonin në industrinë e tekstileve në Serbi	56.75%	60.4%	66%	71%
Numri i grave që punonin në industrinë e tekstileve në Serbi	16,354	44,662	67,915	105,059
Përqindja e grave që punonin në industrinë e tekstileve në Jugosllavi	63%	64%	68%	73%
Numri i grave që punonin në industrinë e tekstileve në Jugosllavi	67,800	124,734	197,000	302,020
Përqindja e grave që punonin në industrinë e tekstileve në Jugosllavi në krahasim me numrin e përgjithshëm të punëtorëve në objektet industrialë dhe në minierat e Jugosllavisë	8.3%	9.8%	11.1%	12.1%

Vjetari Statistikor i Republikës Populllore të Serbisë, 1952, Beograd: Instituti i Statistikave dhe të dhënave RP e Serbisë, fq. 176; 1953, fq. 216; 1955, fq. 59; 1974, fq. 68, 73; 1977, fq. 74, 73; 1979, fq. 77-80;1980, fq. 107-110; 1982, fq. 78-81; 1984, fq. 91-94; 1986, fq. 93-97; 1988, fq. 97-101; 1990, fq. 94-98; RKFJ, Vjetari Statistikor 1954, Beograd: Byroja Federale e Statistikave, fq. 97; 1957, fq. 106, 111, 115; 1962,fq. 82, 83; Vjetari Statistikor i Jugosllavisë 1963, Beograd: Zyra Federale e Statistikave), fq. 101; 1964, fq. 105; 1965, fq. 106; 1966, fq. 101; 1967, fq. 95; 1968, fq. 92-93; 1969, fq. 94-95; 1970, fq. 88-89; 1982, fq. 125,126, 128; 1984, fq. 125, 126, 128. 1990, fq. 144, 146.

Të drejtat politike, shoqërore dhe ekonomike të grave ishin pasqyruar në kushtetutën federale të Jugosllavisë të vitit 1946. Brezi i grave pas luftës kishte më shumë të drejta për t'u arsimuar dhe për t'u përfshirë në tregun e punës, pjesërisht falë proceseve më të gjera të urbanizimit dhe industrializimit. Besohej se fabrikat e tekstileve modernizonin jetët e grave, veçanërisht të grave që vinin nga pakicat etnike, ose republikat me mirëqenie më të ulët (gratë përbënin afërsisht 70% të fuqisë punëtore në industrinë e tekstileve).Në vitin 1947, numri i grave që punonin në Jugosllavi pothuajse ishte trefishuar. Rendi i ri socialist i barazoi formalisht rrogat e burrave dhe grave, por ende mbështeste ndarjen e profesioneve në të ashtuquajturat punët e burrave dhe grave. Disa fabrika kishin restorantet e tyre, shërbimet mjekësore, dyqanet me ulje çmimesh, kopshtet dhe komplekset e strehimit, dhe shpesh iu ofronin punëtorëve paketa pushimesh me çmime të ulëta. Sigurimet shëndetësore dhe pagesat e pensionit i mbulonin nevojat e të gjithë punëtorëve, ndërkohë që legjislacioni për punën parashikonte një ditë pune tetëorëshe dhe kufizimin e punës me kohë të pjesshme në katër orë. Orët e punës shtesë dhe puna gjatë pushimeve paguheshin. Filmi me metrazh të shkurtër" Nga 3 në 22" i Kresho Golikut, i realizuar në vitin 1966, në vitin 1966, përshkruan një ditë në jetën e një punëtoreje në fabrikën e tekstileve "Pobjeda" në Zagreb. Ajo zgjohet dy orë para se të shkojë në punë në orën 5 të mëngjesit, dhe kur kthehet në shtëpi gatuan, qep, dhe lan fëmijët, ndërkohë që i shoqi pushon pas pune. Filmi tregon qartë se gratë ishin të detyruara ta mbanin mbi supe barrën e industrializimit të vendit.

V.3. URBANIZIMI

V-20. Rënia e popullsisë rurale në Evropën Lindore, gjatë viteve 1950-1990

Emri i vendit	Shkalla e popullsisë fshatare (Përqindja e përgjithshme					Ndryshimet në shkallën e popullsisë rurale nga viti 1950
	1950	1960	1970	1980	1987/1990	
Bullgari	72.6	62.6	47.5	37.8	34.1	-38.5
Rumani	76.6	67.9	59.2	50.4	45.6	-31.0
Jugosllavi	79.2	71.7	61.4	53.9	48.0	-31.2
Poloni	60.0	51.3	47.7	41.3	38.4	-21.6
Hungari	55.5	52.5	47.4	43.6	40.8	-14.7

Ederhardt, 1993, fq. 35.

V-21. Urbanizimi në Greqi

Zhvillimi i popullsisë urbane në Greqi, gjatë viteve 1951-1981

		Popullsia urbane gjithsej (%)	% e popullsisë urbane në qytete			
	Gjithsej Popullsi		10,000-20,000	20,000-100,000	over 100,000	Athinë
1951	7,632,801	37.7	4.8	11.0	3.93	18.05
1961	8,388,533	43.3	5.8	9.69	5.63	21.12
1971	8,768,641	53.2	3.0	13.50	7.70	29.00
1981	9,760,300	58.1	6.3	14.60	6.90	31.07

Hastaoglou et al, 1987, fq. 156.

V-22. Urbanizimi në Turqi gjatë viteve 1927-2000



https://chronicle.fanack.com/turkey/economy/, vizituar më 17.08.2016.

V-23. Popullsia urbane dhe rurale në Turqi, 1945-1990

	Urbane (%)	Rurale (%)
1945	24.94	75.06
1950	25.04	74.96
1955	28.79	71.21
1960	31.92	68.08
1965	34.42	65.58

	Urbane (%)	Rurale (%)
1970	38.45	61.55
1975	41.81	58.19
1980	43.91	56.09
1985	53.03	46.97
1990	59.01	40.99

www.tuik.gov.tr/PreIstatistikTablo.do?istab_id=202, vizituar më 28.08.2016.

V-24. Zhvillimi urban i Beogradit

Në vitin 1923 u përgatit plani i parë urban për zgjerimin e qytetit të Beogradit përgjatë bregut të lumit Sava. Në vitin 1946 arkitekti Nikola Dobroviç hartoi një projektrregullore urbane për Beogradin e Ri. Një vit më vonë, plani pesëvjeçar për zhvillimin e Beogradit të Ri mundësoi ndërtimin e komplekseve të strehimit, një qyteti studenti, dhe disa ndërtesave madhështore për Partinë. Më11 prill 1948, punimet nisën me pjesëmarrjen e 5,000 brigadave të rinisë nga mbarë Jugosllavia. Faza e dytë e ndërtimit nisi në vitin 1958 dhe përfundoi në vitin 1969, me ndërtimin e Pallatit Federal (selia e qeverisë), hotelit "Jugosllavia", aeroportit "Beograd", etj.

A. Beogradi i Ri në vitet 1930: Ura e mbretit Aleksandër në vitin 1934

Arkivat Historike të Beogradit, http://www.arhiv-beograda.org/index.php/en/, vizituar më 20.09.2016.

B. Beogradi i Ri në vitet 1970: Ura e Brankos (ish-ura e mbretit Aleksandër)

Ivo Eteroviç, *Pamje nga afër e Beogradit të Ri*, Novi Beograd, 1995, fq. 27.

V-25. Plani i qytetit të Athinës



Problemet e Zonës së Madhe të Athinës, 1974, n. P.

Në vitin 1965, Ministria e Punëve Publike hartoi planin e parë afatgjatë për ndërtimet në qytetin e Athinës, që ishte një ndërhyrje gjithëpërfshirëse për planifikimin urban të kryeqytetit grek që përqendrohej te përdorimi i tokës dhe rekomandimet për zhvillimin e qytetit. Plani u hartua në një kohë kur rritja urbane në Greqi dhe tjetërkund kishte arritur përmasa të pashembullta. Tiparet kyçe të asaj periudhe ishin lëvizjet migratore masive të popullsisë nga fshati në qendrat urbane dhe rindërtimi i mjedisit të ndërtuar. Ndërmjet viteve 1940 dhe 1971, popullsia urbane e Greqisë u dyfishua, dhe përbënte 53,2% të popullsisë gjithsej, 32% prej të cilëve banonin në Athinë. Në fund të viteve 1950, peizazhi i Athinës kishte ndryshuar për shkak të ndërtimit të godinave shumëkatëshe dhe ky proces u përshpejtua gjatë viteve 1970 dhe 1980. Ky imazh shfaq zgjerimin e Athinës nga vitet 1830 në vitet 1970.

V-26. Ndotja e ajrit në Athinë

http://www.mixanitouxronou.gr/giati-forai-maska-o-kirios/, vizituar më 17.08.2016.

Që prej viteve 1960, qyteti i Athinës ka pasur probleme të mëdha me ndotjen e ajrit, kryesisht për shkak të bllokimit të trafikut dhe përdorimit të lëndëve djegëse të papastra dhe me cilësi së ulët për ngrohje dhe gatim. Megjithëse cilësia e lëndëve djegëse është përmirësuar disi, niveli i grimcave është ende shumë i lartë në krahasim me qytetet e tjera, dhe nuk plotësohen standardet e cilësisë së ajrit të vendosura nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë fotografi të bërë në fillimin e viteve 1980, gjatë demonstratës kundër mospranimit të qeverisë për ta trajtuar këtë çështje në mënyrën e duhur, paraqitet një aktivist i ri me një maskë kundërgazi që mban një pankartë ku lexohet: MOS MERRNI FRYMË, KRIJOHET NEFOSI* (SMOGU)

Fjala greke **nefos* përdoret për të përshkruar smogun në zonat urbane në mbarë botën. Analizoni rastet e ditëve të sotme të nefosit, si për shembull në Pekin. Gjeni shkaqet dhe krahasojini.

V-27. Raport nga Kreu i Departamentit të Organizimit dhe Udhëzimit për Komitetet Ekzekutive të Këshillave Populllore për pastrimin dhe zbukurimin e qytetit të Dimitrovit (Pernik), 18gusht 1952

Qyteti i Dimitrovit është rritur me shpejtësi si bazë industriale dhe minerare, por ka mbetur pas me zhvillimin, zbukurimin dhe pastrimin e planifikuar të qytetit. Qyteti është ndërtuar pa plan dhe duket i çrregullt dhe jomikpritës. Disa godina, si termocentrali, veprat e Stalinit dhe shkritoret, si dhe disa nga (godinat) e Gjergj Dimitrovit, janë në afërsi të zonave të banuara.

Ndotja e tokës, ajrit dhe ujit është shumë e madhe. Rrugët, sheshet dhe vendet e tjera publike janë të mbushura me plehra, pluhur dhe papastërti. Pranë blloqeve të minierave dhe fabrikave industriale, si dhe në lagje të tjera, stalla derrash, pulari dhe vendgrumbullime plehrash janë ndërtuar nëpër kopshte, poshtë dritareve, afër gardheve, madje edhe në rrugë. Për këtë arsye, përballë shkritoreve të veprave të Stalinit, vetëm 150-200 metra nga rruga, gjenden mbi 100 stalla derrash dhe vizitorë bullgarë e të huaj kalojnë në këtë zonë për t'i parë objektet dhe veprat e Stalinit. Shumë nga familjet i hedhin plehrat në breg të lumit dhe ujërat e ndotura në kopshte dhe në rrugë. Krahas rrezikut që i kanoset popullsisë, të gjitha këto e bëjnë qytetin të duket shumë i shëmtuar.

Në këtë qytet ndodhen ferma derrash, stalla dhe miniera. Për shkak të mjeteve të transportit (kamionëve), rrugët janë të përbaltura me dhe, materiale ndërtimi, qymyr, etj., dhe meqenëse vetëm një pjesë e vogël e tyre janë të shtruara dhe të asfaltuara, balta dhe dheu janë përhapur në të gjithë qytetin.

Arkivi Qendror i Shtetit, dosja 254, inv. 6, ?. u. 50..

Analizojeni situatën e përshkruar në burimin e mësipërm. Cilët janë faktorët për këtë rrëmujë? Më pas diskutoni planifikimin e ndërtimit të një qyteti të ri. Planifikimi urban është puna e projektuesve arkitektonikë: A mjafton? Cilët faktorë ndikojnë në zhvillimin e zonave urbane? A ndodh e njëjta situatë në vendin tuaj?

V-28. Blloqet e banuara: Një fshat bullgar i shndërruar në qytet në vitet 1970

http://socbg.com/2015/02/%D0%B6%D0%B8%D0%BB%D0%B8%D1%89%D0%BD%D0%B8-%D0%B1%D0%BB%D0%BE%D0%BA%D0%BE%D0%B2%D0%B5-%D0%B2 %D0%B1%D1%8A%D0%BB%D0%B3%D0%B0%D1%80%D1%81%D0%BA%D0%BE-%D1%81%D0%B5%D0%BB%D0%BE.html, i vizituar më 24.09.2016.

V-29. Blloqet e apartamenteve: Shpërfytyrimi i peizazhit të Athinës

Muzeu Benaki (Athinë), Arkivat Fotografike, Dimitris Harisiadhis.

Për të strehuar numrin në rritje të banorëve grekë që vinin nga provincat në qendrat urbane, qeveritë e periudhës së pas Luftës Civile ofruan shtysa për zbatimin e të ashtuquajturit antiparochi në ndërtimin e blloqeve të apartamenteve, "nëpërmjet të cilit pronari i një ndërtese kompensohej me apartamente në vend të pagesës për tokën që i kishte dhënë kontraktuesit". Kryeministri Kostantinos Karamanlis iu përgjigj akuzave se ndërtimi i blloqeve të apartamenteve e kishte shpërfytyruar peizazhin e Athinës, duke thënë: "Ku duhet t'i kisha ndërtuar? Mbi kokën time?"

Komentoni ekstraktin e mëposhtëm nga çelësi: Kryeministri Kostantinos Karamanlis iu përgjigj akuzave që ndërtimi i blloqeve të apartamenteve e kishte shpërfytyruar peizazhin e Athinës, duke thënë: "Ku duhet t'i kisha ndërtuar? Mbi kokën time?" Çfarë përgjegjësie ka qeveria dhe cila është gjendja e dukurisë së urbanizimit të shpejtë?

V-30. Shkup: Tërmet dhe modernizim

A. Pjesë e planit urban për rinovimin e Shkupit nga Kenzo Tange

Fotografi nga Osamu Murai.

B. Qendra Tregtare e Qytetit, simbol i Shkupit modern

Arsovski et al, 1981, fq. 54.

Tërmeti i vitit1963 e ktheu Shkupin në një kantier të madh ndërtimi. Arkitektë dhe inxhinierë nga mbarë bota punuan në planifikimin dhe ndërtimin e qytetit të Shkupit. Nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara, në fillim të vitit 1964 u ngrit një këshill që përbëhej nga arkitektë, planifikues dhe ekspertë të tjerë të shquar nga mbarë bota dhe Jugosllavia (duke përfshirë E. Vajsman, C. Doksiadhis). Njëkohësisht, u zhvillua një konkurs ndërkombëtar, që e fitoi ekipi i drejtuar nga arkitekti Kenzo Tange. Në projektimin e tyre ndërthurej ideja e "Shkupit si qytet i hapur", modernizimit dhe zgjerimit të tij që solli një zhvillim demografik. Njerëzit nga Republika Socialiste e Maqedonisë, veçanërisht nga fshati, nisën të migronin në qytet në masë. Si rrjedhojë, Shkupi iu nënshtrua ndryshimeve të mëdha estetike, shoqërore, kulturore dhe etnike, të cilat ndryshuan edhe mënyrën e jetesës.

1. Si ndikoi industrializimi te urbanizimi dhe pamja e qytetit/qytezës (shih burimin V-27 për pastrimin dhe zbukurimin e qytetit të Dimitrovit)? Përdorni shembujt e Beogradit të Ri, Athinës dhe Shkupit dhe përshkruani se si i kishte shndërruar qytetet procesi i urbanizimit. A kishte arsye të tjera për zhvillimin urban të këtyre qyteteve (p.sh Shkupit)? Cilët faktorë kanë ndikuar në zhvillimin e zonave urbane? Përshkruani ndryshimet në peizazhin urban duke përfshirë pasojat e tyre pozitive dhe negative.

2. Analizojeni rastin e rindërtimit të Shkupit. Ndiqni hapat që çojnë drejt shndërrimit të qytetit dhe krahasojini me shembuj të tjerë. Diskutoni.

V.4. INFRASTRUKTURA

V-31. Autostrada e Bashkim-Vëllazërimit (Zagreb-Beograd)

Ndërtimi i autostradës së Bashkim-Vëllazërimit (sipas motos së Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë) filloi me nismën e Titos në vitin 1948. Ajo përshkonte mbarë Jugosllavinë, nëpërmjet: Sllovenisë, Kroacisë, Serbisë dhe Maqedonisë, nga kufiri austriak deri tek ai grek. Për përfundimin e saj punuan rreth 300,000 anëtarë të brigadave të punëtorëve të rinj dhe Ushtrisë Popullore Jugosllave, si dhe mijëra vullnetarë. Pjesa e parë midis Zagrebit dhe Beogradit ishte 382 km e gjatë dhe u hap më 27 korrik 1950.

A. Autostrada

https://commons.wikimedia.org/wiki/File:SFR_Yugoslavia_autoput_de.svg, vizituar më 22.02.2016.

B. Afishe propagande



V. Kostiç, afishe propagande për ndërtimin e autostradës Beograd-Zagreb. Afishe ilustruese me ngjyra, 35 x 50.5 cm, Muzeu Historik i Jugosllavisë.

V-32. Linja ajrore "Olympic Airways"

http://boraeinai.blogspot.gr/2014/02/blog-post_24.html, vizituar më 17.08.2016.

Nën pronësinë e manjatit grek të lindur në Zmirni (Izmir) Aristotel Onasis (1906- 1975), në prill 1957 Linja ajrore "Olympic Airways" (OA) nisi punën me fluturimin nga Athina në Selanik. Kur kompania iu shit shtetit pak muaj para vdekjes së Onasisit, transportonte 2.5 milionë pasagjerë në vit dhe bënte fluturime ndërkontinentale deri në Amerikën e Veriut dhe Australi. Pompoziteti dhe mënyra e jetesës së pronarit të OA-së e bënë atë një markë ndërkombëtare, njësoj si logoja e tij dhe veshja e stjuardesave, që ishin stiluar nga emra të mirënjohur të modës.

V-33. Elektrifikimi

A. Greqi

E themeluar në vitin 1950 si ndërmarrje publike që "i përket vetëm popullit grek", në fund të viteve 1960 Korporata Shtetërore e Energjisë kishte marrë nën pronësi të gjitha ndërmarrjet private elektrike. →

Duke përdorur burime vendase, si linjiti dhe energjia ujore, kjo Korporatë gëzonte të drejtën e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

Përkthim: Nga llambat me vajgur te shpërndarja e energjisë elektrike edhe në FSHATIN MË TË VOGËL GREK

Arkivi Historik i Korporatës së Pushtetit

Publik, reklamë e vitit 1959.

B. Rumania dhe Jugosllavia

Hidrocentrali më i madh mbi Danub, në "Por?ile de Fier" (Portat e Hekurta) I (Djerdap); Kartolinë (Publiturism, 1987), ribotuar më http://altmarius.ning.com/forum/topics/ romania-de-altadata-portile-de-?er, vizituar më 12.02.2016.

Centrali i Energjisë Elektrike te Portat e Hekurta është ndërtesa model në Rumani. Projekti u hartua dhe u zbatua në bashkëpunim me Jugosllavinë. Diga dhe stacioni hidroelektrik u ndërtuan gjatë periudhës 1964 - 1971. I gjithë hidrocentrali përbëhej nga një grykë derdhëse 441 metra e lartë, rezervuar 55,5 metra i gjerë, kanale me rënie prej 17 metrash dhe një stacion hidroelektrik me gjashtë grupe turbinash. Ndërtimi i digës shkaktoi rritjen e nivelit të ujit me 30 metra, gjë që solli fundosjen e ishullit të Ada Kalehut dhe zgjerimin e rezervuarit deri në Beograd. Stacioni hidroelektrik prodhon 100 milionë kWh energji elektrike, që në ditët e sotme ndahen në mënyrë të barabartë me Serbinë.

V.5. FINANCAT

V-34. Ljubljanska Banka (Banka e Lubjanës). Zyrat e një banke komuniste në Frankfurt

Muzeu i Historisë Bashkëkohore, Lubjanë.

Banka e Lubjanës ishte një nga institucionet financiare më të mirënjohura në Sllovenininë e pasluftës, dhe administronte më shumë se 80% të kapitalit të përbashkët të të gjitha bankave në Republikën e Sllovenisë (në vitin 1972). Në vitin1968, banka nxori kartën e parë American Express. Meqenëse vlerësohej shumë në mbarë Jugosllavinë, shumë migrantë i derdhnin të ardhurat e tyre në këtë bankë, që kishte hapur degë në mbarë Evropën, madje edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

→

V-35. Reklamë e Bankës Shtetërore Bullgare të Kursimeve, 1952

Përkthim: Kursimet e njerëzve janë një faktor i fuqishëm për rimëkëmbjen e ekonomisë së vendit. Gjergj Dimitrov. Derdhni kursimet tuaja në Bankën Shtetërore të Kursimeve.

Tregtia, 1952.

KAPITULLI VI: DEMOGRAFIA

Hyrje	191
VI.1. Migrimet	193
VI.2. Minoritetet	197
VI.3. Ndryshimet e popullsisë	204

HYRJE

Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të XX-të, prirjet e përgjithshme demografike të shteteve të Evropës Juglindore ishin të përafërta. Ato ishin të kushtëzuara nga një sërë zhvillimesh në rajon, që datojnë nga fundi i shekullit të XIX-të dhe që shënuan, edhe pse me intensitet të ndryshëm nga shteti në shtet, kalimin gradual nga një strukturë demografike paramoderne ose tradicionale në një strukturë moderne demografike dhe të riprodhimit të popullsisë. Si një dukuri globale që kishte filluar në Evropën Perëndimore, këto zhvillime ishin rezultat i një sërë faktorësh ekonomikë, shoqërorë dhe kulturorë, që sollën ndryshime në veçoritë kryesore demografike të disa shteteve dhe shoqërive, që kishin arritur zhvillime të suksesshme si për sa i përket industrializimit, ashtu dhe urbanizimit.

Pas Luftës së Dytë Botërore, përpos rrugëve të zhvillimit të zgjedhura me vullnet të lirë apo të imponuara, procesi i modernizimit ekonomik dhe shoqëror në shtetet ballkanike u zhvillua në një shkallë shumë më të madhe. Ekonomitë e rajonit kaluan nga thuajse plotësisht bujqësore në bujqësore industriale. Në rastin e Greqisë dhe Turqisë ky kalim ishte më i ngadaltë, ndërsa në shtetet socialiste ishte më rrënjësor dhe i përshpejtuar. Statistikat tregojnë një prirje drejt pakësimit të numrit të popullsisë rurale dhe rritjes së shpejtë të popullsisë urbane, si për sa i përket zgjerimit të qendrave të vjetra industriale, ashtu edhe krijimit të qendrave të reja, gjë që ndryshoi statusin profesional dhe shoqëror të miliona burrave dhe grave. Kjo shpërngulje e madhe e brendshme e popullsisë ishte e shpejtë, sidomos në shtetet me bujqësi të kolektivizuar. Për shembull, raporti i popullsisë rurale të Bullgarisë, nga 75.3% që ishte në vitin 1946, u ul në 42% në vitin 1975 dhe kjo ndodhi vetëm brenda pak vitesh. Kjo ulje erdhi si pasojë e shpërnguljes së më shumë se dy milion njerëzve nga zonat rurale në ato urbane. Kjo valë shpërnguljesh u pakësua në vitet 1980, por shpërngulja nga qytezat për në qytetet e mëdha vazhdonte të rritej. Pavarësisht ndryshimeve në rang vendor, qarku apo dhe kombëtar, mënyra e jetesës e fshatit tradicional ndryshoi edhe në ato shtete ku fermat familjare dhe lidhjet e banorëve me tokën ishin ruajtur, si në Turqi, Greqi, Qipro dhe Jugosllavi. Në këtë proces kontribuan ndryshimet ekonomike, mekanizimi dhe shtimi i politikave bujqësore, shoqërore dhe shëndetësore dhe infrastruktura e përmirësuar.

Deri në fund të viteve 1980, popullsia e shteteve ballanike në tërësi vazhdonte të rritej, veçanërisht në Turqi, ku brenda tre dhjetëvjeçarësh u dyfishua. Zonat rurale vazhdonin të ishin burimi kryesor i rritjes së popullsisë, me një ulje graduale të lindshmërisë dhe vdekshmërisë së foshnjave. Së bashku me rritjen e jetëgjatësisë, këta dy tregues pasqyruan ndryshime në riprodhueshmërinë e popullsisë; gjithashtu në strukturën e moshës; në përqindjen e martesës dhe divorcit; planifikimin familjar me anë të kontraceptivëve dhe përqindjen e aborteve. Rënia e lindshmërisë erdhi edhe si pasojë e emancipimit të femrave dhe pjesëmarrjes së tyre aktive gjithnjë në rritje, në të gjitha fushat e jetës ekonomike dhe shoqërore. Nga vitet 1970 e më pas, filluan të shfaqeshin disa prirje negative në këtë fushë, kryesisht në shtete socialiste në të cilat tranzicioni demografik ishte më i shpejtë. Përsëri, shembulli më i qartë është ai i Bullgarisë. Autoritetet bullgare u shqetësuan nga ulja e lindshmërisë, nga plakja e popullsisë dhe nga shpopullimi i fshatrave dhe qarqeve të tëra. Ata morën një sërë masash për të nxitur lindjet dhe për të ndaluar abortet, megjithëse nuk ishin kaq të qëndrueshme dhe të prera sa ato në Rumani, dhe nuk patën një ndikim të madh në zhvillimin e pafavorshëm demografik të Bullgarisë. Në vitet 1990 vendi ishte i kapluar nga rrënimi ekonomik; pasiguria shoqërore dhe shkalla e rritjes natyrale të popullsisë ishte jashtëzakonisht e ulët, ndërsa vdekshmëria (përfshirë vdekjen e foshnjave) e tejkalonte lindshmërinë, dhe numri i aborteve të provokuara ishte më i lartë se ai lindjeve .

Shifrat e luhatshme të rritjes demografike kushtëzoheshin shumë edhe nga raporti ndërmjet emigrimit dhe imigrimit për arsye politike, ekonomike ose arsye të tjera, që ndikuan në shtimin apo pakësimin e popullsisë. As periudha e Luftës së Ftohtë nuk bënte përjashtim nga historia e gjatë e migrimeve të mëdha apo të vogla, brenda ose jashtë Evropës Juglindore. Emigrimi i pas luftës nga shtetet me ekonomi në shumicë bujqësore të Evropës Juglindore (Turqi, Greqi dhe Jugosllavi) drejt shteteve të industrializuara e të zhvilluara perëndimore, vazhdoi një traditë që kishte filluar që në shekullin e XIX-të. Gjatë Luftës së Ftohtë, falë nënshkrimit të marrëveshjeve dypalëshe për punësimin, një numër i madh migrantësh ekonomikë u shpërngulën nga vendet e tyre drejt shteteve

evropiane, më së shumti në Republikën Federale të Gjermanisë. Ndërsa pas përfundimit të Luftës Civile, nga Greqia u larguan përafërsisht 90,000 refugjatë politikë (përfshirë dhe fëmijët) , ndërsa në vitet 1950 dhe 1960, rreth 400,000 refugjatë të tjerë emigruan për arsye ekonomike. Në vitin 1961, Turqia mbylli një marrëveshje dypalëshe me Gjermaninë Perëndimore për punësimin, si një mënyrë për të stabilizuar shtetin në një kohë kur kishte vështirësi ekstreme të gjendjes ekonomike, që kishin shkaktuar mungesë furnizimi dhe trazira civile të herëpashershme. Dymbëdhjetë vjet më vonë, kur Qeveria Federale Gjermane e ndërpreu marrëveshjen për punësimin, veprim që u zbatua për të gjitha shtetet, në Gjermani jetonin rreth gjysmë deri në treçerek milionë turq. Për shkak të rritjes së papunësisë, në fund të viteve 1960, Jugosllavia ishte i vetmi shtet socialist në rajon, që dërgoi emigrantë në Gjermani. Ndonëse punëtorët imigrantë kishin planifikuar të qëndronin përkohësisht në shtetin pritës, një numër i madh i tyre u vendosën aty përfundimisht, duke kontribuar kështu në krijimin ose përforcimin e "Diasporave" kombëtare. Këto "Diaspora" luajtën një rol ekonomik, pasi dërgonin remitanca në vendin e tyre, por edhe një rol politik si grupe që bënin presion ndaj elitës kombëtare politike.

Një veçori e rëndësishme e paraqitjes demografike në Evropën Juglindore është edhe larmia etnike dhe fetare e banorëve të rajonit. Rëndësia e saj është paraqitur qartësisht nga politikat e vazhdueshme, edhe pse me ideologji të ndryshme, për integrimin e shumë minoriteteve dhe për homogjenizimin pak a shumë të detyrueshëm të shoqërive që i përkasin botës vazhdimisht në ndryshim në vitet e pas Luftës së Dytë Botërore. Krijimi i Federatës Jugosllave dhe shpallja e parimeve të ndërkombëtarizimit socialist në shtetet e bllokut Sovjetik, ngjallën shpresë se mosmarrëveshjet e trashëguara dhe tensionet e së shkuarës, më në fund do të bëheshin një pjesë e pandashme e përpjekjeve për krijimin e një shoqërie më përparimtare dhe të drejtë. Hovi fillestar i madh i modernizimit në shtetet socialiste të rajonit, u shoqërua nga një përmirësim i përgjithshëm i statusit arsimor dhe kulturor të minoriteteve, si për shembull, për sa i përket përdorimit të gjuhëve të tyre amtare dhe përfshirjes më të madhe në sistemet kombëtare arsimore. Megjithatë, këto arritje ishin të kushtëzuara dhe patën rezultate kontradiktore te minoritetet, ndërsa pjesa më e madhe mjeteve radikale dhe gjithëpërfshirëse të "inxhinierisë sociale" patën ndikim të kundërt, duke mbartur disa nga tensionet e vjetra dhe krijuar të reja. Për shembull, kjo është e vërtetë për sa u përket masave të ndërmarra për vendosjen e ateizmit, ashtu si edhe në rastin e përpjekjeve për të kapërcyer margjinalizimin shoqëror dhe kulturor të disa grupeve, sidomos të komunitetit rom (ciganë). Pavarësisht retorikës së vazhdueshme për ndërkombëtarizim, të drejtat e disa minoriteteve ishin kufizuar në vitet 1960, ndërsa sjelljet nacionaliste gjithnjë në rritje të elitës udhëheqëse komuniste u përfaqësuan jo vetëm me anë të simboleve, por edhe me anë të politikave për dallimet etnike dhe fetare. Demokratizimi dhe liberalizimi i përgjithshëm në Turqi dhe Greqi, krijoi mundësitë për përfaqësim më të madh të kulturës dhe gjuhës së minoriteteve dhe për ushtrimin e të drejtave në këtë aspekt. Gjithashtu, këto dukuri zgjeruan mundësinë për mobilizim politik në bazë etnike dhe për rigjallërimin e fuqishëm të tipareve nacionaliste, që propagandoheshin vazhdimisht jo vetëm nga politikat shtetërore, por edhe nga krizat dypalëshe dhe mosmarrëveshjet që ekzistonin midis tyre, si për shembull problemi me Qipron dhe çështja Kurde, që mbesin mosmarrëveshjet kryesore të zonës në skenën ndërkombëtare që pas rënies së Perdes së Hekurt.

VI.1. MIGRIMET

VI-1. Migrimi në Gjermaninë Perëndimore

Në vitin 1955, qeveria gjermane filloi të realizonte marrëveshje dypalëshe për punësimin me shumë vende, por kryesisht me ato mesdhetare (në vitin 1955 Italia; në vitin 1960 Spanja dhe Greqia; në vitin 1961 Turqia; në vitin 1963 Maroku; në vitin 1964 Portugalia; në vitin 1965 Tunizia dhe në vitin 1968 Jugosllavia), si pasojë e rritjes së shpejtë ekonomike të përjetuar në Gjermaninë Perëndimore gjatë viteve 1950 dhe mungesës së krahut të punës. Këto marrëveshje mundësuan hyrjen e emigrantëve ekonomikë në Gjermani. Kriza e naftës e vitit 1973 dhe recensioni që vijoi, ndërpreu punësimin e fuqisë punëtore të huaj. Nga përafërsisht 14 milion punëtorë emigrantë, rreth 11 milion prej tyre u kthyen në vendet nga kishin ardhur.

Fjala Gastarbeiter, që në gjermanisht do të thotë: punëtor mysafir, u krijua për të përshkruar këta emigrantë, duke nënkuptuar që qëndrimi i tyre në Gjermani ishte i shkurtër dhe vetëm për qëllime punësimi. Si vend komunist që ishte, Jugosllavia ishte rast i veçantë. Një nga pasojat e reformave ekonomike që u ndërmorën në vitin1965 në Jugosllavi, ishte rritja e papunësisë. Në mënyrë që të shmangnin ndikimet negative për shoqërinë dhe ekonominë, autoritetet jugosllave lejuan që punëtorët të punonin përkohësisht jashtë vendit. Në shumë rasteve, këto qëndrime të "përkohshme" u kthyen në të përhershme. Shumica e punëtorëve jugosllavë në vendet pritëse ishin nga Bullgaria dhe Bosnje-Hercegovina.

A. Kombësi të huaja në Republikën Federale të Gjermanisë në vitet 1970-1990

Emigrimi vjetor në Republikën Federale të Gjermanisë (% vjetore e etnive të huaja në Gjermani).

Viti	Italianë	Spanjollë	Grekë	Shtetasit e ish-Jugo-sllavisë	Turq
1970	23.1	11.8	7.7	15.0	6.5
1975	17.4	16.2	16.8	14.8	13.8
1980	12.5	5.6	7.5	6.5	4.8
1981	12.9	5.0	5.3	6.3	4.6
1982	13.6	6.0	6.0	6.5	5.5
1983	12.7	6.1	6.5	5.9	6.5
1984	11.3	5.8	5.8	5.6	15.0
1985	9.7	5.1	5.8	5.2	4.3
1990	6.2	4.5	4.5	5.8	2.1
1995	5.8	5.4			

Aver and Şentürk (eds.), 2013, fq. 29.

B. Popullsia turke në Gjermaninë Perëndimore, 1961-1991



Zentrum für Türkeistudien, Statistisches Bundesamt in Meyer, 2002, fq. 2.

C. Klasë me nxënës turq në një shkollë në Gjermani (1969).

Klasë me nxënës turq në shkollën " Elsa-Brandström" në Frankfurt am Main. Fotografia bërë nga Abisag Tüllman.
http://germanhistorydocs.ghi-dc.org/sub_image.cfm?image_id=625, parë më 6.09.2016.

Megjithëse të dyja qeveritë dhe vetë Gastarbeiterat, mendonin se do qëndronin në Gjermani për një kohë të shkurtër, një numër i madh i tyre qëndruan për periudha shumë më të gjata, dhe filluan t'i merrnin familjet në Gjermani. Fëmijët e tyre, që ishin rritur në atdhe nga mamatë apo gjyshërit, filluan të ndiqnin shkollën në Gjermani. Në mënyrë që ta mundësonin riatdhesimin e imigrantëve, Gjermania i lejoi vendet dërguese që t'iu bënin fëmijëve kurse të gjuhës së tyre amtare. Kjo politikë hasi edhe qëndrime kundërshtuese pasi shkurajonte fëmijët për të mësuar gjuhën që flitej në vendin ku jetonin.

Sammlung Tsakmaki / DOMiD-Archiv, Köln.

D. Largimi nga Shqipëria me mendimin se do të rikthehen në vendlindje

Pavarësisht rritjes vjetore prej 6% në vitet 1953 deri në fund të viteve 1960, dhe nga mesi i viteve '60, numri i punëtorëve emigrantë kryesisht në Australi, Vendet e Ulëta dhe Gjermaninë Perëndimore, përbënin pothuajse 3% të popullsisë së vendit.

E. Punonjëse mysafire me origjinë greke(1963)

Në një fabrikë prodhimi pijesh alkoolike në Hamburg. Fotografia e bërë nga Gerd Mingram [Germin].
http://germanhistorydocs.ghi-dc.org/sub_image.cfm?image_id=2368, parë më 6.09.2016.

Në fund të viteve 1960, 30% e të gjithë punëtorëve mysafirë në Republikën Federale të Gjermanisë ishin femra. Më së shumti, emigrantet punonin në në industrinë e manifakturës: në industrinë e tekstileve dhe veshjeve, në industrinë e metaleve dhe atë elektrike, si edhe në ato të ushqimit dhe të mirave të luksit. Gjithashtu, shumë prej punëtoreve mysafire ishin punësuar në sektorin e shërbimeve, si: në restorante, në shëndetësi si infermiere dhe sanitare.

1. Studioni me kujdes kapitujt VI-1A dhe VI-1B, më pas diskutoni në klasë për pyetjet e mëposhtme. Pse mendoni se numri më i madh I Gastarbeiterve ishin nga Mesdheu? Pse u shpërngulën grekët, jugosllavët dhe turqit për të kërkuar punë në Gjermaninë Perëndimore? Pse mendoni se u pakësua numri i emigrantëve pas vitit 1980 për në Gjermani? Çfarë tregon shtimi i numrit të emigrantëve turq në Gjermani? Cila ishte situata (politike, shoqërore) në vendet dërguese gjatë viteve 1950 dhe 1960? A ishte i organizuar shtetërisht migrimi në atë kohë? Krahasojeni me situatën e fluksit të migrimit në vitet 2015-2016. Diskutoni për situatën e refugjatëve dhe migrantëve.

2. Lexojeni çelësin me kujdes dhe më pas vëzhgoni fotografinë VI-1C. (a) Kishte shkolla për fëmijët migrantë të shtetit tuaj në Gjermani? (b) Imagjino sikur ju jeni një nga ata fëmijë të sapoardhur nga atdheu juaj. Si do të ndiheshit? Çfarë mendoni se do bënit gjatë pjesës së mbetur të ditës pasi të mbaronit orët e mësimit në shkollë? Mendoni se do ishte e thjeshtë të përfshiheshit dhe të komunikonit me fëmijët e shtetit pritës? (c) Përshkruani disa probleme të mundshme dhe tregoni se si do t'i përballonit ato, ose shkruani një faqe ditari ku të përshkruani mendimet dhe ndjenjat tuaja.

3. Vëzhgoni fotografitë e paraqitura në kapitujt VI-1D dhe E. Përshkruani dhe komentoni për gjuhën trupore të meshkujve. Çfarë tregon ajo? Si mendoni se ndihen meshkujt e paraqitur në fotografi? Vendoseni veten në vendin e tyre dhe përshkruani se si do ishit ndjerë ju në atë kohë. Më pas vëzhgoni fotografinë me punëtoret femra dhe lexoni çelësin përkatës. Pse mendoni se përmenden punëtoret që punojnë në industri (kini parasysh që janë të gjitha nga i njëjti shtet)? Bëni një krahasim midis tyre dhe gjendjes së tanishme të migranteve në shtetin tuaj. Çfarë punësh bëjnë ato?

4. Projekt: **I.** Ndajeni klasën në katër grupe. Grupi i parë do të kërkojë dhe gjejë dëshmi gojore të migrantëve që kanë jetuar dhe punuar në shtetet e Evropës Perëndimore gjatë viteve 1950, 1960 apo 1970. Mund të flasin me shokët e klasës apo me nxënësit e klasave të tjera. Përpos regjistrimit të dëshmive, ata do të marrin edhe fotografitë origjinale dhe dokumente të tjera si letra, kontrata, artikuj gazete, etj. Grupi i dytë do të gjejë filma (të kinemasë kombëtare dhe ndërkombëtare) për temën (migrimi në atë kohë). Grupi i tretë do të gjejë të dhëna për mënyrën se si gjini të tjera artistike e kanë trajtuar temën (romanet, muzika, teatri, fotografia). Grupi i katërt do të merret me gjetjen e materialeve për gjendjen e tanishme të fluksit të migrimit në Mesdheun e Jugut dhe të Lindjes (fotografi, artikuj, krijime letrare), dhe krahasojeni këtë lloj migrimi me atë të mëparshmin. Të gjitha grupet duhet të bëjnë një prezantim të gjetjeve të tyre me anë të një rrëfimi të plotë, që mund të prezantohet duke performuar (narrativë teatrale apo dialog) dhe/ose duke përdorur multimedien. Gjithashtu, mund të përgatisni dhe të botoni (botim digjital apo në letër) një libërth me histori të shkurtra mbështetur në dëshmitë gojore të gjetura nga ju. Përqendrohuni në përvojat e problemeve të jetës së përditshme në të shkuarën, duke evidentuar dhe historitë dhe sjelljet pozitive, jo vetëm ato negative.

II. Hapni një faqe Facebook-u (ose një faqe Wikipedia) me emrin, për shembull, Projekt për migrimin. Aty mund të ngarkoni gjetjet tuaja dhe mund të komentoni dhe diskutoni për punën tuaj. Vetëm shokët e shkollës apo njerëz të tjerë, mund të hyjnë në këto faqe.

VI-2. Fluksi i emigrimit nga Bullgaria

Grupet etnike	Shtetet/Kontinentet pritëse	Vitet	Numri i emigrantëve
Bullgarë – migrantë politikë dhe ekonomikë	Evropë, Kanada, SHBA, Australi	1944-1989	15,000
Taurianë (Bullgarë të Krimesë)	BRSS	1944	2,000
Armenë	BRSS	1946-1949	5,000
Çekë, Sllovakë	Çekosllovaki	1947-1951	2,000
Hebrenj	Izraeli	1947-1953	45,000
Turq	Turqi	1949-1951	155,000
Turq	Turqi	1969-1978	115,000
Turq	Turqi	1989	322,000
Gjithsej		**1944-1989**	**661,000**

Gruev, 2009, fq. 378.

1. Sipas burimeve të kapitullit VI.1, thuajse të gjithë shtetet e Evropës Juglindore përjetuan flukse mjaft të mëdha të emigrimit. Pse mendoni se ka ndodhur kjo? Si ndikuan këto flukse te shtetet në fjalë? Ku emigruan numri më i madh i migrantëve? Krahasojeni situatën me gjendjen e tanishme të krizës së refugjatëve.

2. Bëni një listë të të gjitha shkaqeve të migrimit në Gjermani. Ndajini në faktorë shtytës dhe tërheqës.

VI.2. MINORITETET

VI-3. "Procesi i ringjalljes" në Bullgari dhe "Ekskursioni i madh" i turqve të Bullgarisë

Në fillim të vitit 1985, funksionarët e lartë të Partisë Komuniste të Bullgarisë filluan të flisnin për një "Proces ringjalljeje" në Bullgari. Ky term u përdor si referim i fushatave të njëpasnjëshme asimiluese që u ndërmorën kundër turqve të Bullgarisë, bullgarëve myslimanë (pomakët) dhe romëve myslimanë (ciganët), që ndryshe nga fushatat e mëparshme, u krye në një mënyrë shumë sistematike dhe në një shkallë masive. Fushata mbështetej në një teori historike, që ishte krijuar posaçërisht për këtë qëllim. Sipas kësaj teorie, turqit e Bullgarisë ishin pasardhës të bullgarëve etnikë. Si rrjedhojë, "Procesi i ringjalljes" u përshkrua si "si konsolidim i unitetit të kombit socialist të Bullgarisë dhe homogjenitetit të tij etnik." Të gjithë emrat arabë dhe turq që mbanin nënshtetas të Bullgarisë, u kthyen në emra sllavë, dhe traditat dhe kulturat fetare myslimane u ndaluan të praktikoheshin. Gjatë katër viteve pasuese të "konsolidimit", afro 850,000 shtetas bullgarë u detyruan të ndryshonin emrat, të mos flisnin më turqisht, të mos vishnin veshjet tradicionale në publik (më së shumti shallvaret e femrave) dhe praktikimi i ritualeve myslimane u ndalua dhe në të kundërt mbartësit e tyre persekutoheshin. Xhamitë u mbyllën dhe vizitorët e tyre u cilësuan si besimtarë të "besëtytnive banale". Ritualët e varrimit myslimane u zëvendësuan nga ato qytetare, ndërkohë që syneti u ndalua me ligj. Të gjitha këto masa për "pastrimin e vetëdijes kombëtare" u zbatuan me anë të pjesëmarrjes aktive të ushtrisë dhe policisë dhe kjo u arrit përmes rrahjeve, kërcënimeve dhe burgosjeve në kampe të punës së detyruar dhe burgje, internim të brendshëm dhe forma të tjera të dhunës dhe forcës kundrejt qytetarëve bullgarë me origjinë turke, që refuzonin t'iu bindeshin direktivave të Partisë.

Reagimet e turqve të Bullgarisë ndaj "Procesit të ringjalljes" ishin kontradiktore.

Reagimet fillonin që nga zbatimi i pjesshëm i direktivave të Partisë, e deri te protestat individuale dhe kolektive apo demonstratat e hapura. Këto

ishin thelbësore në fillim të fushatës së viteve 1984-1985 dhe përsëri në atë të vjeshtës së vitit 1989, kur absurditeti e përpjekjes për asimilim me forcë, filloi të bëhej edhe më e qartë me perestroikan e Bashkimit Sovjetik dhe sjelljen e komunitetit ndërkombëtar.

Masa e fundit e ndërmarrë nga Partia dhe qeveria e Bullgarisë kishte si qëllim "nxitjen" e emigrimit në masë drejt Turqisë. Në një deklaratë të transmetuar nga Televizioni Kombëtar Bullgar dhe Radioja Kombëtare Bullgare, më 29 maj të vitit 1989, Todor Zhivkofi iu kërkoi "bashkatdhetarëve", që nuk ndiheshin si bullgarë dhe që nuk e mendonin Bullgarinë si atdheun e tyre, të largoheshin dhe të shkonin në Turqi. Gjithashtu, i kërkoi qeverisë turke që t'i pranonte imigrantët. Ai u shpreh shumë qartë që "Sipas normave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, Turqia duhet t'i hapë kufijtë për botën." Ndërmjet 3 qershorit dhe 21 gushtit të vitit 1989, kur Turqia mbylli kufijtë, rreth 360,000 shtetas u larguan nga Bullgaria. Para se të ndodhte kjo, në pranverë të vitit 1989, me mijëra turq të Bullgarisë, intelektualë dhe/ose persona të konsideruar si "jo të besuar" u dëbuan në mënyrë selektive drejt Perëndimit, përmes Jugosllavisë, ose drejt Turqisë.

Burra, gra dhe fëmijë të moshave, gjendjeve shoqërore dhe profesioneve të ndryshëm, u detyruan të largoheshin nga vendlindjet e tyre, të ndaheshin nga familjet, t'i shisnin pronat e tyre me çmime qesharake dhe të kërkonin një jetë të denjë larg atdheve të tyre. Megjithatë, në fund të vitit 1990, më shumë se 150,000 të shpërngulur ishin rikthyer në Bullgari. Pjesa tjetër ishte vendosur më së shumti në Stamboll, Bursa, Izmir dhe në qytete dhe qyteza të tjera të Turqisë Perëndimore. Teksa qeveria Bullgare këmbëngulte që eksodi ishte i vullnetshëm, media krijoi një fjalë të re për dukurinë e emigrimit të detyruar të turqve të Bullgarisë, që në mënyrë ironike njihet si "Ekskursioni i madh."

Gjatë kësaj kohe kishte mospajtime jozyrtare apo protesta masive të organizuara nga disa intelektualë bullgarë, që u bënë shumë të njohur për publikun si pjesëtarë të grupeve që paraqitën kërkesa politike nga organizatat e para jo konformiste, që u shfaqën në Bullgari gjatë viteve 1988-1989. Më 11 janar të vitit 2012, Kuvendi Kombëtar i Bullgarisë miratoi një rezolutë, që deklaronte si më poshtë: "Deklarojmë se dëbimi i më shumë se 360,000 qytetarëve bullgarë, me prejardhje turke, ishte një mënyrë e spastrimit etnik e kryer nga regjimi totalitar".

VI-4. Mohamed Hyseinov, i lindur si Uzunkësh; Një turk i Bullgarisë flet për ndryshimin e emrit

Jam rritur duke e menduar veten si turk. Të rriturit mblidheshin gjithmonë dhe thoshin se kishim të afërm në Turqi dhe që do të aplikonim për viza. Madje, na bënë edhe disa fotografi për pasaporta. Prisnim nga momenti në moment që të emigronim, por nuk ndodhi gjë. Dëgjoja më të rriturit që thoshin se jeta në Turqi ishte shumë e mirë; por në shkollë na thoshin të kundërtën. Na thoshin se jeta atje ishte e vështirë dhe se Turqia ishte vend kapitalist...Arrita të gjeja një të mesme të artë. Thosha: -Jam turk, por jetoj në Bullgari. Atdheu im është Bullgaria. Heronjtë bullgarë nuk kishin luftuar kundër turqve si unë apo kundër popullit turk, por kundër sulltanit dhe makinerisë qeveritare të perandorisë. Ndaj më dukej fyese kur ata thoshin "Skllavëria turke", kur në të vërtetë ishte osmane. Padyshim që një turk i thjeshtë nuk kishte jetë më të mirë se vëllai i tij bullgar, që të dy jetonin në mjerim.

Një vit para se të filloja shkollën e mesme, u mor vesh që disave prej shokëve të shkollës ua kishin ndryshuar emrat. Më parë quhej Hasan, ndërsa tani Hristo. Por e vërteta ishte më e tmerrshme se kaq. Ata i drejtoheshin njëri-tjetrit me emrat e vjetër arabë. Po kështu donin që t'i thërrisnim edhe ne. Më treguan se si ndryshohej emri. Por e gjitha kjo ishte e pakuptimtë. Nuk e mendoja dot që mund të ta ndryshonin emrin pa dëshirën tënde. Më pas kuptova që shteti ishte një makineri e tmerrshme, që mund të të nënshtronte, dhe që ideologjia e Partisë mund të të ndryshonte me forcë.

Gjëja e parë që vendosëm të bënim ishte të organizoheshim me anë të ambasadave të huaja dhe me anë të radiove dhe të lajmëronim njerëzit për atë që po iu ndodhte turqve në Bullgari. Mendonim se kështu mund ta ndalonim "Procesin e ringjalljes." U vura në kërkim të njerëzve, në kërkim të njerëzve të çmendur mjaftueshëm sa të thoshin se ishin kundër këtij procesi [...]. Organizatën e quajtëm "Uzun kış", që në bullgarisht do të thotë: "Dimër i gjatë." E zgjodhëm këtë emër sepse ishte dimri më i gjatë dhe më i tmerrshëm që kishim përjetuar. Sepse kishim vendosur që do të bënim qëndresë deri kur të na rivendosnin emrat dhe të na rikthenin të drejtat dhe liritë tona. U bëra udhëheqës [...]. Nuk i njihja të gjithë anëtarët dhe as ata nuk më njihnin mua. Njihnim vetëm

grupe të caktuara.

Ndiqnim këtë praktikë sepse donim të siguroheshim që në rast dështimi, viktimat të ishin të pakta. E dija se çfarë do të bëja dhe kundër kujt po ngrihesha. Të them të vërtetën, në atë kohë as që më shkonte nëpër mend të rrëzoja komunizmin, Zhivkovin, etj. Ne as nuk e kuptonim se çfarë ishin komunizmi dhe demokracia, jo më të dinim të kërkonim autonomi. Kjo ishte thjesht propagandë e regjimit. E vetmja gjë që donim ishte të na rivendosnin emrat [...]. Filluam të mblidhnim të dhëna për rastet e abuzimit, të drejtave të shkelura, të njerëzve që mbaheshin në kampet e punës dhe thjesht përshkruam atë që po ndodhte.

Ivanova dhe Mutafchieva, 2005, fq. 450-451, 453, 458-459.

Si mundi Mohamed Hyseinovi, i lindur si Uzunkësh, të pajtohej me origjinën e tij turke duke marrë parasysh faktin se ishte shtetas bullgar? Çfarë e bëri të ndryshonte mendjen dhe t'iu kundërvihej autoriteteve bullgare (vini re që ai thotë: "Ne as nuk e kuptonim se çfarë ishin komunizmi dhe demokracia")? Diskutoni për përpjekjet e autoriteteve për të ndërhyrë në "zdrukthimin" e identitetit personal të një personi (me anë të ndryshimit të emrit, arsimimit, etj.).

VI-5. Migrimi i detyruar i turqve bullgarë

A. A. Turqët bullgarë duke kaluar kufirin për në Turqi

http://frognews.bg/news_12406/Jivkov_Gonim_300_000_turtsi_inak_stavame_Kipar/, parë më 21.09.2016.

B. Deklaratë nga Todor Zhivkov transmetuar në Televizionin Kombëtar Bullgar dhe Radion Kombëtare Bullgare, më 29 maj të vitit 1989.

Siç është njoftuar në shtyp, këto ditët e fundit në disa pjesë të vendit situata është tensionuar shumë ndërmjet disa grupeve të veçanta të popullsisë. Kjo situatë është nxitur nga fuqitë e huaja dhe ka lidhje me ligjet për pasaportat e huaja dhe shtetësinë bullgare të miratuara nga Kuvendi Kombëtar.

Së pari: Është fakt historik që falë fitores së revolucionit socialist dhe shtetit tonë socialist, popullsia myslimane është nxjerrë nga errësira, mjerimi dhe padrejtësitë me të cilat i kishte dënuar Perandoria Osmane. Bullgaria kapitaliste nuk mundi ta bënte këtë.

Së dyti: Është fakt historik, që Republika Popullore e Bullgarisë është atdheu i të gjithë atyre që kanë lindur në këtë tokë, ku prehen eshtrat e paraardhësve të tyre dhe ku fëmijët e tyre i hapin sytë për herë të parë.

- Popullsia islamike bullgare nuk e ka origjinën nga asnjë vend tjetër. Bullgaria është atdheu i vetëm i saj. Ka jetuar, jeton dhe do vazhdojë të jetojë në Bullgari.

- Kjo Bullgari është e të gjithëve ne, pavarësisht fesë dhe traditave tona. Jemi bijtë e saj dhe na kërkohet që të kryejmë detyrën tonë si fëmijë dhe të kujdesemi për të.

Fatkeqësisht, së fundmi disa grupe në Republikën e Turqisë janë përfshirë në përshkallëzimin e fushatës kundër Bullgarisë.

Më pas, "regjisorët" e fushatës kundër Bullgarisë, filluan të merreshin me çështjen e emigrimit, duke deklaruar kudo se Turqia ishte e gatshme të pranonte të gjithë myslimanët e Bullgarisë që donin të emigronin. Lidhur me këtë, në emër të myslimanëve të Bullgarisë dhe në emrin tim si Kryetar i Këshillit të Shtetit, dua t'iu drejtohem autoriteteve kompetente turke me këtë thirrje urgjente:

- Hapni kufijtë tuaj për të gjithë myslimanët e Bullgarisë, që duan të shkojnë në Turqi për një kohë të shkurtër apo përgjithmonë.

http://www.znam.bg/com/action/showArticle;jsessionid=6B2F304C789043834EF7E08F47860247?encID=628&article=334750291, parë më, 21.09.2016.

C. Reagimet në Turqi: Fjalimi i Özal në Bursa më 17 gusht të vitit1987

Fatkeqësisht, Bullgaria ka nisur një përpjekje, për të ndryshuar emrat e bashkatdhetarëve tanë që jetojnë atje. Për këtë arsye, Presidenti ynë dërgoi atje një përfaqësues të posaçëm. Ne u ankuam duke thënë: "Çfarë po ndodh kështu?" Ata na u përgjigjën: "Sidoqoftë, ju nuk i doni." Dërgova një letër menjëherë pas kësaj, që thoshte: "Edhe nëse janë dy milionë do i marrim që të gjithë, por a do na i jepnit ju?"

E tillë është çështja. Nuk kanë ndërmend ta bëjnë këtë. Të them të vërtetën, ajo që kemi kuptuar ne është se ata i frikësohen rritjes së numrit të turqve atje. Ky është përfundimi që kanë nxjerrë të gjitha studimet. Ama, një gjë është e sigurt, nuk do t'i braktisim. Kjo nuk do të ndodhë. Do vazhdojmë të ushtrojmë presion ndaj autoriteteve bullgare dhe herët apo vonë do ta zgjidhim këtë çështje. Ashtu siç bëmë edhe në Qipro. Mos u shqetësoni. Në Qipro nuk ka mbetur më nga ajo flaka e dikurshme. Madje, as grekët nuk janë më aq të flaktë. Nuk flasin më për çështjen e detit Egje. Për momentin e menaxhojmë situatën duke këmbyer mesazhe. Për çfarë bëhet fjalë e gjitha kjo atëherë? E përmenda që në fillim. Ka të bëjë me faktin që Turqia është e pushtetshme. Sot Turqia ka një popullsi prej 52 milionë njerëzish. Është shtet i fuqishëm, por duhet që t'i ketë të tilla edhe ekonominë edhe Forcat e Armatosura.

Dağlıoğlu, 2014, fq. 176.

D. Ndarja e turqve që emigruan nga Bullgaria drejt Turqisë, bazuar në gjininë dhe mbështetur në të dhënat e Censusit të vitit 1992

Viti	Gjithsej	Femra	Meshkuj
1989	218,000	111,568	106,432
1990	71,195	31,326	39,869
1991	32,164	13,900	18,264
1992	23,490	10,336	13,154
Total	344,849	167,130	177,719

Dağlıoğlu, 2014, fq. 176.

E. Ekstrakte nga intervista me Ismet Severin, një turk i Bullgarisë

Bullgaria dhe Turqia kishin nënshkruar një marrëveshje për migrimin, për të cilin ne nuk dinim gjë fare. Ne thjesht na dhanë pasaportat. Na thanë që duhet t'iu përmbaheshim dispozitave të kësaj marrëveshjeje dhe që të na jepnin pasaportat duhet të emigronim brenda muajit [...] Nuk them dot që na detyruan, (buzëqesh) por në atë kohë askush nuk thoshte që Partia të detyronte të bëje gjë. E vetmja gjë që bënte Partia është se të lajmëronte për atë që kishte vendosur! [...] Mendoj se një nga gjërat më të vështira për një njeri është ta largojnë nga vendlindja e tij.

Pavarësisht se në cilin vend të botës bëhet, nuk ka gjë më të rëndë dhe më të keqe se kjo! [...] E vetmja gjë që ndjeva ishte dhimbje pasi po ndahesha nga diçka që kishte vlerë shumë të madhe për mua. U ndjeva sikur po më hiqnin një pjesë të rëndësishme nga vetja. U ndjeva si një këlysh i braktisur. Nuk dija kujt t'ia vija fajin, kujt t'i ankohesha, apo më kë të flisja. E vetmja gjë për të cilën isha i sigurt është që vendlindja ime ishte këtu, në Bullgari.

Kur filloi "Ekskursioni i madh", isha kryesekretar i organizatës së emigrantëve në Turqi. Jo si kryesekretar, por si njeri, e ndjeva që e kisha për detyrë t'i ndihmoja ata njerëz. E dija si ndiheshe të shkoje i vetëm në një vend të panjohur, në një vend ku nuk njihje askënd dhe ku nuk e dije se çfarë të priste [...]. Kam kaluar disa javë dhe muaj të gjatë te stacioni i trenit në Edrene dhe kam kujtime shumë të hollësishme të asaj kohe. Dritaret, dyert, kubetë dhe kolonat ishin të mbushura me shënime. Familjet i përdornin këto shënime, si mënyrë për t'iu dërguar mesazhe njerëzve të tyre të dashur, vëllezërve, motrave, nënave, djemve, etj. Në shënime shkruhej: "Bir, jemi në Bursa te shtëpia e tezes" ose "Motër, jam në Kirklareli te shtëpia e xhaxhit." Asnjëherë nuk do më hiqet nga mendja një grua e moshuar, që ishte ulur në trotuar dhe po qante. E dija që duhet ta ngushëlloja. Fillova t'i thosha se edhe këtu kishte njerëz, që ajo duhet të gjente fuqinë për ta mposhtur këtë tragjedi... Ajo vazhdoi të qante. Pastaj më pa me ata sytë e saj të përlotur dhe më tha se po qante për viçat e gjorë që i kishte lënë vetëm të mbyllur në kasollen e tyre. Kaq me nxitim iu desh të largohej nga shtëpia, saqë nuk kishte mundur t'i rregullonte siç duhej bagëtitë e gjora.

Mutafchieva dhelvanova, 2005, fq. 317-318, 320.

Një rast i rrallë i mënyrës se si një regjim autoritar kryen asimilimin është duke heshtur dhe zhdukur etnitë e tjera, me anë të ndryshimit të emrave të turqve të Bullgarisë, dhe duke i detyruar të shpërngulen masivisht në Turqi gjatë viteve 1980. Çfarë pasojash patën këto masa në shoqëritë bullgare dhe turke? Çfarë ndikimi patën tek emigrantët? Pse shkaktoi tensione shoqërore prania e të sapoardhurve, që fillimisht u mirëpritën nga vendi pritës? Bëni një lidhje ndërmjet kësaj dhe mënyrës se si trajtohen sot migrantët dhe refugjatët në vendet e rajonit.

VI-6. Fjalim mirëseardhjeje për kadetët hebrenj të pranuar në Akademinë Ushtarake të Stambollit

Marrëdhëniet e Turqisë me Gjermaninë naziste gjatë Luftës së Dytë Botërore frikësuan shumë nga hebrenjtë e këtij vendi, që i trembeshin faktit se qeveria do merrte masa kundër tyre.
Për këtë arsye, vendimi i Ankarasë për të qëndruar vend neutral i qetësoi ata, megjithatë pas përfundimit të luftës dhe ndërmjet viteve 1948 dhe 1951, rreth 34,547 hebrenj turq (rreth 40% e numrit të përgjithshëm) u larguan drejt Izraelit. Në vitin 1946, Akademitë Ushtarake të Turqisë, që deri në këtë kohë pranonin vetëm qytetarë të të njëjtës fe dhe racë, si vetja, filluan të pranonin dhe kadetë që nuk ishin turq apo myslimanë.

Dëshira për të hyrë në akademinë ushtarake, nënkupton se e do dhe e mbështet ndjenjën e të qenit turk, kulturën turke, atdheun turk [...]. I shoh që tani ata dy qytetarë hebrenj si oficerë të ardhshëm turq, me shpatat e tyre të shkëlqyeshme dhe dashurinë për vendin e tyre, që i shtojnë bashkimit kombëtar një komunitet që ka vite i ndarë.

Düzgün, 2000, fq. 24.

VI-7. Dëbimi i grekëve nga Stambolli, Viti 1964

Ndërmjet marsit dhe shtatorit të vitit 1964, 12,387 persona, shtetas grekë u dëbuan nga Stambolli me pretekst "sigurinë kombëtare". Personat që ishin jashtë vendit në kohën kur marrëveshja e vizave për qëndrim, tregti dhe udhëtim u anulua, nuk u lejuan të ktheheshin më. Ata që ishin në Stamboll në shtator të vitit 1964, nuk u lejuan të rinovonin lejet e tyre të qëndrimit dhe u detyruan të largoheshin.

Dëshmitë personale të të dëbuarve

Dionisis Agelopulos (Athinë): Më kujtohet që ishte ditë e premte, datë 17 korrik 1964. Shkuam te divizioni i katërt. Na u desh të nënshkruanim deklaratat. Pashë daktilografistin dhe ai më tha: "Mos e lexo (deklaratën). Nuk është punë për ty ajo." Më pas na morën shenjat e gishtave dhe na bënë fotografi […]. Na kontrolluan dhëmbët për të parë nëse kishim dhëmbë floriri, apo jo.

Znj. Eleni (Imvros): Po ashtu edhe ime më (që është e ve)

kishte shtetësi greke. Ajo i kalonte të 60-at. Ku do të shkonte kjo grua?! Vëllezërit më ishin larguar. Çfarë mund të bënte ime më? I thashë asaj: "Do të të martojmë. Do të marrësh nënshtetësinë turke." Ajo ishte a pashkolluar […]. "Do të martohem? më pyeti: "Je mirë, bija ime, mos ke luajtur mendsh?" Ishte një burrë të cilit i kishte vdekur e shoqja. U martua me mamanë time. U ndanë vetëm pas disa ditësh. Sigurisht që i dhamë para atij. Deri në këtë pikë arritëm. E martuam dhe time ëmë në atë moshë që kishte.

Irini Brindesi (Athinë): Prindërit e mi patën shumë probleme kur arritën këtu. Ne ishim të vegjël dhe e patëm më të lehtë. Fëmijët përshtaten lehtë, por për të rriturit është më e vështirë. Im atë ishte njeri i mirë, por ishte në një gjendje shumë të vështirë. Fliste në gjumë dhe bërtiste: "Mos më dëboni!" Këtë ëndërr e shihte gjatë gjithë kohës, madje deri ditën kur vdiq. As unë nuk do e harroj kurrë. Sepse këto gjëra nuk harrohen asnjëherë. Sepse nuk është e mundur të fusësh në valixhe një shtëpi, që e ke ndërtuar gjatë viteve.

Ahmet Tanriverdi (Stamboll): Disa njerëz ishin kaq të papërgatitur, saqë kishin lënë frigoriferin në prizë me idenë se do të kthehesin përsëri. Pasi kyçën shtëpitë e tyre, dy burra ia sollën çelësat mamasë sime dhe i thanë: "Do kthehemi, por ndërkohë na i mbaj këto çelësat." Por nëse nuk kthehemi shpejt, na i hiq frigoriferët nga priza dhe ushqeji macet".

Büyüktaşçıyan (ed.), 2014, fq. 25, 30, 31, 42.

Grekët e dëbuar ishin të vetmit që u lejuan të merrnin me vete bagazh me peshë deri në 20 kg, dhe 20 dollarë. Shikoni videon e projektit "20 dollarë, 20 kilogramë" që paraqet dëshmi gojore, të printuara, materiale pamore, etj. në: https://www.youtube.com/ watch?v=8fOmZrvgLRk, parë më 6.09.2016. Çfarë do merrnit me vete nëse do lejoheshit të merrnit vetëm 20 kg dhe nuk do lejoheshit të kthehesh më?

VI-8. Ekstrakte nga një Raport i Punëve të Brendshme për myslimanët e Turqisë dhe Shqipërisë, që emigruan nga Republika Popullore e Maqedonisë në mes të viteve 1950

Gjatë dy viteve të fundit, emigrimi i minoritetit kombëtar turk nga Maqedonia drejt Turqisë, që ka filluar në vitin 1951, ka vazhduar pa ndalur dhe krahas kësaj, numri i personave që dëshirojnë të imigrojnë në Turqi është rritur goxha.

Kjo tregohet qartë nga tabela pasardhëse me të dhënat mbështetur në numrin e aplikimeve të bëra për të hequr dorë nga kombësia e tyre, të dorëzuara nga anëtarët e minoriteteve kombëtare turke në Republikën Popullore të Maqedonisë:

Aplikime të bëra në vitin 1951	24 persona
Aplikime të bëra në vitin 1952	212 persona
Aplikime të bëra në vitin 1953	2,240 persona
Aplikime të bëra në vitin 1954	23,343 persona
Aplikime të bëra në vitin 1955	38,142 persona
	Gjithsej: 63,961 persona

Nga 59,340 persona gjithsej, aplikimet e të cilëve janë miratuar, 46,327 prej tyre kanë aplikuar për pasaportë. Në fund të vitit 1955, u ishte dhënë pasaportë 46,155 personave. […]

Njëkohësisht, shumë shqiptarë kishin aplikuar për emigrim. Për të shmangur emigrimin e shqiptarëve, vendi u nda në rajone të caktuara, ku lejohej heqja dorë nga shtetësia dhe ndalohej emigrimi. Mbështetur në këtë ndarje, të gjithë anëtarët e minoritetit turk, po ashtu edhe shqiptarët, që jetonin në qytetet dhe qarqet e mëposhtme, kishin të drejtë të hiqnin dorë nga shtetësia e tyre: Titov Veles, Tikvesh, Gevgelija, Strumica, Shtip, Koçani, Maleshevo, Prilep, Resnjë dhe Manastir. Këto vende kanë popullsi të madhe turke, ndërsa numri i shqiptarëve është i papërfillshëm […]. Emigrimi ishte i ndaluar në qarqet ku pjesa më e madhe e popullsisë ishte shqiptare.

Sekretaria Shtetërore e Punëve të Brendshme, Zyra Kombëtare e Sigurisë, Shkup, 12 janar 1956. Dokument i arkivës, Akademia Maqedonase e Shkencave dhe Arteve, Fondi Lazar Kolisevski, libri 43, dosja II, AE 25.

Kolektivizimi i bujqësisë, përcaktimi kufijve për pronësinë e tokës (maksimumi 10 hektarë për shtëpi në fshat) dhe shtetëzimi i pronave private ishin të favorshme për migrimin e myslimanëve të Turqisë. Të gjitha këto ndikuan sidomos te pronarët e mëdhenj, artizanët dhe tregtarët turq në qytet. Krahas kësaj, në vjeshtë të vitit 1949, autoritetet ndërmorën masa për ndalimin e përdorimit të jashmakut (mbulesë). Të parët që iu kundërvunë këtyre ndryshimeve dhe masave ishin përfaqësuesit më të spikatur fetarë, dhe më pas iu kundërvunë edhe Konsullata Turke dhe organizata "Yücel". Dokumentet tregojnë se mes viteve 1953 dhe 1957, rreth 105,000 myslimanë të Turqisë dhe 5,000 myslimanë të tjerë shqiptarë u larguan nga Republika Popullore e Maqedonisë.

VI-9. Folësit sllavë dhe ritualet publike në Greqi

Pas bashkimit të më shumë se gjysmës së asaj që përshkruhej si Maqedonia Osmane me shtetin Grek, diktatori I. Metaksas (1936-1941) ndoqi një politikë asimilimi ndaj popullsive sllavishtfolëse të mbetura në vend. Ekstraktet e marra nga publikimet e shtypit, tregojnë për ritualet publike që zhvilloheshin në korrik të vitit 1959 në fshatin Kardia, që ndodhej në qendër të Maqedonisë Greke, gjatë të cilave 692 (sipas censusit të popullsisë së vitit 1951) sllavishtfolës u betuan si më poshtë:

Betohemi solemnisht para Zotit dhe njerëzve, si pasardhës autentikë të grekëve të lashtë, që në të ardhmen nuk do të përdorim asnjëherë gjuhën sllave në asnjë vend.

Kostopoulos, 2000, fq. 236.

VI-10. Ekstraktet nga intervista e bërë në fund të viteve 1980 me një mësues të gjuhës frënge (lindur në vitin 1958) për marrëdhëniet e asaj kohe mes romëve (Rom/Ciganë) dhe Rumunëve, që jetonin në një komunë rreth 40 km larg nga Iashi

Grajduri kishte një problem tjetër dhe ai ishte lagjja e komunitetit rom. Kishte një "qytezë" rome që kishte shtëpi me çati prej teneqeje dhe që ekziston ende. Fëmijët romë regjistroheshin në shkollë gjithmonë në klasë të parë. Më kujtohet një herë, që u mblodhëm një grup njerëzish, drejtori me gjithë mësuesit dhe shkuam në lagjen rome, që t'i merrnim fëmijët dhe t'i sillnim në shkollë. E kishim për detyrë t'i bindnim. Kur shkuam atje, pamë një shtëpi shumë të madhe, ndryshe nga shtëpitë karakteristike të tyre. Ishte shumë e bukur, por nuk kishte as dyer e as dritare […]. Fëmijët romë nuk shkonin në shkollë. Kjo nuk kishte diskutim. Ata ishin të regjistruar në regjistrin e shkollës me disa emra të çuditshëm. Që të gjithë e kishin mbiemrin Stanescu. Kjo më dukej e çuditshme. Mos vallë që të gjithë ishin vëllezër e motra? Çfarë po bëjnë ata kështu? Mos po martohen brenda familjes? Emrat e tyre ishin Bicikleta Stanescu [fjala rome për biçikletë], Ferdinand Stanescu, Portokala Stanescu [fjala rome për portokallet]. E pashë me sytë e mi […]. Më duket e tmerrshme që t'ia vësh një fëmije emrin Mercedes Stanescu […]. Pavarësisht çdo gjëje që mund të ndodhte ata nuk do kishin ardhur në shkollë. Nuk arritëm t'i bindnim prindërit e tyre.
Nga ana tjetër, kishim frikë të shkonim vetëm te shtëpitë e tyre. Prandaj shkonim me drejtorin e Komisariatit të Policisë së komunës.
Ata nuk kishin motivim që të vinin në shkollë, pasi nuk fitonin gjë nga ajo. Paradoksi ishte se këta njerëz, që nuk shkonin në shkollë, jetonin në shtëpi të mëdha dhe të bukura, por të pista. Gjithashtu, iu jepnin edhe makinave. Ndodhte që të shihja një 13-14 vjeçar ose 15 vjeçar duke i dhënë makinës. Më dukeshin shumë të rinj. Mendoja me vete, mos vallë ky është Mercedesi? […] Si ka mundësi që ka makinë ky? Do të thoshte shumë të kishe makinë në atë kohë, pasi makinat ishin të shtrenjta dhe nuk gjendeshin lehtë. Një mëngjes kur arrita në shkollë, pashë që oborri ishte mbushur me fëmijët e komunitetit rom. Mësuesi tha: "Obobo, çfarë po ndodh kështu?". Ata u përgjigjën: "Kemi ardhur të marrim dëftesën e mbarimit të katër viteve shkollë." Ai vijoi: "Por ju nuk keni ndjekur mësimin, si mund t'ua jap dëftesën unë?" Ata ia kthyen: "Nuk e kemi ndjekur mësimin, por ju duhet të na i jepni dëftesat se na duhen." "Për çfarë ju duhen?", i pyeti ai. Pastaj zbuluam se njëri nga djemtë që i jepte makinës kishte bërë aksident. Kur e kishin dërguar te Komisariati i Policisë i kishin kërkuar që të shkruante deklaratën (për atë që kishte ndodhur), por ai u kishte thënë që nuk dinte të shkruante. Meqenëse ai kishte patentë, ata e kishin pyetur: "Po patentën si e ke marrë atëherë?" Aty kishin zbuluar që oficerët e milicisë u jepnin patenta personave të komunitetit rom në këmbim të parave. Për shkak të kësaj ndodhie erdhi një ekip kontrolli nga Bullgaria dhe u bë një rrëmujë e madhe. Oficerët e milicisë i kishin thënë personave të komunitetit rom, që të merrnin dëftesat si provë se dinin të shkruanin. Kjo është historia se si ata na u shfaqën në shkollë dhe nuk pranonin të largoheshin.
E keni vetë parasysh se si janë ata, i qëndrojnë të vetes. Vazhdonin këmbëngulnin. "Sa doni për një dëftesë?" Nga komuniteti rom e ka origjinën mendësia që një dëftesë mund të blihet. Që në vitet '80 e kanë pasur këtë problem dhe ky ves (shitja e dëftesave) ka ardhur duke u përforcuar. Shumë nga veset tona e kanë origjinën nga ky grup etnik […]. Ata ishin një popullsi etnike që nuk mbrohej nga komunistët, por në një farë mënyrë "ruhej" nga ta. Komunistët dështuan rëndë kur u përpoqën t'i integronin. Meqenëse nuk mundën t'i integronin, menduan se ishte më mirë t'i linin të qetë dhe t'i ruanin, në mënyrë që veset e tyre të mos bëheshin të ditur.

Intervistë e bërë nga Katalina Mihalak më datë 16.02.2012.

Policia (milicia) në vendet socialiste ishte përgjegjëse për ruajtjen e rendit publik, por oficerët e këtyre vendeve pikësëpari po zbatonin direktiva politike. Në lagje qyteti apo në zona rurale, ku Komisariatet e Policisë ishin nën kontrollin e një numri të vogël oficerësh, autoriteti i këtyre të fundit rridhte nga aftësia e tyre për të negociuar me banorët vendas.

Lexoni me kujdes tekstin në VI-10 dhe identifikoni: (a) fjalitë që tregojnë për izolimin dhe margjinalizimin relativ të komunitetit rom si një grup etnik; (b) fjalitë dhe frazat që paraqesin steriotipe të komunitetit rom.

VI.3. NDRYSHIMET E POPULLSISË

VI-11. A. Numri i lindjeve në Ballkan për 1000 njerëz (1950-1979)

Shteti/Rajoni	1950	1953	1956	1959	1975	1977	1979
Shqipëri	*38.8*	*40.9*	*44.5*	*41.9*	*31.9*	------	------
Bullgari	25.2	20.9	19.5	17.6	16.6	16.1	15.5
Qipro	29.9	26.6	26.4	25.8	18.4	18.5	19.5
Greqi	20	18.4	19.7	19.4	15.7	15.5	15.9
Rumani	26.2	23.8	24.2	20.2	19.7	19.5	19.1
Jugosllavi	30.2	28.4	25.9	23.1	18.2	17.7	17.1

Shkronjat me të pjerrëta tregojnë që të dhënat nuk janë plotësisht të besueshme dhe të sakta. Për Turqinë nuk ka të dhëna.

Zyra Statistikore e Kombeve të Bashkuara, *Vjetari Demografik i vitit 1960*, Nju Jork, 1960;
Zyra Statistikore e Kombeve të Bashkuara, *Vjetari Demografik i vitit 1979*, Nju Jork, 1979.

B. Numri i lindjeve në Jugosllavi

Vitet	RSFJ	Bosnje-Hercegovina	Kroacia	Maqedonia	Sllovenia	RS e Serbisë	Serbia	Vojvodina	Kosova	Mali i zi
1948-1961	12,1	18,8	7,3	15,2	7,7	12,0	11,4	9,4	20,9	17,1
1961-1971	10,1	13,3	6,2	15,8	8,1	9,9	8,4	5,1	25,3	11,5
1971-1981	8,5	9,4	3,3	14,9	8,6	9,3	7,6	3,8	24,1	9,6
1989	5,1	8,1	0,7	10,1	2,5	5,0	1,4	-1,6	22,4	9,1
1990	5,0	7,7	0,5	9,9	2,5	5,1	1,4	-1,6	23,1	8,9

Jugoslavija 1945-1985, fq. 198; Statistički godišnjak Jugoslavije 1990, fq. 95, 438; Statistički godišnjak Jugoslavije 1991, fq. 99, 443 .

C. Numri i lindjeve dhe aborteve në Bullgari 1955-1990

Viti	Lindjet	Aborte të qëllimshme
1955	151,000	2,200
1956	147,900	2,000
1960	140,000	51,000
1965	125,800	96,000
1970	139,700	119,700
1975	144,700	120,400
1980	128,200	136,300
1985	119,000	112,200
1990	105,200	127,600

Gruev, 2009, fq. 370-385.

D. Rritja e popullsisë në Turqi, 1940-2000

Viti	Popullsia (njëqind mijë)	Rritja vjetore e popullsisë (%)
1940	17,821	
1942		1.059
1947		2.173
1950	20,947	
1952		2.775
1955	24.065	
1957		2.853
1960	27,755	
1962		2.463
1965	31,391	
1967		2.519
1970	35,605	
1972		2.501
1975	40,348	
1977		2.065
1980	44, 737	
1982		2.488
1985	50,664	
1987		2.171
1990	56,473	
1994		1.828
2000	67,804	

Hartuar me të dhëna të marra nga: www.tuik.gov.tr/PreIstatistikTablo. do?istab_id=202, parë më 6.09.2016.

E. Përqindja e vdekshmërisë në Jugosllavi

Popullsia që jeton në territoret e Jugosllavisë u përllogarit të ishte 23.4 milionë njerëz në vitin 1987, 15.7 milionë në vitin 1948 dhe 22.4 milionë në vitin 1981. Krahas kësaj, më shumë se një milionë jugosllavë jetonin dhe punonin në vende të tjera evropiane për periudha kohore të gjata. Dendësia e popullsisë e vendit u rrit nga 62 njerëz për kilometër katror në vitin 1948, në 92 për kilometër katror në vitin 1988.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, përqindja e vdekshmërisë në Jugosllavi ra ndjeshëm. Në vitin 1984, përqindja e vdekshmërisë kishte rënë në rreth 9.3% për njëmijë njerëz, nga 12.8% që ishte në vitin 1948. Në Kosovë, përqindja e vdekshmërisë ra nga 13% për njëmijë njerëz në vitin 1947 në 5.8% në vitin 1984, ndërsa në Sllovenia ra nga 13.5% në 10.9% për njëmijë njerëz.

Përqindja e vdekshmërisë foshnjore në Jugosllavi, një tregues kryesor i niveleve shoqërore, ekonomike, të kujdesit shëndetësor dhe kulturore të popullsisë, ra nga 118.6 vdekje foshnjore për njëmijë lindje në vitin 1950 në 26.2 për njëmijë lindje në vitin 1987. Megjithatë, në vitin 1985, pavarësisht kushteve më të mira të jetesës dhe kujdesit shëndetësor, përqindja e vdekshmërisë foshnjore në Jugosllavi u rendit në vend të parafundit mes vendeve evropiane, ku në vend të fundit ishte Shqipëria.

Përqindja e lindshmërisë ra së bashku me atë të vdekshmërisë në Sllloveni, Kroaci, Vojvodinë dhe Serbi. Por në Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni dhe Mal të Zi, kjo rënie në lindshmëri ndodhi vetëm pas vitit 1960, ndërsa përqindja e lindshmërisë në Kosovë ra shumë pak përgjatë vitit 1990. Problemi më i madh demografik i Jugosllavisë në vitin 1980 ishte bërë hovi i rritjes së popullsisë së shqiptarëve etnikë të Kosovës. Në vitet 1950-1983, popullsia e Kosovës u rrit me rreth 220 për qind, ndërsa ajo e Jugosllavisë u rrit me vetëm 39 për qind [...]. Në vitin 1980, Kosova ishte bërë pjesa me popullsi më të dendur në Jugosllavi (146 njerëz për kilometër katror), megjithëse ishte rajoni më pak i zhvilluar i vendit.

Në mes të viteve 1960, qeveria filloi të mbështeste aktivisht praktikat e planifikimit familjar, si mënyrë për të mbajtur nën kontroll rritjen e popullsisë. Në vitin 1969, Parlamenti Federal (Skupstina) miratoi ligjin për liberalizimin e abortit.

http://www.country-data.com/cgi-bin/query/r-14798.html, parë më 6.09.2016.

Studioni tabelat e statistikave. Më pas përpiquni të lidhni rritjen/uljen e përqindjes së lindshmërisë dhe vdekshmërisë me statuset politike dhe ekonomike të shteteve në fjalë.

VI-12. Politika në favor të lindjeve e Nikolai Çausheskut dhe ndalimi i abortit

Në dhjetëvjeçarët pasardhës pas lëshimit të Dekretit 770/1966, u ndërmorën të tjera masa të forta kundër ndërprerjes së shtatzënisë apo kundrejt atyre që e mbështesin. Për shembull, një grua lejohej të abortonte vetëm nëse ishte më e madhe se 45 vjeçe dhe kishte katër fëmijë. Ndërsa çiftet pa fëmijë duhet të paguanin një taksë të veçantë, deri në 10% të rrogës mujore dhe gratë në moshën e fertilitetit duhet të bënin kontrolle të detyrueshme gjinekologjike.

A. Dekreti 770/1966 për Ndalimin e abortit

Duke marrë parasysh faktin që ndërprerja e shtatzënisë është një vepër me pasoja të rënda për shëndetin e femrës dhe ka një ndikim shumë negativ në përqindjen e lindshmërisë dhe në rritjen natyrore të numrit të popullsisë, Këshilli Shtetëror i Republikës Socialiste të Rumanisë, dekreton:

Neni 1. Ndalohet ndërprerja e shtatzënisë.

Neni 2. Ndërprerja e shtatzënisë do të lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme […] kur: a) shtatzënia vë në rrezik jetën e gruas (dhe nuk ka mënyrë tjetër për ta shpëtuar); b) një nga prindërit vuan nga një sëmundje e rëndë shëndetësore, që është e trashëgueshme ose që çon në deformime të rënda që në lindje; c)gruaja shtatzënë ka aftësi të kufizuara fizike apo shqisore të rënda; d) gruaja shtatzënë e kalon moshën 45 vjeç; e) gruaja shtatzënë ka lindur katër fëmijë dhe kujdeset për ta; f) shtatzënia ka ardhur si pasojë e përdhunimit apo incestit.

Neni 5. Ndërprerja e shtatzënisë autorizohet nga një bord mjekësor në rang qarku apo qyteti, bord i krijuar posaçërisht për këtë qëllim nga një vendim i komitetit ekzekutiv të këshillit publik të qarkut apo qytetit.

Neni 6. Në rastet e urgjencave ekstreme mjekësore, kur ndërprerja e shtatzënisë ishte e detyrueshme dhe është bërë menjëherë, mjeku ka detyrimin, para se të kryejë abortin ose kur nuk është e mundur që brenda 24 orëve të shkruajë, të shkruajë një deklaratë për prokurorin, i cili do të vërtetojë me anë të dëshmisë mjekësore dhe të ndonjë informacioni tjetër të vlefshëm, nëse ndërprerja e shtatzënisë ishte e nevojshme apo jo.

Fletorja Zyrtare, pjesa I, nr. 60, 1 tetor 1966, fq. 416.

B. Dekreti 771/1966 për dënimet e marra në rast mosrespektimi të ndalimit të aborteve

Kushdo, në çfarëdolloj rasti, që kryen ndërprerje të shtatzënisë në kundërshtim me ligjin shpallet fajtor për krimin e abortit dhe dënohet me një deri në tre vite burg […]. Në rast se gruaja shtatzënë lëndohet ose vdes gjatë abortit, dënimet variojnë nga dy deri në pesë vite dhe nga pesë deri në dhjetë vite përkatësisht […]. Kur kjo vepër është kryer për përfitim material, dënimi […] rritet me dy vite.

Kushdo që ka në pronësi mjete të posaçme të nevojshme për ndërprerjen e shtatzënisë […] jashtë qendrave të specializuara të kujdesit shëndetësor, dënohet me tre muaj deri në një vit burg.

Kushdo që nxit, kryen apo ndihmon në abort, dënohet.

Fletorja Zyrtare, pjesa I, nr. 60, 1 tetor 1966, fq. 416-417.

C. Ekstrakte nga fjalimi i Nikolai Çaushesku në mbledhjen e Këshillit Ekzekutiv Politik të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Rumanisë, 24 shkurt 1984

Përqindja e lindshmërisë ka rënë për shkak të aborteve. Mjekët që kryejnë aborte për arsye fitimi do të dënohen. Duhet t'u japim fund këtyre veprave të papërgjegjshme. Nuk duhet të lejohet që ata të vazhdojnë të praktikojnë profesionin e mjekut.

Do të zhvilloj takime me Këshillin e Lartë të Shëndetësisë dhe me kryesinë e ministrisë dhe do të vë gjithçka në vendin e vet. Duhet të zhvillohen mbledhje të ngjashme në çdo shtet, në mënyrë që kjo gjendje të marrë fund, sepse 420,000 aborte janë të papranueshme, duke marrë parasysh, që në vitin 1975 kishte vetëm 350,000 […]. Duhet të ndërmarrim masa kundër atyre që kanë përfituar në kurriz të popullit të vendit, përfshirë këtu dhe proceset gjyqësore, ashtu siç e parashikon ligji.

Arkivat Kombëtare të Rumanisë (Bukuresht), arkëtimet "CC të CPR, seksioni i Kancelarisë", dosja nr. 12/11984, fq. 31-32.

D. Ekstrakte nga intervista për pasojat e dekretit kundër aborteve

Çdo gjë ndodhi në vitin 1987. Isha 18 vjeçe dhe isha bërë me dy fëmijë. Nuk ishte koha e duhur që të bëhesha edhe me një të tretë. Jetoja me prindërit e mi. Vetëm bashkëshorti punonte, unë jo. Fëmijët i kisha më të vegjël se tre vjeç [...]. Mendoja se nuk ia vlente të përfshija dhe dikë tjetër në këtë telash, kështu që e kreva vetë abortin. Isha e gatshme të bëja çdo gjë në ato çaste dëshpërimi dhe varfërie [...].

Gratë përdornin çdo lloj mënyre të mundshme për të cilën kishin dëgjuar [...]. Ishte e tmerrshme [...]. Kisha dhimbje të tmerrshme [...]. Më dërguan në spital [...]. Dy javë pasi dola nga spitali më erdhi një letër, që thoshte se duhet të shkoja te Komisariati i Policisë, në dhomën numër katër, te departamenti i hetimit penal. Shkova dhe dhashë deklaratë time. Një oficer i ri më tha çfarë duhet të shkruaja. Duhet të shkruaja që kisha ngritur një bombol gazi. Më morën dhe një herë të dytë pasi kisha marrë vërtetimin mjekësor nga spitali. Dhashë po atë deklaratë [...]. Ata vazhdonin të më pyesnin se kush ma kishte bërë abortin dhe me çfarë. Por unë i qëndrova deklaratës sime. Një vit më vonë, mbeta përsëri shtatzënë. Mendova me vete: Po sikur të bëj dhjetë fëmijë? Nuk bëj abort tjetër [...]. Por dështova [...]. Mësova se kishin vdekur shumë gra për shkak të abortit. Një fqinjës sime i kreu abortin një grua tjetër dhe vdiq.

Askush nuk fliste për të edhe pse e dinin që të gjithë. Ajo kishte vdekur, çfarë të mire do të sillte burgosja e një njeriu tjetër.

Muzeu Fshatar Rumun, 2008, fq. 42-43.

Çështja shumë e ndjeshme dhe private e ndërprerjes së shtatzënisë u trajtua në një mënyrë autoritare nga Çaushesku dhe kjo solli me mijëra vdekje për shkak të aborteve të paligjshme. Kjo çështje trajtohet ndryshe në shtete dhe kultura të ndryshme ku institutet fetare kanë një rol thelbësor. Diskutoni në klasë për këtë temë dhe bëni lidhjen me bëni lidhjen me Lindjet e Planifikuara e shmangies së shtatzënive të padëshiruara.

KAPITULLI VII: SHOQËRIA DHE KULTURA

Hyrje	209
VII.1. Gjinia	211
VII.2. Feja	218
VII.3. Kultura e të rinjve	222
VII.4. Letërsia dhe Kinemaja	225
VII.5. Konsumizmi	230
VII.6. Turizmi	236
VII .7. Politika sociale	240
VII .8. Sporti	242

HYRJE

Politikat shoqërore dhe kulturore të vendeve të Ballkanit pas Luftës së Dytë Botërore ishin të përcaktuara nga: zhvillimi i tyre i përgjithshëm politik, aleanca e tyre strategjike me blloqet ndërkombëtare ushtarako-politike, globalizimi i kulturës popullore dhe vlerave universale, dhe e fundit por jo më pak e rëndësishmja, nga zhvillimi shoqëror i veçantë i secilit vend.

Gjatë viteve të para të pas luftës, vendet e Ballkanit, paralelisht me konsolidimin e regjimeve të ndryshme politike dhe qeverive autoritare, duhej të rimëkëmbeshin nga dëmet ekonomike dhe shoqërore të luftës. Kjo kërkoi rinegocim dhe rregullore të re lidhur me burimet shtetërore dhe marrëdhëniet shoqërore. Në vendet komuniste, kjo u bë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e partisë komuniste (vendore) të plotfuqishme, që bëri "transformimin revolucionar" të shoqërisë borgjeze, duke përdorur kryesisht argumente ideologjike. Një larmi e madhe e grupeve shoqërore, përfshirë industrialistë, bankierë, pronarë të mëdhenj tokash dhe ushtarakë dhe deri te tregtarët dhe fshatarët e vegjël, përjetuan persekutim të skajshëm dhe u detyruan t'ua jepnin pozicionet e tyre drejtuese në sektorin publik "punëtorëve" dhe klasës punëtore; kjo do të thotë që ato poste iu dhanë atyre që ishin të punësuar në fabrika dhe ndërmarrje, fshatarëve në fermat kooperativiste shtetërore të mëdha, grave që punonin si të barabarta përkrah burrave. Duke ndjekur detyrimin ideologjik marksist të krijimit të një "shoqërie komuniste progresive", regjimet e reja përqendruan përpjekjet e tyre në modernizimin e plotë të jetës dhe kulturës së qytetarëve, që nga sigurimi i kanalizimeve dhe energjisë elektrike në fshatra te ndërtimi i rezorteve dhe krijimi i institucioneve moderne të argëtimit.

Në Greqi, Turqi dhe Qipro, vende që kombinuan një orientim të qartë properëndimor me vizionet kombëtare për një sistem të mirëqenies sociale, në periudha të ndryshme elitat shtetërore u përpoqën të mbronin, ose në të kundërt të kundërshtonin vizionin patriarkal për zhvillimin e shoqërisë, në varësi të faktit nëse i përkisnin spektrit politik të majtë ose të djathtë. Në këto vende, edhe ristrukturimi i jetës shoqërore synonte modernizimin, por që varej në shkallë të madhe në baraspeshimin e brishtë të shtetit, interesat etnike dhe gjeostrategjike, duke iu dhënë shumë përparësi modeleve ekonomike perëndimore. Me përparimin e Luftës së Ftohtë, dhe veçanërisht pas viteve 1960, ritmi i modernizimit të sferës shoqërore dhe kulturore të vendeve të Ballkanit u përshpejtua, duke sjellë një lloj "revolucioni" si në organizimin shtetëror të jetës së përditshme dhe në qëndrimet e vetë qytetarëve ndaj përfitimeve të reja shoqërore dhe mallrave që u ofroheshin.

Për shembull, historia e gjinisë është një ilustrim i shkëlqyer i transformimeve shoqërore të shoqërive të Ballkanit. Nën diktaturat komuniste hamendësohej mbi thirrjen marksiste për lirimin e grave nga shfrytëzimi dhe shtypja. Regjimet socialiste u premtonin grave të drejta të reja dhe një lloj të ri përfshirjeje në strukturat profesionale dhe institucionale. Në njëfarë pike, kjo pasqyronte hyrjen e vërtetë të grave në industrinë moderne dhe ngjitjen e tyre. Aspekti tjetër, jo gjithmonë i dukshëm, i historisë gjinore në vendet socialiste ishte vazhdimi i stereotipeve dhe pabarazive gjinore paramoderne. Si rrjedhim, pavarësisht premtimeve të partive komuniste se burrat do të merrnin pjesë në mënyrë të barabartë me gratë në punët e shtëpisë dhe çështjet familjare, dhe do t'u krijohej mundësia që ta thoshin pa ndrojtje e të lira mendimin e tyre, gjatë periudhës nga vitet 1960 dhe deri në fund të viteve 1980 burrat vazhdonin të mbizotëronin në çështjet shoqërore dhe ekonomike, dhe punët shtëpiake të grave nuk u pakësuan dhe as koha e tyre e lirë dhe e argëtimit nuk u shtua, si edhe të ardhurat e tyre financiare mbetën gjithmonë më të ulëta se ato të burrave. Këto pabarazi kishin një ndikim të madh veçanërisht në statusin e grave nga grupet minoritare, dhe në veçanti të atyre nga bashkësitë myslimane. Gjithashtu, ato diktonin politikat e nxitjes së lindjeve dhe ndalimit e kufizimit të aborteve. Kuptimi publik dhe ligjor i abortit si një shkelje e burimeve biologjike kombëtare, mori forma ekstreme me kriminalizimin e aborteve në Rumaninë socialiste, që shkaktoi trauma të rënda te mijëra gra, të cilat u detyruan të përdornin shërbimet e fshehta dhe të paligjshme të mjekëve të paaftë ose lakmitarë.

Është interesant fakti që këto histori traumatike nuk ishin të njëjta për shoqëritë komuniste. Në Greqi, deri në vitin 1970, ndërprerja e vullnetshme e shtatzënisë konsiderohej vepër penale dhe vetëm pas vitit 1978 u miratua një ligj që lejonte abortin, por vetëm në kushte të veçanta dhe të rrepta. Kufizimet e fundit për abortin u vendosën në vitin 1985, duke përcaktuar kriteret dhe kushtet bashkëkohore për parandalimin e shtatzënisë, planifikimin familjar dhe dekriminalizimin e abortit.

Historia e grave dhe gjinisë paraqet gjithashtu shumë kontradikta në zhvillimin shoqëror të Turqisë. Kjo është një histori e grave të emancipuara, por që nuk janë të lira; të emancipuara nga reformat e Qemal Ataturkut, por në masë jo të lira për shkak të ndryshimeve të ngadalta në sferën shoqërore dhe ruajtjen e qëndrimeve tradicionale dhe praktikave patriarkale. Si një prirje afatgjatë, diskutimet për statusin e grave në shoqëri, pjesë e mëdyshjes së përgjithshme të rrugës së Turqisë moderne,

u rigjallëruan pas kthimit të Islamit në politikë, në dekadën e parë të shekullit XXI. Qëndresa konservatore nga të ashtuquajturat kundërelitat kundër statusit "Perëndimor" të grave turke, luan një rol të veçantë në diskutimin publik për emancipimin e tyre.

Historia e Kishës dhe besimtarëve në Ballkan, pas Luftës së Dytë Botërore, nuk është më pak e ndërlikuar se historia e grave, por ka një ndryshim thelbësor. Ndërkohë që gratë luftuan për emancipim ose duruan pasojat e një emancipimi të papërfunduar ose të pamjaftueshëm, besimtarët u përballën me sfidat e laicizmit në nivel vendor dhe botëror. Doktrina filozofike mbizotëruese materialiste në vendet komuniste, ka krijuar ateizmin si një normë morale e vlefshme për të gjithë. Pas dekadave të para të shtypjes së butë dhe të egër kundër klerit (keqtrajtimi i tyre dhe rekrutimi gjithnjë e më i madh i atyre klerikëve të gatshëm për kompromise si agjentë të policisë sekrete komuniste, persekutimi për arsye të organizimit të riteve fetare, e kështu me radhë) dhe kufizimeve të veprimtarive shoqërore të Kishës, feja filloi të trajtohej si një "anakronizëm i zakonshëm", dhe kjo solli ndryshimin e metodave për ta luftuar fenë. Dhuna radikale u zëvendësua nga më shumë sulme strategjike dhe tinëzare kundër fesë. Programet televizive që tërhiqnin vëmendjen e publikut transmetoheshin në vigjilje të veprimtarive të mëdha fetare, u monitoruan rrëfimet në kishë, nuk u tolerua arsimimi teologjik dhe ritet fetare u zëvendësuan me ato civile. Të gjitha këto masa kundër ndikimit ende të prekshëm të Kishës, ishin veçanërisht të suksesshme në vendet ortodokse lindore. Margjinalizimi i fesë u kombinua me një riformulim të veçantë të rolit të institucionit kishtar. Ndryshe nga Shqipëria, ku politika e ateizmit ishte më radikale, në Rumani dhe Bullgari Kristianizmi Ortodoks Lindor filloi të paraqitej si një shtyllë e fuqizimit të ndërgjegjes kombëtare, me një kontribut historik të rëndësishëm në zhvillimin e doktrinës kombëtare. Si rrjedhojë, në mënyrë paradoksale, në politikat e tyre lidhur me fenë që mbizotëruan në periudhën e socializmit të vonë, Rumania dhe Bullgaria (dhe deri diku edhe Serbia dhe Maqedonia brenda Jugosllavisë) u bënë të ngjashme me vende si Greqia dhe Turqia, që e shihnin fenë, së bashku me gjuhën, si shtylla të patriotizmit dhe besnikërisë ndaj trashëgimisë kombëtare.

Në disa nga këto vende, kriza ideologjike i hapi rrugën një lloji të veçantë autoriteti, ndërkohë që ateizmi komunist filloi të transformohej si një sintezë të veçantë të Epok, veçanërisht në Bullgari, nëpërmjet veprimeve të Ludmilla Zhivkova, kryetarja e Komitetit për Kulturë dhe vajza e udhëheqësit të Partisë dhe shtetit, që përkrahte mësimet mistike të Nikolai Rerik dhe Petar Danov, dhe mbështeste institucionalizimin e parapsikologjisë. Po në këtë kontekst duhet parë edhe nderimi i veçantë që i bëhej një profete bullgare që besohej se ishte e aftë të parashikonte të ardhmen dhe të komunikonte me të vdekurit. Në vendet katolike si në Kroaci, Kisha dhe kleri kishin autoritetin e tyre. Megjithatë, në përgjithësi, proceset vendore të laicizmit ndoqën prirjen e zvogëlimit të rolit të fesë në jetën e përditshme të qytetarëve. Praktikat fetare si lutjet private, respektimi i rreptë i festave fetare ose vajtja në kishë gjatë të dielave, u zëvendësuan me koncerte artistike nga grupe perëndimore, "ndërveprimi shoqëror në vende që i ishin kushtuar argëtimit dhe zbavitjes", festimi i zhurmshëm i arritjeve sportive me shokët ose në rrugë, nga vizitat e pambarimta nëpër "qendrat tregtare" dhe nëpër supermarketet e para dhe nga diskutimet mbi reklamat e makinave dhe pajisjeve të reja elektro-shtëpiake.

Si në vendet socialiste të Ballkanit edhe në ato josocialiste, kultura popullore dhe konsumerizmi u përqafuan në mënyrë po aq entuziaste sa edhe në Shtetet e Bashkuara dhe në Evropën Perëndimore. Agjentët dhe transmetuesit kryesorë të këtyre dukurive ishin të rinj, që përvetësuan me vonesë mesazhet e revolucionit seksual dhe artit modern pop, dhe kërkonin të emancipoheshin. Duke marrë pjesë në forma të ndryshme të veprimtarive nënkulturore, të rinjtë zhvilluan një mënyrë jetese provokuese dhe moderne, dhe sulmuan stereotipet e këtyre mënyrave që barteshin nga brezat e vjetër, që në dukje mbronin traditat dhe vlerat kombëtare. Paralelisht me modernizimin e mënyrës së jetesës dhe përdorimin gjithmonë e më shumë të pajisjeve shtëpiake, seteve të televizorëve, makinave dhe mallrave të luksit, ka një kërkesë në rritje për rroba dhe aksesorë mode, regjistrime dhe kaseta të grupeve të preferuara të muzikës rrok, punk, vala e re dhe heavy metal, dhe për vende të fshehta për të ndërmarrë sfida të reja erotike. Një shembull i veçantë në këtë aspekt ishte Jugosllavia, që u bë si "Amerika e vogël" e Ballkanit. Megjithatë, kultura popullore dhe konsumerizmi në rajon nuk u zhvilluan në mënyrë të njëtrajtshme. Nëse në vende si Bullgaria dhe Rumania kishte lista të personave që prisnin për ushqime në sasi të vogla dhe të rinjtë persekutoheshin se vishnin rroba "të pahijshme" dhe se mbanin flokë të gjatë, prodhimi i makinave në Turqi që ishin në një nivel me markat perëndimore nuk u zhvillua me shumë sukses. Vendet e Ballkanit kishin sukses dukshëm të madh për modernizimin në rastin e turizmit dhe sporteve deri më tani, dhe të dyja së bashku krijuan një hapësirë për shkëmbimin e produkteve dhe vlerave, ideologjive kombëtare, dhe formave të zbavitjes me rëndësi në rrafsh kombëtar dhe mbarëkombëtar. Megjithatë, në fund të fundit, shoqëritë dhe kulturat e tyre u transformuan, në shkallë të ndryshme, përgjatë viteve të liberalizimit, laicizmit dhe globalizimit të madh.

VII.1. GJINIA

VII-1. Ekstrakte nga raporti i Maria Dinkovës, Kryetare e Departamentit të Kërkimit dhe Zhvillimit, për rezultatet e studimit "Efekti i politikës për rritjen e rolit të grave në Bullgari", i kryer nga Këshilli Shtetëror dhe Komiteti i Grave Bullgare, në vitin 1975

INFORMACION LIDHUR ME PËRPARIMIN SHOQËROR TË GRAVE

Vetëm 2.15% e grave të intervistuara nuk punojnë;
98% e grave deri në moshën 35 vjeç janë punësuar në prodhimin shoqëror.
Sipas statusit shoqëror, ato janë shpërndarë si më poshtë (%):

Punëtore fabrike	36.78%
Punonjëse zyre me kualifikime të specializuara	35.70%
Punonjëse zyre pa kualifikime të specializuara	16.05%
Fshatare kooperativistë	8.35%
Të papuna	2.15%
Tjetër	0.59%
Nuk ka	0.38%

Sipas nivelit të arsimit të përfunduar, ato janë shpërndarë si më poshtë (%): →

	gra	burra
I lartë	6.25	10.47
Arsimi profesional gjysmë i lartë dhe i mesëm	27.79	17.92
Arsimi profesional i mesëm i përgjithshëm dhe teknik	27.19	17.92
Fillor	29.56	40.42
Elementar	8.89	6.17
Nuk ka	0.32	1.65

Në vitin 1946, gratë me arsim të lartë përbënin vetëm 1.4% të grave të arsimuara; ato me arsim gjysmë të lartë përbënin 1.0%; me arsim profesional të mesëm 4.2%, dhe me arsim të mesëm të përgjithshëm 7.7%. Si rrjedhojë, ne nuk mund të supozojmë se është bërë shumë progres drejt barazisë shoqërore të grave dhe burrave. 36.56% e grave janë angazhuar në punë publike. Shkalla e angazhimit varet nga niveli arsimor dhe pozita shoqërore. Veprimtaritë publike të punonjëseve të zyrës me dhe pa kualifikime janë më të lartat, ndërsa ato të fshatareve kooperativiste dhe të të papunave janë më të ulëtat. Veprimtaritë e punonjëseve të fabrikës janë shumë të ulëta. Veprimtaritë publike të grave varen gjithashtu nga statusi i tyre martesor. Ato janë të larta ndërmjet të divorcuarave dhe të ulëta ndërmjet vejushave. 36.37% e grave të martuara, 33.33% e vejushave, dhe 42% e grave të divorcuara janë angazhuar në punë publike. Kjo shpjegohet nga fakti se të divorcuarat nuk kanë shumë detyrime shtëpiake, ato kanë më shumë kohë të lirë për veprimtari publike, dhe për më tepër, ato kërkojnë kontakte shoqërore më shpesh se gratë e tjera.

Arkivat Shtetërore Qendrore, dok 1Б, inv. 55, a.u. 839.

VII-2. Shkollimi në Turqi, 1980

Populsia turke sipas shkollimit dhe gjinisë (12 vite e më shumë), 1980 (000 persona)

Niveli arsimor	Shpërndarja e përqindjes			Përqindja relative e femrave në secilin nivel arsimor
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	
Analfabetë	16.8	46.6	31.3	72.2
Të shkolluar (pa diplomë)	10.2	6.4	8.4	27.0
Shkollë fillore	52.8	36.9	45.1	39.6
Shkollë e mesme	8.7	4.5	6.7	32.4
Shkollë e mesme profesionale	0.1	0.1	0.1	40.7
Shkollë e mesme (lice)	4.6	2.6	3.6	34.7
Shkollë profesionale	3.4	1.9	2.6	34.3
Arsim i lartë	3.4	1.0	2.2	22.9
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	

Instituti Shtetëror i Statistikave, 1981, Ozbay (ed.), 1990, fq. 115 (http://unesdoc.unesco.org/images/0008/000871/087174EB.pdf)

Burimi i studimit VII-2. Çfarë përfundimesh mund të arrihen në lidhje me pozicionin e grave në shoqërinë turke në atë kohë? Çfarë mund të shkaktojë margjinalizimi i grave lidhur me arsimin?

VII-3. Gra të emancipuara, por jo të lira në Turqi

Megjithëse gratë në Turqi ishin ligjërisht të emancipuara me reformat qemaliste të viteve 1920, këto nuk ia dolën as të ndryshonin në thelb sistemin patriarkal mbizotërues dhe as të rrisnin statusin e grave. Rishfaqja e konservatizmit islamik në vitet 1970 (shihni. VII-17) si një forcë politike dhe shoqërore, solli një theksim të ri të meritave të sistemit familjar patriarkal. Shfaqja e kundërelitave, orientimi kulturor i të cilave ndryshoi nga ai i qemalistëve properëndimorë, çoi në përpjekje të riforcimit të roleve gjinore tradicionale.

Sidoqoftë, gjashtëdhjetë vite pas ndërmarrjes së refomave qemaliste, gratë turke, veçanërisht ato që jetojnë në zona rurale, ndeshen ende me një larmi problemesh. Ky fakt na detyron të marrim sërish në konsideratë disa çështje. Deri në çfarë mase mund t'i ndryshojë një "revolucion në sistemin ligjor", mënyrat tradicionale të jetesës së pjesës më të madhe të grave në një vend të caktuar? Cilët faktorë ekonomikë, shoqërorë ose politikë kushtëzojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi përshpejtimin ose vonimin e këtij procesi? A e ka feja, ideologjikisht ose moralisht, ende fuqinë e saj vendimtare për të përcaktuar shkallën e integrimit shoqëror dhe pjesëmarrjes politike të grave?

Abadan-Unat, 1990, fq. 13; http://unesdoc.unesco.org/images/0008/000871/ 087174EB.pdf, vizituar më 17.08.2016..

1. Përpiquni të trajtoni dhe diskutoni të tria pyetjet e ngritura te burimi më sipër për statusin ligjor të grave në Turqi.

2. A mendoni se reformat ligjore mund të ndryshojnë sjelljen tradicionale?

VII-4. Numri i parë i revistës së modës "Svijet" doli në vitin 1953. Ajo ishte një pikë reference për gratë jugosllave, që dukeshin dhe vepronin më shumë si gratë perëndimore.

Svijet [Bota], nr. 9, 1953.

VII-5. Shkollimi në Bosnjë-Hercegovinë, në vitet 1948-1991

Populsia e Bosnjë-Hercegovinë e moshës 10 vjeç dhe më shumë lidhur me shkollimin sipas censuseve (në %)

Viti	Përqindja (%)
1948	44.9
1953	40.2
1971	23.2
1981	14.5
1991	9.9

Statistički godišnjaci Bosne i Hercegovine od 1948. do 1992

[Vjetari Statistikor i Bosnjë-Hercegovinës nga viti 1948 deri në 1992] Zavod za statistiku Bosne i Hercegovine, Sarajevë..

Tabela në seksionin VII-5 tregon një ulje të konsiderueshme të shkollimit në Bosnjë-Hercegovinë ndërmjet viteve 1948 dhe 1991. Diskutoni proceset afatgjata, si dhe mbështetjen (njerëzore, materiale, financiare, politike, infrastrukturore, institucionale, etj.) që ishte e nevojshme për të arritur një rezultat të tillë.

VII-6. Legalizimi i ndërprerjes së vullnetshme të shtatzënisë në Greqi (1985)

Deri në periudhën *metapolitefsi* (1974, shihni referencën III-21), shoqëria dhe shteti grek ishte rreptësisht kundër ndërprerjes së shtatzënisë. Megjithëse aborti i provokuar përbënte një vepër penale,në vitin 1970 u raportuan rreth 9,115 aborte të kryera (numri i lindjeve për të njëjtin vit arrinte në shifrën e 145,000). Ligji Nr. 821, i vitit 1978, lejonte abortin për arsye të çregullimeve serioze të fetusit gjatë njëzetë javëve të para të shtatzënisë, si edhe në rast kur kishte rrezik për shëndetin mendor të nënës, siç përcaktohej nga psikiatri i stafit të një spitali publik, edhe pse vetëm në dymbëdhjetë javët e para të formimit të fetusit. Tetë vite më vonë, qeveria e PASOK-ut, që kishte premtuar "t'i jepte fund regjimit të papranueshëm të aborteve të paligjshme" dhe të siguronte infrastrukturën e nevojshme për planifikimin familjar, kontracepsionin dhe dekriminalizimin e aborteve, miratoi ligjin nr. 1609, dispozitat kryesore të të cilave ishin përfshirë në nenet 304 dhe 305 të Kodit Penal të Greqisë. Legalizimi i ndërprerjes së vullnetshme të shtatzënisë ishte kryesisht rezultat i përpjekjeve të bashkërenduara të organizatave dhe grupeve të ndryshme feministe, përfshirë Bashkimin Grek të Grave, presidente e të cilit në atë kohë ishte Margaret Çant, gruaja e ish kryeministrit Andrea Papandreu.

A. A. Nenet 304 dhe 305 të Kodit Penal të Greqisë

304 (4) Ndërprerja e vullnetshme e shtatzënisë, e kryer me miratimin e gruas nga një obstetër ose gjinekolog, i asistuar nga një anestezist, në një njësi të kujdesit gjithëpërfshirës, nuk përbën shkelje nëse përmbushet një nga kushtet e mëposhtme:

(a) Shtatzënia nuk i ka kaluar 12 javë;

(b) Ka tregues, të përcaktuar në përputhje me teknikat moderne të diagnozës para lindjes, se embrioni vuan nga një çregullim serioz, që do të sjellin në një defekt serioz të lindur të fëmijës, dhe shtatzënia nuk i ka kaluar 24 javë;

(c) Ka një rrezik të pashmangshëm për jetën e gruas shtatzënë, dhe rrezik për lëndim serioz dhe të përhershëm të shëndetit të saj fizik dhe mendor. Për këtë qëllim do të kërkohet një certifikatë mjekësore;

(d) Shtatzënia vjen si pasojë e përdhunimit, marrëdhënies seksuale me një femër minorene, incestit, ose marrëdhënies seksuale me një grua që është e paaftë për t'u mbrojtur dhe për të bërë qëndresë, duke pasur parasysh se kohëzgjatja e shtatzënisë nuk i ka kaluar 19 javë;

(e) Nëse gruaja shtatzënë është minorene, do të jetë i nevojshëm miratimi i një prej prindërve ose personit kujdestar.

305 (1) Një person që reklamon ose promovon publikisht, ose nëpërmjet qarkullimit të teksteve të printuara apo paraqitjeve grafike ose ilustruese, madje në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, medikamente ose artikuj, apo metoda të tjera që mundësojnë ndërprerjen e vullnetshme të shtatzënisë, ose në të kundërt, ofron shërbimet e tij ose ato të një tjetri për të kryer, apo për të marrë pjesë në ndërprerjen e vullnetshme të shtatzënisë do t'i nënshtrohet një periudhe burgimi që nuk i kalon dy vite.

(2) Dhënia e informacionit ose shpjegimeve mjekësore për ndërprerjen e vullnetshme të shtatzënisë në qendrat e planifikimit familjar, ose në kursin e trajnimit të mjekëve, apo personave ligjërisht të aprovuar për të përdorur metoda për ndërprerjen e vullnetshme të shtatzënisë dhe publikimi i artikujve dhe të ngjashëm në revista të specializuara mjekësore dhe farmaceutike, nuk përbëjnë shkelje.

http://cyber.law.harvard.edu/population/abortion/Greece.abo.html, vizituar më 17.08.2016.

B. Një afishe feministe greke që bën thirrje për ndërprerjen e vullnetshme të shtatzënisë dhe planifikimin familjar

http://www.isotita.gr/var/uploads/library/posters2010/A11%20AF%20F3.992.JPG, vizituar më 17.08.2016.

Përkthimi: Trupi ynë na përket neve: ndërprerja e vullnetshme e shtatzënisë dhe planifikimi familjar / 31 mars dita ndërkombëtare e planifikimit familjar / takim-diskutim në Shkollën e Drejtësisë - amfiteatri YNAS / E mërkurë 4 prill, ora 7 pasdite / grup studentesh të universitetit

1. Diskutoni nenet 304 dhe 305 të Kodit Penal të Greqisë dhe krahasojini ato me rregulloret dhe debatet në vendin tuaj.
2. Krahasoni rastin grek me atë rumun siç përshkruhet në burimet VI-12.
3. Kërkoni lidhjen ndërmjet feminizmit dhe abortit në shoqëritë perëndimore: pse kanë pretenduar lëvizjet feministe të drejtën e planifikimit familjar dhe ndërprerjes së vullnetshme të shtatzënisë?

VII-7. Ekstrakte të diskutimeve të zhvilluara nga një takim në Komitetin Politik Ekzekutiv për rregullat e konkursit Miss Rumania, 24 maj 1977. Si përfundim, u ra dakord për titullin "Bukuri, Rini, Zell".

Shoku Virgjil Trofin: Ju lutem, nëse më lejoni, unë do të dëshiroja të shpjegoja [...] pse jam kundër këtij konkursi. Duke qenë se për ne bukuria perceptohet tashmë si një tërësi unike, është e vështirë të themi se qeniet njerëzore janë të bukura, vetëm kur trupi i tyre është i bukur, ndërsa karakteri dhe puna e tyre janë krejtësisht ndryshe [...]. Unë nuk besoj se ne duhet të organizojmë një konkurs të tillë, ku bukuria perceptohet vetëm në bazë të paraqitjes së jashtme.

Shoku Nikola Çaushesku: Zgjedhja e një misi tashmë është një praktikë edhe në vendet e tjera [...]. Sigurisht që ne duhet të marrim parasysh integritetin moral të personit në fjalë, por kjo është një praktikë që ushtrohet kudo në botë.

Shoku Virgjil Trofin: Pse duhet ta përcaktojmë nëpërmjet një veprimi të tillë, faktin se disa prej tyre janë shumë të bukura dhe disa janë shumë të shëmtuara. Cili është qëllimi?

Shoqja Elena Çaushesku: Kjo është arsyeja përse ne nuk organizojmë një konkurs për gratë e shëmtuara. Kush është e bukur është e bukur, kush është e shëmtuar është e shëmtuar.

Shoku Nikola Çaushesku: Konkursi quhet "Bukuri, Rini, Zell".

Shoqja Elena Çaushesku: Nga vajzat e zellshme, disa janë më të bukura, disa janë më pak të bukura. Nëse ato i personifikojnë të dyja, si zellin edhe bukurinë, cili është problemi? Dhe pse ne duhet të mendojmë për konkurset e mëparshme të zgjedhjes së Miss Rumanisë? [...] Bukuria është një nga pasuritë e popullit. Populli ynë është një popull i bukur. Në rajone ka vajza të cilat kënaqesh t'i shohësh.

Shoku Leonte Răutu: Ne nuk po bëjmë diçka të mirë për këto vajza, për mendësinë e tyre. Dhe nëse ne do të marrim në konsideratë përvojën ndërkombëtare, ajo konfirmon disa gjëra.

Unë dua të them se ky konkurs ka më shumë një karakter tregtar.

Shoqja Elena Çaushesku: Ndoshta ne duhet të përfshijmë në këtë veprimtari edhe rrobat më të mira.

Shoku Paul Nikulesku: Ky konkurs është një konkurs i ndryshëm. Këtu vajzat nuk vijnë të veshura për konkurs.

Shoku Ion Iliesku: Duhet të vlerësohen konkurrentet dhe të zgjidhen përfaqësueset tipike.

Shoku Nikola Çaushesku: Dhe nëse ne synojmë vetëm këtë, që vajzat të hanë sipas një diete ushqimore, sepse ato filluan të shëndosheshin shumë, ky është një veprim i arsyeshëm. Vajzat duhet të jenë elegante […]. Të rejat duhet të jenë të bukura; ato duhet të përpiqen ta mbajnë në formë trupin e tyre nëpërmjet veprimtarive sportive.

Shoku Leonte Răutu: Zgjidhjen, përcaktimin dhe vendimin mund ta bëjë Këshilli i Arsimit dhe Kulturës Socialiste, jo për Komitetin Ekzekutiv Politik.

Shoku Nikola Çaushesku: Atëherë dakord dhe ta quajmë "Konkursi i Punës, Rinisë dhe Bukurisë".

Ekstrakte nga diskutimet për rregullat e organizimit dhe pjesëmarrjes në konkurs: Konkurrentet duhet të jenë ndërmjet moshës 16 dhe 28 vjeçare [...], të kenë tipare të ëmbla, hijeshi, sharm dhe proporcionalitet trupor [...]. Nëse ka disa konkurrente me të njëjtat pikë që kryesojnë listën, vendimi përfundimtar merret mbi bazën e veprimtarive dhe sjelljes së përgjithshme [të secilës konkurrente], si dhe duke marrë në konsideratë edhe statusin e tyre si nëna.

Douăzeci şi doi [22], nr. 268 (3 shkurt 2009), fq. 2-3.

Përdorni njohuritë tuaja dhe shpjegoni se përse konkursi i bukurisë si Miss Rumania u trajtua si një çështje politike në Rumaninë e Çausheskut.

VII-8. Gratë në politikë

Lina Caldari (1887-1981) ishte një deputetet konservatore dhe Ministre e Mirëqenies Sociale në qeverinë e Konstandinos Karamanlis (1956-58). Ajo ishte gruaja e parë që u bë ministre në Greqi. Vaso Thanaseku (1917-2015), një ish e burgosur politike, e burgosur për gjashtë vjet në burgun Averoff në Athinë, ishte deputetja e parë e të Majtës së Bashkuar Demokratike (EDA), e zgjedhur në vitin1956 kur gratë votuan për herë të parë në zgjedhjet parlamentare.

A. Ekstrakte nga fjalimi i deputetes konservatore Lina Caldari

Gratë greke, që deri më tani nuk ishin të afta të merrnin pjesë në mënyrë aktive në politikë, kanë qenë gjithmonë pjesëtare aktive në përpjekje për të zgjidhur të gjitha problemet dhe çështjet e popullit dhe atdheut tonë, veçanërisht ato të hasura gjatë viteve të vështira së fundmi. Përgjatë viteve të errëta të Luftës së Dytë Botërore, gjatë qëndresës dhe veprimtarive kundër komunistëve ato kryen detyrën e tyre pa e ulur kokën, pa u lodhur dhe pa u zmbrapsur. Ne qëndruam krah për krah me ushtarët tanë dhe familjet e tyre; ne u kujdesëm për heronjtë tanë, të plagosurit dhe personat që ishin gjymtuar; ne punuam në fabrika dhe në shërbimin civil duke zëvendësuar luftëtarët tanë; ne u kujdesëm për njerëzit tanë që i braktisën fshatrat e tyre për të shpëtuar nga zgjedha e komunizmit; ne ushqyem fëmijët tanë që po vuanin nga uria; ne u kujdesëm për nënat e uritura në mënyrë që fëmijët e tyre të mbijetonin. Dhe kur ne u çliruam me ndihmën e Zotit dhe të heroizmit të burrave tanë luftëtarë, gratë greke sërish punuan me këmbëngulje për rimëkëmbjen e atdheut tonë dhe riparimin e shkatërrimeve të tmerrshme që vendi kishte pësuar gjatë Luftës së Dytë Botërore, nga zaptimi dhe banditët. Për shkak të këtyre shërbimeve, shteti e konsideroi detyrë që të na jepte të drejta civile të plota, të cilat ne do t'i ushtronim për herë të parë në zgjedhjet e 19 shkurtit 1956.

Caldari, vëll. II, 1967, fq. 11-12.

B. Lina Caldari

C. Vaso Thanaseku

Pantelidhu-Maluta, 2007, fq. 138-179.

D. Ekstrakte nga një fjalim i deputetes së krahut të majtë Vaso Thanaseku

Në të gjitha përpjekjet kombëtare për pavarësinë dhe liritë demokratike, për mbijetesën dhe ecurinë e vendit,gratë greke kanë qenë dhe janë të pranishme. Nga gratë e Sulit dhe ishujve Hydra, Spetses dhe Kretë, te gratë e Pindusit dhe heroinat e qëndresës kombëtare, nga gratë pioniere të betejave për një Greqi më të mirë, te gratë greke të Qipros dhe beteja e tyre për vetëvendosjen qipriote, prania e tyre ka qenë e njëjtë, e pareshtur dhe për t'u lavdëruar. Kontributi i tyre për Popullin dhe Kombin ka qenë, dhe vazhdon të jetë pozitiv dhe i vlefshëm.

Paragjykimet, padrejtësitë dhe shpifjet e hershme janë lënë gradualisht mënjanë nëpërmjet përpjekjeve të forta dhe të vazhdueshme, duke i hapur rrugën një administrimi pragmatik të problemeve jetësore. Nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre aktive dhe vendimtare në jetën financiare, shoqërore dhe politike të vendit tonë, gratë, që tashmë përbëjnë një faktor të rëndësishëm të jetës kombëtare, marrin përsipër të kontribuojnë gjithashtu për një Greqi të lumtur dhe të gëzueshme.

Thanaseku, 1956, fq. 3.

1. Ndiqni fjalimin e dy deputeteve. Nxirrni në pah elementet e zakonshme, si edhe ndryshimet kryesore që karakterizojnë lidhjen e tyre politike.

2. Kryeni një studim për dhënien e të drejtës së votës për gratë në Evropën Juglindore. Krijoni një kalendar për të drejtën e votës së grave në vende të ndryshme të rajonit. Cili ishte ndikimi i dy luftërave botërore në përpjekjet e grave për të fituar të drejtën e votës?

VII-9. Laiciteti dhe barazia në Jugosllavi

A. Kushtetuta e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë për barazinë ndërmjet burrave dhe grave (1947)

Neni 24. Gratë janë të barabarta me burrat në të gjitha sferat e jetës shtetërore, ekonomike dhe shoqëroro-politike. Për punën që ato bëjnë, gratë kanë të drejtën e pagesës së barabartë me burrat dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë punësimi. Shteti mbron veçanërisht interesat e nënave dhe fëmijëve, duke siguruar salla lindjeje, shtëpi dhe kopshte për fëmijët, lejen e paguar për mungesa para dhe pas lindjes.

Kushtetuta e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë, neni 24, fq. 13. Printuar nga shtypi shtetëror, Beograd 1946; Kushtetuta e Republikës Popullore të Bosnjë-Hercegovinës, neni 25, Fletorja Zyrtare e NRBiH, viti III, nr. 1, Sarajevë, 1947, fq. 5.

B. Ligji për ndalimin e shamisë në Republikën Popullore të Bosnjë-Hercegovinës (1950)

Neni 1: Shpreh vullnetin e popullit, kolektivave punonjëse dhe organizatave të masave për heqjen e shenjës shumë të vjetër të nënshtrimit dhe prapambetjes kulturore të grave myslimane për t'iu krijuar mundësi atyre të gëzojnë plotësisht të drejtat e fituara në Luftën për Çlirimin Kombëtar dhe të ndërtimit socialist të vendit, dhe për të siguruar barazi të plotë dhe pjesëmarrje masive në jetën shoqërore, kulturore dhe ekonomike të vendit, vendosja e shamisë dhe mbulesës janë të ndaluara, si edhe mbulimi i fytyrës së gruas.

Neni 2: Ndalohet detyrimi dhe bindja e grave për të vënë shami dhe mbulesë, p.sh. për të mbuluar fytyrën e tyre, pasi janë të gjitha veprime që synojnë përkrahjen e vendosjes së shamisë dhe çdo forme tjetër të mbulimit të fytyrës së gruas.

Neni 3: Dënimi me tre muaj burg, ose gjoba prej 20,000 dinarë do të caktohet për: a) Çdo grua që vë shaminë ose që mbulon fytyrën e saj; b) Ata persona që i detyrojnë pjesëtaret e familjeve të vënë shami ose të mbulojnë fytyrën e tyre.

Neni 4: Dënimi me burg ose punë të detyruar deri në dy vjet ose me gjobë deri në 50,000 dinarë do të caktohet për: a) Këdo që përdor forcë, kërcënime, shantazhe dhe veprime të ngjashme, për t'i detyruar gratë të vënë një shami ose mbulesë; b) Ata që abuzojnë me ndjenjat fetare, përdorin paragjykim dhe prapambetje, ose në një tjetër mënyrë përhapin vënien e një shamie dhe mbulese fytyre.

Fletorja Zyrtare e Republikës Popullore të Bosnjë-Hercegovinës, nr. 32 (5 tetor 1950), fq. 427.

Fushata për të hequr mbulesën e fytyrës dhe shaminë filloi në vitin 1947, kryesisht nga aktiviste të Frontit Antifashist të Grave. Heqja masive e shamisë bëhej zakonisht në një lloj feste, konference apo ngjarje të shënuar publike, ku hidhej parulla: "Poshtë mbulesa e fytyrës" dhe gratë myslimane i hiqnin mbulesat e tyre të fytyrës. Pas rezolutës së Byrosë Informative (COMINFORM) në vitin 1948, që dënoi qëndrimin e Partisë Komuniste të Jugosllavisë pas ndarjes së Titos me Stalinin, autoritetet komuniste jugosllave vendosën të organizonin gratë dhe t'i përfshinin ato në punën për rindërtimin ekonomik të vendit. Shtypi shkroi vazhdimisht se gratë myslimane pa mbulesë fytyre mund të fitonin para më lehtë dhe mund të merrnin pjesë në mënyrë më aktive në rindërtim. Mbulesa e fytyrës u trajtua si një mbeturinë e së kaluarës, një relike e shoqërisë feudale dhe një fenomen shoqëror i vjetruar. Shtysa u mbështet edhe nga organet më të larta të bashkësisë fetare islamike në Jugosllavi. Zbatimi i ligjit u ndesh me qëndresën e fortë në Kosovë dhe Metohi, ku kundërshtarët e ndalimit të mbulesës së fytyrës pohonin se feja ishte në rrezik, dhe arsyetonin se ligji përbënte një fitore për serbët dhe një sulm për të drejtat kombëtare të shqiptarëve. Zyrtarët qeveritarë arrestuan dhe ndëshkuan ata më të zhurmshmit.

→

Si e arsyetoi ligji i vitit 1950 vendimin për ndalimin e mbulesës së fytyrës? A njihni ndonjë debat bashkëkohor për ndalimin e mbulesës së fytyrës *(niqab)* në publik? Gjeni arsyet pro dhe kundër ndalimeve të tilla (merrni në konsideratë praktikat e ndryshme fetare dhe kulturore, traditat dhe çështjen e të drejtave të grave). A ka debate të ngjashme në vendin tuaj?

VII-10. Shfuqizimi i ligjit për veshjen e uniformës së shkollës në Greqi (1982)

Në shkurt të vitit 1982, Ministria e Arsimit në qeverinë e parë socialiste të Greqisë i dha fund një simboli kryesor të arsimit shtetëror: uniformës së shkollës. Uniforma e shkollës ishte e detyrueshme si për vajzat edhe për djemtë, por në realitet vetëm vajzat ishin të detyruara ta vishnin atë, sepse mësuesit ishin më tolerantë me djemtë. Në vitet 1970 po lulëzonte tregu i uniformës shkollore dhe kishte marka mode për uniformat e vajzave. Shfuqizimi i uniformës së shkollës perceptohej përgjithësisht si favor nga pjesa më e madhe e shoqërisë, edhe pse në një shkallë të caktuar keqardhje. Dëshmia online e një nxënëse të shkollës së mesme nga krahinat në atë kohë e provon këtë.

Duket sikur ka ndodhur dje, kur tridhjetë e një vjet më parë ne shkuam në shkollë pa veshur uniformën tonë të shkollës, pa atë "uniformë" që na ndoqi pas që nga kopshti. Një ditë më parë ishte lajmëruar zyrtarisht shfuqizimi i saj. Ne ishim në klasën e pestë dhe heqja e uniformës së shkollës u realizua në kuadrin e modernizimit. Çfarë gëzimi! Çfarë entuziazmi! Ne vërshuam në rrugë të veshura me fustane dhe funde shumëngjyrëshe - për atë kohë nuk kishte porosi për të veshur pantallona përveçse gjatë orës së edukimit fizik; atëherë, një shok klase më tha se ne dukeshim si

një zgjua i zhurmshëm bletësh. Djemtë ishin të habitur sepse ishin mësuar që për njëmbëdhjetë vite të na shihnin me uniformën e shkollës. Dhe që nga ai mëngjes ne u ndeshëm me një tjetër problem, përveç stresit të marrjes së notave të larta në mënyrë që ne të mund të largoheshim më me lehtësi nga fshati për të vazhduar shkollimin e mëtejshëm. Çfarë duhet të vesh sot? Ne filluam të zgjoheshim gjysmë ore më herët në mëngjes që të mund të kujdeseshim për veshjen tonë. Shumë shpejt, entuziazmi ynë kishte marrë fund. Njeriu mësohet me gjithçka. Tashmë që vitet kanë kaluar, unë mendoj se uniforma e shkollës nuk ishte aspak barrë. Bashkë me të ne u lënduam, qamë, u mërzitëm, ëndërruam, dhe jetuam përmes gëzimeve tona të dashurisë së parë. […] Ajo ishte thjesht një veshje. Por a e dini çfarë? Tani unë e dua atë veshje dhe atë që ne kemi përjetuar së bashku gjatë viteve tërë vrull të adoleshencës.

http://kritivismata.blogspot.gr/2013/03/31_9.html, vizituar më 17.08.2016..

"Tashmë që vitet kanë kaluar, unë mendoj se uniforma e shkollës nuk ishte aspak barrë": Diskutoni kuptimin dhe përdorimin e veshjes së uniformës. A e konsideroni atë si "barrë" apo si një simbol të barazisë ndërmjet nxënësve? Diskutoni se si veshja mund të jetë mjet i diskriminimit dhe dallimit shoqëror.

PYETJE PËR KAPITULLIN VII.1

Burimet në këtë seksion i referohen statusit të grave në shoqëri të ndryshme të Evropës Juglindore në gjysmën e dytë të shekullit XX. Cilat ishin sfidat që u ndeshën gratë dhe që ato duhej t'i kapërcenin? A bini dakord me pohimin e mëposhtëm: "Zgjerimi i hapësirës së lirisë për gratë nënkupton zgjerimin e hapësirës së lirisë për këdo".

VII.2. FEJA

VII-11. Maria Bistrica: Një zonë pelegrinazhi në Kroaci

Maria Bistrica ka ndryshuar përgjithmonë dhe nuk do të jetë më si më parë. Megjithëse askush nuk e kujtoi propozimin publik të At Karlo Batiç që ke vend i shenjtë të deklarohej si vendi i shenjtë kombëtar kroat, kjo u bë në mënyrë spontane nga njerëzit – Maria Bistrica është shndërruar në Lourdes-in e Kroacisë. Kurrë më parë feja nuk ka grumbulluar në një vend kaq shumë besimtarë kroatë, nga të gjitha pjesët e atdheut. Kroatët nuk janë grupuar kurrë në një pjesëmarrje kaq masive në një veprimtari të tillë ndërkombëtare në shkallë të gjerë. Këtë vit, gjatë ditëve të fundit, kroatët u nxitën nga shpirti i tyre i brendshëm, i frymëzuar nga Kisha Katolike. Dhe, për të qenë shumë të qartë, nga Kisha Katolike në kuptimin e saj më modern dhe origjinal: Njerëzit e Zotit te populli kroat. Sepse, nëse është dikush që meriton të lëvdohet dhe t'i atribuohet suksesi i organizimit të këtij Kongresi ndërkombëtar Marian, ky është populli. Ata erdhën aty nga afër dhe nga larg dhe ishin me mijëra dhe dhjetëra mijëra besimtarë. Pse?

Glas Koncila, 22 gusht 1971.

Marija Bistrica është varri në Kroaci për Virgjëreshën Mari. Ai ka qenë një vend pelegrinazhi për shumë katolikë, madje edhe pasi komunistët erdhën në pushtet.

Një nga pelegrinazhet më të mëdha ishte në gusht të vitit 1971. Për sa i përket marrëdhënies tradicionale të identitetit kombëtar kroat dhe katolicizmit, duhet vëzhguar pjesëmarrja e masës gjithmonë e në rritje në pelegrinazh edhe në kontekstin e shprehjes së fortë të ndjenjave kombëtare në vitet 1960 dhe veçanërisht gjatë verës kroate (1971).

VII-12. Babangrica

Babangrica ishte shumë i njohur në Jugosllavi gjatë komunizmit, veçanërisht në Sllloveni dhe Kroaci, si pasojë e ndryshimeve në sistemin shoqëror dhe prirjes drejt një shoqërie më laike. Megjithëse origjina e Babangricës lidhej me historitë ruse, në Sllloveni ai mendohej se jetonte në malin e lartë slloven (Triglav), dhe vishte një pallto të zbukuruar me simbole sllovene tipike dhe një kapele gri prej gëzofi. Zakonisht ai shpërndante dhurata në Vitin e Ri. Ai vizitonte gjithashtu kopshte dhe u jepte dhurata fëmijëve në vendin e punës së prindërve të tyre gjatë veprimtarive të organizuara kryesisht nga sindikatat. Me rënien e komunizmit, është e zakonshme që fëmijët sllovenë të vizitohen nga tre njerëz të mirë: Shën Nikolla (6 dhjetor), Babagjyshi (Krishtlindje) dhe Babangrica (Viti i Ri).

Muzeu i Historisë Bashkëkohore, Lubjanë..

VII-13. Baba Vanga: Një orakulle e famshme bullgare e pranuar dhe e njohur si e tillë nga udhëheqësit e Partisë Komuniste

http://informiran365.net/Aferi/Sapyori-tragnali-po-sledite-na-sakrovishtata-na-baba-Vanga, vizituar më 17.08.2016.

Vangjelia Pandeva Gushterova, e njohur më shumë si Baba Vanga (Gjyshe Vanga), u lind në qytetin e Strumicës në vitin 1911. Kur familja e saj kaloi në qytetin Petrich në vitin 1947 ajo ishte e njohur për aftësinë e saj për të gjetur bagëtitë e humbura dhe për të komunikuar me të vdekurit. Në fund të viteve 1960 dhe në fillim të viteve '70, reputacioni i saj si fallxhore, orakulle dhe shëruese u promovua nga elitat socialiste bullgare falë kontakteve të saj me Ludmilla Zhivkova, vajzën e Todor Zhivkovit, që midis viteve 1975 dhe 1981 ishte kryetare e Komitetit të Kulturës. Nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e Partisë Komuniste u hartuan listat paraprake të atyre që donin ta vizitonin; vizitorët vëzhgoheshin nga policë sekretë. Vanga fitoi interesin, respektin dhe përkrahjen e një sërë politikanësh bullgarë dhe të huaj, dhe të njerëzve të artit si Aleksandër Lilov, Nikolai Giaurov, Svetlin Rusev, Lyubomir Levkev, Boris Jeltsin, Viakeslav Tikonov, Svetoslav Rerik dhe Jevgjeni Jevtushenko. "Profetja bullgare" vdiq në vitin 1996. Në vitin 2008, shtëpia e saj në qytetin Petrich u shndërrua në muze.

VII-14. "Ajo na ftoi të flisnim kundër Zotit": Intervistë me Ivanka Grozdeva (b. 1937), një punonjëse biblioteke nga Targovishte

Julia Dulgerova na ftoi në një nga klubet ateiste. Atëherë në të gjithë vendin kishte klube të tilla. Ne ishim 22 punonjës të bibliotekës vendore ku unë punoja në atë kohë. Pra, ajo na ftoi të flisnim kundër Zotit, dhe donte që të nguliste ateizmin te ne [...]. Personi që ishte i ngarkuar nga klubi zhvilloi leksionin e tij, që zgjati rreth dy orë; dhe tha: "Kur ka pushime ne shkojmë në kishë dhe mbajmë shënim personat që shkojnë atje". Por unë më pas i thashë: "Ju nuk mund ta imagjinoni se sa të pasakta janë statistikat tuaja. Unë punoj këtu. Kisha e Shën Nikollës është këtu pranë; dhe unë para se të vij të punoj, shkoj aty të ndez një qiri, më pas shkoj në kishën e Shën Gjergjit dhe ndoshta ju më keni regjistruar në listën tuaj si një person që shkon në kishë. Statistikat tuaja nuk janë shumë të sakta. Por, ka diçka tjetër që unë dua t'ju them. Kur hyn në kishë, nuk mund ta imagjinosh se sa e lehtë është t'i dallosh njerëzit e tuaj, pasi ata veshin rroba civile. Nga ana tjetër, njerëzit tuaj, kolegët tuaj që ju i çoni në kishë nuk mbajnë një qiri [...] Është e qartë që ata na numërojnë, ashtu siç na numëruat edhe ju sot. Ju na numëruat për të raportuar numrin e saktë të personave që frekuentojnë kishën". Natyrisht që unë pata pasoja. Por, ishte shumë vonë kur unë e kuptova këtë [...]. Në vitin 1992, unë takova një koleg timin në

dyqanin e kishës. U takuam kur po blija libra, ikona dhe sende. Dhe ai më tha: "Drejtoresha Julia Dulgerova erdhi të na sugjeronte se ju duhet të pushoheshit nga puna në bibliotekën vendore sepse ju ishit thellësisht besimtar dhe frekuentonit tre kisha në qytet".

Intervistë e regjistruar më 10 korrik 2010 (10.30 – 12.30), Arkivi i Shënjimit të Tranzicioneve dhe Kuptimi përgjatë Jetës: Kujtesë nga Ceremoni Fetare dhe Laike në Shoqërinë e Projektit të Evropës Lindore dhe Perëndimore, AHRC/ESRC Feja dhe Shoqëria – Faza e Tretë..

Baba Vanga dhe Julia Dulgerova bashkëjetuan në të njëjtin mjedis politik. Çfarë përfaqësuan ato? Dalloni ndonjë kontradiktë në dy burimet e veprimtarive të të dyja grave. A kishte ose a ka ndonjë personalitet me ndikim si Baba Vanga në vendin tuaj?

VII-15. Pasqyrë statistikore e numrit të besimtarëve, indiferentëve dhe ateistëve në shoqërinë jugosllave gjatë viteve 1953-1990 si përqindje e të gjithë popullsisë në vitet 1953-1990

	1953		1964	1968	1990
Besimtarë	87%	88.6%	70.3%	39%	43%
Indiferentë ose të pavendosur		0.8%	0.5%	10%	9%
Ateistë	13%	12.6%	29.2%	51%	48%

Ramet, 1990, fq. 201; Velikonja, 2003, fq. 189. Të dhënat statistikore për vitin 1953 janë paksa të ndryshme në të dy librat dhe listohen në dy nënkolona të ndara.

Pas Luftës së Dytë Botërore, besimi dhe respektimi fetar në Jugosllavi ra për shkak të modernizimit, urbanizimit, dhe propagandës antifetare. Një anketim i kryer në vitin 1964 tregoi se 70.3% e popullsisë së përgjithshme e konsideronin veten si besimtarë. Përqindja më e madhe u regjistrua në Kosovë (91%) dhe Bosnjë-Hercegovinë (83.8%), ndërsa më e ulëta në Sllloveni (65.4%), Serbi (63.7%) dhe Kroaci (63.6%).

Krahasoni ndryshimet në përqindje të besimtarëve në Jugosllavi para vitit 1990 dhe në Serbi pas vitit 1990 (vëll. 2, kapitulli V.2 Feja). Si i shpjegoni ndryshimet në qëndrimet ndaj fesë dhe laicizmit gjatë këtyre gjashtë dekadave?

VII-16. Bashkëjetesa ndërmjet shumë etnive në Ferizaj, Kosovë

Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës, Fondi Fotografitë në versionin bardhezi, Fondi: Fotografitë [Arkivat Shtetërore të Kosovës, Koleksion fotografish].

Ferizaj në shqip, ose Uroševac në serbisht, është një qytet në pjesën jugore të Kosovës. Në qendër të qytetit ndodhet Xhamia e Madhe e Mulla Veselit, e ndërtuar në vitin 1981 dhe Katedralja Ortodokse e Shën Uroš, e ndërtuar gjatë viteve 1929-1933, të cilat konsiderohen si simbole të tolerancës fetare ndërmjet shqiptarëve myslimanë dhe serbëve të krishterë.

VII-17. Sinteza turko-islamike

Pavarësisht ideologjisë laike mbizotëruese të qemalizmit, elitat turke kishin filluar të ktheheshin nga feja menjëherë pas pasojave të Luftës së Dytë Botërore. Megjithatë, perceptimi se dy nga burimet kryesore të kulturës kombëtare ishin turqizmi dhe Islamizmi u shfaq vazhdimisht, si një sintezë turko-islamike, vetëm në vitet 1970. Ky perceptim u përforcua nga grushti i shtetit i vitit 1980, nxitësit e të cilit besonin se Islami mund të vepronte si një pengesë për komunizmin. Në vitet 1980, kjo "sintezë" u shndërrua në një ideologji shtetërore, dhe feja u rishfaq në semiotikën shtetërore dhe ceremoni. Një rol të rëndësishëm në shpërndarjen e saj luajti edhe Instituti për Studimin e Kulturës *(Türk Kültürünü Araştırma Enstitüsü, TAKE)*. Ai u themelua në vitin 1961 dhe publikoi periodikun mujor Türk Kültürü. Pozicioni i fesë si një element themelor i identitetit kombëtar turk, u mbështet në një artikull të vitit 1978 të titulluar "Veçoritë e nacionalizmit turk dhe nacionalistëve turq".

Nacionalistët turq i janë përkushtuar me shpirt Islamit. Ata i quajnë gjuhën dhe fenë si dy shtyllat kryesore të kombit ndaj duan që fesë t'i jepet vendi që i takon. Ata e perceptojnë Islamin si kthim te burimet. Nacionalistët i respektojnë të gjitha vlerat shpirtërore fetare dhe kombëtare.

Türk Kültürü, botimi 188, 1978, fq. 449-452 në Copeaux, fq. 97..

1. Cilat janë dy shtyllat bazë të kombit turk sipas burimit VII-17?

Lexoni me kujdes burimet në këtë seksion dhe gjeni shembuj të tjerë të lidhjeve të forta ndërmjet fesë dhe nacionalizmit/identitetit kombëtar.

2. Lexoni fjalinë: "Kjo u përforcua nga grushti i shtetit i vitit 1980, nxitësit e të cilit besonin se Islami mund të vepronte si një pengesë për komunizmin". Kërkoni për qëndrime të ngjashme në fusha dhe periudha të tjera, për shembull gjatë Luftës Franko-Algjeriane. Pse mendoni se ideja e Islamit si një pengesë për komunizmin është gjerësisht e përhapur? Përdorni argumente bazuar te burimet për fenë në të dyja vëllimet.

VII-18. Deklarata e përbashkët Katolike Ortodokse e Papës Paul VI dhe Patrikut Ekumenik Atenagora I, 7 dhjetor 1965, për shfuqizimin e shkishërimeve të ndërsjellta të vitit 1054

Papa Pauli VI dhe Patriku Atenagora I me sinodin e tij, në marrëveshje të përbashkët, deklarojnë se:

A. Atyre u vjen keq për fjalët fyese, vërejtjet pa baza, dhe gjestet e dënueshme që nga të dyja anët kanë shoqëruar ngjarjet e trishtuara të kësaj periudhe.

B. Gjithashtu, ata ndiejnë keqardhje dhe i largojnë të dyja palët nga kujtesa dhe nga thelbi i Kishës dënimet e shkishërimit që pasuan këto ngjarje, kujtimet e së cilës kanë ndikuar mbi veprimet deri në ditët e sotme dhe ka penguar krijimin e marrëdhënieve të ngushta në bamirësi; dhe ata kërkojnë që këto shkishërime t'ia lënë harresës. Ata shpresojnë se e gjithë bota e krishterë, veçanërisht e gjithë Kisha Katolike Romake dhe Kisha Ortodokse, do ta vlerësojnë këtë gjest si shprehje të një dëshire të sinqertë të përbashkët për pajtim, dhe si një ftesë për të vazhduar në frymën e besimit, vlerësimit dhe bamirësisë së ndërsjelltë dialogun që, me ndihmën e Zotit, do të çojë sërish drejt bashkëjetesës, për të mirën e madhe të shpirtrave dhe ardhjes së mbretërisë së Zotit, në këtë bashkësi të plotë besimi, lidhje vëllazërore dhe jete të shenjtë që ekzistoin dërmjet tyre gjatë njëmijë vjetëve të parë të jetës së Kishës.

https://w2.vatican.va/content/paul-vi/en/speeches/1965/documents/hf_p-vi_spe_19651207_common-declaration.html, vizituar më 17.08.2016.

Cilat janë ngjarjet e trishta të cilave u referohet kjo deklaratë? A mendoni se kjo lëvizje u mirëprit nga të gjitha palët Brenda Kishave Katolike dhe Ortodokse? Gjeni artikuj të shtypit bashkëkohor për temën dhe paraqisni gjetjet tuaja.

PYETJE PËR KAPITULLIN VII.2

Si u përpoqën regjimet komuniste në Evropën Juglindore të nënshtronin fenë dhe traditat fetare? A u morën të gjitha regjimet komuniste në të njëjtën mënyrë me fenë? A gjetët ju ndonjë shembull në burimet e bashkëjetesës të të "vjetrës" me të "renë"?

VII.3. KULTURA E TË RINJVE

VII-19. Karikaturë e të ashtuquajturit "zozi" dhe "qejflinjve"

Përkthimi: Pamje e kafshëve në Sofje
Turma *qejflinjsh* dhe huliganësh që sillen në mënyrë të pahijshme dhe shqetësojnë punëtorët që pushojnë janë rishfaqur së fundmi në bulevardin "Ruski" dhe në parqet e kryeqytetit.
Kopshti zoologjik. Kopshti [publik] përpara Shtëpisë Qendrore të Ushtrisë së Popullit [në qendër të qytetit të Sofjes].

Стършел [Starshel], 1950..

Qejflinjtë bullgarë dhe zozat ishin ndjekës të një lëvizjeje nënkulturore që lindi në Gjermani dhe Francë gjatë Luftës së Dytë Botërore. *Zazous* ishin të rinj parisianë që shprehnin qëndresën e tyre ndaj pushtimit nazist duke përqafuar hapur modën amerikane dhe muzikën xhaz. Bashkëmoshatarët e tyre gjermanë ishin të ashtuquajturit *Swing-Jugend* (fëmijët qejflinj). Megjithatë, termi bullgar *qejflinj*, iu referohej vetëm të rinjve, ndërsa *zozat* nënkuptonte të rejat. Pas vitit 1946, *qejflinjtë* dhe *zozat* kritikoheshin gjithmonë e më shumë si të dashuruarit e "muzikës dekadente"dhe propagandues të "vlerave borgjeze". Paraqitja dhe veshja e tyre ekstravagante, me fustane shumë të ngushta me dekolte, funde të shkurtra dhe këpucë me taka të larta për vajzat, dhe xhaketa të gjata dhe të gjera, dhe pantallona për të rinjtë, ishin bërë objekt talljesh gjerësisht. Gazeta humoristike "*Starshel*" (Grenza) publikoi një sërë karikaturash sarkastike, që nxirrnin në pah mungesën e vullnetit të tyre për të marrë pjesë në nismat e punëtorëve të organizuara nga Partia. *Zozat* dhe *qejflinjtë* përshkruheshin si persona të shthurur dhe dembelë që jetonin si "parazitë" në kurriz të punëtorëve, dhe që interesoheshin vetëm të kërcenin dhe të kënaqnin pasionet e tyre të pashëndetshme për kulturën amerikane. Krahas dënimit publik, *zoza-t* dhe *qejflinjtë* i nënshtroheshin përndjekjes së ashpër, dhe shumë prej tyre u dërguan në kampet e punës të akuzuar për huliganizëm dhe prishje të rendit publik. Në këtë drejtim, ata mund të përkufizohen si përfaqësues të nënkulturave të para të të rinjve në Bullgari.

Studioni burimin VII-19 dhe çelësin shoqërues, dhe përshkruani se si e shprehu karikaturisti qëndrimin e tij ndaj nënkulturave të të rinjve. Gjeni disa nga stereotipet për qejflinjtë dhe zozat e përmendur te çelësi.

VII-20. Koncerti i Rolling Stones në Athinë, 17 prill 1967

Fotografi nga K. Megalokonomos, në Katsapis, 2007, fq. 416.

Kjo fotografi e të rinjve grekë të të dyja gjinive, që shpreh adhurimin e tyre për Rolling Stones nën vështrimin vigjilent dhe të mahnitur të policëve,u bë katër ditë pas grushtit të shtetit të 21 prillit. Disa minuta më vonë arena e koncertit u braktis duke pasuar me përplasjet me policinë. Nga fundi i viteve 1950 dhe në vazhdim një pjesë e konsiderueshme e të rinjve grekë në qendrat urbane iu kthye muzikës Rock 'n' Roll. Duke përkrahur në një shkallë të madhe mënyra të reja sjelljeje në veshje, modelim flokësh dhe argëtim, ata tërhoqën vëmendje negative nga ana e rrathëve konformistë që ngritën kundër tyre akuza për imoralitet dhe prirje "të panatyrshme" për të ndjekur format amerikane të sjelljes.

VII-21. *Bijelo Dugme* (Kopsa e bardhë)

Bijelo Dugme, grupi shumë i njohur muzikor jugosllav u formua në Sarajevë, në vitin 1973 dhe regjistroi deri në vitin 1988 nëntë albume. Udhëheqësi i grupit dhe pjesëtar i vetëm i përhershëm ishte kitaristi Goran Bregoviç. Me albumin e tyre të parë ("Nëse do të isha një kopsë e bardhë", 1974), ata u pagëzuan si "barinjtë e muzikës rock", një bandë që kombinoi muzikën rock 'n' roll me ritmet dhe muzikën tradicionale të popujve jugosllavë. Kjo prirje u ruajt në të gjitha albumet e tyre, me një lloj ndikimi nga "New Wave" (Valës së Re). Albumi i tyre i fundit ("Ćiribiribela", 1988) kishte një "ngjyrim" politik pasi ai nxiti bashkimin e popujve jugosllavë në një kohë kur vendi u zhyt në

→

krizën ekonomike dhe nacionalizmin etnik. Si rrjedhojë, kënga "Lijepa naša" (E bukura jonë) kombinon vargjet nga himni kombëtar kroat me tekstin e një kënge lufte patriotike serbe të Luftës së Parë Botërore. Kjo "përzierje" nuk u pranua mirë nga audiencat në Kroaci dhe Serbi, që e përbuzën me zë të lartë kur u këndua në koncerte. Grupi zhvilloi turin e tyre të fundit në vitin 1988, dhe ata u takuan sërish në vitin 2005 ku organizuan koncerte në Zagreb, Beograd dhe Sarajevë.

***E bukura jonë* (1988)**

Ndonjëherë unë ëndërroj sikur ne fluturojmë
Sikur ne fluturojmë të vetëm sikur jemi të mallkuar
Unë ëndërroj për erën veriore që të lodh krahët
Dhe unë dhe ti, gjuajmë me fajkua dhe ajo gjuan me fajkua
Duke kërkuar shpatullën e gjuetarit të fajkoit
Atdheu ynë i bukur,
Vendi i ëmbël heroik
Aty, larg prej këtu
Aty, larg prej këtu
Aty, larg prej këtu
Larg nga deti, larg nga deti
Ndonjëherë unë ëndërroj për Krishtlindjet
Pastaj më zgjojnë trenat
Ata udhëtojnë drejt jugut nga jastëku im
Në vendin ku jeton zemra ime
Ku njerëzit vajtojnë për mua në Krishtlindje

http://lyricstranslate.com/en/lijepa-nasa-our-beautiful.html, vizituar më 17.08.2016.

VII-22. Hipitë

Në fund të viteve 1960, shpellat e Matalas në bregun jugor të Kretës, u shndërruan në parajsë për të rinjtë e shtresës së mesme, nga e gjithë bota që donin të përjetonin dhe praktikonin "lirinë" nëpërmjet rreshtave të motos së shkrimtarit dhe filozofit grek me famë ndërkombëtare Nikos Kazanzakis: "Nuk shpresoj për asgjë; Nuk kam frikë nga asgjë; Jam i lirë". Bashkësia hipi në Matala, shfaqte lëvizjen e të rinjve në vitet 1960 që kërkonin "rikthimin në natyrë" dhe "të humbisnin pafajësinë" të përfaqësuar nga mënyra jetesë para periudhës moderne. Megjithatë, prania e tyre dhe veçanërisht veprimtaritë e tyre argëtuese, nga lakuriqësia dhe pirja e hashashit, te seksi në grup, ishin provokuese për shoqërinë tradicionale bujqësore vendase të Kretës dhe u përballën me kundërshtimin e ashpër të vendasve dhe të juntës në Athinë. Duke marrë në konsideratë faktin se ajo ishte një periudhë e zhvillimit të turizmit në masë, veçanërisht në Kretë, reagimet e vendasve ishin më të ndërlikuara dhe jo anonimë negativë. Në verën e vitit 1970, me pretekstin e "kongresit ndërkombëtar të ardhshëm të hipive", policia e largoi "bashkësinë", mësyu në shpellat e tyre dhe u vuri zjarrin.

→

A. Shpellat e Matalas, Kretë

http://agonaskritis.gr/%CE%BC%CE%AC%CF%84%CE%B1%CE%BB%CE%B1-%CE%B7-%CF%80%CF%81%CE%B1%CE%B3%CE%BC%CE%B1%CF%84%CE%B9%CE%BA%CE%AE-%CE%B9%CF%83%CF%84%CE%BF%CF%81%CE%AF%CE%B1-%CF%86%CF%89%CF%84%CF%8C%CF%82/, vizituar më 17.08.2016.

B. Peshkopi Timoteos, shkurt 1970

Këta shpirtra të këqij janë dëbuar nga shpellat para se ato të ktheheshin në skutat e hashashit dhe sëmundjeve veneriane. Të dëbuar nga shtetet e tyre, si të padobishëm, kjo baltë ka rënë tashmë mbi ne. Në pak kohë, i gjithë shteti, fshatrat dhe shtëpitë tona do të shndërrohen në një Matala të madhe. Askush nuk do të jetë i aftë të përmbajë llavën e lëvizjes hipi. E keqja do të vërshojë mbi ne.

Theodhoru, 2007, fq. 86.

Koncepti i nënkulturës zakonisht përfshin "sistemet e vlerave, besimeve, traditave, praktikave, preferencave kulturore dhe mënyrave të jetesës të dallueshme nga ato që përmban në përgjithësi kultura mbizotëruese, por që ndërlidhen me to". Grupet e të rinjve të nënkulturës priren të duken sikur i shkatërrojnë vlerat normative të popullsisë së të rriturve. Si do ta përshkruanit lidhjen e nënkulturave të të rinjve të përcaktuar në këto burime me kulturat mbizotëruese? Si forma të kundërvajtjes, forma të qëndresës ose forma të dallimit? Ndërtoni argumente nga faktet e përmendura në këtë burim. Jini të kujdesshëm që të mos pranoni automatikisht këndvështrimet e autorëve të burimeve.

VII.4. LETËRSIA DHE KINEMAJA

VII-23. Fituesi i Çmimit "Nobel", Ivo Andriç, përshkruan Bosnjën gjatë periudhës otomane

Des Fossés nuk e fshehu faktin se ai ishte i befasuar me kokëfortësinë me të cilën në Bosnjë jo vetëm turqit, por edhe njerëzit e të gjitha besimeve të tjera, i bënë qëndresë çdo ndikimi, madje kundërshtuan çdo risi, përparim, madje edhe ajo që ishte e mundshme të realizohej brenda rrethanave të vendit e që varej vetëm prej njerëzve të vendit. Ai nxori në pah të gjithë dëmin që vinte nga kjo ngurtësi "kineze", dhe nga mënyra se si ata e shkëpusnin veten nga jeta.

Des Fossés pyeti "Si është e mundur për vendin që të jetë i qëndrueshëm dhe i organizuar, dhe të përvetësojë një shkallë qytetërimi të afërt me atë të fqinjëve, ndërkohë që njerëzit e tij të jenë kaq të ndarë si askund tjetër në Evropë? Në këtë rrip toke të ngushtë, malor dhe të varfër, jetojnë katër besime. Secili prej tyre është i veçantë dhe rreptësisht i ndarë nga të tjerët. Të gjithë jetojnë në të njëjtin qiell dhe në të njëjtën tokë, por qendra e jetës shpirtërore të secilit prej këtyre katër grupeve është shumë larg, në një tokë të huaj, në Romë, Moskë, Stamboll, Mekë, Jeruzalem, dhe vetëm Zoti e di se ku, dhe në çdo pjesë ku njerëzit lindin dhe vdesin. Dhe secili grup mendon se mirëqenia e tij kushtëzohet nga mungesa e epërsisë së tre besimeve të tjera, dhe se ato mund të përparojnë në kurriz të tyre. Dhe secili prej tyre e ka shndërruar mungesën e tolerancës në virtytin më të madh. Dhe secili prej tyre pret shpëtim nga diku tjetër, secili në drejtimin e kundërt.

Andriç, 1963; http://www.ivoandric.org.rs/html/bosnian_andric_s_treasury.html, vizituar më 17.08.2016.

Ivo Andriç u lind në Travnik (Bosnjë) në vitin 1892. Gjatë viteve të tij të shkollës së mesme në Sarajevë, Andriç mori pjesë aktivisht në Lëvizjen e të Rinjve të Orientuar nga Sllavët e Jugut, që më vonë u njoh si Bosnja e Re. Midis vitit 1912 dhe shpërthimit të Luftës së Parë Botërore, ai studioi në universitetet e Zagrebit, Vjenës dhe Krakovit. Në verën e vitit 1914, ndërkohë që ishte me pushime në Split, ai u burgos nga autoritetet austriake me dyshimin se ai ishte përfshirë në vrasjen në Sarajevë. Pasi kaloi tre vjet në burg, ai u rehabilitua dhe u dërgua për trajtimin e tuberkulozit në Zagreb. Pas fundit të Luftës së Parë Botërore dhe krijimit të Jugosllavisë, ai u zhvendos në Beograd. Nga viti 1920 deri në fillim të Luftës së Dytë Botërore ai punoi kryesisht në shërbimin diplomatik. Në vitin 1937 ai u emërua Zëvendës Ministër i Punëve të Jashtme dhe në vitin 1939 Ministër i Plotfuqishëm dhe i Dërguar i Jashtëzakonshëm në Berlin. Ai u kthye në Beograd në fillim të verës së vitit 1941 dhe jetoi në izolim gjatë luftës, duke u përqendruar te shkrimi i romaneve të tij *Kronika boshnjake*, *Ura mbi lumin Drina* dhe *Gruaja nga Sarajeva*. Pas luftës, ai u përfshi në jetën kulturore dhe politike të Jugosllavisë së re socialiste. Ai fitoi Çmimin "Nobel" për Letërsinë në vitin 1961 për romanin e tij *Ura mbi lumin Drina*. Andriç vdiq në Beograd në vitin 1975.

VII-24. Fituesi i Çmimit "Nobel", Orhan Pamuk përshkruan Stambollin e viteve 1950

Romancieri dhe akademiku Orhan Pamuk (b. 1952) është autori i parë turk që fitoi Çmimin "Nobel" në Letërsi (2006). I lindur në Stamboll në një familje të shtresës së lartë, ai u arsimua në kolegjin Robert. Ai përshkruan fëmijërinë e tij në romanet *Libri i Zi* (1990) dhe *Xhevdet beu dhe djemtë e tij* (1982), dhe në romanin *Stambolli* (2003), përshkruan me më shumë detaje kujtimet e tij.

Gustav Flober, që vizitoi Stambollin 102 vite para se unë të lindja, mbeti i befasuar nga larmia e jetës në rrugët e tij të populluara; dhe në një prej letrave të tij ai parashikoi se brenda një shekulli Stambolli do të ishte kryeqyteti i botës. Në fakt ndodhi e kundërta: Pas rrëzimit të Perandorisë Osmane, bota pothuajse harroi se Stambolli ekzistonte. Qyteti ku unë linda ishte i varfër, i lënë pas dore, dhe shumë më i veçuar sesa ai kishte qenë gjatë historisë së tij dymijëvjeçare. Për mua ai ka qenë gjithmonë një qytet i rrënojave dhe kujtim i trishtë i fundit të perandorisë. Unë e kam kaluar jetën time ose duke luftuar me kujtimin e trishtë (si të gjithë *banorët e Stambollit*) ose duke e bërë atë pjesë timen.

Të paktën një herë në jetë, vetëreflektimi na udhëheq drejt shqyrtimit të rrethanave të lindjes sonë. Pse ne kemi lindur në këtë pjesë të veçantë të botës, në këtë datë të veçantë? Familjet ku ne lindëm, shtetet dhe qytetet ku na ra lotaria të jetojmë presin dashuri nga ne, dhe në fund ne i duam ata nga thellësia e zemrave tona;

por a vallë meritojmë ne më mirë? Ndonjëherë e quaj veten të pafat që kam lindur në një qytet të vjetër dhe të shkretuar, të groposur nën hirin e një perandorie të rrënuar. Por një zë brenda meje këmbëngul gjithmonë se kjo ka qenë vërtetë një copëz e fatit. Nëse kjo lidhet me pasurinë, unë sigurisht mund ta quaj veten fatlum, që kam lindur në një familje të pasur, në një kohë kur qyteti ishte në rënien e tij më të madhe (megjithëse disa kanë arsyetuar me kompetencë të kundërtën). Kryesisht unë nuk dëshiroj të ankohem; dhe e kam pranuar qytetin ku kam lindur në të njëjtën mënyrë që kam pranuar trupin (edhe pse do të kisha dashur që të isha më i pashëm dhe i mirëformuar) dhe gjininë time (megjithëse ende e pyes veten, në mënyrë naive, nëse do kishte qenë më mirë të kisha lindur grua). Ky është fati im, dhe nuk ka kuptim që unë t'i dal kundër. Ky libër ka të bëjë me fatin.

Pamuk, 2006, fq. 6-7; https://books.google.gr/books?id=FEPbryS4KBUC&printsec=frontcover&dq=pamouk+orhan+istanbul&hl=el&sa=X&ved=0ahUKEwjPnIe-l8PKAhULIxoKHasLAvUQ6AEIJjAA#v=onepage&q=pamouk%20orhan%20istanbul&f=false, vizituar më 17.08.2016.

VII-25. Ekstrakt nga poema me titull "*Mbreti i Asinit* [King of Asine]", e fituesit të Çmimit "Nobel" Xhorxh Seferi (1900-1971)

Pasardhësi i një familjeje të shtresës së mesme dhe diplomat në karrierë, puna e Seferit u lëvdua për "stilin e tij lirik, që u frymëzua nga një ndjenjë e thellë për idealin kulturor grek". "*Mbreti i Asinit*" (1938-40) është një nga poemat e tij më të rëndësishme. Ajo përdor një varg nga Iliada, ku shfaqet për herë të parë dhe të vetme emri Asin, një qytet pranë Nauplios së sotëm që ndihmoi me anije në Luftën e Trojës. Në këtë ekstrakt, Seferi kërkon për gjurmë të pranisë së Mbretit të Asinit që përdorte një sërë simbolesh: strehë kaskete, statuja, rrema. Këto simbole nxjerrin në pah kuptimin e rrënimit dhe mungesës, dhe njëkohësisht theksojnë dialogun konstant të poetit me botën antike greke.

Mbreti i Asinit

Gjatë gjithë mëngjesit ne kërkuam për kështjellën duke filluar nga ana e turbullt ku deti jeshil dhe pa shkëlqim,
zemra e një palloi të vrarë, na mori si koha pa pushim.
Damarët e shkëmbit zbresin nga sipër, hardhi të gërshetuara, të zhveshura, me shumë degë, që marrin jetëme prekjen e ujit, ndërsa syri i ndjek ata të përpiqen t'i largohen valës së lodhshme dhe gradualisht të dobësuar.

Në anën me diell një bregdet i gjatë i zgjeruar
dhe drita që përplaset te diamantet në muret e mëdha.
Asnjë krijesë e vetme e gjallë, pëllumbat e egër kanë fluturuar,
dhe Mbreti i Asinit, për të cilin ne kemi kërkuar prej dy vjetësh tashmë
të panjohur, të harruar nga të gjithë, madje edhe nga Homeri vetëm një fjalë te Iliada, dhe kjo pasiguri u përplas këtu si një maskë e artë varrimi.

Poezia moderne greke, 1982, fq.105-106.

VII-26. Jani Ricos, Laureat i Kurorës së Artë, në Festivalin e Poezisë, Strugë, 1985

Jani Ricos (1909-1990) konsiderohet si një nga poetët grekë më të mëdhenj të shekullit XX. Një njeri i letrave me shumë prodhimtari, në veprën e tij poetike që është përkthyer në shumë gjuhë; ai kombinoi lirikën dhe risitë morfologjike me temat që lidheshin kryesisht me betejat politike dhe shoqërore të vendit të tij. Ai u bë anëtar i Partisë Komuniste të Greqisë gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore dhe mori pjesë në Rezistencën Kombëtare kundër Forcave të Boshtit. Për shkak të besimeve dhe idealeve të tij komuniste, ai u dëbua gjatë Luftës Civile në Greqi dhe sërish gjatë diktaturës ushtarake të viteve 1967-1974. Në vitin 1977, ai mori Çmimin Ndërkombëtar "Lenini" për Paqen. Tetë vjet më vonë ai u shpall Laureat i Kurorës së Artë në Festivalin e Poezisë në Strugë. I zhvilluar në një qytet të vogël në breg të liqenit të Ohrit, që prej vitit 1962 ky festival ndërkombëtar i poezisë ka nderuar shumë poetë të famshëm nga e gjithë bota. Ndër fituesit e çmimit përmendim Eugenio Montale, Seamus Heaney, Ted Hughes dhe W.H. Auden, si edhe poetë të tjerë që konsideroheshin disidentë në shtetet e tyre, si Joseph Brodsky, Pablo Neruda dhe Bulat Okudzhava.

Ekstrakte nga parathënia e autorit Gane Todorovski në nderim të Jani Ricos

Vargu i tij është gëzim, dënim, betim, zemërim, sulm, depërtim, armë. Vargu i tij është guxim. Vargu i tij është një metaforë drithëruese madhështore e qëndresës greke […]. Poemat e Ricos janë përkthyer në mbarë botën. Nën tingujt magjikë të melodive të

Mikis Theodorakis, ato kanë përshkuar mbarë botën. Rezonanca e tyre revolucionare lartësohet përgjatë oqeaneve dhe deteve të çdo kontinenti, duke u ngulitur në zemrat e njerëzve. Ricos i përket njerëzimit, dhe në vjershën e tij zhvillohet pareshtur lufta në emër të Njeriut.

Na lejoni ta mirëpresim atë në klimën maqedonase, dhe le të tregojë kjo një shtrëngim duarsh të ndershëm ndërmjet dy popujve të afërt fqinj, në angazhimin e tyre të pashtershëm për mirëqenien e përbashkët, vëllazërinë dhe kuptueshmërinë e mirë.

Gilevski dhe Todorovski, 1985, fq.19-20.

VII-27. Ekstrakt nga poema me titull "Axion Esti" e fituesit të Çmimit "Nobel" Odisea Elitis (1911-1996)

Poema e Odisea Elitis Axion Esti (1959) është 88 faqe. Ajo konsiderohet vepra e tij e madhe letrare dhe një nga pjesët më të rëndësishme të letërsisë moderne greke. Poema është strukturuar sipas traditës ortodokse dhe himnografisë bizantine, dhe ndahet në tre pjesë: "Gjeneza", "Pasioni", "Lavdia". Nxjerrja e vazhdimësisë historike dhe artistike të Helenizmit, "Gjeneza" i referohet lindjes së poetit dhe mënyrës se si krijimi i botës ngulitet në ndërgjegjen e tij. "Pasioni" i referohet pasioneve të Helenizmit dhe të poetit deri në katarsis, që reflekton kujtesën historike të Luftës së Dytë Botërore. "Lavdia" përfaqëson himnin e triumfit të jetës ndaj vdekjes, një himn për Greqinë dhe natyrën greke. Fragmenti është shkëputur nga "Gjeneza" dhe i referohet krijimit të detit, dhe në veçanti deti Egje, një terren poetik i vlefshëm për Elitis. Nëpërmjet një vështrimi diakronik, poeti lidh kuajt antikë të gurit dhe amforat me ullinjtë që sot ende stolisin ishujt e Egjeut. Fragmenti përfundon me thirrjen "Kjo botë / kjo botë e vogël shumë e madhe!" që përsëritet gjatë gjithë poemës, duke nxjerrë në pah në këtë mënyrë lidhjen e përvojës personale të poetit me pafundësinë e universit.

Më pas ai foli dhe deti u krijua
Dhe unë e vështrova dhe u mrekullova
Në qendrën e tij ai shfaqte botë të vogla në imazhin dhe pamjen time:
Kuaj guri me krifë të ngritura dhe amfora të qeta
dhe shpina të pjerrëta delfinësh
Ios, Sikinos, Serifos, Milos. "Çdo fjalë një pranim për të sjellë pranverën në mes të verës", tha ai
Dhe ullinj të bollshëm
për të kaluar dritën nëpërmjet gishtave të tyre
që mund të përhapet butësisht në gjumin tënd
dhe gjinkallat e panumërta
që ti nuk do i ndiesh më
më pas ndien pulsin në kyçin tënd,
por uji është i pamjaftueshëm
kështu që ti i beson Zotit dhe kupton
domethënien e zërit të tij
dhe pemët e vetme
pa tufa poshtë tyre
dhe ti kujton se është një shok
dhe e di emrin e tij të çmuar
toka e pakët poshtë këmbëve të tua
dhe si rrjedhojë nuk ke hapësirë për të shtrirë rrënjët
dhe për të vazhduar për të shtrirë rrënjët në thellësi
dhe qielli i gjerë sipër
në mënyrë që ti të lexosh vetë pafundësinë.

KJO BOTË
kjo botë e vogël shumë e madhe!

Përktheu: Edmund Keeley dhe Philip Sherrard)
Keeley dhe Sherrard, 1981, f. 50.

Mikis Theodorakis kompozoi muzikën e Axion Esti të Elitis (1964) Mund të dëgjoni këngën ("Gjaku i Dashurisë") këtu: https://www.youtube.com/watch?v=4zWLCemYdCg, vizituar më 17.08.2016.

1. Kërkoni për përshkrime letrare në qytetin (ose qarkun) tuaj të origjinës; më pas lexojini ato me zë në klasë dhe diskutoni.
2. Lexoni vargjet e fundit të poemës së Elitis "Kjo botë / kjo botë e vogël shumë e madhe!" dhe diskutoni kuptimin e tyre.
3. Gjeni romancierë dhe poetë fitues të Çmimit "Nobel" nga Evropa Jugore. Përmendni emrat e tyre dhe përpiquni të zbuloni nëse veprat e tyre janë përkthyer në gjuhë të tjera të rajonit. A mendoni (se ne i njohim elementet kulturore të fqinjit tonë dhe sa mirë i njohim ato?

VII-28. Kinemaja greke, "Stela" (1955)

Me regji dhe bashkëskenarist greko-qipriotin Michael Cacoyannis, në filmin "*Stela*" bëri debutimin e saj Melina Merkuri. Filmi tregon historinë e një këngëtareje tërheqëse rebetiko që bën një jetë të pavarur, që zgjedh partnerë pa marrë në konsideratë traditat shoqërore. Megjithëse në fillim ajo pranon propozimin për martesë që i bën futbollisti Miltos, ajo nuk shkon në altar në ditën e martesës, por e kalon natën duke njohur persona rastësorë. Në orët e para të ditës pasardhëse, Miltos do ta godasë me thikë në bark dhe do ta vrasë. Një film i guximshëm, që u kritikua në Greqi në kohën që u shfaq për faktin se ai paraqiste norma të huaja për shoqërinë. Filmi "Stela" u lëvdua ndërkombëtarisht si një ripërsëritje unike e konfliktit ndërmjet vlerave tradicionale, dëshirës seksuale dhe të drejtës së grave për vetëvendosje.

Fondacioni Melina Merkuri, Athinë.

VII-29. Lëvizja "Vala e zezë" në kinematografinë jugosllave

Vala e zezë është një term i përgjithshëm i përdorur për të përshkruar një lëvizje në kinematografinë jugosllave që shënoi vitet 1960 dhe fillimet e viteve 1970. Ajo u frymëzua nga zhvillime bashkëkohore në prodhimin evropian të filmave, veçanërisht Vala e re franceze. Filmat e Valës së zezë ishin kryesisht bardhezi, me një estetikë shumë të ndryshme nga ajo socialiste. Tematikat kishin të bënin kryesisht me jetën e përditshme të njerëzve të zakonshëm, dhe kjo ndeshej qartësisht drejtpërdrejt te filmat heroikë partizanë, ose tek ata që i thurnin lavde progresit dhe përparimit socialit të Jugosllavisë. Lëvizja Vala e zezë përshkruante një realitet që ishte dëshpërues, pesimist dhe pa perspektivë. Filmat përfaqësojnë kohët e arta të kinematografisë jugosllave, duke fituar shumë çmime në festivale ndërkombëtare. Për shembull, filmi i Aleksandër Petroviç "*Kam takuar edhe ciganë të lumtur*" fitoi Çmimin e Madh të Veçantë të Jurisë në Festivalin e Filmit në Kanë në vitin 1967. Midis regjisorëve me famë ndërkombëtare të kësaj lëvizjeje ishin Dushan Makavejevi, Zelimir Zilnik dhe Lazar Stojanoviç. Ky i fundit u dënua me burgim për filmin e tij të parë "Jezusi Plastik". Pas vitit 1973, filmat e Valës së zezë u ndaluan dhe disa kinematografë u detyruan të emigrojnë.

A. Momenti i dyshimit

Të gjithë filmat kulmojnë me akte mizore dhe poshtërimi, duke pasqyruar tragjedinë e brendshme të njeriut dhe atë përreth tij, dhe të gjithë autorët kërkojnë të përdorin efektet më ekstreme në skena shumë të rëndësishme, duke shkatërruar me paramendim, në emër të antidogmatizmit, të gjitha postulatet botërore. […] Spiuni është bërë maskota e kinematografisë sonë.

Boglić, 1969, fq. 1-6.

B. Kritika ndaj socializmit

Ashtu si edhe në sfera të tjera të artit, disa prej filmave tanë kanë një prirje për ta ulur rëndësinë dhe shtrirjen e revolucionit. [...]. Ka një prirje të caktuar, të pashprehur qartë, një lloj nihilizmi, që nuk beson te asgjë, pafuqia, plogështia ndaj gjithçkaje në jetë [...] Një problem i veçantë është pasqyrimi i pikëpamjeve kritike të realitetit tonë [...]. Arsyet se përse filmat tanë janë kaq të suksesshëm në festivalet evropiane perëndimore kanë të bëjnë me faktin se ata paraqesin një kritikë të gjithanshme të socializmit, që ata e miratojnë, pasi iu sjell përfitime shoqërore dhe politike, duke propaganduar, nxitur dhe duke iu dhënë çmime filmave të tillë. […]

"Stanje i problemi u jugoslovenskoj kinematografiji" (Situata dhe problemet e Kinematografisë Jugosllave), Filmska kultura 68-69 (dhjetor 1969), fq. 1-26.

C. Filmi noir

Mohimi, mohimi me çdo çmim - është bërë drita orientuese për punën e shumë njerëzve. Madje edhe nënvlerësimin e artit, madje edhe shndërrimin e tij në një fletushkë, njoftim, pamflet, duke e bërë gjithmonë e më pak estetik, gjithmonë e më pak vepër artistike.

Čolić, 1970, fq. 3-25..

D. Filmi W.R. *Misteret e organizmit* (1971)



Kopertina është krijuar nga Lucien S. Yang për Criterion Collection.

Dushan Makavejevi (b. Beograd, 1932) është regjisor filmi, skenarist dhe profesor. Tre filmat e tij të parë – *"Njeriu nuk është zog"* (1965), *"Histori dashurie ose çështja e operatorit telefonik të humbur"* (1967), dhe *"Pafajësi e pambrojtur"* (1968) – ishin një prezantim me Valën e Zezë jugosllave. Filmi i tij i vitit 1971 W.R.: "Misteret e organizmit" është filmi me më shumë ndikim, i cili u ndalua në Jugosllavi për shkak të përmbajtjes së tij seksuale dhe politike. Historia bazohet në teorinë e Vilhelm Reik për energjinë e jetës ose se si të çlirohet njeriu nëpërmjet revolucionit seksual. Më 5 korrik 1971 (dy javë para se Zyra e Prokurorit Publik të Serbisë ta ndalonte atë) në Novi Sad u organizua një diskutim publik i madh i përqendruar kryesisht te kritika ndaj figurës së Stalinit në film, si edhe për frikën që Josip Broz Tito mund të bëhej subjekt i kritikës. Makavejevi u largua nga Jugosllavia dhe qëndroi në mërgim deri në vitin 1988.

Ju mund të doni të dëgjoni dy këngët (lidhur me dok. VII-28 dhe VII-29D): https://www.youtube.com/watch?v=VtWd6M2ADuY, vizituar më 17.08.2016. ("Dashuria që ti e ktheve në një thikë me dy presa", Melina Merkuri-Manos Hadjidakis, https://www.youtube.com/watch?v=evGC9hekem0, vizituar më 17.08.2016; "Fëmijët poshtë në livadh", muzika nga Manos Hadjidakis për filmin nga D. Makavejev, Sweet Movie).

Bëni një listë të artistëve, romancierëve dhe shkencëtarëve evropiano-jugorë fitues të çmimeve.

VII.5. KONSUMERIZMI

VII-30. Tregu i vetëm me vetëshërbim në Lubjanë, 1959

Muzeu i Historisë Bashkëkohore, Lubjanë.

Tregu i parë me vetëshërbim në Lubjanë u hap më Rrugën Tito, rruga kryesore e qytetit, në vitin 1959, një ditë para pushimit kombëtar më të rëndësishëm në Jugosllavi, Dita e Republikës. Gjatë dy viteve pasardhëse u hapën disa dyqane të tjera, përfshirë dyqanin e parë të madh të quajtur Modna Hiša (Shtëpia e Modës) në vitin 1961, që ishte dyqani i parë në Jugosllavi që kishte shkallë lëvizëse.

Përse mendoni se kishte kaq shumë njerëz në hapjen e tregut të parë me vetëshërbim në Lubjanë? Pyesni gjyshërit tuaj se si dukeshin dyqanet e zakonshme para shfaqjes së tregjeve me vetëshërbim.

VII-31. Dyqane në Athinë



Ditar xhepi i vitit 1957, me imazhe të ndërtesës së re Dragonas.

Chatziotis, 1999, fq. 104..

Për të plotësuar nevojat dhe aspiratat e një mjedisi konsumerist gjithmonë e në rritje, u hapën një sërë dyqanesh të mëdha në Athinë nga mesi i viteve 1950 dhe në vazhdim. I pari i këtij lloji ishte Dragonas (i krijuar në vitin 1938), mjediset e të cilit në vitin 1955 përfshinin shtatë kate dhe katër ashensorë, dhe u shërbente rreth 660 mijë klientëve. Nëntë vite më vonë, konkurrenti i tij kryesor Minion kishte tetë kate, shkallë të lëvizshme dhe kishte premtuar instalimin e një sistemi të ajrit të kondicionuar nga maji i vitit 1965.

VII-32. Coca-Cola si simbol i konsumerizmit të Perëndimit

Сн. 51. Кока-Кола, сп. Турист, 1965 г.

Revista "*Typucm*" [Turisti], 1965.

Reklamë e Coca-Cola-s: Pini Coca-Cola dhe do të ndieni kënaqësinë e vërtetë. Coca-Cola do të bëhet pija juaj e preferuar. Coca-Cola do t'ju freskojë dhe do ju shuajë etjen.

VII-33. Një karikaturë për elektroshtëpiaket "IZOLA"

"Mos u shqetësoni, ka për të gjithë!" Karikaturë nga K. Mitropoulos.

E themeluar në vitin 1930, kompania "Izola" deri në vitet 1990, ishte prodhuesi më i madh i orendive elektroshtëpiake në Greqi, dhe zinte 50% të tregut vendas. Duke u përpjekur për të arritur standarde jetese më të larta dhe rritjen përkuese të konsumerizmit midis grekëve, kryesisht në qendra urbane, marka e saj u bë sinonim i "progresit" ose, siç edhe njoftonte qartësisht kjo reklamë e vitit 1959, me shënimin "qytetërimi në shtëpinë tuaj".

VII-34. Tradita dhe novacioni në profesionet rurale rumune

Në shkallë të vogël, struktura e këtij dyqani me vetëshërbim përkon me modelin urban të frymëzuar nga Bashkimi Sovjetik, që në këtë rast ishte sinonim i modernizimit. Por produktet në vitrina nuk përmbushnin nevojat e vërteta të fshatarëve. Mallrat që ofroheshin më shumë ishin (p.sh. shishe dhe kanaçe pijesh alkoolike) të ngjashme me ato që fshatarët "prodhonin" në shtëpi. Në këtë aspekt, dyqani mund të shihej si një ekspozitë. Artikulli që shoqëron fotografinë, i titulluar "Tradita dhe novacioni në profesionet rurale", nxjerr në pah këtë mospërputhje të madhe. Autorit të tij i vinte keq për numrin e vogël të punishteve ose ofiçinave në qarkun e Ialomița-s. Nga ana e tyre, krerët e organizatave theksuan mungesën e punëtorëve të kualifikuar në fshatra dhe faktin se zejet që dikur kishin qenë tradicionale tashmë janë lënë pas dore, siç është xunkthëtaria. Artikulli përçonte pikëpamjen se përpjekjet e regjimit të ri për të vendosur ekonomi të kontrolluar nga shteti në fshatra, si edhe çoi në shkatërrimin e punishteve familjare dhe bizneseve të vogla, që u bazua në njohuri të shëndosha për tregun rural dhe kapacitetin e tij të punës.

Tradiţie şi inovaţie în meseriile satului

SPORT

Satul Socialist, nr. 1 (4 maj 1969), fq. 2.

Krahasoni tregun me vetëshërbim të stilit perëndimor në Lubjanë me atë në fshatin rumun. Vini re se si janë veshur gratë. A është veshja e tyre në përputhje me traditën apo me modernizimin e propaganduar nga regjimi komunist?

VII-35. Reklamimi i "Zastavas" në Egjipt

TANJUG /Fotografi e Mioljub Jelesijevic.

Jugo ishte një makinë e prodhuar në fabrikën e Zastava-s në Kragujevac në Serbi. Nga viti 1986 deri në vitin 1991, makinat Jugo u shiten edhe në Shtetet e Bashkuara.

VII-36. Televizioni

Në përvjetorin e tridhjetë të transmetimit të parë në radio nga Zagrebi, më 15 maj 1956, po nga i njëjti qytet, u bë i mundur për herë të parë transmetimi në televizor në Jugosllavi. Në fillim, për shkak të mungesës së prodhimit në shtëpi, Televizioni i Zagrebit transmetoi program austriak. Qendrat e televizionit u ngritën gjithashtu në Beograd dhe Lubjanë, dhe më pas në kryeqytete të republikave tjera dhe krahina autonome.

A. A. Transmetimi i parë i stacionit televiziv të Zagrebit

Historia përsërit vetveten. Tridhjetë vite më parë, dëgjuesit e parë të Radio Zagrebit ishin të ftuar në taverna dhe ndoqën transmetimet e para radiofonike nëpërmjet kufjeve. Sot në orën tetë do të ndodhë diçka e tillë. Personat që do të gjenden në Sheshin "Republika" në atë orë, dhe shumë të tjerë që do të shkojnë atje, do të mund të shohin programin e parë të radios dhe stacionit televiziv të Zagrebit të të ardhmes. Gjatë disa ditëve të shkuara, përgatitjet për të krijuar sete televizorësh në shtëpinë Tomislav në Sljeme janë shumë të ngutshme. Për këtë qëllim janë ngritur antena në disa pika në qytet.

Vjesnik, 15 maj 1956.

B. Program televiziv në Kroaci

Transmetime të programit televiziv në Graz. Transmetime televizive të rregullta gjatë të martave, të enjteve, të shtunave dhe të dielave ndërmjet orës 20.00 dhe 21.30. Programe për të rinjtë gjatë të enjteve dhe të dielave ndërmjet orës 17.00 dhe 18.00.

Vjesnik, 15 maj 1956.

C. Prodhimi i televizorëve



Muzeu i Historisë Bashkëkohore, Lubjanë.

Në vitin 1956 Televizioni i Lubjanës (*Televizija Ljubljana*) transmetoi për herë të parë, duke i dhënë shtysë blerjes së 985 seteve të televizorëve. Në vitin 1958 u regjistruan edhe 3,000 sete të tjera televizorësh, ndërsa në vitin 1959 u regjistruan rreth 13,208. Shumë shpejt, prodhuesit e elektroshtëpiakeve kryesore si "Gorenje" dhe "Iskra" filluan të prodhonin sete televizorësh të bërë në shtëpi. Seti i televizorëve "Iskra" u konsiderua një shembull i modelit modern.

Në Jugosllavi, transmetimi në televizion filloi në gjysmën e dytë të viteve 1950. Krahasojeni me situatën në vendin tuaj. Përshkruani programin e hershëm televiziv (burimi VII-36B). Sa orë në ditë transmetohej programi? Flisni me të afërmit tuaj dhe zbuloni se si ishte jeta para përdorimit të televizionit dhe internetit. Çfarë mjetesh ishin të disponueshme për informim dhe argëtim?

VII-37. Paraqitja e modelit për pijet alkoolike, rrushit dhe produkteve të bulmetit në Bullgari (1956)



Marinski et al, 1956, fq. 82.

VII-38. Pamjaftueshmëria e mallrave të përditshme

A. Një listë e mallrave në sasi të pakta në Bullgari (1979)

1. Mobilie (këndе shtretërish, kontrabufe, tavolina kafeje, mobilie për dhomën e fëmijëve)
2. Peshk i tymosur
3. Gjizë
4. Letra higjienike
5. Sheqer (pothuajse të gjitha dyqanet)
6. Detergjentë
7. Fasule
8. Ullinj
9. Mish (disa lloje)
10. Ushqim për foshnja
11. Mollë (vetëm në disa dyqane)
12. Biskota (lloji)
13. Piper i kuq
14. Sodë buke
15. Speca të kuq
16. Peshk dhe lloje sardeleje të freskëta
17. Furnelë elektrike
18. Bateri
19. Ngrohës për soba elektrike, Mechta
20. Pjesë rezervë për disa makina (bulona, pistona, indikatorë, etj.)
21. Birrë (lloji)
22. Ilaç enësh i lëngshëm, Vero
23. Disa lloje çokollatash
24. Majonezë
25. Çimento

Arkivat Shtetërore Qendrore, dok. 15, inv. 55, a.u. 808.

B. Radha për të blerë sheqer në Bukuresht (maj 1982)

http://forum.romanian-portal.com/threads/16502-Trecutul-in-fotografii/page17, vizituar më 22.11.2015.

Përdorni njohuritë dhe informacionin tuaj nga burimet (gjithashtu nga kapitulli VIII.3) dhe bëni një listë me shkaqet e shkurtimeve në të këtyre mallrave në disa vende të Evropës Jugore në fund të viteve 1970 dhe në fillim të viteve 1980. Cilat ishin mallrat në sasi të pakta?

VII-39. Industria e lehtë në Turqi

Prodhimi i parë vendas i makinave larëse në Turqi filloi në vitin 1959. Për shkak të çmimeve tepër të larta, ëndrra e çdo gruaje për blerjen e një makine larëse nuk mund të realizohej. Si një përpjekje për të rritur tirazhin e tyre, në vitin 1960 disa gazeta filluan t'iu ofronin lexuesve të tyre një sërë pajisjesh elektroshtëpiake (makina larëse, frigoriferë), si edhe apartamente moderne.

Përkthimi: Fatlumët që fituan një makinë larëse këtë javë.

Milliyet newspaper, 1966.

Përpiquni të imagjinoni se si ishte jeta në shtëpi pa makina elektrike. Si ndikuan elektroshtëpiaket në emancipimin e grave?

VII.6. TURIZMI

VII-40. Procesverbali i Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bullgarisë, për mbylljen e diskos: "Club 33" në rezortin Sunny Beach, 21 tetor 1969

"Club 33", ose e ashtuquajtura "disko suedeze", e maskuar me disa sekrete që nxitën kureshtjen e pashëndetshme të të rinjve bullgarë, jo vetëm të atyre që qëndronin në rezort, por edhe të atyre nga Burgas. Shumë vendas vijnë në rezort për shkak se janë veçanërisht të interesuar për të shkuar në disko. Gjatë netëve të tëra pafund, turma të rinjsh para klubit shpresojnë të lejohen të hyjnë, pavarësisht masave të rrepta që ndalojnë hyrjen. Por ka shumë syresh që ia dalin të hyjnë në disko dhe si rrjedhojë bëhen disa prej përkrahësve më entuziastë të saj [...]. Dekorimi i brendshëm i klubit është jashtëzakonisht natyralist, vulgar dhe cinik. Një afishe e madhe paraqet një përbindësh me tre koka me këmbë kali që mban në gojë trupin e shqyer të një njeriu dhe që bren kockat e tij. Një tjetër afishe paraqet një burrë të zhveshur me emrin Frank Zappa të ulur në një oturak; është e qartë se ai është idhulli i klubit [...]. Në festat e organizuara në orët e vona të natës, luhet muzikë nëpërmjet një sistemi të amplifikuar, e shoqëruar me kërcim erotik dhe me fikjen e dritave. Frekuentuesit e klubeve veshin rroba ekstravagante dhe provokuese, kanë flokë të gjatë të palarë, dhe propagandojnë dhe praktikojnë mbi të gjitha "lirinë absolute" në sferën seksuale [...]. Sipas të gjithë informacionit të mbledhur, "Club 33" do të mbyllet, dhe vitin tjetër në vend të tij do të hapet një disko bullgare.

Arkivat Shtetërore Qendrore, dok. 1Б, inv. 36, a.u. 676.

VII-41. Organizata turistike greke

Nga mesi i viteve 1960, industria turistike në Greqi mori hov si rrjedhojë e përparimit të madh të botës perëndimore, zonave të shumta tërheqëse të vendit, si edhe përpjekjeve të qëndrueshme të departamentit të promovimit të brendshëm të Organizatës turistike greke. Kjo afishe e dizejnuesit grafik Freddie Carabott fitoi çmimin e dytë në Ekspozitën Ndërkombëtare të Afisheve Turistike në Leghorn (Itali) në vitin 1962).



Carabott dhe Katzourakis, 2008, fq. 119.

VII-42. Afishe për Transportin Ajror Jugosllav (JAT), 1960

VII-43. Modernizimi arkitekturor dhe industria e turizmit

Hotel Haludovo, Malinska, Kroaci. http://pogledaj.to/arhitektura/ljetovanja-u-socijalizmu-pa-u-tranziciji/, vizituar më 18.08.2016.

Pas prishjes me BRSS-në, Jugosllavia u shkëput nga metoda e realizmit socialist. Krahas shndërrimeve në fushën e kulturës dhe të artit, ky transformim u pasqyrua veçanërisht në arkitekturë. Hotelet në bregdetin Adriatik, që shpesh përfaqësojnë kryeveprat arkitekturore, janë shembuj të shkëlqyer në këtë aspekt.

JAT (Jugoslovenski Aerotransport) u prezantua më 1 prill të vitit 1947. Deri në mesin e viteve 1950, për shkak të izolimit të vendit, transporti ajror u kufizua në fluturime vendase. Megjithatë, në fillim të viteve 1960, numri i qytetarëve jugosllavë që udhëtuan jashtë vendit filloi të rritej, duke arritur rreth dy milionë udhëtarë në fund të viteve 1970. Kjo ndodhi për shkak të rritjes së standardeve të jetesës, pengesave më të pakta në lëshimin e pasaportave, marrëveshjeve për heqjen e vizave me një sërë shtetesh, dhe liberalizimit të sistemit bankar që lejoi hapjen e llogarive bankare në monedha të huaja. Krahas nevojave për kohë të lirë dhe pushime, udhëtimi jashtë shtetit ishte një mundësi për të blerë mallra, si copa tekstilesh dhe pjesë rezervë për makina, që ishin në sasi të pakta në Jugosllavi. Vendi më popullor i turizmit "konsumerist" jugosllav ishte Trieste.

←

Dizejnues: B. Spremo, Muzeu i Artit Zagreb.

VII-44. Qëndrimet e turistëve për një natë në Kroaci gjatë viteve 1946-1990



Duda, 2010, fq. 328.

1. Shqyrtoni se si u zhvillua turizmi në secilin vend të Evropës Jugore. Cilat vende mund të konsideroheshin se kishin industri të turizmit? Gjeni materiale pamore për reklamat e destinacioneve turistike, dhe statistika dhe dëshmi me gojë për përvojat e turistëve.
2. Krahasojini ato me burimet nga kapitulli VII.7 për rezortet e punëtorëve dhe diskutoni lloje të ndryshme të turizmit dhe diskriminimit social.

VII-45. Hoteli "Hilton" në Stamboll (1959)

https://commons.wikimedia.org/wiki/File:Hilton_Istanbul,_1959.jpg#/media/File:Hilton_Istanbul,_1959.jpg, vizituar më 18.08.2016.

I projektuar nga një firmë amerikane nga Sedad Hakkı Eldem si arkitekti bashkëpunëtor vendas, hoteli Hilton u ndërtua gjatë viteve 1952-1955. Ai përfaqëson modën e "amerikanizmit" në arkitekturë dhe në mënyrën e jetesës, mallrat e konsumit dhe pasurinë e shtresës së mesme, të vëzhguar në Turqi dhe në shumë shtete të tjera në vitet 1950.

VII.7. POLITIKA SOCIALE

VII-46. Kampet e pushimit për punëtorët

TENDAT SHUMËNGJYRËSHE
Në republikën tonë përgjatë bregdetit Adriatik, nga Neum në Baška Voda ka shumë kampe pushimi për punëtorë […]. Ka tre lloje kampesh pushimi për punëtorë. Lloji i parë përfshin kampet e përhershme të pushimit për punëtorë. Qofshin të blera nëpërmjet grumbullimit të fondeve, qofshin të ndërtuara nga kolektivat e punëtorëve, këto kampe pushimi për punëtorë përdoren bashkërisht nga të gjitha organizatat e punës ose OOUR [organizata bazë të punës së bashkuar] të një SOUR [organizata komplekse të punës së bashkuar]. Lloji i dytë janë të ashtuquajturat kampe të përkohshme pushimi për punëtorë. Punëtorët e turizmit i quajnë ato kampe pushimi sindikaliste, sepse ato funksionojnë për aq kohë sa vijon sezoni turistik, për rreth tre muaj. Lloji i tretë i kampeve të pushimit për punëtorë të organizuar ndërthur akomodimin dhe strehimin në shtëpi private. Ata që në të shkuarën investuan në standardin social kanë tashmë një pozicion më të mirë. Shumë prej ndërmarrjeve kanë kampet e tyre private të pushimit në hotele të kategorisë "B". Ne vizituam hotelin "Đuro Salaj" në Gradac, që i përket organizatës së punës së minierave të qymyrit të Titos SOUR në Tuzla. Minatorët dhe familjet e tyre nga pothuajse të gjitha minierat në republikën tonë pushojnë këtu. [...]. Para sezonit dhe pas sezonit, punëtorët e sëmurë dhe të pafuqishëm, që kanë nevojë për rehabilitim për t'u kthyer në punë, qëndrojnë këtu falas. Këtu gjithçka është e bukur. […]

Oslobođenje, god. XL, br. 12608, Sarajevë, 30.7.1983, fq. 8.

Në qershor të vitit 1947, qeveria e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë miratoi një dekret që i dha të drejtën çdokujt që punonte për 11 muaj për të pasur të paktën 14 ditë leje me pagesë të plotë, ndërkohë që punëtorët që bënin punët më të rënda, dhe ata që punonin në kushte të vështira u jepeshin 30 ditë leje të paguar. Anëtarët e sindikatave mund të udhëtojnë me gjysmë çmimi në të gjitha mjetet e transportit, përveç aeroplanëve. Ka filluar një sistem i turizmit social bazuar te kampet e pushimit për punëtorë. Turizmi konsiderohet si një veprimtari shoqërore, →

shëndetësore dhe kulturore e nevojshme për të gjithë, por edhe si një shenjë e progresit material dhe kulturor. U krijuan zakone të reja, dhe madje ishte i nevojshëm që të prezantohej turizmi, pasi ndonjëherë punonjësit i refuzonin referimet që u mundësonin atyre të qëndronin në një kamp pushimi të sindikatës. Refuzimi i këtij aspekti të modernizimit u konsiderua nga autoritetet si shenjë e integrimit të pakët të punëtorëve në klasën punëtore dhe kulturën e saj industriale. Në mesin e viteve 1960, u zbatuan një sërë reformash lidhur me turizmin, që u përqendruan te të ftuarit e huaj dhe fitimet në monedha të huaja. Si rrjedhojë, përqindja e kampeve të pushimit të punëtorëve në kapacitetin e përgjithshëm turistik të Kroacisë ra nga rreth 30% në vitet 1950 në 10% në vitet 1970.

VII-47. Politika familjare në Jugosllavi

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS POPULLORE FEDERALE TË JUGOSLLAVISË

Neni 24. Shteti mbron veçanërisht interesat e nënave dhe fëmijëve nëpërmjet ndërtimit të maternitetеve, shtëpive të fëmijëve dhe çerdheve ditore, si edhe nëpërmjet dhënies së lejes së paguar para dhe pas lindjes.

Fletorja Zyrtare, nr. 10 (1946).

Leja e lindjes garantohet nga Kushtetuta e Republikës Populllore Federale të Jugosllavisë në vitin 1946. Deri në vitin 1981, leja e lindjes jepej për një periudhë 6-mujore, dhe më vonë për një periudhë 12-mujore.

VII-48. Ekstrakte nga Kodi i Punës i Rumanisë i vitit 1972 "Për punën e grave dhe të rinjve"

Neni 151(2). Gratë që punojnë gëzojnë mbrojtje shëndetësore të veçantë, dhe atyre iu sigurohen mjetet e nevojshme për t'u kujdesur dhe edukuar fëmijët e tyre.

Neni 152(1). Gratë shtatzëna dhe ato që ushqejnë fëmijët me gji, as nuk do të caktohen në vende pune të vështira, të rrezikshme apo ku mund të lëndohen, dhe as nuk do t'iu kërkohet të punojnë me orë shtesë.

Neni 152(2). Gratë shtatzëna dhe ato që ushqejnë fëmijët me gji, të cilat janë të shqetësuara për shkak të kushteve të përmendura në paragrafin më sipër, do të transferohen në vende të tjera pune, pa ua ulur rrogën.

Neni 154. Që nga muaji i gjashtë i shtatzënisë dhe deri sa ato ta ndërpresin ushqyerjen e fëmijëve me gji, ato nuk do të caktohen të punojnë në turnet e natës.

Neni 155(1). Gratë gëzojnë të drejtën e lejes së paguar të lindjes; 52 ditë para lindjes dhe 60 ditë leje pas lindjes.

Neni 156(1). Zyrat duhet të sigurohen që gratë të përfitojnë nga pushimet gjatë kohës së tyre të punës; këto pushime duhet të zgjasin të paktën gjysmë ore, çdo tre orë, dhe duhet të shfrytëzohen për ushqyerjen dhe për t'u kujdesur për fëmijën. Koha që grave u duhet të shkojnë dhe të kthehen nga vendi ku ndodhet fëmija, nuk do të llogaritet si pjesë e pushimit, por do t'i shtohet këtij të fundit. E gjithë koha për ushqyerjen e fëmijës, plus koha e nevojshme vajtje-ardhje nuk mund t'i kalojë dy orë për ditë pune. Këto pushime duhet të garantohen deri sa fëmija të mbushë 9 muaj dhe mund të zgjatet deri në 12 muaj në rast të fëmijëve të lindur para kohe ose distrofikë, ose fëmijëve me nevoja të veçanta për kujdes, në bazë të rekomandimeve mjekësore.

Neni 156(2). Me kërkesë të nënës, pushimet për ushqyerjen dhe për t'u kujdesur për fëmijën mund të zëvendësohen me një pakësim prej dy orësh të programit ditor normal të punës.

Neni 156(3). Pushimet dhe pakësimi i orëve të punës lidhur me ushqyerjen dhe kujdesin për fëmijën, janë përfshirë në programin e punës dhe nuk kanë pasoja për sa i përket shpërblimit dhe të drejtave të tjera financiare.

Neni 157. Nëpërmjet një rekomandimi mjekësor, grave me fëmijë nën moshë 3-vjeçare u garantohet leje e paguar për t'u kujdesur për fëmijën, e cila nuk është pjesë e lejes vjetore.

Neni 158. Gratë me fëmijë nën moshën 6-vjeçare mund të punojnë me kohë të pjesshme nëse nuk i çojnë fëmijët në çerdhe; Kur llogariten vitet e punës [për pension] kjo periudhë e punës me kohë të pjesshme duhet marrë në konsideratë si periudhë pune me kohë të plotë.

Buletinul Oficial al Republicii Socialiste România (Fletorja Zyrtare e Republikës Socialiste, pjesa I, nr. 140 (1 dhjetor 1972), fq. 1183.

Gjeni rregullore dhe ligje për përfitimet shoqërore (pushime në kampet e pushimit të punëtorëve, pensione, leje lindje, kujdes ditor, sigurime shëndetësore, etj.) gjatë dhe pas periudhës socialiste. Shqyrtoni gjithashtu strukturat arsimore dhe sportive. Më pas krahasojini me situatën në vende si Greqia, Turqia dhe Qiproja në të njëjtën periudhë. Diskutoni gjetjet tuaja.

VII.8. SPORTI

VII-49. Nadia Comăneci

VIZITA PREȘEDINTELUI REPUBLICII POPULARE BENIN, MATHIEU KEREKOU

Sportul

UN EXCEPȚIONAL SUCCES AL SPORTULUI ROMÂNESC

NADIA COMĂNECI, CAMPIOANĂ OLIMPICĂ ABSOLUTĂ!

EXCELENTA COMPORTARE A ECHIPEI NOASTRE FEMININE DE GIMNASTICĂ

MONTREAL: ÎNCHIDEREA JOCURILOR

Nadia Comăneci, Kampione Olimpike Absolute. Mjeshtëria e madhe e kampiones së shquar u shpërblye sërish me pikët maksimale [10 nga 10] në paralele dhe trarin e ekuilibrit. Dje Nadia ishte para konkurrenteve kryesore të saj, Nelli Kim dhe Ludmilla Turischeva. Një rezultat shumë i mirë u arrit nga një tjetër përfaqësuese e vendit. Teodora Ungureranu: vendi i katërt.

NADIA COMĂNECI, GJIMNASTJA MË E MIRË NË BOTË! – Këtu është një pjesë e lajmit që ne nxitojmë t'ia komunikojmë stafit të redaksisë, edhe pse jemi shumë të ndërgjegjshëm se miliona teleshikues në mbarë vendin e kanë parë këtë sukses të jashtëzakonshëm të arritur këtu nga gjimnastja jonë e shkëlqyer, në Forum, përballë një salle të tejmbushur. Përveç cilësive për të cilat ne ishim të vetëdijshëm, si mjeshtëria teknike e përsosur, virtuoziteti, këmbëngulja, vendosmëria, ne vumë re këtë mbrëmje vetëpërmbajtjen që ajo tregoi gjatë dy orëve të konkursit. Ajo e dinte shumë mirë se i duhej t'i rezistonte sulmit të kundërshtareve të saj të forta, gjimnasteve sovjetike Nelli Kim, Ludmila Turischeva, Olga Korbut, si edhe shoqes së saj të ekipit rumun Teodora Ungureanu. Nadia Comăneci performoi shkëlqyeshëm në të katër veprimtaritë e konkursit, duke marrë sërish dy vlerësime maksimale […]. Pas katër titujve që ajo fitoi në Kampionatin Evropian të vitit 1975, Nadia Comăneci arriti tashmë çmimin më të madh që një sportist mund të synojë: medaljen e artë olimpike.

Sportul, 23 korrik 1976.

VII-50. Atina Bojaxhi

Radenkovic, 2001, fq. 76..

Atina Bojaxhi, ylli i maratonës së notit në Republikën Socialiste të Maqedonisë dhe Federatës Jugosllave, lindi në Ohër më 13 mars 1944. Në maratonën ndërkombëtare të notit të vitit 1962 në Ohër, Bojaxhiu u bë kampionia më e re e botës e maratonës së notit në ujërat e ëmbla. Gjithashtu, po atë vit, pasi notoi nga Kapri në Napoli, Bojaxhiu mori edhe titullin e kampiones së botës në maratonën e notit në ujërat e kripura. Ajo fitoi shumë tituj në veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtare. Kulmi i karrierës së saj si notare ishte kur ajo notoi përgjatë Kanalit të La Manshit më 9 shtator 1969. Ajo ishte e para notare grua nga Ballkani që bëri këtë akt të guximshëm. Filmi i Aleksandër Gjurcinov i vitit 1977, "Çohu Delfina" (Rise Up, Delfina), me aktoren e famshme jugosllave Neda Arneriç në rolin kryesor, u realizua duke iu kushtuar asaj. Bojaxhiu u bë më vonë trajnere. Ajo punoi fillimisht për klubin e Beogradit "Red Star" (Ylli i Kuq), dhe më pas u largua për në Los Anxheles, ku punoi në një qendër sportive. Në fund të vitit 1991 ajo shkoi në Sarajevë, ku u gjend në mes të një rrethimi ushtarak, por ajo ia doli të largohej dhe u kthye në Republikën e Maqedonisë. Kompleksi sportiv i Ohrit mori emrin e saj. Ajo vdiq në Shkup më 28 dhjetor 2010.

VII-51. Jugosllavia fiton Kampionatin Botëror të Basketbollit të vitit 1970

Edi Šelhaus/Svetozar Busić (fotograf); Muzeu i Historisë Bashkëkohore, Lubjanë.

Në vitin 1970, Kampionati Botëror i Basketbollit u organizua për herë të parë jashtë Amerikës së Jugut, në Jugosllavi. Ndeshjet e kualifikimit u organizuan në Sarajevë, Split dhe Karlovac, ndërsa ndeshjet finale në Lubjanë. Si vendi organizator, Jugosllavia arriti deri në ndeshjet finale ku Jugosllavia mundi skuadrën e SHBA-së dhe fitoi titullin kampion bote. Fansat shpalosën një banderolë gjatë lojës, në të cilën shkruhej: "Ju keni Hënën, ne kemi arin".

VII-52. "Gjithmonë gati": Spartakiada në Shqipëri, 1989

Fotografi: Roland Tasho.

Spartakiada ishte një veprimtari sportive ndërkombëtare gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave e "kontrolluar" nga Bashkimi Sovjetik, që e ka organizuar atë pesë herë nga viti 1928 deri në vitin 1937 si një veprimtari sportive të barabartë me Lojërat Olimpike "borgjeze". Në periudhën pas luftës, Spartakiada u organizua në vendet e Bllokut Lindor. Emri i veprimtarisë u frymëzua nga Spartaku që udhëhoqi kryengritjen e skllevërve në Perandorinë Romake, dhe synonte t'i jepte veprimtarisë shtrirje ndërkombëtare proletare. Spartakiada përfshinte manifestime fizkulturore publike që simbolizonin gatishmërinë dhe besnikërinë e të rinjve ndaj Partisë, dhe manifestime të të rinjve socialistë ku ata paraqiteshin të shëndetshëm dhe të lumtur. Në Shqipëri u organizuan gjashtë spartakiada (në vitet 1959, 1969, 1974, 1979, 1984, dhe 1989). Fotografia është bërë në nëntor 1989 me rastin e 45-vjetorit të çlirimit të vendit.

A VAŠH
TA NAŠA



KAPITULLI VIII: KOHËT E KRIZËS

Hyrje	247
VIII.1. Qipro 1974	249
VIII.2. Jugosllavia në vitet 1980	253
VIII.3. Kriza e komunizmit	262

HYRJE

Muri i Berlinit, ndërtuar në vitin 1961, dhe dyzet e pesë mijë blloqet e tij prej betoni, u shndërruan në një nga simbolet më të rëndësishme të Luftës së Ftohtë dhe regjimeve totalitare. Gjate viteve te para pas ndërtimit te tij, pothuajse askush nuk dyshonte se kriza e socializmit do të përfshinte vendet e Evropës Lindore; një krizë që do të çonte në rrëzimin e blloqeve shtypëse dhe do të shënonte shembjen e një bote të tërë ndarjesh kulturore, përballjesh dhe betejash për identitet. Përpjekjet për të reformuar dhe liberalizuar sistemin komunist – veçanërisht lëvizja e Çekosllovakisë drejt "socializmit me fytyrë njerëzore", me më shume liri mendimi dhe shprehje në publik dhe masat e suksesshme të ndërmarra në Hungari për të nxitur jetën ekonomike duke lejuar veprimtarinë e disa sipërmarrjeve private- u bënë duke ruajtur të paprekur kuadrin e përgjithshëm ekonomik dhe ideologjik. Megjithatë, në vitet 1970-1980, prirja drejt stanjacionit, që u simbolizua nga regjimi i Leonid Brezhnjevit dhe që u theksua në të gjithë Bashkimin Sovjetik i hodhi poshtë idetë për reformimin e sistemit në vendet e bllokut sovjetik. Megjithë bashkëpunimin reciprok të vendeve të COMECON-it, nuk ishte një detyrë e lehtë të mbahej baraspesha midis zhvillimit të centralizuar të industrisë së rëndë, bujqësisë dhe degëve të tjera të ekonomisë. Brenda hapësirës së tyre ekonomike, vendet socialiste nuk ishin të paprekura nga zhvillimet globale; për shembull në vitin 1970 gjendja e tyre financiare u përkeqësua për shkak të kostos së lartë të naftës. Kjo pikë e dobët u theksua edhe më tepër për shkak të çmimit të lartë që u pagua për garën e armatimeve, për luftra dhe konflikte që mbetën në kuadrin e kërcënimeve për supremaci dhe për shkak të barrës së rëndë që solli mbështetja finaniare e regjimeve dhe lëvizjeve pro-sovjetike në Botën e Tretë. Ndërsa strategjia e Perëndimit për "frenim" përfshinte embargon ekonomike ndaj Lindjes, prirjet negative të modelit të ekonomisë së komanduar u thelluan edhe më tepër, duke e bërë atë më pak konkurrues krahasuar me ekonomitë konsumiste post-industriale perëndimore.

Një sërë ndodhish i paraprinë shembjes së regjimeve komuniste në Evropën Juglindore. Josip Broz Tito, "diktatori i butë"i Ballkanit, vdiq në vitin 1980. Udhëheqësi i vetëm komunist në Evropë që pati sukses në refuzimin e dominimit të Bashkimit Sovjetik, mbështeti me vendosmëri parimin federal gjatë qeverisjes së tij. Në vitet 1960-të, ai e hapi Jugosllavinë ndaj burimeve dhe kapitaleve që vinin nga vendet e zhvilluara, si edhe ndaj modeleve kulturore dhe ekonomike të Perëndimit. Ai imponoi me force modelin e një federate socialiste multi-etnike, në të cilën komunitetet dhe besimet e ndryshme fetare bashkëjetonin në mënyrë paqësore nën petkun e idealit komunist. Megjithatë, u desh vetëm një dhjetëvjeçar që Jugosllavia të përfshihej në një luftë të ashpër, një periudhë gjatë së cilës vendi do të binte në një krizë të rëndë ekonomike, rregullimet kushtetuese do të rishikoheshin, ndërkohë që po forcoheshin qendrimet nacionaliste. As vendet e tjera socialiste nuk arritën të shmangnin krizën e vlerave komuniste dhe decentralizimin e fuqisë politike dhe ekonomike. Të gjitha vendet socialiste përjetuan nivele të larta të borxhit të jashtëm dhe paqëndrueshmëri ekonomike, të cilat pa dyshim cenuan në autoritetin e udhëheqësve të Partisë dhe të shtetit. Për shembull, kur Rumania shiti 30% të rezervave të saj të arit që të paguante borxhin e saj të jashtëm, situata ekonomike e vendit u përkeqësua në mënyrë të ndjeshme dhe Nikolai Çaushesku po shihej si një diktator i pamëshirshëm mendjemadh. Imazhi i tij që po venitej përjetoi goditjen e fundit kur urdhëroi ndërtimin e Shtëpisë së Republikës (Casa Republicii), një godinë gjigante ku do të strehoheshin anëtarët e qeverisë dhe të partisë komuniste, dhe Bulevardin e Fitores Socialiste (Bulevardul Victoria Socialismului) që të çonte te Shtëpia e Republikës, duke shkatërruar në këtë mënyrë një pjesë të qendrës historike të Bukureshtit.

Kriza e socializmit u përkeqësua nga shfaqja e hierarkive të reja shoqërore, që u vendosën nga regjimet e vendeve të ndryshme. Mbi të gjitha, po thellohej gjithnjë e më shumë hendeku mes elitës së privilegjuar të Partisë dhe qytetarëve të thjeshtë, të cilët, të privuar nga e drejta për të përfituar nga disa të mira ekonomike dhe shoqërore, po bëheshin më të ndërgjegjshëm për arbitraritetin politik dhe administrativ në vend dhe për mungesën e lirive themelore. Kjo, nga ana tjetër, zbehu tërësisht klishetë ideologjike për paqen, ndërkombëtarizmin, pluralizmin demokratik dhe socializmin me fytyrë njerëzore, që po shihej si një lloj që po shihej si një lloj mbulese dhe mungese informacioni mbi krizën në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Duke ndjekur shembullin e protestave masive të drejtuara nga sindikata e pavarur kundër komunizmit, "Solidariteti", në Poloni u shfaqën disa lëvizje disidence, u krijuan organizata që kërkonin ndihmë ndërkombëtare dhe

një gamë e gjerë samizdatesh (botime jozyrtare) panë dritën e botimit. Ashtu si e tha dhe disidenti bullgar dhe presidenti i parë i vendit i zgjedhur në mënyrë demokratike Zhelu Zhelev, kjo ishte "periudha e shkëlqyer e inteligjencës". Qëndresa kundër regjimeve komuniste në Ballkan, u frymëzua nga ajo që njihej në vitet 1980 si "Shpirti i Helsinkit"- vendosja dhe konsolidimi i standardeve ndërkombëtare në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut, si bazë për formimin e një potenciali social të rëndësishëm. Në të njëjtën kohë, Partia dhe udhëheqësit e saj po akuzoheshin për shpërdorim të pushtetit, korrupsion dhe përvetësim të të mirave të përbashkëta. Individët dhe grupet e brezave të rinj që, në përgjithësi, ishin të familjarizuar me idealet Marksiste nga Komsomoli dhe organizatat e Pionerëve për vite me radhë, filluan të kritikonin boshllëkun politik dhe kulturor të periudhës së fundit të socializmit. Ata filluan rrugëtimin e tyre të vështirë drejt lirisë dhe demokracisë, duke gjetur strehë në forma të ndryshme nënkulturore të ndikuara nga Perëndimi. Të rinjtë kundërshtuan të pajtoheshin me botën shterpë, gri dhe të zymtë të parakalimeve të gjata, fjalimeve të zyrtarëve të Partisë dhe dhe festave që kishin humbur kuptimin të Komsomolit, duke dëgjuar Vladimir Visotskin, poetin, këngëtarin dhe kompozitorin rus, që ishte shumë i famshëm në Bashkimin Sovjetik dhe në Evropën Lindore për imitimin e mënyrës së jetesës së muzikantëve të rrokut, pankut dhe Rrymës së Re.

Elita sunduese zgjodhi t'iu përgjigjej sulmeve të inteligjencës dhe lëvizjeve nënkulturore të të rinjve me diskutime masive kombëtare, në atë që ishte një përpjekje e veçantë për të ridrejtuar kritikat shoqërore te komunitetet minoritare, dhe për të manipuluar shqetësimet dhe frikën ekzistuese. Kjo ishte e dukshme jo vetëm në Jugosllavi, por edhe te minoritet hungareze në Rumani, si edhe te minoritetet në vendet e tjera. Në Bullgari u zhvillua një fushatë masive shtrënguese për t'u ndryshuar emrat turqve bullgarë, me qëllim asimilimin e tyre etnik. Shtypja përfundoi me emigrimin e detyruar të mijëra qytetarëve në Turqi. Pak kohë para rënies së Murit të Berlinit, pati festime me rastin e përvjetorit të 600-të të betejës së Fushë-Kosovës (28 qershor 1989), me mbi një milion pjesëmarrës, një shenjë ogurzezë e rikthimit ngadhënjyes të nacionalizmit, parulla e të cilit ishte "vëllazërim dhe bashkim".

Ndërkohë, në vitin 1985, një udhëheqës i ri, energjik dhe mendjehapur (krahasuar me paraardhësit e tij) erdhi në fuqi në Bashkimin Sovjetik: Mikhail Gorbaçov. Ai shpalli një kurs të ri të perestroika (ristrukturimi) dhe glasnost (transparencë)- një përpjekje për reforma ekonomike dhe shoqërore të ndërthurura me një sferë publike të hapur. Por nismat dhe improvizimet e ndryshme të ndërmarra për këtë qëllim çuan në kaos ideologjik dhe në rritje të pakënaqësisë me krizën ekonomike dhe shoqërore. Koncepti i Gorbaçovit për reformat në ekonomi, në shoqëri dhe në Parti gjeti një jehonë në të gjitha vendet socialiste, dhe çoi në ndryshime sipërfaqësore në strukturën e pushtetit dhe të marrëdhënieve ekonomike. Të paktën në letër, prodhuesve dhe kompanive të sektorit privat iu dhanë më shumë të drejta. Kuadrot e partisë filluan të flisnin për glasnostin dhe heqjen e censurës në media dhe arte. Kriza e komunizmit u thellua pas heqjes së censurës, dhe Gustav Husak në Çekosllovaki dhe Janos Kadar në Hungari paraqitën dorëheqjen e tyre. Më në fund erdhi viti 1989, viti i mrekullive dhe revolucioneve. Në 10 shtator, Hungaria hapi kufijtë me Austrinë dhe mijëra refugjatë të Gjermanisë Lindore ikën në Perëndim. Në tetor, Erik Honeker, udhëheqësi i Gjermanisë Lindore, dha dorëheqjen po ashtu. Në 9 nëntor, Gjermania Lindore hapi kufijtë me Gjermaninë Perëndimore, Muri i Berlinit ra dhe bota hyri në një epokë të re.

Muri i Berlinit, Perdja e Hekurt dhe kufijtë kulturorë përgjithësisht të pakalueshëm, nuk ishin prioritet vetëm i vendeve socialiste dhe kapitaliste që merrnin pjesë në Luftën e Ftohtë. Faktorët e fuqishëm të politikës ekonomike dhe të jashtme të kësaj kundërvënieje botërore, lanë gjurmët e tyre në gjithë botën, ndërkohë që një vazhdë konfliktesh të fuqishme kishin përmasa rajonale ose dypalëshe. Në anën tjetër të Perdes së Hekurt, marrëdhëniet midis Greqisë dhe Turqisë dhe themeluesve të botës perëndimore në përgjithësi - përballë organizatave ndërkombëtare si OKB dhe Këshilli i Evropës - ishin shumë të acaruara për shkak të krizës në Qipro në vitin 1974. Grushti i juntës greke kundër Makarios dhe pushtimi turk i pjesës veriore të ishullit, nuk ishin vetëm kulmi i një sërë krizash që kishin shpërthyer gjatë dekadës së kaluar, por edhe pikënisja e një çështje të ndërlikuar botërore e cila do të kalonte nëpër faza të reja vendimtare gjatë viteve 1990 dhe 2000. Kjo çështje mbetet e hapur edhe në vitin 2016.

Ky kapitull shtjellon krizat që u zhvilluan në vende të ndryshme të Evropës Juglindore, kryesisht në vitet 1980-të. Nga pushtimi turk i Qipros në korrik të vitit 1974, deri tek Revolucioni Rumun në dhjetor 1989, një sërë krizash politike dhe ekonomike, të cilat nuk ishin vetëm lokale por edhe botërore, hapën rrugën për ndryshimet dramatike të viteve 1990. Në fakt, ky kapitull duhet të studiohet së bashku me kapitullin I të volumit 2, ku paraqiten më hollësisht shembja e regjimit komunist në Bullgari si dhe rruga drejt shpërbërjes së Jugosllavisë.

VIII.1. QIPRO 1974

VIII-1. Grushti i juntës greke kundër Makario

Në 15 korrik 1974, me urdhër të juntës greke, forcat greko-qipriote me mbështetjen e oficerëve nga Greqia kontinentale dhe organizatave të fshehta ultranacionaliste EOKA B, nisën një grusht shteti kundër presidentit të Republikës së Qipros, Kryepeshkop Makarios. Pak pas largimit nga pallati presidencial Makarios i drejtoi një mesazh të shkurtër popullit greko-qipriot që u transmetua nga Radio Pafos. Grushti shërbeu si pretekst për pushtimin e parë të ishullit nga turqit më 20 korrik, gjë që çoi në rrëzimin e juntës në Athinë katër ditë më vonë.

A. Kopje e shkruar e mesazhit të Makarios (15 korrik 1974)

Populli qipriot grek!
Zëri që po ju flet është shumë familjar për ju. Ju e dini kush po flet. Jam Makarios. Jam ai që ju e zgjodhët si udhëheqësin tuaj. Nuk kam vdekur, si do dëshironte junta në Athinë dhe përfaqësuesit e saj këtu. Jam gjallë dhe jam në anën tuaj, bashkëluftëtar dhe flamurtar i standardeve në betejën e përbashkët.

https://www.youtube.com/watRvAxp5tcUM, të parë më 26.08.2016.

B. Pallati i Kryepeshkopit pas grushtit të shtetit

Zyra e Shtypit dhe Komunikimit, Republika e Qipros.

Dy burimet paraqitin situatën në Qipro pas grushtit dhe tentativës për vrasje të presidentit Makarios. Përshkruaj foton dhe komento deklaratën e Makarios; "Nuk kam vdekur, si do dëshironte junta në Athinë dhe përfaqësuesit e saj këtu". Pse junta në Athinë e donte Makarion të vdekur? Kini parasysh që pas përpjekjes për ta vrarë atë, shtypi grek (i kontrolluar nga junta) e deklaroi atë të vdekur.

VIII-2. Pushtimi turk i Qipros në vitin 1974

Pushtimi turk i Qipros, i quajtur "Operacioni Atila" nga ushtria, dhe "Operacioni i Paqes" nga qeveria, çoi në ndarjen e ishullit. Ajo detyroi 160.000 grekë qipriotë të "migrojnë" me ngut si refugjatë në pjesën jugore të ishullit. Pak muaj më vonë, shumica e qipriotëve-turq që jetonin në jug u shpërngulën me dëshirë në pjesën veriore të ishullit. Më shumë se 4000 grekë qipriotë u vranë dhe rreth 1600 persona u deklaruan të zhdukur. Raprezaljet e Gardës Kombëtare qipriote-greke dhe trupave paramilitare shkaktuan vrasjen e rreth 350 qipriotëve-turq dhe zhdukjen e 450 të tjerëve. Një komision i OKB-së ende po heton fatin e personave të zhdukur të të dyja palëve. Shumë prej tyre tashmë janë deklaruar të vdekur. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, me Vendimin 3212/74, kërkoi tërheqjen e të gjithë ushtarëve të huaj nga Qipro, por kjo nuk ndodhi kurrë. Këshilli i Sigurimit miratoi rezolutën me Vendimet e tij 365/74 dhe 367/75 dhe i thirri të dyja palët për të filluar një proces marrëveshjeje nën vullnetin e mirë të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së. Në vitin 1975, pala qipriote-turke shpalli në mënyrë të njëanshme themelimin e "Shtetit Federal Turk të Qipros". Nëpërmjet kësaj, udhëheqësit e tyre nënkuptonin se zgjidhja përfundimtare e problemit të Qipros do të ishte krijimi i një Federate të decentralizuar i dy shteteve të federuara, një qipriot-grek dhe një qipriot-turk, që do të formonin një entitet.

A. Fjalim i kryeministrit Bulent Eçevit, 20 korrik 1974

Forcat e Armatosura turke kanë filluar të zbarkojnë dhe t'i dislokojnë trupat në Qipro. Allahu sjelltë fat të mirë për kombin tonë, për të gjithë qipriotët dhe njerëzimin. Ne besojmë se në këtë mënyrë do të ofrojmë një shërbim të madh për njerëzimin dhe paqen. Shpresoj se nuk do të hapet zjarr kundër forcave tona, dhe nuk do të ketë konflikt të përgjakshëm. Në të vërtetë shkojmë në ishull për të sjellë paqe, jo për të bërë luftë; për të sjellë paqe jo vetëm për turqit, por edhe për rumët [qipriotët grekë].

Pas përdorimit të të gjitha mjeteve politike dhe diplomatike, u detyruam të marrim këtë vendim. Ndihem i detyruar të shpreh mirënjohjen time për të gjithë miqtë dhe aleatët tanë, dhe veçanërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britaninë e Madhe, me të cilët kemi qenë në konsultim të ngushtë kohët e fundit, për përpjekjet e tyre dashamirëse për zgjidhjen e problemit pa ndërhyrje [ushtarake] por nëpërmjet mjeteve diplomatike. Nëse këto përpjekje nuk kanë qenë të suksesshme, me siguri që faji nuk ishte i këtyre shteteve dashamirëse.

Edhe njëherë dëshiroj që ky operacion të jetë i mbarë për të gjithë njerëzimin, kombin tonë dhe të gjithë qipriotët. Dëshiroj që Allahu të mbrojë kombin tonë dhe njerëzimin nga fatkeqësitë.

https://tr.wikisource.org/wiki/B%C3%BClent_Ecevit%27in_K%C4%B1br%C4%B1s_Bar%C4%B1%C5%9F_Harek%C3%A2t%C4%B1_Konu%C5%9Fmas%C4%B1, parë më 26.08.2016.

Bulent Eçevit (1925-2006) ishte udhëheqësi i Partisë Republikane Popullore/CHP (Kemalist). Ai fitoi zgjedhjet e vitit 1973, duke bërë fushatë për një platformë "të qendrës së majtë" dhe drejtoi një qeveri koalicioni me Partinë e Shpëtimit Kombëtar (Islamike) të Nexhmetin Erbakan. Në vitin 1989 ai u bë udhëheqës i Partisë së Majtë Demokratike (DSP) dhe shërbeu si kryeministër i Turqisë në vitet 1974, 1977, 1978-79 dhe 1999-2002.

Lexoni çelësin dhe dokumentin VIII-2A. Cilat argumente paraqiti Bulent Eçeviti përsa i përket pushtimit turk të Qipros? Pse flet për paqen?

B. Protesta e të afërmve të personave të zhdukur gjatë pushtimit turk në vitin 1974

Zyra e Shtypit dhe Komunikimit, Republika e Qipros.

VIII-3. Drejt një marrëveshjeje ose rrënimit (1977-1983)

Në shkurt të vitit 1977, presidenti Makarios dhe udhëheqësi qipriot-turk Rauf Denktash ranë dakord të diskutojmë për të krijuar një shtet federal të dy komuniteteve me dy zona që do të ishin nën administrimin e secilit komunitet. Në gusht të vitit 1979 presidenti Makarios vdiq, por përpjekjet për të diskutuar një zgjidhje vazhduan nën mandatin e OKB-së. Në vitin 1979 udhëheqësit e të dyja komuniteteve, Sp. Kyprianou dhe R. Denktash, arritën një marrëveshje të re më të përpunuar (Marrëveshja me 10 pika). Nga viti 1979 deri në vitin 1983 dy Sekretarët e Përgjithshëm të OKB-së, Kurt Waldeim dhe Perez de Kuelar dhanë idenë për të vazhduar me bisedimet. Kuadri i quajtur "Ide", i paraqitur nga Perez de Kuelar, erdhi në një rrugë pa krye në vitin 1983. Pas këtij dështimi, në nëntor të vitit 1983, udhëheqësit qipriotë-turq braktisën "Shtetin Federal Turk të Qipros" dhe deklaruan "Republikën Turke të Qipros Veriore"; një "shtet" i njohur vetëm nga Turqia deri më sot.

A. Marrëveshja e nivelit të lartë e 12 shkurtit të vitit 1977

1. Ne kërkojmë një Republikë Federale të të dy komuniteteve, të pavarur dhe të paanshme.

2. Për trevat nën administrimin e secilit komunitet duhet të diskutohet duke marrë parasysh qëndrueshmërinë ekonomike ose prodhueshmërinë dhe pronësinë.

3. Pyetjet mbi parime si liria e lëvizjes, liria e vendosjes, e drejta e pronës dhe çështje të tjera të veçanta, janë të hapura për diskutim, duke marrë parasysh bazën themelore të një sistemi federal të të dy komuniteteve dhe disa vështirësi praktike që mund të lindin për komunitetin qipriot-turk.

4. Fuqitë dhe funksionet e qeverisë qendrore federale do të konsistojnë në ruajtjen e unitetit të vendit duke pasur parasysh karakterin dy-komunitar të shtetit.

karakterin dy-komunitar të shtetit. http://www.moi.gov.cy/moi pio/pio.nsf/7e10bb4ee842cb7ec2257076004d01da/263fd 4a 15b6f2dc2256d6d00311d48? Hap dokumentin, parë më 27.8.2016..

B. Deklarata e Parlamentit të Shtetit Federal Turk të Qipros, për krijimin e Republikës së pavarur Turke të Qipros Veriore (TRNC), 15 nëntor 1983

Deklarata e krijimit të shtetit u paraqit si manifestim i të drejtës së popullit qipriot-turk për vetëvendosje. Këshilli i Sigurimit të OKB-së u mblodh në 17 dhe 18 nëntor të vitit 1983 dhe miratoi Vendimin 541 i cili përshkruante përpjekjen për të themeluar "TRNC"-në si "ligjërisht të pavlefshëm", kërkoi anulimin e Deklaratës së Pavarësisë dhe iu kërkoi të gjitha shteteve të mos e njohin Republikën e re. Qipriotët turq argumentonin se Këshilli i Sigurimit ishte një organizatë politike që merrej me paqen dhe sigurinë, dhe jo një organizatë e ligjshme, e aftë për të gjykuar "ligjshmërinë" ose "vlefshmërinë" e shteteve.

Asambleja jonë, Duke përfaqësuar vullnetin e lirë të kombit qipriot turk; duke besuar se të gjitha qeniet njerëzore, që janë lindur të lirë dhe të barabartë, duhet të jetojnë në një shoqëri të lirë dhe të barabartë;

Pasi deklaruan të drejtën e kombit qipriot-turk për vetëvendosje, me vendimin e 17 Korrikut 1983;

Duke përjashtuar diskriminimin e qenieve njerëzore pavarësisht nga raca, origjina, gjuha, besimi apo çdo bazë tjetër; dhe duke përjashtuar të gjitha format e kolonializmit, racizmit, tiranisë dhe sundimit; Duke shpresuar se paqja dhe qëndrueshmëria do të triumfonin dhe se liria dhe të drejtat e njerëzve do të lulëzonin jo vetëm në Qipro, por edhe në Mesdheun Lindor, Lindjen e Mesme dhe mbarë botën;

Duke besuar se të dy popujt e Qipros kishin të drejtën të jetonin dhe të vetëqeverisnin trevat e tyre në paqe dhe siguri, dhe kishin të drejtën të mbronin identitetin e tyre kombëtar;

Duke mbështetur me vendosmëri pikëpamjen se këta dy popuj, të përkushtuar që të bashkëjetojnë me njëri-tjetrin në ishull, mund dhe duhet të gjejnë zgjidhje paqësore, të drejta dhe të qëndrueshme për dallimet mes tyre, nëpërmjet bisedimeve në bazë të barazisë;

Plotësisht të bindur se deklarata e Republikës Turke të Qipros Veriore nuk do të pengojë por do të lehtësojë rivendosjen e partneritetit midis dy popujve brenda sistemit federal, dhe do të lehtësojë zgjidhjen e problemeve midis tyre;

Duke shpresuar se bisedimet do të zbatohen në mënyrë të barabartë, dhe nën mbrojtjen e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së me qëllim zgjidhjen në mënyrë paqësore dhe pajtuese të të gjitha çështjeve që ekzistonin midis dy popujve, dhe të bindur se takimi i propozuar i Samitit do të ishte i nevojshëm në këtë këndvështrim;

Duke vepruar në emër të kombit turko-qipriot, miraton themelimin e Republikës Turke të Qipros Veriore dhe Deklaratën e Pavarësisë. Duke shprehur vullnetin e ligjshëm dhe të pakufizuar të popullit turko-qipriot, ne deklarojmë para botës dhe historisë krijimin e Republikës Turke të Qipros Veriore si një shtet i pavarur.

Në këtë ditë historike, ne theksojmë mirënjohjen tonë ndaj dëshmorëve tanë të cilët sakrifikuan jetën e tyre që populli turko-qipriot mos të jetë kurrë më i nënshtruar nën sundimin e huaj dhe të jetojë me dinjitet dhe i lirë. Mëshira e Perëndisë qoftë mbi dëshmorët tanë.

https://tr.wikisource.org/wiki/Kuzey_K%C4%B1br%C4%B1s_T%C3%BCrk_Cumhuriyeti'nin_Ba%C4%9F%C4%B1ms%C4%B1zl%C4%B1k_Bildirgesi, parë më 26.08.2016.

C. Vendimi 541 i 18 nëntorit 1983 i OKB-së

Këshilli i Sigurimit, […]

1. Nuk miraton deklaratën e autoriteteve qipriote turke për ndarjen e supozuar të Republikës së Qipros,

2. Merr parasysh deklaratën që më lart konsiderohet si ligjërisht e pavlefshme dhe kërkon mosmiratimin e saj, […],

6. Ju bën thirrje të gjitha shteteve të respektojnë sovranitetin, pavarësinë, tërësinë territoriale dhe paanshmërinë e Republikës së Qipros,

7. Ju bën thirrje të gjitha shteteve të mos njohin asnjë shtet qipriot përveç Republikës së Qipro,

8. Ju bën thirrje të gjitha shteteve dhe dy komuniteteve në Qipro të shmangin çdo veprim që mund të acarojë situatën, […]

Miratuar në takimin e 250-ë më 13 vota pro, një kundër (Pakistani) dhe një abstenim (Jordania).

United Nations, Security Council Resolutions, 1983, https://documents-dds-ny.un.org/doc/RESOLUTION/GEN/NR0/453/99/ IMG/NR045399.pdf?OpenElement, parë më 26.08.2016.

1. Sipas çelësit, "Deklarata e shtetësisë u paraqit si një manifestim i së drejtës së kombit qipriot-turk për vetëvendosje".
Gjeni faktorët që mbështesin këtë pikëpamje të Deklaratës së Parlamentit të "Shtetit Federal Turk të Qipros" për themelimin e Republikës Turke të Qipros Veriore" (TRNC) të 15 nëntorit 1983.
2. "Republika Turke e Qipros Veriore" u njoh si shtet vetëm nga Turqia, ndërsa Vendimi 541 i OKB-së (1983) "mori parasysh deklaratën që më lart konsiderohet si ligjërisht e pavlefshme dhe kërkon mosmiratimin e saj".

VIII.2. JUGOSLLAVIA NE VITET 1980

VIII-4. Mihajlo Gjuriç dhe argumentet e tij kundër Kushtetutës së re të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (1974).

Kushtetuta e re e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë u publikua në vitin 1974. Ajo parashikon decentralizimin dhe federalizmin e mëtejshëm të vendit, duke garantuar të drejtën e vetos për të gjitha republikat, dhe për krahinat autonome që ishin pjesë e Republikës së Serbisë. Po ashtu, hartuesit e Kushtetutës deklaronin se ishte e vetmja mënyrë për të mbrojtur Jugosllavinë. Nga ana tjetër kritikët e saj, shumica nga Serbia, argumentonin se Kushtetuta do të çonte në shpërbërjen e saj. Publikimi i Kushtetutës u ndoq nga një sërë ngjarjesh politike që shënuan fillimin e federalizmit: Plenumi i Brionit i Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë; demonstratat e studentëve dhe demonstratat në Kosovë në vitin 1968; amendamentet kushtetuese të vitit 1968, 1971 dhe 1972; Pranvera Kroate; rënia e "liberalëve" në Serbi në vjeshtën e vitit 1972 (shih kapitullin III.5.3). Gjatë dëgjimeve publike mbi draftin e Kushtetutës, Mihailo Gjuriç, profesor në Fakultetin Juridik të Beogradit, u dërgua në burg, pasi në fjalimin e tij ai kundërshtoi publikisht ndryshimet e planifikuara kushtetuese.

A. Mihailo Gjuriç në debatin kushtetues

Duhet thënë në mënyrë të drejtpërdrejtë se amendamentet e propozuara kushtetuese ndryshojnë në mënyrë rrënjësore karakterin e bashkimit shtetëror të popujve jugosllavë. Ky amendament, në fakt, mohon idenë e një shteti të tillë. Nëse mbetet ende diçka nga ky shtet, kjo do jetë vetëm ajo që do të marrë fund kur të fillojë faza tjetër, e ashtuquajtura faza e dytë e ndryshimeve. Duhet të jemi plotësisht të qartë se Jugosllavia tashmë është vetëm një koncept gjeografik, pasi në territorin e saj ose, më saktë, në rrënojat e saj, nën maskën e zhvillimit të qëndrueshëm të barazisë midis popujve të saj, janë krijuar disa shtete të pavarura, madje edhe reciprokisht armiqësorë . Ky fakt duhet të shihet drejt në sy […]. Është shumë e rëndësishme të tregojmë që pozicioni i serbëve tashmë nuk është i barabartë me kombet e tjera. Kështu që, amendamenti i propozuar kushtetues është hartuar kundër interesave të tyre bazë. Pasoja përfundimtare e këtij amendamenti do të ishte shpërbërja e tyre e plotë. Natyrisht, kufijtë e Republikës Socialiste të Serbisë sot nuk janë të plota; ato nuk janë as kufijtë kombëtarë, as historikë të popullit serb [...]. A duhet me të vërtetë t'ju kujtoj se rreth 40 për qind e serbëve jetojnë jashtë Serbisë, ose se numri i tyre është pothuajse i barabartë me numrin e kroatëve në Republikën Socialiste të Kroacisë, pra numri i përgjithshëm i sllovenëve, maqedonasve dhe myslimanëve? Nëse vjen ndonjë kohë kur, të detyruar nga rrethanat, ata do të vendoseshin në një pozitë ku do t'ju duhej të themelonin sërish shtetin e tyre kombëtar, a do të qendronte indiferent populli serb ndaj një pjese kaq të madhe të bashkëkombasve të tij që jetojnë jashtë kufijve të tanishëm të Republikës Socialiste të Serbisë?

Đurić, 1971, fq. 230-233.

B. Latinka Peroviç, historiane dhe Sekretare e Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Serbisë, për debatin kushtetues

Pyetje: Si e vlerësoni Kushtetutën e vitit 1974 nga pikëpamja e mbijetesës së Jugosllavisë?

Përgjigje: Mendoj se duhet të shihet si një përpjekje për ta përgatitur Jugosllavinë për epokën e pas Titos, si një vlerësim i procesit të integrimit, që kishte filluar tashmë në shkallë evropiane […]. Krijoi një sistem zgjedhor të pështjelluar, që ishte thuajse i pamundur të zbatohej. Megjithatë, ende synonte që të arrihej një marrëveshje përbrenda shoqërisë jugosllave ku mund të bashkëjetonin të gjitha kombësitë. Gjithandej po talleshin me foljen "federoj", por për mua ishte shumë në rregull!

Pyetje: Rasti i profesor Xhuriçit përmendet shpesh. Çfarë mendimi keni ju për të?

Përgjigje: Që nga fillimi i diskutimeve për kushtetutën, i diskutimeve për ndryshimet kushtetuese të vitit 1971 të zhvilluara në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit të Beogradit, ai mbajti qëndrim kritik dhe tha se po ndryshohej Kushtetuta e Jugosllavisë. Ishte një interpretim i Republikës së Jugosllavisë nga pikëpamja e shtetit të Serbisë së Madhe! Nuk u morën me të për shumë kohë. E arrestuan pasi ne (liberalët) ishim larguar. Edhe sot e kësaj dite ne fajësohemi për arrestimin i tij. Na ka mbetur si damkë […]. Damka na ishte vënë sepse thuhej që ne e kishim dëbuar, sepse pretendohej që ne nuk ishim liberalë të vërtetë dhe që në të vërtetë ishim stalinistë, dhe na ishte vënë ky etiketim sepse nuk ishim nacionalistë dhe sepse besonim që Jugosllavia duhet të jetonte sipas një konsensusi dhe një lloj marrëveshjeje […]. Mënyra se si ne vepruam ishte për të treguar që Kushtetuta nuk ishte dhe nuk kishte qenë asnjëherë kundër interesave të Serbisë, ishte thjesht një version i ri i Jugosllavisë.

Milosavljević, 2010, fq. 47, 163, 164.

VIII-5. Demonstratat në Kosovën e vitit 1981

A. Vlerësimi i ngjarjeve nga komunistët kosovarë

PËRTEJ PARULLAVE DEMAGOGJIKE - VEPRA ARMIQËSORE Punëtorët, qytetarët dhe rinia e Kosovës i panë me shumë shqetësim demonstratat dhe gjendjen e tensionuar të krijuar në Prishtinë dhe pjesë të tjera të Krahinës, duke i dënuar në mënyrën më të rëndë dhe të vendosur, sepse ata e kuptonin shumë mirë se cilat forca armiqësore qëndronin pas tyre. […]

Demonstratat e organizuara nga elementë armiqësorë, pavarësisht se në fillim përdorën parulla për të krijuar kushte jetese më të mira, në fakt ishin organizuar për të shkatërruar atë që punëtorët nga të gjitha kombet dhe kombësitë e kishin arritur me shumë mundim, në mënyrë që të krijonin trazira, mosbesim, të përkeqësonin marrëdhëniet ndërmjet etnive dhe të pengonin bashkëjetesën tonë. Megjithatë, ata nuk ia dolën dhe nuk do t'ia dalin asnjëherë. Studentët dhe populli filluan të tërhiqeshin kur panë fytyrën e vërtetë të organizatorëve dhe kuptuan që demonstratat ishin krejtësisht armiqësore. […]

Sot, ashtu si edhe në të shkuarën, punëtorët tanë janë të vendosur të rrisin rendimentin, fermerët të kultivojnë tokën, ndërsa studentët dhe nxënësit të merren me mësimet. Vetëm kështu do të mund të kontribuojmë edhe më shumë për zhvillimin tonë të shpejtë sipas kritereve të qeverisjes socialiste, dhe për arritjen e interesave tona historike të shtresës sonë punëtore dhe të kombësive tona, si mënyrë për të përforcuar bashkimin dhe bashkëjetesën, për patriotizmin tonë socialist jugosllav dhe për zhvillimin e pandërprerë të komunitetit socialist vetëqeverisës, për Jugosllavinë tonë, për Jugosllavinë e Tito.

Rilindja, 5 prill 1981.

Numri i parë i gazetës shqiptare në Kosovë "Rilindja", u botua më 12 shkurt të vitit 1945, në Prizren, dhe ishte gazeta e parë në gjuhën shqipe brenda Jugosllavisë.

B. Reagimet në Beograd

Në plenumin e katërt të Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Serbisë, zhvilluar më 6 maj 1981, u diskutua për shkaqet dhe pasojat e "aksionit kundërrevolucionar" në Kosovë. Me atë rast, Spiro Galoviç tha si më poshtë: "Si është e mundur që nën hundën tonë po bëheshin përgatitje kaq të mëdha për demonstratat dhe nuk dinte askush gjë për to? Ku janë komunistët dhe organizatat e tyre, ku është Shërbimi i Sigurimit i Kosovës? […] Tani del se protagonistët kryesorë të ideve nacionaliste në Kosovë janë arsimtarët, një pjesë e rinisë dhe inteligjencies; nacionalizmi ndalohet të përmendet në universitete dhe shkolla […]. Për shkak të faktit se donim të kishim marrëdhënie të mira me fqinjët tanë, nuk i kushtuam sa duhet vëmendje nacionalizmit për Shqipërinë e Madhe. […]. Nacionalistët shqiptarë, po e kthejnë rininë kundër serbëve dhe po kërkojnë një

Kosovë të pastër etnike […]. Kërkesa për republikë, parulla mbizotëruese gjatë demonstratave në Kosovë, shprehet në kontekstin e një dëshire shoviniste kundërrevolucionare për ta dëbuar çdo joshqiptar nga Kosova."

Po në të njëjtin plenum, Dragoslav Markoviçi u shpreh: "Serbët dhe malazezët po largohen nga Kosova […]. Kjo valë migratore është e shpërpjestuar goxha dhe përfshin shumë serbë dhe malazezë. Largimi i një numri të madh fermerësh ishte i pritshëm, pavarësisht se zakonisht ata janë pjesa më pak e lëvizshme e shoqërisë. Ata i braktisën tokat e tyre në Kosovë dhe blenë tokë në pjesë të tjera të Serbisë dhe Jugosllavisë. […]. Mendoj se do të ishte me rrezik nëse kjo praktikë vazhdon".

Petranović et al., 1987, fq. 591-617.

Lexoni dy paragrafët nga burimet VIII-5A dhe III-5B:

a. "Demonstratat e organizuara nga elementë armiqësorë, në të vërtetë janë bërë për të shkaktuar trazira, mosbesim, për të përkeqësuar marrëdhëniet ndërmjet etnive dhe për të penguar bashkëjetesën tonë."

b."Në plenumin e katërt të Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Serbisë, zhvilluar më 6 maj të vitit 1981, u diskutua për shkaqet dhe pasojat e 'aksionit kundërrevolucionar' në Kosovë."

Si përshkruhen demonstratat dhe ankesat e popullit kosovar nga autoritetet dhe media e kontrolluar nga shteti? Diskutoni për argumentet dhe llojet e gjuhëve apo fjalorëve të përdorur. Krahasoni fjalët dhe shprehjet e përdorura në të dyja burimet dhe gjeni ngjashmëritë dhe dallimet midis tyre. Si e shpjegoni faktin që gjuha e përdorur në gazeta është më e paqartë dhe e vagët se gjuha e përdorur nga disa prej anëtarëve të Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Serbisë? Sa serioze ju duket akuza se në Kosovë po zhvillohet një "aksion kundërrevolucionar"?

VIII-6. Vendimi kundër Izetbegoviçit dhe të tjerë, 1983

NGA GJYKATA

Dje përfundoi gjykimi publik njëmujor i grupit armiqësor prej dymbëdhjetë anëtarësh të akuzuar për përfshirje në organizimin e veprimtarive në emër të nacionalizmit mysliman, kundër vëllazërisë, bashkimit dhe barazisë së kombeve dhe kombësive tona dhe kundër autoriteteve udhëheqëse të klasës punëtore, me qëllim pengimin e Bosnjë-Hercegovinës si një republikë socialiste dhe si rrjedhojë, pengimin e rendit shoqëror të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë.

Alija Izetbegoviç, një avokat 58-vjeçar nga Sarajeva dhe Omer Behmen, një inxhinier 54-vjeçar në Organizatën e Transportit Hekurudhor të Sarajevës, u dënuan përkatësisht me 14 dhe 15 vjet burg për krime të lidhura me veprimtaritë armiqësore të ndërmarra nga ata, duke krijuar një grup për të organizuar veprime kundërrevolucionare ndaj rendit sociopolitik të vendit tonë.

Vendimi, të cilin e lexoi gjykatësi Riza Hadziç për thuajse një orë, shpjegonte me hollësi se si kishte vepruar në mënyrë të organizuar grupi i nacionalistëve, duke nxitur krijimin e një Bosnjë-Hercegovine "të pastër etnikisht", me qëllim krijimin e një republike të mbështetur në parime islamike, në kontekstin e "bashkimit të fesë dhe ligjit", që do të përfshihej në një shtet të madh islamik që fillon nga Afganistani e shkon deri në Bosanski Brod të Bosnjë-Hercegovinës duke aneksuar pjesë të caktuara të republikave të vendeve të tjera dhe krahinave autonome. "Deklarata islamike" e Alija Izetbegoviçit shërbeu si platformë ideologjike për të gjithë ndërmarrjen.

Duke shpjeguar më tej vendimin, Riza Hadziçi tha:

"Ky nuk ishte një proces gjyqësor kundër fesë apo besimtarëve, ashtu siç u përpoqën ta nxirrnin të akuzuarit që në fillim. Mos vallë predikimi i fesë do të thotë që te xhamia e Tabaçit të hedhësh parulla si: "Vdekje tradhtarëve!", "Qëndroni larg tradhtarëve", apo "Nuk është mik një tradhtar!"? Ky nuk është veçse një sulm i hapur ndaj vëllazërisë dhe bashkimit të kombit dhe kombësive tona, një trashëgimi që na është lënë nga presidenti ynë Tito."

Oslobođenje, 21 gusht 1983, fq. 3.

Alija Izetbegoviç (8 gusht 1925 – 19 Tetor 2003) ishte një aktivist dhe politikan boshnjak, që në vitin 1990, u bë Presidenti i parë i Republikës së Bosnjë-Hercegovinës. Ai është autori i Deklaratës Islame (1970) dhe i librit "Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit" (1985), që ngjallën shumë diskutime dhe në të cilët ai pretendonte se Islami është shumë më i lartë se lidhjet e tjera alternative intelektuale dhe shpirtërore. Në vitin 1983 ai u dënua

→

me katërmbëdhjetë vjet burg për "veprimtari armiqësore të frymëzuara nga nacionalizmi mysliman". Ky vendim u kritikua nga organizatat "Amnesty International" dhe "Helsinki Watch" si një "propagandë komuniste". Izetbegoviçi u lirua pas pesë vitesh. Në vitin 1989 ai krijoi "Partinë Myslimane të Veprimit Demokratik", duke fituar kështu 33% të vendeve në Parlamentin e Bosnjë-Hercegovinës. Në shkurt të vitit 1992 ai kërkoi të zhvillohej një referendum për pavarësinë, për ta njohjur Bosnjë-Hercegovinën si shtet të pavarur. (shiko vëll. 2, kap. I, dok. I-12). Pjesën më të madhe të viteve të luftës Izetbegoviçi e kaloi në Sarajevën e rrethuar. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit, në nëntor të vitit 1995, ai u bë anëtar i Presidencës së Bosnjë-Hercegovinës, nga e cila hoqi dorë në vitin 2000. Alija Izetbegoviç vdiq nga një sëmundje zemre gjatë kohës kur Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (GJPNIJ) po kryente një hetim ndaj tij.

VIII-7. Fjalim publik nga Komiteti i Mbrojtjes së Lirisë së Mendimit dhe Shprehjes së Mendimit, 20 nëntor 1984

Të dashur shokë,
Në vendin tone është shtuar gjithnjë e më shumë praktika e nxjerrjes para trupit gjyqësor e njerëzve për mendimet që kanë, jo vetëm për ato që thonë (krim verbal), gjithashtu edhe konfiskimi i dorëshkrimeve të tyre sa vjen e shtohet dhe është kthyer në një metodë ideologjike dhe e ligjshme, që autoritetet e përdorin për t'u marrë politikisht me kundërshtarët e tyre. Të gjithë elementet e mëposhtme janë burim i shqetësimit të thellë për të gjithë personat e vetëdijshëm dhe mendjelirë të vendit tonë: ndëshkimi drakonian (8 vjet burg) i Vojislav Sheshelit për përmbajtjen e dorëshkrimeve të tij të konfiskuara; arrestimi i intelektualëve të Beogradit; procesi gjyqësor i ardhshëm i gjashtëshes së Beogradit (Vladimir Mijanoviç, Pavlu Shko Imshiroviç, Miodrag Miliç, Milan Nikoliç, Dragomir Olujiç dhe Gordan Jovanoviç) për biseda intelektuale të fshehta; një dorëshkrim i konfiskuar nga policia, gjithashtu, edhe disa vendime të mëparshme të dhëna në Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Slloveni, Kosovë dhe vende të tjera të Jugosllavisë; dhe persekutimi në vendin e punës i intelektualëve "të lëkundshëm moralisht dhe politikisht". Liria e mendimit dhe e shprehjes rrezikohen nga arbitrariteti i pushtetshëm dhe i paskrupullt i mungesës së ligjit dhe nga motivimet dhe prirjet politike të së shkuarës.
Këto arrestime, procese gjyqësore dhe vendime të frikshme përbëjnë një shkelje flagrante të të drejtave themelore të njeriut, në veçanti të të drejtave të lirisë së mendimit dhe shprehjes, e cila sot nuk respektohet vetëm nga regjimet autoritare.

Të nxitur nga shqetësimet humanitare dhe socialiste dhe nga ngjarjet dhe rrethanat shqetësuese të ndodhura së fundi, kemi vendosur që të propozojmë krijimin e Komitetit për Mbrojtjen e Lirisë së Mendimit dhe Shprehjes. […]
Komiteti përfaqëson një shoqatë të lirë të punonjësve të sektorit të kulturës, shkencës dhe atij publik, që janë të gatshëm të mbrojnë publikisht lirinë e mendimit dhe shprehjes. Komiteti do t'iu mundësojë mbështetje qytetarëve të Jugosllavisë, që pritet të persekutohen për shkak se kanë shprehur mendimet e tyre.
Komiteti do të kërkojë lirimin e të gjithë atyre personave të arrestuar për shkak të besimeve të tyre. Komiteti nuk do të mbrojë askënd që propagandon dhunë dhe urrejtje.
Ju përshëndes miqësisht dhe me respekt,
10 nëntor 1984
Dobrica Çosiç, Beograd, Branka Donoviça 6
Taras Kermauner, Lubjanë, Jamova 75
Rudi Supek, Zagreb, Ivana Gorana Kovaçiça 2

Ćosić, 2002, fq. 122-125.

Komiteti për Mbrojtjen e Lirisë së Mendimit dhe Shprehjes, u krijua mbështetur në nismën e nëntorit të vitit 1984 të Dobrica Çosiçit.
Ngjarjet që çuan në krijimin e tij ishin arrestimi dhe procesi gjyqësor që u ndërmor ndaj të ashtuquajturve "Gjashtëshja e Beogradit". Në përputhje me qëllimet e themeluesve të saj, detyra e Komitetit ishte të mbulonte të gjithë Jugosllavinë. Ishte komiteti i parë për mbrojtjen e të drejtave civile dhe të njeriut në Jugosllavi. Qëllimi i tij kryesor ishte të mbronte të gjithë qytetarët jugosllavë dhe të shpëtonte anëtarët themelues, liritë e mendimit dhe të shprehjes të të cilëve ishin në rrezik. Këtë e bënin duke reklamuar çështjen e tyre. Komiteti ndaloi së funksionuari në vitin 1989.

Si e shpjegon ky burim gjendjen, për sa i përket të drejtave themelore të njeriut në Jugosllavinë e viteve 1980?

VIII-8. Protestat e rinisë kundër "persekutimit" të lëvizjes pank në Lubjanë në vitet 1980

Muzeu i Historisë Bashkëkohore, Lubjanë.

Në fillim të viteve 1980, panku shihej si nënkulturë e vetëm një kategorie të caktuar të rinjsh. Megjithatë, nga mesi i atij dhjetëvjeçari u kthye në një lëvizje më të gjerë shoqërore. Zhvillimi i saj lidhej me kushtet e padenja shoqërore dhe ato ekonomike të Jugosllavisë së asaj kohe. Falë faktit se mbështeste pluralizmin politik dhe shoqëror, panku arriti t'i rezistonte shumë pikëpamjeve tradicionale dhe ideologjike të socializmit. Idetë e lëvizjes tërhiqnin rininë, madje edhe Shoqata e Rinisë Socialiste të Sllovenisë i mbështeste ata përmes Radios së Studentit dhe revistave "Tribuna" dhe "Mladina". Megjithatë, elitat e brezit të vjetër në pushtet nuk ndanin të njëjtin mendim.

Çfarë përfaqësonte lëvizja pank për rininë e Sllovenisë? Gjeni të dhëna për muzikën dhe lëvizjen pank në vendin tuaj dhe tregoni sa e famshme ishte në atë kohë.

VIII-9. Kriza ekonomike dhe mungesat në Jugosllavi

Në fund të viteve 1970, Jugosllavia po përjetonte një krizë të thellë ekonomike . Borxhi i saj i jashtëm ishte rritur nga $1.4 miliardë në vitin 1966, në rreth 20 miliardë në vitin 1980, sepse kishte marrë borxhe të reja për shkak të kushteve të shumta të pafavorshme, si mënyrë për të shlyer borxhet e vjetra. Qeveritë e Milka Planincit dhe Branko Mikuliçit kishin si qëllim stabilizimin e ekonomisë përmes së ashtuquajturës "ekonomia e terapisë së shokut". U ndaluan të gjitha importet që nuk ishin të menduara për prodhim, përfshirë këtu edhe mallrat e konsumit. Masat e ashpra të vendosura, me qëllim shlyerjen e huave, shkaktuan shumë "lëkundje" të ekonomisë dhe ndikuan në standardin e jetesës. U ndërmorën edhe masa kufizuese për konsumimin e energjisë elektrike. Gjithashtu, pati edhe mungesë të lëndës djegëse. Konsumi i lëndës djegëse u kufizua në 40 litra për makinë në muaj; u kufizua edhe lëvizja me makinë; u racionuan vaji dhe kafeja dhe ra →

numri i importeve të materialeve të lëndës së parë. Njerëzit prisnin në radha të gjata për të blerë detergjent, sapun, pastë dhëmbësh, banane dhe mallra të tjera të importuara. Jugosllavia u radhit si një nga 17 debitorët më të mëdhenj në botë. U rritën inflacioni dhe papunësia. Kryeministri i RSFJ-së, Ante Markoviç, kishte si qëllim vendosjen e një programi për reformat ekonomike, që rezultoi pjesërisht i suksesshëm brenda një kohe të shkurtër. Në fillim të viteve 1990, filloi të bëhej e qartë që qeveria federale nuk mundej ta zbatonte programin.

A. Makina me targa teke dhe çifte gjatë kohës së krizës (1979)



Përkthim: Kemi planifikuar gjithçka me kujdes, përveç faktit që këtë fundjavë në rrugë lejohen vetëm makinat me targa teke.

Vjesnik, 6 maj 1979.

Si rezultat i zhvlerësimit të dinarit jugosllav dhe pamjaftueshmërisë së monedhës së huaj, në fund të viteve 1970 dhe në fillim të viteve 1980, në Jugosllavi kishte mungesa të mëdha të mallrave të importuara, si kafe. Si rezultat i zhvlerësimit të dinarit dhe për shkak të çmimeve të larta të naftës, pati mungesa edhe në karburant. Autoritetet kishin si qëllim zgjidhjen e krizës duke ndërmarrë një sërë masash të ashpra, përfshirë atë të lejimit të qarkullimit të makinave në rrugë mbështetur mbi faktin nëse shifra e fundit e targës së regjistrimit ishte tek apo çift.

B. Filmat vizatimorë me temë mungesat (1982)

Borba, 10 shkurt 1982.

The Filmi vizatimor satirizon mënyrat e pagesës të pranuara nga një restorant: Kartë krediti American Express, Diners Club, Carte Blanche; Bono për të ngrënë vakt të ngrohtë. Këta elementë tregojnë për ndryshimet shoqërore që filluan të shfaqeshin në vitet 1980. Që në vitet 1960, punëtorëve dhe punonjësve u jepeshin bono për të ngrënë vakt falas, sidomos atyre që punonin në fabrika dhe sipërmarrje që kishin restorant apo mensë. Në vitet 1970, u prezantuan kartat e kreditit.

VIII-10. "Revolucioni kundër burokracisë" ose siç njihet ndryshe, "Revolucioni i kosit" dhe ndryshimet në elitën e udhëheqjes politike të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, viti 1988.

"Revolucioni kundër burokracisë" apo "Guximi I njerëzve" janë fjalët e përdorura për të përshkruar një sërë protestash masive që u zhvilluan gjatë gjysmës së dytë të vitit 1988 dhe gjysmës së parë të vitit 1989, duke dëmtuar Partinë dhe elitën e shtetit të Malit të Zi dhe krahinave autonome të Vojvodinës, dhe Kosovës, që shumë shpejt u zëvendësuan nga mbështetësit e Sllobodan Millosheviçit. Protestat ishin vazhdim i atyre të organizuara nga Serbët e Kosovës në vitet 1980, dhe u bënë masive dhe të organizuara pasi Millosheviçi mori pushtetin në vitin 1987. Pasojat politike ishin shumë të mëdha, pasi Republika Socialiste e Serbisë tashmë kishte katër nga tetë vota gjithsej të Federatës Jugosllave dhe përbënte shumicën në Lidhjen e Komunistëve. Në të njëjtën kohë, autonomia e Kosovës dhe Vojvodinës u cënua shumë. "Revolucioni i kosit" është fjala e përdorur për të përshkruar protestat masive në Vojvodinë, që filluan në verën e vitit 1988 dhe arritën kulmin më 5 tetor të vitit 1988, kur protestuesit goditën me kavanoza me kos ndërtesën e Kuvendit të Provincës në Novi Sad.

A. A. Eksporti i "Revolucionit të kosit" në Mal të Zi

Gjatë diskutimit u evidentua që autorët e organizimit të skenave të shëmtuara, hedhjes së parullave dhe pikëpamjeve të papranueshme, u nxitën në orët e para të mëngjesit të 8 tetorit nga "Eksportuesit e revolucionit", disa emisarë dhe nxitës dhe që për këtë kishte prova të pakundërshtueshme. Kjo ishte arsyeja pse u miratua vendimi për masa të menjëhershme dhe ndërhyrje të policisë, dhe jo i punëtorëve dhe studentëve që u justifikuan në thirrjet e tyre për ndryshim dhe marrje të përgjegjësisë.

Në hapjen e fjalimit të tij, Dr. Miljan Radoviç tha: "Ngjarjet e fundit, si ato të së premtes së kaluar në Titograd dhe më pas në Nikshiç, na kanë treguar që burim i pakënaqësisë janë gjendja e rënduar ekonomike dhe rrethanat shoqërore. […] Ky ishte një rezultat i paprecedentë i kuptimit të realitetit tonë kundër komunizmit dhe socializmit, që deri dje mendohej i pamundur. Nën këto rrethana, origjinaliteti i kombësisë dhe shtetësia e kombit malazez po vihen shumë e më shumë në dyshim […]. Për këtë arsye, në këto kohë të vështira, përsëri dua të theksoj se Lidhja Komuniste e Malit të Zi, do të kërkojë me forcë dhe do të luftojë për bashkimin e Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë dhe klasës punëtore, ashtu siç ka bërë gjithmonë, për një Jugosllavi të bashkuar federale dhe socialiste, për vëllazëri dhe bashkim dhe barazi të të gjithë kombeve dhe kombësive".

Pobjeda, 14 tetor 1988, fq. 1-3.

B. Këngë e kënduar gjatë protestave kundër autonomistëve (udhëheqja vendore e Partisë) në Titov Vrbas, Vojvodinë, Gusht 1988

Slobodan, ti duhesh quajtur Sloboda (Liri).
Të duan që nga i vogli e deri tek i madhi.
Për sa kohë kemi Slobon në udhëheqje,
ne nuk i nënshtrohemi askujt.
Tani njerëzit rrinë vrasin mendjen
se kush do vijë në vend të Titos.

Đukić, 2009, fq. 290.

VIII-11. Greva e urisë e minatorëve të Stari Trg në Kosovë dhe reagimet në Serbi dhe Sllloveni, 1989

Të udhëhequr nga Azem Vllasi, udhëheqja e Krahinës Autonome të Kosovës kundërshtonte ndryshimet kushtetuese dhe politike të shpallura nga Millosheviçi, sipas të cilave autonomia e gjerë që i ishte njohur Kosovës nga Kushtetuta e vitit 1974, do të kufizohej. Më 17 nëntor të vitit 1988, u shkarkuanVllasi së bashku me udhëheqës të tjerë shqiptarë. Si kundërpërgjigje, shqiptarët e Kosovës organizuan protesta masive në mbështetje të udhëheqësve të tyre të shkarkuar. Në shkurt të vitit 1989, minatorët e Stari Trg nisën grevën e urisë, meqenëse kërkesat e tyre nuk u morën parasysh. Më 27 shkurt në Lubjanë, u organizua një mbledhje në mbështetje të minatorëve shqiptarë, në të cilën mori pjesë presidenti slloven, Milan Kuçan. Njëkohësisht, më 28 shkurt, u organizuan demonstrata të mëdha jashtë Kuvendit Federal në Beograd. Demonstruesit kërkuan një zgjidhje të menjëhershme të gjendjes në Kosovë dhe arrestimin e Azem Vllasit. Millosheviçi iu drejtua demonstruesve dhe u premtoi që ai do arrestohej. Po atë ditë, nën trysninë e Millosheviçit, udhëheqja federale shpalli gjendjen e jashtëzakonshme, ndërsa greva e urisë e minatorëve u ndalua me forcë. Një muaj më vonë, më 23 mars, Kuvendi i Kosovës miratoi ndryshimet kushtetuese dhe më 28 mars, Kuvendi i Serbisë miratoi ndryshimet e bëra në Kushtetutën Federale. Më 1 dhjetor të vitit 1989, në Lubjanë u organizua një "Tubim i së Vërtetës" nga serbët dhe malazezët e Kosovës, me qëllim paraqitjen e fakteve të vërteta të ngjarjeve të zhvilluara në Kosovë. Udhëheqja sllovene e ndaloi tubimin dhe më 1 dhjetor udhëheqja serbe kërkoi shkëputjen e lidhjeve ekonomike me Sllloveninë. Ajo që vijoi ishte një bojkot në masë të të mirave sllovene në Serbi, që u sanksionuan nga vendimi i fshehtë i kaluar nga Kuvendi i Serbisë. Sllovenët iu kundërpërgjigjen me masat e tyre.

Mirko Rapaić, Beograd (1 dhjetor 1989)

Presidenca e Aleancës Socialiste të Punëtorëve të Serbisë iu ka kërkuar të gjitha qendrave, institucioneve dhe sipërmarrjeve në Serbi, që të shkëpusin të gjitha lidhjet dhe t'i japin fund marrëdhënieve me Sllloveninë. Mendoj se kjo është një kërkesë historike, e barabartë me atë të 27 marsit. I shpreh urimet e mia udhëheqjes së Serbisë për këtë qëndrim të vendosur dhe patriotik. I bashkohem kësaj kërkese dhe jam plotësisht kundër nazifashizmit slloven […]. Më në fund u bë e qartë se sa shumë sllovenët i urrejnë serbët.

Milorad Simeunoviç, Rakovica (7 dhjetor 1989)

Që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, sllovenët kanë pasur një vend të privilegjuar në shtetin tonë të përbashkët të Jugosllavisë. Falë faktit se vendin kyç në federatën tonë e kishte populli i tyre "i zgjuar" dhe "Jugosllav", ata bënë çfarë i deshi qejfi me këtë vend, dhe të gjitha këto u bënë për të përfituar Sllovenia dhe Kroacia.

Le ta analizojmë pak. Menjëherë pas luftës, Serbia u "mbyt" nga taksimi dhe mbitaksimi. Me qindra mijëra

bagëti u konfiskuan nga fondi për bagëti i Serbisë. Të rikujtojmë se cilët politikanë sllovenë kishin poste të larta në federatë. Gjithashtu, nuk duhet të harrojmë sa sipërmarrje serbe u transferuan në Slloveni dhe në republika të tjera perëndimore. […].

Të zgjohen shokët tanë sllovenë dhe të kuptojnë se nuk munden ta shfrytëzojnë më Serbinë, as përmes materialeve të mëparshme të lëndës së parë, e as përmes rrjetit të tyre tregtar.

Letrat e lexuesve të botuara në të përditshmen e Beogradit, Politika; Mimica et al., 2001, fq. 247-248.

Azem Vllasi (1948) është një politikan dhe avokat shqiptar nga Kosova. Në fund të viteve 1970, ai ishte një udhëheqës i njohur i organizatave rinore të mbështetura nga Tito. Në vitin 1980, ai e kritikoi Enver Hoxhën për sundimin e tij diktatorial, duke pretenduar se shqiptarët ishin më mirë në Kosovë se sa në Shqipëri. Në vazhdim të veprimtarisë së tij politike, ai u bë president i Lidhjes Komuniste të Kosovës dhe në vitin 1986, u bë president i Kosovës (pas ndryshimeve kushtetuese në Jugosllavi, krahinat autonome kishin shumë pak ndryshime nga republikat). Në vitin 1988, Vllasi së bashku me disa politikanë të tjerë udhëheqës shqiptarë, u rrëzuan nga Revolucioni kundër Burokracisë, për shkak të kundërshtimit të politikave të Millosheviçit. Në vitin 1989, u arrestua me akuzë ushtrimin e veprimtarive kundërrevolucionare (akuza që iu bëhej të gjithë kundërshtarëve politike të Jugosllavisë) dhe u lirua disa muaj më vonë. Pas luftës ai nuk pranoi asnjë pozicion të rëndësishëm në politikën e Kosovës, por shërbeu si këshilltar i kryeministrit. Gjithashtu, ka punuar si avokat dhe si këshilltar politik.

VIII-12. Ekstrakte nga fjalimi i Sllobodan Millosheviçit me rastin e 600 vjetorit të Betejës së Kosovës. (1989)

Në këtë vend, në zemër të Serbisë, në Fushë Kosovë, para gjashtë shekujsh, para 600 vjetësh, u zhvillua një nga betejat më të rëndësishme të asaj kohe […]. Si pasojë e rrethanave shoqërore, po zhvillohet ky përvjetor i madh i 600-të i Betejës së Kosovës në një vit kur Serbia, pas shumë vitesh dhe dhjetëvjeçarësh e ka rifituar integritetin e saj shtetëror, kombëtar dhe shpirtëror. […]

Koncesionet që bënë shumë udhëheqës serbë në kurriz të popullit nuk mund të pranoheshin historikisht dhe etnikisht nga asnjë komb në botë, pasi serbët asnjëherë në historinë e tyre nuk kanë pushtuar apo shfrytëzuar të tjerët. Ekzistenca e tyre kombëtare dhe historike është siguruar përmes luftrave çlirimtare gjatë dy luftërave botërore, ashtu siç është edhe sot. Ata u çliruan vetë dhe, kur kishin mundësi, ndihmonin dhe të tjerë të çliroheshin. Nuk është mëkat apo turp fakti që serbët janë një komb i rëndësishëm në rajon […]

Për shkak të udhëheqësve dhe politikanëve dhe mendësisë së tyre vasale, ata ndiheshin fajtorë për veten dhe të tjerët. Kjo gjendje zgjati për dhjetëvjeçarë me radhë dhe ja tek jemi tani në Fushë Kosovë duke thënë se gjërat kanë ndryshuar. […]

Gjashtë shekuj më vonë jemi përsëri pjesë dhe po përballemi me beteja. Nuk janë beteja të armatosura, megjithëse ende nuk mund të përjashtohen. Megjithatë, pavarësisht llojit të tyre, betejat nuk fitohen dot pa vendosmëri, trimëri dhe sakrificë. […]

Gjashtë shekuj më parë, Serbia nuk mbrojti vetëm veten në Fushë Kosovë, por edhe Evropën. Në atë kohë, Serbia ishte bastioni që mbrojti kulturën, fenë dhe shoqërinë Evropiane në përgjithësi. […]

Slobodan Milošević's 1989 Fjalimi i Ditës së Shën Vitusit, Gazimestan,28 qershor 1989; http://www.pecat.co.rs/2011/06/govor-slobodana- milosevica-na-gazimestanu-1989-godine/, parë më 25.8.2016.

Pas takimit të tetë të Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Serbisë në vitin 1987, Sllobodan Millosheviçi u bë shumë shpejt udhëheqësi serb. Kulmi i pushtetit të tij u arrit pas fjalimit që mbajti me rastin e 600 vjetorit të Betejës së Kosovës në ditën e Shën Vitusit, më 28 qershor të vitit 1989. Millosheviçi shkoi në Fushë Kosovë me helikopter dhe e mbajti fjalimin e tij para afro 600,000 dhe 2,000,000 njerëzish. Ishte e pranishme e gjithë udhëheqja shtetërore e Jugosllavisë, gjithashtu edhe shumë ambasadorë të huaj, megjithëse ambasadorët e SHBA-së dhe Turqisë nuk pranuan të ishin të pranishëm. Më vonë fjalimi tij u interpretua në mënyra të ndryshme, por mbeti i njohur si një tregues i luftërave të ardhshme në territorin e Jugosllavisë.

Disa ekstrakte nga fjalimi i Millosheviçit shkaktuan trazira në Jugosllavi, pasi u interpretuan si kërcënime me luftë ndaj disa republikave të tjera. Gjeni idetë e mësipërme te burimi. Shfrytëzoni njohuritë që keni dhe shpjegoni rëndësinë që ka festimi i 600 vjetorit të Betejës së Kosovës në kontekstin e situates së krijuar në fundin e viteve 1980 në Jugosllavi.

Republikat dhe krahinat Autonome të Jugosllavisë

VIII.3. KRIZA E KOMUNIZMIT

VIII-13. Greva e urisë e minatorëve të Valea Jiuluit (1-3 gusht 1977)

Nikolai Çaushesku duke "vizituar" minatorët e Valea jiuluit më 3 gusht të vitit 1977.

Koleksioni në Internet i Fotografive të Komunizmit, numri i referencës 142-1977142-1977, http://fototeca.iiccr.ro/picdetails.php?picid=44492X6X75&lang=en, parë më 27.08.2016.

Fotografia është e parapërgatitur. Çaushesku u kërkua që të shkonte urgjentisht te minierat, që t'i jepte fund grevës së urisë, ndërsa gazetat shpallën që ai do të vizitonte shumë qendra pune të tjera në vend. Preteksti për pakënaqësinë e përgjithshme ishte ligji i ri për sigurimet shoqërore (ligji nr. 3/1977) që solli një ulje shumë të madhe në pagat e punëtorëve. Minatorët nga Lupeni dhe Aninoasa protestuan ndaj masave të reja dhe për faktin se udhëheqësit e Partisë nuk ishin konsultuar me ta, dhe as nuk iu ishin përgjigjur kërkesave të tyre për një sërë takimesh këshilluese. Një numër i vogël minatorësh, propozuan që një delegacion prej 200 punonjësish duhej dërguar në Bukuresht dhe të kërkonte sqarime, por shumica nuk pranoi. Ata kërkuan që Çaushesku të shkonte vetë tek ata dhe të dëgjonte kërkesat e tyre. Kur mbërriti më 3 gusht, Çaushesku nuk pranoi të takohej me anëtarët e komitetit të grevës së urisë (i udhëhequr nga Konstadin Dobre) dhe ai mbajti një fjalim para të gjithë minatorëve, ku pranoi kërkesat e tyre, por më pas nuk mori asnjë masë për t'i përmbushur.

Rreth 30,000 minatorë ishin të pranishëm në atë takim. Ky takim ishte një shfaqje e qartë e shpirtit të solidaritetit, disiplinës dhe organizimit të tyre. Të nesërmen, autoritetet filluan të identifikonin udhëheqësit e grevës së urisë, veçanërisht atyre që ishin anëtarë partie. Forcat e sigurimit u hodhën në veprim dhe larguan me qindra mijëra persona "të dyshuar" nga zona, veprim që nxiti fillimin e grevës së urisë që ishte një nga protestat më të mëdha në Rumaninë komuniste.

VIII-14. Ekstrakte nga intervista me Drejtorin e Shkollës së Mesme Teknike të Nikolinës, në kohën kur zhvilloheshin protestat e punëtorëve në oborrin e fabrikës Nikolina (Iashi, shkurt 1987)

Isha i ri dhe nuk kisha parë asnjëherë diçka të tillë gjatë viteve të komunizmit […]. Sigurisht që më pas u bënë shumë hetime për të zbuluar si dhe ku kishte filluar e gjitha kjo. Askujt nuk i besohej që kjo ishte diçka e çastit. Dhe përfundimi i habitshëm ishte se ata që i kishin nxitur dhe mbledhur protestuesit në oborr mund të ishin vetëm nxënësit e shkollës, që kishin shkuar aty për trajnim[…]. Më pas erdhi dikush nga Sekretariati, me siguri nga Komiteti Qendror. Ai quhej Blanaru[…] dhe gjëja e parë që bëri sulmoi personin përgjegjës për trajnimin e studentëve. Ai po bënte pyetje dhe njëra prej tyre ishte: "Pse nuk kujdeseni sa duhet për nxënësit tuaj?" Ai tha që në shkollë zotëronte një kaos i vërtetë dhe nxënësit shkonin aty ku t'iu donte qejfi, por edhe në fabrikë shkonin ku të donin. Nuk jam i sigurt nëse ia kishte treguar dikush këtë veprim, apo nëse e kishte sajuar dhe e përdorte si justifikim. Si përfundim, shkolla u shpall fajtore.

Pintilie, 2015, fq. 183.

Zakonisht, të intervistuarit nuk e përmendin fare, ose e zbusin këtë ngjarje, që pak a shumë u "mbulua" nga demonstratat anti-komuniste të vitit 1989. Mendimi më i përhapur i asokohe ishte se disa nga punëtorët ishin të pakënaqur pasi iu ishin ulur rrogat, sepse nuk ishin realizuar objektivat e parashikuara të prodhimit. Zyrtarët e Partisë dhe Securitate-it (Departamenti i Sigurimit të Shtetit) të lashit ua vunë fajin drejtorëve të fabrikës, që mendohet se kishin vendosur norma arbitrare për rrogat. Edhe pse demonstratat u zhvilluan brenda një kohe të shkurtër, ato u bënë shumë përshtypje bashkëkohësve të tyre.

VIII-15. Shoqatat rinore jozyrtare në Bullgari

Duhet t'i kundërshtojmë me vendosmëri skemat e ngurta për organizimin e jetës së fëmijëve dhe adoleshentëve, që janë karakteristike të shumë kolektivave pedagogjike dhe fatkeqësisht i shumicës së familjeve. Forma më e preferuar e prindërimit në Bullgari deri më tani ka qenë ajo autoritare dhe organizimi i detyruar i veprimtarive jashtëshkollore dhe punëve shoqërore është ngulitur vazhdimisht në organizatat e Fëmijëve Pionerë dhe Komsomolit.

Deri më tani, veprimtaritë ideologjike dhe arsimore kanë synuar në përcjelljen e trashëgimisë kulturore të brezave paraardhës. Tani është më e thjeshtë të vihet re se vlerat e reja socialiste që ngjasojnë me ato universale, po pranohen dhe kërkohen më shumë.

Grumbullimi i krijuesve shoqërorë të rinisë nuk duhet të kryhet me anë të "pjesëmarrjes", "bindjes", "bashkësisë" apo të çohet dëm në jetën private të rinisë, por në kontekstin e nismës konstruktive dhe të gatishmërisë për ndryshime shoqërore.

Në shoqatat jozyrtare kulturore dhe artistike, përkrahësitt e poezisë së Petia Dubarovës janë më të spikatur. Strofat e saj përmbajnë aspiratat kryesore të rinisë si një grup socio-demografik, si: dëshira për vetëpohim, për të qenë i pavarur, për të arritur rezultate të larta, refuzimi i kompromiseve, zhvillimi i një mendësie kritike, një ndjeshmëri e theksuar, etj. Disa shembuj të këtyre strofave janë si më poshtë:

Vullneti i lirë
Në këtë dhomë çdo gjë është në vendin e saj.
Nuk duhet të lëvizë asgjë.
Do të dal jashtë.
Në këtë botë çdo gjë është në vendin e saj.
Nuk ndryshoj dot asgjë.
Jam e tepërt këtu.
Në zemrën tënde çdo gjë është në vendin e vsaj.
Ritmi i saj është i pagabueshëm.
Do filloj të qaj.

Një baladë për njerëz të vegjël
Kishte shumë njerëz të vegjël.
Ata ishin ulur në formë rrethi.
Njerëzit e vegjël po qanin!
Po qanin rreth kufomës së të sapolindurit, rreth kufomës së më të voglit prej tyre.
E KANË VRARË!
E kanë vrarë sepse kur lindi tha: "KAM NJË IDE."

Balkanski, 1989, fq. 56-57.

Në vitet 1980 u bë shumë e qartë paaftësia e organizatave zyrtare politike të rinisë për të drejtuar jetën e përditshme kulturore të të rinjve bullgarë. Shoqatat rinore jozyrtare u krijuan spontanisht si pasojë e dukurive të reja të kulturës së medies, si për shembull: trupi, seksualiteti, konsumizmi, sportet, muzika pop, dhe në përgjithësi, mundësia për të ndërtuar në mënyrë paksa të lirë botën kulturore dhe një mënyrë jetese që nuk përputhej me vlerat socialiste të vendosura. Këto shoqata bënë të mundur bashkimin e fansave të xhazit, hipit, pankut, heavy metal-it, motoristat, kulturës disko dhe një jetesë luksoze, Hari Krishnat, të droguarit dhe të tjerë. Ndonëse regjistrimi dhe kontrollimi i këtyre shoqatave ishte i vështirë dhe fakti se nuk kishin ndikim të drejtpërdrejtë shoqëror në shumicën e qytetarëve socialistë, prapëseprapë ekzistenca e tyre i shkaktoi shumë shqetësim regjimit. Vërtetë në vitet 1950 ata mbaheshin nën vëzhgim të rreptë të policisë, por në vitet 1980 shërbimet e fshehta nuk kishin më si qëllim "ndalimin e veprimtarive të tyre, por thjesht t'i kontrollonin dhe ridrejtonin" dhe kjo me ndihmën e organizatave zyrtare të rinisë, mësuesve, psikologëve dhe sociologëve.

VIII-16. Historia e Kamen Belopitovit, një nga artistët e parë të grafitit në Bullgari

Mbështetur në kushtet e artit bashkëkohor, Kamen Belopitovi do të quhej artist i konceptimit urban. Veprat e tij të grafitit në rrugët e qendrës së Sofjes nuk janë më tepër se një prototip i grafitit të sotëm. Ato janë një lloj i veçantë i artit që u shfaq dhe u zhduk para se të mund të kuptohej mirë, të mund të vendoseshin rregulla për të, apo të mund të bëhej e pëlqyeshme dhe para se të "plakej". Njësoj si vetë autori.

Puna dhe prania publike e Kamen Belopitovit ishin një bashkim i të menduarit tejet subjektiv dhe i lirisë absolute të shprehjes shoqërore. Nuk duhet harruar që në Sofjen e viteve 1986-1989 ishte e pranishme një "heshtje" e madhe pamore. Qyteti dukej thuajse steril krahasuar me mjedisin e sotëm pamor. Atëherë nuk kishte medie të fuqishme reklamuese, stenda afishimi (billboard) apo reklama të ndriçuara, ndërsa afishat që reklamonin ngjarjet kishin më shumë shkrime dhe gjendeshin vetëm në vende të caktuara. Shkrimet nëpër rrugë bëheshin më shumë me shkumës dhe për klubet e futbollit. Krahasuar me "veljen" pamore të sotme, grafitit 10 deri në 15 cm të Kamen Belipotovit nuk do të dukeshin fare. Por në vitet 1980 ata ishin

goxha të dukshme në një mjedis të organizuar mirë dhe kalimtarët nuk kishin pse të shikonin me shumë vëmendje për t'i spikatur.

Club rimsko prane / Roman Washing Club *Muhtyat me chorapkite* / My socks moss me *Kamara ot podlogi* / Pile of urinals (doormats)

Tenev, 2015, fq. 210-211.

Studioni burimet dhe çelësin. Gjeni materialin me shkrim dhe pamor që përshkruan organizimin, detyrat, sjelljet ceremoniale dhe uniformat e shoqatave zyrtare të rinisë. Më pas krahasoni sjelljet me synimet e lëvizjes rinore siç paraqitet në burimet e mësipërme. Cilat janë ndryshimet kryesore? Çfarë roli ka arti në këto forma shprehjeje? Diskutoni.

VIII-17. Rinia bullgare dhe fatkeqësia e centralit nuklear të Çernobillit në Ukrainë (BRSS)

Në muajt që vijuan fatkeqësinë nukleare të Çernobillit, që shpërtheu më 26 prill të vitit 1986, autoritetet bullgare i censuruan plotësisht lajmet lidhur me pasojat e shpërthimit. Të rinjtë bullgarë reaguan ashpër ndaj mungesës së të dhënave. Ndjesia e të qenurit i braktisur, i neglizhimit dhe pasigurisë së plotë, u kthyen në një kërkesë për gjetjen e përgjegjësit lidhur me çështjet e mëparshme të keqinformimit dhe situatat e krizës për të cilat, deri më atëherë, askush nuk kishte guxuar të niste një debat publik. Një sërë anketash sociologjike treguan se shumica e bullgarëve pa dyshim nuk iu besonin burimeve zyrtare të të dhënave. Ata nuk prisnin ta mësonin të vërtetën, por e kërkonin vetë. Në të shumtën e rasteve, të rinjtë përpiqeshin të gjenin të dhëna duke dëgjuar stacionet "armiqësore" të radiove, si për shembull Radio Free Europe/ Radio Liberty, Zëri i Amerikës, BBC dhe Deutsche Welle. Pakënaqësia në rritje e censurimit të medies zyrtare në përgjithësi u shoqërua nga ndërgjegjësimi në rritje për çështje mjedisore, që çoi në një sërë protestash kundër ndotjes mjedisore. Ndikimi përfundimtar i fatkeqësisë së centralit të Çernobillit në rininë bullgare, ishte që ata u bënë më kritikë ndaj politikave qeveritare socialiste dhe ishin të gatshëm të merreshin me çështje të interesit publik.

Të dhëna nga profesor Petar Mitevi, Drejtor i Institutit të Studimeve Rinore në Komitetin Qendror të Bashkimit Komunist Rinor të Dimitrovit, lidhur me sjelljen e rinisë ndaj mbulimit të situatës së rrezatimit bërthamor më 14-17 maj të vitit 1986 nga media.

Në Sofje qarkullonin thashetheme për shpërthimin edhe para se të merreshin raportet zyrtare nga BRSS-ja përmes të përditshmeve Izvestiya (30 prill) dhe Pravda (4 maj). Natyrisht që ky informacion u gjet falë dëgjimit të agjencive perëndimore të lajmeve. Gjithashtu, është e mundshme që më vonë marrja e informacionit nga qytetarët tanë përmes këtyre burimeve ka qenë mjaft aktive. Në sajë të këtyre të dhënave, populli ynë krijoi një psikozë të caktuar, e cila çoi në prirjen për të shmangur konsumimin e perimeve të freskëta, ujit të pijshëm dhe qumështit. Gjithashtu, u përhapen thashetheme të shumta lidhur me nivelin e radioaktivitetit në disa nga rrethet e vendit dhe së fundmi në bregdetin e Detit të Zi. Që prej 6 majit ka pasur shumë banorë që shkonin për t'u kuruar në qendrat e burimeve termale. Duhet të theksohet që thashethemet lidhur me lejimin zyrtar të aborteve deri në muajin e tretë të shtatzënisë, po ashtu edhe dhënia e pilulave të jodit nëpër kopshte dhe çerdhe kanë ndikuar shumë në stresimin e njerëzve. Kemi pak të dhëna, ose ato janë tepër të përgjithshme, lidhur me këtë rritje spontane dhe përhapje të thashethemeve nga më të pabesueshmet rreth vendit tonë. Nuk është e rastësishme që tendenca humoristike e popullit ka sjellë një sërë anekdotash të përshtatshme, si për shembull, përkufizimi i rrezatimit si dukuri që nuk ekziston fare, por që sa vjen e po ulet, etj. […]. Sindroma e çoroditjes në masë dhe paqartësisë u rrit edhe nga përdorimi zyrtar dhe jozyrtar i fjalëve që shumë pak njerëz i kuptonin, si: "becquerel", "curie", "rem", "millirem", "rad", etj.

Arkivat Shtetërore Qendrore, dok. 1Б, inv. 55, a.u. 712.

"Ndikimi përfundimtar i fatkeqësisë së centralit të Çernobillit në rininë bullgare ishte që ata u bënë më kritikë ndaj politikave qeveritare socialiste dhe ishin të gatshëm të merreshin me çështje të interesit publik (në çelës). Si e kuptoni këtë deklaratë? Diskutoni për lidhjen e tre elementëve të përmendur këtu (gjendja mjedisore, reklamimi dhe perspektiva për të ardhmen) me sjelljen e rinisë. Pse i interesojnë të tilla tema rinisë?

VIII-18. Vendosja e kufizimeve në përdorimin e përditshëm të energjisë elektrike, ujit dhe gazit në Rumaninë e viteve 1980

Pastaj vinte përsëri për disa minuta, por ishte llum balte, jo ujë. Në përgjithësi nuk kishte presion. Nëpër lavamanët e kuzhinave njerëzit mbanin kavanoza dhe tenxhere të mbushura me ujë të pijshëm për gatim, ndërsa në tualete mbanin ujë për të larë duart dhe fytyrën dhe ujë për banjën[…]. Uji i ngrohtë ishte tejet i "racionuar". Kishte vetëm dy orë në mbrëmje dhe dy orë në mëngjes, dy herë në javë. Nuk i thoshe dot ujë i ngrohtë, pasi nuk arrinte deri te katet e sipërme dhe në rastet kur arrinte ishte i ftohtë.

Dritat fikeshin shumë shpesh dhe kjo bëhej për të kursyer. Natën qytetet ishin në errësirë të plotë. Kjo njihej si "errësira socialiste". Shihje vetëm disa drita rruge të ndezura në rrugët kryesore.

Sa herë që iknin dritat, dilja nga hyrja ime, shkoja tek ashensori dhe bërtisja: Ka ngecur njeri në ashensor?

Në të shumtën e rasteve dritat iknin në mbrëmje, rreth orës 18:00-20:00. Nganjëherë kishte dhe ndryshime, sidomos në dimër […]. Disa komshinj të mirë vendosnin qirinj të ndezur në parmakët e shkallëve.

Filluam të kërkonim llamba vajguri në fshat[…]. Blerja e vajgurit ishte problem. Në fshat shitej në këmbim të vezëve, por në qytet ishte më e vështirë për ta gjetur. Na u desh të shkonim te disa karburante në periferi, ku kishte vajgur.

Gjatë ditës nuk kishte gaz. Që të mund të gatuaja duhet të rrija zgjuar natën, atëherë kur sistemi i gazit funksiononte. Pyesnim njëri-tjetrin në punë: Çfarë gatove mbrëmë?

Gazi fikej çdo ditë, që në mëngjes e deri në dhjetë të darkës. Unë gatuaja në mëngjes rreth orës 4 dhe 7. Kishte të tjerë që gatuanin natën, pas orës 23:00.

Muzeu Fshatar Rumun,
2008, fq. 32, 145-147, 181-182.

VIII-19. Anekdota rumune për ndërprerjet e energjisë elektrike dhe mungesën e ngrohjes qendrore

A. - E dinit se rumunët kanë shpikur frigoriferin më të madh në botë?
- Sa kushton?
- 280,000 lei!
- Është shumë shtrenjtë!
- Epo, ka gjithçka që të duhet, kuzhinë, tualet, dhomë gjumi.

B. -E more vesh për çfarë ishte dekreti i fundit? Banorëve që jetojnë në kat të parë nuk u lejohet të hapin dritaret në dimër.
- Pse kështu?
- Që të mos ngrijnë kalimtarët.

C. Një çift i moshuar duke lexuar një gazetë nën dritën e qiriut në një dhomë shumë të ftohtë.
- Përveç faktit se kemi për të ngrënë, jemi njësoj si gjatë luftës.

Niculescu Grasso, 1999, fq. 114.

VIII-20. Anekdota bullgare për mungesën e të mirave

Bisedë në një dyqan mishi në vitin 1985
- Ke mish viçi?
- Jo.
- Ke mish derri
- Jo.
- Ke salsiçe?
- Jo.
- Çfarë ke atëherë?
- Kemi orarin, hapur deri në 18.00.

http://spodeli.net/3/story-43198.html, parë më 26.09.2016.

Anekdotat janë një mënyrë për t'i bërë ballë situatave dhe kufizimeve të lirisë së shprehjes. Përpiquni të gjeni barsoleta politike në vende të tjera, si në sistemet diktatoriale të Greqisë ose Turqisë.

VIII-21. Një radhë me njerëz në pritje të vajgurit në Shqipëri, 1989

Vajguri përdorej nga familjet shqiptare gjatë regjimit komunist (1944-1990) kryesisht për gatim. Kjo fotografi është bërë në vjeshtën e vitit 1989 në një kohë krize të thellë ekonomike.

→

Fotograf Roland Tasho.

VIII-22. Parulla të hedhura gjatë tubimit të parë demokratik që u organizua pas rënies së Todor Zhivkovit, në sheshin Alexander Nevksi në Sofje, më 18 nëntor të viti 1989

Gjatë një plenumi të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste më 10 nëntor të vitit 1989, pas 33 vitesh sundimi autoritar, Todor Zhivkofi dha dorëheqjen nga posti i Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë. Dorëheqja e tij shënoi fundin e regjimit komunist dhe fillimin e tranzicionit drejt demokracisë. Kjo u ndoq nga një valë protestash dhe demonstratash, që sollën ndryshime të rëndësishme kushtetuese dhe legjislative në vend:

Mos vendosni njëzëri për fatin tonë!
Të bëhemi qytetarë, jo thjesht punëtorë!
Liri në shkolla, të drejta civile për nxënësit!
Demokracia kërkon të paktën dy parti politike!
Censorë, servilë, sahanlëpirës: Zhdukuni nga Shtypi, Radioja dhe Televizioni!
Suprimoni nenin 1(2) nga Kushtetuta! Neni thotë: Pushteti udhëheqës në shoqëri dhe shtet është Partia Komuniste e Bullgarisë.
Duam sistem shumëpartiak dhe zgjedhje të lira!
Punëtorë nëpër botë, bashkojuni inteligjencies! Ligjet janë për të gjithë!
Të ringjallim lirinë, këtë të ndjerë madhështore! Kulturë pa diktaturë!
Mos i shtypni qytetarët!
Të kthehemi me buzëqeshje në fytyrë si nga dyqani ashtu edhe nga mbledhja!
Çrrënjoseni ideologjinë nga shkenca! Të ndjekim shembullin e Hungarisë dhe Polonisë! Zgjohuni, njerëz! Është radha juaj! Dëgjoni zërin e popullit: Ndihmë! Perestroika është revolucion! Glasnost, oksigjen, salsiçe! Asnjëherë më totalitarizëm! Profesionalizëm, aftësi, vetëdije!
Milionat e plutokracisë së kuqe të shkojnë për grantet e studentëve! Po pluralizmit! 100 herë po demokracisë!
Mos lejoni që të "ristrukturoheni" sot nga persona që ju kanë "ristrukturuar" dje!

Të heqim metastazat e socializmit!
Komunistët nuk mund të riformohen, duhet të shformohen! Udhëheqës, mos i shtypni njerëzit, janë tuajt!
Pastrojeni mjedisin për fëmijët tanë. Glasnost, oksigjen!
Të heqim 50% të milicisë (policisë), në mënyrë që të rregullojmë ekonominë.
Të kapim kameleonët e tiranit Zhivkov!
Të gjykohen nga Gjykata e Popullit të gjithë ata që kanë "plaçkitur" Bullgarinë.
Cirku 35-vjeçar i totalitarizmit ka marrë fund.
Stalini me Hitlerin kanë vrarë njerëz, ndërsa Brezhnevi dhe Zhivkovi kanë vrarë shpirtra.
Duam spitale në vend të rezidencave qeveritare! Kthejuani emrat turqve tanë!
Mos e ktheni problemin e minoriteteve në bomba shoqërore. Jini tolerantë dhe njerëzorë! Zoti krijoi njeriun, jo kombin. Të drejta të barabarta për popullsitë bullgare dhe turke në Bullgari!
Duam liri fetare, mirëqenie sociale, shkolla bamirësie.
Të drejta të barabarta për ateistët dhe besimtarët. Pavarësi e kishës nga shteti.
Një Bibël për të gjithë!

http://www.omda.bg/public/arhiv/sabitia/parviat_miting.htm#_ftn52, parë më 27.08.2016.

1. Diskutoni për gjuhën e përdorur dhe përmbajtjen e parullave. Cila është kërkesa më e rëndësishme? Çfarë i mungon shtetit deri më tani? Si e kuptoni fjalën "socializëm" brenda këtij konteksti?
2. Komentoni parullën "Kthejuani emrat turqve tanë! (Gjithashtu, shikoni dokumentet e kapitullit VI.2)
3. Mbështetur te parullat, cilat janë problemet më serioze me të cilat po përballet vendi?
4. Pse kërkojnë "Të drejta të barabarta për ateistët dhe besimtarët" dhe "Bibël për të gjithë" demonstruesit?"?

VIII-23. Revolucioni në Rumani, nëntor 1989

Më 21 dhjetor të vitit 1989, njerëzit që ishin detyruar të mblidheshin në Sheshin Mbretëror të Bukureshtit për të shprehur "adhurimin" e tyre të zakonshëm për politikat e Nikolai Çausheskut, → nuk bënë këtë por e fyen atë. Të nesërmen, zëdhënësi i Partisë Komuniste të Rumanisë, edhe pse nuk donte të ngrihej mbi propagandën e zakonshme, botoi fjalimin e fundit të inatosur të diktatorit, me një koment lavdërues që kishte si qëllim "fshehjen" e fillimit të Revolucionit Rumun, nga vetë lexuesit.

A. "Në mbrojtje të arritjeve socialiste dhe pavarësisë dhe integritetit territorial të Rumanisë": Ekstrakte nga fjalimi i fundit i Çausheskut

Të dashur shokë dhe miq,
Po bëhet gjithnjë e më e dukshme se ngjarjet e ndodhura në Timishoara janë vepër e rretheve që kanë si qëllim shkatërrimin e integritetit dhe sovranitetit të Rumanisë, ndalimin e vazhdimit të socializmit, dhe vendosjen e popullit tonë kundër dominimit të huaj. Prandaj duhet të mbrojmë me gjithë fuqinë tonë integritetin dhe pavarësinë e Rumanisë!

Disa njerëz duan të rikthejnë papunësinë dhe të ulin standardet e jetesës së njerëzve, të "shqyejnë" Rumaninë dhe të rrezikojnë të ardhmen e popullit dhe të pavarësisë së kombit tonë.

Scînteia poporului, 22 dhjetor 1989, fq. 1.

B. Ish zëdhënësi i Partisë Komuniste të Rumanisë për pushtetin e ri "çlirues" kundër Çausheskut

"Masat dhe rekomandimet për dhënien fund të padrejtësisë së terroristëve. Ish diktatori dhe shërbëtorët e klanit të tij u arrestuan".

Ishte një ditë e tensionuar dhe e vështirë. Po kthehemi nga baza ushtarake e Frontit Kombëtar të Shpëtimit. Sot, për shkak të veprave kriminale të disa grupeve terroriste, sidomos të atyre të trajnuar për të luftuar kundër popullit dhe në mbrojtje të diktaturës, veprimtaritë tona të zakonshme nuk mund të zhvilloheshin si zakonisht. Na u desh të vendosnim disa përparësi dhe të bashkërendonim luftën kundër terroristëve. Ekzistenca e këtyre grupeve terroriste, e individëve fanatikë që veprojnë me mizori të paprecedentë, si për shembull goditja me armë e shtëpive dhe qytetarëve dhe shkaktimi i viktimave në ushtri. Këto vepra janë një tregues tjetër i karakterit jopopullor të të diktaturës së Çausheskut, i cili i ka lënduar njerëzit jashtëzakonisht shumë.

Si përfundim, të dashur qytetarë, duam t'iu informojmë që Nikolai dhe Elena Çaushesku janë arrestuar dhe tani ruhen nga ushtria.

Scînteia poporului, 22 dhjetor 1989, fq. 1.

C. Ekstrakte nga transkriptimet e "gjyqit" të mbyllur të Nikolai dhe Elena Çausheskut

Udhëheqësit komunistë të Rumanisë u ekzekutuan po atë ditë nga ekipi i pushkatarëve. Ky gjyq dhe skena e tmerrshme e ekzekutimit u regjistruan dhe u transmetuan në Televizionin Rumun dhe më pas në të gjithë botën.

Baza ushtarake e Tirgovistes, 25 dhjetor 1989 Prokuror Gica Popa

NIKOLAI ÇAUSHESKU: Njoh vetëm Asamblenë e Madhe Kombëtare. Do flas vetëm atje.

PROKURORI: Ashtu siç nuk pranoi të fliste me popullin, nuk po pranon të flasë edhe me ne. Gjithmonë ka pretenduar se vepron dhe flet në emër të popullit, që është një fëmijë i dashur i popullit, por e vetmja gjë që ka bërë është se ka tiranizuar popullin gjatë gjithë kohës. Jeni akuzuar se keni bërë festa shumë të shtrenjta për të gjitha pushimet në shtëpinë tuaj. Dihen hollësitë. Dy të pandehurit arritën të siguronin disa nga ushqimet dhe rrobat më luksoze jashtë vendit. Kishte dhe më keq se ish mbreti i Rumanisë. Njerëzve u jepej vetëm 200 gramë sallam në ditë dhe kjo jepej vetëm po të kishe letërnjoftimi.

Elena dhe Nikolai nuk e pranonin këtë. Një pyetje tjetër drejtuar Çausheskut: "Kush e urdhëroi masakrën e Timishoarës?" Çuashesku nuk pranoi të përgjigjej.

Prokurori i kërkoi këshillit mbrojtës ta pyeste Çausheskun nëse e dinte ai që nuk ishte më president i vendit, që edhe Elena Çaushesku nuk është më në detyrë shtetërore dhe që qeveria është shpërbërë[…]. Ai u përgjigj: "Unë jam Presidenti i Rumanisë dhe Komandanti i Përgjithshëm i ushtrisë rumune. Askush nuk mund të m'i marrë këto."

ÇAUSHESKU: Është gënjeshtër që e kam lënë popullin të vdesë urie. Është një gënjeshtër e paturp. Kjo tregon sa pak patriotizëm ka dhe sa vepra tradhtare janë kryer.

PROKURORI: Elena dhe Nikolai Çaushesku […] nuk janë akuzuar vetëm për shkelje të kryera gjatë ditëve të fundit, por edhe për shkelje të kryera gjatë 25 viteve të fundit[…]. Dua të përmend dhe një herë gjenocidin, vrasjet e shumta të ndodhura gjatë ditëve të fundit. Elena dhe Nikolai Çaushesku duhet të jenë plotësisht përgjegjës […]. Jo vetëm që e lanë popullin pa ngrohje, energji elektrike dhe ushqime, por edhe e tiranizuan shpirtin e popullit rumun. Jo vetëm që vranë fëmijë, të rinj dhe të rritur në Timishoara dhe Bukuresht, por edhe lejuan anëtarët e Sekuritates që të vishnin uniforma ushtarake, në mënyrë që të krijonin përshtypjen në popull se ushtria ishte kundër tyre. Donin ta ndanin popullin nga ushtria. Merrnin fëmijë nga jetimore apo nga jashtë vendit dhe i trajnonin në institucione të posaçme për t'u bërë vrasës të vetë popullit të tyre. Ishe kaq i pafytyrë saqë preve linjat e oksigjenit nëpër spitale dhe vrave njerëz në shtretërit e spitalit[…]. Nuk jam për dënimin me vdekje, por nuk do të kishte kuptim që populli rumun të vazhdojë të vuajë për shkak të këtij mjerimi të madh dhe të mos i jepej fund gjithë kësaj me dënimin e dy Çausheskëve me vdekje.

http://www.ceausescu.org/ceausescu_texts/revolution/trial-eng.htm, parë më 15.6. 2015.

D. "Revolucioni rumun nuk ka çfarë të fshehë. Sqarim për kolegët tanë të gazetës *"Le Figaro"*

Progresi i revolucionit nuk ishte as i lehtë dhe as nuk u zhvillua duke qenë në faqet e para të gazetave të mëdha të botës. Megjithatë, e gjithë bota mund t'i shihte ngjarjet dramatike të njëpasnjëshme të revolucionit rumun në televizor në shtëpitë e tyre. Por rumunët nuk e filluan revolucionin në shtëpi para televizorit. Rinia rumune luftoi e armatosur, edhe pse jo aq me armë, se sa me urrejtjen e tyre kundër diktaturës dhe me etjen e tyre për liri. Ata u vranë në emër të revolucionit, pa u menduar dy herë.

România liberă [Free Romania], nr. 18, 13 janar 1990, fq. 1.

Përdorni njohuritë e fituara nga libri dhe të dhëna nga burime të tjera dhe shpjegoni cilat janë shkaqet e brendshme dhe të jashtme të revolucionit rumun.

VIII-24. "Kriza e ambasadave" në Shqipëri, korrik 1990

Në korrik të vitit 1990, në vendin e fundit komunist në Evropë, më shumë se 5000 shqiptarë u futën në oborret e ambasadave perëndimore në Tiranë, në kërkim të azilit politik. E ashtuquajtura "Kriza e ambasadave" u zgjidh pas dy javësh bisedimesh ndërmjet autoriteteve komuniste Shqiptare dhe përfaqësuesve të OKB-së. Nga këto takime u arrit në përfundimin që azilkërkuesit të lejoheshin të shkonin në Perëndim. Eksodi i parë në masë ishte vetëm një nga të shumtët që do ndodhnin pas rënies së regjimit në dhjetor të vitit 1990. Për shembull, përgjatë vitit 1991, me mijëra njerëz u larguan nga vendi në kërkim të një jete më të mirë dhe u drejtuan më së shumti drejt Italisë dhe Greqisë.

A. Shqiptarët në kërkim të azilit politik në oborrin e ambasadës gjermane në Tiranë, korrik 1990

Arkiva e Lothar Parzellerit.

B. E përditshmja e Partisë Komuniste të Shqipërisë për "Krizën e ambasadave"

Huliganët e dinë shumë mirë fuqinë e klasës punëtore dhe prandaj u themi: "Punoni sepse vetëm puna ju shpërblen me gjithçka. Të mirat fitohen vetëm me djersën e ballit".

Punëtorët e fabrikës së miellit shprehën pikëpamje dhe mendime të shumta, të cilat ishin të mbushura me optimizëm për të ardhmen. Violeta Musabelliu, punëtore tezgjahu ka thënë: "Punoj me bashkëshortin tim te fabrika e miellit" Jetoj me djersën e ballit. Nuk kam gjithçka dua, por kur jemi në shtëpi na zë gjumi rehat, sepse nuk i kemi askujt gjë borxh. Nuk na lidh gjë me huliganët dhe njerëzit e liq nëpër rrugë. Policia ka arrestuar disa të rinj që punojnë në fabrikën tonë. I njohim shumë mirë. Ata iu larguan punës dhe nga mënyra jonë tradicionale e jetesës".

Sotiraq Najdo, mekanik, ka thënë: "Sapo jam kthyer nga një vizitë te prindërit e mi që jetojnë jashtë vendit. "Doja të ikja dhe e bëra këtë pa hasur as edhe një problem. Pashë gjithçka me sytë e mi dhe iu thosha disa njerëzve: Ju ka lënë truri fare. Nuk ka vend si i yni! Këtu kemi gjithçka na duhet dhe prandaj duhet t'i futemi punës. E mira nuk bie nga qielli. Siç thotë edhe fjala e urtë "Bukë e kripë dhe zemër të bardhë". Njerëzit e përdornin këtë fjalë të urtë në kohën kur në Shqipëri nuk kishte as edhe një fabrikë, një shkollë apo një spital, jo më sot! A i keni sytë në ballë? Shikoni me kujdes, mendohuni dhe vijani gishtin kokës. Ne do të arrijmë gjithçka me Partinë dhe shokun Ramiz si udhëheqës."

Një nga shokët tanë të punës, minatori Sokrat Sotiri, hyri brenda një ambasade. Ai nuk mund ta turpërojë

profesionin e nderuar të minatorit. 300 minatorë punojnë në minierën e Valiasit, ndërsa ne flasim për veprat e shëmtuara të disa njerëzve që me shumë të drejtë mund t'iu themi "llumi i shoqërisë".

Zëri i Popullit, 4 korrik 1990.

C. Gazeta komuniste "Bashkimi" dënon "huliganët"

Mbledhja e zhvilluar në Uzinën"Enver", uzinë pioniere e industrisë sonë mekanike, punëtorët shprehën njëzëri në emër të partisë, Komitetit Qendror dhe shokut, Ramiz Alia, solidaritetin që karakterizon popullin tonë.

Punëtorët e Qendrës për Informacion dhe Dokumentacion Teknik dhe Shkencor kanë thënë: "Na kanë mërzitur shumë ngjarjet e ndodhura në mbrëmjen e 2 korrikut." "Nuk mund të lejojmë në asnjë mënyrë që shteti ynë të dëmtohet dhe që të njollosen arritjet socialiste të vendit tonë."

Gjatë mbledhjes së hapur me organizatat bazë të Partisë nr.1 dhe nr. 2 të uzinës gjeologjike, punëtorët dënuan njëzëri veprat armiqësore të huliganëve. "Asgjë nuk na ndalon që të zbatojmë vendimet e Plenumeve të Nëntë dhe të Dhjetë të Komitetit Qendror të Partisë. Do të qëndrojmë në krye të vendit tonë të punës dhe të komunitetit tonë, në mënyrë që të përmbushin objektivat e Partisë dhe të luftojmë ndikimet dhe manifestimet e huaja."

Anëtarët e Frontit Demokratik në lagjen nr.39 të kryeqytetit, veteranë dhe të rinj dënuan me forcë veprimet e huliganëve dhe njëkohësisht prezantuan edhe detyra konkrete për zhvillimin e punës edukuese në familje, lagje dhe në shoqëri. Kishte shumë të rinj pjesëmarrës, të cilët shprehën zemërimin e tyre kundrejt veprave të tilla dhe u betuan që do ishin më aktivë, në mënyrë që të rrisnin ndërgjegjësimin e shoqërisë lidhur me manifestime të ngjashme.

Bashkimi, 5 korrik 1990.

1. Si i përshkruante protestuesit gazeta e regjimit? Cili ishte qëllimi i tyre? Kujt i drejtoheshin?
Cilat ishin "përfitimet e socializmit" dhe çfarë i rrezikonte? Ndiqni dhe komentoni për gjuhën dhe retorikën e përdorur në ato gazeta.
2. Cilës grupmoshe mendoni se i përkiste shumica e atyre që "nxitën" krizën e ambasadave?
Çfarë do të thoshte kjo për vendin? Diskutoni për eksodin e tanishëm të të rinjve nga vendet e Evropës Juglindore (si për shmebull, Greqia) për shkak të krizës financiare. →

3. Gjeni materiale pamore për eksodin në masë të shqiptarëve, sidomos të rinjve. Krahasojeni me krizën e tanishme të refugjatëve dhe diskutoni për dallimet (për shembull, anija plot me qytetarë drejtuar për në Itali).

VIII-25. Shkrimtari dhe poeti shqiptar, Ismail Kadare arratiset në Francë në tetor të vitit 1990

U arratis Ismail Kadareja. Shtypi i huaj informon se shkrimtari Ismail Kadare, që punoi për rreth një muaj në Francë, dje kërkoi azil politik aty. Me anë të kësaj vepre të turpshme që turpëron vetëdijen patriotike dhe qytetare të popullit tonë, ai e braktisi popullin dhe atdheun e tij dhe u bë shërbëtor i armiqve të Shqipërisë dhe kombit shqiptar.

Bashkimi, 27 tetor 1990, fq. 1.

VIII-26. Studentët duke djegur portretet e Hoxhës, dhjetor 1990

Fotografi: Roland Tasho.

Gjeni dhe krahasoni fotografitë që tregojnë tipare të ngjashme të aktivizmit (shembja e monumenteve shtetërore, shkatërrimi i portreteve, statujave dhe busteve të politikanëve, etj.) Në vendet e tjera, si në atë kohë dhe vite më vonë. Cili është kuptimi dhe simbolizmi i kësaj veprimtarie? Cila është veçoria e përbashkët e regjimeve që janë vënë në pikëpyetje dhe janë luftuar kështu?

BIBLIOGRAFIA

Abadan-Unat, Nermin, "Gjendja ligjore e grave turke" në Ferhunde Ozbai, 1990.

Ademović, Fadil and Danka Galeb, *Željezara Zenica* [Uzina metalurgjike e Zenicës], NIP Zadrugar, Sarajevë 1967.

Akkurt, Aydın, *Türk Mukavemet Teşkilatı 1957-58 Mücadelesi* [Organizata e Rezistencës Turke, Lufta e 1957-1958], Bayrak Matbaası, Stamboll 1999.

Raporti Vjetor Ndërkombëtar i Amnistisë 1981, 30 shtator, numri i indeksit: POL 10/0001/1981.

Andreescu, Andreea, Lucian Nastasă and Andreea Varga (eds.), *Minorități etnoculturale. Mărturii documentare. Maghiarii din România (1956-1968)* [Minoritetet etno-kulturore. Dëshmi dokumentuese. Hungarezët nga Rumania (1956-1968)], Editura Centrului de Resurse pentru Diversitate Etnoculturală, Cluj 2003.

Andrić, Ivo, *Travnička hronika. Konzulska vremena*, Belgrade 1963; Përkthimi në gjuhën angleze Celia Hawkes në bashkëpunim Bogdan Rakić, Kronika Boshnjake, Shtypi "Harvill", Londër 1992.

Arsovski, Tihomir, Gavrilski Gavril and Stojkov Trajko, *Grad-ski Trgovski Centar* [qendra tregtare Gradski], Lubjanë 1981.

Aver, Caner and Cem Şentürk (eds.), Prirjetemigrimit *hochqualifizierter Türkeistämmiger* [Prirjet Migratore të Turqve të Arsimuar], Stiftung Zentrum fur Turkeistudien und Integrationsforschung, Goethe Institut Izmir, 2013.

Bakarić, V., *Socijalistički samoupravni sistem i društvena reprodukcija* [Sistemi Socialit i Vetadministrimit dhe i Riprodhimit Shoqëror], vëll. 2, Zagreb 1983.

Balkanski, Petar, *Неформални младежки обединения* [Shoqata Rinore Joformale *Georgi Kirkov Series*, Ne. 2, Sofje 1989.

Beikou, Maria, *Αφού με ρωτάτε να θυμηθώ…* [Meqë më kërkuat të kujtoja...], Athinë 2010.

Berindei, Mihnea, Dorin Dobrincu and Armand Goşu, *Istoria Comunismului în Romania, Perioada Gheorghe Gheorghiu-Dej* [Historia e Komunizmit në Rumani. Periudha e Gheorghe-Gheorghiu Dej], vëll. I, Bukuresht 2009.

Bilandžić, Dušan, *Historija SFRJ* [Historia e republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë], Zagreb 1978.

Boglić, Mira, "U trenutku sumnje" [Çasti i dyshimit], *Filmska kultura* 13 (1969), Nr. 65.

Bostandzhiev, Todor, "Семейство и полово възпитание" [Edukata familjare dhe seksuale], *Семейство и училище* [Familja dhe shkolla], nr. 3, 1979.

Burmov, Alexander et al., *Отечествена история за четвърти клас на общообразователните училища* [Historia kombëtare e klasës së katërt të shkollave të përgjithshme], Sofje 1954.

Butković, Tomislav dhe Ranko Petković (eds.), *Nesvrstanost u suvremenom svijetu* [Mosangazhimi i botës moderne], Zagreb 1979.

Byford-Jones, W., Trilogjia Greke *(Rezistenca–Çlirimi–Revolucioni)*, Hutchinson & Co, Londër 1946.

Büyüktaşçıyan, Hera (ed.), *20 dolar 20 kilo: Cumhuriyet Tari-hinin en Büyük Sürgün Hikayelerinden Biri* [20 dollarë 20 kile: Një prej mërgimeve më të mëdha në historinë e Republikës], Babil (Bağımsız Araştırma Bilgi ve İletişim Derneği), Stamboll 2014.

Carabott, F. & M. dhe A. Katzourakis, *Design Routes*, Athinë 2008.

Chatziotis, K., *Μεγάλα καταστήματα Δραγώνα (1896-1987)* [Dyqanet Dragonas], Athinë 1999.

Čolić, Milutin, "Crni film ili kriza autorskog filma" [Film "noir" ose kriza e autorëve të filmave], *Filmska kultura* 14 (1970), Nr. 71.

Copeaux, É., *Espaces et temps de la nation turque. Analyse d'une historiographie nationaliste 1931-1993*, CNRS Éditions, Paris 1997.

Ćosić, Dobrica, *Piščevi zapisi, 1981-1991* [Shënimet e autorit, 1981-1991], Beograd 2002.

Dağlıoğlu, Gökçay, "Turgut Özal Döneminde Türkiye'nin Bulgaristan Türkleri Politikası: Konstrüktivist Bir İnceleme" [Politika e turqve të Bullgarisë në kohën e Turgut Özal-it: Vështrim i përgjithshëm konstruktivist], *JOBEPS*, vëll. 3, n. 6, 2014.

Daskalova, Krassimira (ed.), Zëri i tyre. *Historia gojore Intervistat me gratë*, trans. E. Stoitsova dhe R. Muharska, Sofje 2004.

Dekleris, M., *Κυπριακό: Η τελευταία ευκαιρία, 1972-1974* [Çështja e Qipros: Mundësia e fundit, 1972-1974], Athinë 2003.

Den na razdelenite. Prva svetska sredba na decata begalci od Egejskiot del na Makedonija Skopje 1948-1988 [Dita e ndarjes. Bashkimi i fëmijëve refugjatë të Luftës së Parë Botërore nga pjesa e Egjeut të Maqedonisë. Shkup 1948-1988], Shkup 1993.

Denegri, Jerko, *Umjetnost konstruktivnog pristupa* [Arti i qasjes konstruktive], Zagreb 2000.

Đilas, Milovan, *Nova klasa* [Klasa e re], Narodna knjiga, Belgrade 1990.

Dokos, Thanos (ed.), *Η προσχώρηση της Ελλάδας στο NATO (1952)* [anëtarësimi i Greqisë në NATO], IBE, Athinë 2013.

Dolenc, Ervin, Aleš Gabrič, Marjan Rode, *Koraki v času* [Steps in time], DZS, Ljubljana 1997.

Doxiadis, K. (ed.), *Αι θυσίαι της Ελλάδος στο Δεύτερο Παγκόσμιο Πόλεμο* [Sakrificat e Greqisë në Luftën e Dytë Botërore], Athinë 1946.

Duda, I., *Pronađeno blagostanje* [Begatia e zbuluar], Zagreb 2010.

Đukić, Slavoljub, *Političko groblje* [Varreza politike], Beograd 2009.

Đurić, Mihailo, "Smišljene smutnje" [Obskurantizëm i qëllimshëm], *Anali pravnog fakulteta u Beogradu*, 3, 1971.

Düzgün, Mücahit, "Cumhuriyet'in İlanından İsrail'in Kuruluşuna Kadar Türkiye'deki Yahudiler" [Hebrenjtë në Turqi nga themelimi i Republikës deri te shteti i Izraelit], *Çağdaş Türkiye Tarihi Araştırmaları Dergisi*, çështja 9-10, 2000.

Eberhardt, Piotr, "Proceset e shpopullimit në zonat rurale të Evropës Qendroro-lindore (1950-1990), 1993, http://www. home.umk.pl/~eec/wp-content/uploads/1993_4_ Eberhardt.pdf

Erdelja, K., lufta e Dytë Botërore*, Libër Pune 4*, CDRSEE, Selanik 2009.

Ertem, Barış, "Türkiye Üzerindeki Sovyet Talepleri ve Türk Sovyet İlişkileri,1939-1947" [Pretendimet sovjetike për Turqinë dhe marrëdhëniet turko-sovjetike], *Uluslararası Sosyal Araştırmalar Dergisi*, vëll. 3/11, 2010.

Fleming, Amalia, *A Piece of Truth*, London 1972.

Geiger, V., *Logor Krndija 1945-1946* [Kampi i përqendrimit Krndija], Hrvatski institut zapovijest, Zagreb 2008.

Gilevski, Paskal dhe Gane Todorovski (eds), *Γιάννης Ρίτσος /ЈАНИС РИЦОС, Ποίηση/ПОЕЗИЈА* [Poezitë e Yannis Ritsos], Makedonska kniga, Shkup 1985.

Grasso, Dana Maria Niculescu, *Bancurile politice în ţările socialismului real. Studiu demologic* [Shakatë politike në vendet e realizmit socialist. Studim demologjik], Bukuresht 1999.

Gruev, M. et al, *Nasilie, politika i pamet. Komunisticheskiyat rezhim v Pirinska Makedonia – refleksii na savremennika i izsledovatelya* [Dhuna, politika dhe kujtesa. Regjimi komunist në Pirin ë Maqedonisë– reflektimet bashkëkohore dhe të studiuesve], St. Kliment Shtypi i Universitetit të Ohrit, Sofje 2011.

Gruev, Mihail, "Демографски тенденции и процеси в България в годините след Втората световна война" [Prirjet dhe proceset demografike në Bullgari në vitet pas Luftës së dytë Botërore], in Ivaylo Znepolski (ed.) *История на НРБ. Режимът и обществото* [Historia e Republikës Popullore të Bullgarisë. Regjimi dhe shoqëria], Sofje 2009.

Güven D., *Εθνικισμός, κοινωνικές μεταβολές και μειονότητες. Τα επεισόδια εναντίον των μη Μουσουλμάνων της Τουρκίας (6/7 Σεπτεμβρίου 1955)* [Nacionalizmi, ndryshimet shoqërore dhe minoritetet. Masakra ndaj jomyslimanëve në Turqi (6/7 Shator 1955)], botimet Estia, Athinë 2006.

Hanhimäki, Jussi M. dhe Odd Arne Westad (eds.), Lufta e Ftohtë. Historia në dokumente dhe rrëfimet e dëshmitarëve*, Shtypi i Universitetit* të Oksfordit, 2003.

Harlaftis, Gelina, *Ιστορία της ελληνόκτητης ναυτιλίας 19ος-20ός αιώνας* [Historia e flotës greke, shekujt 19 dhe 20], Athinë 2001.

Hastaoglou, V., C. Hadjimichalis, N. Kalogirou and N. Papamichos, "Urbanizimi, kriza dhe politika urbane në Greqi", *Antipode* 19/2, 1987.

Hatzivassiliou, Ev. (ed.), *Η εξωτερική πολιτική της Ελλάδας με την πένα του γελοιογράφου* [Politika e jashtme e Greqisë me Penën e Karikaturistëve], Athinë 2000.

Hristov, Hristo, *Убийте "Скитник": българската и британската държавна политика по случая Георги Марков* [Vriteni endacakun: Politikat e shtetit bullgar dhe britanik për çështjen e Georgi Markov-it], Sofje 2006.

Jugoslavija 1945-1985, Savezni zavod za statistiku, Beograd 1986.

İnönü, İsmet, *İnönü'nün Söylev ve Demeçleri* [Fjalimet dhe deklaratat e Inönü-së], vëll. I., Türk Devrim Tarihi Enstitüsü [Instituti për Historinë e Revolucionit Turk], Ankara 1946.

Katsapis, Kostas, *Ήχοι και απόηχοι. Κοινωνική ιστορία του ροκ εν ρολ φαινομένου στην Ελλάδα, 1956-1967* [Tingujt dhe jehona. Historia shoqërore e dukurisë së Rock and Roll-it në Greqi], Athinë 2007.

Keeley, Edmund dhe Philip Sherrard (eds.), *Odysseas Elytis. Poezi të përzgjedhura*, Anvil Press Poetry, Londër 1981.

Kiriakov, Boyko et al. (eds), Десталинизацията. Дилемата на едно противоречиво десетилетие. 1953-1956 [Çstanilizimi. Mëdyshja e dhjetëvjeçarit polemizues, 1953-1956], Agjencia e Arkivit të Shtetit, Sofje 2013.

Kirjazovski, Risto, *Македонското национално прашање и Граѓанската војна во Грција* [Çështja Kombëtare Maqedonase dhe Lufta Civile Greke], Instituti i Historisë Kombëtare, Shkup 1998.

Kızılyürek, Niyazi, *Μια εποχή της βίας. Το σκοτεινό 1958* [Kohët e dhunës. Vitit i errët 1958], trans. M. Theodorou, Heterotopia, Limassol 2015.

Kızılyürek, Niyazi, *Bir Hınç ve Şiddet Tarihi: Kıbrıs'ta Statü Kavgası ve Etnik Çatışma* [Kohë dhune. Lufta për statusin dhe etninë në Qipro], İstanbul Bilgi Üniversitesi, Stamboll 2016.

Kostopoulos, T., *Η απαγορευμένη γλώσσα. Κρατική καταστολή των σλαβικών διαλέκτων στην ελληνική Μακεδονία* [Gjuha e ndaluar. Shtypja e dialekteve sllave në Maqedoninë greke nga shteti], Athinë 2000.

Kranaki, Mimika, «*Ματαρόα» σε δύο φωνές - Σελίδες ξενητιάς* ["Mataroa" në dy zëra– faqe nga viset e huaja], Athinë 2008.

Marinski, Lazar and Petar Valchev, Художествено оформяване. Вътрешна и външна украса [Organizime artistike. Zbukurime të jashtme dhe të brendshme], artist bullgar, Sofje 1956.

Markezinis, Spyridon, *Πολιτική ιστορία της νεωτέρας Ελλάδος 1826-1964* [Historia politike e Greqisë Moderne 1826-1964], Papyros, Athinë 1968.

Mate Tadić, Želimirand Crnogorac, *Svjedocanstva o stradanjima Hrvata* [Dëshmitë për vuajtjen e kroatëve], Zagreb 2013.

Meyer, Frau, *Ausländer in Deutschland – Vom Gastarbeiter zum Mitbürger*, Goethe Institut, 2002.

Michail, M.N., *Η επίθεση του Γρίβα εναντίον της Αριστεράς στην περίοδο της δράσης της ΕΟΚΑ 1955-1959. Εν ψυχρώ εκτελέσεις στελεχών της Αριστεράς* [Sulmi i Grivas-it ndaj të majtës gjatë periudhës së veprimit të EOKA-s, 1955-1959. Të majtët ekzekutohen me], e Përjavshmja *Gnomi*, 2012.

Mikula, M., Konceptet kyçe në Studimet Kulturore, Palgrave Mac-Millan, Londër 2008.

Milosavljević, Olivera, *Činjenice i tumačenja. Dva razgovora sa Latinkom Perović* [Fakte dhe interpretime. Dy bisedat me Latinka Perovic], Biblioteka Svedočanstva br. 37, Helsinški odbor za ljudska prava u Srbiji, Beograd 2010.

Mimica, Aljoša and Radina Vučetić, *Vreme kada je narod govorio: rubrika "Odjeci i reagovanja" u listu Politika: jul 1988-mart 1991* [Koha kur njerëzit flasin: rubrika "Jehonat dhe reagimet " në "Politica": korrik 1988 mars 1991], Fond za humanitarno pravo, Beograd 2001.

Poezia Moderne Greke, Përkthimi, Hyrje, Komente dhe Shënime nga Kimon Friar, Grupi Efstathiadis, Athinë 1982.

Moraru, Ion, "Cultura şimasele" [Kultura dhe Masat], in Ştefan Bălan (ed.), *Momente ale revoluţiei culturale din România* [Çastet e revolucionit kulturor në Rumani], Bukuresht 1964.

Murgescu, B. (ed.), *Kombet dhe Shtetet në Evropën Juglindore.*

Libër Pune 2, CDRSEE, Selanik 2009.

Muzeu i Fshatarit Rumun, *Mărturii orale. Anii '80 şi bucureştenii* [Dëshmitë gojore. Vitet 1980 dhe banorët e Bukureshtit], Bukuresht 2008.

Mutafchieva, Vera dhe Ivanova, Marta (eds.), *Историята, населена с хора. Българското общество през втората половина на XX век* [Historia e popullуar me njerëz. Shoqëria bullgare në gjysmën e dytë të shekullit të 20], vëll. 1, Shtëpia Botuese Gutenberg, Sofje 2005.

Arkiva Kombëtare e Bukureshtit, koleksioni: Komiteti qendror i Partisë Komuniste Rumune, pjesa: Ambasada, dosja 85-1971.

Arkivat Kombëtare të Vaslui-t, koleksioni: "Cuza Vodă" Shkolla e Mesme e Huşi-t, dosja 172/1947, vol. II.

Nešović, S., dhe B. Petranović, *AVNOJ i revolucija* [AVNOJ and the Revolution], Beograd 1983.

Fletorja Zyrtare e Inspektoratit të Shkollës të qarkut të Bacău-t, nr. 23-24/janar-shkurt 1948.

Oran, Baskın (ed.), *Türk Dış Politikası. Kurtuluş Savaşından Bugüne Olgular, Belgeler, Yorumlar* [Politika e jashtme turke. Dukuritë, dokumentet, rishikimet që prej Luftës Çlirimtare], İletişim, Stamboll 2002.

Ozbay, Ferhunde (ed.), *Gratë, Familja dhe Ndryshimet Sociale në Turqi*, UNESCO, Bangkok 1990.

Pamuk, Orhan, *Stamboll. Kujtimet dhe Qyteti and the City*, Librat e Qëmotshëm, Nju Jork 2006.

Pantelidou-Malouta, Maro, *Μισός αιώνας γυναικείας ψήφου, μισός αιώνας γυναίκες στη Βουλή* [Gjysmë shekulli e drejtë vote nga gratë, gjysmë shekulli gra në parlament] (2 ed.), Shoqata e Parlamentit Grek për Parlamentarizëm dhe Demokraci, Athinë 2007.

Papadopoulos, G., *Το πιστεύω μας* (Our Creed), vol. I, Eleftheros Kosmos, Athinë 1969.

Pavlou, P.M., *Κράτος, ιδεολογία, πολιτική και εκπαίδευση στην Κύπρο* [Shteti, Ideologjia, Politika dhe Arsimi në Qipro 1959 – 1960], Botuesit Papazisis, Athinë 2015.

Perović, Cedomir dhe Nevenka Ilić (eds.), *Rad Skupstine Crne Gore 1945-1950* [Puna e Parlamentit të Malit të Zi], Titograd 1986.

Petranović, Branko and Momčilo Zečević, *Jugoslavija 1918-1988. Tematska zbirka dokumenata* [Jugosllavia 1918-1988. Koleksioni i dokumenteve], Beograd 1988.

Petranović, Branko and Momčilo Zečević, *Jugoslovenski federalizam: ideje i stvarnost* [Federalizmi Jugosllav: ideja dhe realiteti], 2, Beograd 1987.

Pintilie, Serinela, *Povestirile uitate ale Nicolinei: o istorie a oamenilor şi a fabricii* [Historitë e harruara të Nicolina-s: Historia e popullit dhe fabrikës], Iaşi 2015.

Pllumi, Zef, *"Rrno për me tregue" (Libri i kujtimeve), Pjesa e parë 1944-1951* Shtëpia Botuese "Hylli i Dritës", Tiranë 1995.

Pollo, Stefanaq (ed.), *Historia e Shqipërisë*, vëll. 2, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë 1965.

Pollo, Stefanaq (ed.), *Historia e Shqipërisë*, vëll. 3 (1912-1944), Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë 1984.*Pravopis hrvatskosrpskoga književnog jezika s pravopisnim rječnikom,* [Drejtshkrimi i gjuhës standarde kroato-serbe me fjalor drejtshkrimor], Shoqëria Kulturore Kroate, Zagreb, dhe Shoqëria Kulturore Serbe, Novi Sad, 1960.

Prcela, John, *Hrvatski holokaust* [Holokausti kroat], Zagreb 2001.

Radelić, Zdenko, *Križari: Gerila u Hrvatskoj 1945-1950* [Kryqëzatat:Lufta guerile në Kroaci 1945-1950], Alfa, 2011.

Radenkovic, Mile, *Амина Бојаџи: хероината од Ла*

Манш [Atina Bojadzi: Heroi nga La Manshi], Bashkia e Karposit, Shkup 2001.

Ramet, Sabrina P., *Katolicizmi dhe Politikanë shoqëritë komuniste*, Duke University Press, 1990.

Ranilović, Vjekoslav, *Nevin a osuđen. Istina i dokumenti o kardinalu dr. Alojziju Stepincu* [*Të pafajshëm, por të ndëshkuar. E vërteta dhe dokumentet e Kardinal Dr.* Dr Alojzije Stepinac], Koprivnica 1997.

Roske, Octavian, Florin Abraham and Dan Cătănuş, *Colectivizarea agriculturiiîn România. Aspecte legislative 1949-1962* [Kolektivizimi bujqësisë në Rumani. Aspektet ligjore, 1949-1962], Bukuresht 2007.

Sarınay, Yusuf, *Türkiye'nin Batı ittifakına yönelişi ve Nato'ya girişi (1939-1952)* [Turqia afrohet me Aleancën Perëndimore dhe anëtarësohet në NATO], Ministria e kulturës dhe Turizmit në Turqi, Ankara 1988.

Sedmak, Drago (ed.), *Primorska 1918-1947. Katalog stalne razstave* [Bregdeti slloven 1918-1947. Katalogu i Ekspozitës së Përhershme], muzeu Goriški, Nova Gorica 2002.

Službeni list NRBiH [Flertorja Zyrtare e Republikës Popullore të Bosnjë-Hercegovinës], nr. 32, 5 tetor 1950.

"Stanje i problemi u jugoslovenskoj kinematografiji" [Shteti dhe problemet e kinematografisë jugosllave], *Filmska kultura* 68-69, dhjetor 1969.

Statistički godišnjaci Bosne i Hercegovine od 1948. do 1992 [Vjetari statistikor i Bosnjë-Hercegovinës nga 1948 deri në 1992] Zavod za statistiku Bosne i Her-cegovine, Sarajevë.

Statistički godišnjak Jugoslavije 1990, Beograd 1990. *Statistički godišnjak Jugoslavije 1991,* Beograd 1991. Stojanović, Milinko B., *Svedočanstva zločina: Uspomene*

i doprinosi, dokumentacija i pregled. Treća Knjiga Golootočke Trilogije [Dëshmitë e krimeve: Kujtimet dhe kontributet, dokumentimi dhe vështrimi i përgjithshëm. Libri i tretë i trilogjisë së ishullit Goli], Stručna knjiga, Beograd 1994.

Svoronos, Nicos, *Επισκόπηση της Νεοελληνικής Ιστορίας* [Anketimi i Historisë Moderne Greke], Botimet Themelio, Athinë 1978 [botimi 1st në frëngjisht, 1952].

Tenev, Georgi, "Shkrimi në mur", në Vassileva, Maria (ed.) *Art për Ndryshim. 1985-2015*, Shtëpia botuese ushtarake, Sofje 2015.

Thanasekou, V., *Η θέση της γυναίκας και ο ρόλος της στην οικονομική, κοινωνική και πολιτική ζωή της χώρας μας* [*Pozita dhe roli i grave në jetën ekonomike, shoqërore dhe politike të vendit tonë*], Athinë 1956.

Theodorou, T., «Βιογραφικές ρήξεις και ηθικός πανικός.

Η κοινότητα των χίπις στα Μάταλα, 1965-1975» [Këputjet bibliografike dhe paniku moral. Komuniteti hipi në Matala, 1965-1975], teza e MA-së, Universiteti i Kretës, Rethimno 2007.

Todorov, Petar, *Personal Testimonies*, Fotonika, Sofia 1999.

Tsakalotos, Thrasyvoulos, *40 χρόνια στρατιώτης της Ελλάδος. Πως εκερδίσαμε τους αγώνας μας, 1940-1949* [Dyzet vjet ushtar grek. Si e fituam luftën, 1940-1949], Athinë, 1960, vëll.

Il. Tsaldari, Lina, *Εθνικαί, κοινωνικαί, πολιτικαί προσπάθειαι*

[Përpjekjet kombëtare, shoqërore dhe politike], vëll. II, Athinë 1967.

Ustav Federativne Narodne Republike Jugoslavije [Kushtetuta e Republikës Popullore të Jugosllavisë], Neni 24. Botuar nga shtypi shtetëror, Beograd 1946.

Ustav Narodne Republike Bosne i Hercegovine [Kushtetuta e Republikës Popullore të Bosnjë-Hercegovinës], Neni 25, Fletorja Zyrtare e RPBH-së, viti III, nr. 1, Sarajevë, 1947.

Velikonja, Mitja, Ndarja fetare dhe intoleranca politike në Bosnjë-Hercegovinë,

Teksas, Universiteti A&M

Shtypi, 2003.

Vergnet, Paul, and Jean Bernard-Derosne, *L'Affaire Petkov*, Paris 1948, in Zhoro Cvetkov, Съдът над опозиционните лидери [Gjyqi i udhëheqësve të opozitës], Kupesa, Sofje 1991.

Vryonis, Sp., Mekanizmi i katastrofës. *Masakra turke e 6-7 shtatorit 1955, dhe shkatërrimi i komunitetit grek të Stambollit* Greekworks.com, Nju Jork 2005.

Zbornik na dokumenti od Antifashitickoto sobranie na narodnoto osloboduvanje na Makedonija (ASNOM). Dokumenti za obrazuvanjeto i zakonodavno izvrsnata dejnost na ASNOM od Prespanskoto sovetuvanje na CK KPM do Prvoto vonredno zasedanie na ASNOM (2.VIII.1943-28/30. XII.1944) [Koleksioni i dokumenteve të Asamblesë Antifashiste të Frontit Nacionalçlirimtar të Popullit Maqedonas (ASNOM). Dokumentet lidhur me themelimin dhe veprimtaritë legjislativo-ekzekutive të ASNOM-it që prej Deklaratave të Prespës së Komitetit Qendror të Popullit Maqedonas deri te seanca e parë e jashtëzakonshme të ASNOM-it], Instituti i Historisë së Shkupit, Shkup 1964.

Zečević, Miodrag, libri i parë i dokumenteve nga gjyqi i Lëvizjes Ravna Gora Movement 10 qershor – 15 korrik 1946, rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare, zbardhje të plota, kërkesa për falje, shkurtime, kode, pseudonime, lista e dokumenteve të përdorura, dokumentet më të rëndësishme, bibliografia dhe indeksi SUBNOR [Shoqata Federale e Luftës së Dytë Botërore të Jugosllavisë], Beograd 2001.

Zhivkov, Todor, *За партийното строителство. Доклади, речи, статии* [Për rindërtimin e partisë.

Raportet, fjalimet, artikujt], vëll. III, Sofje 1978.

Δεκαοκτώ κείμενα [Tetëmbëdhjetë tekste], Botimet Kedros, Athinë 1970.

Πρακτικά της Βουλής Punimet Parlamentare], vëll 7, Athinë 1976.

Външната политика на НРБ. Министерство на Външните работи. Сборник от документи и материали [Politika e jashtme e Republikës Popullore të Bullgarisë. Ministria e Punëve të Jashtme. Koleksioni i dokumenteve dhe materialeve], vëll. 4 dhe 5, Naouka i izkustvo, Sofje 1988.

Сборник нормативни актове, примерни сценарии и слова за граждански ритуали [Koleksion i akteve, dorëshkrime dhe fjalime shabllon për ritualet civile], Sofje 1975.